

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE SHKENCORE

# “TË MOHUAR NGA REGJIMI”

Burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe  
puna e detyruar në Shqipëri në 1945-1990

30-31 Tetor 2018



# **TË MOHUAR NGA REGJIMI**

**Përmbledhje e kumtesave dhe referateve të mbajtura në Konferencën organizuar nga  
Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit**

**Tiranë, më 30-31 tetor 2018**

**Tiranë, 2019**

Përgatiti për botim:

**Prof. Asoc. Dr. Sonila Boçi**

Redaktore gjuhësore:

**Meliha Balla**

*Fjala e hapjes e kryetares së AIDSSH-së, znj. Gentiana Sula, në Konferencën shkencore “Të mohuar nga regjimi: kampet, burgjet dhe puna e detyruar”*

## **Narrativë përbashkuese dhe e çliruar nga ideologjia, mbi themelin e të vërtetave historike**



**Sot është një ditë e shënuar.**

AIDSSH me partnerë shumë të çmuar ia ka dalë ta gjejë veten duke luajtur një rol të rëndësishëm, mes një procesi të hulumtimit që synon rishqyrtimin e historisë bashkëkohore, '44 -'90.

36 studiues, nga brenda dhe jashtë vendit, kanë vënë mundin e djersën e tyre, plus intelektin dhe formimin, me qëllim që të ndihmojnë shoqërinë tonë t'u përgjigjet pyetjeve “Pse?” dhe “Si ndodhi?”, që në një kohë aspak të largët shqiptarët u “vunë kundër njëri-tjetrit”, siç e thotë bukur një rrëfyes.

Shkollarët thonë, dhe ne e kemi provuar në lëkurë, që studimi i historisë bashkëkohore ka sfida të mëdha. Protagonistët ende jetojnë, faktet akoma nuk kanë dalë të gjitha në dritë; kujtimet dhe ditarët janë ende pa mbledhur e pa botuar; arkivat, përveçse janë masive, janë ende të pashfrytëzueshme plotësisht.

Një ndër tre të pyetur në vitin 2015 deklaroi se i përket një familjeje që ka përjetuar burg, internim, deportim, shpronësim apo është përjashtuar nga Partia e Punës. Mungesa e një procesi të mirëfilltë shkencor për studimin e historisë ka bërë që empatia dhe mirëkuptimi të mungojë sot e kësaj dite për këto privime. Nga njëra anë është zemërimi, trishtimi, ankthi, humbja dhe të ndjerët i përjashtuar nga grupet e prekura, kurse nga ana tjetër është mohimi i krimeve, mungesa e ndjeshmërisë për vuajtjet dhe viktimat, si dhe nostalgjia për arritjet e diktaturës, siç u bë e qartë në studimin që OSBE kreu mbi perceptimet për diktaturën në vitin 2016.

Për më tepër, në rastin e Shqipërisë, ashtu si në vendet e bllokut lindor, ka dominuar për 50 vjet një indoktrinim masiv, përmes deformimit apo përdorimit selektiv të evidencave, që ka synuar legjitimitimin e sistemit totalitar dhe shtypjen e kundërshtarëve politikë, brez pas brezi. Si përfundim, të vërtetat janë ende pa zbuluar. Historia e shumë të prekurve dhe të përndjekurve nga regjimi ende nuk është thënë e nuk është qartësuar as nga ata vetë. Bashkësitë janë ende në terr për ngjarje të rëndësishme, lidhje shkak-pasojë për to, etj.

Një ndër dëshmitaret e vuajtjeve të kampit të Tepelenës, Gjelë Gjikota që ende jeton, e shprehu me fjalët e saj të zemrës se “Shqipëria është e vogël për t'u parë, por edhe për t'u qarë”. E vërtetë.

A është normale që ende sot të mbetemi kaq të përçarë? Kaq të pandjeshëm për vuajtjet e bashkëqytetarëve tanë? Kaq pak të interesuar për të vërtetat?

Vetëm një studim korrekt dhe një dialog i bazuar në dokumente dhe fakte mund të bëjë të mundur që historia bashkëkohore '45-'90 e periudhës që kemi në dorë, të mund të kuptohet më mirë.

Ç'është një hulumtim? Është një investigim sistematik dhe studim i një materiali dhe burimi, me qëllim që të tregohen fakte dhe të mbërrihet në konkluzione.

Çfarë është një hulumtues? Dikush që studion një subjekt në mënyrë të kujdesshme, me qëllim që të zbulojë informacion të ri, ose ta kuptojë më mirë këtë subjekt.

Më lejoni të ndaj me ju **3 synime drejt të cilëve po ecim me hapa të shpejtë**, pikërisht për t'i shërbyer kësaj kategorie hulumtuesish sistematikë, që bazohen në burime dhe fakte, për të themeluar të vërteta dhe arritur në konkluzione.

**Së pari:** Në AIDSSH, objektivi kryesor është qasja në dokumentet e ish-Sigurimit, të bëhet sa më e kollajshme, e papenguar dhe e dobishme. Deri më sot:

Po identifikojmë dhe mbledhim, përmes negociatave dhe bashkëpunimit me institucionet që kanë dokumente të ish-Sigurimit, MPB, SHISH, Arkivi Qendror i Shtetit, prokurori, degë të rretheve, drejtori të burgjeve, gjykata...; të cilat, në masën më të madhe i kanë vënë në dispozicion dhe i kanë dorëzuar ato në arkivin e AIDSSH-së.

Po i përpunojmë dhe po i rendisim, në atë mënyrë që të bëhen sa më të dobishme.

Po i deklasifikojmë dhe anonimizojmë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë, me qëllim që interesi kombëtar të mbetet i pacenuar nga hapja e arkivave sekrete, por edhe personat të mos riviktimizohen përmes publikimit të thashethemeve dashakeqe që ushqenin urrejtjen klasore.

Po i shërbejmë dokumentet publikut në zyrat tona, në formë të digjitalizuar.

Po i publikojmë rast pas rasti, në formë inventarësh, të zbardhura në libër, ose online në faqe zyrtare, apo në media sociale.

Po i shoqërojmë me studime të studiuesve, e deri në ekspozita, apo kemi konceptuar edhe muzealizim.

**Së dyti:** ne në AIDSSH kemi marrë angazhim që të organizojmë sa më mirë bashkëpunimin me viktimat dhe familjet e tyre.

*Është arritje bashkëpunimi mes tre institucioneve publike dhe krijimi i një partneriteti të gjerë, në mbështetje të konferencës.*

Qëllimi është që të dëgjohet edhe zëri i viktimave.

Fakti është që në dosjet e Sigurimit mungon zëri i viktimave. Për ju të gjithë kjo është e qartë se pse. Këto dosje organizoheshin për të shtypur e kontrolluar armiqtë e Partisë. Institucioni i mbrojtjes përmes avokatit mbrojtës nuk ekzistoi. Po shpesh procedurat kanë qenë jashtëligjore. Mjafton të përmend rastin e të internuarve në kampet me tela me gjemba deri në 1954, ku me qëllim të qartë nuk hartoheshin as lista, por kishte vetëm numra.

Qytetarët që afrohen tek AIDSSH kanë shumë për të thënë. Është fakt se dosjet e Sigurimit janë një burim i rëndësishëm për të prekurit, për të qartësuar fatin e tyre në diktaturë, por në të njëjtën kohë, njerëzit nuk janë të reduktuar vetëm në atë sa i ka menduar Sigurimi. Ata kanë versionin e tyre të ngjarjes. Kanë ruajtur dëshmi të rralla, ditarë, arkiva familjare, foto, punime profesionale e artefakte që kanë shumë vlerë për të përcaktuar narrativën e tyre personale apo familjare. E cila, sidomos në rastet e figurave me rol publik, ka rëndësi për të gjithë ne.

Për më tepër, ata kanë zërin e tyre, përjetimet e tyre, rrjedhën e ngjarjeve, të cilën studiuesit duhet ta përdorin patjetër, bashkë me materialet arkivore që gjenden për to.

Për këtë arsye, AIDSSH, me gjithë mundësitë e veta të pakta, do të mundohet të mbledhë sa më shumë nga zëri i viktimave. Kështu mori jetë projekti “Edhe Muret Kanë Veshë”, i cili lajmëroi publikun e gjerë brenda dhe jashtë vendit, që dëshmitë e tyre janë të nevojshme dhe që kanë vlerë historike. Botimi i parë i rrëfimeve mbi kampin e Tepelenës doli në qarkullim edhe online dhe shpresojmë, në varësi të burimeve, të mund ta zgjerojmë këtë aktivitet. Qëllimi ynë është që brezat e rinj që do të interesohen në një kohë që të mbijetuarit nuk do të jetojnë më, të kenë mundësi ta kenë edhe këtë burim.

“  
Është mirë që ne, burokratët, mbetemi  
vetëm në shërbim të krijimit të kushteve, që  
studiuesit të mblidhen e të diskutojnë për  
një temë kaq të prekshme dhe aktuale.  
”

**Së treti:** të ndërtojmë partneritete sa më të frytshme me vendet që patën fat të ngjashëm historik me Shqipërinë, me qëllim që të mund të konceptualizojmë sa më mirë punën tonë në shërbim të hulumtuesve dhe publikut, të mësojmë si ta kontekstualizojmë sa më mirë dhe ta tregojmë në mënyrë të tillë që t’i shërbejë publikut të gjerë dhe sidomos rinisë, që nuk ka përvoja personale me diktaturën, por ka gjithsesi probleme me përballjen e trashëgimisë së Sigurimit dhe diktaturës, në familje apo më gjerë, në përpjekje për të ndërtuar një shtet të së drejtës e demokraci funksionale.

Në këtë kontekst, më lejoni të falënderoj për praninë në këtë konferencë të një përfaqësie të nderuar të Rrjetit European të Kujtesës dhe Solidaritetit, ku Shqipëria, prej 2016 është vend vëzhgues.

*Organizimi i çdo elementi të formatit dhe përmbajtjes, si dhe komunikimit me studiuesit, u krye nga këshilli shkencor, i cili funksionoi më së miri.*

Personalisht, kam fatin ta përfaqësoj Shqipërinë në këtë rrjet të vlefshëm hulumtuesish dhe institucionesh nga vende të ndryshme të Europës Lindore e Qendrore, të cilët, me kurajën e provave dhe fakteve, dhe me disiplinën e racionalitetin e shkencës bëjnë të mundur që historia bashkëkohore e shekullit XX në Europë, që krijoi shumë luftëra e diktatura dhe dëmtoi miliona njerëz, të mund të kuptohet sa më mirë, me të vërtetat në themel, duke ndërtuar një narrativë përbashkuese, të çliruar nga ideologjia, dhe që është në shërbim të paqes e bashkëpunimit mes grupesh shoqërore, etnish, racash dhe vendesh.

Po ashtu, do të falënderoj një emër të nderuar të përpjekjeve për të vërtetën e shekullit XX, z. Lukas Kaminski, që ka pasur fatin të drejtojë Institutin e Kujtesës në Poloni, dhe që mbetet aktiv në këtë fushë, në rrafshin europian.

Falënderime edhe për përfaqësuesit e institucionit homolog në Gjermani, që po ashtu ndajnë me ne eksperiencën gjermane në kampet e punës. Çdo ditë që zbatojmë ligjin për hapjen e dosjeve, që u ndërtua sipas modelit të zbardhjes së STASI-t, admirojmë cilësinë e mendimit që ngërthen ky ligj dhe ky institucion, që e kemi një ndër partnerët kryesorë në punën tonë.

Këta vizitorë të çmuar do të na ndihmojnë që të konceptojmë punën tonë, duke pasur të qartë të përbashkëtat dhe ndryshimet me vendet e tjera të bllokut komunist, qoftë të mënyrës se si funksionoi sistemi, qoftë të mënyrës se si funksionuan kampet, burgjet dhe puna e detyruar.

Në bashkëpunim me kolegët më sipër dhe me komunitetin e hulumtuesve në vend, do të mundohemi të ndihmojmë për të ngritur një agjendë kombëtare për kërkimin shkencor dhe përkujtimin, përfshirë këtu edhe objektet e ndërgjegjes, për të cilat është bërë ende shumë pak.

Kjo agjendë do të na ndihmojë për t'u fokusuar, përmirësuar bashkëpunimin mes nesh, dhe, - e ndihmuar nga puna jonë e vazhdueshme, - t'i shërbejë rishqyrtimit të historisë dhe edukimit qytetar. Kjo agjendë do të na ndihmojë që të llojmë me qeverinë edhe përmes partnerëve ndërkombëtarë, me qëllim që të zbatohet sa më shpejt e më mirë, aq më shumë se Shqipëria është e vonuar në këtë fushë.

## PASQYRA E LËNDËS

<b>Lukas Kaminski - ENRS, Poloni</b> .....	6
Deportimet komuniste dhe puna e detyruar - Eksperienca polake. Historia dhe Kujtesa. ....	6
<b>Tobias Wunschik - BSUT, Gjermani</b> .....	6
Puna e detyruar në Republikën Demokratike Gjermane, 1950-1990. ....	6
<b>Lory Amy - Georgia Southern University</b> .....	6
Problemi Hoxha: Historia, kujtesa dhe arkitektura e shtetit të terrorit .....	6
<b>Hamit KABA - Instituti i Historisë/ASA, Tiranë</b> .....	7
Komunizmi shqiptar: ngjashmëri dhe veçori me vendet e tjera komuniste të Evropës Lindore e Qendrore (1944-1948).....	7
<b>Klejd Këlliçi - Fakulteti i Shkencave Sociale - Universiteti i Tiranës</b> .....	20
Gulagu European: Regjimi i kampeve të punës dhe përqëndrimit në Shqipëri, Gjermani Lindore dhe Bullgari, 1946-1950.....	20
<b>Afrim Krasniqi - Instituti i Historisë/ASA, Tiranë</b> .....	38
Trajtimi i të kaluarës në raport krahasues: Shqipëria dhe Evropa Lindore .....	38
<b>Beqir Meta - Instituti i Historisë/ASA, Tiranë</b> .....	62
Vështrim analitik mbi sistemin e burgjeve, internimeve dhe përdorimin e punës së detyruar gjatë regjimit komunist në Shqipëri .....	62
<b>Sabit Sylja - Instituti i Historisë, Prishtinë</b> .....	76
Vendosja e pushtetit jugosllav në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare (1944 – 1945).....	76
<b>Ana Lalaj - Instituti i Historisë/ASA, Tiranë</b> .....	86
Pushteti dhe ‘tjetri’ që është përballë (Montimi i regjimit komunist në Shqipëri, 1944-1954 ).....	86
<b>Dorian Koçi - Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë</b> .....	103
Aparati stalinist i dhunës në burgjet e kampet e punës në Shqipëri 1949-1953 .....	103
<b>Ardiana Topi - AIDSSH, Tiranë</b> .....	111
Tipologjia e dokumenteve të krijuara nga ish Sigurimi i Shtetit 1944-1991.....	111
<b>Femi Sufaj, Marinela Sota - Universiteti i Tiranës</b> .....	129
Jeta në kampet e punës së detyruar, nga vështrimi i raporteve zyrtare.....	129
<b>Gjon Boriçi - Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë</b> .....	149
Pohimi nga Byroja Politike e PPSH të dhunës ndaj të burgosurve dhe internuarve nga organet e Sigurimit të Shtetit deri në vitin 1953 .....	149
<b>Ermira Shtino, Marenglen Kasmi - AIDSSH, Tiranë</b> .....	166
Robërit gjermanë të luftës dhe puna e detyruar gjatë viteve 1944-1952 .....	166
<b>Nevila Nika - Universiteti European i Tiranës</b> .....	176



Trajtimi i shtetasve italianë në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore- nga prof. Venanzio Lozzi tek At Giacomo Gardin .....	176
<b>Sonila Boçi - Instituti i Historisë/ASA, Tiranë</b> .....	184
Vizatimi i fytyrës së “armikut të popullit” në vitet e para të regjimit komunist .....	184
<b>Gjon Berisha - Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë</b> .....	194
Persekutimi i klerit katolikë nga Kosova që shërbeu në Shqipëri gjatë regjimit komunist. ....	194
<b>Ermal Frashëri - Universiteti i Harvardit, USA</b> .....	204
Një vështrim mbi rregullimin juridik të punës gjatë periudhës 1944-1991.....	204
<b>Çelo Hoxha - ISKPK, Tiranë</b> .....	215
Paligjshmëria e vendimeve të internim-dëbimit në periudhën 1944-1954.....	215
<b>Etleva Smaçi - Akademia e Forcave të Armatosura, Tiranë</b> .....	226
Shfrytëzimi i krahut të punës në repartet e Xhenios dhe Ndërmarrjet Ushtarake Bujqësore: trajtimi diskriminues i ushtarëve që vinin nga familjet e deklasuar .....	226
<b>Selami Zalli - AIDSSH, Tiranë</b> .....	235
Shkodra në vitet e vendosjes së diktaturës, 1945-1953, nga këndvështrimi i Historikut të Sigurimit të Shtetit.....	235
<b>Alma Liço Mirakaj, Merita Sauku Bruci - Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë</b> .....	252
Internim-dëbimet familjare në zonën e Dumresë 1968-1991: dëshmi dhe refleksione.....	252
<b>Natasha Llanaj Perunja - Veprimtare e të drejtave të njeriut</b> .....	268
Qyteti minator i Selenicës në Vlorë.....	268
<b>Fiona Todhri, Eris Dhamo - Universiteti i Tiranës</b> .....	276
Identiteti dhe profili i grave të dënuara politike në periudhën komuniste (1946-1990).....	276
<b>Agron Tufa - ISKPK, Tiranë</b> .....	287
Mnemozina e topikëve të trishtë letrarë .....	287
<b>Leonora Laçi - ISKPK, Tiranë</b> .....	301
Totalitarizmi shqiptar përmes disa shkrimtarëve.....	301
<b>Kejsi Ziu - Universiteti i Tiranës</b> .....	309
Spiunë dhe sabotatorë: Sakrifikimi i inxhinierëve të Maliqit dhe akuza për mision agjenturor amerikan gjatë regjimit komunist shqiptar .....	309
<b>Gjergj Sinani - Universiteti i Tiranës</b> .....	323
Kujtesa dhe historia në diskursin post-totalitar .....	323
<b>Enriketa Pandlejmoni (Papa) - Universiteti i Tiranës</b> .....	338
Kujtesa dhe rrëfimi i historive jetësore mbi kampet e punës së detyruar, internimet dhe burgjet në Shqipërinë Komuniste .....	338
<b>Erald Kapri - Autoriteti i Mediave Audiovizive</b> .....	355
Vështrim krahasues mbi rehabilitimin e viktimave të komunizmit, rasti çek, gjerman, polak, estonez dhe rumun.....	355

<b>Sara Çapaliku - Juriste</b> .....	362
<b>Interesi publik në Shqipëri: Ballafaqimi me të shkuarën komuniste, në kontekstin e Integritimit Evropian</b> .....	362
<b>Etleva Demollari - Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"</b> .....	370
Muzeu kombëtar i përgjimeve "shtëpia me gjethe" në përballje me të kaluarën .....	370
<b>Roland Qafoku - TV Channel One</b> .....	383
Persekutorët përballë të persekutuarve pas rrëzimit të komunizmit .....	383
<b>Edlira Agolli - Prezenca e OSBE në Shqipëri</b> .....	396
Roli i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në mbështetjen e dialogut kombëtar për të kaluar komuniste në Shqipëri .....	396
<b>Blerina Këllezi, Aurora Guxholli, Clifford Stevenson - Nottingham Trent University, UK</b> .....	406
Diktatura nga këndvështrimi i të prekurve: Roli i familjes .....	406
<b>Lukas Kaminski - ENRS, Polani</b> .....	419
Communist Deportations and Forced Labour: the Polish Experience. ....	419
<b>Tobias Wunschik - BSUT, Germany</b> .....	430
Forced labour in the German Democratic Republic 1950-1990 .....	430
<b>Lory Amy - Georgia Southern University</b> .....	435
The Problem of Hoxha: Communist Heritage and the Demands of the Dead .....	435

## **Hamit KABA - Instituti i Historisë/ASA, Tiranë**

### **Komunizmi shqiptar: ngjashmëri dhe veçori me vendet e tjera komuniste të Evropës Lindore e Qendrore (1944-1948)**

#### **Abstrakt**

Analizohet sesi me asistencën e PKJ dhe të shtetit jugosllav, komunistët shqiptarë që gjatë Luftës, eliminuan kundërshtarët politikë dhe në mungesë të partive të tjera politike, pra, edhe të pluralizmit, pas luftës morën gjithë pushtetin politik në duart e tyre. Fshehja dhe manipulimi i këtij realiteti pas të ashtuquajturit Front Demokratik, duke e lënë gjoja PKSH në ilegalitet, instalimi i një modeli komunist, mungesa e marrëdhënieve diplomatike me SHBA dhe Britaninë e Madhe, lufta e klasave, rënduan gjendjen brenda dhe pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë dhe i dhanë regjimit komunist shqiptar pamjen më të egër në raport me çdo vend tjetër të Evropës Lindore.

Në kumtesën time trajtohen dhe analizohen dy probleme kryesore që kanë të bëjnë me komunizmin shqiptar, *së pari*, me rrënjët e tij, të cilat gjenden te Lëvizja Nacionalçlirimtare, dhe *së dyti*, me veçoritë dhe ngjashmëritë e tij me vendet e tjera ish-komuniste të Evropës. Kuntimi im mbështetet kryesisht në burime arkivore shqiptare e të huaja dhe në një numër botimesh mbi shtetet totalitare komuniste të Evropës Lindore e Qendrore.

#### ***Lufta e Dytë Botërore-bazamenti i regjimit komunist në Shqipëri.***

Rrënjët e vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri duhen kërkuar tek Lufta e Dytë Botërore (LDB): te lindja e Partisë Komuniste Shqiptare (PKSH) dhe rezistenca kundër pushtuesve italianë e gjermanë, e ideuar dhe e drejtuar prej saj; tek përpjekjet e saj pa kompromis për marrjen e pushtetit - deri në asgjësimin e plotë të kundërshtarëve politikë e ushtarakë [Ballit Kombëtar dhe Legalitetit]; tek mbështetja deri - diku e detyruar e dy Aleatëve Perëndimorë të luftës, Britanisë së Madhe dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. PKSH do ta kishte pasur të vështirë, në mos të pamundur, që t'i arrinte synimet e saj, pa pasur në favor rrethanat ndërkombëtare. Në mënyrë të veçantë duhet theksuar roli dhe pesha e Bashkimit Sovjetik në LDB dhe ndikimi i tij i thellë në politikën globale të pasluftës. Pavarësisht se trupat e Ushtrisë së Kuqe nuk e shkelën territorin shqiptar, sikurse ndodhi me disa vende të tjerë të Evropës Lindore e Qendrore (prania e të parit mision ushtarak të BS në Shqipëri u bë e mundur vetëm në gusht 1944), ndikimi i tij mbi komunistët shqiptarë ishte i madh në aspektin ideologjik, frymëzues dhe të modelit të zgjedhur.

Çdokush që ka parë sadopak dokumentet arkivore shqiptare e të huaja të periudhës së LDB e ka vënë re trajtimin e diferencuar të BS në krahasim me dy Aleatët Perëndimorë të Luftës. Aleanca me BS është veçuar e dalluar qartësisht në çdo takim të rëndësishëm të mbajtur nga komunistët shqiptarë, ndonëse nuk janë lënë pa u përmendur as aleatët anglo-amerikanë, të cilët padyshim kontribuan më shumë se çdo kush tjetër për fitoren e shqiptarëve mbi Fuqitë e Boshtit, me praninë e misioneve të tyre në Shqipëri [që nga pranvera dhe vjeshta e vitit 1943],

sidomos me ndihmat dhe furnizimet e tyre ushtarake, të cilat shkuan kryesisht për Lëvizjen Nacionalçlirimtare (LNÇ). Por, padyshim kjo panoramë nuk do të kishte qenë e plotë, pa përmendur rolin e Partisë Komuniste Jugosllave e të Titos, të cilët ishin realisht ‘mësuesit’ e udhëheqësve komunistë shqiptarë, të pranishëm në themelimin e PKSHE dhe në çdo ngjarje tjetër të rëndësishme gjatë dhe pas luftës, para dhe pas skenës.

PKSH dhe Enver Hoxha pasi hodhën poshtë vendimet e Konferencës së Mukjes (gusht 1943) u përpoqën të hidhnin bazat e pushtetit të ardhshëm komunist, duke filluar me Konferencën e Labinotit (shtator 1943), dhe në mënyrë të veçantë me vendimet e marra në Kongresin e Përmetit (maj 1944) dhe në Mbledhjen e Beratit (tetor 1944). Me krijimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe të Qeverisë Demokratike, të dala përkatësisht nga Kongresi i Përmetit dhe nga Mbledhja e Beratit, u dha goditje përfundimtare shpresave për kompromis dhe për qeveri gjithëpërfshirëse e me bazë të gjerë. Përpjekjet e mbretit Zog, të mbështetura edhe nga “Vatra” për të krijuar një qeveri të shqiptarëve në emigracion nuk e patën asnjëherë miratimin e qeverive të Aleatëve të Mëdhenj, të cilët nuk njohën gjithashtu asnjë qeveri të krijuar nga FNÇ, si në Kongresin e Përmetit ashtu edhe në mbledhjen e Beratit.

Asnjë nga këshillat dhe sugjerimet e Aleatëve Perëndimorë të Luftës për të zgjeruar bazën e pushtetit nga ana e FNÇ nuk gjeti zbatim. Drejtuesit e rinj të dalë nga lufta e bënë veshin e shurdhër ndaj kërkesave e tyre. Ndonëse u fol e u shkrua për liri e të drejta demokratike të qytetarëve apo për mbajtjen e zgjedhjeve të lira e demokratike pas luftës, shenjat e vendosjes së një regjimi autoritar apo totalitar ishin të dukshme. Për misionet e Aleatëve Perëndimorë krijuan shqetësim të veçantë disa nga vendimet e marra në Përmet e në Berat. Mosnjohja e asnjë qeverie tjetër, përveç asaj që kishte krijuar FNÇ në Përmet, apo vendimi për të mos lejuar kthimin e mbretit Zog në Shqipëri, cenonte ‘Kartën e Atlantikut’ dhe të drejtën e forcave të tjera për të konkurruar dhe vendosur për të ardhmen e vendit. Në Departamentin e Shtetit pati rezerva sidomos për terminologjinë e përdorur në Kongresin e Përmetit, kur thuhej se Lëvizja Nacionalçlirimtare do t’i shkatërronte plotësisht të gjitha ‘klikat e tjera reaksionare’<sup>1</sup>, të cilat nënkuptonin të gjithë ato forca dhe individë që mendonin ndryshe nga komunistët shqiptarë, të cilët nuk ishin dakord me vendosjen e komunizmit në vend, por aspironin për një model tjetër qeverisjeje. Përrjashtimi i tyre nga e drejta për të zgjedhur modelin që ata dëshironin shihej si ogur i keq. Në ato rrethana, në verën e vitit 1944, brenda Departamentit të Shtetit (DSH) u hodh ideja për të krijuar një qeveri të shqiptarëve në Amerikë e njohur nga qeveria amerikane. Gjithashtu u kërkua të bëhej një deklaratë e re për Shqipërinë, më e plotë dhe më e gjerë se sa

---

<sup>1</sup> *The National Archives and Record Administration* (më tej: NARA), Roll 15, Year 1944, 875.009-544, 5 shtator 1944.

Deklarata e Dhjetorit e vitit 1942. Por asnjë nga këto ide nuk gjeti mbështetje, sepse asnjë qeveri e pjesshme nuk mund të përfaqësonte popullin shqiptar dhe aq më pak qeveri të krijuara jashtë vendit, ndërkohë që pesha e rëndesës gjendej brenda vendit. Por, përfaqësuesit e popullit shqiptar, si brenda ashtu edhe në emigracion, ishin të përcarë. Bashkimi i tyre u rekomandua si rruga më e mirë për sukses. Ndërsa LNCÇ ndërmerre hapa konkrete për të ardhur në pushtet pas luftës, në Foreign Office (FO) dhe në Departamentin e Shtetit përgatiteshin studime e projekte për qeverisjen e ardhshme të Shqipërisë, të cilat në përgjithësi e shihnin si një përjashtim qeverisjen e vendit nga një qeveri e vetme e Frontit Nacionalçlirimtar. Si rezultat, të dy qeveritë e Aleatëve Perëndimorë e refuzuan kërkesën e LNCÇ të 5 gushtit 1944 për njohjen e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar me atributet e një Qeverie të Përkohshme të Shqipërisë.<sup>2</sup> Në të njëjtën mënyrë ata vepruan edhe ndaj Qeverisë Demokratike të dalë nga Mbledhja e Beratit. Asnjëra prej tyre nuk shihet si përfaqësuese e tërë popullit shqiptar. Mendohej parimisht, se qeveritë me bazë të gjerë do të siguronin më shumë stabilitet në vend, sepse do të mbështeteshin në vullnetin e gjerë të popullit shqiptar. Sigurisht, qeveri të tilla do të krijonin më shumë mundësi për të miratuar programe progresive, të cilat do ta vështirësonin apo shmangnin ardhjen në pushtet të një qeverie komuniste dhe vendosjen e regjimit komunist në vend. ‘Regjimi, - përmendej në një studim të Aleatëve në vitin 1945, - është i krahut të majtë dhe me karakter autoritar, megjithëse flet për parime demokratike dhe garanton se do të mbajë zgjedhje të përgjithshme për në Asambleenë Kushtetuese, që do të zëvendësojë qeverinë e tanishme të përkohshme’.<sup>3</sup> Në funksion të idesë për të krijuar një qeveri me bazë të gjerë, perëndimorët bënë përpjekje që në radhët e qeverisë së FNÇ të dalë nga Mbledhja e Beratit të përfshinin edhe disa elementë nacionalistë, të papërlyer në bashkëpunimin me gjermanët e italianët, të tillë si: Abaz Kupi, vëllezërit Kryeziu, apo ndonjë tjetër. Përpjekjet e tyre për ta riafruar Kupin me LNCÇ kishin filluar më herët. Hapi i parë ishte bërë kur Kupi ishte ftuar personalisht që të merrte pjesë në takimin e delegacionit të LNCÇ me Aleatët në Itali, në periudhën korrik-gusht 1944, dhe më herët akoma, kur iu kërkua partizanëve shqiptarë që të ruanin territoret e tyre të kontrollit dhe të mos kalonin në veri të lumit Shkumbin. Por asnjë nga propozimet e Aleatëve nuk gjeti miratim nga PKSHE dhe Enver Hoxha, ndonëse Abaz Kupi e pranoi ftesën. Pas refuzimit të Hoxhës, Aleatët e tërhoqën ftesën për Abaz Kupin. Askush nuk mundi ta shpëtonte Shqipërinë nga konflikti i pastër civil, pas kalimit të forcave partizane në territoret e kontrolluara nga forcat nacionaliste, në verën e vitit 1944. PKSHE jo vetëm që e refuzoi bashkëpunimin me Kupin, por

---

<sup>2</sup> Nicolas J. Costa, *Albania: A European Enigma, East European Monographs*, New York: Columbia University Press, 1995, p. 113.

<sup>3</sup> *The National Archives* (më tej: TNA), War Office (me tej: WO) 204/12572, 1945.

Enver Hoxha i dha urdhër Mehmet Shehut që po të mundej ta likuidonte atë fizikisht.<sup>4</sup> Në bisedimet e Barit, delegacioni i LNÇ arriti të merrte miratimin e Aleatëve për ta njohur LNÇ si forca kryesore e rezistencës në Shqipëri, akt ky që u materializua me dërgimin e Misionit Ushtarak Shqiptar pranë forcave të Shtabit Aleat të Mesdheut në Itali, dhe me atashimin pranë Shtabit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të përfaqësuesve të misioneve britanike e amerikane. Ndonëse kërkesa e delegacionit shqiptar për njohjen e qeverisë së përkohshme të dalë nga Kongresi i Përmetit u refuzua nga Aleatët Perëndimorë, LNÇ fitoi statusin e një aleati ushtarak. Ky konfirmim do të shoqërohej në tetor 1944 me një akt tjetër të Aleatëve Perëndimorë - tërheqjen përfundimtare të mbështetjes së tyre për forcat nacionaliste në Shqipëri.

Britanikët në shtator 1944 po projektonin ta ndryshonin politikën e tyre, duke braktisur plotësisht forcat tradicionale nacionaliste dhe duke i ofruar të gjithë mbështetjen e tyre LNÇ. Kjo politikë mori formë të plotë pas promemories së datës 5 tetor 1944 të Sekretarit të Jashtëm të Qeverisë Britanike, Anthony Eden, e cila iu përcoll kryeministrit Churchill. Promemoria mbante titullin 'Mbi situatën në Shqipëri dhe politikën e ardhshme britanike në këtë vend'.<sup>5</sup> Eden e pranonte mbizotërimin e forcave të FNÇ në Shqipëri. Ai e krahasonte këtë të fundit me partizanët e Titos dhe me ata të EAM-it në Greqi. "Kjo organizatë, - përmendte ai, - kishte ofruar rezistencë serioze si ndaj italianëve ashtu edhe ndaj gjermanëve", ndërsa nënvizonte se, furnizimet e kohëve të fundit të Aleatëve kishin shkuar tërësisht në adresë të saj. Si forcë tjetër të rezistencës, Sekretari i Jashtëm britanik përmendte edhe 'Lëvizjen e Legalitetit', por, ai nuk harronte të shtonte se "kjo organizatë kishte muaj të tërë që nuk kishte ndërmarrë ndonjë aksion kundër gjermanëve". Kupi, - i shkruante Eden kryeministrit Churchill, - personalisht nuk kishte bashkëpunuar me armikun, por ai kishte pasur kontakte me nacionalistët, duke përfshirë edhe ish - anëtarë të qeverisë kukull. Si Kupi ashtu edhe nacionalistët e tjerë vazhdonin t'i siguronin Aleatët se do të luftonin kundër gjermanëve, por deri tani kishin ndërmarrë vetëm disa aksione të vogla. Ata donin ndihma nga Aleatët me qëllim që të vendosnin kontrollin në zonat e tyre, në mënyrë që pas tërheqjes së gjermanëve, të diskutonin për vendosjen e kontrollit në Shqipëri. Eden e konsideronte jugun e Shqipërisë si bastionin kryesor të FNÇ, ndërsa Shqipërinë qendrore e veriore i cilësonte si 'shumë primitive dhe pak të hapura ndaj ekstremistëve të krahut të majtë'. Por, për Sekretarin e Jashtëm britanik nuk ishte surprizë që forcat e FNÇ kishin hasur pak rezistencë gjatë kalimit të tyre në veriun e Shqipërisë. Eden vinte në dyshim aftësitë e Abaz Kupit dhe të nacionalistëve në këtë kohë, për të ndaluar forcat partizane nga kontrolli i plotë i vendit. Por edhe forcat aleate, gjykonte Eden, nuk

---

<sup>4</sup> Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 41, Dosja (më tej: D.) 158, Viti (më tej: V.) 1944, Radiogram nr. 18 i Enver Hoxhës drejtuar Mehmet Shehut.

<sup>5</sup> TNA, FO 371/43555. Promemorie e Anthony Eden për Churchill, 5 tetor 1944, f. 110-114.

mund ta ndalonin marshimin e forcave partizane në territoret e nacionalistëve shqiptarë. Pasi analizonte me kujdes situatën e Shqipërisë, sekretari britanik sugjeronte edhe rrugëzgjdhjen e saj, sigurisht duke respektuar interesat e Britanisë së Madhe. Ai i shkruante Churchill-it: “Interesat tona në Shqipëri janë të kufizuara, por ne kemi premtuar që ta rimëkëmbim Shqipërinë e pavarur pas luftës dhe për këtë arsye ne do të kërkojmë rivendosjen e ligjit dhe rregullit, dhe në mënyrë të arsyeshme një qeveri të qëndrueshme. Do të ishte kundër interesave tona një Shqipëri që do të kalonte plotësisht në influencën sovjetike, dhe për këtë arsye do të ishte e rrezikshme që të vijë në pushtet një qeveri e tillë”.<sup>6</sup> Sekretari britanik arrinte në përfundimin se në rrethanat e krijuara, FNÇ do të kontrollonte tërë Shqipërinë, ndërsa britanikëve do t’u duhej që të fuqizonin pozicionin e tyre rreth kësaj force, me qëllim që të kompensonin influencën ruse. Këtë propozim ai ia kishte përcjellë më parë edhe Macmillan-it.<sup>7</sup> Politika e propozuar nga Eden përbënte risi për FO, sepse deri tani ajo kishte folur për mbështetjen e rezistencës së të gjithë shqiptarëve, pavarësisht nga dallimet dhe ideologjitë e tyre. Thelbin e politikës së re e përbënte braktisja përfundimtare e forcave të tjera [nacionaliste] dhe mbështetja tërësore ndaj FNÇ.

Politika e re e britanikëve iu bë e njohur edhe aleatëve amerikanë, të cilët fillimisht u shfaqën të rezervuar, por shpejt edhe ata do t’i bashkoheshin asaj. Sekretari i Shtetit Hull, më 5 tetor 1944, shfaqte pikëpamjen se Kupa dhe forcat nacionaliste shqiptare nuk e meritonin të ndihmoheshin më nga Forcat Aleate, ndërsa furnizimet e tyre ushtarake nuk do të shkonin më për ta, për shkak të qëndrimit jo aktiv të tyre ndaj armikut të përbashkët. Por, nga ana tjetër, në mënyrë të nënkuptuar fliste edhe për ndihmat ushtarake aleate që përfitonte LNÇ, të cilat po përdoreshin nga partizanët shqiptarë jo vetëm për të luftuar gjermanët, por edhe kundërshtarët e tyre nacionalistë brenda vendit. Me mbështetjen e Aleatëve, LNÇ ishte fuqizuar më tej. Pavarësisht nga rezervat e misioneve aleate ndaj përdorimit të një pjese të furnizimeve të tyre për të likuiduar kundërshtarët nacionalistë, në vjeshtën e vitit 1944, mbizotëronte gjykimi se LNÇ ishte e vetmja forcë që luftonte realisht kundër gjermanëve.

Për momentin politika e mbështetjes tek më i forti dukej premtuese. Aleatët Perëndimorë, të paraprirë nga britanikët, u munduan ta shfrytëzonin politikën e re për të zgjeruar bazën qeverisëse të LNÇ, duke e modifikuar e zbutur qeverinë e saj. Qeveria ekzistuese mund të bëhej më përfaqësuese, nëse do të përfshinte brenda saj elementë nacionalistë, të cilët kishin dhënë prova se kishin luftuar me pushtuesit gjermanë. Propozimi i ri, në thelb, përbënte një lloj tërheqjeje të Aleatëve, sepse tashmë nuk këmbëngulej më për të përfshirë në qeveri elementë të opozitës së gjërë

---

<sup>6</sup> TNA, FO 371/43555, Promemorje e Anthony Eden për kryeministrin Churchill, 5 tetor 1944, f. 110-114.

<sup>7</sup> Harold Macmillan kryente funksionin e ministrit rezident të qeverisë britanike pranë Shtabit Aleat të Mesdheut në Caserta, Itali.

brenda vendit apo në emigracion, por vetëm disa emra të veçantë nacionalistësh me reputacion pozitiv për sytë e popullit shqiptar.

Një qeveri që do të kishte mbështetjen e popullit do të ishte në gjendje që t'u qëndronte sfidave të ardhshme politike e ekonomike. "Doktrina politike e britanikëve dhe amerikanëve, presupozon që siguria politike mbështetet tek vullneti i popullit, dhe si rrjedhim, të gjitha qeveritë e reja të krijuara gjatë luftës, duhet të kenë mbështetjen e tij".<sup>8</sup> Britania e Madhe dhe SHBA i kushtuan vëmendje të madhe procesit të njohjeve *de jure* të qeverive të reja në Evropë. Parimisht ata donin të garantoheshin, *së pari*, që të mos kishte opozita potencialisht më të forta se sa qeveritë e krijuara, dhe *së dyti*, që opozita të mos jetë e shtypur, ndërsa qeveria duhej të jepte siguri se do të mbante zgjedhje të lira. Vështirë të pohohet se këto dy parime do të gjenin zbatim në një vend si Shqipëria. Zgjerimi i bazës qeverisëse me elementë nacionalistë u bë një nga pikat e patolerueshme dhe një ndër kushtet për njohjen e qeverisë së dalë nga Mbledhja e Beratit. Por, udhëheqja komuniste e LNC nuk e pranoi as këtë propozim të Aleatëve. Ajo u mundua të njolloshte çdo figurë nacionaliste jashtë radhëve të Frontit, pavarësisht nëse ata kishin bashkëpunuar apo jo me pushtuesit. Kupi dhe 'Legaliteti' ishin njollosur më herët, ndërsa me vëllezërit Kryeziu u ndoq një taktikë tjetër. Atyre iu kërkua të përfshiheshin brenda radhëve të FNC. Sidoqoftë, në qeverinë e dalë nga Mbledhja e Beratit ishin përfshirë disa ministra antifashistë me profil nacionalist, si Gjergj Kokoshi, ndërsa disa të tjerë, si Sheqet Beja, Riza Dani etj., kryenin detyra në forume të ndryshme legjislative. Aleatët Perëndimorë, në rrethanat ekzistuese, gjykonin si zgjidhjen më të mirë krijimin e një qeverie gjithë përfaqësuese. Por, një alternativë e tillë ishte e vështirë të arrihej sepse Partia Komuniste Shqiptare dhe Enver Hoxha nuk donin ta ndanin pushtetin me forca e individë jashtë radhëve të FNC, ndërkohë që Aleatët Perëndimorë nuk kishin plane e forca ushtarake për të zbarkuar në Shqipëri, të cilat do ta ndryshonin situatën në favor të tyre.

Deri në nëntor 1945 qeveria komuniste e Enver Hoxhës nuk hoqi dorë nga kërkesa për njohjen e saj nga SHBA dhe Britania e Madhe. Kryeministri shqiptar shfrytëzoi çdo mundësi për të imponuar njohjen e saj, që në thelb do të thoshte legjitimim i regjimit komunist në Shqipëri. Për të nënshkruar marrëveshjen me UNRRA-n , për të përfituar prej saj një program ndihmesh, Hoxha vuri si kusht firmosjen e marrëveshjes dypalëshe me cilësinë e kryeministrit të Shqipërisë. Por as qeveria amerikane dhe as ajo britanike nuk pranuan ta njihnin Qeverinë e Përkohshme të Shqipërisë dhe as kryeministrin e saj.

---

<sup>8</sup> TNA, CAB, 106/459, *The Civil Relief Operations of Anglo-American Forces in Balkans*, Part VII, 31 mars 1946.



## *Ngjashmëri dhe veçori të regjimit komunist në Shqipëri me vendet komuniste të Evropës Qendrore e Lindore*

Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri dhe në vendet e tjera të Evropës Lindore e Qendrore ka ngjashmëri dhe diferenca, të cilat do të mundohemi t'i përmendim dhe analizojmë më poshtë. Nuk ka dyshim se pothuajse të gjitha vendet komuniste në Evropë dhe Azi (ndoshta me përjashtim të Kinës) kopjuan modelin sovjetik të komunizmit. Por për shumë arsye që kanë të bëjnë me historinë dhe specifikat e këtyre vendeve, vihen re diferenca, të cilat në thelb nuk e atakojnë modelin totalitar komunist të ndërtimit të shtetit. Në Shqipëri, sikurse në Jugosllavi, Bullgari, Çekoslovakia, Hungari, Rumani, Poloni, Gjermaninë Lindore, në Korenë e Veriut e në Kinë, u vendosën regjime komuniste të cilët prodhuan pak a shumë të njëjtat pasoja për popujt e tyre.

Çdokush mund të bëjë pyetjen: se si u bë e mundur që në një vend si Shqipëria me një Parti Komuniste të krijuar në nëntor 1941 (ndërkohë që në vendet e tjera të Evropës partitë komuniste ishin krijuar përpara LDB), me një lëvizje komuniste të vakët e të përçarë, me një popullsi që nuk kishte ndonjë afeksion për komunizmin, me profil tradicional e deri-diku primitiv, individualiste tej mase dhe pak e prirë për të përqaftuar idetë e reja politike, të bëhej e mundur vendosja e një regjimi komunist nga më të pashpirtët në Evropë - stalinist dhe i pareformuar nga fillimi e deri në rënien e tij në vitin 1991? Komunistët shqiptarë, me pak përjashtime (shih: Sejfulla Malëshovën, Kostandin Boshnjakun etj.), nuk ishin formuar e trajnuar në Bashkimin Sovjetik, sikurse kishte ndodhur me shumë udhëheqës të tjerë të Partive Komuniste të Evropës Lindore.

*Së pari*, vendosja e regjimeve komuniste në Evropë dhe në Shqipëri u arrit falë faktorit sovjetik, i cili ndikoi si gjatë Luftës së Dytë Botërore, por në mënyrë të veçantë pas përfundimit të saj. Ushtria e Kuqe u fut në territorin e shteteve që kishin mbështetur Fuqitë e Boshtit, të tilla si: Hungaria, Bullgaria e Rumania, dhe i ndryshoi realitetet politike në favor të saj. Kurdoherë që pushtohej një territor nga Ushtria e Kuqe atij do t'i imponohej sistemi sovjetik, shkruante Milovan Gjilasi. Por në Shqipëri dhe në Jugosllavi ndodhi ndryshe. Trupat e Ushtrisë së Kuqe nuk u futën asnjëherë në Shqipëri. "Partitë e tyre, - shkruan Szalontai Balazs, duke iu referuar rastit të Shqipërisë dhe Jugosllavisë, - erdhën në pushtet për shkak të triumfit ushtarak të tyre mbi kundërshtarët e jashtëm e të brendshëm".<sup>9</sup> Sidoqoftë, si në Shqipëri ashtu edhe në Jugosllavi, Bashkimi Sovjetik ishte i pranishëm gjatë luftës jo në kuptimin fizik, sikurse dy Aleatët e tjerë, Britania e Madhe dhe SHBA, por si një ndër tre shtetet e mëdha aleate. Ndikimi i tij tek PKSHE ishte i madh, pavarësisht se deri në nëntor 1945, qeveria sovjetike ndoqi të njëjtin hap sikurse edhe dy qeveritë e tjera perëndimore për njohjen e qeverisë komuniste të Shqipërisë.

---

<sup>9</sup> Szalontai Balazs, 'The Dynamic of Repression: The Global Impact of the Stalinist Model, 1944-1953', *The Mongolian Journal of International Affairs*, No. 10, 2003, p. 126.

*Së dyti*, rezistenca e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, e udhëhequr nga PKSH, ishte faktor me peshë të madhe në fitoren mbi fashizmin dhe nazizmin në Shqipëri. Nga një forcë pothuajse anonime në fillimet e veta, LNÇ u shndërrua në forcën kryesore të rezistencës në vend. Për këtë arsye kjo e fundit përfitoi shumicën dërrmuese të furnizimeve ushtarake të sjella nga Aleatët Perëndimorë në Shqipëri, të cilët vlerësonin si primare objektivat ushtarakë mbi objektivat politikë. Roli kryesor i LNÇ në rezistencën e shqiptarëve faktohet në shumë dokumente të dy Aleatëve Perëndimorë të luftës. Por atë e gjejmë të shprehur në mënyrë eksplicite në vendimet e marra nga përfaqësuesit ushtarakë të Shtabit Aleat të Mesdheut dhe delegacionit ushtarak shqiptar në bisedimet e Barit të gushtit 1944. Në thelb të dy palët arritën të pranonin rolin e veçantë të LNÇ në rezistencën shqiptare. Ky vendim do t'i hapte rrugën ndryshimeve të tjera të rëndësishme në politikën e Aleatëve Perëndimorë të luftës, të cilët duke filluar nga muaji tetor e mbrapa do ta tërhiqnin mbështetjen për forcat nacionaliste dhe do t'i ofronin mbështetje më të madhe LNÇ.<sup>10</sup>

*Së treti*, PKSH pati mbështetjen e PKJ dhe të Titos, si gjatë luftës ashtu edhe pas saj. Ajo ndoqi modelin jugosllav për marrjen e pushtetit. Hapat që u bënë nga Tito në Jugosllavi u ndoqën edhe nga PKSH dhe Enver Hoxha. Me vendimet e marra në Konferencën e Labinotit, Kongresin e Përmetit dhe Mbledhjen e Beratit, u hodhën bazat e pushtetit të ardhshëm në Shqipëri. Për këtë çështje PKSH nuk toleroi askënd, as Ballin Kombëtar, as Legalitetin dhe nuk i dëgjoi as këshillat e dy Aleatëve Perëndimorë të luftës, për zgjerimin e bazës së qeverisjes. Në mënyrë të veçantë, periudha pas mbajtjes së Kongresit të Përmetit (por edhe para saj) u karakterizua nga lufta e dyanshme, kundër gjermanëve nga njëra anë, dhe kundër forcave nacionaliste shqiptare nga ana tjetër. Për çështjen e pushtetit, PKSH mund të themi se mbajti qëndrim më intransigjent, bile edhe se PKJ dhe Tito. Enver Hoxha në dallim nga Tito nuk pranoi që të bënte asnjë kompromis, qoftë edhe të pjesshëm e të përkohshëm për ndarjen e pushtetit, sikurse bëri Tito. Ky i fundit, pas presionit të britanikëve, në mars 1945 pranoi në radhët e qeverinë e re, të krijuar prej tij, tre ministra, të cilët përfaqësonin emigracionin politik jugosllav.<sup>11</sup> Qëndrimi i PKSH dhe i LNÇ në këtë aspekt nuk mund të krahasohet ca më shumë me Partinë Komuniste Greke dhe EAM-in, të cilët arritën disa herë në kompromise me forcat e djathta gjatë dhe pas mbarimit të Luftës.

Shqipëria dhe deri - diku Jugosllavia, ndryshe nga vendet e tjera komuniste të Evropës e kishin zgjidhur problemin e pushtetit politik që gjatë luftës. Zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 vetëm sa do të rikonfirmonin regjimin që komunistët dëshironin të vendosnin në Shqipëri, ndërsa parlamenti

---

<sup>10</sup> TNA, FO 371/43555, Anthony Eden për Winston Churchill, 5 tetor 1944, f. 111.

<sup>11</sup> *New Europe, The Impact of the First Decade, Vol.1, Trend and Prospects*, edited by Teresa Rakowska-Harmstone and Piotr Dutkiewicz, Institute of Political Studies-Polish Academy of Sciences, Warsaw: Collegium Civitas Press, 2006, p. 52.

dominohej prej tyre. Pushteti mbeti sërish në duart e Partisë Komuniste e maskuar me emrin e Frontit Demokratik, e cila pas zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese do të fitonte legjitimitetin e munguar deri në këtë kohë.

*Së katërti*, Shqipëria zbatoi modelin sovjetik të qeverisjes, por në ndryshim nga vendet e tjera komuniste të Evropës, ajo e ndërtoi atë kryesisht me asistencën direkte të Jugosllavisë së Titos. Jugosllavia ishte i pari shtet i pasluftës që njohu zyrtarisht qeverinë shqiptare më 1 maj 1945 dhe vendosi me të marrëdhëniet diplomatike. Influenca e Jugosllavisë mbi Shqipërinë ishte asfiksuese dhe me rrezik të madh për pavarësinë e saj. Shumë studiues besojnë me të drejtë se, nëse nuk do të kishte ndodhur çarja sovjeto-jugosllave në vitin 1948, Shqipëria mund të ishte shndërruar në Republikën e 7-të të Jugosllavisë. Hija e Jugosllavisë mbi Shqipërinë u reflektua gjithandej: në ndërtimin e institucioneve shtetërore, në reformat me karakter komunist, në marrëdhëniet e saj me shtetet e Perëndimit dhe në raportet e saj me vendet që hynë në rrugën e komunizmit. Jugosllavia e Titos pati 'gisht' në mosvendosjen e marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me Britaninë e Madhe dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës<sup>12</sup>, si dhe në amplifikimin e rrezikut grek për Shqipërinë. Një shtet shqiptar, pak ose aspak i njohur në botë, do të ishte një objektiv më i lehtë për t'u bashkuar me Jugosllavinë.

*Së pesti*, marrëdhëniet e Shqipërisë me dy ish Aleatët Perëndimorë të Luftës, ndryshe nga vendet e tjera komuniste të Evropës, përfunduan në mënyrën më të keqe. Këto të fundit arritën të rivendosnin marrëdhëniet diplomatike me SHBA dhe Britaninë e Madhe, pavarësisht se gjatë luftës disa prej tyre ishin rreshtuar me Fuqitë e Boshtit, ndërsa Shqipëria ishte rreshtuar me Aleatët. Ndërkohë, që në nëntor 1945, të tre ish Aleatët e Mëdhenj të luftës e njohën bashkërisht qeverinë shqiptare, por ndryshe nga SHBA dhe Britania e Madhe, vetëm BS e njohu atë pa kushte. Qeveria britanike ofroi njohje të kushtëzuar, por marrëdhëniet diplomatike nuk arritën të vendosen, për arsye tashmë të njohura, ndonëse të dyja palët kishin përcaktuar ministrat përkatës, të cilët mbetën rrugës. Ndërkohë, qeveria e SHBA-së nuk shkoi aq larg sa qeveria britanike. Ajo i ofroi njohje të kushtëzuar qeverisë shqiptare, por marrëdhëniet diplomatike nuk u vendosën, sepse qeveria shqiptare nuk i përmbushi të gjitha kushtet e kërkuara prej saj. Pas zgjedhjeve të dhjetorit 1945, Shqipëria u njoh nga Franca, Polonia, Bullgaria, Republika Çeke e Sllovake, ndërsa në vitet 1947-1949 edhe nga Hungaria, Rumania, Republika Demokratike Gjermane, Koreja e Veriut, Mongolia dhe Kina.

Largimi i misioneve britanike e amerikane nga Shqipëria gjatë vitit 1946, pa arritur në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, pati efekte negative mbi zhvillim e vendit dhe duket se

---

<sup>12</sup> AQSH, Fondi 14/AP, Viti 1946, D. 11. Radiogram nr. 5 i Nako Spirut drejtuar Enver Hoxhës, 24 prill 1946.

ndikoi edhe në radikalizmin e saj në rrugën drejt komunizmit. Mungesa e pranisë së dy demokracive të mëdha perëndimore në Shqipëri ndikoi gjithashtu edhe mbi frymën dhe veprimin opozitar në vend, duke shuar shpresat sado të vogullta për mbështetje e inkurajim të tyre. Marrëdhëniet e këqija të qeverisë komuniste me SHBA-në dhe Britaninë e Madhe u acaruan me fillimin e Luftës së Ftohtë, pasojat e së cilës ranë edhe mbi Shqipërinë. Disa vendime të dy qeverive të Fuqive Perëndimore për të mos lejuar pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara, në Këshillin e UNRRA-s, për të mos e njohur atë me statusin e plotë të një vendi aleat etj., ndërkohë që qeveria greke kishte paraqitur zyrtarisht pretendimet për Shqipërinë e Jugut, u perceptuan negativisht në Shqipëri, pavarësisht nga arsyet. Edhe më herët, qëndrimi i SHBA dhe Britanisë së Madhe ndaj Evropës Lindore kishte ushqyer mendimin, se BS do ta kishte këtë rajon zonë të veten të influencës. Kjo gjë ishte reflektuar në takimet e majit 1944 gjatë diskutimeve britanike-sovjetike për sferat e influencës në Greqi dhe në Rumani në takimin e Stalinit me Churchill-in në Moskë, tetor 1944, por edhe në Konferencën e Jaltës.<sup>13</sup> Shqipëria qëndronte në periferi të interesave amerikane e britanike, ndërkohë që i ishte hapur rrugë besimit se ajo i ishte lënë Jugosllavisë së Titos. Siç kemi përmendur më lart amerikanët, në dallim nga britanikët, për arsye parimesh e interesi nuk kishin planifikuar të ndërhynin ushtarakisht në Shqipëri e në Ballkan. Ata kishin kundërshtuar planet e hershme të britanikëve për zbarkim në rajonin e Ballkanit, ashtu edhe përpjekjet e Churchill-it me Stalinin, për të ndarë aty zonat e influencës.

*Së gjashti*, BS e siguroi kontrollin e tij mbi vendet e Evropës Lindore e Qendrore përmes një qasjeje oportuniste, drejt zhvillimeve disi të ngadalshme në rrugën e këtyre vendeve drejt komunizmit. Kjo zgjedhje u diktua nga situata ndërkombëtare, marrëdhëniet dhe detyrimet e BS ndaj dy Aleatëve Perëndimorë të Luftës, por edhe nga zhvillimet e brendshme të këtyre vendeve, një pjesë e të cilëve ishin të papërgatitur për të kaluar në socializëm. Efektet e politikës frenuese të BS u ndjenë edhe mbi zhvillimet e Jugosllavisë e të Shqipërisë. Në të dyja këto vende, reformat komuniste filluan të zbatoheshin më herët se sa ato të vendeve të tjera komuniste të Evropës. Sidoqoftë, politika e qasjes graduale të Stalinit pati efekte edhe tek marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Le të sjellim në kujtesën tonë përpjekjet e qeverive jugosllave e shqiptare për të arritur

---

<sup>13</sup> *Foreign Relations of United States (FRUS)*, Vol. V, 1944, The British Prime Minister (Churchill) to President Roosevelt, London, 31 May 1944, pp.114-115. Në maj 1944 Churchill i propozoi Stalinit një plan për ndarjen e zonave të influencave në Rumani e Greqi. E para do të ishte nën kontrollin dhe përgjegjësinë e BS, ndërsa e dyta nën autoritetin e Britanisë së Madhe. Stalini e pranoi parimisht propozimin e kryeministrit britanik, por kërkoi prej tij të bisedonte paraprakisht edhe me presidentin Roosevelt. Ky i fundit e kundërshtoi propozimin e qeverisë britanike, duke e quajtur atë 'ndarje të zonave të influencës'. Me gjithë këmbënguljen e Churchill dhe përpjekjet e tij për ta argumentuar atë, presidenti amerikan nuk ndryshoi mendim. Sidoqoftë, as Churchill dhe as Stalini nuk u ndalën këtu. Më 9-18 tetor 1944 delegacionet britanike e sovjetike, të kryesuar nga Churchill dhe Stalini zhvilluan në Moskë të ashtuquajturin 'takim të përqindjeve', në të cilin u arrit marrëveshja për ndarjen e zonave të influencës në Ballkan.

një traktat miqësie e ndihme reciproke - në thelb me karakter ushtarak, që në janar të vitit 1945, ende pa u mbledhur Konferenca e Jaltës, e cila u frenua nga Stalini.

*Së shtati*, në dallim nga shumica e vendeve të tjera komuniste të Evropës Lindore e Qendrore, në Shqipëri dhe në Jugosllavi, pushteti politik i komunistëve ishte siguruar (por jo legjitimuar) që para zgjedhjeve të para elektorale. Ndërkohë që në vendet e tjera komunistët ishin në minoritet, në qeveritë e dala nga zgjedhjet e para elektorale. Ata fituan shumicën gradualisht, duke forcuar represionin komunist dhe duke falsifikuar e ndryshuar rezultatin e zgjedhjeve. Sigurimi i pushtetit politik më herët se në vendet e tjera komuniste, i lejoi këto dy vende të ndërmermin reforma, të cilat u paraprinë atyre që u ndërmorën në vendet e tjera, të ashtuquajtura ‘Demokraci Popullore’.

Në përgjithësi, kultura politike e ‘Demokracive Popullore’ nuk e favorizonte vendosjen e komunizmit. Në zgjedhjet e para partitë komuniste ishin në minoritet krahasuar me partitë e tjera. Në Çekosllovakia, p.sh. komunistët kishin fituar në zgjedhjet elektorale, në rastin më të mirë, 10% të votave, ndërsa në vitin 1946 morën 38% të tyre. Në Hungari, në zgjedhjet e vitit 1945, Partia Komuniste mori 17% të votave.<sup>14</sup> Pak a shumë e njëjta gjë ndodhi edhe në Poloni, Rumani. Mbështetja për PK në Evropën Lindore erdhi duke u rritur me zgjerimin e programeve sociale. Tmerret e LDB ushqyen oportunitetin dhe ndryshimet ekonomike e sociale në këto vende. Në Shqipëri e në Jugosllavi, ndryshe nga vendet e lartpërmendura, komunistët morën shumicën në zgjedhje. Ndërkohë në Shqipëri, ndoshta si askund tjetër, Partia Komuniste nuk konkurroi në zgjedhje me emrin e saj, por u fsheh brenda Frontit Demokratik. Kjo manovër e saj duket se u bë për të ruajtur imazhin e kohës së luftës, por edhe për shkak të mungesës së partive politike në vend. Në disa studime të ndërmarra nga Komiteti i Përbashkët i Inteligjencës, në përbërje të Shtabit të Forcave Aleate për Mesdheun, Frontin Demokratik të Shqipërisë e cilësojnë shpesh si ‘Partia e Frontit Demokratik’.<sup>15</sup> Më 6 dhjetor 1946, Kuvendi Popullor miratoi një ligj për krijimin e partive politike dhe shoqatave kulturore shkencore e profesionale<sup>16</sup>. Miratimi i këtij ligji dukej i çuditshëm për kohën dhe për konceptet e komunistëve shqiptarë ndaj demokracisë perëndimore. Sejfulla Malëshova - ministër i Shtypit dhe Propagandës, më 10 qershor 1945, ishte shprehur në një konferencë për kotësinë e pluralizmit politik: “Disa njerëz, - kishte thënë Malëshova, - e quajnë qeverinë tonë diktatoriale. Quajeni si të doni, - shtonte ai më tej, - por kjo është. Disa mendojnë se sa më shumë parti aq më shumë demokraci ka. Ne nuk e masim demokracinë tonë me numrin e

---

<sup>14</sup> Mark Kramer, *Stalin, Soviet Policy, and the Consolidation of a Communist Bloc in Eastern Europe, 1943-1944*, Davis Center for Russian and Eurasian Studies, Stanford University: 2010, p. 15.

<sup>15</sup> TNA, WO 204/12572, Year 1945, 1946, *JIC Standing Appreciation on Albania*, 17 shtator 1945, 27 maj 1946.

<sup>16</sup> “Dekret Nr. 241, datë 6 Dhjetor 1946”, shih: *Gazeta Zyrtare*, Nr. 115, 23 dhjetor 1946.

partive”. Megjithëkëtë, vazhdonte më tej Malëshova, “demokracia jonë është vigjilente, gati me shpatë në dorë për të goditur tendenca të tilla (fashiste e opozitare)”.<sup>17</sup>

Miratimi i ligjit të lartpërmendur për krijimin e partive politike duket se ishte farsë, pasi ai u arrit në një kohë kur deputetë opozitarë të Kuvendit Popullor ishin vënë në qendër të kritikave dhe mbi ta ushtrohej presion i gjithanshëm. Ndërkohë që Musine Kokalari ishte arrestuar dhe dënuar për krijimin e Partisë Socialdemokrate. Ligji për krijimin e partive politike duket se ka pasur qëllime propagandistike, për të krijuar imazhin se edhe Shqipëria ishte si vendet e tjera komuniste të Evropës, të cilat kishin ende sistem demokratik të limituar. Përmbajtja e këtij ligji, sipas nenit 7 të tij, e ndalonte krijimin e partive politike të cilat kishin për qëllim të ndryshonin apo të rrëzonin rendin konstitucional të Shqipërisë, që kishin karakter antidemokratik..., apo kur krijuesit e tyre frymëzoheshin nga parimet e lartpërmendura.<sup>18</sup> Ligji i miratuar kishte parasysh realitetin ekzistues dhe ‘demokracinë komuniste’.

*Së treti*, në vendet e Evropës Lindore e Qendrore vendosja e regjimeve komuniste u përball me rezistencën e opozitave dhe elementëve opozitarë dhe me represionin e gjerë të regjimeve komuniste. Por shkalla e dhunës nuk ishte e njëjtë, ajo ndryshonte nga vendi në vend, për arsye të brendshme e të jashtme. Sipas historianit, Szalontay Balazs, Jugosllavia pati eksperiencën më të keqe. Në maj - qershor 1945, partizanët e Titos ekzekutuan më shumë se 18 mijë ushtarë të Gardës së Bardhë dhe të Ljotiç.<sup>19</sup> Partizanët bullgarë ekzekutuan dhe vranë në mënyrë arbitrare rreth 10 000 vetë, ndërsa gjyqet popullore dënuan me vdekje 12 000 të akuzuar për krime lufte, ndërsa 2 700 prej tyre u ekzekutuan. Në Gjermaninë Lindore, sovjetikët dënuan 12 807 vetë si bashkëpunëtorë të nazizmit, por vetëm 118 prej tyre u dënuan me vdekje. Sipas historianes, Maria Turlejska, gjykatat ushtarake në Poloni dënuan 2 500 persona me vdekje dhe shumica e tyre u ekzekutuan. Në vende të tilla, si Çekosllovakia, Gjermania Lindore, Hungaria e Rumania, partitë komuniste për shkak të traditave politike nuk përfshinë në listën e dënimeve kundërshtarët politikë që u përkisnin pakicave etnike. Franca dhe Italia provuan eksperiencë ekstreme. Në Francë u ekzekutuan më shumë se 4 000 bashkëpunëtorë të gjermanëve, gjatë dhe pas mbarimit të luftës, ndërsa në Itali 12-15 000 njerëz vdiqën në periudhën prill-qershor 1945, si rezultat i hakmarrjen së partizanëve mbi ish fashistët dhe bashkëpunëtorët e tyre. Në Greqi, pas mbarimit të luftës, terrori i kuq u zëvendësua me terrorin e bardhë. Në Shqipëri, Jugosllavi, Bullgari dhe Poloni, nuk u dënuan vetëm elementët fashistë e nazistë, por edhe kundërshtarët politikë të regjimeve komuniste, si dhe demokratë antikomunist që kishin bashkëpunuar dhe luftuar për çlirimin e vendeve të tyre.

<sup>17</sup> TNA, CAB 122/721, 1945, f. 165.

<sup>18</sup> Gazeta Zyrtare, Nr. 115..

<sup>19</sup> Szalontay Balazs, *vep. për.* f. 126.

Mungesa e pluralizmit politik dhe e traditave liberale e progresive të qeverisjes, ndarja e madhe e klasave sunduese me popullin, dhe mbi të gjitha, represioni i regjimit komunist ndaj kundërshtarëve të tij, e bënë Shqipërinë një ndër vendet me treguesit më të lartë të dënimeve me vdekje, dënimeve afatgjata, ndëshkimeve të familjeve me internime dhe privacioneve të natyrave të tjera. Rasti shqiptar i dënimeve ishte një kalvar, i cili filloi gjatë LDB dhe vazhdoi pas saj, pavarësisht nga format e shfaqjeve: me akuza për bashkëpunim me fashizmin e nazizmin, me akuza për pjesëmarrje në rezistencën antikomuniste, me fajësime për bashkëpunim me misionet britanike e amerikane në Shqipëri, me akuza ndaj personave që aspironin për demokracinë perëndimore, me akuza si ‘armiq të klasës’ etj.

# Klejd Këlliçi - Fakulteti i Shkencave Sociale - Universiteti i Tiranës

## Gulagu European: Regjimi i kampeve të punës dhe përqendrimit në Shqipëri, Gjermani Lindore dhe Bullgari, 1946-1950

### Abstrakt:

Evidentohen dhe krahasohen eksperiencia gjermano-lindore, bullgare dhe shqiptare. Sistemi i kampit u risoll në pasluftë në vendet komuniste, ku partitë komuniste, ndërtnuan kampe përqendrimi e pune si një praktikë normale të konsolidimit të pushtetit dhe të kontrollit të popullsisë. Ky proces shihet përmes riprodhimit të modelit të ‘gulagut’ në kampet e përqendrimit dhe punës në Gjermaninë Lindore, Bullgari dhe Shqipëri.

Simbolikisht fundi i Luftës së Dytë Botërore u shënua nga proceset e Nurembergut dhe politikave të shpagimit ndaj kriminelëve të luftës apo bashkëpunëtorëve vendas, në një sërë vendesh evropiane përfshi ato të lindjes. Shpagimi preku sidomos individët e përfshirë në drejtimin e kampeve të përqendrimit. Por nëse çlirimi i hapësirave ku këto kampe gjendeshin shënoi dhe lirin e të mbijetuarve, sistemi i kampit u risoll në pasluftë sidomos në vendet tashmë komuniste. Në disa nga këto, menjëherë sapo partitë komuniste përkatëse morën pushtetin, kampet e përqendrimit e të punës u kthyen në një praktikë normale të konsolidimit të pushtetit dhe kontrollit të popullsisë. Ky punim ka për qëllim pikërisht të evidentojë dhe krahasojë tre eksperiencia, atë gjermano lindore, atë bullgare dhe shqiptare. Ato do të shihen në kuadrin teorik të sovjetizimit si projekt ‘perandorak’ i eksportuar nga BS dhe si formë vetë-sovjetizimi i vendeve tashmë komuniste. Ky proces do të shihet përmes riprodhimit të modelit të ‘gulagut’ sovjetik në kampet të përqendrimit dhe punës në Gjermaninë Lindore, Bullgari dhe Shqipëri si dhe përkthimit të këtij modeli në praktikë. Punimi do të mbështetet në burime primare arkivore dhe ato sekondare.

### Hyrje

Pas Lufta e Dytë Botërore (LIIB) ishte për shumë nga vendet evropiane momenti kulminant i mbarimit të një tmerri gati gjashtë vjeçar. 9 Maji sot përkujtohet si një ditë simbolike çlirimi dhe pastrimi shpirtëror. Çlirimi në kuptimin e eliminimit fizik të nazizmit si praktikë ushtrimi dhune dhe terrori në arritjen e idealit që mobilizoi luftën, atë të supermacisë raciale, të një rendi hierarkik që vinte mbi gjithë të tjerët një kategori të humanitetit, në formën e popullit të vetë zgjedhur sikurse dhe pretendonte ideologjia naziste. Simboli më i tmerrshëm i luftës ishte kampi i përqendrimit, një vend ushtrimi të paprecedent pushteti të njeriut mbi njeriun. Por historia e kampeve as fillon e as mbaron me fundin e LIIB, pse ajo është pjesë e natyrshme e rrugëtimit të shteteve moderne. Në këtë kuptim rivendosja e kampeve në Evropën Lindore mund të shihet si një vazhdimësi historike dhe pse historia e kampeve, hapësirën komuniste filloi të njihej relativisht vonë<sup>1</sup>, pas vendosjes së pluralizmit.

Në vendet e Evropës Lindore konfrontimi me të kaluarën tyre kishte ndodhur pjesërisht gjatë të ashtuquajturit destalinizim, kur pas Kongresit të XX të Partisë Komuniste të Bashkimit

---

<sup>1</sup> Forcat aleate ishin në dijeni të kampeve të punës së detyruar e nuk pati reagime të mëdha për këtë. Arsye ndoshta lidheshin me natyrën retributive apo ndëshkimore që pati paslufta. Vendet e Evropës Lindore (përfashto Poloninë dhe Shqipërinë), kishin qenë aleatë të Gjermanisë naziste. Shpesh ato kishin përdorur politika të forta represive ndaj grupeve etnike minoritare apo kundërshtarëve politikë. *Shih*: British Operations in Albania, 29.July.1953, REF: TRIE4050, TRIB .10Z7, D11140835, TR-134048.

[https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/OBOPUS%20BGFIEND%20%20%20VOL.%2025%20%20\(BGFIEND%20OPERATIONS\)\\_0073.pdf](https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/OBOPUS%20BGFIEND%20%20%20VOL.%2025%20%20(BGFIEND%20OPERATIONS)_0073.pdf).



Sovjetik, ku Hrushovi kish denoncuar krimet e Stalinit<sup>2</sup>. Në Shqipëri, destalinizimi nuk u krye<sup>3</sup> e kështu, publiku shqiptar u përball me krimet e kryera gjatë komunizmit sa me dëshmitë e të mbijetuarve nga burgjet apo kampet e internimit sa nga shtypi dhe dokumentet arkivore vetëm në fillim vitet nëntëdhjetë. Ato tregonin një histori paralele, të jetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga aktorët (viktima dhe xhelatë) sa në mënyrë tangente nga masa tjetër jo e përfshirë, e cila gjithsesi jetonte me frikën e përditshme të së qenit në kategorinë ‘e gabuar’ dhe subjekt potencial persekutimi. Historia e kampeve në Evropën Lindore ishte, sikurse ajo e atyre të nazizmit një histori e pathënë e fshehur, ku viktimat shpeshherë jetonin paralelisht me jo viktimat, në distancë sigurie për të dytët.

Qëllimi i këtij punimi është të japë një panoramë të përgjithshme të fenomenit të kampit si formë shtrëngimi, arsyet e funksionimit dhe dallimet mes tyre në hapësirën e kampit socialist. Njëkohësisht, nëse në imagjinarin kolektiv kampi përkon vetëm me atë pjesë të ngushtë të viteve tridhjetë e deri në fund të Lufta e Dytë Botërore (LIIB), në Gjermaninë naziste, ai është natyrisht më i gjerë. Studimet mbi kampet në ish-Bashkimin Sovjetik janë të shumta, qoftë me publikimin e librit ‘Arkipelagu Gulag’ i Solzhenicinit, qoftë me studimet që kanë pasuar sidomos me hapjen e arkivave pas viteve nëntëdhjetë. Ndërkohë studimet mbi kampet në Evropën Lindore janë të pakta e akoma më të pakta ato krahasuese. Dhe sot, përveç studimeve të veçanta mbi memorien<sup>4</sup> e të dënuarve në këto kampe, mungon një panoramë e përgjithshme krahasuese në lidhje me kampet e shtrëngimit të qytetarëve në ish- vendet komuniste. Për këtë arsye janë zgjedhur tre raste studimore, ai i Gjermanisë Lindore, i Bullgarisë dhe Shqipërisë. Së pari duhet rënë dakord se kampi apo shtrëngimi i një popullate të caktuar në kushte izolimi është një praktikë jo e re por që mund të lidhet me natyrën ekspansive të shtetit modern dhe formave të organizimit socio-ekonomik<sup>5</sup>. Më pas, kampet mund të shihen si vazhdim i fenomenit masiv që ato patën gjatë LIIB, në logjikën e funksionimit dhe arsyet fundore të krijimit të tyre. Kampet mund të konsiderohen si pjesë praktike e implementimit dhe transferimit të një sistemi të caktuar politik, pra si një aksesor i pashmangshëm

---

<sup>2</sup> Mbi procesin e destalinizimit në Evropën Lindore shih: Ben Fowkes, *Eastern Europe 1945-1969: From Stalinism to Stagnation*, (Pearson Education Limited, 2000).

<sup>3</sup> Elidor Mëhilli, “Defying De-Stalinization: Albania ’s 1956”, in: *Journal of Cold War Studies*, 13:4 (Fall 2011): 4–56.

<sup>4</sup> Për rastin tonë studimet mbi memorien e ish-të burgosurve janë ato që zenë vendin kryesor në këtë lëmi. Shih: Tzvetan Todorov, *Voices from the Gulag: Life and Death in Communist Bulgaria*, Robert Zaretsky (trans.). (University Park, PA: Penn State Press:1999) pp. 38–42; Lori Amy “Re-Membering in Transition: The Trans-National Stakes of Violence and Denial in Post-Communist Albania”, in: *History of Communism in Europe*, Vol. I: *Politics of Memory in Post-Communist Europe*, Bucharest: Zeta Books, 2010, pp. 205–222; Caitlin E. Murdock “A Gulag in the Erzgebirge? Forced Labor, Political Legitimacy, and Eastern German Uranium Mining in the Early Cold War, 1946–1949”, in: December 2015, *Central European History* 47(04):791–821.

<sup>5</sup> Kampet e sidomos ato të punës ishin një rezervë e pashtershme dhe e gatshme pune të papaguar. Për këtë shih: Ann Applebaum, *Gulag: A History*, Doubleday, 2003.

e logjik që aplikohet në vendet e Evropës Lindore në aplikimin e modelit Stalinist. Së fundmi si nevojë praktike e regjimeve dhe grupimeve politike që erdhën në pushtet në këto në dy nënlogjika, atë të shpagimit dhe hakmarrjes mbi klasat e përmbysura dhe për pasojë si formë gati permanente disiplinimi shoqëror për të ruajtur në vazhdimësi mbijetesën e regjimit.

Kampet mund të ndahen në kampe pune dhe përqendrimi. Kjo mund të shihet në natyrën e dënimit të individit, puna e detyruar ose në zhvendosjen e një individi apo grupi shoqëror në një vend të caktuar e kufizuar nga një regjim izolimi. Përsa i përket kampeve në nazizëm llojet e kampeve mund të ndaheshin në dy format e sipërcituara ndërkohë që në kampet e periudhës komuniste ky dy logjikat përziheshin pra izolimi dhe puna e detyruar. Për këtë arsye në tekst i referohem logjikës së kampit në përgjithësi e më pas tentohen të bëhen dallimet oportune. Periudha kohore e zgjedhur është ajo mes viteve 1945- 1950 e që përkon pak a shumë me konsolidimin e regjimeve në Gjermaninë Lindore, Bullgari e Shqipëri, konsolidim që, natyrisht, shoqërohet me aplikimin praktik të modelit sovjetik. Për të parë më në detaje këtë duhet marrë parasysh natyra dhe koncepti teorik i kampit dhe më pas analizuar, nën këtë logjikë, ajo e natyrës dhe karakteristikave të këtyre vendeve si dhe procesi i sovjetizimit.

### *Natyra e kampit*

Kampet nuk ishin risi për historinë më të ngushtë evropiane. Përpara se sistemi i kampeve të gjente aplikim të gjerë në Evropën e shek. XX ato ishin pjesë logjike e sistemit politik në Rusinë pre-revolucionare. Studiuesit e historisë dhe teorive koloniale e post-koloniale nuk e kanë të vështirë të kërkojnë gjenezën e kampit kryesisht në kolonitë e themeluara nga evropianët në Afrikë, Amerikë apo Azi<sup>6</sup>. Ata kapen tek nocioni i disiplinës dhe ndëshkimit të Fukosë<sup>7</sup>, ku shtetet moderne përdorin burgun si formë disipline dhe ndëshkimi ku ushtrohet dhe mësohet autoriteti e pushteti. Fukoja i sheh institucionet e ndëshkimit si ‘një rrjet i lehtë, gradual burgjesh...pjesë e një diapozitivi teknikash moderne disipline që i shkëputen spektaklit të ndëshkimit dhe dhunës në qeli<sup>8</sup>’. Kështu burgjet apo arkipelagu i burgjeve siç dhe ai shprehet është një institucion ndëshkimi, sanitizimi i cili ka për qëllim të eliminojë një seri sjelljesh të konsideruara si jo konform rregullave të cilat shteti vendos. Në këto kategorizime kampi nuk del në sipërfaqe, sepse jo detyrimisht ai është pjesë e fokusit të autorit<sup>9</sup>. Fukoja i referohej kryesisht historisë moderne evropiane, ndërkohë që autorë të

---

<sup>6</sup> Për një histori të kampeve shih: Andrea Pitzer, *One Long Night: A Global History of Concentration Camps*, (Little, Brown and Company, 2017).

<sup>7</sup> Michel Foucault, *Disiplinë dhe Ndëshkim: Lindja e Burgut*, (ODEON, 2010).

<sup>8</sup> *Po aty*, p. 205.

<sup>9</sup> Jan Plamper "Foucault's Gulag" , *Kritika: Explorations in Russian and Eurasian History* 3, no. 2 (2002): 255-280. <https://muse.jhu.edu/> (accessed October 3, 2018).

tjerë si Stoler<sup>10</sup> e shtyjnë akoma e më tej konceptin e kampit, duke futur konceptin e kolonisë si 'një formacion jo-mirë i përcaktuar, ilegjitim dhe që mund të mbajë veten vetëm duke bërë dallime të cilët i kthejnë njerëzit në kategori të ndryshme shoqërore'<sup>11</sup>.

Pikërisht në këtë afirmim mund të shihen dhe format e organizimit të kampeve që janë të pranishme dhe pjesë integrale e shteteve moderne në formën kategorive të shumta në Evropën Perëndimore si zgjatime koloniale përtej detit dhe si zgjatim territorial i Perandorisë Cariste në zonat aziatike. Prehistoria e kampit pra është pjesë integrale e historisë evropiane, ndonëse format dhe arsyet e krijimit mbeten të ndryshme. Ajo që mbetet si karakteristikë kryesore e konceptit të kampit është diferencimi shoqëror mes atyre që janë jashtë dhe brenda kampit si dhe filtri nëpërmjet të cilit kategorizohen dhe përcaktohen karakteristikat që ka anëtari i një komuniteti. Nëse e ngushtojmë spektrin e analizës gjeografike të kampit dhe i referohemi modelit mbi të cilin u ngritën kampet në Evropën Lindore, atë sovjetik, kampet nuk janë thjeshtë element aksesor i sistemit të burgjeve por ato kanë një kuptim më të gjerë. Sistemi i kampeve lidhet me ushtrimin e një pushteti të pastër (të zhveshur nga elementë të disiplinimit e mësimin të autoritetit) por ai lidhet me natyrën e vetë regjimeve socialiste e komuniste nga një anë dhe me natyrën apo aspektet të cilësimit të individëve që bëjnë pjesë në një komunitet.

Kështu, sistemi i kampeve nuk ka thjeshtë funksion riedukimi por atë më pastër dhe esencial të dallimit se cilët janë anëtarët e komunitetit të ri politik dhe cilët janë ata që përjashtohen. Në këtë kuptim modeli i gulagut siberian ngjan me modelet e kampeve apo kolonive penale që shumë vende evropiane inaugurojnë me proceset kolonizuese<sup>12</sup>. Vende si Franca apo Anglia (më pas Britania e Madhe) organizojnë në kolonitë e tyre kampe burgosje për individë të padëshiruar sikurse në Guajanën Franceze apo Australi. Pra në gjenealogjinë e vet kampet vendosen në atë moment historiku shteti ndjen nevojën dhe ka aftësinë apo kapacitetin për të përcaktuar natyrën dhe kriteret specifike që duhet të ketë/kenë anëtarët e komunitetit të ri apo në ngjizje e sipër. Këtu kampin mund ta vendosim si në një moment modernizimi ushtrimi pushteti mbi të gjithë anëtarët e komunitetit dhe eliminimin e të padëshiruarve si në një moment esencial krize ku në pamundësi të transformimit të individit apo grupit shoqëror, ky i fundit dëbohet dhe izolohet nga pjesa tjetër e komunitetit.

Në këtë logjikë kampet që ndërtohen në Evropën Lindore post LIIB kanë funksion përjashtimi të elementit të padëshiruar jo aq në funksionin e edukimit sa atë të ndarjes apo përcaktimit arbitrar se kush mund të bëjë pjesë e kush jo në komunitetin e ri komunist nga një anë

---

<sup>10</sup> Ann Laura Stoler, *Duress: Imperial Durabilities in Our Times*, (Duke University Press, 2006), p. 79

<sup>11</sup> *Po aty*, p. 80.

<sup>12</sup> Alexander Etkind, *Internal Colonization: Russia's Imperial Experience*. (Cambridge, UK and Malden, Mass.: Polity Press, 2011).

dhe frikën potenciale të reaksionit që mund t'i kundërvihet pushtetit të ri. Andaj kampi në modelin sovjetik, modeli të cilit aplikohet dhe në Evropën Lindore bart një paradoks sipas Pamplers<sup>13</sup>, ku nga një anë sistemi socialist ve theksin tek elementi i njeriut të ri, korrigjimit, pastrimit të ndërgjegjes e në anën tjetër cilëson elementin në shtrëngim si të pakorrigjueshëm. Duke ju referuar Fukosë<sup>14</sup>, Pamplers ve në dukje paradoksin e kampeve e sidomos atyre të punës në një shoqëri socialiste, ku puna e të dënuarve është shfrytëzim i pastër gjë që bie ndesh me parimet e vetë sistemit, themeluar mbi barazinë dhe mosshfrytëzimin. Këtë logjikë ndjek dhe Sokolov<sup>15</sup> i cili e lidh ekzistencën e gulagut sovjetik<sup>16</sup> me natyrën e regjimit e sidomos me periudhën staliniste të tij. Ai thotë se gulagu ishte pjesë e një sistemi ekonomik skllavërimi, ku nevoja për t'i provuar botës superioritetin e regjimit sovjetik çoi në projektimin e veprave të mëdha, jo detyruesisht të nevojshme, ku puna e detyruar bëhej pjesë integrale e projektit sovjetik. Në të njëjtën kohë një vend përjashtimi i të mbyllurve në kamp nga komuniteti sovjetik.

### ***Mes sovjetizimit dhe indigenizimit***

Është kështu e rëndësishme të kuptohet natyra e modelit sovjetik i cili më pas transferohet në Evropën Lindore, në kuadrin e implementimit të një sistemi, funksioni i të cilit ishte ai zyrtar i triumfit të trashëgimisë së Revolucionit të Tetorit, si ai i riprodhimit të strukturave sovjetike me funksion kontrolli nga qendra në periferi (ku Moska ishte qendra) si nevojë e klasave drejtuese vendore në stabilizimin e pushtetit mbi komunitetin. Për këtë arsye raporti me kampet në Evropën Lindore do lidhur pashmangshmërisht me procesin e sovjetizimit të këtyre vendeve. Me të nënkuptojmë jo thjeshtë çlirim/okupimin e vendeve Lindore nga Armata e Kuqe por vendosjen e mirëfilltë të institucioneve të cilat mëtonin të kopjonin modelin sovjetik. B.S. i cili ishte i vetmi vend socialist në botë, kishte jo vetëm rolin moral drejtues të lëvizjes komuniste por mbi të gjitha posedonte format dhe mënyrat praktike nga të cilat bënin të mundur serinë e tranzicioneve drejt komunizmit. Këtu Rees bën një dallim mes procesit të sovjetizimit dhe atij të komunistizimit<sup>17</sup>, ku me të parin nënkuptohet ideali për t'u realizuar dhe tek i dyti, elementët praktikë përmes të cilëve ky duhej të realizohej. Pashmangshmërisht konteksti evropian i pas luftës përkon me triumfin e

---

<sup>13</sup> J. Pamplers, *Foucault ...*, p. 267

<sup>14</sup> *Po aty*.

<sup>15</sup> *Andrei Sokolov*, "Forced Labor in Soviet Industry: The End of the 1930s to the Mid-1950s", in: Valery Lazarev dhe Paul. R. Gregory, *The Economics of Forced Labour: The Soviet Gulag*, (Hoover Institutional Press 2003), p. 25

<sup>16</sup> Me termin 'Gulag' Stone i referohet një insitucioni administrativ të kontrolluar nga organet e sigurimit të brendshëm sovjetik, i cili përmblihte një seri insitucioneesh vuajtje dënimi. Dan Stone, *Concentration Camps a Short History*, (Oxford University Press, 2017) p. 58.

<sup>17</sup> E. A. Rees, "Introduction: The Sovietization of Eastern Europe", in: Balázs Apór, Peter Apór and E. A. Rees, (eds.), *The Sovietization of Eastern Europe: New Perspectives on the Postwar Period*, (New Academia Publishing, 2008), pp. 4-6.

modelit stalinist të organizimit shoqëror të B.S. dhe për rrjedhojë të vendeve komuniste. Në raport me këtë duhen dhe konsideruar aspiratat ‘perandorake’ të vetë B.S. realizimi i të cilave kalonte përmes a. kontrollit/transformimit shoqëror të vendeve të Evropës Lindore dhe b. vendosjes së elementëve të kontrolluar dhe të kontrollueshëm në pushtet. Bashkë me Ushtrinë e Kuqe në një pjesë të mirë të vendeve të këtij rajoni erdhën dhe anëtarët e partive komuniste respektive, të cilët gjendeshin në Moskë e ku kishin kaluar një pjesë të mirë të aktivitetit të tyre politik përfshi dhe mbijetesën nga terrori i viteve tridhjetë. Pavarësisht mangësive të qenësishme ekonomike, B.S. e vendosi Evropën në një kontroll të fortë, e kjo u pa sidomos në ato vende ku kontrolli politik përkonte me atë ushtarak<sup>18</sup>.

Procesi i sovjetizimit do të nënkuptonte kështu kontrollin ekskluziv të partisë shtet mbi të gjitha sferat e jetës, eliminimin e privates dhe publikes në kuptimin e autonomisë individuale, rolin e ideologjisë, centralizmin ekonomik. Realizimi i këtyre parimeve implikonte përmbyshjen e të gjithë strukturave shoqërore në Evropën Lindore dhe zëvendësimin e tyre me modelin sovjetik. Natyrisht kjo nuk mund të vinte pa pasur një aparat të fortë represioni i cili do të siguronte minimalisht okupimin fizik të institucione nga anëtarët e partive komuniste dhe kontrollin mbi territorin. Panorama e kontrollit të B.S. mbi vendet e atij që tashmë quhet si kamp sovjetik natyrisht nuk ishte e plotë. Megjithatë ky model nuk u implementua kryekëput ose më saktë pati devijimet e veta. Nëse mund të bëhet një panoramë e përgjithshme e vendeve të Evropës Lindore dallimet mes tyre në periudhën përpara LIIB dhe pas saj, japin një pamje të qartë dallimesh të forta që shkojnë nga zhvillimet socio- ekonomike pararendëse, diversiteti gjeografik etnik e kështu me radhë. Procesi i sovjetizimit dhe në momentet më intensive të transferimit (nënkuptuar si model organizimi social ekonomik e politik) ju përgjigj dinamikave specifike të vendeve receptive<sup>19</sup>. Nga një anë modeli sovjetik kërkohet të arrihet uniformitet e nga ana tjetër ai përballë me rezistencat si të elitave vendore (qoftë dhe të udhëheqësve që vinin direkt nga Moska si në hapësirën lindore gjermanike apo Bullgari) si në vështirësitë e penetrimit të tij në këto shoqëri.

Me pak fjalë, sovjetizimi u prit dhe u përpunua në mënyrë autonome pavarësisht se instrumentet e represionit pak a shumë u replikuan në mënyrë uniforme. Në pjesën e Gjermanisë të kontrolluar nga Sovjetikët procesi ishte më inciziv dhe i shpejtë për arsye të kontrollit direkt, ‘kufitarizimit’ dhe pranisë së një aparati burokratik që vinte direkt nga Moska. Për më tepër anëtarët aparatit burokratik gjermano-lindor kishin jetuar një pjesë të mirë të jetës në B.S. pas largimit nga

---

<sup>18</sup> Për një panoramë të përgjithshme të situatës në Evropën Lindore në fund të LIIB shih: Anne Applebaum, *Iron Curtain: The Crushing of Eastern Europe 1944-56*, (Anchor Books, 2013).

<sup>19</sup> John Connelly, *Captive University: The Sovietization of East German, Czech and Polish Higher Education 1945-1956*, (University of North Carolina Press, 2000), p. 2.

represioni nazist. Kthimi i tyre, shënonte jo vetëm triumfin e B.S. ndaj nazizmit por dhe atë të forcave vendore komuniste të cilat ishin eliminuar gradualisht gjatë periudhës së Republikës së Weimar-it<sup>20</sup>. Si okupatorët sovjetikë si administratorët vendorë kishin ekzigjenca të ndryshme në situatën e pasluftës. Represioni shihej i natyrshëm sa kohë që ai shoqërohej dhe me denazifikimin apo me të ashtuquajturën drejtësi retributive, gjetjen dhe ndëshkimin e funksionarëve të ish- Rajhut të III. Në dallim nga zonat perëndimore ku procesi i denazifikimit mbaroi relativisht shpejt dhe u përqendrua në organizimin e sistemit politik në atë lindore, për vetë natyrën e ndryshimeve socio-ekonomike që pushtimi sovjetik sillte, procesi ishte më i gjatë dhe më skrupuloz<sup>21</sup>. Paralelisht me këtë proces dhe shpesh pa bërë dallim, represioni i drejtohej të gjithë armiqve potencialë të sistemit. Këtu nuk mund të anashkalohen dhe nevojat e elitave politike gjermanolindore, të prirura në përmbushjen e detyrimit ndaj ‘çlirimtarëve’ dhe nevojës së brendshme për kontrollin e territorit. Vetë të qenit të Gjermanisë si zonë e dyfishtë kufitare (Berlini i ndarë mes sovjetikëve dhe aleatëve e më gjerë zona sovjetike e pushtimit) rriste nevojën e një kontrolli më të ashpër dhe represiv mbi popullsinë.

Dhe në rastin e Bullgarisë komunistët erdhën në pushtet me ardhjen e Armatës së Kuqe. Ndonëse zyrtarisht vendi u shkëput nga aleanca me Gjermaninë në fund të vitit 1944, komunistët vendorë dhe ata të ardhur nga Moska arritën të merrnin shpejt pushtetin. Partia Komuniste Bullgare<sup>22</sup> u kthye kështu në një mekanizëm të nevojshëm të B.S. për të kontrolluar vendin e për të implementuar modelin sovjetik. Mes viteve 1944-46 komunistët anashkaluan të gjitha forcat e tjera politike duke inauguruar kështu dhe terrorin<sup>23</sup>, qëllimi i të cilit ishte spastrimi i sistemit nga elementët tashmë të konsideruar alienë e të rrezikshëm. Ata, nuk ishin thjeshtë ata që kishin qenë pjesë e aparatit politik para dhe gjatë LIIB por të gjithë ata që potencialisht mund të identifikoheshin si armiq politikë por si potencial shkatërrimtar të vetë unitetit territorial të vendit. Në këtë logjikë, mekanizmat e represionit funksionojnë jo thjeshtë duke identifikuar armikun e brendshëm pasi thjeshtë eliminimi fizik apo neutralizmi në kuptimin e ekskluzivitetit dhe monopolit të ideor të

---

<sup>20</sup> Jens Geiseke, *The History of the Stasi: East Germany's Secret Police, 1945-1990*, (Berghahn Books, Oxford-New York, 2014) p. 16

<sup>21</sup> Norman Naimark prek në mënyrë të hollësishme situatën e pasluftës në atë që më vonë quhet Gjermania Lindore. Ai sheh sidomos ndryshimet e pilotuara nga vetë sovjetikët për ta transformuar territorin nën kontroll. Norman M. Naimark, *The Russians in Germany: A History of the Soviet Zone of Occupation, 1945-1949*, (Belknap Press, 1997).

<sup>22</sup> Michael M. Boll, *Cold War in the Balkans: American Foreign Policy and the Emergence of Communist Bulgaria 1943-1947*, (The University Press of Kentucky, 1984) p. 6.

<sup>23</sup> Në Bullgari, akti i hapjes së kampeve u nënshkrua nga ministrat e koalicionit qeveritar. Shumë prej tyre më pas do të mbylleshin vetë në këto kampe. Ekaterina Nikova, “Bulgarian stalinism revisited”, in: Vladimir Tismaneanu, *Stalinism Revisited: The Establishment of Communist Regimes in Central and Eastern Europe*, (CEU Press, 2009) p. 293.

partive komuniste nuk ka kuptim. Këtu futen dhe elementë më ancestralë ku armiku i klasës është dhe armiku i kombit, agjent i përhershëm që rrezikon unitetin kombëtar.

Partitë Komuniste me ardhjen e tyre në pushtet sidomos në Ballkan luajnë fort kartën e nacionalizmit për t'i apeluar jo vetëm komunistëve por dhe një segmenti më të gjerë popullor. Jo më kot e nëse kthehemi tek rasti shqiptar gjejmë shumë paralele me atë bullgar në vendosjen dhe justifikimin e regjimeve komuniste. As Jugosllavia<sup>24</sup> e as Shqipëria nuk panë praninë e trupave sovjetike e për më tepër klasa politike në këto vende ishte indigjene dhe jo e importuar, pa konsideruar faktin e mënyrën si partitë komuniste në këto vende erdhën në pushtet. Ndonëse pati mungesë të një diktimi të modelit nga B.S., kjo nuk i pengoi këto vende t'i përshtateshin apo të implementonin elementë bazikë të sovjetizimit të paktën në fazat e para. Kampet të cilat shërbenin për shtrëngimin dhe kontrollin e popullsisë erdhën sa si pasojë e tentativës për të huazuar modelin sovjetik si imponim (në rastet e kontrollit të drejtpërdrejtë të BS) apo si nevojë dhe politikë e brendshme. Ardhja e komunistëve në pushtet nën petkun e një koalicioni mbarë kombëtar e si pasojë e luftës së armatosur, i dha terrorit një legjitimitet sa në kuptimin e fitimit të pushtetit sa në atë të drejtësisë ndëshkimore pas-luftës. Një pjesë e historiografisë shqiptare e ka konsideruar LIIB si konflikt sa ushtarak në kuadrin e përgjithshëm aq edhe civil<sup>25</sup>. Hoxha shkruan se armiku projektohej si i tillë jo vetëm në kushtet e luftës por shërbente si kategori për t'u kriminalizuar më vonë<sup>26</sup>. Në dallim nga vende si Bullgari dhe Zona e Okupuar Sovjetike (më pas RDGj), gjeneza mbi të cilën u ngrit terrori i pas-luftës përngjante më shumë me konflikte post-civile ku theksi vihej sa tek hakmarrja sa tek identifikimi i armikut potencial. Në dallim nga rastet e mësipërme procesi i sovjetizimit në Shqipëri filloi më vonë. Kjo dhe për arsye të raporteve ekskluzive me Jugosllavinë titiste por gjithsesi represioni i përgjigjej sa logjikës së mbarimit të luftës sa asaj të perceptimit të të ndodhurit në kufijtë e kampit komunist, e kështu subjekt aktiviteti subversiv të mëtuar nga forcat antikomuniste.

Nëse ndjekim sërish Rees<sup>27</sup>, në vendet e Evropës Lindore procesi i sovjetizimit fillimisht kap aparatin e sigurisë, polici dhe ushtri, sa kohë që politikat e sovjetizimit duhet të gjenin zbatim e ky nuk mund të vinte pa siguruar kontrollin mbi monopolin e dhunës dhe forcës. Por dhe aty ku mungoi ky element pranë, si në rastin e Shqipërisë, kontrolli i Partisë mbi forcat e armatosura partizane ishte vendimtar në vendosjen e pushtetit, mbajtjen e tij dhe stabilizimin institucioneve të

---

<sup>24</sup> Për raportet specifike mes Jugosllavisë, Shqipërisë dhe B.S. mund të shihet Ivo Banac, [\*With Stalin against Tito: Cominformist Splits in Yugoslav Communism\*](#), (Cornell University Press, 1998).

<sup>25</sup> Mbi gjenezën e konfliktit civil në Shqipëri shih: Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe Tokat e Lirume*, (Shkodër: Botime "Jozef" 2018).

<sup>26</sup> Çelo Hoxha, *Krimet e Komunistëve gjatë Luftës 1941-1945*, (Tiranë: ISKK, 2014), f. 30.

<sup>27</sup> E. A. Rees, "Introduction ...", p. 12.

shtrëngimit si kampet. Në këtë panoramë kampi, bart dy elementë të dalluar dhe të përzier me njëri-tjetrin. *Së pari*, kampi është proces filtrimi, sanitizimi dhe përjashtimi i alienëve apo elementëve të pakorrekteshëm në shoqëritë socialiste të themeluara rishtas. *Së dyti*, funksioni tjetër i rëndësishëm i tij është puna. Kësisoj i vetmi element që mund të shfrytëzohej për të arritur potencialisht rezultatet e dëshiruara ishte puna e kapitalit njerëzor, që nuk mungonte në Evropën Lindore. Kampi, pra kishte funksion të rëndësishëm atë të disiplinimit të forcës së punës, normalisht pak të paguar, si sakrificë e elementit alien apo të papërshtatshëm për sistemin socialist, që shpëtimin e gjen vetëm nëpërmjet punës si formë korrektimi. Kampi si ndarje/dhunë ndaj elementit alien dhe si punë është jo lehtësisht i ndashëm në sistemet e derivuara nga ai sovjetik. Këtu nuk duhet lënë pa përmendur fakti se pavarësisht doktrinës zyrtare që lartësonte Ushtrinë e Kuqe si çlirimtare dhe emancipuese të popujve, vendet e Evropës Lindore kishin qenë pjesëmarrëse në agresionin ndaj BS e, si të tilla, duhej të paguanin ‘çmimin’ e dëmshpërblimit.

***Konteksti historik i kampeve të punës e përqendrimit: Zona Sovjetike e Okupimit (më pas R.D.Gj), Bullgaria dhe Shqipëria***

Në mesin e viteve '40 e deri në fillim të viteve '60, në Bullgari, sipas një raporti, ekzistonin 80 kampe pune dhe përqendrimi<sup>28</sup>. Gjatë LIIB, Bullgaria<sup>29</sup>, sikurse dhe disa vende të tjera të Ballkanit, midis të cilave edhe Shqipëria, nuk kishin pasur eksperiencë përqendrimi dhe shtrëngimi të grupeve të ndryshme shoqërore. Kampet, kështu, u modeluan sipas modelit sovjetik të gulagut. Ndonëse ky nocion, siç u tha më sipër, është i gjerë thelbi mbetet pak a shumë i njëjtë në aplikim, ai i shtrëngimit të personave të konsideruar si alienë dhe armiq të regjimit. Logjika ishte ajo e përqendrimit e individëve apo grupimeve shoqërore në hapësira me natyrë riedukative dhe korrektive, gjë që duhej të kryhej përmes punës<sup>30</sup>. Represioni, të paktën në pjesën e parë të marrjes së pushtetit nga Partia Komuniste Bullgare ishte funksiononte në dy drejtime, atë të terrorit<sup>31</sup>, kjo sidomos në fazën emergjente të okupimit të institucioneve, dhe atë të ndëshkimit nëpërmjet izolimit të elementit alien. Natyrisht që marrja e pushtetit nuk shërbente si një akt i kufizuar që mjaftohej vetëm me përjashtimin e asaj që ishte opozita por me aplikimin e modelit sovjetik në përpjekjen për

<sup>28</sup> Dinyu Sharlanov, Venelin I. Ganev, *Crimes Committed by the Communist Regime in Bulgaria*, Report prepared by the Hannah Arendt Center in Sofia, 2010.

<sup>29</sup> Bullgaria përshembull nuk dorëzoi hebrejtë me nënshtetësi bullgare, por ata të zonave të pushtuara në pjesë të tjera të Ballkanit. Vende të tjera si Rumania apo Jugosllavia u përballën me eksperiencën e kampit dhe persekutimin e popullsisë vendore respektivisht të hebrejve apo të minorancave etnike sikurse serbët në Mbretërinë Kroate dhe më gjerë hebrejtë. *Shih*: David Bruce Macdonald, *The Balkan Holocaust: Serbian and Croatian victim-centred propaganda and the war in Yugoslavia*, (Manchester University Press, 2003).

<sup>30</sup> Cit. te Daniela Koleva, 'Belene: remembering the labour camp and the history of memory', in: *Social History* Vol. 37, No. 1 February 2012, pp. 1-18.

<sup>31</sup> Ekaterina Nikova, *Bulgarian stalinist ...*, p. 291.



ta aktualizuar pushtetin kah ndryshimeve shoqërore radikale. Ato jo vetëm nënkuptonin kopjimin masiv të sistemit sovjetik por në fund të ditës kërkonin pikërisht arritjen e transformimeve socio-ekonomike. Kampet në këtë kuptim shërbyen si element primar i represionit dhe konsolidimit të pushtetit. Sipas Nikova-s gati e gjithë elita politike dhe sociale e vendit u zhduk në periudhën 1944-1947<sup>32</sup>. Një pjesë e saj u eliminua fizikisht ndërsa pjesa tjetër u burgos në kampet e punës. Kampet luajtën një rol instrumental në kapjen e pushtetit nga komunistët.

Meqenëse Bullgaria, sikurse pjesa tjetër e Ballkanit nuk mund të aspironte apo të kishte një bazë pararendëse ekonomike të zhvilluar sa për të kaluar nga faza kapitaliste në atë socialiste e më pas në komunizëm, regjimi bullgar sikurse dhe regjime të tjera, mëtonin të luftonin ‘me kohën’. Kjo luftë përkthehej sa në eliminimin e rezistencës sa në atë të ndërtimit qoftë dhe simbolik të rendit të ri, nëpërmjet veprave të mëdha. Pjesa më e madhe e të burgosurve nëpër kampe u përqendruan në të ashtuquajtura kampe pune, pranë siteve të ndërtimit apo minierave të mëdha<sup>33</sup>. Kampet kështu kishin si funksionin zyrtar atë të riedukimit, ndonëse ato u kthyen shpejt në një njësi përqendrimi krahu pune të lirë, gjë që ishte e nevojshme në kuadrin e një ekonomie të centralizuar. Këtë argument e mbështetin dhe Appelbaum apo Bacon<sup>34</sup> të cilët i japin një funksion special ekonomik gulagut sovjetik ku nevoja për të ndërtuar vepra gjigante me natyrë të fortë simbolike kukonte përqendrimin e krahut të punës.

Dhe në Bullgari kampet e punës dhe të përqendrimit replikuan këtë logjikë, atë të mënjanimin, identifikimit të elementit alien dhe vënien e tij në përdorim për nevoja shtetërore. Gjatë viteve 1945-1950 rreth 80.000 mijë persona ishin të mbyllur në këto kampe. Vendndodhja e kampeve sipas raportit të Sharnalov dhe Ganev ishte në të gjithë vendin gjë që na thotë se shtrëngimi apo izolimi i individëve në këto facilitete penale ishte i shumanshëm. Një interpretim i parë që mund të jepet është ai i klasik se pas fazës fillestare të terrorit, ku skalioni i dytë i armiqve të pa eliminuar nga terrori duhej të izolohej. Pas këtaj vjen momenti i punës së detyruar në kampe, ku më pas individët apo grupet shoqërore të izoluara punojnë për nevojat e në shërbim të shtetit. Këtu puna si mekanizëm humbet vlerën e saj dhe kthehet në një instrument kryekëput shfrytëzimi i vetë shtetit socialist ndaj të burgosurve. Puna gjithsesi nuk ishte elementi kryesor i kampit. Themelimi i rendit të ri dhe pamundësia materiale manifestimit të superioritetit të këtij rendi ndaj atij të vjetrit dashje padashje i kthente kampet në destinacione finale për të ndaluarit. Në kampe hynin të gjithë të padëshiruarit i regjimit. Të qenit i padëshiruar interpretohej në bazë të parimeve ideologjike ose ku

---

<sup>32</sup> *Po aty*, p. 294.

<sup>33</sup> Nadia Kaneva, “Remembering Communist Violence: The Bulgarian Gulag and the Conscience of the West”, in: *Journal of Communication Inquiry*, Volume 31, Number 1, January 2007, pp. 44-61.

<sup>34</sup> Edwin Bacon, *The Gulag at War: Stalin's Forced Labour System in the Light of the Archives*, (Palgrave Macmillan, 1996), p. 45

çdo interpretim i realitetit social që bëhej nga komunistët e nuk pranohej nga segmente të caktuar të shoqërisë, automatikisht i fuste këta në kategorinë e armiqve. Nuk ishte e pazakontë kështu që në një kamp të mos kishte vetëm disidentët apo devijantët politikë por dhe ata socialë, keqbërësit e zakonshëm. Ishte Partia ajo që identifikonte elementin që nuk i hynte në punë apo që e dëmtonte shoqërinë e re bullgare e që më pas i nënshtrohej riedukimit në kamp. Duke mos pasur një status të mirëpërcaktuar në panoramën e institucioneve të ndëshkimit, kampi kishte shpesh kushte tejet më të vështira se sa vetë burgu. Sipas Sugarev<sup>35</sup>, një pjesë e të dënuarve në kampe vetë akuzoheshin për krime nga më të ndryshmet vetëm e vetëm që t'i nënshtroheshin gjykimit e ta vuanin dënimin e tyre në burg.

Ekzistenca e kampeve në Bullgari ishte pra një nevojë fillimisht politike e, më pas, një zgjidhje për ta 'pastruar' shoqërinë nga elementi i cili zor se hynte në logjikën e ndërtimit të një shoqërie të re. Sikurse u tha më sipër, njëherë që terrori fillestar u konsumua, interpretimi mbi natyrën dhe pozitën e qytetarëve bullgarë do të ndryshonte. Kalimi në fazën e kampeve dhe burgut për elementin alien shënonte sidomos nga vitet 1947-50 dhe atë të konsolidimit të pozitës politike të komunistëve bullgarë. Kontrolli dhe monopoli i pushtetit gjithsesi ishin relativisht të brishtë. Nëse do t'i referohemi Mayer<sup>36</sup>, ai e lidh terrorin në post-revolucionin rus dhe atë të periudhës staliniste të viteve tridhjetë me natyrën e vetë regjimit, brishtësinë e legjitimitetit si dhe ambientin ndërkombëtar të pafavorshëm. Kampi në këtë kuptim është aksesor i terrorit, element permanent i sistemit që funksionon sa dhe kurdo që një regjim e ndjen veten të brishtë.

Rasti shqiptar i kampeve ka disa ngjashmëri me atë bullgar, ndonëse në një kontekst të ndryshëm. Terrori në Shqipëri lidhet në fazat e para të ardhjes së komunisteve në pushtet 'nënshttrimin' e zonave të çliruara. Procesi i sovjetizimit implementohet gradualisht<sup>37</sup> më vonë. Pikërisht për këtë arsye dhe represioni në Shqipëri është i natyrës më tepër ushtarake se sa civile. Sfida kryesore e regjimit ishte kontrolli i territorit dhe spastrimi i të gjitha atyre bërthamave që mund të krijonin hapësira për rebelim të armatosur. Në këtë kuptim natyra e instituteve të represionit, kampet e përqendrimit apo të punës së detyruar shërbenin më shumë në kuptimin klasik të kampit atë të lëvizjes së një pjese të popullsisë nga një territor në një tjetër me qëllim shpërnguljen nga baza sociale e saj. Sipas Dervishit, në Shqipëri ekzistonin rreth 12 kampe përqendrimi apo internimi dhe

---

<sup>35</sup> Sugarev cit. te N. Kaneva *Remembering ...*, p. 47.

<sup>36</sup> Arno J. Mayer, *The Furies: Violence and Terror in French and Russian Revolutions*, (Princeton University Press, 2000), p. 609.

<sup>37</sup> Prapambetja ekonomike dhe copëzimi socioekonomik i Shqipërisë e shtyn drejt viteve pesëdhjetë procesin e sovjetizimit. Fakt për këtë janë dhe zhvillimet apo reformat fillestare të regjimit si ajo agrare që i përgjigjen më tepër nevojave apo aspiratave të fshatarësisë se sa një projekti të mirëfilltë socialist. Për këtë *shih*: Elidor Mëhilli, *From Stalin to Mao: Albania and the Socialist World*, (Cornell University Press, 2018).

8 kampe pune nga viti 1945 deri në vitin 1953<sup>38</sup>. Ato u krijuan sapo forcat partizane konsoliduan kontrollin mbi territorin e Shqipërisë në kufijtë e para 1941. Ato ecën paralelisht me fazën e terrorit dhe ndëshkimit të figurave politike të periudhës së monarkisë, pushtimit italian dhe regjencës<sup>39</sup>. Në dallim nga Bullgaria, kampet mbajtën jo nga autoritetet civile por nga ato ushtarake. Situata në Shqipërinë e pas luftës ngjante me tepër me atë të një vendi në kushte emergjence e ‘të vetë pushtuar’. Fakti se një pjesë e mirë e forcave partizane u inkuadruan në mënyrë imediate në ushtrinë e re shqiptare tregonte për brishtësinë e regjimit të sapo vendosur. Po kështu dhe përpjekja e ethshme për t’i bërë, sikurse dhe në vende të tjera të Evropës, gjyqin klasës politike të para LIIB<sup>40</sup>.

Ndonëse pa një kontroll direkt nga Moska dhe pa një eksperiencë të inkuadrimin dhe eliminimit të kundërshtarëve politikë, regjimi komunist në Shqipëri iu përshtat shpejt simotrave në Lindje. Kështu në Shqipëri nuk mund të flitet për një proces të mirëfilltë sovjetizimi sa kohë që eksperiencia apo modeli kryesor ishte ai jugosllav. Megjithatë, vetë Jugosllavia titiste nuk ndryshonte shumë nga vendet e tjera të lindjes në rrugëtimin stalinist. Rasti i Shqipërisë dhe Jugosllavisë, sikurse u tha më sipër trajtohen veçmas në studimet e vendosjes së regjimeve komuniste. Ato shihen si regjime me natyrë të theksuar indigjene, kjo falë ardhjes në pushtet ‘me forcat e veta’, narrativë kjo rëndom e përdorur nga historiografia komuniste<sup>41</sup> në Shqipëri. Natyrisht që regjimi i vendosur nuk erdhi pa kundërshti, ndonëse kjo e fundit ishte relativisht e vogël por me potencial akoma të lartë. Regjimi i Tiranës vihej në rrezik dhe nga lidhjet e forta që ekzistonin mes pjesëve të Kosovës dhe Shqipërisë së Veriut, rezistenca anti-serbe, opozitë të natyrës lokaliste apo dhe të elitës politike që kish mbetur pas emigracionit të pas-luftës.

Vetë kompozimi social, fetar, lokal dhe zhvillimor i vendit si dhe përpjekjet e shërbimeve sekrete të huaja për destabilizimin regjimit ngrinin pikëpyetje të forta për mbijetesën e tij<sup>42</sup>. Në vitet 1944-45, Shqipëria pozicionohet gjeografikisht e sërish (pas rënies së Perandorisë Otomane) në kufi mes dy kampeve diametralisht të kundërta, Lindjes Komuniste dhe Perëndimit (nëse Greqia mund të kualifikohet si e tillë). Sa më sipër janë disa prej kushteve që favorizon emergjencën e kampeve të përqendrimit dhe atyre të punës dhe të internimit në vend. Roli dhe funksioni i tyre varej nga kategoria shoqërore e njerëzve të mbyllur aty. Logjikisht sistemi mëntonte të izolonte elementin opozitar, atë armik dhe atë potencialisht të tillë. Në këtë kuptim mes viteve 45-6 dhe 50 në kampe u mbyllën kategori të ndryshme njerëzish. Në kampet e punës së detyruar përziheshin të burgosurit

---

<sup>38</sup> Kastriot Dervishi, *Burgjet dhe Kampet e Shqipërisë Komuniste*, (Tiranë: ISKK, 2015).

<sup>39</sup>Në lidhje me terrorin e viteve 1944-1947, shih: Pjetër Pepa, *Dosja e Diktaturës*, (Tiranë: ISKK, 2017).

<sup>40</sup> *Shih: Aktet Gjyqësore Politike*, Vol. 1, 2 dhe 3, (Tiranë: ISKK, 2015&16).

<sup>41</sup> Bernd J. Fischer, “20-th Century Albanian Military Prowess”, in: Stephanie Schwandner-Sievers dhe Bernd J. Fischer (eds.) *Albanian Identities: Myth and History*, (Indiana University Press, 2000) p. 141.

<sup>42</sup> Nicholas Bethell, *Tradhëtia e madhe*. (Tiranë: Progresi, 1993).

politikë dhe ata të zakonshëm. Ky dallim bëhet *a posteriori*, duke qenë se për regjimin e sotëm liberal, i burgosuri politik nuk ekziston më si figurë. Në vitet për të cilat flasim ky konfuzion është më se logjik.

Kampi i punës kishte si funksion primar riedukimin. Frymën e për aq sa perceptohej ideologjia ahore, aktiviteti kryesor në kamp, puna duhej të kishte këtë funksion. Këtu e ndoshta dhe në rastet e trajtuara, ka një paradoks ku nga një anë mëtohej formalisht riedukimi por nga tjetra, e të paktën për të burgosurit politikë, ata i përkisnin klasave të përmbysura. Kur flasim për përmbysje në kuptimin e revolucionit hakmarrja e një grupi social mbi tjetrin është e paevitueshme e për më tepër kur kjo ishte kultivuar gjatë përplasjeve civile në LIIB. Por, njëherë që mbaron faze e terrorit, veprimet pedagogjike që regjimi i ri bën ndaj klasave të përmbysura, vazhdojnë logjikën e hakmarrje<sup>43</sup>. Puna e kryesisht ajo e detyruar shihet si formë hakmarrje më tepër se sa si korrektim. Zef Pllumi përshkruan shumë mirë sa më sipër kur flet për kampin e Bedenit në Kavajë<sup>44</sup>. Dëshmitë që jepen janë ato të kushteve të tmerrshme të punës dhe kampit e për më tepër efektet që ato kishin mbi të burgosurit ku vihet theksi tek jo përshtatshmëria që kishin të burgosurit, me aktivitetin. Për kampet e punës në vitet e pas luftës ka pak dëshmi e ato që janë vijnë nga individë me formim të qenësishëm intelektual e në një moshë ku efektet e kampit kanë qenë të shpesh vdekjeprurëse.

Kategoria e dytë e kampeve ishin ato të përqendrimit, sikurse ai Tepelenës. Në të u mbyllën përgjithësisht pleq, gra e fëmijë<sup>45</sup>. Kjo është një kategori që nuk haset në rastet në e marra në shqyrtim në këtë punim. Familjarët e tyre, ishin armiq të regjimit të cilët ose ishin eliminuar në momentet e terrorit të fund vitit 44 ose nga seria e gjyqeve speciale të viteve 1945-46. Me mbarimin e luftës një pjesë e konsiderueshme e elitës politike apo individë të implikuar me Regjencën, Ballin apo opozitarë të regjimit u internuan në kamp. Popullsia e këtij kampi ishte shumë specifike pasi bëhej fjalë për gra, pleq e fëmijë. Si kategori këto nuk mund të konsideroheshin armiq në kuptimin ideologjik të fjalës për vetë inaktivitetin sociopolitik, por ata kishin një vlerë tjetër, atë të pengut. Nëse në vitet e paraluftës, ishte më se e zakonshme që kryetari i familjes të largohej në emigracion politik e të linte familjen prapa pa pasur frikën e hakmarrjes, kjo nuk ndodh në vitet e pasluftës. Ata që largohen nga vendi në emigracion politik lenë pas familjet të cilat kthehen në objekt sulmi nga regjimi i ri. Në këtë kuptim, ardhja e komunistëve në pushtet dhe veprimet e tyre japin një sinjal të qartë e radikal ndryshimi ku format e persekutimit shtrihen përtej individit tek familjet. Tradicionalisht forcat partizane e kishin bazën sociale në jug e në të njëjtën kohë eliminuan çdo

---

<sup>43</sup> AQSh, Sektori Politik i Policisë Popullore drejtuar Komitetit Qendror të P.K.Shqiptare, "Raport Informativ Mujor", Tiranë, 30.VI, 1948

<sup>44</sup> Zef Pllumi, *Rrno vetëm me tregue*, (Shkodër: Hylli i Dritës, 2001), f. 231.

<sup>45</sup> K. Dervishi, *Burgjet dhe Kampet ...*, f. 21.

formë opozite në rajon. Me kalimin e lumit Shkumbin drejt veriut ato hynin në një terren të vështirë e kësaj një prej mënyrave të vendosjes së kontrollit ishte ajo e marrjes peng dhe vendosjes së familjarëve të kundërshtarëve të regjimit larg bazës së tyre shoqërore, dhe për të shkurajuar çdo formë rezistence. Kampi i Tepelenës, është një element i veçantë në panoramën e rasteve të marra në këtë punim e i përgjigjet specifikave të vendit dhe kushteve të ardhjes së komunistëve në pushtet. Në vitet e fundit, viktimat kanë dhënë dëshmi të shumta në lidhje me kushtet e tmerrshme që sollën si pasojë vdekjen e shumë prej të vendosurve atje. Kampi kishte një vend-ndodhje të veçantë, në kazermat e braktisura të ushtrisë italiane në hyrje të Tepelenës. Nëse në B.S. apo vende të tjera kampet janë larg zonave të banuara apo në afërsi të një lokacioni pune (minierë apo objekt). Vendndodhja mund të ketë qenë rastësore, e varur nga kushtet logjistike (kazermat), por afërsia me një zonë, dhe pse të vogël urbane tregon se si regjimi bën një dallim të qartë mes anëtarëve brenda kampit, tashmë të përjashtuar nga komuniteti politik dhe atyre jashtë duke treguar dhe vizualisht ‘armikun kolektiv’<sup>46</sup>.

Në Gjermaninë Lindore apo Zonën Sovjetike të Okupimit (S.B.Z.), situata politike ishte nën kontrollin e Ushtrisë së Kuqe dhe administratës së pushtimit. Fill pas mbarimit të luftës forcat sovjetike u përpoqën të zgjidhnin problemet imediate të zonës nën kontroll. Në dallim nga Bullgaria dhe Shqipëria, zona e Gjermanisë nën kontrollin sovjetik nuk kishte as asnjë formë organizimi civil e aq më pak ushtarak. Kështu sovjetikët u ndikuan nga zgjidhja e problemeve imediate në raport me organizimin politik të rajonit. Naimark<sup>47</sup> thotë se këto zgjidhje diktoheshin shumë nga kuptimi politik dhe simbolik që kishte rajoni (si zemra e ish-Rajhut). Ndërhyrja sovjetike gjithashtu diktohej nga parimet e natyrës ideologjike, mospërputhshmëria me projektin nazist dhe transformimet rrënjësore që duhej të aplikoheshin për të bërë të mundur vendosjen e një sistemi socialist në zonën e okupimit. Për këtë arsye procesi imediat ishte ai i denazifikimit<sup>48</sup> që prodhoi dhe kampet e para të ndalimit në rajon<sup>49</sup>. Kampet ishin të dy llojeve ato me të burgosur ushtarakë dhe ato civilë. Dallimi mes të dyve është i qartë dhe i përgjigjet kushteve të Gjermanisë së pasluftës, porse trajtimi i të ndaluarve ishte pak a shumë i njëjtë. Kampet (Spetzlager) kishin një funksion e identifikimit dhe

---

<sup>46</sup> Nëse i referohemi Fukosë, periudha që përkon me revizionizmin e sistemeve penale në Evropë, shënon dhe mënjanimin vizual të ndëshkimit trupor. Dënimi dhe ndëshkimi ndodh tashmë brenda në burgjeve e kampeve. Në Shqipëri, në periudhën e fill pasluftës, dënimi e ndëshkimi janë të prekshëm bile dhe manifestohen sikurse në rastin e Kampit të Tepelenës të vendosur afër një qendre të banuar apo të të dënuarve me punë të detyruar që punojnë krahas vullnetarëve në Maliq. Mbi konceptin e eliminimit të ndëshkimit si ‘spektakël publik’ shih: Foucault *Disiplinë dhe Ndëshkim*, f. 18-19

<sup>47</sup> N. M. Naimark, *The Russians in Germany ...*, p. 5.

<sup>48</sup> Timothy R. Vogt, *Denazification in Soviet-Occupied Germany: Brandenburg, 1945–1948*, (Cambridge, Massachusetts, and London: Harvard University Press, 2000) f. 36.

<sup>49</sup> Sipas Herf, sovjetikët certifikuan rreth 800.000 qytetarë në këtë proces shih: Jeffrey Herf, *Divided Memory: The Nazi Past in the Two Germanys*, (Cambridge, Massachusetts, and London: Harvard University Press, 1997).

më pas ndalimit të individëve të lidhur me nazizmin. Ato kontrolloheshin në mënyrë direkte nga NKVD, sigurimi i brendshëm sovjetik e më pas ju kaluan nën kontroll Stasit<sup>50</sup>. Në dallim nga perëndimi<sup>51</sup>, procesi i denazifikimit në lindje u shtri dhe në sfera të tjera të organizimit shoqëror. Në dallim nga Bullgaria e Shqipëria, e përtej kontrollit imediat ushtarak nga forcat sovjetike, Partija Komuniste Gjermane (KPD) dhe ajo Social Demokrate (më vonë të shkruara në një të vetme SED) e konsideronin popullsinë si fajtorë që nuk i kishte rezistuar në masë ardhjes së nazistëve në pushtet. Kështu represioni mbi popullsinë ishte i dyfishtë si nga sovjetikët dhe nga administrata civile e okupuar tashmë nga forca jo vetëm me autonomi të kufizuar politike<sup>52</sup> por tejet të gatshme të çonin përpara procesin e sovjetizimit. Përtej kësaj S.B.Z. ju nënshtrua dhe një procesi traumatik deindustrializimi dhe shfrytëzimi ekonomik nga ana e forcave sovjetike. Ushtria e Kuqe e konsideronte zonën e saj të kontrollit si një entitet ku nuk aplikoheshin veçse rregullat ato të gjendjes së jashtëzakonshme. Në këtë kuptim kampet në zonën lindore shërbenin sa për procesin e denazifikimit sa për atë të qëllimeve imediate të vetë okupatorëve sovjetikë. Nga viti 1945 deri në vitin 1950 rreth 122,671 gjermanë ishin të internuar në kampet e S.B.Z. Një pjesë e mirë e tyre vdiqën prej kushteve të këqija të jetesës<sup>53</sup>. Në disa raste kampet naziste si ai i Buchenwald-it dhe Sachsenhausen-it, u kthyen në kampe burgosje nga autoritetet okupuese sovjetike. Në të njëjtën kohë, okupatorët sovjetikë ishin dyshues ndaj popullsisë dhe segmenteve të ndryshme të shoqërisë gjermano-lindore. Kjo vinte si pasojë e natyrës së vetë regjimit sovjetik dhe logjikës izolacioniste me të cilën lidhshipi sovjetik ishte mbrojtur. Terrori në B.S. ishte bërë në emër të mbrojtjes së revolucionit, e si i tillë ai aplikohesh në vendet e Evropës Lindore e sidomos në S.B.Z.

Përpos kushteve, natyrës së okupimit ushtarak dhe raportit të tij me popullsinë civile, kampet në pjesën lindore të Gjermanisë u kthyen morën karakterin e gulagëve sovjetikë, atë të punës së detyruar. Sovjetikët, përdorën popullsinë civile si krah pune për të përmbushur detyrimet e reparacioneve të luftës që Gjermania e mundur kishte ndaj B.S. dhe një pjesë e konsiderueshme e të ndaluarve në kampeve u dërguan për të punuar me punë të detyruar në B.S.<sup>54</sup>. Sipas Murdock<sup>55</sup>, deri në vitin 1949 puna e detyruar ishte pjesë e pandashme e jetës në S.B.Z., kjo aplikohesh si në për individët pjesë të kampeve si për popullsinë punëtore të lirë. Në zonën lindore, popullata ishte subjekt jo vetëm kontrolli por dhe i përgjigjeve direkt nevojave që mund të kishin okupatorët

---

<sup>50</sup> J. Gieseke, *The History of the Stasi: East Germany's Secret Police, 1945–1990*, (New York-Oxford: Berghahn Books, 2014)/

<sup>51</sup> Ulrich Merten, *The Gulag in East Germany: Soviet Special Camps 1945-1950*, (Teneo Press, 2017).

<sup>52</sup> T. R. Vogt, *Denazification ...*, p. 37.

<sup>53</sup> J. Herf, *Divided Memory ...*, p. 73.

<sup>54</sup> J. Geiseke, *The History of Stasi ...*, p. 17.

<sup>55</sup> C. Murdock, *A Gulag in the Erzgebirge ...?*, p. 820.

sovjetikë. Naimark kështu shkruan se N.K.V.D.,deportoi disa mijra shkencëtarë dhe punëtorë të specializuar në B.S. për të punuar në programin raketor sovjetik<sup>56</sup>.

Pjesë integrale e natyrës së kontrollit të B.S. në Gjermani ishte, përtej elementit të ndëshkimit dhe ai i konsiderimit të vendit si një rezervë teknologjike e pune të specializuar të cilën mund ta dispononte sipas dëshirës dhe me konsensusin e autoriteteve gjermane. Por, S.B.Z. nuk ishte e izoluar, dallimi që kish filluar të përvijohet mes lindjes dhe perëndimit në raport me kushtet diktoi shpejt një tentativë të sovjetikëve për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe për të ulur, pas vitit 1949 represionin. Kjo natyrisht nuk i aplikojë sektorëve strategjikë ku rëndom përdroreshin të ndëshkuar me punë të detyruar. Sektori minerar e sidomos minierat e uraniumit përbënin një sektor strategjik për sovjetikët. Një prej tyre, Erzgebirge u kthye në një vend simbol të vuajtjeve ekstreme të punëtorëve. Në fakt miniera nuk ishte konceptuar si një kamp por natyra e punës bënte që ajo të kishte nevojë të vazhdueshme për punëtorë. Përveç elementit politik apo kriminal, në minierë dërgoheshin dhe të burgosurit e luftës gjermanë të cilët ktheheshin në Gjermani. Pjesa dërmuese e tyre nuk kishin dokumente kështu që autoritetet i dërgonin në minierë<sup>57</sup>. Kushtet ishin të tmerrshme, e këtu nuk bëhej fjalë vetëm për ato të punës, por për gjithçka kishte të bënte me jetesën e punonjësve. Ndonëse Erzgebirge nuk ishte në posaçërisht një kamp pune apo burgosje, kushtet, format e rekrutimit apo dhe vetë trajtimi i punëtorëve ishin aq të vështira saqë i ngjanin më tepër një vendi dënimi.

Natyra e shtrëngimit të njerëzve në Gjermaninë Lindore në periudhën 1945-50 mund të shihet në disa forma. Fillimisht vendi ishte territor i pushtuar ushtarakisht gjë që, i vinte okupatorët para disa dilemash sikurse kontrolli dhe organizimi ekonomik i territorit. Vetë sovjetikët dhe për logjikën sistematike që përdornin, bënë një proces denazifikim shumë më skrupuloz sesa Aleatët Perëndimorë, gjë që detyrimisht prodhoi kampin. Sovjetikët përmes represionit kërkuan të zhduknin që në fillim çdo lloj forme rezistence të dhunshme apo të jo të dhunshme ndaj pushtimit. Paralelisht me këtë, kampi dhe persekutimi erdhën dhe si pasojë e mbështetjes që B.S. i dha S.E.D.-it apo dhe vetë si kërkesë e vetë administratorëve komunistë gjermanë. Këta të fundit ishin të interesuar të mos kishin asnjë formë rezistence jo vetëm nga ish-nazistët por dhe nga opozitarë të tjerë politikë. Elementi i fundit që justifikon logjikën e kampit ishte ai i punës së detyruar si formë reparacioni lufte. Ndonëse kjo formë jo detyrimisht futet në natyrën e kampit si vend shtrëngimi dhe ndëshkimi, prapë shërben për të dhënë një pamje më të plotë të panoramës së okupimit sovjetik në Gjermaninë e pas luftës. Vendi siç u tha më sipër u pa jo vetëm si hapësirë strategjike në atë që më pas do të ishte lufta e ftohtë, por si plaçkë lufte. Kampet kryenin një pjesë të këtij funksioni, atë

---

<sup>56</sup> N. M. Naimark, *The Russians in Germany ...*, p. 221.

<sup>57</sup> *Po aty*, p. 239

të pagimit të reparacioneve mes punës së vendasve. Persekutimi në këto hapësira ishte pjesë e natyrshme e mënyrës se si, në mungesë të një legjitimiteti të qartë, sovjetikët kërkonin të kontrollonin territorin.

### *Përfundime*

Pas komunizmi në Evropën Lindore ka qenë një përpjekje e vazhdueshme për të njohur anën fshehtë apo për të provuar ta çka një pjesë e publikut njihte. Kampet e shtrëngimit të popullsisë, ishin ndofta pjesa më e errët e problematike e historisë së këtyre vendeve. Ajo që del nga ky punim nuk është vetëm fakti i ekzistencës së këtyre formave në vendet ku komunistët morën pushtetin, por format dhe mënyrat në të cilat kampi u konceptua. Në njërën anë, ardhja e komunistëve në pushtet nuk ishte fundi i historisë, pasi regjimet komuniste, gati në të gjithë Evropën Lindore ndjenin një pasiguri kronike gjë që prodhoi dhe format e represionit.

Kampet fillimisht ishin një nevojë sigurie se sa si formë shfrytëzimi. Në vende si Bullgaria apo Shqipëria raporti i shtrëngimit të popullsisë dhe punës së detyruar në rindërtimin e vendit nuk i përgjigjej nivelit të zhvillimit pasi të dyja ishin vende agrare. E kundërta në Gjermaninë Lindore ku puna e detyruar, sikurse dhe transferimi punonjësve gjermanë në B.S. shërbenin si forma reparacioni të luftës. Fakti mbetet që kampi ishte një prej elementëve që shënojnë vendosjen e regjimeve komuniste dhe konsolidojnë permanencën e tyre në pushtet.

Ndonëse koncepti sovjetik i gulagut ishte vetëm si formë, kampet erdhën dhe si nevojë e vetë elitave të reja politike për të siguruar dhe mbajtur pushtetin. Në Shqipëri një pjesë e konsiderueshme e elitës ishte larguar kur LIIB ishte në mbarim e sipër. Shumë prej të larguarve shpresonin në një ndërhyrje të aleatëve për t'u kthyer e kështu lanë mbrapa familjet. Për të evituar pikërisht një opozitë të ardhshme regjimi komunist operoi përdori represionin jo vetëm për të konsoliduar pushtetin por dhe shënjuar përherë armikun. Ruajta e luftës së klasave në diskurs dhe praktikë, shënon jo thjeshtë forcën por më shumë frikën nga ato që quheshin klasa të përmbysura. Aspekti pedagogjik dhe korrektues i kampit apo burgut kështu bie, e me të bie thelbi i vetë socializmit, i cili pranon mos korrektimin e individit e për pasojë dështimin e tij. Në Bullgari po kështu ardhja e komunistëve në pushtet lidhet ngushtësisht me represionin. Në kuptimin më klasik ai ishte pjesë e paketës ndëshkuese ndaj elitës para-komuniste si aleate e nazizmit por dhe si persekutorë e komunistëve përpara luftës. Aspekti i punës dhe këtu ishte dytësor, pra kampi e puna e detyruar i shërbenin më shumë represionit se sa ekonomisë në kuptimin e shfrytëzimit të punës së papaguar.

Në përfundim eksperiencat me kampet variojnë sikurse dhe llojet e kampeve apo motivet. Një element i përbashkët mbetet ai i kampit si element i pashmangshëm në vendosjen e regjimeve



komuniste, të cilat ndonëse ishin fituese të luftës, nuk arrinin të krijonin një bazë të qëndrueshme legjitimiteti. Ndryshimet radikale që kërkoheshin të operoheshin nuk e justifikonin kampin dhe represionin përveç se në raport me marrjen e pushtetit. Në Bullgari e aq më shumë në Shqipëri, industrializimi dhe kolektivizimi filluan në një kohë kur kampet kishin humbur funksionin e tyre e ishin kthyer në insititucione mirëfilli penale.

**Trajtimi i të kaluarës në raport krahasues: Shqipëria dhe Evropa Lindore**

**Abstrakt**

Trajtohen tiparet kryesore të qëndrimit ndaj së kaluarës në Shqipëri, duke u përqendruar në kategoritë e punës së detyruar dhe të dhunës shtetërore, krahasuar me praktikatat e vendeve të tjera ish komuniste si Rumania, Polonia, Çekia dhe Estonia, vende që paraqesin identitete të mjaftueshme përfaqësuese të kornizës së plotë të ndarjes me të kaluarën. Punimi përmbledh analizën politike të procesit të qëndrimit ndaj së kaluarës në këto vende, ecurinë juridike dhe sjelljen shtetërore, si dhe bilancin e deritanishëm të proceseve në rrafsh krahasues.

**Hyrje**

Tri dekada pas rënies së Murit të Berlinit dhe fundit të Luftës së Ftohtë vendet ish-komuniste ende ndeshen me pasojat e të kaluarës dhe sfidën e përballjes me to. Në Rumani, Bullgari, Poloni, Sllovakia dhe në Çeki debatet mbi të shkuarën komuniste, dosjet sekrete dhe “dekomunizimin” vijojnë të jenë pjesë e agjendës dhe retorikës politike. Në Ukrainë nismat për dekomunizimin e vendit kulmuan me ligjin e vitit 2015, debatet dhe efektet e të cilit vijojnë të jenë prezent edhe sot. Gjermania vijon të ketë rol aktiv në dialogun mbi të kaluarën dhe memorien ndaj saj. Në Estoni, më 2015 u iniciua nisma për krijimin e një grupi hetimor ndërkombëtar mbi krimet e komunizmit dhe përgjegjësit e tyre, duke marrë si model praktikatat e hetimit dhe të gjyqimit në tribunalin e Nurembergut. Nismës estoneze iu bashkuan tetë shtete ish komuniste të Evropës Lindore dhe një numër i madh vendesh e institucioneve perëndimore. Shqipëria nuk i është bashkuar ende kësaj nisme, megjithatë edhe ajo vijon periodikisht të jetë e përfshirë në debat.

Shqipëria ishte e fundit në listën e shteteve që bënë ndryshimin e sistemit dhe miratimin e shumicës së akteve politike, përfshirë edhe ato mbi politikën dhe nismat që lidhen me të kaluarën. Në realitetin tonë, ashtu si në praktikatat e ndryshimeve të mëdha, pritshmëritë qytetare ishin shumë më të mëdha sesa kapacitetet: shumica absolute besonin se ndarja me të kaluarën do të bëhej e shpejtë dhe e plotë. I pari sondazh perëndimor (USAID 1991) i zhvilluar në Shqipëri në pranverë dhe vjeshtë 1991 tregonte se mbi 85% e qytetarëve besonin se Shqipëria do të bëhej një demokraci e qëndrueshme dhe funksionale, mbi 95% mbështesin integrimin, rreth një e katërta besonte se do të kishte një periudhë të gjatë tronditjeje, 52% kërkonin ndryshime radikale në ekonomi dhe në shtet, 71% vlerësonin se do të kishte qenë më mirë nëse

komunistët nuk do të kishin ardhur kurrë në pushtet<sup>1</sup> dhe 7 në 10 veta besonin se në 5 vitet e ardhshme jeta e tyre do të jetë shumë më e mirë. Pesë vjet pas këtij sondazhi vendi hyri në krizë të thellë politike dhe më pas edhe krizë sociale e ekonomike, duke rrezikuar ekzistencën e rolit të shtetit dhe duke ftuar trupa paqësore ndërkombëtare të përmbushnin funksionet bazë të tij. Në këtë mënyrë shqiptarët e nisën tranzicionin politik përmes pritshmërive të mëdha, të cilat pasonin zhgënjimet e mëdha gjatë periudhës komuniste. Brenda këtyre përgjigjeve mund të kuptohet edhe më mirë fakti se konceptet e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe reformave ekonomike ishin dukshëm në kontrast me kapacitetet, aftësinë, vizionin dhe formimin kulturor të elitës së re politike dhe të vetë sistemit të ri.

Në dhjetor 1990 u lejua pluralizmi politik dhe u legalizuan partitë e para politike. Në programin fillestar me 23 pika, opozita e parë jo komuniste nuk kishte asnjë citim apo trajtim të çështjes së ndarjes nga e kaluara apo referimit tek shtresa e ish të përndjekurve politikë, përfshirë dhe ata që ende ndodheshin në burgje apo kampe internimi. Opozita e përfaqësuar nga Partia Demokratike, angazhohej për shtet të së drejtës, pluralizëm konkurrues, liri mendimi e veprimi, diversitet në pronësi, integritet dhe tema të tjera deklarative<sup>2</sup>. Opozita iu kthye kësaj kategorie dhe tematike vetëm në mesin e janarit 1991, një muaj pas pluralizmit dhe në ditët kur udhëheqësi i fundit komunist, Ramiz Alia, nxori dekretin në mbrojtje të figurës së diktatorit Hoxha.

Në javën e fundit të muajit dhjetor 1990 edhe partia në fuqi, Partia e Punës (PPSH) publikoi programin e saj elektoral politik, - në asnjë pikë të së cilit nuk flitej për falje, reflektim, lirim të të burgosurve politikë dhe as rehabilitim apo drejtësi. Përkundrazi, në program citohej diktatori Hoxha me vlerësime të larta<sup>3</sup> dhe ruheshin të njëjtat linja ideologjike si në paraditen e 12 dhjetorit, kur ende nuk ishte lejuar e jetësuar ndryshimi i sistemit politik. PPSH-së iu deshën gjashtë muaj të tjerë kohë për të pranuar nevojën e rishikimit të programit në drejtim të së kaluarës dhe të vendosë ndryshimin e emrit, ekipit drejtues dhe elementëve të tjerë funksionalë në një parti politike. Të njëjtat tipare gjejmë edhe tek partitë e tjera politike që u krijuan në fillim të vitit 1991 dhe konkurruan si subjekte reale apo fiktive në zgjedhjet parlamentare të marsit 1991.

Analiza e debatit politik 1991 na ndihmon për të kuptuar më qartë vizionin dhe nivelin demokratik të elitës së re politike, e cila dominoi për më shumë se dy dekada procesin e

---

<sup>1</sup> Ylli Bufi, *Në fillimet e tranzicionit*. Tiranë: UET Press, 2016, f. 330-334.

<sup>2</sup> Afrim Krasniqi, *Partitë politike në Shqipëri 1920-2006*, Tiranë: ISP, 2006, f. 360.

<sup>3</sup> *Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSH) Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi i Partisë (më tej: AP) Viti (më tej: V) 1990, Dosja (më tej: D.) 22, Fleta (më tej: fl. 2/3). Programi për fushatën elektorale dhe për legjislaturën e ardhshme.*

tranzicionit. Liderët kryesorë të vitit 1991 ishin edhe liderët kryesorë në secilën prej vendimmarrjeve të mëdha politike të tranzicionit. Më 1 gusht 1991, Kuvendi i Shqipërisë u mbledh në seancë për të nisur debatin mbi projektligjin “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”. Më shumë sesa një debat ligjor dhe teknik, ai përfaqësonte vizionin e elitës politike ndaj periudhës komuniste, si dhe testonte gatishmërinë e sistemit të ri për të rivendosur drejtësi dhe për të krijuar ndarjen ligjore me të kaluarën. Debati mbi ligjin zgjati 4 ditë, pa arritur të gjendet zgjidhje konsensuale.

Siç shkruan në kujtimet e tij ish-kryeministri Ylli Bufi, trajtimi i të kaluarës dhe ish të përndjekurve politikë ishte “një nga çështjet e nxehta të asaj periudhe ... Fillimisht, projektligji u paraqit nga Qeveria e Stabilitetit në Kuvend më 1 gusht ... Kuvendi nuk e pranoi projektligjin dhe ia ktheu qeverisë për ta rishikuar. Çështja themelore e këtij debati lidhej me dhënien e pafajësisë të të gjithë ish-të dënuarve politikë dhe të përndjekurve politikë. Ministria e Drejtësisë, që kishte përgatitur projektligjin, e shikonte çështjen thjesht nga pikëpamja juridike, duke argumentuar se pafajësinë mund ta japin vetëm gjykatat”<sup>4</sup>. Vetë qeveria, në votëbesimin e saj në qershor 1991, kishte premtuar<sup>5</sup> se “brenda një kohe të shkurtër do të paraqesë për miratim në Kuvendin Popullor një akt normativ me anë të të cilit të realizohet rikthimi i të drejtave politike, juridike, të strehimit, punësimit etj., të njohjes së kohës së vuajtjes së dënimit si kohë e vlefshme për efekte pensioni si dhe probleme të tjera që lidhen me sigurimet shoqërore, të profesionit të të dënuarve politikë të ndërgjegjes si dhe për ata të dënuar që deklarohen të pafajshëm”.

Midis palëve politike në parlament kishte diferenca të dukshme. Në emër të së majtës, kryetari i sapozgjedhur i Partisë Socialiste, Fatos Nano deklaroi se “ne e thamë hapur dhe qartë se gjithë të dënuarit apo të arratisurit politikë, përveç kolaboracionistëve të fashizmit dhe atyre që shfrytëzuan deri në palcë punëtorin dhe fshatarin, duhet të shpallen të pafajshëm”<sup>6</sup>. Siç del nga kjo deklaratë dhe nga diskutimet e shumta të atyre seancave plenare, megjithëse parlamenti ishte mbledhur për të rivendosur drejtësinë lidhur me ish të përndjekurit politikë, ende dominuese mbeteshin etiketimet kolektive për “bashkëpunëtorë të fashizmit” dhe “ata që shfrytëzuan deri në palcë punëtorin dhe fshatarin”, pra shtresat e pasura në qytet e fshat, të shpronësuara me forcë në vitet 1944-1948.

Përballë mazhorancës, opozita u shfaq më e avancuar në qëndrimet e saj dhe më përfshirëse në kategoritë dhe problematikat që ligji do të trajtonte. Sipas kreut të opozitës Sali

<sup>4</sup> Y. Bufi, *Në fillimet e tranzicionit ...*, f. 184.

<sup>5</sup> *Programi i Qeverisë së Stabilitetit*, Kuvendi i Shqipërisë, 12.06.1991.

<sup>6</sup> “Fatos Nano” në: *Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të*, Viti 1991, nr. 4, 30.09.1991, f. 1714.

Berisha, “*ligji është një ligj vendimtar në kuptimin e ndarjes së shoqërisë shqiptare nga e kaluara*”<sup>7</sup>. Ai pranoi më tej vlerën simbolike të nismës, kur deklaroi se “*e vërteta është që në qoftë se kjo Qeveri, në morinë e halleve të mëdha, një burim financiar të caktuar nuk gjen dhe nuk cakton për to, fjalët dhe ligjet tona do të kenë vlerë morale, por këta përsëri do të vazhdojnë të jetojnë në zinë dhe mjerimin, në të cilën i zhytëm*”, por ndryshe nga PS kërkoi që krahas ndjesës publike, “*të bëjmë dhe një dënim solemn të krimit dhe diktaturës, e cila pa dyshim është përgjegjëse për këtë vepër*”.

Analiza të tilla dhe sidomos analiza e akteve politike dhe ligjërit politik të elitave të reja që dominuan tranzicionin tregon se ndryshimi deklarativ i sistemit rezultoi se ishte shumë më i lehtë sesa ndryshimi përmbajtësor i tij. Kjo shfaqet kryesisht në mentalitetin dhe vizionin e elitave të viteve ’90-’92, të cilat shtruan shinat për tranzicionin dhe sistemin që edhe aktualisht po qeveris vendin. Në dallim nga sjellja e elitave të reja në mazhorancën dhe opozitën e parë politike prej vitit 1923, gjatë ditëve të Lëvizjes Studentore pati më shumë solidaritet, kurajë dhe sprovë mbështetëse për shtresat “armike”, siç cilësoheshin figurat më të njohura të ekzekutuara, burgosura, censuruara apo denigruara gjatë regjimit komunist. Por pas jetësimit të pluralizmit studentët nuk ishin më forcë drejtuese dhe se agjendat politike ndoqën rrjedha të tjera më pragmatiste.

Për rrjedhojë, të burgosurit e fundit politikë të periudhës komuniste u liruan nga burgjet vetëm në javën e dytë dhe të tretë të marsit 1991, pak ditë para zgjedhjeve të para politike; nga 11 partitë politike më të rëndësishme të krijuara më 1991-1992 asnjë prej tyre nuk drejtohej nga ish të burgosur politikë. Në parlamentin e ri pluralist arritën të përfaqësoheshin 4% ish të përndjekur politikë ndaj 11% të ish anëtarëve apo kandidatëve të Komitetit Qendror të PPSH. Rreth 65 ditë pas zgjedhjeve të para partitë politike komuniste dhe antikomuniste ranë dakord të krijojnë një qeveri të përbashkët koalicioni, e cila drejtoi vendin deri në dhjetor 1991 për t’i lënë vendin një qeverie tjetër konsensuale teknike deri në rotacionin politik të marsit 1992.

### ***Shqipëria dhe vendet e tjera: raporti mbi të kaluarën***

Kurba politike drejt rotacionit politik dhe qëndrimi i elitave të sistemit të ri ndaj të kaluarës komuniste e viktimave politike të saj, janë një matës i mirë dhe dallues midis përvojave ndër vendet ish komuniste të Bllokut Socialist. Në Shqipëri e Bullgari, Partitë Komuniste fituan në shumicë absolute zgjedhjet e para shumëpartiake, duke vonuar 1 deri në 2 vjet rotacionin politik. Në Çekosllovakia, Poloni dhe sidomos në Hungari, ndryshimi i sistemit erdhi përmes

---

<sup>7</sup> “Sali Berisha” në: *Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të*, Viti 1991, nr. 4, 30.09.1991, f. 1715.

bisedimeve dhe marrëveshjeve politike, duke mundësuar zëvendësimin e elitave drejtuese në mirëbesim ose përmes standardeve më të larta. Në Rumani ndryshimi erdhi në formë më të dhunshme, duke qenë vendi i vetëm që ekzekutoi diktatorin komunist, kurse në republikat baltike procesi i ndryshimeve kishte dallime thelbësore me proceset e njëjta në vende si Shqipëria. Midis shteteve në Jugosllavi, procesi i pavarësisë dhe ndryshimeve politike ndodhi në forma unike në raport me modelet e tjera referuese, të motivuar nga faktorë të tjerë dhe të drejtuar nga elita me agjenda të tjera politike.

Kjo shumëllojshmëri formash dhe praktikash të zbatuara në realizimin e ndryshimit të sistemit politik në vendet e Evropës Lindore pati rol përcaktues edhe në krijimin e modeleve të sjelljes institucionale dhe publike ndaj të kaluarës. Praktika e ndryshimit në Gjermaninë Lindore dhe administrimi tërësor i shpejtë dhe produktiv i procesit të tranzicionit drejt ribashkimit gjerman, përbën rast përjashtimor dhe nuk ka ngjashmëri me asnjë prej praktikave të tjera në ish- vendet e Bllokut Socialist. Për rrjedhojë, referimi në praktikën gjermane, edhe për shoqëri si Shqipëria, shpeshherë është i sforcuar dhe nuk merr në konsideratë dallimet esenciale në traditë, mjete, mentalitet, kulturë dhe as potencialin e shtetit të ish Gjermanisë Perëndimore.

Cili mund të jetë modeli më i mirë referues? Ka një numër studimesh që mbrojnë tezën se proceset politike dhe sjellja e institucioneve përcaktohet kryesisht nga specifikat e secilit vend. E njëjta tezë vlen edhe në analizën e trajtimit të së kaluarës. Pas viteve '50 dhe në vijim Shqipëria nuk pati klasë dhe as grupe klasike të disidencës së organizuar politike, grupe liberale që promovuan ide dhe i mbrojtën ato, nuk pati grupe sindikaliste dhe as ndikim të diasporës në jetën e brendshme politike, ndërpreu komunikimin e plotë me Perëndimin dhe më pas edhe me Lindjen dhe ndaloi besimin në Zot duke eliminuar ndikimin në shoqëri të komuniteteve fetare. Për krahasim, kur Shqipëria ndaloi me Kushtetutë besimin në Zot një prift polak, Papa Gjon Pali II, u bë kreu i Kishës Katolike; në kulmin e vetizolimit të Shqipërisë diktatorë të tjerë komunistë si Çaushesku, bënë vizita zyrtare dhe morën dekorata të larta nga vende si: Britania e Madhe, Italia, Gjermania, Austria etj. Në të njëjtat vite edhe udhëheqësi bullgar Zhivkov mori dekoratë të lartë nga vende si Portugalia; gjeneral Jaruzelski në Poloni mori dekorime të larta nga vende si Italia, Franca, Belgjika, Portugalia etj. Një pjesë e madhe e tyre u anuluan vetëm pas 1989-ës, por kjo është një e dhënë me rëndësi për të kuptuar diferencën midis diktaturës izolatore dhe antiperëndimore në Shqipëri dhe modelit rumun, si një prej modeleve më të skajshme të Evropës Lindore.

Dallim tjetër thelbësor është raporti i vendeve me “armikun”, “pushtuesin” dhe ndjenja e çlirimit në fazën e ndryshimit të sistemit. Vende si Estonia, Letonia, Polonia, Hungaria,

Çekosllovakia etj., e përjetuan ndarjen me sistemin e kaluar edhe si ndarje me dominimin sovjetik, prania e dhunshme e të cilëve mori nota tragjike më 1956 në Hungari dhe 1968 në Çekosllovakia. Vende si Kroacia, Sllovenia etj., e përjetuan ndarjen nga sistemi i kaluar si ndarje nga projekti i imponuar i Jugosllavisë Federative dhe shpallje të pavarësisë, kurse në vende si Shqipëria ndjesitë ishin më specifike, u bë ndarje e një pjese të popullsisë me pjesën tjetër, e cila në shumicë ose pakicë, pati sunduar me dorë të hekurt për 46 vjet. Duke qenë ndarje brenda vetes, nuk mund të kishte revolucion dhe as ndryshime radikale dhe se nuk mund të kishte receta të gatshme të huazuara nga pjesa tjetër e kontinentit. Një rast më analog, Rumania e Bullgaria, mund të shërbenin si pika referimi në disa aspekte, por edhe atje, sukcesi i Ion Ilieskut ishte sukcesi i një zyrtari të lartë, por të pakënaqur brenda vetë regjimit.

Në nivel krahasues midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera, rezulton se në vitin e parë të ndryshimit të sistemeve politike (1989-1991) pothuajse të gjitha vendet ndoqën praktika të njëjta politike dhe ligjore për trajtimin e të kaluarës dhe viktimave politike të tij. Secili vend miratoi forma të ndryshme amnistie kolektive ose për grupe të caktuara, duke i dhënë fund praktikave të diferencimit zyrtar. Në vende si ish Republikat Sovjetiko-Baltike, procesi i amnistisë është më i hershëm dhe ndodhi përpara se të ndryshonte regjimi politik, kurse në vende si Shqipëria procesi ndodhi gati një vit pas ndryshimit të sistemit politik.

Vendimi për amnistitë kolektive lidhet me veçoritë e memories ndaj të kaluarës dhe rrethanat specifike politike në secilin vend. Në vendet baltike burimi kryesor i dënimeve politike ishte Moska dhe qëndrimet “pro” apo “kundër” politikave të saj, në vendet e Evropës Qendrore burim kryesor ishin grupet liberale dhe disidente, përfshirë edhe grupe civile e fetare, në ish Jugosllavi burim kryesor ishin grupet nacionaliste, liberale dhe fetare, kurse në vende si Shqipëria gjendeshin kategori të shumta, përfshirë edhe një pjesë e madhe e ish elitës komuniste përpara viteve '60 -'80.

Në procesin e amnistisë debati ishte kompleks: parlamentarët diskutuan mbi kategoritë përfituese duke pasur vija të dukshme ndarjeje për ngjarjet politike të Luftës së Dytë Botërore, mbi konceptin e amnistisë kolektive dhe të drejtës së parlamentit për ta jetësuar atë, mbi efektet juridike dhe sociale të amnistisë, mbi raportimin midis pritshmërive të vetë viktimave të regjimit komunist dhe kapaciteteve të shtetit për t'iu përgjigjur, mbi të drejtat sociale midis viktimave dhe pjesës tjetër të popullsisë, mbi kategoritë e atyre që shkaktuan viktima dhe që trajtoheshin me ligje të tjera të veçanta, si dhe mbi specifika të tjera që lidhen me kontekstin politik, juridik e social shqiptar. Ajo që bie dukshëm në sy në debatin parlamentar të vitit 1991 asnjë palë ose asnjë folës politik nuk referon ndonjë praktikë të njëjtë me vendet e tjera ish komuniste, një tregues i mungesës së informacionit mbi praktikat e mira dhe problematikat e

lindura në vendet e tjera ish komuniste. Në debatet e tjera parlamentare, si më 1993, 1997, 2004, 2007, 2014 etj., deputetët i janë referuar gjithnjë e më shumë praktikave të ndjekura në vendet e tjera të ish Bllokut Lindor, cilësi që ka ndikuar në zhvillimin e debateve më cilësore sesa atij të vitit 1991.

Pas amnistisë dhe procesit të rehabilitimit politik dhe social, të gjitha vendet ish komuniste kaluan edhe fazën e nismave ligjore të lustracionit. Procesi i lustracionit, natyra dhe bilanci i tij ndryshon nga vendi në vend, në varësi nga specifikat, periudhës, forcave politike në pushtet dhe pranimi të tij si normë demokratike në kuadër të pajtimit dhe ndërtimit të sistemit të ri. Tipar i procesit të lustracionit në Shqipëri është distanca midis produktit ligjor parlamentar dhe normave kushtetuese dhe për rrjedhojë, anulimi i ligjeve përmes vendimeve të Gjykatave Kushtetuese. Një analizë e detajuar e procesit dhe e legjislacionit shqiptar mbi ndarjen me të kaluarën përmes lustracionit, nuk përcakton apriori përgjegjësi tek organet vendimmarrëse ligjore, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, sa gjen përgjegjësi tek mënyra sesi elitat politike u sollën me të kaluarën dhe sesi e përdorën atë në varësi nga nevojat politike dhe elektorale.

### ***Reagimi shtetëror si përgjigje dhe paradokset në reagime***

Një lexim i detajuar i bazës ligjore dhe akteve politike të qeverisë, parlamentit, Presidentit, institucioneve dhe funksionarëve të tjerë të lartë publikë që kanë rol direkt ose indirekt me ish të përndjekurit politikë, nxjerr në pah tri të dhëna interesante.

*Tipari i parë*, të gjitha ndërhyrjet kanë ndodhur në kohë krizash, kryesisht pas grevave e protestave të vetë ish të përndjekurve politikë. Më 1991 në ditët e debatit parlamentar për amnistinë dhe ligjin për rehabilitimin, grupe ish të përndjekurish politikë ndodheshin në grevë urie, e dhënë kjo që del vazhdimisht në debatin parlamentar si tregues nxitës për një vendimmarrje të shpejtë dhe sa më konsensuale. Në mesin e viteve '90 pati një grevë tjetër urie të ish të përndjekurve politikë që çoi në korrektimin e akteve të ekzekutivit për trajtimin e tyre. Më 2004 përsëri pati protesta dhe greva të veçuara të ish të përndjekurve politikë që korrespondojnë me ndryshimet në bazën ligjore mbi trajtimin dhe rehabilitimin e tyre, ndërkohë që në prag të rotacionit politik 2013 pati një tjetër grevë urie nga ish të përndjekurit politikë, me një rast tragjik vetësakrifice, që motivoi politikanët të rishohin skemat e trajtimit financiar dhe social dhe të bëjnë ndërhyrje të reja ligjore. Në tërësi, gjatë 28 viteve tranzicion nuk ka pasur grup tjetër social me numër më të lartë grevash, protestash dhe reagimesh publike në mbrojtje të të drejtave të mohuara kushtetuese sesa grupimet nga komuniteti i ish të përndjekurve politikë. Pavarësisht se të ndarë në disa shoqata dhe grupime, në tërësi kërkesat e



tyre kanë qenë të njëjta dhe kanë qenë e janë brenda kuadrit kushtetues dhe detyrimeve ndërkombëtare mbi Shqipërinë.

*Tipari i dytë* është fakti se Shqipëria nuk ka arritur ende të ketë një strategji kombëtare trajtimi në të gjitha aspektet që lidhen me të kaluarën dhe ish të burgosurit apo ish të përndjekurit politikë. Për pasojë, çdo qeveri ka deklaruar prioritete afatshkurta, të cilat jo vetëm nuk janë përmbushur në nivelin e premtimeve, por edhe kanë krijuar shkëputje në varësi nga natyra e qeverive dhe ecurisë politike të vendit. Nisma më e rëndësishme ligjore, ajo e vitit 1991 për amnistinë dhe paketën e rehabilitimit, plotësuar më 1993, nuk u shoqërua me faturë financiare dhe as me marrëveshje politike afatgjatë. Për më tepër, ndryshimet e vazhdueshme të strukturës së qeverisë dhe të kompetencës funksionale të organeve që mbulojnë këto kategori, krijuan vonesa, mbivendosje dhe një rrjet burokratik periodik me kosto të reja shtesë për qytetarët e interesuar.

*Tipari i tretë* lidhet me paaftësinë politike dhe juridike të klasës politike dhe institucioneve për të përcaktuar që në fillim kategoritë në trajtim dhe nënkategoritë sipas natyrës së persekutimit: të burgosurit, të zhdukurit, të ekzekutuarit, të internuarit, ata që u detyruan të punonin pa pagesë, ata që u diskriminuan për shkak të statusit politik në aktivitetin e tyre profesional etj. Për pasojë, një sërë ndërhyrjesh ligjore plotësuese për kategori të caktuara brenda komunitetit të ish të përndjekurve politikë, vetëm sa e vonuan dhe e komplikuan procesin tërësor të amnistisë, rehabilitimit dhe të integritimit. Së fundi, edhe më 2018, Kuvendi ndërhyri në ligj për një kategori të vogël të ish të përndjekurish politikë, duke përcaktuar se *“koha e vuajtjes së dënimit të ish të dënuarve politikë në burgjet ku punohej në minierë në nëntokë, për efekt pensioni, njihet si punë e kryer në minierë në nëntokë. Periudha njihet sa dyfishi i periudhës së qëndrimit në këto burgje. Paga llogaritet sa paga e punës në minierë në nëntokë, sipas legjislacionit përkatës. Vërtetimi për kohën e vuajtjes së dënimit në burgjet ku punohej në minierë në nëntokë lëshohet nga Ministria e Brendshme, pas konfirmimit nga Ministria e Drejtësisë”*<sup>8</sup>. Në ndërhyrjen e fundit përfshiheshin vetëm 264 persona, me koston totale financiare 4 milionë lekë/muaj nga buxheti i shtetit.

*Tipari i katërt* lidhet me raportet e brishta të shtetit shqiptar ndaj detyrimeve të brendshme kushtetuese dhe me detyrimet ndërkombëtare. Një sërë aktesh ndërkombëtare u ratifikuan pa u shoqëruar me akte administrative në vijim të tyre dhe pa gjetur zbatim në nivelet e angazhimit. Në Shqipëri ka pasur disa ndërhyrje nga Gjykata Kushtetuese për të vendosur norma dhe praktika pune më realiste dhe më funksionale në lidhje me trajtimin social, ekonomik

---

<sup>8</sup> “Ligj nr. 24/2018 Për një shtesë në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, “për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, 17.05.2018” në: *Fletore Zyrtare*.

e shtetëror të kësaj kategorie, ndërkohë që Shqipëria ka humbur disa procese në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me problematikat e pronësisë apo të drejta të tjera të cenuara.

Pothuajse të gjitha vendet ish komuniste aplikuan amnisti të përshkallëzuara midis viteve 1988-1989, kurse Shqipëria më 1990. Vendet baltike ishin më të avancuara në përfshirjen e kategorive të amnistisë ndaj ish të përndjekurve politikë, kurse vendet e tjera aplikuan forma të diferencuara. Procesi ndodhi në kuadër të ndryshimeve politike pas ardhjes së Gorbaçov-it në BRSS, si dhe presionit në rritje të grupeve të ndryshme qytetare brenda vendit ose presionit të jashtëm. Vende si Rumania (1988) dhe Shqipëria (1990) reduktuan ndjeshëm numrin e veprave penale me dënime afatgjata, si dhe amnistuan një numër të madh krimesh të parashikuara deri në 5-10 vjet burgim. Në Rumani dënimet me vdekje u reduktuan në 10 vjet burgim<sup>9</sup>, kurse në Shqipëri dënimi maksimal i tradhtisë për ikjen nga vendi u reduktua në dënim disavjeçar për kalim të paligjshëm të kufirit.

Procesi i reagimit të paplanifikuar të qeverive dhe legjislatrave parlamentare, dhe për pasojë, i reagimit nën presion nga protestat apo grevat e urisë, u shoqërua edhe me paradokse thelbësore në klimën politike dhe institucioneve të reagimeve. Për shembull, në momentin kur më 1991 u zhvillua debati mbi amnistinë e ish të përndjekurve politikë ende në burgjet shqiptare kishte të burgosur politikë. Sipas referimit të ministrit të Drejtësisë në debatin parlamentar të gushtit dhe shtatorit të vitit 1991, të burgosurit e fundit politikë ishin në tri kategori: disa të mbetur nga periudha e mëparshme për shkak të dënimeve të mëdha, disa nga të dënuarit në shkelje të dekretit të janarit 1991 lidhur me mbrojtjen e emrit dhe përmendoreve të diktatorit Hoxha dhe një kategori e tretë e individëve të dënuar për akte të veçuara politike, kryesisht ndaj figurave politike të regjimit, përfshirë edhe të dënuar gjatë vitit 1991.

Nuk ka të dhëna të detajuara specifike, por në debatin parlamentar të gushtit 1991 flitet për rreth 1000 persona që ndodheshin ende në burgje shumica e tyre me sfond politik, për të cilët kërkohet lirim përmes një amnistie kolektive. Midis tyre në burgje ndodheshin edhe disa prej protestuesve antikomunistë të janarit 1990 në Shkodër, të periudhës së ngjarjeve në ambasada 1990, të kalimit të kufirit shtetëror përpara dhjetorit 1990, të protestave të shkurtit 1991 dhe të ngjarjeve të tjera më të vogla me karakter politik. Deputetët dhe vetë ministri i Drejtësisë pranonin në gusht 1991 se amnistia do të përfshinte *“edhe për persona që janë duke vuajtur dënimin për vepra penale, të cilat, ndonëse nuk përfshihen në kapitullin e krimeve kundër shtetit, janë të karakterit politik, për shkak të motiveve të kryerjes së tyre, si të dënuarit*

---

<sup>9</sup> Raluca Grosescu, “Transitional criminal justice in post-communist Romania”, in: *Crimes of the Communist Regimes*, Czech Republic 2010, p. 333.

*për shpifje dhe fyerje kundër organeve më të larta të shtetit e të partisë, për shkelje të dispozitave të dekretit “Për respektimin dhe mbrojtjen e monumenteve që lidhen me historinë kombëtare dhe të simboleve shtetërore”, si dhe të dekretit “Për mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve në vendet publike”<sup>10</sup>.*

Ky paradoks i madh shqiptar nuk gjendet në vendet e tjera ish komuniste, me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë të drejtimit autoritar ose në raste specifike si ai i Kosovës nën administrimin jugosllav e serb. Ekzistenca e të burgosurve politikë edhe në gusht - shtator 1991 në një vend me përkatësisht 9 dhe 10 muaj sistem pluralist demokratik dhe me Kushtetutë të re, është e pajustificuar në aspektin politik dhe institucional. Ajo është një dëshmi më shumë e paqartësisë së elitës së re politike për të përshtatur mekanizmat dhe frymën e sistemit të ri politik me akte konkrete institucionale, ligjore dhe administrative, si dhe e koncepteve minimale demokratike në formimin e tyre.

### ***Paqartësia në bilancin e viktimave humane - si tregues anormaliteti***

Një dallim tjetër i rëndësishëm midis përvojës shqiptare dhe të vendeve të tjera ish komuniste është ecuria e procesit të krijimit të database njerëzore mbi viktimat politike të regjimit komunist. Në kërkimin arkivor në vendet e tjera rrallë gjenden tregues kritikë mbi të dhënat zyrtare, dhe në tërësi raste të tilla specifike lidhen me procesin e internimeve apo zhdukjeve në vende të tjera, kryesisht në ish zonat e Bashkimit Sovjetik. Në Shqipëri nuk ka pasur praktika të tilla deportimi në drejtim të shteteve të tjera, ndaj edhe mundësitë tona për të saktësuar database me të dhëna duhej të ishin reale.

Ka pasur disa përpjekje serioze, përfshirë edhe nisma për botimin e të dhënave enciklopedike mbi emrat e viktimave të regjimit komunist, por procesi është ende në vijim, dhe metodika kërkimore lë hapësirë për interpretime kritike. Në këto rrethana mund të thuhet se 28 vjet nga rënia e sistemit komunist, Shqipëria mbetet një nga shtetet e vetme, ku ende nuk ka të dhëna zyrtare referuar numrit të ish të përndjekurve politikë gjatë sistemit komunist dhe viktimave politike të tij. Për pasojë, pas çdo debati politik dhe institucional mbi këtë komunitet, trajtimin dhe problematikat e integritetit të tyre, burimi referues, shifrat, janë objekt dyshimi dhe kontestimi.

Referuar të dhënave të vetë institucioneve zyrtare, ato janë dukshëm kontradiktore. Për ilustrim, të dhënat e dy institucioneve kryesore shtetërore që trajtojnë këtë periudhë, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKPK) dhe Institutit të Integritetit për ish

---

<sup>10</sup> “Shefqet Muçi” në: *Punime të Kuvendit Legjislativa e 12-të*, Viti 1991, nr. 4, f. 1540.

të Dënuarit e të Përndjekurve Politikë (IIDPP), kanë diferenca të mëdha. Sipas ISKPK numri i qytetarëve të burgosur politikë ka qenë 34 135<sup>11</sup>, kurse sipas IIDPP numri i të burgosurve politikë ka qenë 14 563 ose mbi 19 mijë më pak<sup>12</sup>. Diferencat e mëdha në deklaramë nga dy institucionet, të cilat janë në varësi përkatësisht nga parlamenti dhe qeveria, janë tregues i hendekut të madh lidhur me krijimin e database efektive mbi viktimat e regjimit komunist në Shqipëri.

Në politikë ka pasur dy debate të mëdha lidhur me numrin e ish të burgosurve politikë, numrit të personave të ekzekutuar apo atyre të zhdukur, fillimisht më 1991 dhe më pas më 2004. Më 1991 debati ishte më shumë politik sesa teknik dhe lidhet edhe me klimën e përgjithshme ku ndodhej vendi, si dhe me pamundësinë reale të qeverisë dhe sidomos të aktorëve politikë, për të pasur të dhëna të detajuara. Më 2004 është një periudhë tjetër pas 13 vjet tranzicion, gjatë të cilave shteti ka pasur të gjithë mekanizmat në dispozicion për të evidentuar dokumentacionin arkivor dhe të dhënat mbi numrin e viktimave politike të regjimit komunist.

Gjatë debatit parlamentar të gusht-shtatorit 1991 deputetët cituan shifra të ndryshme të ish të përndjekurve politikë. Më shumë se shifrat, debati lidhej edhe me kategorinë e cilësuar me statusin e ish të përndjekurve politikë, ku shumica absolute e parlamentit, përfshirë mazhorancën ish komuniste dhe një pjesë të opozitës së re, ishin kritike e përjashtuese ndaj fatit tragjik të individëve që kishin milituar në grupet nacionaliste në Luftën e Dytë Botërore apo mbështetësit e ish Mbretit Zog. E vetmja shifër e cituar në debat është ajo e ministrit të Drejtësisë në Qeverinë e Stabilitetit, Shefqet Muçi, i cili në paraqitjen e projektligjit “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, tha se nuk ka të dhëna të sakta, por midis periudhës 1951-1990 janë evidentuar rreth 8500 persona të burgosur politikë<sup>13</sup>. Opozita e kontestoi deklaratën, me argumentin kryesor se periudha 1944-1951 ka qenë edhe periudha më e ashpër e vrasjeve dhe dënimeve politike, ndaj numri real duhet të jetë shumëfish më i lartë. Parlamenti ngarkoi qeverinë të bëjë evidentimin e saktë të të dhënave, përgjegjësi që nuk u përmbush asnjëherë, nga asnjë prej qeverive prej vitit 1991 e në vijim.

Më 2004, Ministria e Drejtësisë informoi Kuvendin<sup>14</sup> se ka identifikuar 9870 persona si ish të përndjekur politikë. Në të njëjtën seancë citohet se “*Instituti i Integritit të përndjekurve politikë, është një institucion shtetëror dhe shifrën e ka sjellë krejtësisht të ndryshme, 17 650*

---

<sup>11</sup> ISKPK (2016). Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Raport, 2016.

<sup>12</sup> IIDPP (2018). Institutit të Integritit... <http://ishperndjekurit.gov.al/al/statistika/> (parë më 14.10.2018).

<sup>13</sup> “Shefqet Muçi” ..., f. 1544.

<sup>14</sup> “Arben Malaj” në: *Punime të Kuvendit Legjislativa e 16-të*, Viti 2004, nr. 6, f. 1728.

persona<sup>15</sup>”. Edhe lidhur me të pushkatuarit, ministri i Financave (2004) raportoi se ka mospërputhje të mëdha, pasi “*shoqatat, Instituti, jep një shifër që është rreth 6 403 persona, arshiva e Ministrisë së Drejtësisë jep një shifër që është rreth 607 persona*”<sup>16</sup>. Dy vjet më parë, më 2002, Këshilli i Ministrave pati deklaruar një shifër gati të njëjtë të personave të pushkatuar, rreth 6 333 dhe shifër shumë më të lartë të personave ish të dënuar politikë, rreth 70 720 individë. Në gusht 2003, ministri i Shtetit në atë kohë, Blendi Klosi, raportoi në Kuvend se në Shqipëri kanë qenë të pushkatuar 6 313 veta dhe të burgosur 23 000 vetë<sup>17</sup>. Po ashtu, në vlerësimin e Komisionit të Venecias (2004) referohet numri i 6 300 personave të vdekur në burgje, si dhe 10 750 persona të dënuar ose përndjekur politikë<sup>18</sup>, si kontingjent që do të trajtohet në procesin e kompensimit financiar.

Hapja e arkivave jep të dhëna, të cilat edhe gjatë pjesës më të madhe të viteve të tranzicionit kanë qenë të panjohura. Për shembull, në një raportim në Byronë Politike në nëntor 1990, vetëm një muaj përpara lejimit të pluralizmit politik, ministri i Punëve të Brendshme deklaronte se deri më 1990 numri i të arratisurve politikë ishte 9 220 persona<sup>19</sup>. Po ashtu, në llogari janë edhe rreth 5 mijë persona që emigruan në kuadër të ngjarjeve në ambasadat perëndimore në Tiranë. Më 2016, një auditim i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit flet për 14563 të burgosur politikë, 5 548 të pushkatuar, 987 të vdekur në burg, dhe 21 401 të internuar<sup>20</sup>.

Shifra të ndryshme gjenden edhe në botime studimore individuale apo të promovuara nga institucione shtetërore e publike, duke e komplikuar akoma më shumë krijimin e një baze të qëndrueshme reference. Gjatë viteve të fundit institucionet janë përpjekur të evitojnë citimin e shifrave dhe të flasin vetëm për numër dosjesh të përpunuara ose të aplikuara, ndërkohë që të dhënat e dy instituteve dhe të grupeve joqeveritare që merren me ish të përndjekurit politikë vijojnë të kenë diferenca të dukshme në deklaramë. Të ndara në kategori, përfshirë edhe kategorinë e atyre që kanë kryer punë të detyruara dhe që janë shfrytëzuar fizikisht nga regjimi, të dhënat janë edhe më konfuze nga institucionet, burimet publike dhe dokumentacioni arkivor në dispozicion.

---

<sup>15</sup> “Ekrem Spahia”, në: *Punime të Kuvendit Legjislativa e 16-të*, Viti 2004, nr. 6, f. 1724.

<sup>16</sup> “Arben Malaj”, në: *Punime të Kuvendit Legjislativa e 16-të*, Viti 2004, nr. 6, f. 1729.

<sup>17</sup> “Ekrem Spahia” në: *Punime të Kuvendit Legjislativa e 16-të*, Viti 2004, nr. 6, f. 1750.

<sup>18</sup> Peter Paczolay, “Comments on the amendments to the law of the Republic of Albania on the status of politically ex-convicted and prosecuted people by the communist regime”, në: *Venice Commission, Opinion no. 298/2004*.

<sup>19</sup> *AQSH*, F.14/AP, V. 1990, D. ??, f. 35. Raport i Hekuran Isait paraqitur në Byronë Politike, 20 nëntor 1990.

<sup>20</sup> Kontrolli i Lartë i Shtetit (më tej: KLSH), *Raport Auditimi i Performancës "Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit"*, Tiranë: 2016.

Përgjegjësia kryesore për krijimin e database të saktë është shtetërore. Organizatat e ndryshme civile nuk kanë burimet dhe as mekanizmat e mundshme për realizimin e një misioni të tillë, ndërkohë që shteti, përmes të dhënave të dokumentuara, mekanizmave verifikues, buxhetit dhe personelit në dispozicion, ka të gjitha mundësitë të ketë database të saktë dhe lidhur me të, edhe një strategji reale mbi trajtimin e të gjithë ish të përndjekurve politikë. Pa këtë database shifrat për kompensime, trajtime sociale, ato për ligjërim politik kontestues apo mbështetës, si dhe analizat krahasimore me vendet e tjera, mbeten relative.

### ***Trajtimi i paplotë mbi punën e detyruar***

Kampet e punës së detyruar në vendet ish komuniste ishin të shumta, por referuar në numër kampesh për numër popullsie, Shqipëria rezulton afër kreut të listës. Konkretisht, midis 1948-1954 Hungaria kishte 199 kampe, Çekosllovakia 124, Bullgaria 99, Rumania 97, Polonia 47 dhe Shqipëria mbi 20. Trajtimi i personave të përfshirë në kampet e punës së detyruar u bë jetike për vendet pas periudhës së ndryshimit të sistemit, por ishte edhe normë e pranuar ndërkombëtare. Shqipëria ishte e vonuar në ratifikimin e akteve ndërkombëtare, gjë që reflektoi edhe vonesa e pengesa për një legjislacion koherent dhe ndërhyrje në kohë për zbatimin e tij.

Në hyrje të ligjit 7541, datë 30.09.1991 *“Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”*, duke pranuar se *“gjatë 45 vjetëve, shumë qytetarë shqiptarë janë akuzuar, gjykuar, dënuar dhe burgosur, internuar apo përndjekur për shkelje të natyrës politike, duke dhunuar të drejtat e tyre civile, sociale, morale dhe ekonomike”* deklarohet angazhimi konsensual të krijohet *“një sistem juridik i drejtë e i ndershëm, që të përputhet plotësisht me ligjet dhe rregullat që mbrojnë të drejtat bazë njerëzore”*. Më tej, duke deklaruar ndjesën publike, faljen dhe angazhimin për rehabilitimin dhe rikthimin e drejtësisë, thuhet *“Qeveria do të marrë të gjitha masat që të kompensojë dhe rehabilitojë të gjithë personat që janë akuzuar padrejtësisht për shkelje për të cilat bën fjalë ky ligj dhe të sigurojë për ta, me përparësi, ndihmën materiale dhe morale për t’u riintegruar plotësisht në shoqëri”*.

Në nenin 5 të ligjit ka referime të drejtpërdrejta për ish të burgosurit politikë në kampet e punës, duke përcaktuar detyrimin për dëmshpërblimin, përfitimin e shtesave në pension, trajtimin e fëmijëve, dhe elementë të tjerë socialë rehabilitues. Por pas çdo dispozite të ligjit ka referime të tilla si *“në përputhje me kriteret ndërkombëtare”* apo *“aktet e Këshillit të Ministrave”*. Në thelb janë dy standarde gati paralele, pa përputhje me njëra-tjetrën. Aktet ndërkombëtare janë më statike dhe përfshirëse, janë detyruese dhe mbështeten në konceptet e kompensimit pozitiv, kurse aktet e Këshillit të Ministrave janë akte në ndryshim, në varësi nga kapaciteti financiar, prioriteti publik, mbështetur në konceptin e kompensimit relativ.

Në formën sesi u formatua legjislati shqiptar fillestar dhe nisi praktika e trajtimit të punës së detyruar, procesi i rehabilitimit dhe më pas integrimi social, ka dallime të dukshme me shumicën e modeleve të vendeve të tjera të ish Bllokut Socialist. Puna e detyruar ishte një prej dënimeve “paketë” që regjimi ndoqi ndaj të arrestuarve dhe të dënuarve politikë. Puna e detyruar nuk lidhej me ushtrimin e profesionit dhe as me mundësinë e përzgjedhjes vullnetare dhe kontratën e punës me efekt të ardhurash e pensioni, por një formë shfrytëzimi shtetëror ndaj atyre që shteti i konsideronte kontingjente armike e kundërshtarë të tij. Praktikën e punës së detyruar morën përpjesëtime të mëdha sidomos në periudhën e parë pas vendosjes së sistemit komunist. Tashmë është e pranuar zyrtarisht një listë e gjatë me objekte të rëndësishme publike, të ndërtuara me punë të detyruar nga ish të përndjekurit politikë dhe familjarët e tyre.

Aktiviteti i detyruar fizik, puna e detyruar në burg apo kampe, praktikën e imponuara të punës në miniera apo në fronte të tjera të vështira prodhimi dhe aktiviteti social, në rastin shqiptar paraqet dy veçori: *e para*, puna e detyruar është konsideruar gjerësisht si aktivitet normal mbijetese dhe bindjeje, jo vetëm për të burgosurit politikë, por edhe për një pjesë të madhe të qytetarëve; *e dyta*, ka vështirësi në përcaktimin e hapësirës dhe statusit të punës së detyruar dhe modeleve të tjerë të skllavërisë të aplikuara gjatë regjimit komunist. Në konceptin e sotëm të vlerësimit, periudha më dominuese për punë të detyruar kolektive për të gjithë të burgosurit politikë dhe familjarëve të tyre mbetet periudha deri në mesin e viteve '50. Më pas ka pasur ndryshime në sistemin e punës së detyruar, megjithëse për pjesën më të madhe të të burgosurve kjo vijoi në forma të tjera edhe shumë vite më pas.

Ka pasur dëshmi të shumta të të dënuarve politikë, të cilët refuzonin punën e detyruar apo protestonin ndaj kushteve mjerane e të rrezikshme të punës. Midis tyre ka pasur edhe individë, të cilët duke e pranuar se janë të dënuar për akte politike dhe agjitacion, kanë refuzuar urdhrat për punë të detyruar si formë tjetër dënimi, duke u ndeshur më pas me dënime të tjera shtesë për kundërshtim apo sabotim të urdhrave dhe praktikave vendimmarrëse të regjimit. Vetëm falë këtyre dëshmive dhe një numri të kufizuar të dokumenteve arkivore në korrespondencën midis institucioneve të burgjeve dhe instancave më të larta, mund të provohet edhe zyrtarisht se të burgosurit politikë trajtoheshin në mënyrë të dhunshme dhe shfrytëzoheshin në forma maksimale jashtë klauzolave ligjore që përcaktonte Kushtetuta, ligji apo aktet administrative zyrtare. Në dallim nga vende të tjera ish komuniste në Shqipëri nuk ka pasur debat edhe për një kategori të veçantë individësh, kryesisht intelektualë të dënuar, të cilët gjatë viteve të burgut ose në mbikëqyrje jashtë tij, janë detyruar të përkthejnë pa autorësi literaturë të panumërt ose të krijojnë produkte letrare e artistike për regjimin, pa marrë si shkëmbim as të drejtën e autorësisë dhe as shpërblimin ligjor financiar.

### ***Debati i (pa)përfunduar mbi standardet***

Kushtetuta e RSH (1998) në nenin 44 thekson *“kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”*. Një numër aktesh ndërkombëtare që Shqipëria ka nënshkruar plotësojnë parimin e zhdëmtimit për shkak të vendimmarrjeve të gabuara shtetërore.

Në fillimet e tranzicionit ka pasur diskutime të shumta edhe mbi referimet ligjore përpara dhe pas 1990. Sipas kritikëve të procesit të rehabilitimit kolektiv të ish të përndjekurve politikë shteti komunist ka vepruar me ligje dhe përderisa ka pasur shkelje ligjore, nuk mund të ketë kompensim për dëmin e shkaktuar. Një arsyetim i tillë u përmend edhe në debatin parlamentar të vitit 1991 mbi amnistinë. Vetë Kodi Penal i RPSSH përmbante dispozita ligjëruese për punën e detyruar<sup>21</sup>. Sipas nenit 20 aplikohet parimi penal i *“riedukimit nëpërmjet punës”*, gjatë të cilës individ i paguhej deri në 75% të punës, puna e kryer nuk llogaritej si kohë pune për efekt pensioni, refuzohej çdo shtesë apo përfitim tjetër financiar etj. Kodi detyronte çdo individ të ishte i angazhuar në punë, duke cituar parazitizmin në punë si krim që dënohet me riedukim të detyruar përmes punës ose me burg deri në dy vjet. Në përgjigje të këtyre neneve dhe argumentit kritik, Gjykata Kushtetuese i dha fund debatit, kur më 2005 në një vendim të saj, shpalli se *“dëmshtëpërblimi dhe kompensimi i të burgosurve dhe të përndjekurve politikë për dëmin personal, për vuajtjet apo për punën e papaguar të tyre gjatë regjimit të kaluar, nuk mund të bazohen në kuadrin ligjor të periudhës së para tranzicionit”* duke e konsideruar atë si kuadër ligjor antidemokratik dhe antinjerëzor<sup>22</sup>.

Debati tjetër paralel lidhej me standardet e trajtimit të ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politikë në kushtet e sistemit të ri politik. Në debatin parlamentar 1991, pavarësisht konsensusit për amnistinë dhe qëndrimet politike mbi nevojën e rehabilitimit dhe integritimit, midis palëve politike dhe midis edhe deputetëve të së njëjtës parti kishte qëndrime të ndryshme lidhur me standardet e trajtimit financiar. Një shembull tipik është diskutimi i një deputeti, sipas të cilit *“mos vallë ndonjë bir i ish-beut të djeshëm, i ish-pronarit të djeshëm kërkon tapitë e babait, fabrikën ose vlerën e fabrikës së babait?... para se të votoj, dua të di .. a do ta marrë ai ... mallin, ashtu dhe për tokën”*<sup>23</sup>. Të tjerë deputetë deklarorin *“nuk do të quhej vepër e madhe ajo që po bën ky Parlament për martirët e demokracisë, në qoftë se ne,*

<sup>21</sup> Kodi Penal (1952, 1977). Kodi Penal i RPSH, Tiranë: QBZ, 1977.

<sup>22</sup> Vendim nr. 34 i Gjykatës Kushtetuese, më 20 dhjetor 2005.

<sup>23</sup> “Ndriçim Hysa”, në: *Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të*, Viti 1991, nr. 4, f. 1738.



me vendimet që do të marrim, nuk do të vëmë në vend nderin dhe dinjitetin e tyre, që patjetër është i lidhur pazgjidhshmërisht edhe me anën materiale e financiare”<sup>24</sup>. Një prej diskutimeve më realiste të debatit citoi se “kërkohej t’u jepet amnisti. Do të thosha që shteti duhet të kërkojë që të amnistohet prej tyre, jo ata të kërkojnë të amnistohen nga shteti, sepse ata janë të pafajshmit dhe jo e kundërta”<sup>25</sup>. Dritëro Agolli, një funksionar i lartë, por edhe kritik publik i regjimit në ditët e ndryshimit të sistemit prezantoi tezën interesante se “në kushtet e diktaturës së Enver Hoxhës Shqipëria ishte në dy shtete: shteti që dukej, që ishte me administratë e me të gjitha, dhe shteti i padukshëm, që ishin të burgosurit. Ky ishte një shtet i tërë, me administratë e me të gjitha ... Unë jam plotësisht për falje, këtu të mos keqkuptohemi, edhe për shpërblimet e për të gjitha, por ne ta lehtësojmë”<sup>26</sup>.

Elementi tjetër i rëndësishëm i debatit lidhet me standardet konkrete të vlerësimit të kompensimit dhe mbështetjes sociale. Në vendimin e saj nr.34/2005, Gjykata Kushtetuese theksoi se shteti demokratik i dëmshpërblen dhe i kompenson këta persona sipas kushteve e mundësive ekonomike e financiare, duke u bazuar kryesisht në parimet e rëndësishme të drejtësisë dhe të barazisë, citim i marrë nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë<sup>27</sup>. Sipas këtij shpjegimi, parimet e drejtësisë “kërkojnë të merren në konsideratë edhe interesat e anëtarëve të tjerë të shoqërisë si dhe interesi publik në tërësi” duke pasur synim kryesor jo eliminimin tërësor, por “zvogëlimin sa më shumë të pasojave të këtyre padrejtësive”<sup>28</sup>.

Parimi i barazisë përjashton ndarjen në kategori të ndryshme diskriminuese për të njëjtat shtresa, tregues që është kritikuar shpeshherë edhe në mënyrën e trajtimit të kësaj problematike nga Shqipëria. Më 1991 në debatin për amnistinë koncepti mbi barazinë dhe mundësitë ishte dominues nga të gjitha palët politike. E majta ishte statike në nevojën për akte më shumë politike sesa ekonomike, tezë që pati mbështetje politike dhe tek pjesa më e madhe e opozitës. Sipas njërit prej eksponentëve kryesorë të saj, “idealja do të ishte kënaqja e plotë e kërkesave ekonomike. A kemi mundësi t’i japim tërë rrogat një ish të burgosuri që ka qenë 20 vjet në burg? Ne e dimë që ka mijëra e mijëra të tillë, por edhe qindra mijë njerëz që kanë vuajtur nga këto ligje, të cilat po hezitohet t’i dënojmë. A ka mundësi ky shtet t’i kënaqë këta? Ne e dimë që ky shtet, me këto mundësi që kemi, është i mbytur në borxhe me 400 milionë dollarë, me një ekonomi të shkatërruar që s’po prodhon gjë. Në qoftë se ne angazhohemi konkretisht t’i shpërblejmë që sot këta njerëz, kjo do të ishte një aventurë. Por ne duhet të marrim

<sup>24</sup> “Sadedin Balla”, në: *Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të*, Viti 1991, nr. 4, f. 1621.

<sup>25</sup> “Arben Imami”, në: *Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të*, Viti 1991, nr. 4, f. 1573.

<sup>26</sup> “Dritëro Agolli”, në: *Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të*, Viti 1991, nr. 4, f. 1602

<sup>27</sup> Vendim nr. 1 i Gjykatës Kushtetuese, 1995.

<sup>28</sup> Vendim nr. 30 i Gjykatës Kushtetuese, 1 dhjetor 2005.

*përgjegjësinë morale që do t'i shpërblejmë në atë masë që ka mundësi shteti, në atë masë që mund t'i fusim këta njerëz në jetë. Këtë gjë duhet ta bëjmë dhe pjesërisht ky ligj e përmban këtë*<sup>29</sup>. Më vonë, qëndrimet politike patën dallime, - e majta e pritur më shumë tek simbolika e akteve dhe reagimi përballë ndjenjës së fajësisë dhe e djathta e pritur për ta parë procesin e kompensimit dhe integritet si paketë masash dhe si çështje që i përket kryesisht asaj.

27 vjet pas debatit parlamentar të vitit 1991 mbi standardet e kompensimit dhe të trajtimit të viktimave politike të regjimit komunist duket se ende nuk ka qëndrime unike në standarde, por më shumë rendet pas akteve simbolike. Në një raportim në Kuvend, ministri i Financave, ndërsa flet për rëndësinë e procesit të kompensimit financiar dhe meritat e qeverisë ku bën pjesë, e vlerëson procesin si penalizim brezash për shkak të gabimeve të brezave të mëparshme. Konkretisht, ai duke evituar qëndrimin e tij pro apo kundër, thotë *“brezi i ri i shqiptarëve që vjen do të paguajë nga 1.5 deri në 2 miliardë dollarë nga taksat e tij për çfarë ka ndodhur që nga viti 1945 dhe deri në vitin 1989. Brezi që vjen do të paguajë gati 1.5 deri në 2 miliardë dollarë, në 8 -15 vjetët që vijnë nga taksat e tij brezi që sot është 16-20 vjeç, sa do të fillojë punë do të paguajë taksa për çfarë ka ndodhur në këtë vend që nga vitit 1945 dhe deri në vitin 1989. Nuk po mbaj qëndrim nëse është e drejtë apo e gabuar, se nuk e kam unë këtë të drejtë të mbaj qëndrim nëse është e drejtë apo e gabuar, por dua të ndaj me ju se kjo kosto, po i kalohet brezit aktual dhe brezit që vjen*<sup>30</sup>.

Lidhur me standardet e vlerësimit ka pasur interpretime të ndryshme nga vetë shoqatat dhe grupet që përfaqësojnë ish të përndjekurit politikë, institucionet zyrtare që veprojnë në çështje që lidhen me to, si dhe nga aktorët politikë. Debatimi mbi standardet që duhen ndjekur ka qenë më i gjatë dhe më kompleks sesa debati për përmbushjen e standardeve. Ky është një dallim thelbësor nga praktikatat e shumicës së vendeve të tjera ish komuniste, sidomos vendet e ish Evropës Qendrore, ku debati mbi standardet është mbyllur herët, duke lënë të hapur vetëm debatin mbi përmbushjen cilësore të standardeve.

### ***Praktika shqiptare dhe ajo referuese nga vendet e tjera ish komuniste***

Në çdo vend ish komunist është pranuar parimi i kompensimit dhe përgjegjësisë shtetërore ndaj viktimave të komunizmit. Dallimet gjenden në elementë të zbatimit të këtij parimi, prioritetet, standardet dhe normat politike e financiare. Praktika rehabilituese përfshi si

---

<sup>29</sup> “Neritan Ceka”, në: *Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, Viti 1991, nr. 4, f. 1563.*

<sup>30</sup> Arben Ahmetaj, *Raportim në Komision në Kuvend. Legjislatura IX, Tiranë, 13 shtator 2018, f. 20.*

element thelbësor “kompensim financiar për viktimat<sup>31</sup> dhe/ose të afërmit e tyre, ashtu edhe rehabilitimi "moral" që është edhe më i rëndësishëm për shoqërinë. Koncepti i dëmshpërblimit i jep vlerë dhe dinjitet personave duke i konsideruar ato qenie njerëzore dhe duke pranuar jo vetëm teorikisht përgjegjësitë e shtetit. Ndjesa në emër të shtetit dhe shoqërisë e plotëson procesin, të shkëputura nga njëra-tjetra dy konceptet sjellin pasoja të reja diskriminuuese. Aktet politike të viteve 1990-1992 ishin të nevojshme por të pamjaftueshme për të përmbyllur procesin e rehabilitimit dhe integrimin real me drejtësi dhe barazi, siç përcaktohet nga vendimet e të paktën dy Gjykatave Kushtetuese. Pjesa kompensuese i përket një faze të përshkallëzuar nga vendi në vend.

Në dekadën e parë të tranzicionit ka pasur disa dokumente komentuese të Komisionit të Venecias dhe të strukturave të tjera ligjore brenda kuadrit evropian, mbi çështjet e kompensimit të viktimave politike të së kaluarës komuniste dhe qasjes së qeverive në sistemin e ri politik. Parimi dominues në secilin prej dokumenteve është detyrimi i shtetit për të njohur përgjegjësitë e tij ndaj fajeve të vetë shtetit në të kaluarën. Në njërin prej akteve referuar ligjit shqiptar, Komisioni i Venecias referoi si parim orientues Rezolutën 40/34 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të 29 nëntorit 1985 mbi trajtimin e viktimave të krimit dhe të pushtetit abuziv. Deklarata parasheh detyrimin për kompensim të menjëhershëm financiar të dëmit për viktimat, por “*ekzekutimi i legjislacionit dhe kompensimit varet edhe nga kapaciteti ekonomik i vendit*” duke e trajtuar debatin mbi masën e kompensimit më shumë si çështje financiare sesa çështje ligjore ose kushtetuese<sup>32</sup>. Duke ndjekur të njëjtën linjë, në rastin shqiptar Komisioni i Venecias vlerësoi se ligji i vitit 1993, është më shumë një natyrë teknike-financiare sesa ligjore, pasi përcakton shumat e kompensimeve, procedurën dhe afatet e pagesës së saj. Rregullimi i këtyre çështjeve duhet të vlerësohet si një shprehje e politikës shtetërore në lidhje me personat, viktimat të regjimit komunist<sup>33</sup>. Kompensimi nuk është çështje zgjedhjeje, por pjesë e të drejtës ndërkombëtare dhe detyrimit që nëse qeveria në detyrë nuk e përmbush këtë detyrim, ai i kalon qeverisë pasardhëse derisa të realizohet, duke ndjekur parimin se “*të gjithë duhet të fitojnë të drejtat brenda fushëveprimit të kërkesave të përcaktuara me ligj*”<sup>34</sup>.

---

<sup>31</sup> Gábor Halmai, “Lustration and Access to the Files in Central Europe”, in: *Lustration and Consolidation of Democracy, and the Rule of Law in Central and Eastern Europe*, KAS, Political Science Research Centre Zagreb, 2004, pg. 21,

<sup>32</sup> Peter Paczolay “Comments on the amendments to the law of the Republic of Albania on the status of politically ex-convicted and prosecuted people by the communist regime”, in: *Venice Commission, Opinion no. 298/2004*.

<sup>33</sup> Kestutis Lapinskas, “Comments on the amendments to the law of the Republic of Albania on the status of politically ex-convicted and prosecuted people by the communist regime”, in: *Venice Commission, Opinion no. 298/2004*.

<sup>34</sup> Neil J. Kritz, *The Dilemmas of Transitional Justice*, in: *Transitional Justice*. Vol. I. Washington, D.C.: United States Institute for Peace Press, 1995, p. 538.

Në debatin midis parimit ndërkombëtar dhe parimit kombëtar ka pasur dhe ka një debat më shumë politik sesa juridik. Në aspektin juridik, e drejta ndërkombëtare nuk detyron apriori shtetet për të ofruar kompensim të plotë mbi viktimat, por u sugjeron atyre dëmshpërblim sipas mundësive vetëm për viktimat dhe familjarët, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe vullnetin e shtetit për të paguar vlerat e tilla sipas ligjit<sup>35</sup>. Sipas studiueses Nika Bruskina, kur një shtet nuk ka ndërmarrë asnjë detyrim për të paguar kompensimin, e drejta ndërkombëtare nuk ka ndikim në ligjin vendas. Nëse një shtet ndërmerr detyrimin për të paguar kompensimin, e drejta ndërkombëtare mund të veprojë midis hapësirës ligj ndërkombëtar e vendor, duke kërkuar standarde vlerësimi dhe zbatim të ligjit vendor. Në këtë mënyrë, e drejta ndërkombëtare identifikon standardet dhe garancitë që bëjnë harmonizimin midis angazhimit për dëmshpërblimin brenda një afati të arsyeshëm, me atë për mosdiskriminimin etj., ndaj edhe praktikatat dhe sidomos masat e kompensimit ndryshojnë nga vendi në vend. Parimisht, kur shtetet marrin përsipër kompensimin por nuk e realizojnë atë, individët e prekur kanë të drejtë që të ankimohen në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut duke sjellë detyrime ligjore ndërkombëtare për vetë shtetin. Kjo Gjykatë, sipas Bruskina, nuk trajton elementë të shumës së kompensimit, formës, hapësirës apo metodikës, duke i njohur shteteve të drejtën e vendimmarrjes për këto elemente, por vlerëson të drejtën e cenuar dhe parimet që lidhen me të.

Praktika shqiptare e kompensimit ka pësuar ndryshime të vazhdueshme, në varësi nga rëndësia e problematikës, reagimit të vetë komunitetit të ish të përndjekurve politikë, si dhe vullnetit politik të mazhorancave qeverisëse. Bazuar në parashikimet e ligjit të vitit 1993 procesi i kompensimit duhet të përfundojë brenda tre vjetëve nga dita e miratimit të amendamenteve<sup>36</sup>, pra më 1996. Zhvillimet praktike në terren tregojnë se ky proces nuk është përmbyllur as pas dy dekadash nga afati i parashikuar. Më 2006, KLSH vlerësoi se me ritmet e kompensimit financiar të viteve të fundit, “*detyrimi i pa likuiduar prej 36 miliardë lekë do të shlyhej nga qeveria pas 18 vjetësh*”<sup>37</sup>. Sipas qeverisë aktuale, nga viti 1991 deri 2013, ish të dënuarit politikë kanë arritur të përfitojnë vetëm 20% të vlerës së dëmshpërblimit për vitet e burgut dhe vuajtjet në regjimin komunist, kurse përgjatë harkut kohor 2009-2018 janë miratuar rreth 13 101 dosje të aplikuara nga ish të përndjekurit politikë<sup>38</sup>. KLSH raportoi se midis 2007 dhe 2009

---

<sup>35</sup> Nika Bruskina, *State compensation to victims of crimes of nazi and communist regimes: interface between international and domestic law*, Summary of Doctoral Dissertation Social Sciences, Law (01 S) Vilnius University, 2014

<sup>36</sup> Peter Paczolay “Comments on the amendments to the law of the Republic of Albania on the status of politically ex-convicted and prosecuted people by the communist regime”, in: *Venice Commission, Opinion no. 298/2004*

<sup>37</sup> KLSH, *Raport Auditimi i Performancës "Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit"*, 2016.

<sup>38</sup> Arben Ahmetaj. *Raportim në Kuvend*. Seanca, Tiranë, 13 shtator 2018, f. 20.

pati 20 591 aplikime për dëmshpërblime, pas 2009, pati rreth 3 373 aplikime të reja jashtë afatit ligjor<sup>39</sup> dhe se në total deri 2016 u evidentuan 19 316 dosje pensioni për familje me statusin e të pushkatuarit, të vdekur në burg apo ata të dënuar politikë.

Referimet në shifrat e dhëna nga qeveritë shqiptare për procesin e rehabilitimit dhe të trajtimit financiar të ish të burgosurve dhe ish të përndjekurve politikë janë e mbeten problematike. Çdo qeveri jep të dhëna pozitive për veten dhe kritike për kabinetet paraardhëse. Për shembull, në debatin e vitit 1994, ministri i Financave raportoi në parlament se gjatë viteve 1994-1996 rreth 15% e buxhetit vjetor është destinuar për procesin e kompensimit, dhe se 17 miliardë lekë janë dhënë përmes bonove të privatizimit. Shifra duket e lartë, por qeveria pas 1997 e kontestoi atë. Pas rotacionit të vitit 2005, procesi i rivlerësimit dhe trajtimit financiar u shoqërua me akte të reja zyrtare dhe disa vite më pas nisi procesi i pagesave të rregullta financiare sipas një skeme teknike të diferencuar. Më 2011 u përcaktua sistemi i pagesës në tetë këste të barabarta, sistem i cili në formë më të korrektuar dhe funksionale vijon të aplikohet edhe tani.

Gjatë viteve, disa herë nga burimet zyrtare janë cituar shifrat e nevojshme të kompensimit, por gjithnjë duke marrë vlerën e monedhës në momentin e debatit. Për shembull, në gusht 1994, qeveria bëri një deklaratë kritike ndaj një grupi të ish përndjekurish politikë që ishin në grevë urie kundër saj, duke theksuar<sup>40</sup> se kërkesa për kompensim financiar brenda 1996 është e pamundur të realizohet, pasi *“do të duhen 15 deri 30 miliardë lekë, sa tri buxhetet vjetore të mbrojtjes, të shëndetësisë dhe të arsim-kulturës”*. Oferta zëvendësuese e qeverisë ishte përdorimi nga ish të përndjekurit politikë të letrave me vlerë në procesin masiv të privatizimit të ekonomisë. Po ashtu, 10 vjet më vonë, në debatin parlamentar u theksua se janë rreth 91 500 vite burgu, të cilat *“bëjnë 32 milionë ditë burgu, të cilat ... në një kurs të monedhës kombëtare, që lëviz nga 115 - 130 lekë për dollarë, kostoja totale është 107 deri 132 miliardë lekë”*<sup>41</sup>.

A mund të kishte një proces tjetër? Më 1991 ishte paralajmëruar pamundësia e përballimit të procesit, kur qeveria deklaroi se *“një pjesë e mirë e ekonomisë është e paralizuar për mungesë lëndësh të para apo që nuk punohet, njerëzit paguhen me 80% dhe arka e shtetit është në një borxh të madh me rritje të pandërprerë”*<sup>42</sup>, dhe se *“gjithnjë më tepër po intensifikohen kërkesat për rritje pagash, për subvencione e të tjera kërkesa të ngjashme jashtë mundësive reale për t’u plotësuar”*. Megjithatë, ka tregues të shumtë që provojnë se mundësitë

<sup>39</sup> KLSH, Raport Auditimi i Performancës "Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit", 2016.

<sup>40</sup> ATSH. Deklaratë e qeverisë shqiptare, 5 gusht 1994.

<sup>41</sup> “Arben Malaj”, në: *Punime të Kuvendit Legjislativa e 16-të*, Viti 2004, nr. 6, f. 1730.

<sup>42</sup> ATSH. Deklaratë e qeverisë shqiptare, 28 tetor 1991.

dhe kapacitetet ndër vite kanë qenë shumë më të mëdha sesa sasia dhe skema që u zbatua. Le ta ilustrojmë me një detaj domethënës. Më 2004, qeveria raportoi se sistemi social shtetëror mbulonte pagesat mujore për rreth 5 mijë familje dëshmorësh, me vlerë rreth 300 milionë lekë<sup>43</sup>, shifër kjo shumë më e madhe sesa ajo që shteti paguante atë vit në procesin e kompensimit të ish të përndjekurve dhe ish të burgosurve politikë që zyrtarisht konsideroheshin prioritet.

Një nga kritikantët themelore lidhet jo vetëm me vullnetin politik por edhe me paqartësinë në bazën ligjore, ndryshimet e shumta dhe sistemin burokratik të evidentimit dhe trajtimit të dosjeve. Një përfundim i tillë provohet edhe nga korrespondenca midis Avokatit të Popullit dhe Ministrisë së Financave më 2012. Në analizën e tij mbi problematikën 1991-2012, Avokati i Popullit arriti në përfundimin se “*megjithëse ligji nr. 9831 datë 12.11.2007 ligjëron fillimin e një procesi dëmshpërblimi financiar për ish të dënuarit politikë, përsëri konstatohet se, ndryshimet ligjore që kanë shoqëruar këtë proces nuk janë në dijeninë e atyre subjekteve, të cilat përfitojnë prej tij ... draftet e ndryshimeve nuk janë konsultuar paraprakisht me ta apo me përfaqësues të tyre...ligji nuk është zbatuar korrektësisht nga ana e organeve shtetërore*”<sup>44</sup>. Dy ilustrime konkrete e mbështetnin këtë tezë kritike: *e para*, KLSH analizoi detyrimin ligjor të vitit 1992 për derdhjen e 1% të fondit të pagave nga ndërmarrjet jobuxhetore në fondin për të përndjekurit politikë dhe arriti në përfundimin se shumica absolute e ndërmarrjeve as nuk kanë aplikuar dhe as e kanë njohur këtë dispozitë ligjore<sup>45</sup>; *e dyta*, gjatë debatit parlamentar 2018 u raportua p.sh., se pas vitit 2000, ish të përndjekurit politikë patën pamundësi reale për marrjen e vërtetimeve që kërkonte ligji për kohën e vuajtjes së dënimit dhe punën që kanë kryer në burg. Kjo erdhi pasi komisioni shtetëror përgjegjës ishte jofunksional dhe se burgjet kryesore komuniste nuk ekzistonin më<sup>46</sup>. Në rrethana të tilla ata u detyruan për shkak të natyrës burokratike dhe kundërvënëse të ligjit, të ndjekin procedura ankimi në rrugë gjyqësore.

Praktikat e vendeve të tjera reflektojnë specifika të ndryshme. Një prej tezave interesante në analizimin e praktikave lidhet me ndërvarësinë midis shpejtësisë e sasisë së kompensimit me nivelin e besimit tek drejtësia. Kompensimi ishte vetëm një pjesë e procesit të ndarjes me drejtësi nga e kaluara, lustracioni, memoria historike dhe elementë të tjerë që e plotësojnë atë. Megjithatë të dhënat tregojnë se demokracitë e reja më të suksesshme ishin ato që kanë pasur më shumë traditë demokratike në periudhën midis dy Luftërave Botërore dhe ato që kanë pasur potencial ekonomik më të lartë dhe pozita strategjike më të rëndësishme. Më

---

<sup>43</sup> Neritan Alibali (2004). *Punime të Kuvendit. Legjislatura e 16-të, Viti 2004, nr. 6, f. 1740.*

<sup>44</sup> Avokati i Popullit (2013). *Raport vjetor mbi veprimtarinë për vitin 2012*, Tiranë, f. 185.

<sup>45</sup> KLSH, *Raport Auditimi i Performancës "Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit"*, 2016.

<sup>46</sup> Kuvendi i Shqipërisë. [www.parlament.al/Files/Procesverbale/Komisioni-i-Shendetesise-date-07-05-2018.pdf](http://www.parlament.al/Files/Procesverbale/Komisioni-i-Shendetesise-date-07-05-2018.pdf)

poshtë po ilustron disa nga të dhënat e përgjithshme të procesit në disa prej vendeve të ish Bllokut Lindor.

Në Hungari, *legjislacioni kompensues (1992) e shtriu veprimin midis 1939-1989, ndryshe nga Shqipëria, e cila pati kohështrirje 1945-1990. Për rastet e humbjes së jetës në Hungari kompensimi financiar ishte rreth 4 mijë euro, shifër e lartë për kohën e vendimmarrjes. Si pasojë e debateve politike dhe ndërhyrjes së Gjykatës Kushtetuese, më vonë kjo shifër u reduktua në 120 euro mbështetur në parimin jo si detyrim kushtetues, por si skemë asistence për këtë grup social<sup>47</sup>. Në Hungari debati vazhdoi më shumë se një dekadë sidomos lidhur me viktimat që kanë humbur jetën në regjimin komunist. Sipas qeverisë shqiptare referime të tilla vlejné për të kuptuar se edhe për rastin tonë “nuk bëhet fjalë shpërblim për ditë burgu, por bëhet fjalë për një asistencë suplementare që Qeveria i jep për një skemë, e cila funksiononte dhe vijnë e plotësohen nga njëri vit në tjetrin”<sup>48</sup>.*

Në Lituani që në fillimet e procesit të tranzicionit u përcaktua kompensimi për të përndjekurit politikë, duke përfshirë dëmshpërblimin e menjëhershëm me para në dorë, kompensim page, toke, ndërtesa, punë e papaguar dhe vuajtjet etj. Gjithashtu, në Lituani kompensimi përfshin edhe pagesën e kompensimit material deri në 3.000 LTL (870 euro) për familje. Të gjithë ish të burgosurit dhe të depërtuarit fituan të drejtën e pensionit shtetëror, pensione të posaçme u dhanë për familjet e viktimave të rezistencës etj.

Në rastin bullgar, referuar të dhënave të qeverisë shqiptare, pagesa kompensuese ishte 23 euro/muaj, 10 më pak sesa parashikimi i Kodit Penal në RSH për ditë/burgu. Gjithashtu në Bullgari u aplikua fillimisht pagesa direkte në dorë prej 750 euro, për të ndjekur më pas procedurën standarde. Kompensimi ligjor parashikonte pagesa me 1 500 deri 5 000 leva/muaj, ose 1 060\$/muaj për vitet në kampet e punës dhe në burgje, ndërkohë që për të deportuarit dhe të shpërngulurit me forcë pagesa 800-2 500 leva/muaj, kurse për studentët që u detyruan të braktisnin studimet me 10 mijë leva/muaj.<sup>49</sup>

Në Gjermani që më 1992 me aktin e Korrigjimit ndaj padrejtësive të SED, u bë anulimi i vendimeve politike të gjykatave si dhe ndaj vendimeve me gjykim disproporcional penal, si dhe u miratua një paketë e gjerë kompensimi, përfshirë trajtimin e dhunës psikike dhe ata që kishin punuar në kampet e detyruara të punës. Të gjitha viktimat u dëmshpërblyen me rreth 300 DM/210\$ për muaj për vitet e dënimit. Gjithashtu pati trajtime të tjera të shumta plotësuese për

---

<sup>47</sup> “Arben Malaj”, në: *Punime të Kuvendit Legjislatura e 16-të*, Viti 2004, nr. 6, f. 1731.

<sup>48</sup> Po aty.

<sup>49</sup> Lavinia Stan *Transitional Justice in Post-Communist Romania: The Politics of Memory*, Cambridge, University Press, (2003), p. 165

individët në pamundësi shëndetësore pune, ata që kanë humbur profesionin dhe ata që jetonin në varfëri etj.

Republika Çeke ka aplikuar sistemin më efektiv të tranzicionit të drejtë në vendet ish komuniste. Ai u përqendrua në drejtësi dhe pajtim. Deri në fund të vitit 1993, 96% e viktimave ishin rehabilituar dhe mbi 100 milionë euro u paguan si kompensime<sup>50</sup>. Kompensimi financiar ka pasur ndikim direkt edhe në besimin tek drejtësia<sup>51</sup>, duke provuar tezën se nëse vendimmarrësit politikë vendosin të rrisin kompensimin financiar, ata kështu investojnë tek rritja e besimit tek drejtësia. Në Çeki ish të përndjekurit politikë që kaluan më shumë se një vit në burg u kompensuan direkt me 120 mijë korona/6 660\$ dhe me 1 000 korona për çdo muaj burgim. Në Lituani u kompensuan rreth 8 000 dollarë amerikanë/20 mijë litas për të mbijetuarit e rezistencës që kanë vdekur në luftë, gjatë hetimeve ose në burg.

Në Rumani kompensimi në pjesën më të madhe u bë që në fillim të viteve '90, duke iu dhënë prioritet viktimave të revolucionit të vitit 1989. Ligji rumun pësoi disa herë ndryshime, më kryesoret më 2009, ku u përcaktua shifra e kompensimit rreth 8 mijë euro për person, duke llogaritur se kanë mbetur pa kompensuar më pak sesa 10 mijë persona.

Në Estoni, sipas shembullit të pjesës lindore të Gjermanisë, u përdor modeli i besimit ose modeli i agjencisë së privatizimit. Privatizimi, i filluar nga ligji i privatizimit të qershorit 1993, përfundoi me sukses, pavarësisht nga shumë probleme.

### ***Përfundime***

Procesi i ndërtimit të demokracisë funksionale dhe i ndarjes me të kaluarën komuniste, mbështetur në parimin e drejtësisë dhe të barazisë rezultoi shumë më kompleks dhe i vështirë sesa procesi i reagimit dhe lëvizjeve të viteve 1989-1990 që çoi në ndryshimin e sistemit. Ndikim thelbësor patën natyra e vetë regjimeve të kaluara, mënyra e realizimit të ndryshimit të sistemit, tradita demokratike e shtetërore, potencialet ekonomike dhe burimet njerëzore në dispozicion, vizioni i elitave të reja politike dhe gatishmëria e shoqërisë për t'u përballur me vetveten. Midis vendeve ish komuniste gjenden modele e standarde të ndryshme aplikimi, të cilat reflektojnë edhe karakteristikat specifike të secilit vend. Trajtimi politik, moral dhe ligjor i viktimave të sistemit të kaluar, sidomos atyre të përfshirë në kategorinë e punës së detyruar, është pjesë e të tërës dhe reflekton sa tiparet aq edhe zgjedhjet që bëri secili vend.

---

<sup>50</sup> Jacques Rupnik. (2002). "The Politics of Coming to Terms with the Communist Past. The Czech Case in Central European Perspective, Transit", in: *Europäische Revue*, Nr. 22.

<sup>51</sup> Roman David, "Transitional justice effects in the Czech Republic", in: *Post-Communist Transitional Justice* edited by Lavinia Stan, Nadya Nedelsky, Cambridge University Press, 2015, p. 113.



Shqipëria nuk përbën një shembull sukseesi, por as dështimi kategorik në këtë drejtim. Çdo fazë e procesit në Shqipëri erdhi e vonuar në kohë, ndaj ajo reflekton disa nga gabimet klasike, por edhe mësimet të brishta të nxjerra nga përvoja e vendeve të tjera. Duke qenë vend me histori unike izolimi dhe diktature të brendshme, me nivel jetese në kufijtë e mbijetesës dhe me nivel të lartë të dhunës shtetërore mbi qytetarët kritikë, me mungesa në formimin demokratik dhe koncepte minimale mbi shtetin e së drejtës, Shqipëria u ndesh me sfida të mëdha, të cilat as nuk ishte e përgatitur dhe as nuk kishte vizionin e aftësinë t'i përballonte. Ajo eksperimentoi vazhdimisht në kërkim të zgjidhjeve oportune me kalkulime elektorale, eksperimentoi me standardet, format, ligjet, vendimet, praktikat dhe grupet sociale, mori vendime nën presion dhe e burokratizoi procesin, duke e zgjatur shumëfish më tepër sesa premtimi e parashikimi, si dhe për pasojë, duke mos arritur të ketë një bilanc të qartë të nivelit të integritetit real të ish të përndjekurve politikë në sistemin e shoqërinë e re. Natyra eksperimentale dhe kontrolli politik mbi procesin demotivoi nismat e ish të përndjekurve politikë për reagim kolektiv dhe ndikim të qëndrueshëm në vendimmarrjen politike.

Pas rreth tri dekadash Shqipëria, në dallim nga shumë prej vendeve të tjera ish komuniste, përballet ende me sfidën e përballjes me të kaluarën. Ajo ka nevojë për reflektim serioz, për strategji afatgjatë, për heqje dorë nga keqpërdorimi i pasojave të së kaluarës për synime elektorale, për politika reformatore e konsensuale si dhe për investim cilësor në rritjen e harmonisë dhe ndërveprimet në shoqëri. Integriteti real i ish të përndjekurve politikë do të ndodhë vetëm kur këto sfida të pranohen dhe të jetësohen.

## Beqir Meta - Instituti i Historisë/ASA, Tiranë

### Vështrim analitik mbi sistemin e burgjeve, internimeve dhe përdorimin e punës së detyruar gjatë regjimit komunist në Shqipëri

#### Abstrakt

Punimi është një studim mbi mekanizmat e ushtrimit të dhunës gjatë regjimit komunist dhe jep një panoramë mbi sistemin e burgjeve, internimeve, trajtimin e kundërshtarëve të regjimit brenda këtij sistemi, si dhe analizon arsyet e përdorimit të punës së detyruar në këto burgje dhe kampet e internimit.

#### *Tipare të përgjithshme të regjimeve totalitare komuniste*

Komunizmi, në këndvështrimin e atyre që e promovuan atë, ishte i destinuar të riformatonte shoqërinë njerëzore kudo në botë<sup>1</sup> sipas një modeli që theksonte sa barazitizmin, aq edhe antagonizmin e përhershëm të saj. Në sistemet politike të ndërtuara duke u bazuar në këtë ideologji në thelb totalitare, pajtimi ishte i pamundur ndërmjet atyre që besonin në parimet e kësaj ideologjie dhe ndërmjet atyre që kërkonin një tjetër model qeverisjeje.

Vullneti për t'i përjetësuar regjimet komuniste dhe lidërshtipin në krye të tyre krijoi një sistem dhune dhe represioni. Mohimi i lirive dhe të drejtave themelore, sociale dhe politike për individët e një kategorie të shoqërisë, argumentohej nga propaganda zyrtare si një çmim i vogël që duhej paguar për të prekur ëndrrën e përealizueshme të një shoqërie pa klasa, pa pronë dhe pa varfëri. Persekutimi i çdo individi të konsideruar të rrezikshëm për pushtetin e lidërshtipit komunist dhe indoktrinimi me ideologjinë marksiste dhe derivatet e saj i pjesës tjetër të shoqërisë është një prej trashëgimive kryesore të komunizmit.

Regjimet komuniste ndërtuan një mekanizëm të rafinuar shtetëror dhune dhe terrori. Dhuna konsiderohej mjete i vetëm për marrjen e pushtetit, ndërsa terrori ishte i domosdoshëm për ta konsoliduar dhe përjetësuar pushtetin dhe kultin e individit të lidërshtipit komunist. Qysh në vitin 1918, "ati" i Revolucionit Bolshevik të Tetorit, Vladimir Iliç Lenini do të porosiste drejtuesit komunistë lokalë: *"Shokë! Rebelimi i kulakëve në pesë rajonet duhet të shtypet pa mëshirë. Ne duhet t'u japim një mësim të mirë. 1) Varni 100 kulakë të regjur publikisht. 2) Botoni emrat e tyre. 3) Merruni të gjithë ushqimin. 4) Merrni pengje. Të gjitha këto të bëhen që të përhapet fjala anëmbanë, njerëzit të shikojnë dhe të tmerrohen".*<sup>2</sup>

Pasuesi i tij, Josif Visarionoviç Stalin i përsosi mekanizmat e dhunës dhe të terrorit të shtetit sovjetik. Gjatë qeverisjes së tij, emri i Stalinit dhe komunizmi ishin shndërruar

<sup>1</sup> David Pryce-Jones, *The War that never was; the fall of the Soviet Empire 1885-1991*, London: Phoenix Press 1995, f. 1.

<sup>2</sup> *Po aty*, f. 11.

në sinonime. Stalini ka hyrë në kujtesën historike me çibukun e tij në buzë teksa jepte urdhrin "Të pushkatohet!" apo "Të pushkatohet menjëherë!"<sup>3</sup> Në regjimin e tij termat e rinj "proletarë", "luftë klasash" ishin rend i ditës. Termat e tjerë të përdorur të cilët do të përqafoheshin nga të gjithë diktatorët komunistë të Evropës Lindore e Qendrore do të ishin "revizionistët", "trockistët", "kulakët", "borgjezët", "sabotatorët". Të gjithë këto terma të "zbuluar" prej Stalinit do të ktheheshin në "besëtytni" për të gjithë komunistët dhe ndjekësit e luftës së klasave dhe të kultit të individit.

Eliminimi i kundërshtarëve, gjyqet politike, sistemi i burgjeve dhe internimeve, gulagët e tmerrshëm ishin pjesë e mekanizmit shtetëror për të frikësuar, nënshtruar dhe kontrolluar shoqërinë. Në këtë strukturim dhune, organizmi më i frikshëm për mbrojtjen e pushtetit të sovjetëve dhe e ushtrimit të dhunës dhe të terrorit në Bashkimin Sovjetik ishte KGB (Komiteti për Sigurimin e Shtetit). Ai ishte caktuar nga partia për të zbuluar, ndjekur dhe, jo rrallë, eliminuar "armiqtë e popullit". Sipas këtij modeli, u ngritën të gjitha shërbimet sekrete në Lindjen Komuniste. Në Shqipëri ekuivalenti i tij ishte Sigurimi i Shtetit. Do të ishin me miliona njerëz në Bashkimin Sovjetik dhe me mijëra në Shqipëri të cilët do të vuanin pasojat e këtyre strukturave të frikshme të regjimit, një histori për të cilën deri më tani nuk kemi një studim të mirëfilltë shkencor. Mohimi dhe sakrifikimi i çdo vlere njerëzore nga ana e kësaj strukture represive do të ishte në të vërtetë "fytyra" e këtyre regjimeve.

Do të ishin këto mekanizmat e dhunës dhe të terrorit që gradualisht do t'i shndërronin shoqëritë në këto vende në të mbyllura dhe të nënshtruara. Shkrimtari i madh rus Aleksandër Sollzhenitsin (Alexander Solzhenitsyn) konstaton në veprën e tij "Arkipelagu Gulag" se në regjimet totalitare komuniste "shteti nuk ekziston më si klasë sunduese, por si shtet skllavopronar"<sup>4</sup>. Njeriu i ri, apo siç e quante ai "*Homo Sovieticus*", të cilit shteti i impononte bindjet, besimin, shijet, rrjedhën e jetës, nuk mund të ishte një njeri i lirë. Në burgje, kampe pune dhe internimi, dehumanizimi i njeriut mori përmasa të frikshme. Akademiku i mirënjohur rus, Andrei Sakarov, i ka përshkruar "gulagët" apo kampet e punës si "*vende ku jeta njerëzore nuk kishte asnjë lloj vlere dhe çdo gjë njerëzore pushonte së ekzistuari*"<sup>5</sup>.

### ***Jeta në kampe dhe zona internimi***

---

<sup>3</sup> *Po aty*.

<sup>4</sup> *Po aty*, f. 23.

<sup>5</sup> Jay Bergman, *Meeting the demands of reason; the life and thought of Andrei Sakharov*, New York: Cornell University Press, 2009, f. 308.

Pas vendimeve të marra në dhjetor 1944, një sërë urdhëresash detyruan një kategori të caktuar njerëzish: pronarë tokash, tregtarë, ish politikanë të largohen nga qytetet kryesore të Shqipërisë si: Tiranë, Durrës, Korçë, Shkodër etj., dhe të jetonin në zona të tjera të vendit. Këtyre individëve u hiqej e drejta për t'u kthyer në shtëpitë e tyre, të cilat u konfiskuan dhe e përdorën për të strehuar zyrtarë të regjimit të ri, familje të dëshmorëve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare etj. Që prej vitit 1945, filloi të përdorej internimi si një masë ndëshkimore ndaj kundërshtarëve politikë. Të dhënat më të hershme që kemi për zbatimin e kësaj mase i takojnë shkurtit të vitit 1945, kur Mehmet Shehu porositi të internohen personat që strehojnë të arratisurit në male, apo “kriminelët e luftës”, si dhe ata që nuk pranonin të dorëzonin armët<sup>6</sup>. Në dosjen që përmban këto urdhra, jepen edhe emrat e banorëve të Malësisë së Shkodrës, Pukës e Mirditës të cilët janë internuar. Sipas këtyre dokumenteve, internimet nuk janë kryer duke u bazuar në një ligj të posaçëm. Ato kanë shërbyer si mjet dhune dhe presioni, me qëllimin e vetëm për të nënshtuar banorët e Veriut të cilët nuk ishin mbështetës së Qeverisë Provizore të E. Hoxhës.

Një tjetër kategori që u internuan që në fillimet e vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, ishte ajo e familjeve të personave që ishin dënuar si “kriminelë lufte”. Nga kërkimet e deritanishme nuk gjenden shumë të dhëna për vendimet e internimeve të tyre, por dëshmitë e shumë prej tyre e vërtetojnë se ata janë dërguar në kampe internimi që prej vitit 1945.

Në një analizë të përgjithshme vitet 1945-1949 kanë qenë vitet më të rënda të zbatimit të këtij sistemi, për shumë arsye:

*Së pari*, në këto vite funksiononte sistemi i kampeve të internimit të rrethuara me tela me gjemba, shumë të ngjashme me konceptin e kampeve të përqendrimit. Territori ku ishte shtrirë kampi ishte një vend i rrethuar me tela me gjemba i ruajtur nga anët kryesore me roje të armatosura. Kampet ishin të përshtatura në godina të vjetra, si depo repartesh, magazina ose baraka të përshtatura. Duke qenë se të gjitha këto kampe, nuk ishin të ndërtuara për të strehuar familjarë, por ato u përshtatën me shpejtësi si kampe grumbullimi apo përqendrimi, siç shprehej Enver Hoxha shpesh në mbledhjet e Byrosë Politike, kushtet elementare të jetesës, ushqimi, fjetja, higjiena, linin tej mase për të dëshiruar. Që prej marsit 1945, deri më 1949, ishin dy kampe të kësaj natyre, në Berat dhe në Krujë<sup>7</sup>. Si rregull, të internuarit nga Veriu dërgoheshin në kampin e Beratit dhe ata të Jugut në Krujë. Kjo ishte një taktikë e mirëmenduar, pasi

---

<sup>6</sup> Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi i Partisë (më tej: AP)-Strukturat (më tej: Str.), Viti (më tej: V.) 1945, Dosja (më tej: D.) 215, Fleta (më tej: fl.) 31. Urdhër i Mehmet Shehut, komandanti i Korpusit III, Shkodër për shtabet e brigadave I, XI, XXIII, XXIV, 12 shkurt 1945.

<sup>7</sup> Kastriot Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë Komuniste*, Tiranë: ISKPK, 2015, f. 79.

shmangte familjaritetin që mund të krijohej midis të internuarve dhe rojeve të kampit. Njëkohësisht kjo gjë krijonte vështirësi për familjarët e të internuarve të kujdeseshin për ta dhe t'u siguronin ndonjë mundësi më shumë për ushqimin dhe higjienën.

*Së dyti*, në vitet 1945 - 1949 internimet dhe dëbimet nga vendbanimet nuk kishin asnjë bazë ligjore. Është e rëndësishme të përmendet se deri më 1949, baza ligjore ku mbështetej ky sistem, mbetet ende për t'u qartësuar. Sipas studiuesit Kastriot Dervishi, qeveria e drejtuar nga komunistët shfrytëzonte në këtë drejtim legjislacionin e periudhës së Mbretërisë Shqiptare. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë një pjesë e madhe e vendimmarrjes për internimet dhe dëbimet duhet të ishte atribut i Këshillit të Ministrave. Ne na rezulton që, pjesën dërrmuese të vendimeve e kanë marrë komandat ushtarake, ose ato të Mbrojtjes së Popullit, pararendëse të Sigurimit të Shtetit.

*Së treti*, në këto kampe internimi nuk dërgoheshin persona që ishin drejtpërdrejtë fajtorë, por të afërmit e njerëzve të padëshiruar për regjimin: të të arratisurve jashtë vendit, të atyre që ishin maleve dhe po organizonin rezistencë kundër regjimit; të burgosurit politikë; të partizanëve të dezertuar nga ushtria komuniste.

Më 10 janar 1949 u miratua dekreti nr. 649, i cili legalizoi "dëbimet dhe konfiskimet". Më 26 qershor 1954, ky dekret u rishikua dhe u plotësua, duke shmangur disa kundërshtime që kishte në raport me dekretin e miratuar tre muaj më parë që titullohej: "Mbi konfiskimet", si dhe për të përcaktuar më mirë termat juridikë mbi nocionin e internim-dëbimeve<sup>8</sup>. Dekreti u miratua nga Kuvendi Popullor më 2 gusht 1954 dhe sanksiononte internim-dëbimin si masë administrative për kundërshtarët politikë. Ky dekret lejonte *de jure* mbylljen e kampeve të punës, por *de facto* ato u zhvendosën si pjesë e sistemit të burgjeve. Legjislacioni mbi internim-dëbimet ndryshoi sërish në vitet 1960, 1979 dhe 1986<sup>9</sup>.

Sistemi i internim-dëbimeve vazhdoi të urdhërohej kundër kundërshtarëve politikë të regjimit, personave që paraqisnin tendenca arratisjeje, apo familjarëve të të burgosurve politikë, si dhe kundër çdo personi për të cilin regjimi dyshonte se "paraqiste rrezikshmëri shoqërore". Kjo donte të thoshte se masa e internim-dëbimit mund të merrej edhe ndaj të burgosurve politikë që përfundonin dënimin. Nga viti 1979 masa e internim-dëbimit u aplikua edhe ndaj fëmijëve mbi moshën 14 vjeç. Të internuarit që akuzoheshin kryesisht për arratisje, ose agjitacion dhe propagandë dënoheshin, duke i larguar nga shtëpitë e tyre dhe transferoheshin në qendra internimi. Ndonëse në bazë të ligjit koha e internim-dëbimit ishte 3-5 vjet, Komisionet e

---

<sup>8</sup> AQSH, F. 490/Këshilli i Ministrave, V. 1954, D. 1057, fl. 2. Relacion i ministrit të Punëve të Brendshme, Mehmet Shehu paraqitur Këshillit të Ministrave në lidhje me projekt-dekretin, mbi internim-dëbimet, pa datë.

<sup>9</sup> Shih: K. Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë Komuniste...*, f. 33-37.

internim-dëbimeve kishin të drejtë ta zgjasnin pafundësisht këtë kohë<sup>10</sup>. Në fondin arkivor të hetuesisë, pranë Arkivit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sot në administrim të Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish Sigurimit të Shtetit, ka qindra vendime të tilla që tregojnë për shtyrjen e kohës së internimit. Në shumë raste kohëzgjatja e internimit i kalonte 20-30 vjetët. Familjeve e ish bashkëpunëtorëve të pushtesit, krerëve të Ballit Kombëtar e Legalitetit, të internuara që prej vitit 1945 qëndruan në internim deri në rënien e regjimit komunist në vitin 1991. Kjo do të thoshte që 3-4 breza prej këtyre familjeve u lindën dhe rritën në internim, pa të drejta më minimale si qytetarë të RPSH/RPSSH.

Që prej vitit 1949, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, por nën kontrollin e rreptë të Komitetit Qendror, funksiononin komisione të posaçme, të cilat merrnin vendimet për masën e internim-dëbimit (Komisioni i Dëbimeve dhe Konfiskimeve (1949-1954); Komisioni i Internim-Dëbimeve 1955-1976 dhe 1980-1990; Komisioni i Veçantë i Internim-Dëbimeve 1977-1979; Komisioni Qendror i Internimeve dhe Dëbimeve, 1990). Sipas shifrave zyrtare të hartuara së fundmi nga institucionet qeveritare përgjegjëse për dhënie kompensimi për dëmet e shkaktuara gjatë periudhës së diktaturës, internimet me vendim ishin 12 500, një shifër kjo që nuk përfshin të miturit, fëmijët e të burgosurve etj. Sipas një raporti të publikuar më 2016 nga Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) në Shqipëri, në periudhën 1944 – 1990 të internuarit ishin 59 009. Sipas të njëjtit raport, të vdekurit për shkak të kushteve të internimit ishin 7022<sup>11</sup>.

Një masë relativisht më e butë e kufizimit të lirisë, si pasojë e internimit, ishte ajo e dëbimit, sipas së cilës një person ose një familje urdhërohej nga Komisioni Qendror që të largohej nga shtëpia e vet dhe të transferohej për të jetuar në një zonë tjetër që mund të ishte deri në 3 rrethe larg. Në dallim nga personi i internuar, personi i dëbuar mund të lëvizte në disa rrethe (përveç atij të origjinës) pa qenë nevoja të bënte kontrollin e përditshëm të punëtorit operativ apo të ai i policisë.

Vendet e identifikuara si qendra internimi politik ishin me dhjetëra në të gjithë Shqipërinë. Deri në vitin 1954 vazhdoi tipologjia e kampeve të internimit të rrethuara me tela me gjemba, në të cilët jeta e të internuarve ishte e vështirë. Pas vitit 1954 nuk bëhej fjalë më për zona të mbyllura si kampet e përqendrimit, por ishin fshatra nga të cilët të internuarit nuk mund të largoheshin pa leje. Çdo ditë të internuarit duhet të paraqiteshin për të firmosur në një regjistër në zyrën e Sigurimit apo të policisë. Zonat më të njohura ishin fshatrat në rrethet e Fierit, Lushnjës, Vlorës e Beratit, por në të vërtetë në të gjithë Shqipërinë kishte fshatra që

<sup>10</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme* (më tej: *AMPB*), F. 4/Hetuesia, V. 1949-1975.

<sup>11</sup> Të dhënat janë marrë nga faqja zyrtare e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

përdoreshin për këtë qëllim. Kriteri i përgjithshëm vazhdoi të ishte që banorët e veriut internoheshin në jug dhe anasjelltas, duke zhdukur kështu kontaktin me territorin e origjinës dhe me miqësitë e vjetra. Të internuarit kryesisht punonin nëpër kooperativat bujqësore, por shpesh i angazhonin edhe në ndërtime publike ose rikonstruksione siç bënin edhe me të burgosurit politikë.

Një panoramë të plotë mbi internimet gjatë viteve '50 i pasqyron një relacion i ministrit të Brendshëm, Kadri Hazbiu në shtator të vitit 1963. Sipas këtij relacioni numri i të internuarve të Komisionit të internim-dëbimeve kapte shifrën 1103, të cilët gjeografikisht ishin shpërndarë në këtë mënyrë: “662 janë vendosur në rrethin e Lushnjës, 206 në rrethin e Fierit, 71 në Thumanë të Krujës, 66 në Borsh të Sarandës, 30 në rrethin e Beratit, 19 në Hajmel të Shkodrës, 10 në Cërrik të Elbasanit, 12 në rrethin e Rrëshenit, 11 në Zvërnec të Vlorës, 3 në rrethin e Tepelenës, 4 në rrethin e Lezhës, 5 në rrethin e Vlorës, 1 në Gramsh, 1 në Gjirokastrë dhe 1 në Maliq të Korçës”<sup>12</sup>. Sipas kategorive shoqërore të internuarit ndaheshin: “103 t’internuar si pjestarë të familjes të kriminelave të luftës që nuk përfitojnë nga amnistija (pjestarë të familjes të Gjon Marka Gjonit, Prenk Previzit, Abas Kupit, Muharem Bajraktarit, Qazim Mulletit, Hysni Demës, Fiqiri Dines etj.). Këta janë vendosur në rrethin e Lushnjës, e në pjesën më të madhe në Gradishtë. 2) 101 t’internuar janë bajraktarë, kulakë ose pjestarë të familjeve të tyre, që kanë t’arratisur jashtë shtetit. 3) 292 t’internuar kanë pjestarë të familjes së tyre t’arratisur jashtë shtetit, të cilët zhvillojnë veprimtari spiunazhi ose futen si diversantë në vendin tonë. 4) 239 t’internuar kanë pjestarë të familjes së tyre t’arratisur jashtë shtetit dhe që banojnë në brezin kufitar (5 km. larg kufirit). 5) 271 t’internuar për rrezikshmëri arratisje”<sup>13</sup>. Pjesa tjetër ishin të dënuar për shkaqe ordinere.

### ***Kampi i Tepelenës (1949-1953)***

Vitet 1949-1953 ishin padyshim vitet më të vështira për regjimin komunist në Shqipëri. Pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë e Titos, pavarësisht propagandës së saj, qeveria komuniste u përball me vështirësi si ekonomike ashtu dhe në planin politik. Në të njëjtën kohë, qeveria shqiptare u përball me një trysni që vinte si nga fqinji jugor, Greqia, ashtu edhe nga shtetet perëndimore. Në Greqi, Lufta Civile ishte në fazën e saj kulmore dhe qeveria shqiptare jetonte me frikën e një sulmi të mundshëm nga Greqia. Ndërkohë, ShBA dhe Britania e Madhe

---

<sup>12</sup> *Autoriteti për Informim mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit* (më tej: *AIDSSH*), F. Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1963, D. 168. Relacion i Ministrisë së Brendshme për Kryesinë e Këshillit të Ministrave, 30 shtator 1963.

<sup>13</sup> *AIDSSH*, F. Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1963, D. 168. Relacion i Ministrisë së Brendshme për Kryesinë e Këshillit të Ministrave, 30 shtator 1963.

filluan një operacion të përbashkët, i cili kishte synim të përmbyste regjimet komuniste në Evropën Lindore<sup>14</sup>. Në kuadër të këtyre operacioneve, ato stërvitën dhe dërguan në Shqipëri grupe të arratisurish politikë shqiptarë. Të gjitha këto rrethana të brendshme dhe të jashtme, shkaktuan vështirësi në jetesën e shqiptarëve, gjë që shkaktoi rritjen e pakënaqësisë së tyre për shkak të kushteve shumë të vështira ekonomike<sup>15</sup>. Vështirësitë ekonomike rrisnin numrin e të pakënaqurve ndaj regjimit. Si pasojë, në këto vite, ka një rritje të numrit të të arratisurve jashtë kufirit të Shqipërisë, gjë që shtoi numrin e familjeve që internoheshin. Kushtet e vështira ekonomike dhe masa e madhe e të internuarve pati reflektim të drejtpërdrejtë në kushtet tejet të vështira të jetesës në kampin e Tepelenës.

Pas mbylljes së kampeve të rrethuara me tela me gjemba të Beratit dhe Krujës, të internuarit u transferuan në Tepelenë. Fillimisht si zona internimi u përdorën fshatrat e Turhanit, Memaliajt dhe Veliqiotit dhe, më pas, u zhvendosën në afërsi të qytetit të Tepelenës. Arsyeja që u zgjodh Tepelena si vend internimi, mendojmë se ka të bëjë me disa lehtësi praktike. Tepelena ishte nën juridiksionin e Drejtorisë së Punëve të Brendshme të Beratit dhe aty gjendeshin 6 kabina të mbetura nga koha e pushtimit italian, të cilat u përshtatën si vendbanime për të internuarit<sup>16</sup>. Në kampin e Tepelenës ishin strehuar familjet e politikanëve shqiptarë të cilët kishin qenë pjesë e administratave të pushtimit gjatë Luftës, krerëve të Ballit Kombëtar dhe Legalitetit, krerëve të Dibrës të tillë si: Gjonmarkaj, Kazazi, Bajraktari, Mirakaj, Kola, Kaloshi, Dine, Previzi, Kupi, Merlikaj, Petrela, Blloshmi, Mulleti, Biçaku etj. Kampi i Tepelenës u drejtua nga dy komandantë: Bektash Pogaçe (1949 -1952) dhe Haki Ibrahim (1952-1953), të dy me arsimim të papërfunduar<sup>17</sup>. Lek Previzi një i internuar në kampin e Beratit dhe më pas në Turhan dhe Tepelenë kujton: “*Propozimi [për transferimin e të burgosurve në Tepelenë] vinte nga Manush Myftiu, një shpirt kriminal. Ky, në konferencën e Beratit kishte propozuar se të gjithë kundërshtarët e armiqtë e tyre, të vriteshin, nga mosha 12 vjeç e lart. Sa që dhe vetë Enveri ishte çudit. Si u vendos transferimi nga Berati, në maj 1948, të internuarit të ngarkuar në 38 kamionë të ushtrisë, nisën natën rrugës së keqe malore të grykës së Këlcyrës, që llogaritën të kenë qenë mbi 2500 vetë. Por ç’ndodhi? Në një kthesë të keqe një kamion përmbysset dhe aty vdesin burrë e grue çifti Petrela, që i hedhin foshnjët që mbanin, të cilët shpëtojnë mrekullisht. Pati dhe disa të plagosur e të sakatuar. Kamionët arritën*

<sup>14</sup> Në të vërtetë, shumë studime mendojnë se Perëndimi synonte t’i mbante nën presion qeveritë komuniste të Evropës Lindore, në mënyrë që të pengonte përhapjen e ideologjisë komuniste në shtetet perëndimore si p.sh. Itali dhe Francë.

<sup>15</sup> Burimet dokumentare flasin për kushte tejet të vështira ekonomike, veçanërisht në krahinat e veriut, të cilat ishin përballë një krize të vërtetë urie.

<sup>16</sup> Kastriot Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë Komuniste*, Tiranë: ISKPK, 2016, f. 17.

<sup>17</sup> *Po aty*, f. 18.



*në Tepelenë, dhe s'u ndalën aty, kaluan tutje, deri në Turan, Veliçot e Memaliaj, ku i shkarkuan si t'ishin thasë me patate*"<sup>18</sup>.

Kampi i Tepelenës vazhdoi të ishte një vend i rrethuar me tela me gjemba, në të cilin të internuarit kontrolloheshin nga ushtarë të armatosur. Sipas studiuesit Kastriot Dervishi, i cili ka dhënë një panoramë shumë të plotë mbi burgjet dhe kampet e internimit në Shqipërinë Komuniste, gjatë viteve 1949-1953, në Tepelenë u vendosën gjatë viteve 1950-1952 kanë qenë të internuar nga 600 vetë më 1952 deri në 1405 vetë në gusht 1950: burra, gra, të moshuar dhe fëmijë<sup>19</sup>. Tepelena nuk ishte i vetmi vend internimi në Shqipëri. Kampe të tjera ishin dhe ai i Porto Palermos (1949-1951), ai i Kuçit të Kurveleshit etj. Por, kampi i Turanit dhe ai Tepelenës janë dy kampet të cilat mbeten të pashlyera në kujtesën e atyre që patën fatkeqësinë për të jetuar në të. Turani dhe Tepelena mbahen mend për kushtet tejet të vështira të jetesës dhe mungesën e theksuar të ushqimit, për mungesën e theksuar të higjienës, për punën tejet të rëndë që burrat, gratë dhe fëmijët mbi moshën 12 vjeç ishin të detyruar të zhvillonin, si dhe për fëmijët që humbën jetën nga sëmundjet apo nga minat e mbetura nga koha e Luftës së Dytë Botërore dhe që rrethonin territorin e kampit.

Humbja e jetëve njerëzore, veçanërisht të fëmijëve është ajo që e bën kampin e Tepelenës një vend të veçantë kujtimi dhe reflektimi. Ndonëse hulumtimi në dokumentet arkivore nuk është ende i thelluar dhe ka nevojë për një kërkim të mëtejshëm, ato tregojnë që gjatë viteve 1949-1950, lajmërohet për raste vdekjesh nga dizenteria. Ndërkohë që nga muaji tetor 1950 deri në dhjetor të po atij viti numri i fëmijëve është zvogëluar me 285 vetë. Kjo diferencë kaq e madhe në shifra mund të shpjegohet edhe me një urdhër për të lejuar fëmijët e vegjël të qëndronin tek të afërmit e tyre të cilët nuk ishin të internuar. Ky ndryshim erdhi pas një diskutimi në Byronë Politike të situatës në kampin e Tepelenës dhe të Valiasit. Enver Hoxha pohoi se “nuk është mirë që mbahen fëmijët në kampe përqendrimi” duke shtuar se “atje mund të jenë fëmijët gjer në 2-3 vjeç që kanë nevojë për nënat e tyre”<sup>20</sup>.

Mbi numrin e fëmijëve që humbën jetën në Tepelenë kemi dëshmi të shumta, të cilat jo gjithmonë konvergojnë. Vëmendja e studiuesve duhet të përqendrohet në përcaktimin e saktë të numrit të tyre dhe për këtë duhet ende hulumtim qoftë në burimet dokumentare, të cilat janë shfrytëzuar pjesërisht dhe mbetet ende për t'u hulumtuar pjesa dërrmuese e tyre, ashtu dhe në kryqëzimin e dëshmimeve të të mbijetuarve të kampit të Tepelenës.

<sup>18</sup> <https://kujto.al/si-u-krijuan-e-si-funksionuan-kampet-e-internimit-ne-diktaturen-komuniste-ne-shqiperi/> vizituar më 25.6.2018.

<sup>19</sup> <https://kujto.al/dokumenti-i-1950-kampi-i-tepelenes-dhe-mizorite-mbi-femijet/> vizituar më 24 prill 2018.

<sup>20</sup> *AQSH*, F. 14/AP-organet udhëheqëse (më tej: OU), V. 1950, D. 70, fl. 16. Nga fjala e Enver Hoxhës në mbledhjen e Byrosë Politike, 22 nëntor 1950.

Lekë Previzi e kujton kështu jetën në Tepelenë: “*të internuarit e Tepelenës, gra e burra ishin kthyer në kafshë bartëse me peshë të renda, si dru, shtylla trungje, pllaka guri etj. Për të plotësuar këtë tregim dëshmuës, me vrasjen e Bardhok Bibës në gushtin 1949, Tepelenës iu shtuen 500 familje mirditore që përbanin 2500 vetë, pleq, gra e fëmijë, që u shtuen problemet dhe vdekjet i përfshinë edhe ata, kryesisht në fëmijë. Me ardhjen e mirditorëve, të internuarit arritën në rreth 5000. Për mungesë vendi në katër gazermat me shtretër, ata u strehuan në dy gazerma boshe pa skele druri, drejt në çimento. Në nëntor 1951 pati një lirim fëmijsh, të paktë, sepse familjet s’kishin ku me i çue. Por, me këtë rast u liruen një pjesë e mirditorve, dhe disa burra. Kështu që u lirua vend dhe të gjithë të internuarit u mblodhën në katër gazermat me skele druri. Nuk pati më internime masive. Por herë pas here binin ndonjë familje dhe individë. Filluan të bien të burgosur që kishin mbaruar dënimin, dhe këta ishin klerikë katolikë, dhe disa intelektualë shkodranë. Në verë 1952, sollën nga Tirana dhjetra familje dhe burra, me pretekste të ndryshme<sup>21</sup>”. Një tjetër dëshmi e dhimbshme është dhe ajo e Gjelë Gjokolës, e cila humbi vajzën e saj në Tepelenë. Vajza kishte lindur ditën që bashkëshorti i Gjelës, së bashku me vëllain e tij dhe 60 malësorë ishin arratisur në Jugosllavi. Gjelën dhe kunatën e saj e kishin arrestuar. Kunata kishte lindur fëmijën rrugës. Të dyja gratë fatkeqe, së bashku me fëmijët e porsalindur i kishin mbajtur katër muaj në hetuesi dhe më pas i kishin internuar në Tepelenë. Gjela kujton: “Erdhi [Beqir Balluku](#). Bani apelin. Qemë 3 mijë vetë, u bëmë 6 mijë vetë. U internuan edhe 3 mijë vetë të tjerë. I sollën atje... Nuk e di, se si jam gjallë sot pra, merr vesht a jo! Tepelena ishte: gjethe lisi hanim, lende, hithna ... I zinim e i hanim. E kemi jetue e kemi ardh ne ship ... Na jepshin vetëm dy lek bukë sa me rru gjallë, si sot deri nesër në këtë vakt. Ata na jipshin vetëm ndoi groshë, n’ ata fuçiat me naft qe s’hahej. Ishim popull shumë, ishim 6 mijë vetë.*

*Pale, pale, pale...në Tepelenë! Ah Tepelena, çfarë maj mend unë! Sa njerëz kanë vdek atje, shpresë na m’zotin! E kot. Tre mijë vetë kane ardhë kot, se kanë vra Bardhok Bibën. Ishim 3 mijë vetë, u bamë 6 mijë dhe ... U pre buka mrapa, u pre buka, u pre ushqimi, vetëm t’u varros njerëz përditë, për ditë. Se harroj kurrë. Nji e kishte vra (Bardhok Bibën) se kishte vra gjithë Mirdita! I internuan gjithë Mirditën. Vinin makinat me të internum, pa fund. Fmijët krejt t’u vdek Se mban mend historia! O sa fmi kane vdek atje... Malsija e Shkodrës u kanë vdek kalamaj shumë. Nji shkodrane quhej Tereza, tre mbesa i vdiqën prej tifos si vajzat tona: 14 vjeç, 12*

<sup>21</sup> <https://kujto.al/si-u-krijuan-e-si-funksionuan-kampet-e-internimit-ne-diktaturen-komuniste-ne-shqiperi/> vizituar më 25.6.2018.

vjeç, 6 vjeç. Tre mbesat i ka lane vdek e asht liru përnjiherë me mu, e s'ka pas kënd, me fut në shpi". Nata kur Dila, tre vjeç, dha shpirt duke lyp ujë ..."<sup>22</sup>

Disa studiues mendojnë se ishte pikërisht vdekshmëria e lartë e fëmijëve në kampin e Tepelenës dhe nevoja për të konsoliduar sistemin e internim-dëbimeve, që i detyroi drejtuesit e lartë komunistë të marrin vendimin në fund të vitit 1953 për ta mbyllur kampin e Tepelenës dhe në përgjithësi kampet e rrethuara me tela me gjemba.

### ***Jetesa në burgje dhe puna e detyruar në kampet e vendosura pranë tyre***

Në bazë të dokumenteve të shfletuara deri tani në arkivat e Ministrisë së Brendshme dhe të KQ të PKSH/PPSH, numri i personave të arrestuar, veçanërisht në vitet 1945-1947 ishte i konsiderueshëm<sup>23</sup>. Burgjet ekzistuese në vitin 1944 ishin tërësisht të pamjaftueshme për të përballuar arrestimet e të gjitha kategorive të sipërpërmendura. Qeveria e drejtuar nga Enver Hoxha përdori shtëpitë private dhe institucionet e tjera publike, si qendra paraburgimi dhe torture. Në vitet 1944-1946 burgjet politike vareshin nga Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit, asokohe strukturë operative e Ministrisë së Mbrojtjes. Në vitin 1947 të gjitha burgjet kaluan nën kontrollin e Ministrisë së Brendshme që ishte përgjegjëse për sigurinë e brendshme, ndërsa perimetrat e jashtëm kontrolloheshin nga ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, duke bërë kujdes të zgjidheshin ata më besnikët<sup>24</sup>. Tetë burgjet ekzistuese të periudhës para Luftës së Dytë Botërore iu rezervuan të burgosurve politikë të cilët përcaktoheshin si "armiq të popullit", shtatë burgje të burgosurve të përcaktuar si "ordinerë" dhe tre burgje ishin të përziera. Gjatë kësaj periudhe, krahas burgjeve filluan të funksiononin kampet e punës për të burgosurit<sup>25</sup>. Kampet e punës ishin vende ku dënimi kryej duke bërë punë të detyruar si në bonifikim, ndërtime veprash publike, nxjerrje minerale, bujqësi etj. Ato ndërtoheshin shpeshherë pranë vendit ku të burgosurit duhet të punonin. Kampet e tilla kanë qenë të përkohshme (të ndërtuara me çadra apo baraka, të rrethuar nga tela me gjemba dhe rreptësisht të kontrolluara nga ushtarë të armatosur), ndërsa në raste të tjera ishin të vendosura në formë të përhershme, sidomos afër minierave.

Të gjithë të burgosurit politikë detyroheshin të punonin në këto kampe pune. Kampet e para të punës për të burgosurit ishin ato të Jubës, afër Durrësit (1946); ai i Maliqit, afër Korçës (1946); Bedenit dhe Lekajt, afër Kavajës (1948), Valshuk, Berat (1948) e shumë të tjerë.

<sup>22</sup> <https://kujto.al/gjele-gjikola-ne-kampin-e-tepelenes-lashe-shpirtin/> vizituar më 24 qershor 2018.

<sup>23</sup> Për të përcaktuar numrin e saktë të arrestimeve dhe dënimeve të kësaj periudhe do të duhej një studim më i thelluar.

<sup>24</sup> K. Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë Komuniste...*, f. 79.

<sup>25</sup> *Po aty*.

Karakteristikat e kampeve të punës kishin edhe vendet e internimit gjatë kësaj periudhe. Të gjithë të internuarit, pavarësisht nëse ishin burra, gra, të moshuar apo fëmijë, jetonin në vende të rrethuara me tela me gjemba dhe detyroheshin të punonin në punë tejet të rënda. Kampe të tilla pune për të internuarit kishte në Tiranë, Tepelenë, Cërrik etj.

Gjatë viteve 1951-1990 regjimi krijoi mekanizma për të vijuar luftën e klasave dhe diktaturën e proletariatit si e vetmja mënyrë për të mbajtur në këmbë regjimin. Represioni u bë më i strukturuar dhe sistematik. Ndërsa deri në vitin 1949, ende nuk ishin formalizuar me anë të ligjeve dhe vendimeve organizimi i jetës në burgje dhe vende internimi, tanimë sistemi bëhet më solid dhe i bazuar mbi një bazë të qartë ligjore. Nga hulumtimet paraprake që zhvilluam në arkiva rezulton se ka ende dokumente të pazbuluara që japin dëshmi mbi jetën e të burgosurve dhe të internuarve gjatë kësaj periudhe. Kështu, në Fondin e Këshillit të Ministrave në Arkivin Qendror Shtetëror gjenden një numër dokumentesh që i referohen normave ushqimore të të burgosurve dhe të internuarve, si dhe modalitetet e pagesës së tyre. Ndonëse kërkimi ka nevojë për thellime të mëtejshme, rezulton se jeta e të burgosurve ishte tejet e vështirë edhe për sytë e drejtuesve të lartë komunistë. Të burgosurit që punonin nëpër kampe pune, shpërbleheshin në bazë të realizimit të normës. Por shpërblimi nga puna e tyre derdhej në masën 85% në buxhetin e shtetit dhe vetëm 15% derdhej në buxhetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe do të përfitohej nga të burgosurit, por edhe kjo jo në vlerë monetare, por për veshmbathje e pajisje pune<sup>26</sup>. Në vitin 1950 ka një ulje të normës ushqimore të të burgosurve në burgje dhe kampe pune. Sipas dokumenteve të fondit të Këshillit të Ministrave që gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit, kaloritë e të burgosurve politikë që nuk punonin u caktuan të ishin 1803 në ditë, ndërsa për të burgosurit në kampe pune do të merrnin 2347 kalori në ditë. Kaloritë më së shumti do të vinin nga buka (900 g), oriz, makarona dhe vetëm 100 g mish<sup>27</sup>.

Me kalimin e viteve regjimi hapi burgje të reja në të gjitha qendrat kryesore, duke dalluar gjithmonë ato të rezervuara për të burgosurit politikë nga burgjet e destinuara për të burgosurit ordinerë. Qëllimi zyrtar i paraburgimit për të burgosurit politikë ishte “riedukimi dhe rehabilitimi” nëpërmjet vuajtjes dhe punës, kështu që, përveç burgjeve (që ishin të izoluara e të rrethuara me tela me gjemba dhe me ushtarë, brenda të cilave të burgosurit vuanin dënimin e tyre pa punuar), regjimi filloi ndërtimin e kampeve të punës. Vetëm dy burgje në Shqipërinë komuniste nuk përdoreshin si kampe pune, ndërsa të gjithë të tjerat kishin edhe këtë funksion.

---

<sup>26</sup> *AQSH*, F. 490/Këshilli i Ministrave, V. 1953, D. 1093, fl. 4. Relacion i ministrit të Punëve të Brendshme, Mehmet Shehu paraqitur Këshillit të Ministrave në lidhje me projekt-dekretin, mbi shpërblimin e të burgosurve që punojnë në ndërmarrje dhe ente shtetërore, 12 qershor 1953.

<sup>27</sup> *AQSH*, F. 490/Këshilli i Ministrave, V. 1950, D. 704, fl. 21. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 657, datë 21.8.1950 mbi racionet e ushqimit për personelin e MPB dhe të burgosurit e të internuarit.

Pothuajse të gjithë të burgosurit që ishin në gjendje të punonin caktoheshin në këto kampe dhe, me kalimin e viteve, numri i kampeve të punës tejkaloi atë të burgjeve. Punimet publike më të mëdha në Shqipëri, gjatë viteve të komunizmit, janë realizuar nëpërmjet punës së detyruar të të burgosurve (si të burgosur politikë ashtu dhe ordinerë) dhe të të internuarve, të cilët ishin të detyruar të punonin në këto vepra edhe për të mirëmbajtur veten.

Edhe në këtë periudhë pjesa më e madhe e burgjeve ishte konceptuar si kamp pune, në të cilat kushtet e jetesës ishin shumë të vështira. Në fillim të viteve '50, veçanërisht pas vdekjes së Stalinit, vërehet një lloj ndryshimi në drejtim të përmirësimit të jetesës të së burgosurve. Më 10 nëntor 1953 u diskutua një projektdekret mbi shpërblimin e të burgosurve të cilët punonin në ndërmarrje dhe ente shtetërore. Ndryshe nga perioda e mëparshme, të burgosurit do të paguheshin në bazë të plotësimit të normës. Tashmë të burgosurit do të merrnin 35% të pagesës së tyre në formë veshmbathjesh apo vegla pune dhe kampet, me kalimin e kohës, do të trajtoheshin si pjesë e sistemit të hozrashotit<sup>28</sup>. Sipas relacionit të paraqitur nga ministri i Punëve të Brendshme, nga ky ligj ishin lënë jashtë të internuarit, pasi ata ishin dënuar administrativisht. “Të internuarit do të vendoseshin në punë të ndryshme dhe nuk do t’u ndahet (jepet) asgjë nga të ardhurat e punës së tyre, por me këto do të sigurojnë mjetet e jetesës. Këtyre të internuarve nuk do t’u paguhet asgjë nga shteti, ndërsa atyre që nuk janë në gjendje pune do t’u sigurohet ushqimi, veshmbathja dhe teshat e fjetjes si gjer më sot”<sup>29</sup>.

Një përmirësim vërehet dhe në racionet e ushqimit që u jepeshin të burgosurve që punonin. Sipas relacionit që shoqëronte Vendimin e Këshillit të Ministrave mbi normat e ushqimit të të burgosurve që punonin në ndërmarrje dhe ente shtetërore, thuhet se deri më 1954 normat e ushqimit të të burgosurve ishin pakësuar me gati 50% dhe, si rezultat, rendimenti i tyre i punës kishte pësuar një rënie të ndjeshme. Vërehej keqësim i gjendjes së tyre shëndetësore dhe rritje e numrit të të sëmurëve<sup>30</sup>. Sipas këtij vendimi, të burgosurit do të trajtoheshin si më poshtë:

Bukë	900 g/ditë
Koloniale (?)	120 g/ditë
Mish	100 g/ditë

<sup>28</sup> *AQSH*, F. 490/Këshilli i Ministrave, V. 1953, D. 231, fl. 1. Relacion i ministrit të Punëve të Brendshme, Mehmet Shehu për Këshillin e Ministrave mbi shpërblimin e të burgosurve që punojnë në ndërmarrje dhe ente shtetërore, 10 nëntor 1953.

<sup>29</sup> *AQSH*, F. 490/Këshilli i Ministrave, V. 1953, D. 231, fl. 1. Relacion i ministrit të Punëve të Brendshme, Mehmet Shehu për Këshillin e Ministrave mbi shpërblimin e të burgosurve që punojnë në ndërmarrje dhe ente shtetërore, 10 nëntor 1953.

<sup>30</sup> *AQSH*, F. 490/Këshilli i Ministrave, V. 1954, D. 205. Relacion i ministrit të Punëve të Brendshme, Mehmet Shehu për Këshillin e Ministrave mbi normimin e ushqimit të të burgosurve që punojnë në ndërmarrjet dhe entet shtetërore, 10 prill 1954.

Sheqer	10 g/ditë
Vaj	15 g/ditë
Kripë	15 g/ditë
çaj ose kafe	respektivisht 1 dhe 2 g/ditë <sup>31</sup>

Për të burgosurit që punonin në minierën e Bulqizës norma ushqimore ditore ishte pak më e lartë. Ata, përveç ushqimeve të sipërpërmendura, furnizoheshin me 16g djathë në ditë, 36g marmelatë dhe 7 kokrra vezë në muaj<sup>32</sup>. Mbetet të thellohet studimi mbi normat e punës së këtyre të burgosurve dhe sasisë ditore të ushqimit që konsumohej.

Ndër burgjet e destinuara për "armiqtë e popullit", më famëkeqit janë ata të Burrelit (1946), i cili konsiderohej si një super burg, nga i cili ishte e pamundur të arratisesh dhe në të cilin të burgosurit politikë jetonin në kushte çnjerëzore; Spaçit (1968), i cili mbeti i hapur deri në vitin 1990 dhe shfrytëzonte punën e të burgosurve për nxjerrjen e mineralit të bakrit dhe piritit, në kushte çnjerëzore. Jeta në burgjet komuniste, ashtu si dhe në kampet e punës, ishte shumë e ashpër: të burgosurit politikë, shpesh të akuzuar mbi baza dëshmish të rreme, ose mbi dëshmi të nxjerra përmes torturave nga Sigurimi, nëse nuk dënoheshin me vdekje, shpesh vdisnin për shkak sëmundjesh, urie ose kushtesh të vështira të punës.

Në arkivin e Ministrisë së Brendshme deri në vitin 1990 rezultojnë të dënuar 25 mijë të burgosur politikë, por duke qenë se mungojnë statistikat e të dënuarve të periudhës nga 1945 në 1946 dhe të dënuarve me dënime të vogla, besohet se të burgosurit politikë në Shqipëri kanë qenë mes 30.000 dhe 34.000. Sipas një raporti të publikuar më 2016 nga Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, të burgosurit politikë ishin 26.768 burra dhe 7.367 gra; të burgosurit e vdekur në burg për shkak të kushteve të burgjeve ishin 984, dhe 308 të tjerë humbën aftësinë e tyre mendore. Sipas të njëjtit burim, 5.577 burra dhe 450 gra u dënuan me vdekje dhe u vranë. Trupat e të burgosurve që ekzekutoheshin ose vdisnin në burg gjatë punës së detyruar apo nga sëmundjet, nuk i ktheheshin të afërmeve.

Një raport i Departamentit të Shtetit drejtuar Kombeve të Bashkuara në vitin 1955 shprehet me nota shqetësuese për përdorimin e punës së detyrueshme në burgjet dhe kampet e internimit në Shqipëri. Sipas tij, “puna e detyrueshme përdoret në masë në Shqipëri që kur regjimi i sotmë komunist erdhi në fuqi në Nëntor 1944. Janë botuar një numur ligjesh dhe vendimesh të cilat legalizojnë punën me përdhunë, dhe Kodi Penal i ri Shqiptar që u adoptua në Maj 1952, bazuar në Kodin Penal Sovjetik, bën parashikime me mjeshtëri për “punë

<sup>31</sup> *AQSH*, F. 490/Këshilli i Ministrave, V. 1954, D. 205. Vendimi nr. 61 i Këshillit të Ministrave mbi normimin e ushqimit të të burgosurve që punojnë në ndërmarrjet dhe entet shtetërore, 10 prill 1954.

<sup>32</sup> *Po aty*.

korrektonjëse” dhe internime qytetarësh në kampe koncentrimi dhe pune. Edhe fëmijët që kanë mbërritur moshën 12 vjeç janë të përgjegjshëm kundrejt masave për në kampet “me punë korektonjëse” t’akuzuar për krime kundër shtetit. Në 10 vjetët e fundit nja 40 burgje politike dhe kampe koncentrimi kanë vepruar kohë në kohë, nëpër të cilat kanë kaluar 80.000 burra, gra dhe fëmijë dhe nga të cilët 16.000 kanë humbur. Tash ka të dhëna se nja 10.000 persona po shërbejnë në burgjet politike dhe veç këtyre 10.000 deri 15.000 janë në kampe koncentrimi. Veç atyre të dënuar me punë, ka një numër të madh njerëzish në Shqipëri, sidomos të rinj, të cilët janë të detyruar të bëjnë punë “vullnetare” (aktualisht me detyrim). Gati gjithë projektet industriale dhe ndërtimet rrugore e hekurudhore ndërmarrë nga regjimi i sotmë që më 1944 janë ndërtuar me të dënuar me punë dhe “vullnetarë”.

Veçanërisht pas vitit 1948, në tipologjinë e “armiqve të popullit” filluan gjithmonë dhe më shumë të shtoheshin dhe persona të cilët kishin mbajtur pozicione të rëndësishme drejtuese në strukturën partiake dhe shtetërore të regjimit. Dënime të tilla ndodhnin sa herë regjimit i duhej të përliqte shkëputjen e një aleance më jashtë, apo kur duhet të justifikonte dështimet në politikat e tij ekonomike, kulturore dhe ushtarake. Këto dënime shtonin pasigurinë e përgjithshme dhe frikën e të gjithë popullsisë. Në atë regjim askush nuk ishte i sigurt dhe i paprekshëm.

## **Sabit Syla - Instituti i Historisë, Prishtinë**

### **Vendosja e pushtetit jugosllav në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare (1944 – 1945)**

#### **Abstrakt**

Trajtohet problemi sesi faktori jugosllav, nacionalist dhe komunist bashkohen në qëllimin për ta mbajtur Kosovën brenda Jugosllavisë. Urdhëresa e Shtabit Kryesor të Serbisë, 2 dhjetor 1944: Në Kosovë nisin masakra, ekzekutime, dhunime, burgosje individuale e kolektive; Organizohet qëndresa shqiptare: Brigada e Drenicës, me komandant Shaban Palluzhën, në dhjetor 1944, me afro 3000 luftëtarë; Në janar-shkurt 1945, mobilizohen rreth 36 mijë trupa kundër Drenicës: Brigada I Kosovë - Metohi, në krye Zufer Musiqi, Brigada e Bokelit apo "Bokelska", e 6-ta malazeze, Brigada e KNOJ-it, Brigada IV dhe V të Kosovës, Brigadat serbe e maqedone, edhe Brigadat shqiptare; Me urdhër të Titos, 8 shkurt 1945, vendoset Administrim Ushtarak i Kosovës; Mbytet me gjak qëndresa e Drenicës; Pranverë e përgjakshme e 1945: pushkatohen mijëra vetë; mbi 20 000 burgosen ose futen në kampe, mijëra familje izolohen; mijëra shpërngulen për në Turqi; mbi 6000 veta vriten jashtë kufijve të Kosovës; ndodh një ndër tragjeditë më të mëdha -Tivari.

#### **Hyrje**

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, Kosova dhe viset tjera shqiptare u shndërruan në një poligon të vërtetë të masakrave, ekzekutimeve, dhunimeve, burgosjeve individuale e kolektive nga forcat jugosllave nacionaliste dhe komuniste. Ato harmonizuan planet dhe projektet e tyre, me synim spastrimin etnik të shqiptarëve përmes hakmarrjes kolektive të tipit racial. Dimër dhe pranverë të përgjakshme më 1944/1945, do të përjetojë populli shqiptar. Më 8 shkurt 1945, me urdhrin e Titos, në Kosovë ishte vendosur edhe Administrimi Ushtarak. U pushkatuan mijëra, u futën në burgje e kampe, u shpërngulen, e shumë të tjerë u vranë jashtë kufijve të Kosovës. Tivari që një tragjedi tjetër që u ndodhi shqiptarëve, mbase një ndër tragjeditë më të mëdha të kohës më të re! Nën Administrim Ushtarak u mbajt edhe Sesioni i Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës, i njohur si Kuvendi i Prizrenit, në korrik të vitit 1945, në të cilin u nënshkrua Rezoluta për bashkimin e Kosovës me Serbinë.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Kosova ishte një çështje rreth së cilës bëheshin diferencime e polarizime forcash, madje çështje që përcaktonte orientimin e shtresave e të rrymave të ndryshme politike dhe marrëdhënien e tyre me Koalicionit Antifashist. Ndodhte kështu meqë të dy Blloqet ushtarako-politike ndërluftuese me vizionet e tyre të diferencuar për të ardhmen e shqiptarëve në Ballkan do përcaktonin e orientonin forcat politiko-ushtarake në Shqipëri dhe në Kosovë. Në ato rrethana, problemi i Kosovës do të shndërrohej në një pikë objeksionesh për shqiptarët dhe do të ndikonte në shkallën e rezistencën e tyre në Kosovë dhe në Shqipëri. Si rrjedhojë, çështja e Kosovës ishte problem i vetë shqiptarëve të Kosovës, i



forcave politike dhe ushtarake të Shqipërisë së pushtuar, i forcave politike dhe ushtarake të Jugosllavisë, por edhe i vendimeve të Aleatëve të Mëdhenj<sup>1</sup>. Në këtë punim do trajtojmë vetëm qëndrimin dhe veprimin e forcave jugosllave komuniste dhe nacionaliste.

Planet pushtuese serbe ndaj tokave shqiptare vazhduan edhe gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Mbështetur në të dhënat e deritanishme dokumentare dhe të historiografisë shqiptare e më gjerë, të gjitha projektet dhe idetë serbe për zgjidhjen e çështjes së Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, qofshin ato të hartuara nga komunistët e Titos apo nacionalistët e Drazha Mihailoviçit, ishin në thelb serbe. Ato ndryshonin në metodë dhe në praktikën e realizimit (është e njohur tashmë se platforma e Mihailoviçit ishte më ekstreme).

Shtabi Komandues i radhëve çetnike të ushtrisë jugosllave i kryesuar nga Drazha Mihailoviçi, më 20 dhjetor të vitit 1941, hartoi platformën e programit të saj që shpallte: “Krijimin e Jugosllavisë së madhe dhe në të, të Serbisë së madhe, etnikisht të pastër në kufijtë e Serbisë e të Malit Zi, të Bosnje e Hercegovinës, të Sremit, Banatit e Baçkës. Spastrimi i territorit shtetëror nga të gjitha pakicat kombëtare dhe elementet jo nacionale”<sup>2</sup>. Me synimet e tyre të inkurajimit për mundësitë e kthimit në idetë e vjetra mbi Serbinë e Madhe, këta nacionalistë parashikonin që në territorin e shtetit të tyre të ardhshëm të jetonin vetëm serbët, kroatët dhe sllovenët. Pakica kombëtare nuk mund të kishte, prandaj shqiptarët duhej të shfaroseshin e trojet e tyre etnike të gllabëroheshin. Mbështetur në programet dhe veprimet e tyre, jo vetëm që e shihnin Kosovën si jugosllave, por shqiptarët duheshin masakruar dhe dëbuar për të arritur shkombëtarizimi i trojeve të tyre. Në një nga elaboratet e përgatitura në atë kohë, “Krahina e Kosovës dhe e Rrafshit të Dukagjinit”, midis të tjerave thuhej: “Kosova ka qenë serbe dhe ajo do të mbetet patjetër serbe, jo vetëm për nga pozita shtetërore juridike, por edhe nga struktura e popullsisë së vet, e cila duhet të jetë me shumicë serbe”<sup>3</sup>. Kësaj platforme i shkonin për shtat edhe elaboratet e Ivo Andriçit dhe Vasa Çubrolloviçit, që “çështja e Kosovës të zgjidhej me dëbime masive të spastrimit etnik të territorit ..., e që shteti serb të shndërrohej në shtet të pastër etnik”<sup>4</sup>.

Tito, që herët gjatë luftës kishte rishpallur rishtazi Jugosllavinë e mëparshme, duke e quajtur atë federative, çka nënkuptonte brenda rrethit të saj edhe Kosovën. Komunistët

<sup>1</sup> Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2017, f. 28-29.

<sup>2</sup> *Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës* (më tej: ASHAK), Fondi (më tej: F.) Komiteti Krahinor i LK të Kosovës, Viti (më tej: V.) 1941, Kutia (më tej: K.) 5, Dokumenti (më tej: dok.). 2031, Fleta (më tej: fl.) 1-3. Platformë e Programit të Shtabit Komandues të radhëve çetnike të ushtrisë jugosllave, dhjetor 1941.

<sup>3</sup> Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore 1941-45*, Prishtinë: Dukagjini, 1997, f. 38.

<sup>4</sup> Izber Hoti, Synimet dhe sendërtimet çetnike e partizane për shpërnguljen dhe shfarosjen e shqiptarëve, *Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-1995)*, Prishtinë: 1997; Kristaq Prifti e të tjerë, *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë: “8 Nëntori”, 1990, f. 546-555.

jugosllavë nëpërmjet demagogjisë marksiste të gjoja vëllazërimit të popujve, u premtuan shqiptarëve të drejtat e tyre kombëtare, duke u rreshtuar përkrah tyre dhe Aleatëve të Kombeve të Bashkuara. Por, mbështetur mbi bazën e vendimeve të miratuara të kohës, realiteti ishte ndryshe. Në vendimet e Mbledhjes së Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë (KANÇJ, në serbo-kroatisht: Antifašističko veče narodnog oslobodjenja (AVNOJ-it) në Jajcë të Bosnjës, në nëntor të vitit 1943, nuk u përmend Kosova në mënyrë të drejtpërdrejtë. Aty, në mënyrë indirekte, flitej për garantimin e të drejtave të pakicave nacionale në Jugosllavi<sup>5</sup>. Në këtë mbledhje Këshilli u shndërrua në një asamble të vërtetë parlamentare, të përbërë nga 67 anëtarë, që përfaqësonin popujt e ndryshëm jugosllavë e që u vesh me pushtet legjislativ e administrativ. Asambleja vendosi për krijimin e Jugosllavisë Federative<sup>6</sup>. Edhe në bisedimet e zhvilluara për organizimin e shtetit të ri jugosllav në ishullin e Visit, në verën e vitit 1944 Tito, Edvard Kardeli dhe Vladimir Bakariqi, pranuan që Kosova do të bëhej një provincë autonome, pra, që ajo të ishte pjesë integrale e detyrueshme e Jugosllavisë<sup>7</sup>.

Mbreti i Jugosllavisë, Petri II, i cili kryesonte Qeverinë e Emigracionit në Kajro, përmes një mesazhi të përhapur në radio, më 26 gusht 1944, iu kërkoi nënshtetasve të tij, që të bashkoheshin me Ushtrinë e Çlirimit dhe e njohu Titon si kryetar të të gjitha forcave luftuese në Jugosllavi<sup>8</sup>. Ndërkaq, zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Qeverisë Mbretërore në emigracion, Stojan Gavriloviqi, në shtator të vitit 1944, gjatë kohës që një delegacion bullgar i paqes zhvillonte bisedime me Aleatët në Kajro të Egjiptit, lidhur me çështjen e pretendimeve të Shqipërisë ndaj Kosovës, do t'i pohonte një oficeri amerikan të zbulimit se “për ta dorëzuar atë, do të duhej një tjetër 28 qershor i vitit 1389 ..., serbët më lehtë do të linin Beogradin sesa Kosovën”<sup>9</sup>. Edhe Miladin Popoviçi, i njohur si “revolucionar e mik i madh i shqiptarëve”, për zgjidhjen e çështjes së Kosovës nuk i tejkalonte kornizat e përcaktuara nga Titoja. Më 30 nëntor 1944, ai udhëzonte të gjithë ndihmëskomisarët politikë, që përmes njësave ushtarake të fillonin spastrimin e Kosovës nga bandat reaksionare, ekzistenca e të cilave, sipas tij, pengonte Luftën Nacionalçlirimtare dhe forcimin e pushtetit popullor. Lidhur me këtë, u tërhoqte vëmendjen anëtarëve të partisë, duke u shprehur: “Nëpër të gjitha katundet ku do të kalojnë njësitet tona,

<sup>5</sup> Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë: Rilindja, 1971, f. 459.

<sup>6</sup> Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, Prishtinë: Gutenberg, 1997, f. 477.

<sup>7</sup> Ky koncept i udhëheqjes jugosllave iu bë i qartë, në mesin e gushtit të vitit 1944 edhe një delegacioni shqiptar pas takimit të zhvilluar ndërmjet Ramadan Çitakut e Bedri Spahiut dhe udhëheqjes komuniste jugosllave. Tito i deklaroi delegacionit shqiptar se: “... as që mund të mendohej që Jugosllavia e re do të humbte territore; se Kosmeti do të ishte pjesë integrale e detyrueshme e Jugosllavisë”. *Shih*: Lefter Nasi, “Presioni i PKJ dhe braktisja e problemit kombëtar nga PKSH 1943-1945”, në: *Kosova*, nr. 29/30, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2008, f. 277.

<sup>8</sup> G. Castellan, *Histori e Ballkanit...*, f. 488.

<sup>9</sup> Ethem Çeku, *Kosova në sfondin e diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945-1981*, Prishtinë: Dukagjini, 2008, f. 41.

patjetër duhet të mbahen konferenca mbi misionin çlirues të ushtrisë sonë krijuese kundër okupatorit, dhe si simbol i vëllazërimit e bashkimit të popujve tonë, e cila do të sjellë çlirimin e të gjithë popujve, pra edhe të popullit shqiptar të Kosovës e Metohisë, të cilët për të fituar të drejtën me vendosë mbi fatin e tyre, të hidhen në masë në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të luftojnë kundër tradhtarëve të vet e të ndihmojnë UNÇ-në dhe pushtetin popullor për formimin e shtetit të ri - Jugosllavisë Demokratike Federative”<sup>10</sup>.

Qëndrimi i faktorëve jugosllavë, qofshin nacionalistë apo komunistë, ndaj Kosovës ishte i njëjtë: ata të ardhmen e Kosovës e shihnin brenda shtetit jugosllav dhe për këtë harmonizuan planet dhe projektet e tyre të përbashkëta. Kjo platformë politiko-ushtarake u bë më radikale sidomos nga fundi i luftës, kur forcat e përbashkëta çetnike-partizane iu vërsulën Kosovës me synim e qëllim të vetëm, pastrimin e Kosovës nga elementi josllav, pra etnik shqiptar, përmes hakmarrjes kolektive të tipit racial<sup>11</sup>. Në fundin e vitit 1944, dhuna e terrori i ushtruar ndaj shqiptarëve nga pushteti ushtarak serb u bë krahas me masakrat më çnjerëzore, duke u mbështetur në spastrimin nga “bandat shqiptare” e nga “njësitet e armatosura prej tradhtarëve shqiptarë”. Kjo nuk do të thotë se më parë nuk kishin ndodhur krime e masakra të llojeve të ndryshme. Kështu, në janar të vitit 1943, forcat çetnike serbo-malazeze të Mihailoviçit, iu vërsulen si të tërbuara popullsisë shqiptare në Kosovë e në Mal të Zi. Sipas një dokumenti<sup>12</sup>, ata vranë rreth 4 000 veta, ndër të cilët 2 083 fëmijë dhe 797 gra dhe dogjën 1 763 shtëpi e plaçkiten çdo gjë. Duke bërë fjalë për djegien e 49 katundeve të Bjellopoljes, në një deklaratë zyrtare të firmosur nga funksionarë të aparatit shtetëror shqiptar të atëhershëm, thuhej: “Shumica e viktimave janë fëmijë dhe gra të djegur në zjarr, të therur me thikë e çdo lloj masakrimi tjetër, që s’mund ta lejojë në asnjë mënyrë humaniteti. Sot veç fakteve që u kanë ardhur dhe që i kemi parë vetë me sy, po të shkosh në zonën e atakuar, gjen krye fëmijësh dhe grash, këmbë e të tjera pjesë trupash”<sup>13</sup>.

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore në koordinim të përbashkët të forcave serbe, malazeze, maqedonase, bullgare do të shtohet dhuna e terrori ndaj shqiptarëve. Sipas gazetës “Zëri i Popullit”, Jugosllavia akoma nuk ishte çliruar, kur në fshatrat dhe qytetet shqiptare nisën ndjekjet. Kjo ndodhi, së pari në viset shqiptare në Maqedoni në vjeshtën e vitit 1944, në fshatra,

---

<sup>10</sup> ASHAK, F. Komiteti Krahinor i L. K. të Kosovës, V. 1944, K. 10, dok. nr. 1281, fl. 1-2. Komiteti Qarkor i Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Kosovë e Metohi, Miladin Popoviçi.

<sup>11</sup> Izber Hoti, *Qëndrimi i Partisë Komuniste të Jugosllavisë ndaj çështjes së Kosovës 1919-1945*, Bujku 02. 02. 1995; M. Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë...*, f. 52-53.

<sup>12</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë* (më tej: AMPJ), V. 1960, Dosja (më tej: D.) 530/2, fl. 61-62. Të dhëna të ndryshme lidhur me qëndrimin marksist-leninist të PKSH-së gjatë luftës e në vazhdim ndaj Kosovës.

<sup>13</sup> *Po aty*.

me pushkatime njerëzish në masë, gjer në arrestimin e 10 000 vetëve në Tetovë dhe me pushkatimin pa gjyq të mbi 1 200 prej tyre, përveç të vdekurve të shumtë në burg ..., fshatarët e pafajshëm u pushkatuan rrugëve, u dogjën në zjarre, u infektuan me qëllim me mikrobe sëmundjesh, si tifo ekzantematike, aq sa në fshatra e qytete shqiptare të Maqedonisë, në ditët e nëntorit, dëgjoheshin veç ofshe e vaje<sup>14</sup>.

Sjelljet çnjerëzore të njërive komuniste jugosllave-maqedonase detyruan popullsinë e pambrojtur shqiptare t'i lëshojnë vatrat e tyre për t'u vendosur në vende më të sigurta. Shtabi i Brigadës XVII maqedonase, më 16 nëntor, njoftonte se në fshatrat Strimë, Riovicë, Gllazhnjë, Goshincë, Dumanocë dhe Izvor, qëndronin rreth 10 000 shqiptarë të arratisur nga fshatrat Nagushtak, Vishticë, Ropalcë, Mateçë, Hotël, Likovë, Orizare dhe Sllupçan, kurse pjesa tjetër, si Llojan, Vaksincë, Miratoc, gjeti strehimin në Shurdhan etj<sup>15</sup>. Një ngjarje tjetër që tronditi thellë opinionin e gjerë shqiptar ishte masakra e kryer në fshatin Bllacë të Shkupit, më 18 nëntor 1944, nga ana e Brigadës XVI, ku nga të dhënat tashmë të konfirmuara, u masakruan 210 burra të këtij fshati<sup>16</sup>. Pas ngjarjeve tragjike që ndërmorën brigadat partizane bullgaro-serbo-maqedonase në vendbanimet shqiptare, si në Sopot, Kumanovë, Bllacë të Shkupit, Strugë, Gostivar, Kërçovë, Tetovë etj., ato depërtuan edhe në territorin e sotëm të Kosovës dhe të Preshevës. Shtabi i Përgjithshëm i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë për Maqedoninë urdhëronte Shtabin e Divizionit të Kumanovës që me brigadat e veta, më 28 nëntor, të kryente një aksion të përgjithshëm mbi fshatrat shqiptare të Kaçanikut, Ferizajt, Vitisë, Gjilanit, Kumanovës dhe të Preshevës. Në urdhëresë vihej në dukje që “gjatë marshimit ose luftimeve në qoftë se haset ndonjë rezistencë armiqësore” të gjithë ata shqiptarë “të ekzekutohen aty për aty”, si dhe të kryhen kontrole të detajuara “në të gjitha ato vendbanime ku do të depërtoni, ndërsa të arrestohen të gjithë meshkujt nga mosha 16 deri 50 vjeç dhe t'i vendosni nëpër llogore dhe t'i koncentroni në territoret e brigadave tuaja ...”<sup>17</sup>. Për rrjedhojë, më 29 nëntor, në orët e hershme të mëngjesit brigadat e Divizionit të Kumanovës dhe të Divizionit të 42-të, marshuan në vendbanimet shqiptare. Brigada XII hyri në fshatrat Kurbali, Mjak, Brezë, ndërsa Brigada XVI dhe Brigada XVIII marshoi nga Ferizaj në drejtim të Vitisë. Gjatë këtij marshimi, nën pretekstin e çarmatosjes së popullatës dhe të shtypjes së “reaksionit”, u vranë e masakruan

---

<sup>14</sup> “Politika nacional-shoviniste e revizionistëve jugosllavë kundër shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi”, *Zëri i Popullit*, 9 shtator 1958, nr. 217 (3118), f. 4.

<sup>15</sup> Qerim Lita, “Rrethanat politike e ushtarake në trevat verilindore shqiptare, nëntor 1944-nëntor 1945”, në: *Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës 1944/1945*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2016, f. 222-224.

<sup>16</sup> *Po aty*.

<sup>17</sup> Qerim Lita, *Tokat e liruara*, Përmbledhje dokumentesh, vëllimi III, Shkup-Prishtinë-Tiranë: Logos-A, 2016, dok. nr. 561, f. 298-304.

qindra banorë shqiptarë, mijëra të tjerë u arrestuan, duke i futur në kampet e përqendrimit, nëpër kazermat ushtarake e lokalitete të tjera. Nga të dhënat që i ofronte Divizioni i Kumanovës, numri i të vrarëve ishte mbi 200, mijëra të tjerë ishin arrestuar, si dhe ishin djegur dhe plaçkitur shumë fshatra shqiptare<sup>18</sup>.

Një masakër e ngjashme si ajo e Bllacës, u krye në fshatin Izvor nga Brigada XVII Maqedone. Ngjarja tragjike ndodhi më 29 nëntor pas një marrëveshjeje paraprake midis parisë së fshatit dhe Shtabit të kësaj brigade, një batalion u fut në fshat. Me pretekst se fshatarët e Izvorit, paskan “përgatitur një atentat” ndaj Shtabit të këtij batalioni, u arrestuan të gjithë meshkujt e fshatit (44 veta) dhe që të gjithë përnjëherë u ekzekutuan. Njëkohësisht i vunë zjarrin fshatit<sup>19</sup>.

Edhe në pjesët e tjera të Kosovës pati dhunë, terror e masakra të llojeve të ndryshme si në Llap, Shalë, Gallup, Prishtinë, Drenicë, Vushtrri, Mitrovicë, Istog e vende të tjera. Duhet vënë në dukje fakti se këto brigada kudo kishin hasur në rezistencë të fortë të forcave vullnetare shqiptare, si p.sh. në luftimet e zhvilluara në Përmalinë të Llapit dhe në Shalë, ku Divizionit 24 serb iu kundërvunë formacionet vullnetare shqiptare: Brigada e Ukshin Kovaçicës, Batalioni “Hasan Prishtina” dhe një grup luftëtarësh me Aziz Zhilivodën në krye. Luftëra të përgjakshme u zhvilluan edhe në Kaçanoll dhe Dobratin, në Shalë dhe Gallup, ku në krye të forcave shqiptare qëndronte Ahmet Selaci<sup>20</sup>.

Në Drenicë (dhjetor të vitit 1944) ishte formuar Brigada e Drenicës, me komandant Shaban Polluzhën. Në janar-shkurt të vitit 1945, kjo Brigadë luftoi kundra Brigadës I të Kosovës dhe Metohisë të komanduar nga Zufer Musiqi; Brigadës së Bokelit, të njohur me emrin famëkeq “Bokelska”; Brigadës VI malazeze; Brigadave IV dhe V të Kosovës si dhe kundër KNOJ-it (Korpusi Narodne Odbrane Jugosllavije - Korpusi i Mbrojtjes Popullore të Jugosllavisë). E tërë kjo forcë ushtarake, e cila kishte rrethuar shqiptarët përbëhej nga afro 36 000 ushtarë. Në këtë luftë për vetëm 28 ditë u vranë dhe u plagosën rreth 430 luftëtarë nga Drenica, u dogjën dhe u plaçkitën 450 shtëpi, iu konfiskua gjithë ushqimi e gjëja e gjallë 6 000 banorëve të Vushtrrisë e të Mitrovicës me rrethinë. Sipas të dhënave të Komandantit të Administratës Ushtarake, Sava Dërljeviç, ishin mbi 40 000 luftëtarë të huaj<sup>21</sup>.

---

<sup>18</sup> *Po aty*, dok. nr. 571, f. 318-321.

<sup>19</sup> *Po aty*.

<sup>20</sup> Asllan Istrefi, *Ahmet Selaci - Komandant i Divizionit “Ibri” i Ushtrisë Nacional-Demokratike Shqiptare të “Besës Kombëtare”*, Prishtinë: Faik Konica, 2012, f. 97-100.

<sup>21</sup> Sabit Syla, “Drenica në fund të Luftës së Dytë Botërore”, në: *Studime për Historinë Ushtarake*, 8 (2014) 2, Tiranë: Instituti i Studimeve të Historisë Ushtarake (ISHU), 2014, f. 71; Izber Hoti, “Qëndrimet, orientimet dhe veprimtaria e Shaban Polluzhës”, në: *Dardania sacra*, nr. 1, 1999.

Në kohën që zhvilloheshin luftime, në fundin e janarit 1945, udhëheqësit e PKJ-së, të përfaqësuar nga Aleksandër Rankoviçi, Milovan Gjlasi dhe Svetozar Vukmanoviç-Tempo, thirrën në Beograd Miladin Popoviçin dhe Fadil Hoxhën për një konsultë dhe u bënë të ditur vendimin se Kosova do të kishte autonomi formale dhe do t'i bashkëngjitej Serbisë, se do të mbahej vetëm flamuri i Jugosllavisë dhe Serbisë, kurse flamuri shqiptar nuk duhej të dukej më<sup>22</sup>. Ky akt u konfirmua ende pa u mbledhur Konferenca e Jaltës, e cila do të merrte vendime të rëndësishme për Jugosllavinë dhe përgjithësisht për botën e pasluftës. Më 8 shkurt 1945, vetëm një ditë pas vendimit të marrë në Konferencën e Jaltës për njohjen e kufijve të Jugosllavisë së paraluftës, Tito do të shpallte dhe urdhëronte vendosjen e Administrimit Ushtarak në Kosovë, epiqendër e së cilës do të ishte Drenica, në të cilën vazhdonin të zhvilloheshin luftime me ushtrinë jugosllave<sup>23</sup>.

Për t'i shpëtuar dhunës e terrorit jugosllav shqiptarët arratiseshin nga Kosova, duke kërkuar strehim në Shqipëri. Por, ata ndiqeshin edhe në Shqipëri nga njerëzit e UDB-së (Unutrašnja dršavna bezbednost - Mbrojtja e Brendshme Shtetërore), dhe pastaj shoqëroheshin për në Jugosllavi, ku gjatë rrugës me pretekste të ndryshme vriteshin<sup>24</sup>. Në fillim të vitit 1945 autoritetet jugosllave, pushkatuan ilegalisht dhe pa gjyq edhe në territorin e shtetit shqiptar, më tepër se 1 000 shqiptarë nga Kosova<sup>25</sup>. Krimet e terrorit i ushtruar në Shqipëri në periudhën e pasluftës, dëshmohej nga disa deklaratat të bëra nga ish nëpunës të lartë të shtetit shqiptar si Nesti Kerenxhi, ish zëvendësministër i Brendshëm<sup>26</sup>; nënkolonel Zoi Themeli, ish nëpunës i lartë i Sigurimit të Shtetit<sup>27</sup>; Shefqet Peçi etj.<sup>28</sup> Terrori dhe masakrat e viteve 1944 - 1946 ndaj

---

<sup>22</sup> AMPJ, V. 1963, D. 909, fl. 2. Relacion "Të dhëna për Kosovën gjatë e mbas luftës".

<sup>23</sup> S. Sylja, "Drenica në fund të Luftës...", f. 71.

<sup>24</sup> AMPJ, V. 1950, D. 247, fl. 1. Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit (Dega I). Relacion mbi terrorin dhe persekutimet në Kosovë, Tiranë, 19 tetor 1950.

<sup>25</sup> AMPJ, V. 1949, D. 191 (B/ V-2), fl. 43. Relacion rreth terrorit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë e Shqipëri.

<sup>26</sup> Më 28 mars 1948 deklaroi: "Në Drejtorinë e Sigurimit kanë ardhur disa lista kosovarësh, të ikur nga Kosova dhe dezertorë që kërkoheshin për t'u arrestuar. Nuk më kujtohet kush i sollti ose si erdhën këto lista, vetëm di se u është dhënë urdhër Organeve të Sigurimit që, po të kapen, t'i përcjellin në Jugosllavi. Dhe kjo punë është bërë". *Shih: Ndreçi Plasari&Luan Maltezi, Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948, Përmbledhje dokumentesh, Tiranë: Gjergj Fishta, 1996, f. 578.*

<sup>27</sup> Më 6 prill 1949 deklaroi se: "Mbas çlirimit të Shqipërisë janë lejuar organet e UDB-së që të ngrinin spiunazhin në Shkodër, me qëllim që gjoja këta të zbulonin armiqtë e popullit jugosllav, t'i arrestonin vet dhe të bënin si të donin me këta njerëz. Në atë kohë OZNA kishte dërguar për këtë punë majorin Niko Piper. Ky arrestoi një numër njerëz pa pyetur aspak organet tona dhe i shoqëronte për në Jugosllavi. Nga këta njerëz që arrestoheshin shumë prej këtyre vriteshin rrugës, duke i maskuar, dhe ka ndodhur që të jenë vrarë edhe në tokën shqiptare. Nga mesi i vitit 1945, - vazhdohej më tej, - jugosllavët duke shoqëruar një numër kosovarësh të mobilizuar për në Mal të Zi, rrugës vribnin njerëz në masë nga këta, pa pasur asnjë faj, dhe nga ky veprim disa nga këta kosovarë duke shpëtuar nga plumbat mundën të ikin dhe të dorëzohen në organet tona, duke kërkuar mëshirë dhe mbrojtje për të shpëtuar kokën..., mbas disa ditëve u urdhëruam që kosovarët e dorëzuar ose të kapur t'u dorëzohen jugosllavëve...". *Poaty, N. Plasari & L.Maltezi, Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave..., f. 579-581.*

<sup>28</sup> Në kohën e pluralizmit politik, rrëfente mbi ekstradimin e shqiptarëve nga Kosova në drejtim të Tivarit: "isha në Shkodër, kur po kalonin ata kosovarë të gjerë për në Mal të Zi, me mijëra e mijëra, të lodhur, të uritur, të

popullsisë shqiptare u bënë objekt shqyrtimi në disa relacione të ndryshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Jashtme të Shqipërisë. Në një relacion të Ministrisë së Jashtme të vitit 1960 jepen një sërë shembujsh për mizoritë e kryera nga organet jugosllave ndaj shqiptarëve: Në Mitrovicë kur hyri Brigada VI e Kosmetit, u pushkatuan mbi 2 000 vetë prej qytetit dhe katundeve të afërta. Në qytetin e Vushtrrisë u gjendën 400 vetë të varur. Në nëntor të vitit 1944 nga Kosova deri në Tetovë u pushkatuan më shumë se 1 000 vetë, duke u lënë arave dhe hendeqeve. Në Gostivar oficerët jugosllavë mbasi i nxorën nga kazermat vranë 300 shqiptarë. Në muajin dhjetor të vitit 1944 po në këtë qytet u arrestuan 70 vetë, të cilët u pushkatuan në një kodër të quajtur Gradishtan. Më 17 nëntor 1944, në stacionin e monopolit të duhanit në Tetovë u grumbulluan rreth 10 000 shqiptarë dhe në të njëjtën natë nga këta u pushkatuan shumë veta ... Në katundin Kërçovë u vranë 320 burra. Nga Shkupi u morën 300 djem shqiptarë me pretekst se do t'i dërgonin në një repart ushtarak, porse nuk u kthyen më në shtëpitë e tyre. Në Gjilan u pushkatuan 1 000 vetë, ndërsa në Skënderaj u gjendën 250 shqiptarë të varur. Në katundin Polon (Pozhoran - S.S.) të Ferizajt u pushkatuan 28 vetë përpara familjeve të tyre. Afër Prishtinës në vendin e quajtur Tomboce (Taukbashqe - S.S.) u pushkatuan mbi 200 vetë, kurse në një ditë brenda në Prishtinë u masakruan 70 vetë. Në Pejë prej dhjetorit 1944 deri në fillim të vitit 1946 u vranë 200 burra shqiptarë. Në rrethin e Shkupit u bënë masakra të mëdha. Në katundin Bojane të këtij rrethi u vranë 76 burra dhe 30 gra e fëmijë, ndërsa në katundin tjetër Bllacë të gjithë burrat (160 vetë) dhe 50 fëmijë, thuhet se këtij katundi mbas masakrave iu vu zjarri<sup>29</sup>.

Sipas gazetës “Zëri i Popullit”, “... xhelatët e Titos grisën dhe hodhën poshtë flamurin shqiptar dhe filluan pushkatimet në masë, terrorin e pashembullt në Drenicë, me krime të papara si therje fëmijësh dhe grash shtatzëna, njerëz të varur mbi hunj, njerëz që vdisnin në tortura dhe agoni të tmerrshme ..., mbi 2 000 vetë të pushkatuar në Mitrovicë, mbi 1 000 në Gjilan, me mijëra të pushkatuar që shkuan për të luftuar nazistët në brigadat jugosllave ..., qindra shqiptarë të rekrutuar ushtarë u pushkatuan në rrugën Prizren-Kukës-Tiranë. Në këtë qytet buzë detit u pushkatuan edhe 1 200 vetë ..., në Gorica të Triestes, më shumë se 2 000 djem shqiptarë nga Maqedonia, të mobilizuar në brigada pune i mbytën me gazra helmuese. Krime dhe krime, krime rrëqethëse ..., vetëm nga të dhëna të pjesshme llogaritet se 36 000 shqiptarë ranë nga

---

keqtrajtuar..., kisha dëgjuar se kosovarët i kishin marrë me forcë për t'i çuar në Tivar. *Shih: Apostol Duka, Udhëkryq të historisë (rrëfyer nga miqtë dhe armiqtë e Enver Hoxhës)*, Tiranë: Toena, 2007, f. 116-117.

<sup>29</sup> AMPJ, V. 1960, D. 530/2, fl. 10. Relacion “Gjendja dhe probleme të popullsisë shqiptare në Jugosllavi”, përgatitur nga Rako Naço dhe Petro Papi.

plumbi, bajoneta dhe helmi titist, nga viti 1944 në vitin 1948. Masakra, të cilat nuk ishin të drejtuara kundër reaksionarëve, por kundër popullit për ta shfarosur atë”<sup>30</sup>.

Në Kosovë qenë edhe dy divizione partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, disa prej tyre edhe mbanin shënime për veprimet shoviniste të njësiteve partizane të Jugosllavisë ndaj popullit shqiptar të Kosovës. Kështu, në një raport të Korparmatës III të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në mars të vitit 1945, thuhej: “... në Kosovë janë vrrarë njerëz nga Ushtria Nacionalçlirimtare jugosllave. Në Ushtrinë Nacionalçlirimtare duket se ka mjaft elementë shovinistë provokatorë. Një pjesë e madhe e popullit të këtyre anëve është në mal. Populli i Kosmetit (Kosovës S.S.), nuk ka aspak besim në Ushtrinë Nacionalçlirimtare jugosllave ... Heqja e flamurit shqiptar në qytetet e Kosovës e Metohisë, vrasja e delegacionit shqiptar që ishte dërguar nga Shtabi Operativ për marrëveshje ... vrasja e 20 vetëve nga Malësia e Gjakovës pa asnjë arsye, vrasja në masë në Drenicë, humbja e njerëzve natën pa i marr vesh askush, janë shkaqet që revoltojnë për së tepërmi popullin e Kosmetit kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare jugosllave”<sup>31</sup>.

Mbledhja e Kuvendit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë u mbajt në Beograd, nga 7 deri më 9 prill të vitit 1945, ku përveç delegatëve nga Serbia merrnin pjesë edhe 2 përfaqësues nga Kosova: Mehmet Hoxha, kryetar i Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe Dushan Mugosha, sekretar i këtij Këshilli. Ky i fundit në fakt ishte një delegat i Kosovës, por jo i zgjedhur nga populli. Sidoqoftë ai shprehte gjoja dëshirën e 700 mijë shqiptarëve dhe 100 000 malazezëve që Kosova t’i aneksohej Serbisë<sup>32</sup>. Atë që e fshihte Titoja në këtë Mbledhje e thoshte hapur Rankoviçi. Duke folur mbi çështjen e aneksimit të Kosovës Serbisë, ai deklaronte se ky aneksim “është përgjigjja më e mirë për ata që trumbetojnë rrezikun e copëtimit të tokës “serbe”, që akuzojnë Luftën NÇL (Luftën Nacionalçlirimtare - S.S.), sikur do të dobësojë serbët për llogari të kroatëve dhe të tjerëve”<sup>33</sup>. Më 9 prill, gazeta “Borba” me tituj të mëdhenj informonte opinionin se Mbledhja e Kuvendit Antifashist të popullit të çliruar të Serbisë “pranoi dëshirën” e popujve të Kosovës e Metohisë për bashkimin me Serbinë Federale. Më 8, 9 e 10 korrik 1945, u mbajt Kuvendi i Prizrenit, i cili aprovoi Rezolutën për aneksimin e Kosovës ndaj Serbisë. Në rezolutë ndër të tjera thuhej: “Për arsye të rrethanave të vështira që kanë mbretëruar para një viti e gjysmë në krahinë, popullsia e kësaj krahine nuk ka pas mundësi të përfaqësohet

<sup>30</sup> “Politika nacional-shoviniste e revizionistëve jugosllavë kundër shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi”, në: *Zëri i Popullit*, 9 shtator 1958, nr. 217 (3118), f. 4.

<sup>31</sup> *AMPJ*, V. 1981, D. 1140/1, fl. 114-115. Raport i Korparmatës III të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, mars 1945.

<sup>32</sup> *AMPJ*, V. 1963, D. 909 (B/VII-2dh), fl. 2. Të dhëna për Mbledhjen e Kuvendit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë në Beograd, prill 1945.

<sup>33</sup> *Po aty*, f. 3.



në mbledhjen e dytë të AVNOJ-it në Jajcë, në nëntorin e vitit 1943. Për këtë shkak, populli i kësaj krahine me anë të Asamblesë së tij Krahinore të zgjedhur lirisht, mundet vetëm tash me shprehë në mënyrë të lirë pajtimin e tij të plotë me vendimet historike të AVNOJ-it, të cilat i vunë themelin e fortë Jugosllavisë së re Federative Demokratike dhe lirisë e barazisë së popujve të saj dhe pakicave kombëtare. Asambleja Krahinore Popullore e Kosovës e Metohisë, deklaroi unanimisht se popullsia e kësaj krahine, njësoj si të gjithë popujt e Jugosllavisë kurrë ndonjëherë nuk e ka njohur copëtimin e krahinës së vetë të kryem nga okupatori, as copëtimin e Jugosllavisë, prandaj shpreh dëshirën e mbar popullsisë së krahinës që kjo t'i bashkohet Serbisë Federale si pjesë përbërëse e saj<sup>34</sup>. Ngjashëm me Kosovën u vendos pushteti jugosllav edhe në viset e tjera shqiptare. Vlen të përmendim se përveç heshtjes së PKSH-së, as Aleatët e Mëdhenj të cilët kishin shpresuar shqiptarët nuk reagon ndaj aneksimit të dhunshëm të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë Federative.

---

<sup>34</sup> *ASHAK*, F. Komiteti Krahinor i L. K. të Kosovës, V. 1945, K. 23/A, dok. nr. 2352, fl. 1-2. Rezolucion i Asamblesë Krahinore të Kosovës e Metohisë.

## **Ana Lalaj - Instituti i Historisë/ASA, Tiranë**

### **Pushteti dhe 'tjetri' që është përballë (Montimi i regjimit komunist në Shqipëri, 1944-1954 )**

#### **Abstrakt**

Kjo trajtesë merret me procesin e montimit të pushtetit që në terminologjinë e kohës shpallej si diktaturë e shumicës mbi pakicën, por që në fakt ishte hapur diktaturë e pakicës mbi shumicën, e pjesës mbi të tërën. Procesi shihet në rrafsh politik, shprehur në platformat politike të komunistëve në pushtet, ashtu edhe në rrafsh legjislativ, fushë e ndërvarur tërësisht nga platforma politike. Në më pak se dhjetë vjet, 1944-53, në shoqërinë shqiptare ndodhën thyerje të mëdha. Më tipikja, kundërshtarët politikë vetëm për këtë shkak u thirrën 'kriminelë lufte', 'sabotatorë të pushtetit', 'armiq të popullit' e më së shumti të gjitha bashkë. Kjo ndarje u kthye në epidemi masive, ku pjesë të tëra të popullsisë u gjendën të përjashtuara pa shkak, jo vetëm nga pjesëmarrja normale në jetën sociale, por humbën të drejtat civile dhe nga radhët e tyre u mbushën burgje dhe kampe internimi.

#### **Hyrje**

E djeshmja e afërt vazhdon të mbetet temë mjaft e rrahur në debatet publike që prej fillimviteve nëntëdhjetë e deri më sot. Në fakt, debatet për të djeshmen kanë zotëruar e zotërojnë më shumë tribunat politike dhe mediatike dhe kjo është e shpjegueshme, mjaft të mbajmë në vëmendje trashëgiminë komplekse të komunizmit. Megjithatë, tanimë, pas gati tridhjetë vjetësh nga ndarja me komunizmin, tribunat politike duket se nuk ndihmojnë më, madje po shfaqen si pengesë për shqyrtime të ftohta e të thelluara të së kaluarës. Kësisoj, është bërë e ngutshme nevoja për këto lloj studimesh, me objekt ekonominë, zhvillimet sociale, kulturore e deri psikologjinë e një shoqërie të ndarë dhe të traumatizuar, siç është shoqëria shqiptare. Këtu hyjnë edhe shqyrtimet historike. Në këtë kuadër, më duket intriguese të shqyrtohet si u perceptua dhe u instalua regjimi komunist në Shqipëri, cila qe filozofia dhe cilat qenë teknikat, me të cilat ai u ngrit dhe u mbajt për gjysmë shekulli. Si pjesë e kësaj filozofie dhe e teknikave të regjimit, jam përpjekur ta shoh edhe këtë trajtesë për dhunën dhe përjashtimin.

\* \* \*

Për Shqipërinë e pasluftës, korniza e parimeve do të ishte e njëjtë me atë të regjimeve respektive në Evropën Lindore. Si gjithë ato vende, edhe Shqipëria do t'i mbahej parullës spekulative të diktaturës së shumicës mbi pakicën, do të shpallte luftën e klasave si rrugë zhvillimi, do të pranonte kufizimin e lirive në socializëm, në emër të lirive të pakufizuara në një kohë të dytë, hipotetike. Gjithçka që bën ndryshimin me të tjerët janë veçoritë lokale, stadi

zhvillimor i popullsisë, kultura, traditat etj. Sigurisht edhe cilësitë e drejtuesve politikë të kohës dhe luftërat politike në kupolën e pushtetit.

Dy javë pasi qeveria e përkohshme hyri në Tiranë, më 15 dhjetor 1944, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar miratoi dy ligje. Njëri drejtohej kundër sabotatorëve të luftës dhe të pushtetit, ndërsa tjetri njoftonte mobilizimin civil të specialistëve për nevojat e rindërtimit. Në të dy rastet, si për të shpallurit në kërkim për krime lufte dhe për rezidentët e tyre, ashtu edhe për ata që i shmangeshin mobilizimit të përgjithshëm, dënimet shkonin deri “me burg të përjetshëm ose me vdekje, si dhe me konfiskim të pasurisë së tyre të tundshme dhe të patundshme.”<sup>1</sup> Kuptohet, masa si këto, përveçse të ashpra, përmbanin arbitraritete pa fund. Megjithatë, për kushtet e luftës këto janë konsideruar pak a shumë të përligjura. E veçanta është se fryma e atyre akteve të përkohshme zotëroi në mënyrë të përhershme dhe në gjithçka 45 vitet pasuese. Në ato akte, si dhe në vendimin për krijimin e gjykatave ushtarake, janar 1945, e kanë zanafillën termat “sabotator”, “spekulant”, “armik i pushtetit dhe i popullit”<sup>2</sup>, që u bënë kudo pjesë e jetës së përditshme.

Kur flasim për kufizime në të drejtat e ‘tjetrit’, vërejmë se kjo është praktikë pushteti në të gjitha kohët e për të gjithë regjimet. Termin ‘tjetri’ po e përdorim me marrëveshje, duke kuptuar me këtë term cilindo që është objekt i kufizimit. Në rastin e Shqipërisë dhe të regjimeve të ngjashme me të, kufizimi shkon deri në përjashtim, tipar ky i shoqërive jodemokratike dhe që është aplikuar e aplikohet nga regjime diktatoriale. Për Shqipërinë e kohës së komunizmit, përjashtimi i ‘tjetrit’, si dukuri i ka fillesat që gjatë Luftës II Botërore, kur komunistët provokuan konflikte civile me arsyen e vetme për të kapur të vetëm dhe pa garë pushtetin. Dhe ndodhi ajo që pritej, zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, prodhuan një pushtet arbitrar.

Të gjithë ata që kanë shkruar e folur për Shqipërinë pasluftës kanë vërejtur ashpërsinë e pazakonshme të sjelljes së pushtetit në raportet me ‘tjetrin’. Në dhjetëvjetëshin e parë të regjimit komunist, ‘tjetri’ ishte ai që u thirr kriminel lufte, ai që u afishua si kundërshtar politik dhe iu vu emri armik i popullit, sipërmarrësi privat që u cilësua spekulant e sabotator, pronari i tokave, i cili u quajt kulak dhe që u kufizua, u shpronësua dhe më tej u asgjësua. Midis tyre, ata që ikën me pushtuesin ose kolaboracionistë të tjerë, apo 3500 kundërshtarët e shpallur të regjimit të

---

<sup>1</sup>Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 40/APL/Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ), Viti (më tej: V.) 1944, Dosja (më tej: D. 37). Mbledhje e Kryesisë së KANÇ, datë 15.12.1944.

<sup>2</sup> Ligj nr. 41, datë 14.1.1945 “Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake” në: *Gazeta Zyrtare*, Botohet nga Ministria e Shtypit, Propagandës dhe e Kulturës, Tiranë, 23 janar 1945.

pasluftës që u tërhoqën dhe vepruan ilegalisht në male,<sup>3</sup> këta dhe të ngjashmit me ta, përbëjnë pjesën e përligjur të kufizimit.

Por për regjimin komunist shqiptar, karakteristike ka qenë, sipas meje, shuarja e dallimit midis kufizimit me arsye të përligjura dhe kufizimit joproporcional të ‘tjetrit’, në raport me sjelljen e tij ndaj “pushtetit të popullit”, siç thuhej në terminologjinë e kohës. Kjo ka qenë dukuri jo vetëm e ashpërsisë së ligjit, por edhe e praktikave *ekstraligjore* të pushtetit.

Në Shqipëri, diagrama e raporteve të pushtetit me ‘tjetrin’, në përmbajtje ka ardhur si një luftë e pandërprerë klasash, për të cilën ka pasur një shpjegim të stërpërdorur, se në socializëm ajo herë rritet e herë zbutet, po kurrë nuk shuhet. Ndërsa si shtrirje, diagrama tregon se kontrolli i pushtetit nuk njohu tkurrje. Përkundrazi. Si fillim, kontrolli mbi territorin, pastaj kontrolli mbi shoqërinë. Duke marrë në kontroll territorin, komunistët treguan se pushteti i tyre do të mbahej me çfarëdoqjosh kostosh. Një raport i Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Shqipërisë, mars 1945, por pa adresë se kujt i drejtohej në Beograd dhe që ndodhet në Arkivin e Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë (ACK SKJ), flet se një operacion i ushtrisë shqiptare, nëntor 1944 – mars 1945, për të marrë në kontroll Veriun e Shqipërisë, u shndërrua në një luftë të vërtetë dhe me mjaft humbje. Raporti tregon se “në zona si Dukagjini, Kelmendi, Mirdita, Lezha e Shkodra me rrethina, reaksioni po e ndante turmën nga pushteti, duke e përgatitur me armë kundër nesh”.<sup>4</sup> Puna kishte shkuar deri aty, sa në ushtri pati dezertime masive, “deri 20 e 30 vetë në ditë”. Por fundi i operacionit, pasi u vranë në luftime 75 vetë nga populli dhe 50 vetë nga ushtria, pasi u dogjën 90 shtëpi e u arrestuan gati 800 persona, prej të cilëve 30 u pushkatuan me vendim gjykate, kjo tregoi se turma u detyrua t’i bashkohej pushtetit, për shkak të forcës dhe “jo se e ndjen atë”.<sup>5</sup>

Kontrolli i pushtetit komunist mbi territorin, mbi popullsinë, kontrolli mbi grupe të caktuara shoqërore, deri te kontrolli mbi individin, rezulton të ketë qenë një proces mjaft kompleks. Vetë procesi i përmban të alternuara programet dhe reformat e pushtetit, si programet për zhvillimin e vendit, ashtu edhe ato të goditjes për kundërshtarët, si propagandën në emër të progresit, ashtu edhe demagogjinë për arritje të paqena. Në këtë proces teknikat e shtrëngimit u ngritën në perfeksion, falë edhe demagogjisë, e cila gjeti terren në mjedise kulturalisht të kufizuara. Një shembull. Është i njohur gjyqi i deputetëve, më 1947. Në fakt, problemi filloi më herët, në shtator 1945, kur Këshilli Antifashist, miratoi Ligjin për zgjedhjet në Asamblenë

---

<sup>3</sup> Turhan Shilegu, *Lufta e klasave në Shqipëri, 1948-1953*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1985, f. 15.

<sup>4</sup> *Arkivi i Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë (Arhiv Centralnog Komiteta Saveza Komunistica Jugoslavije*, më tej: ACK SKJ), IX, 1/II-41, datë 8.3.1945. Raport mbi Krahinën e Tretë në Shqipëri.

<sup>5</sup> *Po aty*.

Kushtetuese. Atë kohë kishte disa përpjekje për të krijuar një opozitë, por asgjë e konkretizuar. Megjithatë me Ligjin e 45-ës u la një hapësirë kur flitej për listat e kandidatëve, neni 13 i Ligjit, se “Titulli i listës formohet nga emri i organizatës ose grupit politik, në të cilin bëjnë pjesë kandidatët.”<sup>6</sup> Riza Dani tha se nuk do ta votonte me arsyetimin se ai nuk u lejonte kandidatëve të pavarur të hynin në Asamble përmes proporcionalit. Arsyetimi i Danit ishte lehtësisht i atakueshëm, pasi proporcionali vërtet nuk mund të përdorej ndryshe, përveçse duke u ndarë midis organizatave dhe grupeve politike pjesëmarrëse. Formoni një parti dhe merrni nga proporcionali, iu tha pak a shumë, Danit.<sup>7</sup> Vetë Partia Komuniste ishte fshehur brenda organizatës së Frontit, duke orientuar që kjo organizatë të ishte e hapur ndaj rrymave të ndryshme. Madje, u kujdes që në Asamble të vinin edhe elementë nacionalistë, sado të pasigurt, përfshirë edhe vetë Danin. Qëllimi ishte të evitohej një opozitë nga jashtë, si dhe t’i tregohej Perëndimit se komunistët ishin për demokraci liberale. Lidhur me këtë çështje, Hoxha e ka pohuar qartë: Ne nuk e hëngrëm sapunin për djathë, se nëse do të kishim dalë më vete, atëherë edhe partitë e tjera do të krijoheshin menjëherë e kështu do të ndahej pushteti.

Katër ditë pas zgjedhjeve, më 6 dhjetor, Byroja Politike erdhi shpejt në përfundimin se Fronti ishte bërë strehë e reaksionit, “se ne i dhamë dorë reaksionit dhe dolëm me një parlament të dobët”.<sup>8</sup> Lëshimet ndaj reaksionit Hoxha ia faturoi Malëshovës, me oportunizmin e të cilit u mor një plenum partie, në shkurt-mars 46. Organizatën e Frontit, Hoxha u kujdes ta kthejë në një organizatë politike dhe, më tepër se aq, e ndërseu në fushata demaskimesh publike ndaj cilitdo që nuk u përshtatej rregullave të regjimit. Edhe pasi e nxori partinë nga ilegaliteti, organizatën e mbajti gjithë kohën subjekt të vetëm elektoral. Në mars 1946, megjithëse e votoi, Dani e ironizoi statutin e ri të Republikës, duke e quajtur si të denjë për një republikë popullore socialiste.<sup>9</sup> Po atë vit Dani u arrestua dhe u ekzekutua si organizator i kryengritjes së Postribës, akuzë të cilën ai nuk e pranoi. Është fakt që ai inkurajoi një opozitë brenda parlamentit, me qëllimin për t’u shndërruar në parti, po ajo u mbyt. Për ironi, atë vit Kuvendi Popullor miratoi një ligj që garantonte të drejtën për të formuar parti politike.<sup>10</sup> Por, kjo ishte fasada. Më 1947 u ekzekutuan të gjithë ata që u përpoqën për një alternativë tjetër politike, përveç asaj të

---

<sup>6</sup>AQSH, F. 489, V. 1945, D. 74. Ligj nr. 124, datë 28.9.1945 “Mbi zgjedhjet e përfaqësuesve të popullit në Asambleshën Kushtetuese.” *Shih* gjithashtu: Sonila Boçi, “Zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 (ngjarje që sollin në pushtet apo legjitimoi pushtetin e komunistëve)”, në: *Studime Historike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 2008, nr. 1-2, f. 81-105.

<sup>7</sup>AQSH, F. 489, V. 1945, D. 83. Procesverbal i Mbledhjes III të Këshillit Antifashist NÇ, 29 shtator 1945.

<sup>8</sup>AQSH, F. 14/Arkivi i Partisë (më tej: AP)-organet udhëheqëse (më tej: OU), V. 1945, D. 4, f. 1. Pjesë nga konkluzionet e Byrosë Politike, mbledhur më 6 deri më 10 dhjetor 1945.

<sup>9</sup>AQSH, F. 489, V. 1946, D. 1. Diskutime rreth Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë, 6 mars 1946.

<sup>10</sup>AQSH, F. 489, V. 1946, D. 117. Ligj nr. 370, datë 6.12.1946 “Mbi formimin e partive politike dhe shoqatave kulturele, shkencore, profesionale etj. dhe mbi mbledhjet publike.”

komunistëve, si dhe u asgjësua çdo përpjekje për opozitë. Ligji që garantonte opozitën nuk u abrogua kurrë. Por ai mbeti aq formal sa askush nuk u kujtua ndonjëherë në kishte një të tillë. Madje, Ramiz Alia në takimin me një grup studentësh, më 11 dhjetor 1990, i sfidoi ata, jo pa cinizëm, kur i pyeti nëse e njihnin nenin 54 të Kushtetutës në fuqi,<sup>11</sup> nen i cili sanksiononte të drejtën e bashkimit të shtetasve në organizata të ndryshme politike, ekonomike, kulturore etj.

U ndala pak në këtë moment për të kuptuar si u kombinua shtrëngimi deri në terror i pushtetit me demagogjinë; si në nëntor u vesh maska e “demokracisë liberale” dhe u zhvesh në dhjetor, kur u njoftuan spastrimet; si u shfaq papritur “pelerina” e kuqe e garancisë për pluralizëm, si në një arenë toreadorësh, e kur në çdo portë qe vënë një gijotinë ... Kështu kishte ndodhur edhe me Mukjen në mesin e luftës, ku jo thjesht u braktis njëanshmërisht një ftesë për bashkëpunim, por ky çast historik ishte ai që ndau më dysh shqiptarët. Procesi kundër deputetëve ishte një rast i ngjashëm. I ngjashëm në kuptimin se kur përplasja me kundërshtarët e pushtetit ishte në kulmin e vet, po niste një tjetër luftë brenda vetë pushtetit.

Reformat e para ishin kufizuese deri përjashtuese për grupe të caktuara shoqërore. Konfiskime, shpronësime, shtetëzime, tatimi i jashtëzakonshëm për fitimet e luftës, goditja e spekulimit dhe e spekulantëve, sursharzhimi i monedhës\*, taksa për kulakët, reforma agrare e të tjera, të gjitha këto përbënin lajmet e ditës. Merret me mend që këto reforma prodhojnë natyrshëm grupe kundërshtarë përballë pushtetit. Por, ato krijuan edhe ushtri mbështetësish, karakteristike për shoqëritë e varfra, sidomos në rrethanat kur u rishpërndanë mbi 170 mijë hektarë tokë për fshatarët pa ose me pak tokë.<sup>12</sup>

Nëse do të klasifikojmë grupet kundërshtarë në çastet e para të instalimit të pushtetit komunist, pas *kundërshtarëve politikë të luftës*, fill pas tyre vijnë *elitat e pushtetit të vjetër*, bashkë me *grupet e prekura nga reformat*. Eliminimi fizik e politik i tyre ishte në vijën e sjelljes së pushtetit. Por, krahas tyre, pati një grup tjetër social, ndaj të cilit regjimi ishte mosbesues. Fjala është për *elitën intelektuale të kohës*, e cila hyri në listat e zeza të pushtetit. Një proces

---

<sup>11</sup>AQSH, F. 489, V. 1990, D. 264. Takim i Kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor (më tej: PKP) Ramiz Alia me përfaqësues të studentëve dhe pedagogëve të Universitetit “Enver Hoxha”, më 11 dhjetor 1990. Neni 54. Atëkohë në fuqi ishte Kushtetuta e *Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e vitit 1976, në të cilën sanksionohej se “Shtetasve u sigurohet e drejta e bashkimit në organizata të ndryshme që veprojnë në fushën politike, ekonomike, kulturore, si dhe në çdo fushë tjetër të jetës së vendit”*, në: *Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar nga Kuvendi Popullor, më 28.12.1976*, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 nëntori”, 1977, f. 30.

\**Surcharge*: mbitaksë, supertaksë. Në këtë rast fjala është për reformën monetare, më 1945, me të cilën u ndalua tregtia e arit jashtë Bankës së Shtetit Shqiptar, si dhe u vulosën të gjitha kartëmonedhat në qarkullim me prerje 20 franga e lart, me vlerë afro 215 milionë franga shqiptare, përkundrajt 309 milionë franga gjithsej, që vlerësohej pasuria monetare e vendit atë kohë. Me këto masa u vu në kontroll monedha në qarkullim, sidomos financat e shtresave të pasura, si dhe u pengua kontrabanda e mallrave dhe e arit jashtë vendit.

<sup>12</sup>Enver Hoxha, *Vepra*, vëllimi 5, Tiranë: “Naim Frashëri”, 1970, f. 340.

gjyqësor në përgjigje të aktit që ndodhi në ambasadën sovjetike, kur mbrëmjen e 19 shkurtit 1951 në oborrin e saj u hodh një pako dinamit, dëshmon për qasjen kriminale të pushtetit në raport me aktin. Të nesërmen e ngjarjes, ministri i Brendshëm i kërkoi Byrosë Politike “masa të jashtëzakonshme represive, pa marrë parasysh ligjet në fuqi”. Në atë mbledhje, ministri hapi listat dhe kërkoi të arrestoheshin 100 ose 150 vetë dhe të pushkatoheshin 10 ose 15 prej tyre.<sup>13</sup> Ngjarja tashmë dihet. Me kërkesë të kryeministrit Hoxha, Presidiumi i Kuvendit Popullor, më 26 shkurt miratoi një dekret, që sanksiononte gjykim të shpejtuar për aktet terroriste, pa pjesëmarrje të palëve dhe pa mbrojtje ligjore, pa të drejtë kërkesë për falje të jetës, si dhe pa të drejtë rekursi.<sup>14</sup> Përfundimi: 22 të pushkatuar. Asnjëri prej tyre nuk kishte lidhje me të ashtuquajturën *bombë*. Të gjithë intelektualë të njohur, por jo simpatizantë të pushtetit.

Duke ndjekur hapat e instalimit të regjimit komunist lindin mjaft pyetje për arsyet e aplikimit të masave të terrorit ose, së paku, për arsyet e zgjerimit të rrethit, ku u përfshinë grupe sociale që iu nënshtruan përndjekjes ose kufizimit. Duhet pranuar se në kohë dhe rrethana të ndryshme kanë variuar edhe masat shtrënguese. Për shembull, në vitet 49-51 kishte operacione të shtuara nga jashtë për përmbysjen e pushtetit në Shqipëri. Platformat e Perëndimit orientonin veprime terrori që mund të shkonin deri në luftë civile për të përmbysur pushtetin.<sup>15</sup> Megjithatë lindin mjaft dyshime për arsyet e zgjerimit të terrorit në kategori të ndryshme shoqërore.

Arsyeja më kryesore më rezulton se lidhet me vetë natyrën e sistemit. Në qoftë se sektarizmin e shohim si qasje intolerante të pushtetit ndaj grupeve dhe individëve që mendojnë ndryshe, sektarizmi nuk mund të jetë tjetër veçse në vetë thelbin e komunizmit. Sektarizmi, si shprehje e kufizimit, e mohimit, është tipar i sistemit, është vetë rregulli. Ndërsa liberalizmi dhe oportunizmi është ikje nga rregulli. Dy herë është folur kundër sektarizmit në kupolën politike shqiptare. Herën e parë në Plenumin e Beratit dhe herën e dytë në rastin e Koçi Xoxes. Por të dyja herët nuk ka pasur një shtysë të brendshme, gjithçka u bë me nxitje nga jashtë. Herën e parë me nxitjen e jugosllavëve dhe të dytën me orientimin sovjetik kundër jugosllavëve.

Plenumi i Beratit ishte dekurajues për fitimtarët e luftës, por ai ishte akti më i sigurtë, në mos i vetmi, në historinë e PKSH. Më 1946, shkak për ngecjet në programin e rindërtimit të vendit, Hoxha gjeti oportunizmin në parti dhe në administratën e tij, duke bërë fajtor sidomos Sejfulla Malëshovën, kritikun e tij më të ashpër të Beratit. Në parti dhe në shtet u rikthyen shpejt arbitraritetet, më të dukshme në Ministrinë e Brendshme. Kongresi i Parë i Partisë bëri

---

<sup>13</sup>AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1951, D. 1, f. 228. Mbledhje e Byrosë Politike më 20 shkurt 1951.

<sup>14</sup>AQSH, F. 489, V. 1951, D. 27, Dekret nr. 1223, datë 26 shkurt 1951. “Për aktet terroriste kundër punonjësve të pushtetit dhe organizatave politike e shoqërore.”

<sup>15</sup>Stephen Dorril, *MI6 (Inside the Covert World of Her Majesty's Secret Intelligence Service)*, New York London Toronto Sydney: Simon & Schuster, pp. 366-367; 393.

përgjegjës Koçi Xoxen, i cili iu dha gjyqit. Ka studiues që procesin ndaj tij e shohin si kopje të proceseve në vitet '30 në Bashkimin Sovjetik.<sup>16</sup> Takimi *incognito* në Bukuresht, në verë 1948, i Hoxhës me Vishinskin, prokurorin e famshëm në *Purgën e Madhe*, ka mundësi të ketë pasur për temë hapjen e një “Purge” tjetër në Evropën Lindore, e cila nisi nga Tirana.<sup>17</sup>

Që sektarizmi është tipar thelbësor për një regjim terrori po përpiqem ta shpjegoj më tej, duke qëndruar te rasti Xoxe e sidomos me zhvillimet post Xoxe. Në Tiranë, më 1949, Xoxe u ekzekutua jo vetëm me akuzën për trockizëm dhe si agjent i jugosllavëve, por edhe për arbitraritete dhe krime ndaj popullit të vet. Madje, akuza e fundit, pra ajo për krime, u bë varkë shpëtimi për Enver Hoxhën, më 1955, kur me kujdesin e Hrushovit u rehabilituan të gjithë të dënuarit në vendet e Lindjes pas thyerjes Stalin – Tito. I vetmi që nuk u rehabilitua ishte Koçi Xoxe. Pas Kongresit I të Partisë, në diskutimet në parti dhe në popull u dhanë shembuj të përbindshëm si vepronin njerëzit e Sigurimit të Shtetit dhe agjentët e Xoxes me njerëzit e pafajshëm. Të dërguarit e partisë në popull kur u kthyen në Tiranë raportuan se “njerëzve u janë bërë lloj-lloj torturash nga më të tmerrshmet: spica, vezë, fishekë në gishta, shpuar këmbët me tel të skuqur, çarë mishi dhe futur kripë, varur për duarsh ose për këmbësh në tavan dhe lënë për disa ditë.”<sup>18</sup> Për njërin nga ndihmësit e Xoxes raportohet se më 1946, në një operacion ndëshkimor në Peshkopi, kishte dhënë urdhra të pushkatoheshin fshatarë pa gjyq (për shembull, në një natë shtatë vetë), duke i kaluar më parë në tortura. Për të njëjtin person shkruhet se ai jepte porosi me shkrim, me copa letrash, si të veprohej me të ndaluarit dhe sipas rastit “vinte **A**, që do të thoshte *Arrestim*, kur vinte **P**, do të thoshte *Pushkatoje, ndërsa Rr*, do të thoshte *Rrahje*”.<sup>19</sup> Më tej, në një raport përmbledhës, i hartuar në zyrat e KQ të partisë shënohej se “ata që nuk dorëzonin bereqetin janë rrahur në sy të popullit, u është marrë mielli nga magjja, buka nga saçi dhe janë shkëlmuar fëmijët që qanin për bukë, veprime që na kanë armiqësuar me njerëzit.”<sup>20</sup>

Po kur Xoxe ra nga pushteti, u vërejt se metodat e Xoxes nuk ishin produkt i një individi, por produkt i sistemit që i shërbente. Ka mjaft të dhëna që e provojnë këtë gjë. Pas Kongresit I, Ministria e Punëve të Brendshme paraqiti një platformë të re politike dhe organizative për Sigurimin e Shtetit, në të cilën listohen gabimet në kohën e Xoxes. Por vetë platforma është e

---

<sup>16</sup>Robert Austin, “Purge and Counter-purge in Stalinist Albania, 1944-1956,” në: *Stalinist Terror in Eastern Europe*, (Elite purges and mass repression) eds. Kevin McDermott and Matthew Stibbe, p. 210.

<sup>17</sup>AQSH, F. 10/Enver Hoxha, Grupi III, nëngrupi IV, V. 1966, D. 281, fl. 12. Shënime nga takimi i E. Hoxhës në Byronë e KP të rrethit të Lushnjës, më 8 mars 1966.

<sup>18</sup>AQSH, F. 14/AP-Strukturë (më tej: Str.), V. 1948, D. 83. Raport mbi gjendjen në Dukagjin, 14 dhjetor 1948.

<sup>19</sup>AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1948, D. 85. Raport nga Aktivi i Partisë në Durrës, Shijak, Hekurdhë dhe Garnizoni i Durrësit, më 23 deri më 27 dhjetor 1948.

<sup>20</sup>AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1948, D. 85. Relacion mbi raportet e shokëve të KQ për punimin e vendimeve të Kongresit I në aktivet e Partisë.



njëjtë me platformat e mëparshme, si dhe ato të mëpasme, dhe përshkohet kryekëput nga kujdesi që Sigurimi i Shtetit të ketë në kontroll të gjitha segmentet e shoqërisë, përjashtuar kontrollin mbi partinë, që është ndërhyrja e vetme korrigjuese.<sup>21</sup> Madje, në parti u ngrit gjithnjë e më shumë një shqetësim i ri, rindërtimi i autoritetit të dëmtuar të Sigurimit, ngritja e rrjetit të informatorëve, rezidentëve etj. Rezolucioni që doli nga Plenumi IX i KQ të Partisë, 19 – 23 shkurt 1951, e shtronte fort nevojën e ashpërsimit të luftës kundër armiqve të klasës dhe të rritjes së dashurisë për organet e Ministrisë së Brendshme, duke bërë që “çdo komunist, në radhë të parë, dhe çdo qytetar i republikës sonë të bëhet një ‘çekist’.”<sup>22</sup> Megjithatë, Ministria e Brendshme pavarësisht nga përgjegjësitë që iu ngarkuan, vazhdoi të mbetej një ministri me analfabetë.<sup>23</sup>

Një tregues tjetër mjaft domethënës. Kur partia në gjithë vendin fliste për metodat e shëmtuara të bashkëpunëtorëve të Xoxes, nga informacionet doli një listë personash, të cilët kishin ushtruar terror të egër, kudo që kishin qenë në krye të operacioneve. Çfarë ndodhi me ta? Nga të dhënat që kam mundur të mbledh, më rezultoi se pjesa më e madhe e këtyre personave ose qëndruan në detyrat e mëparshme apo paralele, ose edhe u ngritën në përgjegjësi. Nëse disa prej tyre u ndëshkuan në vitet e mëvonshme, kjo nuk ndodhi aspak për shkak të arbitraritetit të tyre të mëhershme, por për shkak të zhvillimeve të brendshme në parti. Për ta mbyllur, edhe një përpjekje e Bilbil Klosit, kryetar i Gjykatës së Lartë Ushtarake, përfundoi pa dobi. Klosi i kishte drejtuar një promemorie Enver Hoxhës, ku i kërkonte që ata të cilët u dënuan me prova të marra nën torturë, të ushtronin të drejtën e rekursit, përfshirë edhe disa prej atyre që ishin ekzekutuar të shpallëshin viktimat të trockizmit.<sup>24</sup> Kërkesën e Klosit e kundërshtoi prerë ministri i Brendshëm Shehu. “Në vend të ngjallim urrejtje kundër elementëve të dobët, tha ai, ne bëjmë të kundërtën. Duhet ashpërsi kundër armikut!” Në të njëjtat tone ishte edhe Hoxha: “Bilbil Klosi nuk ia ka idenë fare si punon armiku”.<sup>25</sup>

Për komunizmin është shkruar shumë. Autorë të ndryshëm divergojnë në mendime, po edhe plotësojnë njëri-tjetrin, kur flasin për motivet e terrorit në vende të ndryshme, për të

<sup>21</sup>AMB, F. 46/Sekretariati, V. 1948, D. 29. *Platforma politike dhe organizative e organeve të Sigurimit të Shtetit, pas kthesës*, 1948.

<sup>22</sup>AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1951, D. 1. Protokoll i mbledhjes së Plenumit IX të KQ të Partisë, më 19-23 shkurt 1951, f. 91/1-92.

<sup>23</sup>AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 8, f. 30. “Mbi gjendjen e brendshme në Republikën Popullore të Shqipërisë,” raport i ministrit të Brendshëm në Byronë Politike të KQ të Partisë, më 26 janar 1953. Sipas këtij raporti, në sektorin e Sigurimit, 61.74% e kuadrit oficer e nënoficer kanë 1-5 klasë shkollë fillore; 25% kanë 1-3 klasë unike; vetëm 4.69% kanë 1-4 klasë të mesme dhe 8.57% janë autodidakte ... Por te ne nuk kanë as shkollën fillore që të gjithë.

<sup>24</sup>AQSH, F. 14/AP-Str, V. 1949, D. 626. Materiale të Drejtorisë së Kuadrit për “Politikën e goditjes”, qëndrimet oportuniste, si dhe një promemorie e Bilbil Klosit, më 17 maj 1949.

<sup>25</sup>AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1949, D. 35. Mbledhje e Sekretariatit të KQ të Partisë, 2 maj 1949

përbashkëtat dhe të veçantat. Por, duket se janë në një mendje, teksa përvoja e ka treguar se “komunistët nuk ishin liberalë, ata ishin revolucionarë dhe alternativa e tyre ishte shtrëngesa”.<sup>26</sup> Në aktivin e Partisë të një garnizoni ushtarak njëri nga zyrtarët e Sigurimit të Shtetit pohoi se në Drejtorinë e Sigurimit ka qenë mendimi se “ai shok që nuk rrihte, do të thoshte se ai nuk e urrente armikun dhe e kundërta, ai që rrihte më shumë, ai urrente më shumë armikun”.<sup>27</sup> Edhe në këtë rast mund t’u kthehemi përvojave të vendeve nën komunizëm, ku sindroma e armikut ka qenë dominuese, ndërsa dhuna është parë si maja e mprehtë e luftës së klasave. Në shoqëri të tilla, ku dhuna e shtetit është e përligjur, nuk është vështirë që ajo, pra dhuna, të marrë format më të ashpra si terror shtetëror, deri në variantet e shëmtuara të torturës.

Le të kthehemi edhe një herë tek sektarizmi dhe oportunizmi, jo si koncepte teorike, po si dukuri për periudhën e marrë në shqyrtim. Të dyja dukuritë tregojnë sjelljen e pushtetit me qytetarët, përfshirë dhe kundërshtarët e pushtetit. Në komunizëm si sektarizmin, ashtu edhe oportunizmin, propaganda i ka ‘shitur’ njëlloj të rrezikshëm për shtetin e diktaturës së proletariatit. Kësisoj, njëlloj të dënueshëm. Por, ashtu si u tha më lart, paradoksi është se në praktikë sektarizmi ka qenë vijë sjelljeje për regjimin dhe askush nuk është ndëshkuar për sektarizëm. Ndryshe është me oportunizmin, i cili ka ngrënë koka. Për oportunizëm, i pari në radhën e gjatë të të ndëshkuarve është Sejfulla Malëshova. Rastin Malëshova mund ta marrim edhe si fillesë për një gjueti të re, kur ‘tjetri’ filloi të kërkohet brenda shtëpisë. Malëshova u pasua nga rasti tjetër, ai i Tuk Jakovës, atë kohë numri dy në parti, pas Hoxhës. Edhe ky për oportunizëm, shpirtbutë me armikun e klasës.\* Si fillim, të dy ata u cilësuan si udhëheqës që kishin gabuar rëndë. Prandaj ata u zhveshën nga funksionet në parti, duke u mbajtur në postet shtetërore. Pastaj për ta u tha se ishin armiq të egër të partisë dhe të shtetit. I pari e kaloi gjithë jetën në internim. I dyti shkoi në burg, ku dhe vdiq, larg kujdesit mjekësor. Që atëherë u pa se për pushtetin e ri, marrë me ‘grykën e pushkës’, sfidat nuk do të ishin të lehta dhe përplasjet e brendshme të pashmangshme.

Për oportunizëm u sulmua edhe drejtësia, prokuroria dhe gjykatat. Manol Konomi dhe Bilbil Klosi, dy ‘hamenjtë’ e pushtetit të ri, të shkolluar në Perëndim dhe të lidhur me komunizmin e me luftën, u përpoqën t’ia përshtatin parimet e së drejtës një regjimi të padrejtë.

---

<sup>26</sup>Kevin McDermont and Matthew Stibbe, “Stalinist terror in Eastern Europe: problems, perspectives and interpretations”, në: *Stalinist terror in Eastern Europe*, (Elite purges and mass repression), Manchester University Press, 2010, p. 4.

<sup>27</sup>AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1948, Dosje në përpunim. Shënime të Sadik Bocajt në Aktivin e Partisë të Garnizonit T për punimin e Rezolucionit të Plenumit XI të KQ, 12 tetor 1948. Material në përpunim.

\* Plenumi IX i KQ të PPSH, shkurt 1951, e largoi Tuk Jakovën nga Byroja Politike dhe si sekretar i KQ me motivin për oportunizëm të thellë, liberalizëm të patolerueshëm dhe për mungesë urrejtjeje për armikun e klasës. Më 1955 Jakova u përjashtua nga KQ dhe nga Partia për diversion në parti. Më 1956 u internua në Berat dhe më 1957 u dënua me heqje lirie, ku dhe vdiq në spitalin e burgut në rrethana të paqarta.

Konomi, kinse i lodhur, në fakt refuzues ndaj arbitrariteteve të vazhdueshme të pushtetit, kërkoi dorëheqje. Me të drejtë nuk e besuan dhe e zhveshën nga të gjitha funksionet për disfatizëm. Kjo ndodhi në ditët e bombës në ambasadën sovjetike. Atëherë ai ishte ministër i Drejtësisë. Asnjëherë nuk hapi gojë nëse e kishin pyetur ose jo, siç ishte dhe është rregulli, para se të hidhej firma mbi atë dekret të zi. Ndryshe nga Konomi, Klosi e vazhdoi edhe për një kohë luftën me pushtetin. Po ashtu, ai vazhdoi t'i lutej partisë “të ruajë independencën e gjyqeve” dhe “ndërgjegjen e lirë të gjyqtarit”.<sup>28</sup> Sidoqoftë, si Konomi, ashtu edhe Klosi, falë profesionalizmit të tyre, në mjaft raste ia dolën me pushtetin. Kuptohet, edhe lëshuan, pra u përdorën. Por, në këmbim, në fund të fundit, u mbajtën.

Në vijim të idesë së zgjerimit të “politikave të goditjes” (ky është termi i kohës), e pasigurt ishte jo vetëm elita intelektuale, por edhe grupe të tjera sociale, njerëzit e administratave, mësues, oficerë e nënoficerë, deri te shitësit e rojet. Një raport i ministrit të Brendshëm Shehu, në janar 1953, vë alarmin e përbërjes së dyshimtë të administratave. Raporti konstaton: “Në Bankën e Shtetit mbi 45 për qind e nëpunësve janë fshatarë të pasur dhe ish nëpunës të regjimeve të vjetra, në Ministrinë e Financave 35 për qind, në Ministrinë e Tregtisë së Jashtme 43 për qind, në Ministrinë e Tregtisë së Brendshme 44 për qind, në Ministrinë e Grumbullimit 40 për qind, në Ministrinë e Bujqësisë mbi 40 për qind, në Ministrinë e Komunikacionit rreth 30 për qind etj. Të gjithë këta nëpunës përbëjnë një kontingjent të vlefshëm për punën e armikut, në përgjithësi ata nuk mund të pajtohen me pushtetin popullor.”<sup>29</sup>

Duket se ministri i Brendshëm, Shehu ka një hartë të detajuar të prezencës së “armiqve” gjithandej në institucionet dhe administratën e shtetit shqiptar. Ai bëri me dije se spiunazhi i huaj ishte përpjekur të fuste njerëzit e vet në vende kyçe, në pushtet, në parti, në sigurim, në polici dhe në ushtri. Për gjendjen në ushtri ai i solli Byrosë Politike një prognozë të zymtë, teksa dha shifra të larta arrestimesh, arratisjesh dhe dezertimesh nga ushtarakët shqiptarë. Me siguri ishin këto statistika që pak muaj më vonë e nxorën bluf Hoxhën, kur në qershor 1953, ai u thirr në Moskë dhe me këtë rast iu tha prerë: “Ju keni krijuar mendimin se ushtrinë e keni tërësisht me vete, por 35 për qind e oficerëve janë me armikun. Kjo do të thotë se ju nuk e njihni gjendjen ... Ju duhet ta pastroni ushtrinë sa më shpejt dhe ne do të ju ndihmojmë.”<sup>30</sup>

---

<sup>28</sup>AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1949, D. 56, fl. 22. Procesverbal i mbledhjes së komisionit për shqyrtimin e çështjeve në sektorin e drejtësisë, 25 korrik 1949.

<sup>29</sup>AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 8, fl. 18. “Mbi gjendjen e brendshme në Republikën Popullore të Shqipërisë,” raport i ministrit të Brendshëm në Byronë Politike të KQ të Partisë, më 26 janar 1953, f. 18.

<sup>30</sup>AQSH, F. 14/AP-MPKBS, V. 1953, D. 9, fl. 4, Mbi bisedimet që ka bërë Enver Hoxha me udhëheqësit e PKBS dhe të qeverisë së BS, në Moskë, në gjysmën e parë të muajit qershor 1953. (Protokolli i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, më 20 dhe 22 qershor 1953, ku raportohet verbalisht nga Enver Hoxha për bisedimet).

Në përgjigje të raportit të ministrit të Brendshëm Shehu, kryeministri Hoxha dërgon në dikastere dhe komitete ekzekutive një platformë të detajuar spastrimesh, pasi në administratat shtetërore kishin hyrë shumë elementë të padëshirueshëm, armiq të pushtetit popullor.<sup>31</sup> “Nuk mund t’i besohet tezgjahu një ish ballisti, nuk mund t’i besohet traktori një ish federali të fashizmit ose centrali elektrik një ish oficeri të xhandarmërisë”, thuhej në platformën Hoxha.<sup>32</sup> Për këtë arsye do të ngriheshin kudo *komisione spastrimi* dhe do të identifikonin dy grupe njerëzish, ata me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe grupi i dytë, ata që nuk kanë dhënë mjaftueshmërisht shenja besnikërie ndaj pushtetit. Largimi nga puna do të bëhej në dy faza dhe në çdo rast do të njoftoheshin organet e punëve të brendshme.

Spastrimet do të shtriheshin kudo. Si përgjigje ndaj Moskës, nga ushtria u larguan gati nëntë mijë ushtarakë aktivë, që në popull u përmend gjatë, ‘*nëntëmijëshi*’. Kështu ndodhi edhe me arsimin, me organet e drejtësisë etj., si dhe me vetë partinë, e cila u përfshi në një fushatë verifikimesh të anëtarësisë. Në fund të vitit 1953 doli se përveç largimeve nga puna, në parti ishte përjashtuar 20 për qind e anëtarësisë, mbi dhjetë mijë njerëz ishin pa triska fronti, një formë diskriminimi politik e social. Po ashtu mbi katër mijë vetë qenë shpallur kulakë, mbi njëzet mijë vetë ishin dënuar.<sup>33</sup> Shifra të larta për një popullsi rreth 1.5 milionëshe.

Platforma të tilla, si kjo që u përmend vijnë nga një gjendje pasigurie deri në ankth, pasi siç thuhej, spastrimet “kanë lidhje me fatet e pushtetit popullor ... në vendin tonë”.<sup>34</sup> Me fjalë të tjera, kemi të bëjmë me përpjekje që pushteti të fitojë sigurinë që i duhet në ushtrimin e funksioneve të veta.

Por, për fat të keq, ka edhe platforma të tjera të cilat, kësaj here, nuk reflektojnë pasigurinë e pushtetit, por egërsinë e tij me të pambrojturit. Kjo është pjesa më e errët dhe më çnjerëzore e regjimit komunist në Shqipëri. Në konferencën “Të mohuar nga regjimi”, organizuar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), më 30-31 tetor 2018, pati disa kumtesa me subjekt burgjet dhe kampet e punës, internim dëbimet etj. Kësisoj, në shkrimin tim rastin po e përdor vetëm e thjesht në funksion të idesë së shprehur se me internimet masive të njerëzve që nuk janë përfshirë në krime, sidomos të grave dhe fëmijëve, si dhe me mënyrat mizore të trajtimit në kampe e burgje, regjimi në fakt nuk bëri tjetër veçse e zgjeroi rrethin e kundërshtarëve. Kësisoj ‘*tjetri*’ dita-ditës po i ikte të qenit pakicë.

---

<sup>31</sup>AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1953, D. 527, fl. 30. Qarkore e kryeministrit Enver Hoxha ‘Mbi spastrimin e aparateve shtetërore dhe ekonomike nga elementët e padëshirueshëm dhe armiq’, datë 20 shkurt 1953, f. 24.

<sup>32</sup>Po aty, f. 27.

<sup>33</sup>AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 41. Raport për përjashtimet nga Partia në mbledhjen e Byrosë Politike, më 31.11.1953, f. 38

<sup>34</sup>AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1953, D. 527, f. 30. Dokument i përmendur në referencën nr.31.

Një raport i qeverisë amerikane që iu dërgua sesionit të Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB-së, në shkurt 1955, trajton hollësisht gjendjen e kampeve dhe burgjeve në Shqipëri, qendrat e internimit, të ashtuquajturën punë vullnetare etj. Thuhet se në dhjetë vjet janë hapur rreth 40 kampe e burgje, se në to kanë kaluar 80 mijë burra, gra e fëmijë, nga të cilët 16 mijë kanë humbur.<sup>35</sup> Shifrat që sillen në këtë raport janë, mendoj unë, të pasigurta, ndërsa gjendja e përshkruar është në pajtim me dokumentacionin që gjendet në arkivat tona. Ministria e Jashtme e Shqipërisë për këtë raport formuloi një përgjigje të vetën, të cilën ia dorëzoi ambasadës sovjetike në Tiranë, me qëllim që Misioni sovjetik në OKB të mund ta përdorte, kur ta sillte rasti. Ajo çka mund të themi është se përgjigja nga Tirana ishte e dobët, e mbushur me frazeologji propagandistike dhe jo bindëse. Ajo nuk pranon punën e detyruar në Shqipëri dhe ngre lart aksionet vullnetare të rinisë. Mendoj se është vështirë të ndash punën e detyruar nga përfshirja masive në punë vullnetare, të ndash se ku fillon njëra dhe ku mbaron tjetra. Në Shqipëri nuk ka pasur ligje për punë të detyruar, por njeriu është ndjerë kurdoherë i shtrënguar për të pranuar jo punën që ka dashur, por një punë të imponuar. Sa për punën në burgje është e njohur se të burgosurit janë dërguar me detyrim në punë dhe se ata kanë përballuar punë të vështira. Më 1953, ministri i Brendshëm i raportonte Byrosë Politike se një vit më parë, më 1952, nga puna e të burgosurve ishin marrë 76 milionë lekë, bashkë me një statistikë të objekteve ku punonin të burgosurit, që nga fabrika e tullave në Tiranë, kanalet ujitëse në Fier, Urën Vajgurore etj. Gjithsej mbi 5 mijë të burgosur.<sup>36</sup> Pak a shumë e njëjta gjë mund të thuhet për punën vullnetare, ku dëndur mungoi vullnetarizmi dhe gjithmonë gjendeshin mënyra shtrënguese. Në raportet e të dërguarve të partisë gjejmë të flitet shumë për të tilla metoda shtrënguese me njerëzit. Sa për shembull, në njërin nga këto raporte thuhet se në krahinat e Veriut puna vullnetare e rinisë barazohej me marrjen me forcë. “Ja sillni vajzat, ja merrni pushkën dhe dilni në mal!”<sup>37</sup> Kjo ishte alternativa që u vihej fshatarëve.

Po ashtu në reagimin e Ministrisë së Jashtme jeta në burgje përshkruhet plot lustër, ndërsa për kampet thuhet se “në Republikën Popullore të Shqipërisë nuk ekziston asnjë fushë përqendrimi”.<sup>38</sup> Pavarësisht lojës me termat, ajo që dimë është se pushteti i kohës nuk la statistika për të grumbulluarit në kampe nga viti 1949 deri në 1952, kohë kur kanë qenë grumbullimet më të mëdha, si në Berat, Tepelenë, Valias, Krujë etj. Dimë po ashtu se një

---

<sup>35</sup>AQSH, F.14/AP-Str., V. 1955, D. 176. Ministria e Jashtme i dërgon KQ të PPSH një raport të qeverisë amerikane për OKB mbi punën e detyruar në Shqipëri, më 4 prill 1955.

<sup>36</sup>AQSH, F.14/AP-OU, V. 1953, D. 8. Raport i MPB për gjendjen e brendshme në RP të Shqipërisë, më 26 janar 1953, f. 36

<sup>37</sup>AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1948, D. 85. Raporte të të deleguarve në rrethe pas Kongresit I të PPSH, 29 dhjetor 1948.

<sup>38</sup>AMPJ, V. 1955, D. 254. Shpifjet e imperialistëve amerikanë kundër RPSH dhe qëllimet e tyre, f. 4, pa datë.

statistikë zyrtare shënon se në njëzet vjet (1949-1969) janë dëbuar dhe internuar 4997 persona.<sup>39</sup> Sigurisht shifra duhet të jetë shumë më e lartë. Statistika në fjalë jep një grafik në vite dhe viti që ka numrin më të lartë të dëbim-internimeve është pikërisht viti 1954, me 646 persona.<sup>40</sup> Disi i çuditshëm ky qëndrim i regjimit të Tiranës, në një kohë që qeveria poststaliniste e Moskës promovonte Kursin e Ri, kur në republikat sovjetike po mbylleshin gjithandej *gulagët* dhe qeveritë komuniste po lironin të burgosurit politikë.

Gjithsesi, atë çka regjimi është përpjekur ta fshehtë, ajo ka mbetur gjallë në kujtimet e mjaft prej të mbijetuarve, si prof. Sami Repishti,\* Kurt Kola,\*\* Amik Kasoraho,\*\*\* Agim Musta\*\*\*\* e shumë të tjerëve. Një botim i mrekullueshëm i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, kolona disavëllimëshe *Ad memorandum* na vjen si kontribut me vlera autentike dokumentare. Në raportin që përmenda, po sidomos në kolanën e cituar, përshkruhen fate tragjike të njerëzve të pambrojtur, të grave e fëmijëve, të pleqve etj., duke na sjellë dimensione çnjerëzore. Kjo temë ka tërhequr vëmendjen edhe të studiuesve të huaj. Ndër ta, prof. Lori Amy sjell vëzhgime interesante për dhunën dhe mohimin në Shqipërinë komuniste. Me interes është edhe një tezë e saj për ekzekutimet publike, qëmtuar nga biseda të drejtpërdrejta me njerëzit, megjithëse deri më tani jo fort e mbështetur me të dhëna nga arkivat.<sup>41</sup>

Në vijim, po i kthehem më në hollësi një dukurie të njohur, por shumë të dhimbshme, që ka të bëjë me të ekzekutuarit në burgjet e komunizmit, mjaft prej të cilëve ende nuk kanë një varr të identifikuar. Kjo është një dramë e trashëguar e, me sa duket, nuk ka gjasa të mbyllet. Më 1947 një dekret i Presidiumit të Kuvendit Popullor, me propozim të ministrit të Brendshëm Koçi Xoxe, normonte praktikën e ekzekutimit të veprave penale, midis tyre edhe dënimet me vdekje. Sipas atij dekreti, një ditë para ekzekutimit, njoftohej familja e të dënuarit me vdekje dhe “që prej këtij lajmërimi, të dënuarin mund ta vizitojnë të afërmit e tij ose persona të tjerë,

---

<sup>39</sup> AQSH, F. 490, V. 1970, D. 255. Relacion i Ministrisë së Brendshme për Kryeministrin Mehmet Shehu, datë 10.3.1970.

<sup>40</sup> *Po aty*.

\* Sami Repishti, *Pika Loti*, Shkodër: “At Gjergj Fishta”, shih gjithashtu: *Nën hijen e Rozafës (narrativë e jetueme)*, Tiranë: Onufri botime, 2004.

\*\* Kurt Kola, *Në Shqipërinë burg*, Tiranë: UET Press, 2016.

\*\*\* Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë: 2017.

\*\*\*\* Agim Musta. *Burgjet e shtetit Burg*, Tiranë: Botimet Toena, 2000.

<sup>41</sup> Lori Amy “Re-Membering in Transition: The Trans-National Stakes of Violence and Denial in Post-Communist Albania”, in: *History of Communism in Europe, Vol. I, Politics of Memory in Post-Communist Europe*, Bucharest: Zeta Books, 2010, pp. 205 - 222.

me të cilët ai dëshiron të flasë”(neni 7). Po ashtu “Kufoma e personit të ekzekutuar mund t’i dorëzohet familjes së tij për t’u varrosur pa ceremoni”(neni 9).<sup>42</sup>

Por ky trajtim merr fund kur pasardhësi i Xoxes, Mehmet Shehu, i kërkoi Byrosë Politike “të ndryshojmë disa ligje të cilat nuk i kemi aspak në rregull, siç është leja për takim që u jepet familjeve të atyre që është vendosur të ekzekutohen, përpara se të bëhet kjo gjë ose të dihet vendi se ku është bërë ekzekutimi.”<sup>43</sup> Për pasojë, një dekret i vitit 1950 u mor posaçërisht me ekzekutimin e dënimeve me vdekje, duke ndryshuar dy nene të dekretit të vitit 1947. Konkretisht, dekreti i ri abrogoi nenin 7 të dekretit të mëparshëm, duke ua hequr të drejtën familjarëve dhe të afërmeve të tjerë të shihnin njeriun e tyre për herë të fundit. Po ashtu, ky dekret ndryshoi nenin 9, i cili deri atëherë lejonte t’i dorëzohej familjes trupi i të vdekurit. Neni i ri u formulua kështu: “Kufoma e personit të ekzekutuar varroset nga ana e organeve të brendshme me shpenzimet e shtetit.”<sup>44</sup> Kjo do të thoshte që trupi i të vdekurit nuk i jepej familjes, duke nënkuptuar edhe fshehtësinë e vendvarrosjes. Arsyeja për këto ndryshime në ligj është se, sipas relatorëve të projektit, takimi i familjarëve me të dënuarin “përveç dëmeve, nuk ka pasur asnjë dobi, sepse jo vetëm ka shkaktuar vajtime dhe lutje të kota, por i dënuari u thotë zakonisht familjarëve të tij se gjoja është i pafajshëm dhe se pushteti e ka dënuar padrejtësisht, duke ngjallur në këtë mënyrë ndjenjën e urrejtjes dhe të hakmarrjes”. Shpjegimet shkojnë edhe më tej, kur thuhet se “në takim, i dënuari, me anë parullash mund të merret vesh dhe të japë udhëzime për shumë gjëra” dhe se “për të njëjtat arsye dorëzimi i kufomës së të ekzekutuarit familjes së tij për ta varrosur, nuk është oportun”.<sup>45</sup>

Pas dekretit të vitit 1950, ka edhe dy dekrete të tjera që janë marrë me këtë çështje, më 1962 dhe më 1973. Dekreti i vitit 1962, ashtu si edhe ligjet e mëvonshme, i mbahen formulimit të vitit 1950, sipas të cilit “kufoma e personit të ekzekutuar varroset nga ana e organeve të Punëve të Brendshme, me shpenzimet e shtetit”.<sup>46</sup> Por ekzekutimi i dënimeve me vdekje është vetëm një pjesë e problemit të madh të trajtimit të të vdekurve në burgjet e komunizmit në Shqipëri. Kjo çështje, pra sjellja me të vdekurit, nuk është trajtuar me ligje, por me urdhra dhe udhëzime, si dhe me rregullore, dalë nga Ministria e Punëve të Brendshme. Jam këshilluar me disa prej këtyre dokumenteve, konkretisht me një urdhër të ministrit të Brendshëm, më 1950,

---

<sup>42</sup>AQSH, F. 489, V. 1947, D. 67. Dekret ligj nr. 390, datë 10.1.1947 i Presidiumit të Kuvendit Popullor “Mbi ekzekutimin e vendimeve penale”.

<sup>43</sup>AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1949, D. 56. Protokoll nr. 66 i mbledhjes së Byrosë Politike, ku merret në shqyrtim një raport për çështjet e drejtësisë, më 7 shtator 1949, f. 27.

<sup>44</sup>AQSH, F. 489, V. 1950, D. 112. Dekret ligj nr. 1130, datë 14. 8. 1950 i Presidiumit të Kuvendit Popullor “Mbi disa ndryshime në Dekretligjin nr. 390, datë 10.1.1947 mbi ekzekutimin e dënimeve.”

<sup>45</sup>Po aty, Procesverbal i mbledhjes nr. 347 të Kuvendit Popullor, më 14 gusht 1950.

<sup>46</sup>AQSH, F. 489, V. 1962, D. 100. Dekret nr. 3584, datë 12.11.1962 “Mbi ekzekutimin e vendimeve penale.”

me rregulloret e administrimit të burgjeve dhe të kampeve, më 1965, 1977, 1983 dhe 1985. Midis tyre më ka tërhequr vëmendjen rregullorja e vitit 1965, sipas të cilës të dënuarit me heqje lirie që vdesin në burgje, “varrosen në varrezat më të afërta të qytetit ose katundit ku është dislokuar burgu ose kampi”.<sup>47</sup> Unë nuk e kam ndjekur, por mendoj se është me interes të saktësohet, nëse ka pasur vërtet në këto varreza të qytetit apo fshatit parcela të posaçme, qoftë dhe varre të veçantë, aq sa ka pasur, për të ekzekutuarit apo për të vdekurit në burgje.

Më 1983, një udhëzim i ministrit të Brendshëm të kohës, Hekuran Isai, i ndau më dysh të vdekurit në burgje, përfshirë të ekzekutuarit, një palë që u ktheheshin familjeve, ndërsa të tjerët jo. Pak a shumë, një tjetër luftë klase në ushtrinë e të deklasuarve. Në grupin e atyre që nuk ktheheshin, më kryesorët ishin të ekzekutuarit me varje ose pushkatim, të vdekurit në burg që ishin dënuar për krime kundër shtetit, si dhe nga ata të burgosur që në gjallje ishin konsideruar me rrezikshmëri të veçantë shoqërore (!).<sup>48</sup> Nga trembëdhjetë të vdekur në burgje më 1983, gjashtë prej tyre kanë qenë të dënuar për krime kundër shtetit.<sup>49</sup>

Nga jashtë, duket se më 1983 u bë një lëshim. Në fakt, udhëzimi i ministrit veçse e thelloi dramën. Në atë udhëzim për herë të parë nuk u zunë në gojë varrezat e fshatrave e të qyteteve, ku do të preheshin të vdekurit që nuk mund t’i merrnin familjarët. Për ta u formulua pika 15 e Udhëzimit të ministrit, ku thuhet: “Personat e vdekur, për të cilët nuk lejohet dhënia e kufomës varrosen në vende të caktuara posaçërisht në bashkëpunim me organet e pushtetit dhe mbahet evidencë e rregullt sipas modelit të miratuar dhe skemë (hartë topografike) e posaçme për vendin e varrimit. Në kokën e varrit të vendoset një tabelë në të cilën të shkruhet vetëm nr. i regjistrimit të tij.”<sup>50</sup> Për korrektesë, në këtë dokument, megjithëse me firmë, ka një shënim me këtë përmbajtje: “Të ripunohet. Ta bisedojmë me gjykatën.” Kësisoj, do ta merrnim të paqenë këtë udhëzim, nëse nuk do të ishte përmendur për referencë në dokumentet e mëvonshme lëshuar nga kjo ministri. \* Për më tepër, pikën 15 të udhëzimit që flasim e përmban fjalë për fjalë edhe një dokument i mëvonshëm, Rregullorja për sigurimin e të dënuarve në burgje, më 1985.<sup>51</sup>

---

<sup>47</sup>AMPB, F. 50, V. 1965, D. 1683. Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 01-68, datë 16.10.1965, për miratimin e Rregullores për administrimin e burgjeve ose kampeve. Shih edhe: AMPB, F. 7/ Drejtoria e Zbatimit të Veprave Penale (më tej: DZVP), V. 1988, D. 268, Letër e zëvendësministrit të Brendshëm për KQ të Partisë, më 14.9.1988.

<sup>48</sup>AMB, F. 7/ DZVP, V. 1983, D. 34, f.2. Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-90, datë 8.6.1983 për dhënien e kufomave familjeve të personave që vdesin në repartet e riedukimit, burgjet dhe dhomat e izolimit, f.2.

<sup>49</sup>Po aty, f. 6, shënim i drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Veprave Penale, më 9.3.1984.

<sup>50</sup>AMB, F. 7/ DZVP, V. 1983, D. 34. Udhëzim i Ministrit ... Dokument i përmendur në referencën 48, f. 4.

\* Shih: AMB, F. 7/ DZVP, V. 1988, D. 268. Letër e zëvendësministrit të brendshëm për KQ të Partisë, më 14.9.1988.

<sup>51</sup>AMB, F. 50/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Popullore, V. 1985, D. 10746. Rregullore mbi sigurimin dhe riedukimin e të dënuarve në repartet e riedukimit dhe burgjet, miratuar me Urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-78, datë 25.9.1985, f. 82.



Përmasat e dramës u bënë të qarta më 1991, kur qeveria e parë pluraliste krijoi një komision shtetëror për ish të përndjekurit politikë, ndërsa në Ministrinë e Rendit Publik, në burgje dhe në degët e rendit publik të rretheve u ngritën komisione për eshtrat e të vdekurve. Në raportet e kohës u sollën të dhëna të përafërta, nxjerrë nga Arkivi i Ministrisë, sipas të cilave në 40 vjet, që prej 1945 deri më 1985, në burgje kishin vdekur, pushkatuar ose ishin vrarë në përpjekje luftarake 2819 vetë.<sup>52</sup> Po ku ishin varret e tyre? Në cilat varreza publike? Në cilën faqe kodre a në cilën rrëzë mali? Në cilin breg lumi, në cilën korie, cep pylli apo kudo gjetkë? Gjithçka rezultoi zhgënjyese. Nga kërkimet në arkiva doli që “... në shumicën e rasteve nuk gjenden procesverbalet e vdekjes, të ekzekutimit, as dhe skemat e vendvarrimit të tyre.” Po ashtu u raportua se po haseshin shumë vështirësi “për personat që kanë rënë në përpjekje, pasi për ta nuk ka asnjë lloj dokumentacioni, as edhe vendvarrimi.”<sup>53</sup> Dhe nuk ishin pak. Deri atëherë komisioni kishte mundur të identifikonte 614 persona.<sup>54</sup> Por mungesa e dokumentacionit nuk ishte (dhe nuk është) vështirësia e vetme. Raportet thonë se në plot raste, aty ku kishte dokumente, skema e lista, në terren mungonin shenjat dalluese. Më e keqja e të këqijave, vetë terrenet e shënuara nëpër harta qenë transformuar me ndërtime industriale, rrugë, tarraca, bonifikime, përmbytje etj.<sup>55</sup>

Në përfundim, mbeten të mundimshme mjaft nga *pse*-të e kësaj drame. Jo thjesht e as vetëm për studiuesit. Më kryesorja, për vetë shoqërinë. Përpiqemi të kuptojmë zhvillimet menjëherë pas luftës dhe themi se ashpërsia e pushtetit është e shpjgueshme për atë kohë. Po e pranojmë si të pritshme edhe ndërhyrjen në ligj, më 1950, për të ekzekutuarit me vdekje, ndërkohë që operacioni *Rollback* i Perëndimit kundër Shqipërisë ishte në kulmin e vet. Momente të tilla, sipas meje, flasin për pasiguri të pushtetit dhe në kësi rastesh regjimet komuniste zgjedhin terrorin. Po nëse e pranojmë si të shpjgueshëm terrorin e viteve ‘50-të, si ta kuptojmë këtë gjë në vitet ‘80-të? Përsëri sipas meje, rrethanat janë të ngjashme. Në vitet ‘80-të dështimet e regjimit u bënë evidente. Enver Hoxha ndërmori spastrime të egra në rrethin e bashkëpunëtorëve dhe thirri pranë vetes proletarë të besueshëm. Lufta e klasave u kthye në rendin e ditës. Me këtë represion të ri lidhen edhe fatet e atyre që kishin guxuar, kundërshtarët e njëmendtë të pushtetit, të burgosurit politikë. Për ata regjimi kishte rezervuar dënimet më makabre, duke i lënë pa rini, sa ishin në këtë jetë dhe pa varr në atë jetë!

---

<sup>52</sup>AMB, F. 7/DZVP, V. 1992, D. 9. Informacion për kthimin e eshtrave të ish të dënuarve politikë, ekzekutuar ose vdekur në burg, pa datë.

<sup>53</sup>Po aty.

<sup>54</sup>Po aty.

<sup>55</sup>AMPB, F. 7/DZVP, V. 1991, D. 7. Informacion i ministrit të Rendit Publik drejtuar Këshillit të Ministrave për kthimin e eshtrave në familje të ish të dënuarve, vdekur në burg ose ekzekutuar, më 26.10.1991.

\*\*\*

Duke u përpjekur të parashtrij diçka nga sa kam vërejtur për periudhën e marrë në shqyrtim, më duhet të them se tema e përjashtimit ‘*të tjetrit*’ mbeti temë e ditës gjithë kohën sa zgjati vetë sistemi që shkoi. Madje, dukuria u zgjerua aq shumë sa kufizimit dhe mohimit iu nënshtruan edhe disa nga liritë më elementare të njeriut. Liria e besimit është njëra prej tyre. Që këtej, më duhet t’i kthehem përsëri një pyetjeje: Mirë që një pushtet arbitrar e ka devizë të vetën dhunën kundrejt pakicës kundërshtare, po ashtu po e pranojmë se një pushtet i tillë e ka nevojë t’i mbajë në distancë intelektualët kritikë, duke i ndarë ata në ‘*tanët*’ dhe ‘*jo tanët*’, po pse kufizimi e mohimi të shkojnë deri te njerëzit e pambrojtur, madje deri te dashamirësit e pushtetit? Mendoj se regjimet komuniste e kanë nevojë të administrojnë ndjenjën e frikës. Ato manifestojnë egërsi me kundërshtarit, pikërisht për shkak të frikës që kanë prej tij. Mbajnë në kontroll segmentet e pasigurta në shoqëri prapë për shkak të frikës prej tyre. Dhe mbi të gjitha, kontrolli i turmës. Injektimi në turma i frikës prej pushtetit është mënyra më efektive që pushteti t’i shpëtojë frikës që vjen prej tyre. Që prej këtij momenti ‘*tjetri*’ nuk është më vetëm armiku, kundërshtari politik, intelektual i dyzuar, në ‘*tjetri*’ kthehet vetë turma. Madje edhe atëherë kur prej saj merr duartrokitje dhe brohoritje. Që do të thotë se atëherë është mbërritur në shkallën më të lartë të terrorit. Në regjimin komunist kjo është e provuar. Por me këtë akt të fundit komunistët shkuan larg, duke humbur të drejtën e përfaqësimit të shumicës. Rënia e legjitimitetit shënoi dhe fillimin e fundit të regjimit.

# Dorian Koçi - Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë

## Aparati stalinist i dhunës në burgjet e kampet e punës në Shqipëri 1949-1953

### Abstrakt

Komunizmi dhe fashizmi si pjesë të ideologjive totalitare apo murtajave të shekullit, ushtruan terror për të realizuar qëllimet e tyre të inxhinierive sociale. Komunizmi shqiptar ishte derivat i komunizmit sovjetik, i pajisur me asistencë dhe ndihmë jugosllave. Tmerri i vërtetë i terrorit është se ai sundon mbi një popullsi plotësisht të nënshtruar. Propaganda është një instrument dhe ndoshta më i rëndësishmi i totalitarizmit, për t'u lidhur me botën jototalitare, kurse terrori është vetë thelbi i formës së tij të qeverisjes.

### Totalitarizmi

Në vendet totalitare propaganda dhe terrori paraqet dy anë të së njëjtës monedhë. Kudo që totalitarizmi zotëron kontroll absolut, ai zëvendëson propagandën me indoktrinimin dhe e përdor dhunën jo aq sa për të frikësuar njerëzit, sesa për të realizuar vazhdimisht doktrinat e tij ideologjike dhe gënjeshttrat e tij praktike.<sup>56</sup> Kjo ishte situata që u instalua në Shqipëri menjëherë pas ardhjes në fuqi të komunistëve pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Për shumëkënd që e njëjtte historinë e instalimit të pushtetit sovjetik në Bashkimin Sovjetik nuk kishte dyshime se një model dhe praktikë e tillë do të ndiqej edhe nga komunistët shqiptarë. Komunizmi shqiptar ishte një derivat i komunizmit sovjetik i pajisur me asistencë dhe ndihmë jugosllave. Terrori përdoret në regjimet totalitare edhe kur synimet e tij psikologjike janë arritur; tmerri i tij i vërtetë është se ai sundon mbi një popullsi plotësisht të nënshtruar. Propaganda është një instrument, ndoshta nga më të rëndësishmit e totalitarizmit, për t'u lidhur me botën jototalitare, kurse terrori është vetë thelbi i formës së tij të qeverisjes.

Por a është terrori në vetvete një tipar i regjimeve të drejtuara nga partitë komuniste? Sigurisht që zhvillimet e mëvonshme e kanë saktësuar këtë dilemë. Komunizmi dhe fashizmi si pjesë të ideologjive totalitare apo murtajave të shek. XX, siç i vlerësuan mendimtarë të mëvonshëm, ushtruan terror për të realizuar qëllimet e tyre të inxhinierive sociale. Totalitarizmi është dukuri e shek. XX. Kjo nuk do të thotë se në të kaluarën nuk ka pasur regjime qeverisëse, që janë orvatur për sundim të pakufizuar, si p.sh. Luigji XIV në Francë me sloganin e tij të famshëm “Shteti jam unë”<sup>57</sup>. Por sundimtarët e para shek. XX, nuk mundën ta vendosin sundimin totalitar e të pretendonin për një kontroll qeverisës me të vërtetë total dhe, aq më pak, ata nuk arritën dot ta manipulonin masën e gjerë të popullsisë. Totalitarizmi u bë i mundur në

<sup>56</sup> Hannah Arendt, *Origjinat e totalitarizmit*, Prishtinë: Dija, 2002, f. 441.

<sup>57</sup> Llambro Filo, *Sistemet politike bashkëkohore*, Tiranë: Ideart, 2008, f. 342.

rrethanat e zhvillimit të teknologjisë së avancuar e të modernizimit të mëtejshëm të të gjitha mjeteve të komunikimit, të armëve dhe të ushtrisë. Këto zhvillime lehtësuan shtrirjen dhe forcimin e kontrollit të gjithanshëm shtetëror. Fried Uillhuid e përcakton totalitarizmin si formë e autokracisë të shek. XX, i cili përdor ide, teknika dhe institucione prej periudhave të mëparshme historike, por të kombinuara me teknologjinë moderne për të krijuar një tip të ri regjimi. Totalitarizmi komunist ka këto tipare:

1- **Ideologjia e vetme sunduese ose ideologjia totalitare.** Ideologjia marksiste konsiderohet si udhëheqëse në të gjitha aspektet e qeverisjes e veprimtarisë publike dhe private dhe është e detyrueshme për t'u përqaftuar nga të gjithë individët. Ajo cilësohet si botëkuptim i gjithanshëm, që përshkon dhe mishëron gjithçka. Ideologjia paraqitet si platformë e “së ardhmes” e ndërtimit të “shoqërisë së re” e të “rendit të ri”. Ky lloj regjimi nuk lejon ideologji apo alternativa të tjera politike apo filozofike.

2 - **Ekzistenca e një partie të vetme, e cila kontrollon të gjitha pushtetet (partishtet).** Partia vendos monopolin në drejtimin e vendit dhe të të gjitha hallkave të qeverisjes, prandaj qeverisja cilësohet si parti shtet; likuidohet konkurrenca politike, opozita politike.

3- **Kulti i udhëheqësit.** Udhëheqësi është ai që përcakton zhvillimin dhe çdo gjë i nënshtrohet autoritetit të tij. Ai është udhëheqës i përhershëm.

4 - **Ekspozimi i madhësisë së komb-shtetit dhe i kontrollit total të shtetit.** Komb-shteti vihet mbi gjithçka; të gjitha aspektet e jetës politike, sociale, ekonomike, kulturore, shpirtërore janë subjekt i kontrollit të shtetit. Individu është i varur dhe i nënshtuar prej shtetit. Nuk lejohen organizata të pavarura, joqeveritare, ose ato vihen nën kontrollin e plotë të shtetit. Nuk ka kufizime ndaj ndërhyrjes qeveritare. Të tria hallkat e qeverisjes janë të shkrira në kuadrin e drejtimit njëpartiak e parti-shtet.

5-**Terrori dhe frikësimi masiv.**<sup>58</sup> Sajimi dhe deklarimi i armiqve të klasës dhe të kombit. Terrori ushtrohet ndaj elementëve të veçantë në trajtën e gjenocidit. Qëllimi i terrorit është të ngjallë frikë në masën e gjerë të popullsisë. Regjimi totalitar komunist prodhon armiq, ndaj të cilëve merren masa shtrënguese, shtypëse, represive deri në likuidimin fizik. Për regjimet komuniste armiq të janë klasa e borgjezisë, e çifligarëve, imperialistët, të cilësuar si klasa shtypëse e shfrytëzuese, armiq të proletariatit dhe të fshatarësisë. Në komunizëm “lufta e klasave” trajtohet dhe cilësohet si forcë lëvizëse për të gjithë periudhën e transformimit të shoqërisë. Pra, gjatë gjithë periudhës së socializmit e të kalimit në komunizëm kërkohen dhe zbulohen armiq të rinj. Në Shqipëri i gjejmë të gjitha format e komunizmit dhe një ndikim të

---

<sup>58</sup> Ll. Filo, *Sistemet politike ...*, f. 342-343.

madh ka pasur stalinizmi, e cila ka qenë ideologji sunduese. Në jetën politike, regjimi komunist shqiptar ndoqi verbërisht përvojën sovjetike.<sup>59</sup> Më 1 shtator 1952 u vu në zbatim Kodi i Ri Penal. Duke bërë fjalë për të, ish ministri pasardhës i Drejtësisë, Bilbil Klosi, shkruante se “në kompliminin e kodit të ri jemi frymëzuar nga Kodi Penal Sovjetik. Duke marrë parasysh përpjekjet e përsëritura për një kryengritje në vendin tonë, të përkrahur dhe të drejtuar nga elementë të huaj, kemi qenë të shtrënguar të vëmë masa dhe dënime më të rrepta nga ato që ka Kodi Penal Sovjetik”.<sup>60</sup> Siç mund të kuptohet nga këto pohime nga përfaqësuesit më të lartë të sistemit të drejtësisë, Shqipëria ishte vendi socialist me diktaturën më të egër në vendet e Lindjes Komuniste.

### **Aparati i dhunës nën stalinizmin shqiptar**

Stalinizmi shqiptar është një kopje e atij sovjetik. Arshi Pipa pohon në shkrimet e veta se “stalinizmi depërton në ideologjinë shqiptare sikur të justifikojë monedhën e bashkimit “stalinoshqiptarizëm”.<sup>61</sup>

Ndërsa vendet e tjera të Evropës Lindore kishin adoptuar tipare të veçanta nga stalinizmi sovjetik, Shqipëria kishte marrë pothuajse gjithçka. Hoxha ashtu si Stalini zhduku kundërshtarët politikë në fushat e kulturës, arsimit dhe mbrojtjes. Modeli stalinist në Shqipëri u zbatua në këto drejtime: në eliminimin e elitave të mëparshme drejtuese të vendit, në industrializimin socialist, ku me përparësi u zhvillua industria e rëndë dhe në punën e papaguar në funksion të zhvillimit të vendit. Në funksion të këtyre premisave u zhvillua dhe ndërtimi i kampeve të internimit për të shfrytëzuar një qëllim të dyfishtë. Në njërën anë instrumentalizohej terrori për të izoluar të ashtuquajturit armiq të brendshëm dhe në anën tjetër shfrytëzohej puna e papaguar e njerëzve në funksion të sfidave të reja që hasi regjimi si për rindërtimin e vendit pas lufte, por dhe për projektet ideologjike të propagandës siç ishte tharja e kënetës së Maliqit.

Njohja e diktaturës staliniste nuk ka kuptim nëse nuk njohim misterin e burgjeve dhe të kampeve të internimit. Mijëra shqiptarë patën fatin e keq të provonin egërsinë e diktaturës staliniste, duke vuajtur dënimin në burgjet dhe kampet e internimit. Në Shqipëri diktatura staliniste gjeti terren të përshtatshëm dhe u ushtrua në formën më të tmerrshme të saj.<sup>62</sup> Për ta konkretizuar këtë po japim një pasqyrë të përgjithshme të kampeve të internimit në vitet 1949-1953.

---

<sup>59</sup> Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë: Ideart, 2004, f. 348.

<sup>60</sup> Luan Malltezi, *Terrori komunist në Shqipëri*, Tiranë: Grapic-Line-01, 2012, f. 1.

<sup>61</sup> Arshi Pipa, *Stalinizmi shqiptar*, Tiranë: IKK &Princi, 2007, f. 250.

<sup>62</sup> Kastriot Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste*, Tiranë: ISKPK, 2015, f. 3.

**Kampi i Tepelenës** filloi të funksionojë në maj të vitit 1949. Në këtë kamp u internuan familje nga veriu i Shqipërisë pasi shteti komunist shqiptar ndërpreu marrëdhëniet e ngushta me Jugosllavinë dhe ato u konsideruan si potencial i mundshëm i popullsisë për t'u arratisur. Fillimisht të dënuarit i strehuan në fshatrat e Tepelenës si Turan, Memaliaj dhe Veliqot. Meqë këto fshatra nuk kishin asnjë mundësi për të vazhduar si kampe internimi dhe vdekshmëria ishte e lartë, kampi u zhvendos në afërsi të qytetit të Tepelenës. Në fushën e qytetit qenë gjashtë kazerma të ushtrisë italiane, të cilat u përshtatën si vende banimi dhe u rrethuan me tela me gjemba. Në çdo kazermë jetonin rreth 200 persona. Numri i përgjithshëm i të internuarve i kalonte një mijë vetë. Përveç kushteve të vështira të jetesës një rrezik potencial për të internuarit ishin edhe minat që kishin mbetur nga Lufta e Dytë Botërore.

Lirim Biçaku, një nga të internuarit në këtë kamp do ta kujtonte kampin e Tepelenës në këtë mënyrë: “Në Tepelenë flinim në një kapanon të madh të kohës së luftës, ndërtuar nga italianët. Në tokë kishim shtrirë nga një copë dërrasë dhe të gjithë qëndronin të radhitur si fishekët në karikator. Për 5 vjet se pamë kurrë ngjyrën dhe ngrohtësinë e zjarrit. Banjën e kishim 200 metra larg në breg të lumit, se dinim se çfarë ishin ndërresat”. Të internuarit bënë punë bujqësie. Burrat transportonin dru nga mali i Turanit dhe përshkonin një rrugë 7 km, ndërsa gratë mblidhnin pleh organik dhe e transportonin në kurriz me litar. Një grup vajzash transportonte driza, që merreshin tek ura e Dragotit rreth 5 km. Të tjerët bënë qilizmë. Në maj të vitit 1950 në kamp ishin 284 burra, 514 gra dhe 554 fëmijë”. Tmerret e kampit famëkeq të Tepelenës i kishin kaluar kufijtë e Shqipërisë. Këto krime u diskutuan, në raportin e qeverisë amerikane, paraqitur në OKB në shkurt 1955.<sup>63</sup> Kampi i Tepelenës qëndroi gjashtë vjet dhe u mbyll më 1954. Në pavijonin e Terrorit Komunist të Muzeut Historik Kombëtar ndodhen një sërë objektesh, të cilat janë përdorur nga të burgosurit, Gjon Tunxhi dhe Nikoll Mazreku, të cilët kanë kryer dënimin në kampin e Tepelenës. Përveç objekteve kemi edhe një stendë me skica të bëra nga Lek Previzi, i cili na sjell pamje nga kampi i Tepelenës. Pantallonat e Gjon Tunxhit janë të arnuara me fije flokësh të nënës së tij Mrika Tunxhi gjatë kohës së internimit. Objekti tjetër është një gotë për të matur racionin e miellit që u jepej për frymë në kampin e Tepelenës. Gjon Tunxhi është dënuar nga diktatura, ka humbur një këmbë në burgun e Gjirokastrës. Më pas u internuan në vende të tjera internimi në Shqipëri.

**Kampi i Çorovodës.** Në vitin 1951 deri në janar 1953, një pjesë të vuajtësve të kampit të Tepelenës i dërguan në një kamp në Çorovodë. Të internuarit bënë punimet për rregullimin e hyrjes së qytetit. Gjithashtu kanë punuar për ndërtimin e godinës së degës së punëve të

---

<sup>63</sup> K. Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste ...*, f. 17-18.

brendshme dhe të komitetit të Partisë së Punës së qytetit të Çorovodës. Ndër të internuarit kanë qenë aktori Gjoshë Vasija, Dom Nikollë Mazreku etj.<sup>64</sup>

**Kampi i Lozhanit.** Kampi filloi të funksionojë në prill 1949. Të internuarit u dërguan në Lozhan të Korçës, duke ecur më këmbë për 17 ditë e net. Në kampin e Lozhanit kishin sjellë të kryenin dënimin edhe 80 çamë, të cilët nuk kishin pranuar të bashkoheshin me forcat e EAM-it (Partisë Komuniste Greke) për të luftuar kundër monarko-fashistëve grekë. Numri i përgjithshëm i të internuarve në kamp ishte 250 vetë. Të internuarit punonin për hapjen e rrugës Gramsh-Lozhan. Një pjesë e të internuarve i transferuan në kampin e Porto Palermos.

**Kampi i Porto Palermos.** Kampi ka filluar të funksionojë gjatë viteve 1949-1950. Numri i të internuarve ka qenë 181, prej të cilëve 82 burra, 62 gra dhe 37 fëmijë. Në kampin e Porto Palermos të internuarit vuanin për ujin e pijshëm. Kalaja e Porto Palermos e ndërtuar dikur nga Ali Pashë Tepelena ishte vend i rrethuar nga deti dhe të internuarit nuk kishin asnjë komunikim me tokën. Të internuarit bënë punë sezonale, duke vjelë ullinj në Himarë. Ata i mbanin për një kohë të gjatë në errësirë, prandaj vuanin nga shikimi. Kampi i Porto Palermos u mbyll në dhjetor 1950.

**Kampi i fermës “Çlirimi” në Fier.** Kampi është hapur në qershor të vitit 1950. Në këtë kamp internimi kanë qenë edhe 200 emigrantë grekë, të cilët qenë larguar nga lufta civile që bëhej në vendin e tyre. Midis tyre kishte komunistë dhe monarko-fashistë. Të internuarit merreshin me punë të detyruar në bujqësi.

**Kampi “Lufta e Vlorës” në Llakatund.** Kampi filloi të funksionojë në qershor të vitit 1950. Në kamp qenë 50 të internuar dhe 20 të burgosur. Në fundin e vitit 1953 në kampin e Llakatundit u sollën 207 emigrantë jugosllavë, duke përfshirë edhe shqiptarët nga Kosova. Të internuarit merreshin me punë të detyruar në bujqësi.

**Kampi i Valiasit, Tiranë.** Kampi është hapur në vitin 1948 pranë fermës “Ylli i Kuq” në Valias. Të internuarit qëndronin nëpër çadra, stalla e shtëpi të vjetra dhe merreshin me punë të detyruar në bujqësi. Gjatë muajve janar-maj 1950 në kampin e Valiasit vuanin dënimin edhe rreth 200 robër gjermanë. Sipas të dhënave të vitit 1950 në kampin e Valiasit numri i të internuarve kapte shifrën e 820 personave. Të internuarit qenë të paveshur e të rreckosur, karakteristikë kjo e përgjithshme e kampeve të internimit. Kampi i Valiasit ka funksionuar deri në fundin e vitit 1952.

Në fund të vitit 1953, duke u nisur nga vdekshmëria e lartë e fëmijëve në kampin e Tepelenës, por edhe nga nevoja për të konsoliduar institucionin e vuajtjes së dënimit regjimi

---

<sup>64</sup> Fatbardha Mulleti, *Kalvari i grave në burgjet e komunizmit*, Tiranë: ISKPK 2013, f.132.

vendosi mbylljen e kampeve të rrethuar me gjemba, duke kaluar në një vend internimi të hapur ku të internuarit do të merreshin me punë të detyruar në bujqësi. Më 14 dhjetor 1953 doli dekreti nr. 1782 i Presidiumit të Kuvendit Popullor, i cili ndalonte shfrytëzimin në punë të të internuarve.<sup>65</sup> Ky hap u ndërmor në fakt edhe në kuadër të politikës së shkrirjeve të akujve që kish filluar në Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së Stalinit.

Vdekja e Stalinit e gjeti të papërgatitur Lindjen Komuniste për sfidat e reja në ballafaqimin me Perëndimin. Një nga tiparet e sistemeve totalitare është pagabueshmëria e udhëheqësit dhe mosgatishmëria e këtij të fundit për të lënë pasardhës. Bashkimi Sovjetik u gjend pikërisht në një situatë të tillë, pasi asnjë udhëheqës komunist nuk ishte konfiguruar qartë në pozitën e një udhëheqësi pasardhës. Malenkovi, Hrushovi, Molotovi dhe Beria nuk mund të ndërmerrnin pa bashkëpunuar dhe pa u njohur nga njëri-tjetri si udhëheqës suprem. Prandaj në këtë situatë u përshtat koncepti i asaj që ekzistonte si frymë kolegjaliteti në vendimmarrje, por që rrallëherë ishte ushtruar, përveç rasteve kur Stalini nuk kishte dashur të mbante mbi shpinën e vet vendimmarrjet e vështira. Kjo frymë, e vendosur në Moskë u përhap si rrathët koncentrikë në pothuajse të gjitha vendet e Bllokut Komunist.

Në vitet '50, Lindja Komuniste përjetoi kudo probleme të ngjashme, aq sa pas vdekjes së Stalinit, ajo u rrezikua të përfshihej nga trazirat. Për këtë arsye Moska u kërkoi qeverive satelite që buxhetet e tyre të shkonin më shumë për plotësimin e nevojave të popullsisë me produkte ushqimore dhe mallra konsumi, qeveritë të aplikonin politika më liberale tregu dhe shërbimesh për qytetarët, të ndërprisnin për një kohë ngritjen e kooperativave në fshat etj.<sup>66</sup> Në këtë mënyrë, Moska kërkoi që pakënaqësitë e ndryshme në Evropën Lindore t'i zbuste përmes një politike më liberale në ekonomi. Këtë lloj liberalizimi Kremlini kërkoi ta shtrinte edhe në politikën e brendshme të vendeve të Bllokut Lindor duke ndërprerë politikat e terrorit stalinist dhe promovuar një politikë më liberale.

Lidhur me trajtimin e kundërshtarëve politikë dhe përmirësimin e të drejtave themelore të njeriut, si e drejta e lëvizjes, e drejta e punës dhe e drejta e fjalës, Moska kërkoi po ashtu amnisti të gjerë për të arratisurit dhe burgosurit politikë, prishjen e kampeve të punës ose të qendrave të internimit.<sup>67</sup> E gjithë kjo politikë e re sovjetike u emërtua Kursi i Ri i Hrushovit. Për ironi të fatit, ata që e ideuan dhe u munduan ta vinin në zbatim kishin qenë të gjithë bashkëpunëtorët më të ngushtë të Stalinit, si: Hrushovi, Malenkovi, Molotovi etj.

---

<sup>65</sup> K. Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste ...*, f. 22-28.

<sup>66</sup> Ana Lalaj, *Pranverë e rrejtshme e '56*, Tiranë: Infobotues, 2015, f. 32.

<sup>67</sup> A. Lalaj, *Pranverë e rrejtshme e '56 ...*, f. 32.



Kursi i Ri i Moskës i trazoi ndjeshëm ujërat në Bllokun e Lindjes. Formalisht ai u pranua dhe në Tiranë, por gjatë zbatimit u frenua hap pas hapi.<sup>68</sup> Për udhëheqjen shqiptare kjo shkrirje e akujve do të thoshte liberalizim i politikës së brendshme të modelit ekonomik, që kishte ndjekur deri më atëherë. Modeli ekonomik shqiptar qe një model që karakterizohej nga masat shtrënguese ndaj fshatarësisë dhe sforcimit për të ndërtuar baza industriale të papërballueshme nga buxheti i shtetit. Drejtuesit e rinj sovjetikë që erdhën pas Stalinit, ia thanë hapur Enver Hoxhës: “ju e vidhni, e grabisni fshatarësinë. Me të filluar fshatari të mëkëmbë ekonominë, ju menjëherë nxirni ligje e urdhëresa dhe ia rrëmbeni. Në 200.000 tonë prodhim, t’i marrësh 50.000 tonë fshatarësisë si taksë në natyrë, kjo është vjedhje”.<sup>69</sup> Në të njëjtin kontekst, për të përmirësuar jetesën dhe furnizuar popullin me mallra të konsumit të përditshëm dhe ushqime, Moska ndërhyri në vitin 1953 të hiqeshin nga plani një fabrikë për shkrirjen e çelikut, një fabrikë letre, fabrikë qelqi, si dhe të shtyhej për pesë vitet e ardhshëm ndërtimi i hidrocentralit mbi lumin e Matit dhe i një rafinerie naftë.<sup>70</sup> Këto reduktime në shpenzime për investime u kërkua që të shkonin në furnizimin e popullsisë me mallra konsumi dhe në ndihmë të ekonomisë së fshatit. Udhëheqja komuniste shqiptare i mori parasysht këto udhëzime dhe bëri përmirësimet e këshilluara në mbledhjen e Byrosë Politike, më 22 qershor 1953: mori vendimin nr. 227 që shprehte politikën e re në ekonomi dhe në planin e brendshëm.

Vuajtjet dhe shfrytëzimi i krahut të punës gjatë sistemit totalitar komunist qenë të mëdha, prandaj dokumentimi i këtyre vuajtjeve përbën një domosdoshmëri të kohës. Kush kontrollon të shkuarën kontrollon dhe të ardhmen, - thotë Orwell, shkrimtari që përjetësoi totalitarizmin komunist në dy vepra madhore, “Ferma e Kafshëve” dhe “Viti 1984”. Shqipëria si asnjë vend tjetër i ish-Lindjes Komuniste nuk ka bërë dekomunistifikimin e shoqërisë së vet por nëpërmjet formulave të tipit “bashkëfajtorë dhe bashkëvuajtës” ka toleruar infiltrimin në politikë dhe në jetën shoqërore të njerëzve të kompromentuar me *ancient regime*. Kanë mjaftuar vetëm disa deklarata individuale apo institucionale për dënimin e komunizmit dhe praktikën e tij dhe, brenda natës, “demonët” e dikurshëm të jetës shoqërore janë kthyer në “engjëj” të politikës së sotme. Rezoluta e Këshillit të Evropës për dënimin e krimeve të komunizmit është shumë e qartë në këtë drejtim dhe ajo duhet të fillojë të zbatohet edhe në Shqipëri.

## **Bibliografi:**

---

<sup>68</sup>Po aty.

<sup>69</sup>Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi i Partisë-organet udhëheqëse (më tej: AP-OU), Viti (më tej: V.) 1953, Lidhja (më tej: L.) 1, Dosja (më tej: D.) 23. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë politike të KQ të PPSH, 20 qershor 1953. Cituar sipas A. Lalaj, *Pranverë e rrejtshme e '56 ...*, f. 23.

<sup>70</sup> A. Lalaj, *Pranverë e rrejtshme e '56 ...*, f. 22.

- Ana Lalaj, *Pranverë e rrejtshme e 56'*, Tiranë: Infobotues, 2015
- Arshi Pipa, *Stalinizmi shqiptar*, IKK &Princi, Tiranë: 2007.
- Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Ideart,Tiranë: 2004.
- Kastriot Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste*, Instituti i Studimit të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë: 2015.
- Luan Malltezi, *Terrori Komunist në Shqipëri*, Grapic- Line-01, Tiranë: 2012.
- Llambro Filo, *Sistemet politike bashkëkohore*, Ideart,Tiranë: 2008.
- Hannah Arendt, *Origjinat e totalitarizmit*, Dija, Prishtinë: 2002.

# **Ardiana Topi - AIDSSH, Tiranë**

## **Tipologjia e dokumenteve të krijuara nga ish Sigurimi i Shtetit 1944-1991**

### **Abstrakt**

Ky studim ka për qëllim të analizojë mënyrën e krijimi të dokumenteve arkivore të krijuara nga ish Sigurimi i Shtetit në institucionet qendrore të tij ashtu edhe në strukturat lokale apo siç njihen ndryshe me emrin degët e punëve të brendshme në rrethe e organet e sigurimit në ushtri. Gjithashtu pjesë e këtij studimi është edhe përshkrimi i fondeve arkivore që ruhen në arkivin e dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit, arkivin e AIDSSH-së. Fondet arkivore përfshijnë fondin e zbulimit, kundërzbulimit, rrjetit sekret të informatorëve, fondi i hetuesisë etj. Kategoritë e dosjeve të dokumenteve, pjesë e këtyre koleksioneve janë të larmishme. Ato përfshijnë dosje me dokumente administrative dhe korrespondencën zyrtare, dosje të personave që viheshin në përpunim në nivele të ndryshme, dosje të bashkëpunëtorëve, dosje të hetuesisë dhe proceseve gjyqësore etj.

### **Hyrje**

Ky artikull synon të njohë lexuesit në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme me sistemin eurvejimit dhe përndjekjes që kishte ndërtuar ish Sigurimi i Shtetit nëpërmjet paraqitjes së modeleve të dokumenteve të krijuar nga vetë ai dhe që sot janë pjesë e koleksioneve të fondeve arkivore që ruhen në arkivin e AIDSSH-së. Informacioni i paraqitur në këtë artikull është rezultat i analizës direkte të dosjeve, dokumenteve dhe mjeteve të evidentimit dhe informimit në arkiv. Dokumentet e arkivit të AIDSSH-së datojnë nga 28 nëntori 1944 - 2 korrik 1991, e përcaktuar kjo në ligjin 45/2015.

### ***Organizimi i ish Sigurimit të Shtetit***

Regjimi komunist përtej luftës së klasës synonte kontrollin absolut mbi gjithë veprimtaritë jetësore të qytetarëve dhe krijimin e mekanizmave që synonin jo vetëm nënshtrimin e tyre por njëkohësisht të garantonin që pakënaqësia e qytetarëve të mos kishte asnjë mundësi të ndryshonte në një opozitë të organizuar.

Strukturat e ish Sigurimit të Shtetit i kanë fillesat e tyre gjatë LANÇ, me të ashtuquajturat Seksionet e Mbrojtjes së Popullit (SMP). Më 14 dhjetor 1944, u krijua Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit<sup>1</sup> pranë së cilës u ngritën disa seksione:

seksioni i parë - zbulimi politik

seksioni i dytë – kundërzbulimi

seksioni i tretë – në drejtim të të huajve

seksioni i mbrojtjes së popullit në radhët e ushtrisë

seksioni i katërt – kartoteka

---

<sup>1</sup> Udhëzimi nr. 33, datë 8 dhjetor 1944 “Për detyrat dhe funksionet e seksioneve të mbrojtjes së popullit”.

seksioni i pestë – vëzhgimi dhe sekretaria

dhe tre seksione të mbrojtjes së popullit në krahina të ndryshme, konkretisht *seksioni i mbrojtjes së popullit të krahinës së parë Tiranë, seksioni i mbrojtjes së popullit të krahinës së dytë Berat dhe seksioni i mbrojtjes së popullit të krahinës së tretë Shkodër*. Në këtë periudhë seksioni i mbrojtjes së popullit i krahinës drejtonte rrjetin në terren dhe në reparte ushtarake. Më 1945 u krijuan seksionet e mbrojtjes së popullit të qarqeve.




Figura 1: Struktura organizative e Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit, korrik 1945

Në korrik-gusht 1946, Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit u quajt Drejtoria e Sigurimit të Shtetit dhe kaloi në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Punëve të Brendshme<sup>2</sup>. Në prill-maj 1947, në përshtatje me ndarjen e re administrative territoriale u organizuan drejtoritë e punëve të brendshme të qarqeve të cilat kishin në varësi të drejtpërdrejtë degët e punëve të brendshme në rrethe. Pranë drejtorive të punëve të brendshme në qarqe u ngritën të njëjtët sektorë që ishin ngritur në Drejtorinë e Sigurimit të Shtetit, konkretisht:

Seksioni I, i kundërzbulimit

Seksioni II, i luftës kundër bandave, organizatave dhe grupeve kundërrevolucionare

Seksioni III, i mbrojtjes së ekonomisë socialiste


Seksioni IV, i evidencës operative

Seksioni V, vëzhgimi dhe kontrolli i përfaqësive diplomatike


<sup>2</sup> Ligji nr. 248, datë 22.8.1946 dhe praktika e SEMP e viteve 1945-1947.

## Seksioni VI, hetuesia, shifra dhe sekretaria

Në nëntor - dhjetor 1947, me shkrirjen e qarqeve dhe organizimin e rretheve u bë një organizim i ri i strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme në nivel lokal. Në çdo rreth u ngritën seksionet e punëve të brendshme të rrethit dhe seksionet e punëve të brendshme të qytetit të cilat vareshin nga MPB. Struktura organizative e ish Sigurimit të Shtetit në dhjetor 1948, paraqitej si më poshtë:



Në dhjetor 1948, Byroja Politike e KQ të PPSH i bëri një analizë të thellë punës së organeve të ish Sigurimit dhe më pas aprovoi “*Platformën politike e organizative të Sigurimit të Shtetit*”. Gjatë periudhës dhjetor 1948 - janar 1949 bë riorganizimi i organeve të ish Sigurimit të Shtetit. U nda roli i ministrit të Punëve të Brendshme nga funksioni i sekretarit për kuadrot e KQ të Partisë, u forcuan disa sektorë dhe u krijuan disa sektorë të rinj. Organizimi i ri i strukturës në vitin 1949 paraqitej:



Në vitin 1958, me vendimin nr. 213, datë 4.7.1958 të Byrosë Politike të KQ të PPSH-së platforma e punës operative të organeve të punëve të brendshme pati sërish rishikime dhe ndryshime. Sipas kësaj platforme, Ministria e Punëve të Brendshme përbëhet nga Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Drejtoria e zbulimit politik, nga Drejtoria e policisë popullore, Forcat e kufirit dhe ndjekjes, Organet e repartet e mbrojtjes lokale kundërajrore dhe Degët e Punëve të Brendshme në rrethe. Secila nga drejtoritë kryesore të Ministrisë së Punëve të Brendshme kishte strukturën e saj. Drejtoria e parë ishte e organizuar në disa degë të ndryshme në varësi të aspekteve të ndryshme të punës operative. Në këtë periudhë Degët e Punëve të Brendshme ishin bazuar në ndarjen administrative-territoriale të vendit.

### ***Ish -Sigurimi i Shtetit dhe Partia e Punës së Shqipërisë***

Në platformën e vitit 1948, përcaktohej qartë se organet e Sigurimit të Shtetit sikurse të gjitha organet e tjera drejtoheshin nga Partia e Punës së Shqipërisë dhe kishin si detyrë kryesore të zbulonin dhe të godisnin në kohë veprimtarinë armike kundërrevolucionare të armiqve të jashtëm dhe të brendshëm të Republikës Popullore dhe të Partisë së Punës dhe të informonin partinë mbi të gjithë aktivitetin e tyre.

Drejtorja e Sigurimit të Shtetit (ministri i Brendshëm) duhej të informonte rregullisht Sekretariatit e Komitetit Qendror mbi të gjithë veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit, për çështje me rëndësi të veçantë informohej Komiteti Qendror i Partisë.

Në terren, shefat e Sigurimit duhej të informonin vetëm Sekretarin Politik të Komitetit të Partisë, por nëse ata e gjenin të nevojshme mund të njoftonin një pjesë apo të gjithë anëtarët e Komitetit të Partisë. Informim bëhej për:

Dyshimet e ekzistencës së punës armike në sektorë të ndryshëm, përmasat dhe rrezikshmërinë që paraqesin këto dyshime;

Mbi parullat dhe komentet e elementëve reaksionarë dhe sektorët ku ishin shfaqur ato;

Mbi gjendjen politike të popullsisë dhe mënyrës së reagimit të tyre karshi punës armike;

Mbi ekzistencën e armiqve të arratisur në terren, identifikimin e tyre, identifikimin e mbështetësve të tyre, të qëllimeve dhe aktiviteteve pa treguar bazat e tyre, emrat e bashkëpunëtorëve të Sigurimit dhe emrat e personave të marrë në përpunim (pa autorizim).

Udhëheqja dhe kontrolli i partisë mbi organet e punëve të brendshme realizohej nga:

Organizatat bazë të partisë në organet e punëve të brendshme;

Nëpërmjet llogarisë që përgjegjësi i organeve të punëve të brendshme jepte përpara organeve të partisë;

Nëpërmjet informacionit që përgjegjësi i organit të punëve të brendshme i jepte Sekretarit të Parë të Partisë. Ai duhej të informonte rregullisht Sekretarin e Parë të Komitetit të Partisë së rrethit.

Nga fillimet e tij dhe deri në ditët e fundit, viti 1991, ish Sigurimi i Shtetit ishte një strukturë e cila krijoi në mënyrë sistematike dosje dhe dokumente në mënyrë të veçantë për dy kategori kryesore personash: personat e angazhuar në punët operative dhe për personat të cilët viheshin nën survejimin, ndjekjen e më tej asgjësim nga strukturat e ish Sigurimit të Shtetit.

### **Dosjet e dokumentet e krijuara nga ish Sigurimi i Shtetit për bashkëpunëtorët**

Funksionarë të Sigurimit të Shtetit, quhen të gjithë njerëzit e Sigurimit, oficerë, nënoficerë, nëpunës që kanë funksione legale në aparatet e Sigurimit, si në qendër ashtu edhe në terren.

Bashkëpunëtore të ish Sigurimit quhen të gjithë njerëzit e Sigurimit të padekluar botërisht, dhe që shërbejnë ilegalisht për sigurimin dhe përfshijnë rezidentët, informatorët, agjentët dhe strehuesit.

Ish Sigurimi i Shtetit, në mënyrë të ngjashme edhe me vendet e tjera të Bllokut të Lindjes, Bullgaria, Rumania etj., për të gjithë kategoritë e bashkëpunëtorëve që tërhiqeshin në bashkëpunim, krijonte dy lloje dosjesh, dosjen personale dhe dosjen e punës. Secila prej tyre përmbante dokumentet si më poshtë:

**Dosje personale**, e cila krijohet për të gjithë kategoritë e bashkëpunëtorëve në bazë të vendimit përkatës mbasi ishte bërë raporti përfundimtar i tërheqjes në bashkëpunim. Dosjet personale përmbanin dokumentet si më poshtë:

Lista e dokumenteve që ndodhen në dosje;

Lista e punëtorëve operativë që e mbanin dosjen;

Lista e personave që njihen me dosjen;

Lista e bashkëpunëtorëve që ka në lidhje rezidenti (për rastin e rezidentit);

Lista e lidhjeve familjare;

Fletë kontrolli e kartotekës (model 5)

Dokumente të studimit paraprak;

Skica të bazës së takimit (vetëm për strehuesin);

Dokumentet e bashkëpunëtorëve që tërhiqen me material detyrues;

Vendimi dhe plani i tërheqjes në bashkëpunim;

Procesverbalet dhe deklaratimet gjatë tërheqjes në bashkëpunim;

Deklarata e bashkëpunimit;

Raporti përfundimtar i tërheqjes në bashkëpunim;

Parulla/ kundërparulla dhe fotografia;

Rrethi i çështjeve (agjentët dhe informatorët);

Karakteristika e punës, e cila bëhet çdo dy vjet;

Vendimi për shpërblime apo shpenzime të tjera;

Plani i kombinacionit me dhe pa TO;

Legjendimet e vijat e sjelljes;

Korrespondenca që zhvillohet gjatë kohës së bashkëpunimit;

Letra dhe përgjigje të bashkëpunëtorëve;

Plani i tërheqjes në bashkëpunim nga burgjet apo repartet ushtarake;

Vendime të ndryshme që kanë të bëjnë me caktimin e një informatori tek një rezident i caktuar, për ndryshim kategorie, heqjen nga rrjeti sekret informativ etj.;

Plani i masave operative për marrjen e gjurmëve të çelësave;

Implikim të hetuesisë.

**Dosja e punës**, për kategorinë *agjent* dhe *informator* krijohet në të njëjtën kohë me dosjen personale. Për kategorinë *rezident* dhe *strehues*, hapja e dosjes së punës bëhet vetëm kur ata japin të dhëna me interes operativ.

Lista e dokumenteve që ndodhet brenda në dosje, sipas modelit 1;

Lista e punëtorëve operativ që mbajnë dosjen, sipas model 2;



Lista e personave që njihen më dosjen , sipas modeli 2/1;

Raportet e bashkëpunëtorit, detyrat e ndryshme që i jepen bashkëpunëtorëve ;

Vendimi për arkivimin e dosjes ose për asgjësimin e saj.

Për çdo bashkëpunëtor krijoheshin dy kartela model 2, një kopje e të cilës qëndronte në degën që e krijonte ndërsa tjetra dërgohej në degën e kartotekës qendrore. Kjo kartelë përmban të dhënat e mëposhtme:

Numri i Regjistrimit, Mbiemri, Emri, Emri i Babës, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, vendi i punës, origjina shoqërore, kombësia, shtetësia, arsimit, kategori, pseudonimi, Sektori, drejtimi, baza e tërheqjes, data e tërheqjes, R.u ku stërvitet, profesioni, gjendja shoqërore, partiniteti, si dhe të dhënat e punonjësit operativ që e ka tërhequr në bashkëpunim dhe titullari i organit.

### ***Dokumentet që mbanin funksionarët që merreshin me punë operative***

Çdo funksionar që merrej me punë operative duhej të mbante katër dosar:

#### ***Dosari i Parë***

Fashikulli i korrespondencës në ndjekje;

Fletorja me planet mujore, ditore dhe grafikët e takimeve me bashkëpunëtorët;

Fletorja me shënime sekrete;

Fletorja e përgatitjes profesionale;

Fletorja e përgatitjes ushtarake.

#### ***Dosari i dytë***

Dosja e informatave;

Dosja e përpunimeve aktive 2/A, paraprake dhe personave në kontroll operativ 2/B;

Dosje agjenturore, të kërkimit dhe të të arratisurve;

Fashikujt e të huajve, emigrantëve, të internuarve e të dëbuarve dhe shkelësve të kufirit.

#### ***Dosja e tretë***

Dosje ORV;

Dosje drejtimi;

Fashikuj me material të papërfunduara.

#### ***Dosja e katërt***

Dosjet personale dhe të punës të bashkëpunëtorëve ;

Libri i evidencës operative të punëtorit operativ;

Regjistrat që hapen nga sektorët operativë.

Rrjeti informativ sekret ishte sistemi kryesor i cili furnizonte me informacion ish Sigurimin e Shtetit. Puna në Drejtorinë e Sigurimit të Shtetit dhe strukturave të saj konsistonte ndër të tjera edhe në rekrutimin, udhëzimin, organizimin dhe drejtimin e rrjetit informativ nga oficerët dhe punonjësit operativë. Rrjeti informativ përbëhej nga:

**Rezidentët** që varen direkt nga punonjësi operativ i Sigurimit, i cili është funksionar në Degët e Punëve të Brendshme. Duhet të jetë i maskuar me punë zyrtare, nuk merr rrogë. Çdo lokalitet apo objekt pune duhet të ketë një ose dy rezidentë, të cilët nuk duhet të njihen me njëri-tjetrin. Çdo rezident ka në varësi të tij një grup informatorësh, deri në 12 vetë të cilit i jepen të gatshëm mbas rekrutimit të tyre nga punonjësi operativ. Rezidenti nuk i mbledh kurrë bashkë informatorët e tij, por mban lidhje individuale sekrete me to dhe është përgjegjës për dekonspirimin e tyre. Funksionari i cakton detyra konkrete rezidentëve dhe ju kërkon atyre rregullisht llogari.

**Informatori** që varet nga rezidenti dhe mund të jetë anëtar partie në raste të veçanta. Rekrutohet nga punëtori operativ dhe dokumentohet me aktin e rekrutimit. Informatorët që janë anëtarë ose kandidatë partie rekrutohen jo me imponim, por me vullnetarizëm. Informatori duhet të jetë i maskuar me funksione, si bujk, punëtor, nëpunës, student etj. Në përgjithësi nuk shpërblehet rregullisht me përjashtim të disa rasteve të veçanta. Vepron në bazë të udhëzimeve që jep rezidenti nga i cili varet. Si rregull, informatori duhet të ishte element i kompromentuar me armikun por edhe një patriot i ndershëm apo qytetar i thjeshtë.

**Agjentët** – Rekrutohen, varen direkt nga punonjësi operativ i Sigurimit dhe nuk mund të kenë kurrë lidhje me rezidentin. Agjenti mund të jetë anëtar partie vetëm në raste të jashtëzakonshme, por zakonisht agjenti duhet të ishte element i kompromentuar me punë armike, dhe që në bazë të materialit komprometues që ka për të Sigurimi, imponohet të punojë për Sigurimin në radhët e armikut. Punonjësi operativ, bën propozim me shkrim të cilin ia dorëzon shefit të seksionit apo degës së Sigurimit. Pas aprovimit nga shefi i Sigurimit, akti i propozimit i kalon për aprovim Drejtorit të Sigurimit. Rekrutimi miratohet nga ministri ose n/ministri, më pas çohet në arkivin e bashkëpunëtorëve. Agjentët nuk duhet të njihen me njëri-tjetrin si agjentë. Ata duhet të jenë të maskuar në pozicione pune dhe nuk shpërblehen me rrogë të rregullt, por sipas rasteve në bazë të sukseseve. Veprimtaria e një agjenti kontrollohej me anën e një ose më shumë agjentësh dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të bazohet vetëm në punën e njërit prej tyre. Agjentët veprojnë bashkë dhe brenda grupeve kundërshtarë duke luajtur rolin e kundërshtarit sipas udhëzimeve që merrte nga punonjësi operativ i Sigurimit nga i cili varet. Agjentët përbënin rrjetin special të agjunkturës të Sigurimit që vlen për të përpunuar elementët kundërshtarë që zhvillojnë aktivitet armiqësor.

**Strehuesit** – Është i zoti i shtëpisë që përdoret nga organet e Sigurimit për të bërë takime me bashkëpunëtorët e tyre. Zakonisht mund të ishin anëtar partie ose patriot i vendosur dhe i provuar i cili nuk duhet të dekonspironte personat që vinin për takime në shtëpinë e tij. Strehuesi nuk duhet të dijë funksionet e bashkëpunëtorëve. Rezidenti dhe agjenti nuk mund të takoheshin me punonjës in operativ të tyre në të njëjtën shtëpi.

**Bashkëpunëtori personal** - Quhet agjenti që mban lidhje personale me punëtorin operativ të Sigurimit. Çdo punëtor operativ përveç atyre që nuk merren me punë operative (sekretar, daktilografist etj.) duhet të merren me punën e agjunkturës nga referenti deri tek ministri, që do të thotë secili prej tyre duhet të ketë rekrutuar një apo më shumë agjentë dhe i mban personalisht në lidhje për të përpunuar elementët armiq. Funksionarët dhe bashkëpunëtorët firmosnin një deklaratë në fillim për mos dekonspirim, një para fillimit të detyrës dhe një kur dilnin nga Sigurimi.

### **Përpunimet**

Përpunim agjunkturor quhet kompleksi i masave agjunkturorë operative që merren nga organet e punëve të brendshme gjatë procesit të zbulimit, dokumentimit dhe ndërprerjes së veprimtarisë subversive të agjunkturës së huaj. Në proces përpunimi merreshin shtetasit shqiptarë, të huaj ose persona pa shtetësi, të cilët kishin mbushur moshën 14 vjeç në kohën kur datonin të dhënat që i implikonin këta persona si “armiq apo keqbërës të partisë dhe pushtetit”.

Përpunimet klasifikohen në dy grupe: përpunim paraprak dhe përpunim aktiv.

**Përpunimi paraprak**, fillonte kur OPB kishin sinjale ose të dhëna për “veprimtari armiqësore” për një individ apo një grup individësh. Zakonisht nuk zgjaste më shumë se gjashtë muaj. Nëse gjatë kësaj periudhe vërtetoheshin të dhënat atëherë personi kalonte në përpunim aktiv dhe regjistroheshin në kartotekën e dytë. Në rast se gjatë përpunimit paraprak vërtetohen se të dhënat janë të rreme, atëherë përpunimi likuidohet duke mos u regjistruar në kartotekë.

**Përpunimet aktive** klasifikoheshin në dy nivele, Përpunim 2A dhe Përpunim 2B.

*Në përpunim aktiv 2A* viheshin të gjithë ata persona për të cilët OPB kishin evidentuar të dhëna të vërtetuara të cilat sipas tyre i implikonin ata në veprimtari armiqësore kundër partisë dhe pushtetit.

*Në përpunim aktiv 2B* regjistroheshin të gjithë ata elementë të cilët ishin përcaktuar nga OPB si persona të dyshimtë, të cilët në të kaluarën kishin zhvilluar veprimtari kundërrevolucionare dhe që kishin kondita për t’u aktivizuar kundra partisë dhe pushtetit të kohës, por që në kohën që ishin nën përpunim 2B ishin inaktivë.

Për t'u vënë në përpunim paraprak vendos punonjësi operativ. Ndërsa për t'u vënë në përpunim aktiv vendos Kryetari i Degës në rreth ose Kryetari i Degës Operative në qendër, ndërsa në ushtri vendos shefi i Sigurimit në njësi dhe repart ushtarak, në kufi vendos shefi i zbulimit në batalion.

Për secilin prej rasteve të mësipërm krijohet sipas rastit Dosje përpunim 2A, PP ose Dosje e kontrollit operativ 2B. Këto dosje përmbanin dokumentet si më poshtë:

- Lista e dokumenteve që ndodhen në dosje;
- Lista e punëtorëve operativë që e mbanin dosjen;
- Lista e personave që njihen me dosjen;
- Lista e bashkëpunëtorëve që japin informacion për përpunim;
- Lista e lidhjeve familjare;
- Fletë kontrolli e kartotekës (model 5);
- Të dhëna që kanë shërbyer për marrjen në përpunim;
- Vërtetim biografik, certifikata familjare;
- Vendim për marrjen e personit në përpunim;
- Plani i masave operative;
- Të dhëna të marra gjatë përpunimit;
- Aktet e ekspertizës;
- Denoncimet e shtetasve;
- Fotografi;
- Plane masash të rishikuara me e pa TO;
- Vendime për dëgjimin e bisedave telefonike;
- Dokumente të ndryshme të krijuara gjatë procesit të përpunimit;
- Relacioni përfundimtar, i cili pasqyron të dhëna të hetimit dhe masën e dënimit të dhënë nga gjykata;

Vendimi i heqjes nga përpunimi, i veçimit të dosjes për asgjësim (vetëm për dosjet PP).

#### ***Tipa të tjera dosjesh të krijuara nga strukturat e ish Sigurimit të Shtetit***

**Dosje Agjenturore**, krijoheshin për një grup personash që banojnë në territorin e një rrethi të caktuar dhe sipas OPB zhvillojnë “veprimtari të përbashkët armiqësorë” dhe jo më pak se dy prej këtyre personave janë në përpunim aktiv 2/A.

**Dosje të problemeve të centralizuara**, krijoheshin nga oficerët operativë për ngjarje apo objekte përpunimi që sipas OPB paraqesin rëndësi të veçantë operative dhe rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Dosjeve agjenturore dhe të centralizuara për efekt sekreti zakonisht iu caktoheshin pseudonime.

**Dosje me dokumentet e personave të këshilluar jashtë përpunimit.**

**Dosja e kërkimit**, krijohej nga DPB që shpallte kërkimin:

për gjetjen e kuadrove dhe agjentëve të zbulimeve të huaja që futen ilegalisht ose me dokumente falso në territorin e RPSSH;

për personat e ndaluar, arrestuar dhe dënuar me heqje lirie, të internuar që largohen nga vendi i vuajtjes së dënimit ose izolimit;

për persona që ndiqen nga hetuesia;

për personat me tendencë arratisjeje.

**Dosja e zbulimit të autorit**, krijohej për zbulimin e autorëve të krimeve kundra shtetit;

**Dosja informative**, krijohej nga punëtorët operativë të zonave, të objekteve të rëndësisë së veçantë ku nuk vepron zona, nga Sigurimi i ushtrisë etj.;

**Dosja e të arratisurve, krijohej për çdo shtetas shqiptar që ka mbushur moshën 14 vjeç, i cili arratiset jashtë shtetit;**

**Dosja e të arratisurve me aktivitet**, kryesisht ato që kanë vepruar si diversantë dhe që mund të kishin aftësi e mundësi fizike të vepronin sërish etj.;

**Dosja e shoferëve të huaj me aktivitet**, e cila përmbante të dhëna me interes operativ për shoferët e huaj që hynin në territorin e RPSSH-së;

**Fashikulli i të internuarit dhe i të dëbuarit**, krijoheshin nga DPB, e cila kishte bërë edhe propozimin për internim apo dëbim të personit. Fashikulli i të internuarit përveç listës së dokumenteve që ka çdo dosje përmban edhe:

Listën e lidhjeve me interes operativ;

Dëshmi penaliteti;

Vendime të gjykatës, certifikata familjare;

Shkresë amë numrin dhe datën e vendimit të Komisionit të Internim Dëbimeve;

Vërtetime biografike;

Kopje të raport propozimit për internimin apo dëbimin e personit;

Korrespondenca dhe informacione të ndryshme që kanë të bëjnë me të internuarin si individ apo si familje.

**Fashikuj për të huaj me qëndrim të përkohshëm në RPSSH**

**Fashikulli i shkelësit të kufirit**

**Fashikulli i emigrantit**

**Fashikulli i personave që arrestohen e dënohen pa qenë në përpunim**

**Dosje të objekteve të Rëndësisë së Veçantë (ORV), të cilat përmbajnë:**

Në fashikullin e parë:

Lista e dokumenteve që ndodhet në fashikull, sipas modelit 1;

Lista e punëtorëve operativë që mbajnë dosjen, sipas modelit 2;

Lista e bashkëpunëtorëve që punojnë në objekt , sipas modelit 3/1;

Lista e personave në përpunim 2/A, kontroll operativ 2/B e kontingjent, të cilët punojnë në objekt;

Studimi për përcaktimin e vendeve dhe pikave kyçe të ORV-së;

Vendimi për krijimin e dosjes;

Skica për sigurimin e objektit;

Planet e masave operative për sigurimin e objektit;

Historiku i objektit, i cili duhej pasuruar në vazhdimësi;

Vendimi për heqjen e objektit nga lista e ORV dhe arkivimit të dosjes.

Në fashikullin e dytë:

Lista e dokumenteve që ndodhen në fashikull;

Lista e personave që implikohen në fashikull;

Lista e regjistrimit të ngjarjeve të ndodhura në objekt;

Analiza, raporte bashkëpunëtorësh, të dhëna të rëndësishme të dala nga puna operative.

**Dosjet e përfaqësive diplomatike ose tregtare.** Edhe në këto dosje kishte katër fashikuj. Në fashikullin e parë përfshihen dokumente të cilat në lidhje me hapjen e dosjes, planimetri të godinës, listë emërore e shtetasve shqiptarë të cilët punojnë në përfaqësi dhe dokumente të karakterit evidentues. Në fashikullin e dytë duhej të pasqyroheshin të dhënat e personelit të përfaqësisë, lista e zbuluesve të cilët kanë punuar në përfaqësi, fotografi të personelit të përfaqësisë. Në fashikullin e tretë, përfshihen planet e masave operative, analiza, relacione dhe raporte të bashkëpunëtorëve dhe çdo e dhënë tjetër që lidhet me veprimtari armiqësore të personelit të përfaqësisë. Në fashikullin e katërt ruhet lista e dokumenteve që përmban fashikulli, dosjet e përpunimeve, fashikujt e kontrollit për familjarët e personelit të përfaqësisë diplomatike etj

**Dosje drejtimi**

***Dokumente dhe dosjet që krijohen për të ashtuquajturit elementë “armiç dhe keqbërës”***

Dosje përpunim 2/A, krijohej për çdo shtetas shqiptar, shtetas të huaj dhe persona pa shtetësi me banim të përhershëm ose të përkohshëm në RPSSH, që kishte mbushur moshën 14 vjeç, *në kohën kur për të janë gjetur të dhëna të vërtetuara se ka zhvilluar veprimtari armiqësore*, në drejtim të së cilit përdoren aktivisht metoda të ndryshme të punës operative.

Dosjet e përpunimit 2/A përmbajnë dokumentet si më poshtë:

- Lista e dokumenteve që ndodhet brenda në dosje, sipas modelit 1;
- Lista e punëtorëve operativë që mbajnë dosjen, sipas model 2;
- Lista e personave që njihen më dosjen, sipas modelit 2/1;
- Lista e bashkëpunëtorëve që japin informacion për përpunim, modeli 3/1;
- Lista e personave që implikohen;
- Lista e lidhjeve familjare, miqësore e shoqërore me interes operativ;
- Fleta e kontrollit të kartotekës;
- Të dhënat që kanë shërbyer për marrjen në përpunim;
- Vërtetim biografik, certifikata të gjendjes familjare;
- Vendim për marrjen në përpunim;
- Plani i masave operative;
- Të dhëna të marra gjatë përpunimit, konkluzione dhe detyra të nxjerra nga studimi i dosjes;
- Aktet e ekspertizës së organeve të specializuara;
- Fotografi;
- Shtesa të planeve operative si dhe plane kombinacionesh;
- Vendime për dëgjimin e bisedave telefonike;
- Vendime për kopjimin e çelësave.
- Informacione të teknikës operative.

### ***Internimet dhe dëbimet***

Bazuar në dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, nr.1906, datë 0.8.1954, OPB mund të vendosnin si masë administrative për personat që sipas tyre “paraqisnin rrezikshmëri shoqërore” internim ose dëbim. Internimi dhe dëbimi si masë administrative merrej për personat e mëposhtëm:

- Pjesëtarët e familjeve të të arratisurve jashtë vendit;
- Personat që paraqisnin “rrezikshmëri”, për të cilët nuk ekzistonin faktet për t’i kaluar në procedim penal.

Propozimin për internimin apo dëbimin e bënte Kryetari i degëve të punëve të brendshme në rreth, të cilin ia kalonte për pëlqim sekretarit të Parë të Komitetit të Partisë. Më pas dosja së bashku me materialet e hollësishme i kalon degës së VII - të ish DSSH (Dega e Hetuesisë). Dega e Hetuesisë mbasi studion dosjen së bashku me degën operative në qendër ia përcillte dosjen të shoqëruar me mendimin përkatës Komisionit të Internimeve dhe Dëbimeve. Komisioni i Internimeve dhe Dëbimeve merrte vendimi kolegjial, të cilin ia komunikonte organit propozues për të vepruar. Në mbledhjet e Komisionit të Internimeve dhe Dëbimeve duhej të asistonte Prokurori i Përgjithshëm ose i deleguari i tij.

Ministri i Punëve të Brendshme kishte të drejtë të urdhëronte dëbimin ose internimin e një personi. Në këtë rast komisioni duhej të mblidhej brenda 3 ditëve nga dalja e urdhrit të ministrit për të sanksionuar ose jo urdhrin e dhënë prej tij.

### ***Arrestimet***

Arrestimet nga ana e ish Sigurimit të Shtetit për faje politike mund të kryheshin sipas rregullit.

Arrestohet çdo person i cili kapet në flagrancë, duke përfshirë tentativë për vrasje, akt diversion, arratisje etj.;

Kur janë mbledhur dokumente dhe material i nevojshëm që dokumentojnë fajin e të arrestuarit. Në këtë rast, seksioni apo dega e brendshme përpilon letër rreshtimin e cila përpilohet nga referenti, dakordësohet nga shefi i degës e miratohet nga ministri apo n/ministri dhe i kalon prokurorit ushtarak pranë gjykatës ushtarake i cili aprovon ose jo duke u shprehur me shkrim mbi letrën e rreshtimit;

Urdhër arresti, i cili firmoset nga drejtoria e sigurimit, ministri apo n/ministri.

### ***Hetuesia***

Të burgosurit e Sigurimit hetohen vetëm nga Hetuesia e Drejtorisë së Sigurimit në bashkëpunim me punëtorët operativë ose hetuesit dhe organet e Sigurimit në terren.

Mbas procedimit të të burgosurit, procesverbalet i dërgohen Gjykatës Ushtarake për gjykim dhe vendim bashkë me dokumentin zyrtar të aktakuzës që firmoset nga personat që kanë aprovuar arrestimin, ministri i Brendshëm ose zëvendësministri dhe prokurori ushtarak.

### ***Censura***

Telegramet dhe kutipostat që dërgohen brenda vendit në drejtim të elementëve të identifikuar si element me rrezikshmëri.



## **Lidhja, komunikimi**

Lidhja kryhej me anë të:

Korrierëve

Radios, përdoret për dërgimin e radiogrameve më karakter jo të rëndësishme;

Telegrafës dhe telefonit, përdoren për dërgimin nga lart –poshtë dhe poshtë-lart radiograme dhe telegrame të cilat gjithmonë janë të shifruara. Telegramet firmosen nga ministri, n/ministri, kryetarët e degëve, zëvendëskryetarët e degëve në rrethe.

Çdo seksion apo degë e punëve të brendshme duhej të njoftonte Drejtorinë e Sigurimit:

Një herë në 24 orë në lidhje me ngjarjet e ditës me anë të telegrameve ose radiogrameve, edhe në rastet kur nuk ndodh asnjë ngjarje.

## **Regjistrat**

Duke qenë se puna operative ishte shtrirë pothuajse në çdo qelizë të shoqërisë shqiptare, sasia e të dhënave dhe informacionit që mblidhej dhe manipulohet ishte mjaft e madhe. Mekanizmi i krijuar nga ish Sigurimi për evidentimin dhe regjistrimin e këtyre në dhënave ishte një set me regjistra të cilët kishin shumë mirë të përcaktuara fushat që duhej të përmbanin ato. Regjistrat kryesorë të përdoruar nga të gjithë strukturat e ish Sigurimit të Shtetit ishin:

Regjistri i korrespondencës, i cili përdorej nga drejtorja kryesore dhe degët e punëve të brendshme për regjistrimin e të gjithë korrespondencës zyrtare që kryenin këto institucione.

Regjistri i evidencës së regjistrave, regjistrohen të gjithë regjistrat me të dhëna sekrete që ka në përdorim çdo vit çdo sektor me përjashtim të regjistrave të kartotekës dhe regjistrave me të dhëna sekrete të rëndësishme të veçantë.

Regjistri i përpunimeve, në të cilin regjistroheshin të gjithë personat të cilët kanë qenë në përpunim PP, 2/B dhe 2/A dhe krijohet pranë çdo dege të punëve të brendshme

Regjistri i bashkëpunëtorëve, përdorej për regjistrimin e të gjithë bashkëpunëtorëve në një degë të caktuar të punëve të brendshme. Ai mban informacion të detajuar për bashkëpunëtorët dhe përfshin të dhëna personale, datën e rekrutimit, kategorinë, pseudonimin, drejtimin, sektorin që e regjistron etj.

Regjistri i kontingjenteve;

Treguesi alfabetik i informatave;

Indeksi alfabetik i personave të këshilluar e demaskuar;

Regjistri i dosjeve dhe fashikujve që mban punonjësi operativ;

Regjistri i dosjeve dhe fashikujve të arkivuara;

Regjistri i dosjeve agjenturore dhe problemeve të centralizuara;

Regjistri i regjistrimit të fletoreve/bloqeve me shënime sekrete dhe të planeve të punës.  
Ky regjistër hapet çdo vit;

Regjistri i evidencimit të konspekteve dhe materialeve të daktilografuara sekrete të rëndësisë së veçantë;

Regjistri i shqiptarëve të riatdhesuar;

Regjistri i të arratisurve;

Regjistri i dosjeve penale;

Regjistri i shkelësve të kufirit

Regjistri i personave të internuar dhe dëbuar;

Indeksi i bashkëpunëtorëve nga radhët e të dënuarve.

### ***Përpilimi dhe trajtimi i dokumenteve në OPB***

Duke filluar nga viti 1953, u hartuan akte juridike të cilat rregullonin proceset e përpilimit dhe trajtimit të dokumenteve të krijuara në organet e punëve të brendshme, konkretisht Urdhri nr. 01-65 datë 31.10.1953 “Mbi trajtimin e akteve zyrtare<sup>3</sup>” dhe Urdhri nr. 01-95 datë 10.11.1953 “Mbi përpilimin e akteve zyrtare”. Më 1965-1966 këto rregulla u rishikuan me qëllim thjeshtëzimin e tyre. Sipas këtyre akteve dokumentet që ruheshin dhe administroheshin nga OPB klasifikoheshin në tre grupe kryesore:

Dokumente me karakter juridik, si ligje, dekrete, vendime, urdhëresa, rregullore apo udhëzime;

Dokumente të korrespondencës zyrtare, shkresa, informacione raporte etj.;

Dokumente të brendshme.

Tipat kryesore të dokumenteve të përdorur nga repartet apo degët e punëve të brendshme ishin në formë të standardizuar, çka lehtësonte ndjeshëm prodhimin dhe komunikimin e tyre.

Urdhrat, qofshin këto me karakter normative dhe individual;

Rregullore;

Udhëzimet janë dokumente normative me karakter udhëzues mbi mënyrën e zbatimit në praktikë të normave apo rregullave të vendosura me akte normative të tilla si ligje, vendime, urdhra etj.;

---

<sup>3</sup> F. Sekretariati, D.119

Raportet paraqesin në mënyrë të përmbledhur punën e bërë gjatë një periudhe të caktuar nga një organ, repart apo sektor i veçantë. Raport mujor i seksioneve dhe degëve të sigurimit në terren përmbajnë informacion për:

Përpunimet e realizuara;

Gjendja e përpunimeve agjenturore të vjetra që nuk kanë përfunduar;

Mbi përpunimin agjenturor të filluar së voni;

Gjendja e rrjetit, e cila përfshin të dhëna të detajuara për informatorët dhe agjenturën;

Gjendja e Hetuesisë, e cila përfshin personat e proceduar gjatë muajit, rezultatet e procedurës së hetuesisë dhe konkluzionet për çdo procesverbal si dhe propozime;

Raport në lidhje me ngjarjet e jashtëzakonshme, bëhen sa herë ndodhin ngjarje të jashtëzakonshme dhe menjëherë pas ndodhjes së lëtyre ngjarjeve ose gjatë zhvillimit të tyre;

Raportet në lidhje me përpunimin agjenturial me rëndësi, bëhen gjithmonë në fillim të përpunimit, në vazhdimi dhe në mbarim të përpunimit;

Raport mbi gjendjen e organit të sigurimit, i cili bëhet një herë në muaj nga ana e shefit të Seksionit ose Degës së Brendshme;

Relacion, përshkrim i një problemi apo një çështjeje të caktuar;

Informacioni është një dokument i cili përdoret për të njoftuar një institucion apo person në lidhje me një problem të caktuar;

Buletinet janë botime periodike në lidhje me probleme apo çështje të caktuara, p.sh. buletini i Drejtorisë së Policisë;

Komunikatë, njoftim zyrtar me anë të shtypit për ngjarje të ndodhura apo veprime të kryera e cila në organet e punëve të brendshme si rregull nuk publikohet. P.sh. komunikatat e ngjarjeve të jashtëzakonshme të ndodhura brenda 24 orëve;

Planet, dokumente ku parashikohen detyrat që duhet të realizohen për një periudhë të caktuar p.sh. planet e punës, plani i masave

Procesverbale

### ***Arkivi i dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit***

Arkivi i dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit të identifikuara deri më tani rreth 22 milion dokumente të krijuara nga veprimtaria e OPB në nivel qendror dhe atë lokal. Tërësia e dokumenteve është e organizuar në nivel fondesh si më poshtë:

Ish Sigurimi i shtetit ishte një organ shtetëror, veprimtaria e të cilit drejtohej nga partia shtet. Si e tillë, një pjesë e dokumenteve të cilat buronin nga strukturat partiake vazhdon të jetë ende në fondet arkivore të ish PPSH që ruhen pranë AQSH dhe arkivat shtetërore vendore.

Nga studimi, i cili është bazuar në konsultimin me dokumentet origjinale konstatohet se strukturat e ish Sigurimit, për sa i përket krijimit të dokumenteve kanë funksionuar në bazë të rregullave strikte dhe bazuar në modele standarde, çka ka sjellë në shumicën e rasteve krijimin e dosjeve në formë të organizuar dhe njëkohësisht evidentimin e punës operative si nga krahu i bashkëpunëtorëve ashtu edhe nga ana e punonjësve operativ.

Shfrytëzimi i dokumenteve deri në fund të viteve 1991 bëhej vetëm nga personal e autorizuar, çka duhej realisht të rezultonte në ruajtjen fizike të dokumenteve, e cila nuk konstatohet në masë të madhe.

Strukturat e Sigurimit, nuk kujdeseshin vetëm për krijimin e fabrikimin e dosjeve por fatkeqësisht edhe për asgjësimin e tyre. Një numër i madh dokumentesh rezulton i asgjësuar, por kjo procedurë në shumicën e rasteve është e dokumentuar nëpërmjet procesverbaleve të asgjësimit të cilët janë pjesë e fondeve arkivore.

Me kalimin e viteve strukturat e arkivit të MB kanë punuar për krijimin e mjeteve të informimit dhe kërkimit të dokumenteve arkivore. Disa mjete kryesore kërkimi janë:

Inventarët e dosjeve të fondeve;

Katalogët gjeografiko-alfabetik të përpunimeve;

Kartelat, model 1, model 2;

Regjistra të modeleve të ndryshme.

### ***Konkluzione***

Qëllimi i këtij studimi ishte të krijonte një panoramë të përgjithshme të dokumenteve dhe dosjeve të krijuara nga ish Sigurimi i Shtetit. Për këtë qëllim, fillimisht është bërë një përshkrim i shkurtër i organizimit dhe funksionit të organeve të Sigurimit të Shtetit dhe më pas i dokumenteve të krijuara nga këto organe.

Dokumentacioni është krijuar në bazë të strukturave organizative qendrore (Drejtoria e Sigurimit të Shtetit dhe degët e saj) dhe strukturat organizative në nivel lokal, në degët e punëve të brendshme, repartet ushtarake apo në kufi.

# Femi Sufaj, Marinela Sota - Universiteti i Tiranës

## Jeta në kampet e punës së detyruar, nga vështrimi i raporteve zyrtare

### Abstrakt

Situata politike dhe ekonomike e vendit në të cilën u ngritën kampet e punës së detyruar lidhet me instalimin në vend të regjimit komunist dhe nivelin tepër të ulët të ekonomisë dhe infrastrukturës. Puna e detyruar e të dënuarve, të paraburgosurve, të internuarve, të dëbuarve, të moshuarve, të rriturve, fëmijëve, burrave dhe grave, i ka lënë gjurmët e saj në të gjithë vendin nga veriu në jug, në fusha, rrugë, miniera dhe qytete, duke mbajtur një peshë të rëndësishme në të ardhurat e shtetit të periudhës së regjimit komunist.

Bazuar në dokumente zyrtare, raporte, statistika dhe informacione, të Degës së Kampeve dhe Burgjeve, të Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve të tjera të lidhura, do të përpiqemi të prezantojmë përmasat e fenomenit, numrin e të dënuarve, të internuarve dhe dëbuarve të aktivizuar në punë të detyruar dhe të përqendruar në kampet e quajtura “vende edukimi nëpërmjet punës”. Do të paraqesim të dhëna mbi të ardhurat e krijuara nga puna e detyruar në vite në kampe të ndryshme të punës, jetën e vështirë, standardet e ulëta të trajtimit dhe si pasojë, rreziku i shëndetit dhe humbjet e jetës së qindra të dënuarve dhe internuarve.

Pjesë e rëndësishme e trajtesës do të jenë shkeljet e të drejtave, veprimet arbitrare dhe torturat e identifikuar nëpërmjet disa raporteve zyrtare të institucioneve shtetërore dhe të kujtimeve nga shumë persona, të cilët kanë qenë subjekte të shkeljeve, dënimeve dhe torturave.

Fjalë kyçe: kampe pune, burgim, internim dhe dëbim, keqtrajtim.

### Hyrje

Objekti i këtij punimi është të prezantojë një panoramë, mbi sistemin e dënimeve penale gjatë periudhës së diktaturës komuniste i cili të kontribuojë për pasurimin e historisë kombëtare gjatë kësaj periudhe. Studimi synon të influencojë për përmirësimin dhe pasurimin e teksteve dhe programeve mësimore të arsimit të të gjitha niveleve si dhe të shërbejë për njohjen e brezit të ri me këtë pjesë të jetës së shoqërisë tonë dhe të orientohet më mirë për t’u bërë mbrojtës të lirive individuale dhe të parimeve të shoqërisë demokratike. Nëpërmjet këtij studimi do të paraqiten të dhëna të shumta mbi përmasat e përndjekjes gjatë regjimit komunist dhe njëherazi analiza të aspekteve të rëndësishme si përbërja sociale e të dënuarve politikë gjatë regjimit komunist, diferencimi dhe veçimi politik i grupeve të caktuara të shoqërisë, pasojat e politizimit dhe ideologjizimit të sistemit të drejtësisë penale. Do të bëhen përpjekje për të pasqyruar në mënyrë sa më reale dhe të qartë mënyrën si ka funksionuar sistemi shtypës në periudhën komuniste dhe cili ka qenë rezultati dhe pasojat negative mbi jetën e qytetarëve.

Burimet kryesore të përdorura janë: Dokumentet zyrtare të Kuvendit Popullor, të Qeverisë dhe Institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë penale. Të tilla janë, Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata e Lartë, Ministria e Brendshme. Dokumentet e mësipërme janë ruajtur në Arkivin Qendror Shtetëror në fondet përkatëse. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, fondi Dega e Kampeve e Burgjeve. Arkivi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si dhe një numër të konsiderueshëm të botimeve të historiografisë shqiptare.

### *Fillimet e sistemit të dhunës dhe eliminimeve*

Kampet e punës së detyruar dhe burgjet e mbyllura, janë një nga elementët tipik që karakterizon natyrën e shteteve diktatoriale komuniste që u instaluan gjatë shek. XX. Përmasat dhe tejzgjatja e këtij fenomeni, kanë qenë rezultat i luftës së klasave, që përbën rrugën e forcimit të shtetit të diktaturës së proletariatit dhe kishte në objektivin e saj likuidimin e klasave kundërshtarë. Zhvillimi i luftës së klasave përbënte esencën e të gjithë propagandës së partisë në pushtet, të zbrërthyer në fjalimet e udhëheqjes komuniste dhe madje të fiksuar edhe në Kushtetutën e vitit 1976 dhe në legjislacionin penal, i cili konsiderohej një armë e fuqishme e diktaturës së proletariatit në luftën e klasave.<sup>1</sup> Gjatë regjimit komunist, prej fillimit dhe deri në ditët e fundit, të tij, një sistem i mirë organizuar propagande, kishte pushtuar të gjitha fushat e jetës së shoqërisë, letërsinë, artin, sportin, shkollën, universitetin, ushtrinë, ndërmarrjet, dhe në emër të formimit të njeriut të ri, besnik i partisë, krijoi një shoqëri të ndarë, në të mirë dhe të këqinj, në heronj dhe tradhtarë. Likuidimi i klasave kundërshtarë, të regjimit komunist, nuk parakuptonte vetëm ndryshimin e statusit e të gjendjes sociale, por edhe eliminimin fizikisht të tyre, siç edhe shkruhet qartë në objektivat politike të Partisë Komuniste. Në raportin e Kongresit V të Partisë së Punës së Shqipërisë, u theksua se “lufta e klasave edhe pas likuidimit të klasave shfrytëzuese, mbetet një nga forcat kryesore lëvizëse të shoqërisë”.<sup>2</sup>

Eliminimet fizike, burgosjet, likuidimi i klasave dhe grupeve kundërshtarë të komunistëve, u paralajmëruan që pa mbaruar Lufta. Regjimi i ri nuk ishte i sigurt duke pasur nëpër këmbë rivalët e tij, prandaj për të garantuar mbajtjen e pushtetit, vendosi që në Kongresin e Përmetit, t'i ndalohej rikthimi ish mbretit Zog dhe të mos njihej asnjë qeveri tjetër e formuar brenda ose jashtë vendit. Në ditët e dhjetorit 1944, gazeta “Bashkimi” paralajmëronte se “pushteti ynë do të pastrojë të gjitha hauret e regjimeve të okupacionit, të Zogut e të Judës”.<sup>3</sup> Qysh me datën 28 maj 1944, Këshilli Antifashist Nacional Çlirimtar kishte vendosur krijimin e një komisioni për zbulimin dhe vërtetimin e krimeve të pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre.<sup>4</sup> Në qarkoren e Komisionit Qendror<sup>5</sup> për krimet e luftës urdhërohej me urgjencë që në çdo

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste Shqipërisë, viti 1977.

<sup>2</sup> *Dokumente kryesore të PPSH*, vëll. V, F. 151-152.

<sup>3</sup> “Bashkimi”, 31 dhjetor 1944; *Arkivi Qendror i Shtetit/ Arkivi i Partisë (më tej: AQSH/AP)* Fondi 14, viti 1945, dos.7, fl. 82. Cituar prej Demir Dyrmishi në “Spastrimi i administratës shtetërore nga kundërshtarët politikë (1944-1960)”, në *Studime Historike*, nr. 3-4, 2006, F. 105.

<sup>4</sup> *Historia e Shqipërisë*, vëll. IV, botimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 1983 F. 22.

<sup>5</sup> *AQSh*, F. 515, V. 1945, D. 5, fl. 1-25, Komisioni Qendror i Hetimeve të Krimeve të Luftës përbëhej nga Manol Konomi, Koçi Xoxe, Bedri Spahiu, Nako Spiro, Pjetër Deda, Ali Shtepani, Faik Shehu dhe Qirjako Harito

prefekturë e nënprefekturë të krijohen komisionet hetuese për krimet e luftës, shqiptarë ose të huaj.

Në ligjin e datës 15.12.1944 mbi sabotatorët e luftës dhe të pushtetit popullor parashikoheshin dënime deri në 30 vjet burg, dënim të përjetshëm dhe me vdekje. Përveç arrestimeve, burgosjeve dhe vrasjeve, u bë edhe sekuestrimi i pasurisë së të gjithë personave që shpallehin kriminel lufte. Numri i personave të kësaj kategorie të dokumentuar arrin deri në 2048 persona, të cilët i përkasin periudhës brenda vitit 1945.<sup>6</sup> Më 15 dhjetor 1944 u krijua në Tiranë gjykata speciale për gjykimet e personave të konsideruar kriminelë lufte dhe bashkëpunëtorë me fashizmin.<sup>7</sup> Në raportimin e zyrtarit të shërbimit të jashtëm J.E.Jacobs, dërguar Sekretarit të Shtetit, më 11 qershor 1945, thuhej "...gjyqe të tilla po përdroreshin për të hequr qafe kundërshtarët politikë...".<sup>8</sup> Në një qarkore të datës 25 qershor 1945, Enver Hoxha Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, u drejtohet të gjitha reparteve ushtarake, ku i njofton për dënimet me vdekje të 14 oficerëve efektiv të Ushtrisë Nacional Çlirimtare dhe 17 me dënime të ndryshme, të cilët kishin qenë anëtarë të Ballit, Legalitetit, milici dhe xhandarmëri dhe sipas qarkores kishin bërë propagandë kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Mënyra si e përçon në publik Enver Hoxha, lajmin për ekzekutimin e oficerëve, nxit urrejtje klasore midis grupeve sociale dhe ndjenjë hakmarrjeje. Ai shprehet: "Këta renegatë me vetëdije e shpirt reaksionari të pakorrigjueshëm kanë vazhduar tradhtinë e tyre duke mohuar gjakun e dëshmorëve të rënun për liri dhe sakrificat e panumërta të popullit shqiptar. Porse shpirt gjërësi nuk do të thotë dobësi dhe për këtë gjë shpata e drejtësisë, me vend ra mbi këta tradhëtar duke i dënuar me vdekje".<sup>9</sup>

Si rezultat i politikës së goditjes masive numri i të dënuarve u rrit me shpejtësi dhe përmasa të papara. Kështu më 1 janar 1950, Shqipëria kishte 7168 të dënuar me heqje lirie dhe 2000 të internuar që arrinin gjithsej në 9168,<sup>10</sup> pra 753 të dënuar për 100 mijë banorë (Popullsia e Shqipërisë më 3.9.1950 llogaritej në 1.218 900 banor). Një sasi e tillë të dënuarish nuk mund të sistemohej në burgje të cilat jo vetëm që ishin të shkatërruar, por edhe në gjendjen më të mirë të tyre ishin llogaritur për një kapacitet 3 herë më të vogël.

Statistikë mbi kapacitetin e burgjeve më 1 janar 1951<sup>11</sup>

<sup>6</sup> AQSh, F. 515, V.1945, D. 4, fl. 1-22.

<sup>7</sup> *Historia e Shqipërisë...*, F. 24.

<sup>8</sup> Bernd Fischer, *Shqipëria 1943-1945, Një vështrim përmes dokumentave perendimore*, Tiranë: AIIS, 2012, F. 116.

<sup>9</sup> AQSH, F. 516 Gj. L. Ushtarake, V. 1945, D. 5.

<sup>10</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (më tej: AMPB)*, Fondi Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V.1950, D. 50.

<sup>11</sup> *AMPB*, Fondi Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V.1951, D. 17.

R	Burgjet	Kapaciteti		Gjendja në fakt	Mbi kapacitet
	Tirana	Politik	28 7	902	615
		Ordine	19 1	873	722
	Elbasani	Politik	16 3	216	53
		Ordine	11 8	324	206
	Korça	Politik	22 1	353	132
		Ordine	91	487	396
	Vlora	Politik	21 1	130	81
		Ordine	10 2	544	442
	Shkodra	Politik	25 6	565	309
		Ordine	26 5	564	309
	Durrësi	Politik	14 9	97	-52
		Ordine	17 6	308	132
	Berati	Ordine	21 6	487	273
	Gjirokastra		35 1	735	384
	Burreli	Politik	22 8	581	353



	Shuma		30	7168	416
			05		3

Gjendja e kampeve të internimit ishte si më poshtë:

Kam pet	T epelene	V alias	P. Palermo	Gj erman	G rek	Shu ma
Maj 1949	1 172	5 84	198	21 2	6 06	277 1
Maj 1950	1 352	7 33	91	21 2	6 05	299 3

### ***Kampet e punës së detyruar.***

Ngritja e kampeve të punës së detyruar me të dënuar dhe paraburgosur si dhe ngritja e kampeve të internimit, kishte qëllim të shumëfishtë, përdorimin e punës së detyruar, pa pagesë në degët më të vështira të ekonomisë, eliminimin e klasave kundërshtarë, parandalimin e rrëzimit të pushtetit dhe ndikimin në gjithë popullatën.

Në dhjetor 1944, me urdhër të Qeverisë së Përkohshme Demokratike u hap në Tiranë Burgu nr 5, në të cilin u izoluan personat e etiketuar armiq të popullit. Burgjet dhe kampet, nga dhjetori 1944 deri në maj 1945 siguroheshin nga Divizioni i Mbrojtjes së Popullit dhe pas kësaj kohe, personat që janë proceduar për vepra ordinere janë vënë nën administrimin, drejtimin dhe sigurimin e Policisë Popullore, ndërsa ata të cilët procedoheshin për vepra politike, kanë qenë nën juridiksionin e Divizionit të Mbrojtjes së Popullit, pra të sigurimit dhe të gjykatave ushtarake.

Sistemi i ekzekutimeve të vendimeve penale, gjatë regjimit komunist, është zbatuar, në burgje të mbyllura, në kampe pune, të cilët janë emëruar “reparte” dhe në kampe internimi. Qëllimi i këtij organizimi, ishte ekonomik, për shfrytëzimin e punës së detyruar në ngritjen e veprave ekonomike. Në kodin Penal të vitit 1952 përdoret termi kampe korektonjëse, në Kodin Penal të vitit 1970 përdoret termi “vende riedukimi nëpërmjet punës”. Në Kodin Penal të vitit 1952 parashikohet që heqja e lirisë rregullisht të vuhej në kampet e punës korektonjëse. Gjykata mund të vendosë që gjithë koha, ose një pjesë e heqjes së lirisë të vuhej në burg, kur e gjen se i dënuari është përsëritës i rrezikshëm si dhe kur ka kryer një krim të rëndë.<sup>12</sup> Zakonisht gjykatat nuk i vendosnin të dënuarit në burgje të nisur nga fakti se ishin përsëritës. Në burgje

<sup>12</sup> Ligji nr 1470 dt.23.Maj 1952 i ndryshuar, Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë

vendoseshin detyrimisht të dënuarit për krime kundër shtetit, që ndryshe jo vetëm verbalisht, por edhe në dokumente zyrtare quheshin “armiç të popullit”. Dekreti nr 3584, datë 12 Nëntor 1962, mbi ”Zbatimin e vendimeve gjyqësore”, parashikon që burgjet konsiderohen një formë më e rëndë ndëshkimi krahasuar me kampet e punës. Të burgosurit e dënuar dërgohen në burgje nëse ata realizojnë “dhunime të rënda apo të përsëritura”<sup>13</sup> të rregullit të kampit, ose nëse mbajtja e tyre në një kamp pune “përbën rrezik”, apo në rastin kur ata nuk janë në gjendje të punojnë për shkak të gjendjes fizike.

Në fillim në punë u aktivizuan ushtarakët e dënuar me dënime të lehta dhe që nuk paraqisnin rrezik për rendin. Kjo bëhet e qartë me një urdhër të E.Hoxhës me cilësinë e Ministrit të Mbrojtjes dhe Komandantit Suprem të datës 4.5.1946 ku i drejtohet Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit dhe Divizionit të III dhe porositen “Për me aktivizuar të burgosurit ushtarak në punë të ndryshme në dobi të ushtrisë në fillim dhe më vonë sipas rrethanave në dobi të pushtetit popullor.”<sup>14</sup> Në vazhdim të planeve për punësimin e të dënuarve, më 6.12.1946, Ministri i Punëve të Brendshme Koçi Xoxe i dërgon një shkresë Ministrisë së Punëve Botore dhe të Bujqësisë e Pyjeve ku midis të tjerave thekson: “Ndër burgje kemi një numër të konsiderueshëm të burgosur të cilët ushqehen dhe e shkojnë bukën kot. Në mënyrë që të aktivizohen në punë dhe veçanërisht të ekzekutohet dënimi i dhënë me punë të detyruar, ky dikaster ka ngritur si problem futjen e të dënuarve në punë...”<sup>15</sup>

Internimet dhe dëbimet kishte filluar që në vitin 1945, megjithëse ky lloj dënimi, ligjërisht është parashikuar në vitin 1949. Në një evidencë të vitit 1947 konstatohet që gjatë vitit 1947 nga janari ndodheshin 1272 të internuar dhe ishin të vendosur në Krujë dhe në Berat.

	an	hk	ars	rill	aj	ersh	orr	usht	hta	et	ënt	hjet
/r Total	272	158	115	126	110	67	78	84	95	81	86	76
ampi Berat	55	92	62	70	43	65	75	75	86	71	83	83

<sup>13</sup> AQSH, Fondi Prokuroria e Përgjithshme (492),v.1962, D. 31.

<sup>14</sup> AQSH, Gjykata e Lartë Ushtarake (516), V.1946, D. 8, fl. 1.

<sup>15</sup> Po aty (Letër e Ministrit të P. Brendshme, Koci Xoxe, dërguar Ministrisë së Punëve Botore, datë 6.12.1946)

ampi Krujë	16	66	53	56	67	02	03	09	09	10	03	03
---------------	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----

Të dhënat i referohen Fondit të Degës së Kampeve dhe Burgjeve në Arkivin e Ministrisë së Brendshme.<sup>16</sup>

Dënimet, me internim dhe dëbim, janë parashikuar në dekretligjin nr. 649 datë 10.1.1949, si masë administrative, në kompetenca të Komisionit të Internimeve. Ky ligj është ndryshuar, pjesërisht, pa e cenuar thelbin dhe qëllimin e tij, gjatë viteve, me dekretin nr. 1906, dt. 02.08.1954, nr. 3021, datë 12.01.1960, nr. 4137, datë 9.5.1966 dhe me dekrete të tjera të mëvonshme. Dënimi me internim dhe dëbim, u parashikua edhe në Kodin Penal, si dënim gjyqësor. Në nenin 22 të Kodit Penal të vitit 1952 përcaktohet procedura dhe aplikimi i masës së dëbimit.<sup>17</sup> Në nenin 21 të Kodit Penal përcaktohet masa e internimit: “Internimi është largimi i të dënuarit nga vendbanimi me detyrim që të qëndrojë në një vend të caktuar me ose pa punë korektonjëse. Internimi si dënim kryesor jepet për një kohë nga një gjer në 10 vjet. Internimi pa punë korektonjëse jepet për një kohë nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet dhe ekzekutohet pas vuajtjes së dënimit kryesor.<sup>18</sup> Internimi nuk jepet kundër të miturve sipas ligjit, por në të vërtetë janë me mijëra ata që kaluan fëmijërinë në kampet e internimit. Edhe në Kodin Penal të vitit 1977 janë ruajtur këto dispozita thuajse të pandryshuara, çka dëshmon se asgjë nuk kishte ndryshuar në politikën penale të shtetit komunist.

Masa e internimit ose dëbimit administrativ vendosej nga një komision i veçantë i cili kishte në përbërje 7 veta të caktuar me dekret të Presidiumit Kuvendit Popullor dhe që kryesohet nga Ministri i Punëve të Brendshme. Në mbledhjen e Komisionit merr pjesë edhe Prokurori i Përgjithshëm ose zëvendësi i tij. Kundër vendimeve të Komisionit mund të bëhet protestë në Këshillin e Ministrave nga Prokurori i Përgjithshëm. Në diskutimin e projektligjit, raportohet të jetë marrë parasysh eksperiencia sovjetike. “Në përpunimin e projekt ligjës,-raportonte M.Shehu,-është shfrytëzuar eksperiencia sovjetike për sa i përket internim dëbimeve si masë administrative dhe dispozitat e neneve 21 dhe 22 të K.Penal shqiptar”.<sup>19</sup> Me ndryshimet e herëpashershme që i është bërë ligjit për internimet dhe dëbimet, vetëm sa është theksuar dhe forcuar kontrolli mbi zbatimin e internimeve dhe janë kufizuar të gjitha mundësitë për t’u mbrojtur, apo për t’u shprehur. Në dekret nr. 3027 datë 12.1.1960 mbi internim-dëbimet

<sup>16</sup> AMPB, Fondi Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V.1950, D. 10.

<sup>17</sup> Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë 1959.

<sup>18</sup> Po aty, Kodi Penal...

<sup>19</sup> AQSH, F. 890/Kuvendi Popullor, V.1953, D. 231.

parashikohej kjo përbërje e komisionit: Kryetari që është Zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, Zëvendësi i tij që është Ministri i Punëve të Brendshme, Prokurori i Përgjithshëm dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë. Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash dhe janë të formës së prerë. Neni 6 i dekretit të vitit 1954 që bën fjalë se mund të protestohet nga Prokurori i Përgjithshëm, abrogohet.<sup>20</sup>

Në vitin 1969 u diskutua që të hiqet internimi dhe dëbimi si masë administrative dhe të lihej vetëm si dënim penal i dhënë nga gjykata. Kjo u hodh poshtë nga juristët pasi sillte disa vështirësi për gjykatat. Konkretisht shumica e internimeve dhe dëbimeve ishin dhënë si masë administrative nga komisioni dhe në se do të ndryshohej procedura, duhej që të internuarit të liroheshin, gjë që konsiderohej e pamundur për pushtetin e kohës, sepse jo vetëm donte t'i mbante nën kontroll një kategori të caktuar njerëzish, por edhe t'i shfrytëzonte në punë krahu. Problemi i dytë “ishin personat që do të kryenin veprime antiparti por që nuk arrinin në krim kundër shtetit dhe nuk dënoheshin nga kodi penal”.<sup>21</sup> Pra, kuptohet që internimi jepej edhe pa prova nga komisioni, kurse gjykata duhet të bazohej në prova dhe fakte, sipas diskutantëve. Së treti, do të ishte problem me familjet e të arratisurve, kur nuk provohej se ata kane dijeni për anëtarin e familjes së tyre.<sup>22</sup> Pra, nga diskutimet e specialistëve lidhur me organin që ka kompetencë të dhënies së masës së dënimit internim dhe dëbim, del e qartë se kjo masë është ushtruar në mënyrë arbitrare, pa provat e nevojshme dhe në procedurë, nuk ishte parashikuar një proces i rregullt, dëgjimi, informimi, mbrojtje dhe apelimi. Kriteret për internimin dhe dëbimin si masë administrative, parashikoheshin në ligjet e përmendura më lart dhe rregulloren mbi të internuarit dhe të dëbuarit. Internimi dhe dëbimi do të aplikoheshin kundër personave që paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore si:

Pjesëtarë të veçantë ose të gjithë familja e një personi që arratiset jashtë shtetit, kur ajo banon në afërsi të zonës kufitare;

Mund të internohen edhe një pjesë ose disa pjesëtarë të familjes së një personi që arratiset jashtë shtetit, të cilët banojnë jo në zona kufitare, kur një masë e tillë i shërben prevenimit të arratisjeve të tjera të mundshme nga ajo zonë;

Elementë antiparti, qëndrimi i të cilëve në vendin ku banojnë bëhet i rrezikshëm;

Persona të veçantë ose familje të personave që banojnë në afërsi të zonave kufitare dhe që paraqesin rrezikshmëri për t'u arratisur;

Elementë me tendencë të mprehtë terrori;

---

<sup>20</sup> Po aty, D. 231.

<sup>21</sup> AQSH, F. 890/Kuvendi Popullor, V.1970, D. 255.

<sup>22</sup> Po aty, D. 255.

Kundër pjesëtarëve madhorë të familjeve të kriminelëve të luftës që janë arratisur jashtë shtetit, pjesëtarë të personave të tjerë të t'arratisurve jashtë shtetit kur ata kanë prejardhje klasore reaksionare dhe vet paraqesin rrezikshmëri. Për të dy këto kategori, kjo masë të merret kur banojnë në qytetet kryesore.

Në raste të veçanta, masa e internim dëbimit mund të merret edhe kundër personave që kanë kryer vepra të tilla keqbërëse si vjedhje, prostitucion, vagobantazh me përsëritje, por kur këta banojnë në qytetet kryesore.<sup>23</sup>

Nga raporti mbi internim-dëbimet gjatë vitit 1967, shikohet të jenë si të dënuar me internim dhe dëbim 1189 persona, nga të cilët 791 të internuar, duke shënuar një rritje 49% të krahasuar me vitin 1966, 1965. Kjo lidhet jo me shtimin e shkeljeve, por me ashpërsimin e kontrollit mbi shoqërinë dhe me acarimin e luftës së klasave, në kuadër të nisjes së të ashtuquajturit revolucion ideologjik dhe forcim të vijës së masave. Të dhënat flasin qartë se nga drejtohej goditja dhe ku përqendrohej kontrolli i plotë i shtetit.

Nga 1189 të internuar dhe dëbuar 496, raportohen të jenë shtresa të pasura, 421 ishin shtresa të mesme, 272 janë shtresa të varfra dhe 555 persona janë nga fshati, 634 nga qyteti. Arsyet e internimit konkludohet të jetë, 432 persona kanë pjesëtarë të familjes të arratisur, 105 kanë tendencë arratisje, 288 kanë rrezikshmëri shoqërore, 19 persona antiparti, 285 sjellje të padenjë në shoqëri, vjedhje, kurvëri etj. Në shkallë vendi rezultojnë 270 familje të internuara, nga të cilat 122 nga fshati dhe 148 nga qyteti.<sup>24</sup>

Trajtimi dhe të drejtat e të internuarve ishin parashikuar në një rregullore të posaçme të vitit 1962, e cila në fakt ishte krejt formale sepse asgjë nuk realizohej nga ato që ishin parashikuar. Masa e dënimit me internim jepej deri në 10 vjet dhe më pas kishte zgjatje afati. Kështu nga viti 1965 deri në gusht 1967 u ishte zgjatur afati 117 personave dhe ishin liruar me plotësim kohe vetëm 73 vetë ose 38% e tyre. Në nenin 5 parashikohej që personat e internuar, me kërkesën e tyre kanë të drejta të marrin dhe mbajnë me vete fëmijët e tyre të mitur. Për këtë organi i punëve të brendshme bën pasaportizimin e të internuarit. Gjithashtu, personi i internuar ka të drejtë të marrë me vete edhe pjesëtarë të tjerë të familjes, gruan, burrin, nënën, ose të tjerë, mbasi të jetë dhënë autorizimi përkatës nga organet e punëve të brendshme. Shkelja e të drejtave dhe arbitrariteti ndaj të internuarve dhe të dëbuarve, dokumentohet edhe në raporte zyrtare të organeve përkatëse. Një raport i vitit 1961, mbi inspektimet dhe kontrollin në kampet e të internuarve Savre, Gradisht të Lushnjës dhe Shtyllas, Ferma "Çlirimi" në Fier si dhe kampin e të huajve Seman Fier dhe Çermë Lushnjë, raportohet: "Në lidhje me administrimin dhe zbatimin

<sup>23</sup> AQSH, F. 890/Kuvendi Popullor, V.1970, D. 255.

<sup>24</sup> AQSH, F. 492/Prokuroria e Përgjithshme, V. 1967, D. 60.

e ligjshmërisë, ka të internuar që nuk kanë të qartë sa do të qëndrojnë atje, nuk janë bërë anëtarë kooperative dhe punojnë si argatë, refuzohen për të ndjekur shkollat të mesme dhe të larta”.<sup>25</sup> Në lidhje me strehimin e tyre, raportohet se në disa raste gratë janë ndarë nga burrat e tyre dhe flenë në kapanone të ndara. Gjendja e pajisjeve është e mjerueshme. Këpucët, ushqimet, rrobat mbahen të varura mbi krevat në mure. Në të njëjtin vend flenë, hanë, gatuajnë duke munguar higjiena. Uji i pijshëm mungon, ka ngjyrë të kuqe dhe është i ngrohtë.<sup>26</sup>

Në një informacion dërguar Kuvendit Popullor mbi disa probleme mbi internim dëbimet rezulton: Deri më 1969 kanë qenë 849 të internuar dhe 295 të dëbuar në rrugë administrative, gjithsej 1144 persona.<sup>27</sup> Nga këta 807 ishin për qëndrime armiqësore ndaj pushtetit popullor dhe 337 për vepra ordinere, 118 janë individë të tjerët familjarë. Nuk janë llogaritur ata që qëndrojnë përgjithnjë në vend internimi. Në prill 1965 kanë qenë 794 persona të internuar e dëbuar.

Numri i përgjithshëm i personave që kanë kaluar në internim dëbim gjatë viteve 1949-1969.<sup>28</sup>

o ji I dën im	o ti vi	3	4	5	6	7	8	9	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	hu ma
nter nim	olit	7 9	4 6	0	9 4	1 3	1 2	0 2	1 6	5 7	7 2	2	6	9	8	9 7	5 7	2 7	<b>528</b>
	rdi ner		1			3						9	0		9 9	5	8	8	<b>14</b>
	jith sej	7 9	5 7	0	9 4	2 6	1 2	0 2	1 6	5 7	7 2	1 1	6	0 0	9 7	8 2	5 5	8 5	<b>141</b>

<sup>25</sup> AQSH, Fondi Prokuroria e Përgjithshme (492), V.1967, D. 69.

<sup>26</sup> AQSH, Fondi, Prokuroria e Përgjithshme (492), V.1961, D. 20.

<sup>27</sup> Po aty, Dosja nr. 20.

<sup>28</sup> Po aty, Dosja nr.255.

ëbi m	olit ik		6	3	3	0	7	5	5	3		7	3						<b>86</b>
<b>otal</b> <b>i</b>		<b>7</b> <b>9</b>	<b>7</b> <b>3</b>	<b>3</b>	<b>2</b> <b>7</b>	<b>5</b> <b>6</b>	<b>2</b> <b>9</b>	<b>3</b> <b>7</b>	<b>4</b> <b>1</b>	<b>0</b> <b>0</b>	<b>8</b> <b>1</b>	<b>2</b> <b>8</b>	<b>9</b>	<b>0</b> <b>1</b>	<b>9</b> <b>7</b>	<b>8</b> <b>4</b>	<b>5</b> <b>7</b>		<b>997</b>

Në këto shifra përfshihen edhe 379 persona të internuar dhe dëbuar gjatë viteve 1949-1952 të cilët janë internuar në bazë të dekretit nr. 649, dt 19.01.1949. Në momentin e hartimit të këtij raporti rezultonin të jenë 868 të internuar, nga të cilët 578 për veprimtari armiqësore dhe 250 për veprimtari keqbërëse. Nga 578 për veprimtari armiqësore: 115 u janë arratis pjesëtarët e familjes, 90% janë në zona kufitare, 124 kanë pasur tendenca arratisje, ose kanë nxitur të tjerët për arratisje, 23 dyshohen si agjentë të huaj, 13 elementë antiparti, 303 për qëndrim të keq të familjeve, janë nga familje reaksionare. Përveç krimeve, ose dyshimeve që kishin strukturat e shtetit, për individë të veçantë ose familje që nuk pajtoheshin me sistemin, kishte shumë të internuar ose të dëbuar për arsye të shkeljeve të tjera të karakterit ordiner, si vrasje, papunësi, akte që nuk pajtoheshin me normat dhe rregullat standarde të shoqërisë komuniste. Kjo kategori përbënte rreth 290 persona, të cilët ishin internuar për vjedhje të përsëritura, për të parandaluar vrasjet, sjellje të padenjë në shoqëri, marrëdhënie seksuale jashtë martese etj. Shumica e personave të kësaj kategorie ishin nga qytetet, 279 nga 290 gjithsej. Në zonat qytetare, shoqëria është më e organizuar dhe për rrjedhojë më e kontrolluar.<sup>29</sup>

### ***Puna e detyruar një burim i rëndësishëm i buxhetit të shtetit komunist***

Nga puna e të burgosurve sigurohej një e ardhur e konsiderueshme në buxhetin e shtetit, që më pas përdorej përveç nevojave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, kryesisht nga Ministria e Financave për investime në sektorë të tjerë. Po të shikohen disa raporte mbi bilancin ekonomik të të ardhurave të krijuara nga puna e të burgosurve, arrin të kuptosh se ata përballonin punët më të vështira të vendit dhe përbënin një faktor të rëndësishëm për shtimin e të ardhurave.

Në vitin 1948, realizimi i të ardhurave nga puna e të burgosurve raportohet 10.780.420.50 lek, me kursin e kohës. Gjatë vitit 1950, raportohen 16.000.000 lek, ku vetëm në

<sup>29</sup> AQSH, F. 890/Kuvendi Popullor, V. 1970, D. 255.

Bishqem llogariten 65.000 ditë pune nga 800 të burgosur dhe 3.282.595.50 lek të ardhura.<sup>30</sup> Në kampin Ura e Bonës në Peqin, filluan punimet më 22.01.1950. Janë dërguar në fillim 500 të burgosur, të cilët kanë punuar në trasenë e hekurudhës Peqin-Elbasan, në gjurmime dheu, në transport dhe mbushje traseje. Janë realizuar 70350 ditë pune dhe 4.834.343 lek të ardhura. Në tharjen e kënetës së Maliqit ishte ngritur një nga kampet më të vështira. Punimet kanë filluar më 1947 dhe kanë përfunduar më 1951. Gjatë vitit 1950 kanë punuar 900 të dënuar, të cilët kanë kryer 110.000 ditë pune dhe siguruar 12.671.741.50 lek të ardhura. Gjatë vitit 1951 në këtë kamp kanë punuar 1085 të dënuar duke kryer 148.026 ditë pune dhe realizuar 22.773.449.65 lek të ardhura.<sup>31</sup> Për nevoja që kishte Ministria e Brendshme, ishte ngritur një kamp me rreth 150 të burgosur, të cilët ishin organizuar në disa reparte si marangoz, rrobaqepës, mekanikë, përkthyes dhe këpucarë. Të ardhurat e realizuara prej tyre llogariteshin në 1.628.336 lek brenda vitit 1950. Në janar 1950 në Sukth u ngrit kampi me robërit monarko-fashistë grek.<sup>32</sup> Rreth 400 veta merrnin pjesë në punë çdo ditë për shpyllëzime, prashitje pambuku, vreshtari, korrije, mbledhje domatesh etj. Puna ishte dy orë larg vajtje-kthim. Sipas analizave të vitit, llogariten 80.000 ditë punë dhe 1.628.336 lek të ardhura. Gjithsej kampi kishte 616 grekë. Kampi i Valiasit ishte ngritur që në vitin 1948. Në këtë kamp bënë pjesë të internuarit, robërit e luftës dhe të burgosur. Në janar 1950, në kamp ndodheshin edhe 200 gjermanë. Pjesa më e madhe e të internuarve ishin gra. Në maj të vitit 1950 ky kamp kishte 733 vetë. Në Vlorë ka qenë ngritur një kamp me 50 veta që quhej “Lufta e Vlorës” dhe në Fier një kamp tjetër. Përveç kampeve të punës me të burgosur, në vitin 1950 ishin ngritur edhe disa kampe internimi. Në Tepelenë, 1352 të internuar, në Valias 733 vetë, në Porto Palermo 91, kampi i gjermanëve me 212 dhe kampi i grekëve me 605 veta. Në total llogariten në vitin 1950 të jenë 2993 të internuar, prej të cilëve janë aktivizuar në punë 2500 veta. Në punë janë aktivizuar, përveç të rriturve dhe grave edhe fëmijët. Kampi nr. 2 në Selenicë filloi më 2 maj 1951. Në këtë kamp punuan çdo ditë 788 të burgosur. Kushtet e punës ishin shumë të vështira, mungonte uji i pijshëm dhe shumë të burgosur ishin sëmurë. Gjatë vitit 1951 janë realizuar në këtë kamp 120.259 ditë pune. Kampi i quajtur “Kombinati Stalin” filloi në korrik 1951 dhe çdo ditë janë aktivizuar 299 të burgosur. Në Urën Vajguorere ishte ngritur kampi për ngritjen e aeroportit dhe kanë punuar 2000 të burgosur.

---

<sup>30</sup> AMPB, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V.1950, D. 9.

<sup>31</sup> AMPB, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V.1951, D. 17.

<sup>32</sup> Po aty, D. 17



Gjatë vitit 1954, sipas raportit vjetor të Degës së Kampeve e Burgjeve,<sup>33</sup> janë aktivizuar në punë 4272 të dënuar dhe të arrestuar, por duke i llogaritur forcat për çdo kamp, llogariten rreth 6684 të burgosur. Në kampin nr.1 ishin aktivizuar 1159 vetë, në kampin nr .2, 2769 të dënuar, në kampin nr. 3, 1252 të dënuar dhe në kampin nr.4, 394 të dënuar, në punëtorinë e artizanatit, 679 vetë dhe në kampin e të internuarve, 431 veta, nga të cilët 200 gra dhe fëmijë dhe 215 burra. Gjatë vitit 1956, aktivizimi në punë sipas kampeve ishte: Reparti 301, Bulqizë ka aktivizuar 931 të dënuar, nga 1047 që kishte gjithsej.<sup>34</sup> Në Rinas, ku ishte dislokuar, kampi nr. 2, ose Reparti 303, ishin aktivizuar 800 të burgosur. Në Zadrimë Lezhë, ndodhej kampi nr.3, ose Reparti 305 me 1284 të burgosur të angazhuar në bonifikimin dhe sistemimin e lumit Gjadër. Në Tiranë, për ndërtim pallatesh, ishin aktivizuar të dënuarit e kampit nr.4, me një efektiv prej 333 forca pune, nga 400 që kishte kampi. Në punëtorinë e artizanatit, që ishte një kamp me shërbime të ndryshme, ishin angazhuar 581 të burgosur. Për tharjen e kënetës së Tërbufit ishte dislokuar kampi nr. 5, ose Reparti 309, me një forcë prej 700 të dënuar. Në gjithë vendin punonte një ushtri e tërë të burgosurish që kapte numrin 5000 veta, por në raportimet zyrtare, thuhej se ishin angazhuar 4044 të burgosur.

Reparti (ose burg)	(kamp)	Të dënuar ordiner	Të dënuar politik	Shuma
Bulqizë	Reparti 301	716	-	716
Rinas	Reparti 303	-	401	401
Zadrimë	Reparti 305	668	93	761
Tiranë	Reparti 307	455	9	464
Tërbuf	Reparti 309	-	557	557
Artizanatit	Punëtorinë e	388	139	527
Burgu i Tiranës		302	319	621
Burgu i Shkodrës		189	127	316

<sup>33</sup> AMPB, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V.1954, D. 34.

<sup>34</sup> AMPB, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V.1956, D. 47.

Burgu i Vlorës	302	262	564
Burgu i Burrelit	6	240	246
Burgu i Korçës	95	105	200
Shuma	3121	2252	5373

Kjo statistikë i përket vitit 1957.<sup>35</sup>

Këtu nuk janë llogaritur personat në pritje të gjykimit, të cilët qëndronin pranë degëve të punëve të brendshme të rretheve.

Gjatë vitit 1958 dhe 1959, kampet vazhduan të spostohen në zona dhe fronte të reja pune. Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 1959, raportohen 161.438.454 lek.<sup>36</sup> Gjatë vitit 1961, 4345 të dënuar ishin shpërndarë në 6 kampe pune dhe 4 burgje. Një pjesë e konsiderueshme e të dënuarve gjatë vitit 1961-1962, ishin përqendruar në Tiranë në ndërtime pallatesh, vepra industriale dhe kulturore. Raportet thonë se “Tiranën e kemi rrethuar nga veriu dhe jugu, nga lindja dhe perëndimi me të dënuar, ..... të ruhen nga legatat e huaja”.<sup>37</sup> Pra, është e kuptueshme se kjo “ushtri skllëvërishe” nuk ishte lavdi për pushtetin komunist, i cili përpiquej ta fshihte në sytë e botës, por që nuk fshihej.

Në vitin 1965, kampet ishin vendosur në Elbasan, për ndërtimin e fabrikës së çimentos, Rubik, uzina e shkrirjes së bakrit, Bulqizë, në minierën e kromit, Fushë Krujë, në fabrikën e çimentos. Në bazë të një urdhri të kryeministrit datë 24.11.1966, çdo vit në Tiranë do të ndërtoheshin 150 pallate banimi, gjatë periudhës 1966-1970. Në shkurt të vitit 1966 u krijua reparti 315, në Belsh të Elbasanit i cili përbëhej nga mosha të reja 14 deri 24 vjeç. Ky kamp kishte rreth 373 të dënuar dhe një personel prej 14 punonjës, oficerë, policë dhe 40 ushtarë, të cilët bënë shërbimin e detyruar në sigurimin perimetrik të kampit. Në vitin 1966 filloi puna për sistemimin dhe taracimin e bregdetit Jon, ku për një periudhë më shumë se dy dekada punuan mijëra të burgosur, në kushte tepër të vështira, të cilët e transformuan plotësisht peizazhin natyror duke krijuar plantacione të tëra me agrume. Nga viti 1968 deri më 1990, një pjesë e konsiderueshme të burgosur politikë, u dislokuan në minierën e Spaçit, i quajtur reparti 303. Përveç këtyre kanë ekzistuar edhe disa kampe të tjera si Qafa e Barit, Pukë, Tërnovë, Dibër, Batër Martanesh.

Frontet e punës ku u aktivizuan të burgosurit kanë qenë më të vështirët dhe të shtrirë në gjithë territorin e Republikës. Në një letër të ministrit të Ndërtimit, Josif Pashko drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Mehmet Shehu më 6.4.1963 i kërkon të aktivizohen të

<sup>35</sup> AMPB, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V. 1958, D. 9.

<sup>36</sup> AMPB, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V. 1959, D. 71.

<sup>37</sup> Po aty, D. 71.

burgosurit në veprat industriale që do të ndërtoheshin me ndihmën e Republikës Popullore të Kinës. Konkretisht kërkoheshin 2000 të burgosur në vitin 1963 dhe 1000 në vitin 1964 të cilët do të punonin në uzinën e bakrit Rubik, çimentos Fushë Krujë, Elbasan dhe uzinën e sodës, Vlorë.<sup>38</sup> Në një raport të Ministrisë së Ndërtimit në vitin 1964, informohemi se, në vitin 1963 në Laç dhe Vlorë kanë punuar 860 të burgosur dhe në vitin 1964 janë aktivizuar 1400 të burgosur në kampet e mësipërme dhe 330 në Fushë Krujë dhe 250 në Rubik.<sup>39</sup> Sipas raportimit zyrtar më 1956, nga 5346 të dënuar që ishin vendosur në burgje dhe kampe, 1321 ishin të sëmurë, nga të cilët 890 të sëmurë, rezultonin për shkak të kushteve të këqija të burgut dhe pjesa tjetër raportoheshin me sëmundje të trashëguara, por që janë keqësuar. Nga sëmundjet më të përhapura ishin ato TBC, ku raportoheshin 334 të sëmurë.<sup>40</sup> Uria që sundonte në të gjithë territorin e vendit, por veçanërisht në burgje, konsiderohej si një vuajtje tjetër, përveç privimit të lirisë së të burgosurve. Kjo duket qartë në një raport, ku thuhet se të dënuarve u është dhënë ushqim më shumë se norma e tyre, kështu që ata nuk e kanë ndjerë si duhet dënimin.<sup>41</sup> Pra duket qartë se përmirësimi i kushteve të banimit dhe të trajtimit të të dënuarve, nuk ishte në misionin e shërbimit të burgjeve, pasi keqtrajtimi ishte pjesë e filozofisë së politikës penale të sistemit të diktaturës. Gjatë vitit 1949, janë raportuar 59 të vdekur nga të burgosurit politikë dhe 14 të burgosur ordinerë të cilët ishin në burgje. Në këto të dhëna nuk përfshihen ata që kanë vdekur në kampe pune dhe qendra internimi. Në kampin e internimit Tepelenë, kishin vdekur 3 burra, 12 gra dhe 28 fëmijë. Në vitin 1950 janë raportuar të kenë vdekur 39 të burgosur dhe 53 të internuar. Gjatë vitit 1951, gjendja ka ardhur në keqësim, ku raportohen 5132 të sëmurë, 178 të vdekur, nga të cilët 129 të burgosur dhe 48 të internuar. Sëmundjet më të përhapura kanë qenë TBC, ku janë identifikuar të vdekur për shkak të kësaj diagnoze 46 persona. Vitet në vazhdim, nuk sollën ndonjë përmirësim në kushtet dhe trajtimin e të burgosurve. Viti 1952 shënon një rritje të madhe të shifrave të fatkeqësive, ku raportohen 207 të vdekur, 101 të burgosur politikë dhe 106 të dënuar ordiner.<sup>42</sup> Nga analizat e drejtorisë së kampeve dhe të burgjeve, vdekjet e shumta në radhët e të burgosurve dhe të internuarve pranohen zyrtarisht të jenë rritur si rezultat i punës së rëndë në kampe dhe i sëmundjeve të shumta.<sup>43</sup>

Në disa raste është hedhur dyshim për mënyrën e vdekjes së të dënuarve dhe janë bërë deklaratime për ekzekutime të planifikuara nga ana e komandave, si mënyrë parandalimi të çdo

<sup>38</sup> AQSH, F. 494/Ministria e Ndërtimit, V.1963, D. 174, fl. 1.

<sup>39</sup> AQSH, F. 494/Ministria e Ndërtimit, V.1963, D. 174.

<sup>40</sup> AMPB, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V.1956, D. 47.

<sup>41</sup> Po aty, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V. 1948, D. 2.

<sup>42</sup> Po aty, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V. 1952, D. 25.

<sup>43</sup> Po aty, D. 25.

rezistence, apo hakmarrje ndaj të burgosurve të veçantë. Në raportin e vitit 1950 informohemi se një i burgosur është vrarë pa paralajmërim vetëm se ka shkelur vijën e ndaluar.<sup>44</sup> I dënuari ishte dënuar dy vjet dhe pas dy muajve lirohej. Në raportin e datës 7.6.1952 thuhet se masat ndëshkimore kanë qenë ekstreme. Në kampin nr. 1 dhe 2 të burgosurit janë qëlluar me shkop nga policët, punëtori operativ në kampin e monarko-fashistëve grekë Lushnjë ka plaçkitur dhe torturuar të internuarit. Janë konstatuar edhe mjaft sjellje imoraliteti.<sup>45</sup> Keqtrajtimet e kishin bazën në filozofinë e urrejtjes që ishte mbjellë nga shteti midis shtresave të ndryshme të vendit, veçanërisht ndaj të burgosurve politikë. Vendosja e etiketimit “armiq të popullit” ishte nxitje direkte për dhunë, për veçim, për poshtërim dhe diskreditim. Në raportin e vitit 1956, thuhet: “Ne kishim qëllim të godisnim disa të meta të zbutjes së luftës së klasave dhe urrejtjen karshi armikut, por në disa reparte janë hedhur në ekstrem dhe kërcet druri”<sup>46</sup>.

Ministria e Punëve të Brendshme me shkresë nr. 1374 datë 1.8.1968,<sup>47</sup> i ka përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme denoncimin e qytetarit S.H ish kryeinfermier në kampin e Bulqizës ku thuhet se gjatë vitit 1957 janë kryer disa krime: kanë vrarë në pritë të burgosurin H.S. Ka vdekur në tortura i burgosuri S.M. Është hedhur në një oxhak galerie i burgosuri M.I. Janë pyetur 12 persona dhe është provuar nga organet e hetuesisë, se është kryer krim kundër të dënuarve me bashkëpunimin e stafit. Ushqimi që u jepej të dënuarve ishte i pamjaftueshëm dhe shumë larg sasisë së kalorive që duhet të marrë organizmi për të jetuar. Në burgje deri në vitin 1950 është përdorur vetëm buka, në pjesën më të madhe e misrit që ishte plot mbeturina. Në mars 1950 qeveria vendosi që krahas bukës të gatuhej edhe supa, duke e interpretuar si zemërgjerësi të qeverisë. “Ky vendim ka pasur rëndësi politike, - thuhej në një raport, - sepse komentohet se pushteti popullor megjithëse ata kanë kryer krime e faje kundër shtetit e shoqërisë, mendon për shëndetin e tyre . . . Të sqarohen të burgosurit për rëndësinë politike të problemit, se pushteti popullor mendon për ata, megjithë veprimtarinë e tyre armiqësore”.<sup>48</sup>

Në një raport të vitit 1970 jepet një panoramë e plotë e situatës në burgje dhe kampe. Në atë periudhë në burgjet dhe kampet e Shqipërisë ndodheshin 4145 të dënuar, nga këto 1420 për krime kundër shtetit dhe 2724 ordinerë. Kampet dhe burgjet ishin dislokuar në 9 rrethe. Burgjet ndodheshin në Tiranë dhe Burrel, ndërsa kampet në Bulqizë, Spaç, Elbasan, Kuçovë, Vlorë, Borsh, pra 2 burgje dhe 7 kampe. Në Spaç dhe Bulqizë punohej në minierë ndërsa në kampet e tjera në bujqësi. Në raport theksohet se ka pasur shkelje të ligjshmërisë në lidhje me

<sup>44</sup> Po aty, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V. 1950, D. 10.

<sup>45</sup> AMPB, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V. 1952, D. 25.

<sup>46</sup> AMPB, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V. 1965, D. 47.

<sup>47</sup> AQSH, F. 492/Prokuroria e Përgjithshme, V. 1969, D. 66.

<sup>48</sup> AMPB, F. Dega e Kampeve dhe Burgjeve, V.1950, D. 10.

të dënuarit si rrahje, fyerje e raste të tjera ndëshkimore të cilat kanë shkaktuar ankesa nga të burgosurit deri në organet më të larta të Partisë dhe shtetit. Gjendje e mjerueshme raportohet edhe në kampin e grave në Kuçovë. Në bazë të një raporti të Prokurorisë së Përgjithshme datë 24.04.1974, Kampi i grave Kuçovë kishte 322 të dënuara, shumica e tyre flenë për tokë ku dhomat janë të mbipopulluara dyfishin e kapacitetit. Në një dhomë me kapacitet 48 të dënuara banojnë 70 gra e vajza, të ngjeshura sa nuk hapet porta. Të dënuara të tjera flenë në lavaneri, në korridor dhe në ambientet e punës.<sup>49</sup> Për krime politike vuanin dënimin në këtë kamp 35 gra, nga të cilat një pjesë ishin me kombësi të huaj, si ruse, çeke, jugosllave, të martuara me shtetas shqiptarë dhe shumica e tyre ishin të dënuara në vitet 1975-1978,<sup>50</sup> periudhë që lidhet me një shkallëzim të luftës së klasave.

Në burgun 313, në Tiranë, ku shërbente si qendër paraburgimi dhe një seksion si pikë grumbullimi për shpërndarjen e të dënuarve nëpër kampe pune, raportohet nga prokuroria e Tiranës një gjendje e mjeruar, sidomos për të miturit në pritje të gjykimit, të cilët mbaheshin në ambiente të përbashkëta me të rriturit.<sup>51</sup>

Gjatë vitit 1991 u mbyllën kampet famëkeqe Spaç, Qafë Bari, Bulqizë, Burgu i Burrelit dhe për një kohë shumë të shkurtër u mbyllën të gjitha kampet e punës duke u trashëguar vetëm dy burgje, i Burrelit dhe burgu i Tiranës në gjendje të mjeruar dhe me histori të dhimbshme.

### ***Konkluzione***

Shqipëria gjatë 45 viteve pas çlirimit nga nazistët, përjetoi një prej diktaturave komuniste më të egra në Europë. Gjatë kësaj periudhe u ekzekutuan për motive politike 5037 burra dhe 450 gra. Janë dënuar me burg, ose dërguar në kampet e punës së detyruar 19.250 persona dhe kaluan në kampet e internimit 48217 burra dhe 10792 gra.

Komunistët erdhën në pushtet nëpërmjet luftës kundër okupatorit dhe kundërshtarëve politikë dhe e mbajtën pushtetin me anë të dhunës si tipari kryesor i luftës së klasave, që shigjetoj jo vetëm klasat e përmbysura dhe opozitare, por edhe klane, individë dhe grupe të shumta brenda gjirit të partisë.

Funksioni kryesor i shtetit totalitar ishte dhuna dhe shtypja, që përcaktonte politikën kriminale dhe luftën juridike penale si formë të luftës klasore. Si model i politikës kriminale, legjislacionit penal dhe zbatimit të vendimeve penale, ishte marrë eksperiencia e vendeve të Bllokut Komunist të Europës Lindore dhe kryesisht eksperiencia sovjetike.

---

<sup>49</sup> AQSH, F. 492/Prokuroria e Përgjithshme, V.1974, D. 96, fl. 13.

<sup>50</sup> Arkivi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, shkresë nr 122, datë 14.5.1985, Reparti 318 Lushnjë.

<sup>51</sup> AQSH, F. 492/Prokuroria e Përgjithshme, V. 1974, D. 96, fl. 3.

Burgjet e regjimit komunist u bënë simboli më i qartë i dhunës, shkeljeve të të drejtave të qytetarëve dhe shtypjes. Nën shembullin e gulagut të Bashkimit Sovjetik u ngritën kampet e punës së detyruar ku u grumbulluan mijëra të burgosur ordinerë dhe politikë, të cilët kanë punuar në kushte çnjerëzore të zhveshur dhe pa ushqyer, nën kërcënimin e armëve. Të burgosurit dhe të paraburgosurit e regjimit komunist, si dhe familjarët e tyre, janë një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë shqiptare, të cilët përballuan peshën kryesore të dhunës, shtypjes dhe shfrytëzimin barbar për ndërtimin e vendit pa asnjë shpërblim.

## BURIME DOKUMENTARE DHE BIBLIOGRAFIA

### Burime dokumentare

#### Dokumente arkivore të pabotuara

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Fondi Dega e Kampeve dhe Burgjeve, dosjet 1-150, viti 1946-1974.

Arkivi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, viti 1981-1991

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Arqipeshkvia Durrës (131), vitet 1945-1966

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli Antifashist Nacional Çlirimtar (489), viti 1945

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli Ministrave (490), vitet 1945-1981

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Ministria e Drejtësisë (515), vitet 1945-1966

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Komiteti Mysliman (482), vitet 1946-1966

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Presidiumi I Kuvendit Popullor(489), vitet 1946-1991

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Ministria e Ekonomisë (494), viti 1946

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Ministria e Punëve Botore (499) viti 1946

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Gjykata e Lartë Ushtarake (516), vitet 1945-1960

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Ministria e Financave (505), vitet 1949-1968

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Prokuroria e Përgjithshme (492), vitet 1945-1991

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Ministria e Ndërtimit (499), viti 1952

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Komiteti Bektashi (483), viti 1954

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Arqipeshkvia Shkodër (132), viti 1955

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Abacia e Mirditës(616), viti 1955

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Gjykata e Lartë(493), vitet 1945-1991

### II. Literatura historiografike

*Historia e popullit shqiptar*, vëll.III, Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, viti 1999

- Historia e popullit shqiptar*, vëll.IV, Botim i Akademisë së Shkencave, viti 1999
- Historia e Shqipërisë*, vëll.IV, Botim i Akademisë së Shkencave, viti 1983
- Bernd Fischer, *Shqipëria 1943-1945,Një vështrim përmes dokumenteve perëndimore*, Tiranë, AIIS 2012
- Pol Xhonsón. *Kohët Moderne*. Bota nga vitet 1920-1990,Vëllim I. Përkthyer nga Vjollca Shtylla. Copyright 1983
- Sufaj, F. *Historia e Burgjeve të Shqipërisë*, Albin, Tiranë, 2000
- Sufaj, F. *Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri gjatë regjimit komunist*, Dita 200), Tiranë 2014
- Krasniqi, A. *Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008*. UFO Press, Tiranë 2009
- Bernd J.Fischer, *Shqipëria gjatë Luftës,1939-1945*. Përkth. K.Hajdëri, Tiranë: Çabej MÇM, 2000
- Dyrmishi, D.- *Lufta politike në udhëheqjen e PKSh (PPSh)1944-1960*, Tiranë 2011
- Pipa, A. *Stalinizmi shqiptar*, Tiranë, Pegi, 2007
- Bare,Th.- *Provokacione dhe komplete kundër Republikës Popullore të Shqipërisë në vitet 1945-1956*, Tiranë, 1966
- Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur. Lufta Nacional Çlirimtare e Shqipërisë*, Përkth. Xhevat Lloshi,Tiranë 1993
- Hannah ARENDT, *Origjina e Totalitarizmit*. Përkthyer prej origjinali nga Myftar Gjana, Prishtinë 2002
- Misja, V. ; Veisiu, Y. ; Bërxolli, A. - *Popullsia e Shqipërisë*, Tiranë 1987
- Nina D. Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Ideart, Tiranë

### III. Botime dhe artikuj në revista dhe gazeta

- Gashi, Rexhep. *Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri*, Prishtinë 2001.
- At Zef Pllumbi,-*Rrno vetëm me tregue*, Tiranë, Shtëpia bot. “55”, 2006
- Repishti, S.-*Nën hijen e Razafës*,narrativë e jetueme. Tiranë, “Onufri” 2004
- Musta, A. *Burgjet e Diktaturës Komuniste në Republikën e Shqipërisë*, Tiranë, 2005
- Musta, A.- *Gjëmat e komunizmit në Shqipëri*, Tiranë 2001
- Imzot Zef Simoni, *Persekutimi i kishës katolike në Shqipëri nga 1944-1990*
- Aliko, T.- *Antologjia e krimit komunist*, Tiranë, 2006
- Dosti, H.- *Një jetë për çështjen Kombëtare*, Tiranë 2008

Koncilija, Ziga. *Karakteristikat kryesore te sistemit juridik si mjet represioni ne vitet 1945-1951 ne Slloveni*. Kumtesë mbajtur në Faenza, Itali në Konferencën ndërkombëtare mbi stalinizmin dhe viktimat e tij, më 27-29 shtator 2010.

Gullotta, Andrea. *Kultura si rezistence: Rasti i kampit të të burgosurve Solovki*. Kumtesë mbajtur në Faenza, Itali ne Konferencën ndërkombëtare mbi stalinizmin dhe viktimat e tij, më 27-29 shtator 2010

Grbic, Srdjan. *Nga denoncimi i Stalinit, në praktikimin e Stalinizmit*. Kumtesë mbajtur në Faenza, Itali në Konferencën ndërkombëtare mbi stalinizmin dhe viktimat e tij, me 27-29 shtator 2010

Premtja, Sadik-*Stalinizmi dhe komunizmi në Shqipëri*. Botuar së pari në revistën “Internacionalja e 4-t”, janar 1949 dhe ribotuar në revistën “Revolutionary History”, 1990

Blendi Fevziu, artikull, *Strategjia e terrorit gjatë “mbretërimit” të Enver Hoxhës*, botuar në Koha Jonë, shtator 2011

Dyrmishi, Demir -*Zgjedhjet e 2 dhjetorit*, artikull i botuar në “Tirana Observer” 2 dhjetor 2005

Gazeta Zyrtare, nr.12, datë 22 maj 1945

Dyrmishi, Demir -*Goditjet e organeve të drejtësisë dhe dënimi i Tuk Jakovës dhe Bedri Spahiut (1949-1952)*, Studime Historike, nr.1-2, viti 2007, botim i Institutit të Historisë.

“Në mbrëmjen e 17 nëntorit”, botuar në gazetën Shekulli, 16 prill 2011

#### IV. Dispozita ligjore

Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, 1946

Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1976

Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, 1952

Kodi i Procedurës Penale i Republikës Popullore të Shqipërisë, 1953

Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1977

Ligj nr. 59 datë 17.5.1945 mbi organizimin e përkohshëm gjyqësor

Ligj nr. 275 datë 13.8.1946 mbi organizimin e përkohshëm gjyqësor

Ligj nr. 1284 datë 9.6.1951 mbi organizimin e përkohshëm gjyqësor

Udhëzim nr. 32, datë 11.1.1952 i Ministrisë së Brendshme për administrimin e burgjeve

Rregullore mbi Sigurimin dhe Riedukimin e të Dënuarve në Repartet e Riedukimit e Burgjet, 1986



## Gjon Boriçi - Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë

### Pohimi nga Byroja Politike e PPSH të dhunës ndaj të burgosurve dhe internuarve nga organet e Sigurimit të Shtetit deri në vitin 1953

#### Abstrakt

Kumtesa përqendrohet në vitin 1953: Diskutimet e Byrosë Politike dhe të MP të Brendshme për “gabimet” e Sigurimit të Shtetit ndaj të burgosurve dhe internuarve, përgjegjësia e ministrit të brendshëm, Mehmet Shehu dhe shpërblimi i tij duke e promovuar në detyrë. Dokumentet zyrtare pohojnë sjelljen terroriste të shtetit kundrejt një pjese të madhe të popullit, të cilin e vrau, burgosi, torturoi, dëboi, internoi pa asnjë ligj.

#### *Hyrje - Rëndësia e studimit të kujtesës në histori*

Historia si shkencë, të paktën në pjesë të ndryshme të saj është një produkt njerëzor, intelektual, shoqëror dhe politik. Historia përpiket të na sjellë të vërtetën. Jo pak historianë me famë kanë njësuar kujtesën dhe historinë në një gjë të vetme.<sup>1</sup> Por, tregimi i historisë dhe akoma më shumë të shkruarit e saj, janë tërësisht të ndryshëm nga kujtesa. Por, kjo nuk do të thotë se nuk ka ngjashmëri ndërmjet historisë dhe kujtesës. As kujtesa dhe as historia nuk na japin një tregim për ngjarjen me paanshmëri të plotë.<sup>2</sup> Të dyja krijojnë versionin e tyre për të kaluarën dhe që të dyja janë produkt i kohës që jetojnë. Interesi për të studiuar kujtesën (memorien) e së kaluarës ndikon në faktin për të kuptuar ashtu si duhet njerëzit që kanë jetuar ngjarjet e ndodhura atëherë si dhe vetëkuptimin që njerëz të veçantë duan t'i japin ngjarjeve që kanë përjetuar. Duke ndodhur kjo, për historinë bëhet e vështirë për të kuptuar botëkuptimin e individëve që kanë përjetuar ngjarjet dhe botën e tyre. Studimi i kujtesës duhet të na çojë më afër mendjes së njerëzve që kanë përjetuar ngjarjet e së kaluarës. Kjo gjë do të na ndihmojë si historianë që të shmangim interpretimet anakronike të periudhës që kemi marrë në studim dhe të na bëjë të mundur të kuptojmë në mënyrën e duhur personazhet që kanë marrë pjesë vetë në ato ngjarje të kaluarën e tyre. Për ta bërë këtë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm kur studiojmë të kaluarën. Siç thoshte vetë ish kryeministri i Britanisë së Madhe, Uinston Çërçill (Winston Churchill) në vitet e pas Luftës së Dytë Botërore:

*"Sa më gjatë të shohësh prapa, aq më larg shikon përpara".<sup>3</sup>*

---

<sup>1</sup> Simon Price and Peter Thoneman, *The birth of classical Europe; a history from Troy to Augustine*, New York: Penguin, 2010, f. 7.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Niall Ferguson, *The Square and the tower; networks and power from the Freemasons to Facebook*, New York: Penguin Press, 2018, f. 419.

***Viti 1953: urdhri i Enver Hoxhës për spastrimin e administratës shtetërore nga "të padëshiruarit dhe armiqtë"***

Dhuna shtetërore e Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH) nuk përqendrohej vetëm tek arrestimi dhe dënimet me gjyqe farsë të elementëve kundërshtarë, por edhe tek pushkatimet pa gjyq.<sup>4</sup> Një nga metodat e këtyre pushkatimeve ishte rrëmbimi i njerëzve nga banesat në mes të natës dhe më pas për fatin e tyre nuk dihej më asgjë, deri sa vinte ndonjë njoftim i organeve të Sigurimit.<sup>5</sup> Këto metoda të Sigurimit për eliminimin e njerëzve pa gjyq, bëheshin sigurisht me urdhër të Koçi Xoxes dhe me aprovimin e Enver Hoxhës. Por, duke qenë se marrëdhëniet me Jugosllavinë në atë kohë ishin në prishje e sipër gjatë vitit 1948, "Komandanti" [Enver Hoxha] duhej të dilte i larë nga këto faje dhe e tërë përgjegjësia të kalonte tek ministri i Brendshëm. Në këtë periudhë janë të panumërta informacionet që vinin në Komitetin Qendror të PKSH lidhur me situatën që mbizotëronte në organet e Sigurimit, mbi metodat e "gabuar" që aplikonte ai të cilat ishin urdhëruar nga Koçi Xoxe.<sup>6</sup>

Koçi Xoxe do të arrestohej në vitin 1948 dhe ekzekutohej në maj 1949.<sup>7</sup> Me ekzekutimin e tij, për organet e Sigurimit të Shtetit fillon një epokë e re nën drejtimin e Mehmet Shehut, i cili do të jetë në krye të këtij organi nga posti i ministrit të Punëve të Brendshme edhe më me vrazhdësi e brutalitet sesa paraardhësi i tij. Nën autoritetin e tij nga organet e hetuesisë do të fillojë të zbatohet "ligjshmëria e goditjes" ku, sipas një materiali të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, i titulluar "Në dritën e ligjshmërisë", do të justifikoheshin (për aq sa mund të vliente) keqtrajtimet në burgje, veprimet arbitrare etj., nga organet kompetente ligjzbatuese në vend.<sup>8</sup> Ky material nuk dihet nga kush është hartuar dhe nuk është i firmosur.<sup>9</sup>

---

<sup>4</sup> Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 14/AP-Str., Viti (më tej: V.) 1948, Dosja (më tej: D.) 167, fl. 2-4. Korrespondencë e Drejtorisë Politike të Ushtrisë dhe Komitetit të Partisë të rrethit Pukë ardhur në Komitetin Qendror të Partisë që bën fjalë për disa pushkatime personash pa gjyq nga organet e Sigurimit e Mbrojtjes së Popullit.

<sup>5</sup> *Po aty*.

<sup>6</sup> *AQSH*, F. 14/AP-Str., V. 1948, D. 169. Relacione, letra e informacione ardhur në Komitetin Qendror të Partisë nga Nesti Kerenxhi e shokë të tjerë mbi situatën e organeve të Sigurimit mbas Plenumit XI si dhe informata mbi metodat e gabuara në punën e Sigurimit të Shtetit të urdhëruar nga Koçi Xoxe. Shih edhe *AQSH*, F. 14/AP-Str., V. 1948, D. 469. Letër e kapitenit Mit-hat Zaçe adresuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare në lidhje me arrestimin dhe ekzekutimin fshehurazi e pa gjyq të Skënder Çelës e Mark Toçit nga Durrësi me urdhër të Koçi Xoxes.

<sup>7</sup> *AQSH*, F. 14/AP-Str., V. 1948, D. 621. Relacione dhe informacione nga Ministria e Punëve të Brendshme, dërguar shokut Enver Hoxha dhe KQ të PPSH, si dhe korrespondencë mbi këto çështje: Mbi arrestimin dhe burgosjen e Koçi Xoxes, Pandi Kristos, Vaskë Kolecit, Vangjo Mitrojorgjit dhe Myftar Tares.

<sup>8</sup> *AQSH*, F. 14/AP-Str., V. 1949, D. 627, fl. 1-5. Material nga prokuroria e përgjithshme me titull "Në dritën e ligjshmërisë" ku flitet: mbi pengesat dhe dëmtimet në plane, veprime të kundraligjshme, keqtrajtime në burg, veprime arbitrare, mbi mungesën e disiplinës nga ana e dikasterëve në përgatitjen dhe dërgimin e planeve, mos zbatimin e qarkoreve dhe urdhrave nga ana e komiteteve ekzekutive; dhe mbi neglizhencat në administrimin e pasurisë së shtetit.

<sup>9</sup> *Po aty*. Pa firmë, fl. 5-10.

Katër vjet pas ekzekutimit të Koçi Xoxes, saktësisht më 24 shkurt 1953, në direktivën Nr. 180 me mbishkrimin “Tepër Sekret”, Enver Hoxha jep udhëzime të posaçme sesi duhej të vijonte spastrimi i aparatit shtetëror dhe ekonomik nga elementët e padëshirueshëm, siç i quante ai, të elementëve armiq dhe sesi duheshin zëvendësuar ata.<sup>10</sup> Sipas kësaj direktive, bazuar tek Plenumi V i Komitetit Qendror, ishte dhënë urdhër i prerë për vijimin e spastrimit të aparatit shtetëror, për ta mbajtur të pastër partinë.<sup>11</sup>

Plenumi V i Partisë së Punës të Shqipërisë i mbajtur në janar të vitit 1953<sup>12</sup>, kishte dhënë alarmin lidhur me “infektimin” e administratës shtetërore nga elementët e padëshirueshëm. Enver Hoxha jepte urdhër të prerë që deri më datë 1 qershor 1953, të pushoheshin menjëherë nga puna në administratë të gjithë ata persona që nuk kishin garanci politike dhe që ishin, sipas tij, armiq të popullit.<sup>13</sup> Po ashtu, duheshin pushuar menjëherë nga puna të gjithë ata persona që kishin të afërm në burg, të internuar apo të pushkatuar prej pushtetit.<sup>14</sup> Enver Hoxha nuk ndalet me kaq, por urdhëron në cilësinë e kryeministrit dhe sekretarit të Parë të Partisë që brenda vitit 1953 të bëhej edhe pushimi gradual nga puna i njerëzve të tjerë që, sipas tij, nuk ishin njerëz besnikë të partisë.<sup>15</sup>

### ***Pikëpyetjet e udhëheqjes komuniste shqiptare për Sigurimin e Shtetit pas rënies së Berias në Bashkimin Sovjetik***

Bashkimi Sovjetik ishte vendi që kishte zëvendësuar çdo partner të rëndësishëm tregtar të Shqipërisë pas prishjes me Jugosllavinë. Enver Hoxha dhe klika e tij besonin dhe ndiqnin me fanatizëm çdo lloj vije politike që ndërmerre Stalini sado absurde që të dukej. Gjatë të gjithë ekzistencës së saj në pushtet, klasa politike drejtuese e Shqipërisë gjithnjë ka pasur një ambasadë të një shteti protektor në të cilën do të “vajtonte” çdo herë që do të kishte probleme. Duke filluar nga ambasada austro-hungareze, italiane, jugosllave dhe së fundi sovjetike, klasat e paafta politike shqiptare të 40 viteve pas Shpalljes së Pavarësisë, gjithnjë do të përpiqeshin t’i

<sup>10</sup> AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1953, D. 29, fl. 3. Mbi spastrimin e aparateve shtetërore dhe ekonomike nga elementët e padëshirueshëm e armiq dhe forcimin e kontrollit të Partisë mbi organet shtetërore për vendosjen e kuadrit.

<sup>11</sup> Po aty. Sipas Enver Hoxhës infiltrimi i elementit armik në radhët e administratës kishte ndodhur pasi nuk ishte ashpërsuar sa duhet lufta e klasave dhe se komunistët nuk kishin qenë të ashpër sa duhet për të zbuluar dhe goditur armikun e klasës.

<sup>12</sup> Po aty, fl. 17/1. Kryeministria. Tepër Sekret-Personale. Komitetit Qendror të PPSH. Mbi spastrimin e aparateve shtetërore dhe ekonomike nga elementët e padëshirueshëm dhe armiq.

<sup>13</sup> Po aty, fl. 17/2.

<sup>14</sup> Po aty, fl. 17/3. “Të pushohen menjëherë nga puna ata të cilëve u janë pushkatuar ose dënuar rëndë me burgim njerëzit e tyre të afërt, nga pushteti ynë. Ata që kanë qenë tregtarë të mëdhenj, pronarë tokash dhe fabrikash, të cilëve u janë konfiskuar pasuritë e tyre dhe qëndrimi i të cilëve pas çlirimit të vendit nuk ka qenë i mirë. Nga kjo kategori mund të mbeten si nëpunësa në funksione të parëndësishme vetëm persona të rrallë në rast se kanë dhënë prova besnikërie ndaj pushtetit”.

<sup>15</sup> Po aty, fl. 17/4.

mbijetonin luftës së brendshme për pushtet me ndihmën e tyre. Që nga viti 1949 e deri në vitin 1953 që kemi marrë në shqyrtim, nuk kishte fjalim e mbledhje të çdo rangu partie që të mos lavdërohej deri në *ad nauseam* miqësia e çeliktë dhe e pathyeshme mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. Stalini ishte “zoti” në tokë për Enver Hoxhën. Lideri komunist shqiptar nuk hezitonte ta quante “Ati ynë i adhurueshëm, Stalini ynë”.<sup>16</sup>

Mëngjesin e 5 marsit 1953, Radio Moska dha lajmin e trishtueshëm për komunistët e të gjithë botës se Josif Stalini kishte vdekur.<sup>17</sup> Shumë pikëpyetje u ngritën në Perëndim se kush do të ishte pasardhësi që do të zëvendësonte udhëheqësin suprem të vdekur. Kasta e mbetur e politikanëve sovjetikë jepte shumë pak shpresa për ulje tensionesh. Georgi Malenkov, kryetari i Sekretariatit të PK të BS dukej se do të ishte më i favorizuari të zëvendësonte Stalinin. Por, dy ishin figurat qendrore që luftonin fort për pushtetin absolut në Bashkimin Sovjetik; ministri i Jashtëm Vjaçesllav Molotov (Vyacheslav Molotov) dhe shefi famëkeq i KGB-së, Lavrenti Beria (Lavrenti Beria).

Pas trazirave të qershorit 1953 në Gjermaninë Lindore, Beria u akuzua për disfatizëm në një mbledhje të Byrosë Politike të datës 26 qershor 1953 dhe, pas kësaj, u arrestua dhe u ekzekutua brenda ditës.<sup>18</sup> Gazeta “Pravda” raportoi vdekjen e tij gjashtë muaj më vonë më 24 dhjetor 1953.<sup>19</sup> Molotovi dukej se kishte triumfuar, por në fakt fitimtari i vërtetë ishte Nikita Hrushovi. Dështimi politik i Bashkimit Sovjetik në Republikën Demokratike Gjermane (RDGJ) ishte i plotë. Frazën më të bukur për këtë dështim e ka shkruar shkrimtari majtist Bertold Breht që asokohe jetonte në Gjermaninë Lindore:

*"Populli ka humbur besimin tek qeveria. Përse qeveria nuk e heq qafe popullin dhe të zgjedhë një popull të ri?"*<sup>20</sup>

Dy muaj pas ekzekutimit të Berias, më 22 gusht 1953, në një letër me mbishkrimin “Tepër Sekret”, Enver Hoxha i drejtohet të gjithë sekretarëve të partisë në rrethe si dhe Drejtorisë Politike të Ministrisë së Punëve të Brendshme.<sup>21</sup> E. Hoxha në fakt përcillte një letër të Mehmet Shehut drejtuar drejtorive të Ministrisë së Punëve të Brendshme “mbi gabimet në

---

<sup>16</sup> *Instituti i Historisë*, Buletin për shkencat shoqërore, Tiranë 1953, f. IV.

<sup>17</sup> W.R. Smyser, *From Yalta to Berlin; the Cold War struggle over Germany*, London: Macmillan Press 1999, f. 119.

<sup>18</sup> *Po aty*, f. 125.

<sup>19</sup> *Po aty*.

<sup>20</sup> Philip Windsor, *Germany and the management of peace*, New York: Praeger, 1971, f. 80.

<sup>21</sup> *AQSH*, F. 14/AP-Str., V. 1953, D. 29, fl. 72. Mbi disa shfaqje të shkeljes së ligjeve nga organet e punëve të brendshme.

detyrë të organeve të Sigurimit”, duke kërkuar që të punohej me kujdes dhe të mbahej qëndrim për të.<sup>22</sup>

Me sa duket, letra e Mehmet Shehut të cilën do ta analizojmë më poshtë, e trembi Enver Hoxhën. Kjo duket kur në letrën e tij, lideri komunist shqiptar shkruan se “*në përpunimin e kësaj letre duhet të kini parasysh rrezikun e krijimit të një farë frike në punonjësit e Ministrisë së Brendshme dhe në hedhjen e tyre në pasivitet përpara armikut duke u druajtur se mos gabojnë*”.<sup>23</sup> Me sa duket, Enver Hoxha ishte frikësuar nga masat që kishte marrë Mehmet Shehu kundrejt disa oficerëve të Sigurimit për “shkelje ligjesh”.<sup>24</sup> Prandaj në fund të letrës së tij ai porositi që “*të forcohet kontrolli i partisë mbi organet e punëve të brendshme, me qëllim që organet e punëve të brendshme të jenë kurdoherë syri dhe veshi i partisë*”.<sup>25</sup>

Po çfarë përmbante letra e Mehmet Shehut që e kishte shqetësuar kaq shumë Enver Hoxhën? Që në fillim të letrës, Mehmet Shehu pasi nxjerr edhe një herë në pah “tradhtinë” e Koçi Xoxes, nuk heziton të shprehë besnikërinë e thellë për Enver Hoxhën.<sup>26</sup> Por, sipas ministrit të Brendshëm, organet e punëve të brendshme kishin bërë gabime të rënda duke shkelur sipas tij ligjet e shtetit.<sup>27</sup> Rruga e drejtë e eksperiencës sovjetike duhet të ishte triumfuese sipas Shehut.<sup>28</sup> Në letrën e tij, Mehmet Shehu konstatonte gabime të rënda sidomos gjatë hetuesisë ku në mjaft raste ishte përdorur tortura ndaj të burgosurve.<sup>29</sup> Nga torturat më të përdorura, sipas Shehut, ishte goditja e të burgosurit, zhvillimi i hetuesisë duke e mbajtur lidhur të burgosurin, shtrëngimi i duarve të të burgosurve jashtë mase me hekura, prerja e përkohshme e bukës ose e gjellës, ndalimi i përkohshëm i rrobave për shtresë e mbulesë, mbajtja në këmbë për një kohë të gjatë në hetuesi.<sup>30</sup> Gjithashtu, edhe gjatë arrestimeve nuk ishin respektuar të drejtat legjitime si dhe ishin mbajtur jashtë rregullave në burg njerëz si pasojë e neglizhencës së organeve të punëve të brendshme.<sup>31</sup> Gjithashtu, kishte pasur raste të sjelljes arrogante deri të goditjes me pëllëmbë nga ana e punonjësve të Sigurimit të qytetarëve të lirë të shtetit.<sup>32</sup> Ministri i Brendshëm, kërkonte në mënyrë eksplicite nga hetuesia që të shmangej çdo lloj torture në

---

<sup>22</sup> *Po aty*, fl. 74. Çfarë është? Telegram/raport/letër Ministria e Punëve të Brendshme për Komitetin Qendror, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Degëve të P. të Brendshme të rretheve, gjithë degëve operative të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit dhe Drejtorisë së Policisë Popullore.

<sup>23</sup> *Po aty*, fl. 72.

<sup>24</sup> *Po aty*, fl. 73.

<sup>25</sup> *Po aty*.

<sup>26</sup> *Po aty*, fl. 74.

<sup>27</sup> *Po aty*, fl. 75.

<sup>28</sup> *Po aty*.

<sup>29</sup> *Po aty*.

<sup>30</sup> *Po aty*.

<sup>31</sup> *Po aty*, fl. 76.

<sup>32</sup> *Po aty*.

marrjen në pyetje të të pandehurve.<sup>33</sup> Më tutje, Shehu shkruan se “*kushdo që do të përdorte torturën që këtej e tutje, në çfarëdo lloj forme qoftë, kundrejt atij do të merren masa penale duke ia referuar gjyqit*”<sup>34</sup>.

Një tjetër fakt interesant në letrën e Mehmet Shehut është edhe pjesa kur sqaron internimet. Sipas tij, Sigurimi nuk kishte të drejtë të internonte, vetëm Komisioni i Internim-Dëbimeve që ndodhej nën autoritetin e Ministrisë së Brendshme e kishte këtë të drejtë.<sup>35</sup> Për të internuar një person duhej që kryetari i Degës t’i bënte një propozim me shkrim Komisionit internim-dëbimeve pranë Ministrisë, të argumentuar gjerë e gjatë.<sup>36</sup> Vendimi i Komisionit për të internuar apo liruar nga internimi individët ishte i prerë.<sup>37</sup> Askush nga punonjësit e Sigurimit të Shtetit nuk duhej që të sfidonte vendimin e tij. Nëse dikush nuk ishte dakord me vendimet e Komisionit, shprehej Shehu, atëherë duhej njoftuar menjëherë ministri i Brendshëm.<sup>38</sup>

Një tjetër faj që ishte evidentuar nga kontrolli mbi punën e organeve të Sigurimit ishte edhe përvetësimi i pasurive të konfiskuara nga shteti pa formalitete zyrtare dhe ligjore.<sup>39</sup> Enver Hoxha thoshte se “*punonjësit e Sigurimit duhet të jenë të pastër si qelibari, të pastër nga të gjitha pikëpamjet*.”<sup>40</sup> Por, me këtë letër tepër të rëndë që po paraqiste zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Brendshme, anëtar i Byrosë Politike, punonjësit e Sigurimit vetëm “qelibar” nuk mund të ishin. Një tjetër fakt që sjell në vëmendje Mehmet Shehu, ishin shfaqjet imorale që kishin përdorur punonjësit e Sigurimit. Sipas Shehut, imoraliteti ishte i palejueshëm, dhe shfaqjet e imoralitetit të punonjësve operativë në drejtim të grave bashkëpunëtore, grave të paraburgosura ose të burgosura, ishte një faj shumë i rëndë dhe i pafalshëm.<sup>41</sup> Gjithashtu, ministri i Brendshëm, kërkonte ashpërsi dhe jo oportunitizëm nga punonjësit e Sigurimit ndaj kulakëve paçka se këta të fundit mund të ishin kthyer në bashkëpunëtorë.<sup>42</sup>

### ***Përplasja Hoxha-Shehu, shtator 1953***

---

<sup>33</sup> *Po aty*, fl. 79.

<sup>34</sup> *Po aty*, fl. 80.

<sup>35</sup> *Po aty*, fl. 82.

<sup>36</sup> *Po aty*.

<sup>37</sup> *Po aty*, fl. 83.

<sup>38</sup> *Po aty*.

<sup>39</sup> *Po aty*, fl. 84. Sipas drejtuesve të lartë komunistë, “pasuria e shtetit është e paprekshme dhe duhet të mbrohet e jo të shpërdorohet nga organet tona. Vjedhja, shpërdorimi, abuzimi, dëmtimi i pasurisë së shtetit, duhet të konsiderohet si një faj jashtëzakonisht i rëndë kur ky kryhet nga punonjës të Ministrisë së Brendshme, mbasi punonjësit e Ministrisë së Brendshme kanë si funksion kryesor ruajtjen e pasurisë së shtetit”.

<sup>40</sup> *Po aty*, fl. 84-85.

<sup>41</sup> *Po aty*, fl. 86.

<sup>42</sup> *Po aty*, fl. 86-87.

Letra me të dhëna tronditëse e Mehmet Shehut, për të cilat sigurisht Enver Hoxha kishte dijeni sesi trajtoheshin të burgosurit dhe të internuarit duhet ta ketë vënë në mendime liderin shqiptar. Dy javë e gjysmë më vonë, më 7 shtator 1953, Enver Hoxha i drejtohet me një letër tjetër të gjithë sekretarëve të partisë në rrethe dhe në qarqe ku flet hapur për letrën e Mehmet Shehut mbi paligjshmërinë e veprimeve të organeve të punëve të brendshme.<sup>43</sup> Sipas Enver Hoxhës, ishte kaluar dëndur nga arbitrariteti në oportunizëm.<sup>44</sup>

Duke qenë se ishte i lidhur kokë e këmbë me Bashkimin Sovjetik dhe për të treguar se i qëndronte besnik çdo lloj “fryme të re” që vinte nga Moska, Enver Hoxha vendosi të godasë Mehmet Shehun. Çështja e tij duhej peshuar mirë. Vetëm letra e tij drejtuar rretheve nuk mjaftonte. Duhej një lëvizje shumë më e fortë. Paralelisht me letrën e Shehut, Enver Hoxhës i duhej që të gjithë sekretarët e parë të rretheve brenda muajit gusht 1953, të dërgonin raporte të hollësishme mbi punën e organeve të Sigurimit në rrethet përkatëse<sup>45</sup>. Nga të gjitha qarqet e Shqipërisë vërshuan me dhjetëra letra informuese mbi punën e organeve të punëve të brendshme duke sjellë fakte të rënda të ushtrimit të dhunës nga ana e tyre.<sup>46</sup> Duket sikur sekretarët e parë të komiteteve të PPSH në rrethe mezi kishin pritur që të informonin me detaje mbi punën e organeve të Sigurimit në zonat e tyre.<sup>47</sup> Në informacionet që dërgonin sekretarët e parë, nuk përmendnin vetëm ato gjëra të dhunshme që kishin ushtruar organet e punëve të brendshme gjatë vitit 1953, por jepnin detaje edhe për ngjarje të ndodhura që nga viti 1951.<sup>48</sup>

Raportet e sekretarëve të parë të rretheve ishin një armë e fortë në dorën e Enver Hoxhës kundër Mehmet Shehut, por edhe këto duket se ishin të pamjaftueshme për të goditur plotësisht ministrin e Brendshëm. Mehmet Shehu duhej likuiduar me metodën e parë: letër e drejtpërdrejtë e shkruar hapur kundër tij dhe aktivitetit të dikasterit që drejtonte nga një anëtar i rëndësishëm partie, por jo anëtar i Byrosë Politike apo i Komitetit Qendror. Kjo për të treguar se baza ishte vigjilente. Personi që shprehu hapur qëndrime kundër veprimtarisë së Mehmet Shehut ishte sekretari i parë i Fierit, Sokrat Bufi. Në letrën e tij, ai shprehet se Mehmet Shehu përbënte rrezik për partinë.<sup>49</sup> Me një “armë” të tillë në dorë Enver Hoxha mendoi se mund ta godiste Mehmet Shehun me aprovimin e të gjithë Byrosë Politike.

---

<sup>43</sup> *Po aty*, fl. 94.

<sup>44</sup> *Po aty*.

<sup>45</sup> *AQSH*, F. 14/AP-Str., V. 1953, D. 511, fl. 18. Raporte e relacione të KP të rretheve e qarqeve mbi disa gabime të organeve të P. të Brendshme në veprimtarinë e tyre. Letra e Enver Hoxhës datë 22/8/1953, nr. 002190.

<sup>46</sup> *Po aty*, fl. 18.

<sup>47</sup> *Po aty*, fl. 19.

<sup>48</sup> *Po aty*.

<sup>49</sup> *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 38, f. 84. Pjesë nga letra e Sokrat Bufit ndaj Mehmet Shehut: “Unë nga disa gabime të shokut Mehmet kam arritur në mendjen time që shoku Mehmet do të përbëjë rrezik për Partinë. Në Plenumin e IX të Komitetit Qendror unë në kundërshtim me Komitetin Qendror kam menduar se shoku Mehmet ka influencuar në heqjen e shokut Tuk si sekretar të dytë me qëllime karrieriste për të zënë vendin e tij, unë

Fill pas informacioneve që i duheshin nga rrethet dhe nga reagimi i Sokrat Bufit kundër Shehut, Enver Hoxha thirri një mbledhje të jashtëzakonshme të Byrosë Politike, e cila zgjati dy ditë, më 28 dhe 29 shtator 1953.<sup>50</sup> Por, ajo që kishte trembur deri në ezaurim nervor Mehmet Shehun ishte një shprehje që Liri Belishova, përpara se të nisej për në Moskë, në mënyrë të shkujdesur i kishte thënë Fiqirete Sanxhaktarit (Shehut): “*Ta keni kujdes, ta ruani Mehmetin*”.<sup>51</sup> Sipas Enver Hoxhës, Liri Belishova e kishte thënë pa takt dhe në pije e sipër shprehjen e mësipërme, por, pavarësisht kësaj, ajo kishte nxjerrë sekretin se do të merreshin në shqyrtim punët e brendshme.<sup>52</sup>

Kur në korrik 1953, gazeta “Pravda” botoi artikullin mbi “tradhtinë” e Berias, atëherë strukturat drejtuese të PPSH u vunë në lëvizje. Duhej gjetur patjetër një “kokë turku” për të treguar se PPSH ndiqte verbërisht vijën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Lëvizja që shpëtoi Mehmet Shehun nga eliminimi i sigurt ishte shkuarja e tij “për të qarë hallin” tek ambasadori sovjetik në Shqipëri, K. D. Leviçkin. Vizitën e Mehmet Shehut tek ambasadori sovjetik e pohon hapur vetë Enver Hoxha kur deklaroi në mbledhje se që me datë 10 shtator 1953, Leviçkini e kishte njoftuar për vizitën e Shehut.<sup>53</sup> Enver Hoxha u mundua ta justifikonte vizitën e zëvendësit të tij tek Leviçkini sikur po kërkonte ndihmë meqë i dukej sikur ishte lëkundur besimi i partisë dhe i sekretarit të parë në drejtim të tij.<sup>54</sup> Por, Enver Hoxha nuk heziton në mbledhje ta pyesë direkt Mehmet Shehun se përse nuk bisedoi një herë me të përpara se të shkonte tek Leviçkini.<sup>55</sup>

---

mendova ahëre se gabimet e shokut Tuk nuk ishin aq të mëdhaja sa të merrte atë masë nga Partia, pra efektivisht kam rënë në pozita mos besimi në udhëheqjen kolegiale të Komitetit Qendror. Unë mendova se shoku Tuk është punëtor dhe prandaj shoku Mehmet s’e shikon mirë udhëheqjen e klasës punëtore në vendin tonë”.

<sup>50</sup> *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 32, f. 1. Protokollin e mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH më datën 28-29 shtator 1953, ku analizohen disa gabime të rënda të shokut Mehmet Shehu, anëtar i Byrosë Politike të KQ të PPSH.

<sup>51</sup> *Po aty*, fl. 14. Fjala e Enver Hoxhës pas diskutimit të Mehmet Shehut.

<sup>52</sup> *Po aty*. Vijon fjala e Enver Hoxhës: “Një ditë porsa përsëritem me Lirinë që po nisej për në Moskë, më erdhi Fiqreti për të më vënë në korent mbi një shprehje që kish lëshuar shoqja Liri. “Gjykojeni ju shoku Enver këtë shprehje, më tha Fiqreti, se më duket se nuk është në rrugën e drejtë të partisë”. E pyes ç’ishte. Ajo më thotë se “kish shkuar të piqej me Lirinë që do të nisej për në BRSS. Unë vajta ta përcillja, tha Fiqreti, e gjeta tek shoku Kiço Ngjela, në shtëpinë e të cilit kish shkuar për drekë dhe atje mbasi kish pirë pak, ishte bërë në qejf dhe në muhabet e sipër më thotë mua se “nuk bën më nëna si Mehmetin”. Unë i them si gjithë shokët e tjerë të Byrosë. Mirë, mirë vazhdon ajo dhe prapë pas pak më përsërit të njëjtën shprehje. Përsëri unë i them si gjithë shokët e tjerë të Byrosë, pastaj Lirija vazhdon t’i thotë se Mehmeti është një shok shumë i mirë, dora e djathtë e shokut Enver etj. Më në fund tha “ta keni kujdes, ta ruani Mehmetin”. Po pse e kishte pyetur Fiqreti. Ja, i thotë Lirija “janë edhe këto punët e Ministrisë së Brendshme që do të zhvillohen”. Kjo mua më bëri përshtypje, tha Fiqreti. Në atë drekë ish edhe nëna e Nakos dhe Lirija ishte e emocionuar dhe i kish thënë Fiqretit “nuk muarëm masa me kohë për ruajtjen e Nakos”.

<sup>53</sup> *Po aty*, fl. 15-16.

<sup>54</sup> *Po aty*, fl.16.

<sup>55</sup> *Po aty*.



Mehmet Shehu, sipas Enver Hoxhës, kërkonte me domosdo përjashtimin dhe arrestimin e Sokrat Bufit, njeriut që kishte guxuar të shkruante letër kundër tij, por Hoxha refuzonte pa u parë mirë “puna e tij”.<sup>56</sup> Duke parë se situata ishte rënduar, Mehmet Shehu i kishte thënë Enver Hoxhës: “Nga një anë po ndihmon shoku Enver, po nga ana tjetër po më vret me dorën tënde, praktikisht je duke më vrarë”.<sup>57</sup> Por, meqenëse ambasadori sovjetik kishte “kërkuar” dy javë kohë që të merrte instruksione në qendër për çështjen Shehu dhe kur u takua me Hoxhën, i tha se “Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik ka besim të plotë tek Mehmet Shehu”<sup>58</sup> atëherë Sekretari i Parë i PPSH bëri prapa kthehu dhe shprehet në mbledhje:

*“Sot pasdreke [28 shtator] e pashë prapë Mehmetin të vijë tek unë. Këtë radhë ishte më i lehtë, më i qartë dhe më i hapët. Kishte shkuar tek shoku Leviçkin, i cili e kish ndihmuar dhe kishte kuptuar esencën e gabimeve. Ky është një sukses i madh jo se këtë çështje ne nuk do ta zgjidhnim, se për këtë do të luftonim me Mehmetin që ta bindnim, po e vërteta është se ky ishte një gabim shumë i rëndë që bëhet, sidomos në këto momente, kur partia, Komiteti Qendror dhe Byroja Politike ka gjithë këto detyra të mëdha për të kryer, në një kohë kur këta bëjnë gjithë këtë luftë për forcimin e ekonomisë dhe të mirëqenies së popullit, lufta edhe kundra reaksionit të brendshëm dhe të jashtëm”.*<sup>59</sup>

Pas qetësimit të situatës dikush duhet të paguante për gjithë këtë “shqetësim” që i kishte sjellë Byrosë Politike. Duke qenë se Mehmet Shehu doli pa lagur madje u konfirmua në detyrë si zëvendës i Enver Hoxhës kur ky i fundit do të ishte me pushime<sup>60</sup>, Sokrat Bufi mbeti vetëm në mes të zjarrit. Çështja e tij u rëndua akoma më tepër kur, sipas Enver Hoxhës, ai ishte munduar ta lidhte çështjen Shehu me atë të Berias në BS.<sup>61</sup> Enver Hoxha fjalën e udhëheqjes së Bashkimit Sovjetik e kishte ligj dhe e dinte se nëse i dilte kundër fjalëve të Moskës vendi do

---

<sup>56</sup> *Po aty*, fl. 18-21. Enver Hoxha Mehmet Shehut: “Ti gabohesh në trajtimin e kuadrit dhe unë nuk jam dakord me ty, të dënojmë Sokrat Bufin, vetëm me deponimet e tij të para. Unë mendoj se ti shoku Mehmet nuk e kupton mirë konceptin e drejtësisë së partisë në lidhje me kuadrin. Drejtësia marksiste nuk na lejon të bëjmë gjëra të tilla. Ti konsideron dënimin si çështjen kryesore në trajtimin e kuadrit, kurse unë nuk mendoj kështu. Përpara një njeriu që gabon ose edhe bën krime kundër partisë ose popullit, duhet më parë të analizojmë mirë çështjen, të bëjmë të gjitha përpjekjet për të nxjerrë të vërtetën në mënyrë që t’ia nxjerrim të gjitha në shesh, ta bëjmë lakuriq dhe pastaj ta demaskojmë dhe më në fund ta dënojmë. Kur të shohi partia dhe populli se është ky njeri që ka bërë këto faje, ahëre mund t’i jepet edhe dënimi, ahëre dënoje se populli dhe partia e aprovon. Si mundet të dënojmë në një kuadër partie me një të kaluar të mirë vetëm me një letër se thua ti? Unë me këtë pikëpamje nuk mund të jem dakord, i thashë Mehmetit dhe nuk do të lejoj që të futet partia në këto rrugë të gabuara. Prandaj mendoj se për drejtësinë e partisë ti nuk ke koncept të drejtë. Unë përse i përket kuadrit, përpiqem të kem shumë durim, se kuadri është gjëja më e shtrenjtë për partinë dhe bëj përpjekje gjer në fund, gjer në buzën e varrit, ashtu si na ka mësuar Stalini, që ta shpëtojmë. Kjo nuk është oportunistik, po detyrë ndaj kuadrit. Kur të tëra përpjekjet janë bërë dhe ai nuk vjen në rrugën e partisë ahëre unë i fut shqelmin”.

<sup>57</sup> *Po aty*, f. 8, f. 24.

<sup>58</sup> *Po aty*, fl. 25.

<sup>59</sup> *Po aty*.

<sup>60</sup> *Po aty*.

<sup>61</sup> *Po aty*, fl. 70.

të rrënohej më tepër. Në çdo rast ai nuk humbte kohë të deklaronte se “*pa Bashkimin Sovjetik dhe pa Partinë Bolshevike ne nuk mund të rrojmë asnjë minutë*”<sup>62</sup> dhe se Mehmet Shehu kishte bërë shumë mirë që kishte shkuar në ambasadën sovjetike për t’u “këshilluar”.

Sokrat Bufi kishte mbetur vetëm. Ai thërritet në Komitetin Qendror prej Manush Myftiut, dhe pas tre orësh “mbledhje” në datën 23 tetor 1953, del hapur me një autokritikë të shkruar ku “mallkon” veten për gabimin e madh që kishte bërë “duke dyshuar tek shoku Mehmet”.<sup>63</sup> Por vetëm autokritika nuk mjaftonte. Sokrat Bufit me urdhër të Enver Hoxhës i tërhiqet vërejtje e rëndë dhe dënohet që të mos kishte poste drejtuese në parti për një periudhë dyvjeçare dhe të dërgohej në një punë të rëndomtë.<sup>64</sup>

### ***Raporti i Mehmet Shehut mbi dhunën e ushtruar ndaj të burgosurve dhe internuarve***

Mbledhja e radhës për të shqyrtuar gabimet e organeve të Sigurimit të Shtetit ndaj të burgosurve dhe të internuarve u vendos që të bëhej më datë 2 tetor 1953 në Shtëpinë e Partisë në orën 20.<sup>65</sup> Se çfarë është diskutuar në atë mbledhje dokumentet nuk e sqarojnë. Tri javë më vonë, më datë 22 tetor 1953, zëvendëskryeministri Mehmet Shehu paraqet përpara Byrosë Politike një raport të detajuar mbi të metat e organeve të punëve të brendshme.<sup>66</sup> Raporti që paraqet Mehmet Shehu është tronditës. Fillimisht, për gabimet e organeve të Sigurimit, ai ia hedh fajin mbeturinave të trockistëve jugosllavë të tradhtarit Koçi Xoxe.<sup>67</sup> Gjithashtu, sipas tij, rrethimi kapitalist nën të cilin ndodhej Shqipëria e bënte shumë të komplikuar punën e organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.<sup>68</sup>

Në raportin e tij, Shehu shprehet se të metat kryesore të Sigurimit konsistojnë së pari në drejtim të ruajtjes së ligjshmërisë revolucionare, në sjelljen ndaj popullsisë, punën e dobët agenturore dhe kontrollin e dobët të organeve të partisë mbi punët e brendshme.<sup>69</sup> Gabimet në arrestime të njerëzve nga ana e organeve të Sigurimit për vitet 1952 dhe 1953 ishin në masën 8.4% pasi arrestimet ishin krejtësisht të pabaza në shkelje të hapur të të drejtave të qytetarëve.<sup>70</sup> Në bazë të platformës së Byrosë Politike arrestimet bëheshin vetëm me aprovim të ministrit apo

---

<sup>62</sup> *Po aty*, fl. 72.

<sup>63</sup> *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1953, D. 38, fl. 86. Letra në formën e autokritikës e Sokrat Bufit drejtuar Komitetit Qendror.

<sup>64</sup> *Po aty*, fl. 97, 158.

<sup>65</sup> *AQSH*, F.14/AP-OU, V. 1953, D. 38, fl. 1. Mbi punën e organeve të punëve të brendshme.

<sup>66</sup> *Po aty*, fl. 1.

<sup>67</sup> *Po aty*, fl. 2.

<sup>68</sup> *Po aty*, fl. 3.

<sup>69</sup> *Po aty*, fl. 4.

<sup>70</sup> *Po aty*, fl. 6.

të zëvendësministrave. Shehu deklaronte se organet e punëve të brendshme kishin abuzuar me të drejtën e tyre për të arrestuar duke spekuluar më së shumti me “arrestimet në flagrancë”.<sup>71</sup> Madje, organet e Sigurimit kishin arrestuar edhe të mitur pa pasur prova të mjaftueshme nëse kishin bërë faj apo jo.<sup>72</sup> Neni 108 i Kodit të Procedurës Penale përcaktonte qartë se “*ndalimi i një personi nuk mund të zgjaste më tepër se tre ditë pa pëlqimin e prokurorit. Kur prokurori ka dhënë pëlqimin e tij, ndalimi kthehej në arrestim dhe në këtë rast brenda 14 ditëve nga dita e ndalimit, personi i arrestuar duhej të merrej si i pandehur*”.<sup>73</sup> Kjo procedurë ishte shkelur në dhjetëra raste të cilat janë të deklaruara në raportin e Mehmet Shehut.

Pjesa më tronditëse e raportit të Mehmet Shehut është pohimi i torturave të ndryshme të ushtruara ndaj të burgosurve dhe të internuarve nga punonjësit e Sigurimit. Zëvendëskryeministri flet për emra konkretë, punonjës të Sigurimit të Shtetit që kanë përdorur presion fizik ndaj të arrestuarve për të pohuar fajin.<sup>74</sup> Ndër torturat më të përdorura sipas Shehut ishin goditja me pëllëmbë e shqelma, shtrëngimi tej mase i duarve deri në paralizë të gjymtyrëve, ofendimi me fjalë fyese, hetuesia ditë e natë, mbajtja në këmbë gjatë hetuesisë, mbajtja pa bukë, pagjumësia etj.<sup>75</sup> Mehmet Shehu mundohet t’i justifikojë torturat që kishin ndodhur sepse shumë prej punonjësve të Sigurimit nuk e njihnin Kodin e Procedurës Penale dhe me mungesën e plotë të kontrollit nga ana e prokurorisë.<sup>76</sup> Por, një nga veprat më të rënda antinjerëzore që kishin bërë punonjësit e Sigurimit ishin edhe përdhunimet. Nga viti 1950 deri më 1953 ishin më shumë se 70 raste të konfirmuara përdhunimi ndaj grave të burgosura dhe të internuara në kampe.<sup>77</sup>

Një nga abuzimet më të mëdha që bënin kryetarët e degëve të brendshme ishin padyshim urdhrat për internime masive sidomos gjatë vitit 1952 dhe tetëmuorit të vitit 1953 ku ishin deportuar 631 persona.<sup>78</sup> Kjo ishte një shkelje flagrante pasi Komisioni i Internim-dëbimeve kishte aprovuar internimin e vetëm 290 personave ndërsa për 341 të tjerët nuk ishte pranuar internimi.<sup>79</sup> Për këtë “gabim”, Mehmet Shehu ia ngarkon përgjegjësinë e rënies në pozita të gabuara, Kryetarit të Komisionit të Dëbimeve që asokohe drejtohej nga zëvendësministri i brendshëm, kolonel Delo Balili.<sup>80</sup>

---

<sup>71</sup> *Po aty*, fl. 7.

<sup>72</sup> *Po aty*.

<sup>73</sup> *Po aty*, fl. 8.

<sup>74</sup> *Po aty*, fl. 10.

<sup>75</sup> *Po aty*, fl. 10-11.

<sup>76</sup> *Po aty*, fl. 12.

<sup>77</sup> *Po aty*, fl. 13 & fl. 15.

<sup>78</sup> *Po aty*, fl. 17.

<sup>79</sup> *Po aty*.

<sup>80</sup> *Po aty*.

Një tjetër e metë që vë në dukje Mehmet Shehu, ishte edhe mungesa e kontrollit nga ana e komiteteve të partisë në rrethe mbi organet e Sigurimit.<sup>81</sup> Kjo sipas Shehut kishte përforcuar spekulimet dhe shkeljen e frymës së ligjshmërisë revolucionare.<sup>82</sup> Nga raporti i Mehmet Shehut për të metat e Sigurimit figurojnë prej tij 406 raste gabimesh dhe fajesh për periudhën e tre viteve të fundit.<sup>83</sup> Këto gabime dhe faje klasifikoheshin si më poshtë:

Shtrenguarje të duarve për presion në hetuesi.....	57 raste
Qëlluarje me pëllëmbë dhe me shqelm të të paraburgosurve dhe të burgosurve....	119 raste
Lënie pa bukë ose tesha të të paraburgosurve.....	6 raste
Mbajtje në këmbë në hetuesi.....	17 raste
Arbitraritete, keqsjellje, prozvalje kundrejt popullit.....	168 raste
Shkelje e afatit ligjor për arrestime.....	9 raste
Mos zbatim me kohë i vendimeve të gjykatave e prokurorive.....	6 raste
Mbajtja e jashtëligjshme në arrest (ndalim).....	3 raste
Sjellje imoraliteti.....	71 raste
Shpërdorim i pasurisë shtetërore.....	62 raste
Të tjera.....	15 raste
Gjithsej.....	406 raste. <sup>84</sup>

Për të gjitha këto raste, përgjegjësinë kryesore e merrte vetë Mehmet Shehu, por nuk lë pa përmendur si përgjegjës të kësaj situatë edhe zëvendësministrat e Punëve të Brendshme Kadri Hazbiu, Mihallaq Ziçishti, nënkolonel Llambi Premti ish drejtori Politik i Ministrisë së Brendshme. Sipas Shehut, jo vetëm që kishin gabuar, por kishin krijuar edhe idenë e supremacisë së organeve të punëve të brendshme ndaj të gjitha organeve të tjera të pushtetit aq sa punonjësit e Sigurimit ishin nga njerëzit më të privilegjuar dhe kjo vërtetohet nga raporti se punonjësit e Sigurimit e kishin për fyerje të largoheshin nga strukturat e punëve të brendshme edhe nëse emëroheshin në detyra të tjera më të larta.<sup>85</sup>

<sup>81</sup> *Po aty*, fl. 34.

<sup>82</sup> *Po aty*. Oficerët anëtarë partie nuk kritikohen nga poshtë në organizatat bazë të partisë ku ata bënin pjesë, “se mos shkelet prestigji i gradës dhe funksionit”, “se mos dekonspirohet puna operative”, “se mos zemërohet superiori dhe hakmerret”. Kjo i bënte drejtuesit e lartë komunistë të arrinin në përfundimin se “atje nuk ka autokritikë komuniste të shëndoshë. Organizatat bazë të partisë në organet e punëve të brendshme nuk e kanë luajtur rolin e tyre si duhet, për të edukuar anëtarët e partisë me frymën e ruajtjes së ligjshmërisë revolucionare dhe të sjelljes së mirë me popullin”.

<sup>83</sup> *Po aty*, f. 39.

<sup>84</sup> *Po aty*, fl. 39-40.

<sup>85</sup> *Po aty*, fl. 41-42.

### ***Byroja Politike pranon dhunën e ushtruar ndaj të burgosurve dhe të internuarve***

Raporti i paraqitur prej Mehmet Shehut nuk kishte sesi të mos vinte përsëri në lëvizje Byronë Politike. Ç'masa duheshin marrë? Kishte kaluar pak më shumë se një muaj nga përplasja Hoxha-Shehu e 28-29 shtatorit 1953 ku vetëm shkarazi ishin përmendur gabimet e organeve të punëve të brendshme, dhe tani, raporti pothuajse i plotë i Mehmet Shehut vuri në lëvizje strukturat më të larta të Byrosë Politike. Enver Hoxha vendosi të thërrasë një mbledhje tjetër të Byrosë Politike më 2 nëntor 1953.<sup>86</sup> Në mbledhje do të merrnin pjesë edhe emrat më të lakuar në raportin e Mehmet Shehut për gabimet e organeve të punëve të brendshme, të tre zëvendësministrat e Punëve të Brendshme; Kadri Hazbiu, Mihallaq Ziçishti dhe Delo Balili.

Nga të tre zëvendësministrat e pranishëm në mbledhje pas Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut, fjalën e mori i pari Kadri Hazbiu. Hapur dhe pa doreza ai pranoi gabimet e kryera nga ana e tij dhe metodat e gabuara të përdorura për të rekrutuar kundërshtarët politikë të regjimit me anë të kërcënimeve për të qenë pjesë e Sigurimit të Shtetit.<sup>87</sup> Kadri Hazbiu pranoi se shumë herë ka vepruar me kokë të tij dhe pa u këshilluar as me këshilltarin sovjetik pranë Ministrisë së Brendshme<sup>88</sup> dhe as e kishte ndihmuar sa duhet ministrin e Brendshëm kur nuk ishte në dijeni të ngjarjeve. Në fund të fjalës së tij, Kadri Hazbiu mundohet të justifikojë ministrin e Brendshëm dhe jo punën e tij, duke i lidhur gabimet e ndodhura me mungesën e ministrit në dikaster për arsye të përgjegjësive të shumta që kishte.<sup>89</sup>

Pas Kadri Hazbiut, fjalën për të bërë autokritikë e merr Mihallaq Ziçishti. Ziçishti ishte një nga kryesorët që kishte udhëzuar, sipas raportit të Mehmet Shehut, sesi duhej përdorur tortura në burgje. Por, gjatë fjalës së tij ai nuk e përmend asnjëherë këtë fakt, por mjaftohet duke thënë se ka gabuar dhe se nuk i ka shkuar çështjeve deri në fund.<sup>90</sup> Nëse deri atë moment Enver Hoxha nuk e kishte ndërprerë Kadri Hazbiun kur diskutoi, Mihallaq Ziçishtit i ndërpret fjalën dhe e pyet drejtpërdrejt:

*“Po pse ke vepruar kështu?”*<sup>91</sup>

I gjendur përballë diktatorit dhe me karrierën në fije të perit, Ziçishti mundohet t'ia kalojë përgjegjësinë zëvendësministrit tjetër, Delo Balilit duke thënë se gabimet janë kryer nga

---

<sup>86</sup> Po aty, fl. 99.

<sup>87</sup> Po aty, fl. 103. Diskutimi i Kadri Hazbiut: “Një pjesë e këtyre gabimeve janë bërë nën drejtimin tim”.

<sup>88</sup> Po aty, fl. 104.

<sup>89</sup> Po aty, fl. 105.

<sup>90</sup> Po aty, fl. 106. Diskutimi i Mihallaq Ziçishtit: “E kam parë çështjen më shumë si zëvendësministër që nuk i takon sektorit tim. Kështu nuk u kam shkuar çështjeve deri në fund”.

<sup>91</sup> Po aty.

sektori që drejtonte ai.<sup>92</sup> Pas kësaj fjale, Enver Hoxha hedh vështrimin nga Delo Balili që ky i fundit të merrte fjalën dhe të diskutonte. Duke qenë se kolegu i tij sapo i kishte ngarkuar një pjesë të mirë të përgjegjësisë, Balili [i cili dy vjet më vonë do të rifitojë besimin e partisë dhe do të emërohet ambasador në Kinë] duke iu dridhur këmbët ngrihet e merr fjalën dhe pranon pa justifikime gabimet e sektorit të policisë që e drejtonte vetë në lidhje me keq sjelljet me popullin dhe të burgosurit.<sup>93</sup> Në raportin që kishte paraqitur përpara Byrosë Politike, Mehmet Shehu kishte vënë më shumë se çdo gabim tjetër në dukje urdhrat që kishte dhënë Delo Balili për të përdorur “drurin” siç e quante ai ndaj të burgosurve.<sup>94</sup> Balili mundohet të justifikojë veten dhe punën e organeve të policisë për “gabimet” që ishin kryer se “ata [policët] kanë të bëjnë me gjithfarë lloj elementësh ... me fundërrinat e shoqërisë dhe këto rrethanat nuk mund të mos influencojnë në policët e ulët politikisht”.<sup>95</sup> Duke marrë shembullin e Ziçishtit, Balili justifikohet për këto veprime se “këto çështje i dimë ne, se kjo është çështje Sigurimi, se na ka thënë gjeneral Kadriu ose Mihallaqi”.<sup>96</sup>

Në këtë pikë, si për t’ia shtuar akoma më shumë sikletin, Enver Hoxha i ndërpret fjalën dhe e pyet: “Po si i kupton ti këto çështje?”<sup>97</sup> Pyetjes së udhëheqësit, Balili mundohet t’i përgjigjet me justifikimin e mungesës së eksperiencës dhe në mosnjohjen mirë të ligjeve revolucionare të vendit dhe se ishte ende në fuqi ligji i vitit 1946 mbi policinë i hartuar nga Koçi Xoxe, por që ishte shpërfillur.<sup>98</sup> Ligji që kishte hartuar Koçi Xoxe nuk duhej përdorur edhe pse e ndalonte torturën vetëm për faktin se ishte bërë nga ish ministri dhe meqenëse ai ishte shpallur armik, atëherë edhe ligji nuk duhet të ekzistonte. Kështu që duke hedhur poshtë ligjin e vitit 1946 meqë ishte i Koçi Xoxes, nuk kishte pengesa për të vrarë dhe abuzuar me tortura të burgosur dhe të internuar.<sup>99</sup>

Në këtë pikë, diskutimi i Balilit kthehet në një pyetje përgjigje mes tij dhe Enver Hoxhës. Kur Hoxha e pyet se “përse ke urdhëruar të përdoret druri për mbledhjen e floririt”<sup>100</sup>,

---

<sup>92</sup> *Po aty*.

<sup>93</sup> *Po aty*, fl. 107. Diskutimi i Delo Balilit: “Të metat që dalin në raport, më shumë se kudo, reflektohen në punën e organeve të policisë”.

<sup>94</sup> *Po aty*, fl. 45-46. Pjesë nga raporti i Mehmet Shehut: “Torturat janë përdorur në radhë të parë nga vetë kryetarët e degëve të punëve të brendshme në rrethe dhe nga vetë shokë kryesorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme si Delo Balili, Misto Billaci, Vesel Ahmeti etj. Nga raportet e komiteteve të partisë del se shpesh herë kanë qenë këta shokë që kanë orientuar rrethet për të përdorur tortura. Ka pasur raste që këto tortura kanë shkaktuar edhe vdekje të njerëzve të ndryshëm. Përsa i përket floririt del se nga shoku Delo Balili u është planifikuar rretheve se sa flori duhet të zbulojnë dhe ai ka dhënë kudo orientimin se për fshehje flori mund dhe duhej përdorur druri”.

<sup>95</sup> *Po aty*, fl. 108.

<sup>96</sup> *Po aty*.

<sup>97</sup> *Po aty*.

<sup>98</sup> *Po aty*.

<sup>99</sup> *Po aty*.

<sup>100</sup> *Po aty*, fl. 111.

zëvendësministri nuk e mohon se ka shkelur ligjin duke lejuar dhe përdorur torturën edhe pse ligji e ndalonte.<sup>101</sup> Pas Delo Balilit, fjalën e mori kryetari i Degës Politike të Ministrisë së Brendshme, Gani Goxhi, i cili i justifikon rrahjet në burgje pasi udhëheqja e ministrisë nuk dinte gjë<sup>102</sup>, kur në fakt raporti i Mehmet Shehut i nxirrte zbuluar drejtuesit e ministrisë.

Duke qenë se gabimet e organeve të punëve të brendshme dolën në pah, Mehmet Shehu merr fjalën dhe thotë se tani pas letrës së tij dhe vendimit që do të merrte Byroja Politike, ekzistonte rreziku që njerëzit e Sigurimit të frikësoheshin dhe do të humbte akoma më shumë vigjilenca revolucionare nga ana e tyre në luftën kundër armikut.<sup>103</sup> Në mbështetje të kësaj teze dhe të ministrit ngrihet e flet përsëri Kadri Hazbiu se nuk ishin vlerësuar edhe në të kaluarën gabime të tilla.<sup>104</sup> Por, Enver Hoxha e ndërpret vrullshëm duke i thënë: *“Mos ke ndonjë gjë tjetër ti si p.sh. megallomani, një kuptim jo të drejtë të pikëpamjeve të partisë d.m.th. se njerëzit e Sigurimit bëjnë më pak gabime, se ne jemi më të favorizuar, me superiorë se të tjerët?”*<sup>105</sup>

Duke e parë se foli pa matur, Hazbiu u përpoq ta ndreqte duke shtuar se ishte detyrë që të analizoheshin e kuptoheshin edhe gabimet e së kaluarës.<sup>106</sup> Josif Pashko ngrihet dhe hedh poshtë pretendimin se Mehmet Shehu dhe Delo Balili nuk kishin dijeni më parë për shkeljen e ligjshmërisë duke deklaruar se nga prokuroria ishte njoftuar herë pas here Ministria e Brendshme për shkeljet e ligjit.<sup>107</sup> Kësaj here, Mehmet Shehu përpiqet të ngarkojë me përgjegjësi Delo Balilin pasi nuk e kishte njoftuar sa duhet për shkeljet e ligjshmërisë në burgje dhe kampe.<sup>108</sup> Megjithatë, sipas Shehut, për më shumë se 500 kuadro ishin marrë masa disiplinore si çmobilizim apo duke i çuar në gjyq.<sup>109</sup>

Krimet që ishin bërë nga Sigurimi i Shtetit nuk ishin diçka që Byroja Politike të mund t’i anashkalonte lehtë. Në konkluzionet e mbledhjes të referuara nga Enver Hoxha, kryeministri kërkon që të metat në organet e punëve të brendshme të mos referoheshin thjesht si rreshtim faktesh.<sup>110</sup> Platforma për Sigurimin e miratuar në vitin 1949 nga Byroja Politike duhej të zbatohet pa mëdyshje.<sup>111</sup> Punonjësit e Sigurimit sipas Enver Hoxhës nuk duhet të ishin njerëz politikë (mbështeti platformën e Mehmet Shehut që të ketë sa më pak anëtarë partie në radhët

---

<sup>101</sup> *Po aty.*

<sup>102</sup> *Po aty.*

<sup>103</sup> *Po aty*, fl. 117.

<sup>104</sup> *Po aty*, fl. 118.

<sup>105</sup> *Po aty.*

<sup>106</sup> *Po aty*, fl. 118.

<sup>107</sup> *Po aty*, fl. 121.

<sup>108</sup> *Po aty.*

<sup>109</sup> *Po aty*, fl. 122.

<sup>110</sup> *Po aty*, fl. 140. Konkluzionet e mbledhjes së Byrosë Politike nga Enver Hoxha.

<sup>111</sup> *Po aty*, fl. 29.

e Sigurimit).<sup>112</sup> Enver Hoxha vë gjithashtu theksin tek një kontroll më i rreptë i organeve të partisë mbi strukturat e Sigurimit të shtetit pasi sipas tij, kjo gjë deri në këtë kohë kishte munguar.<sup>113</sup>

Enver Hoxha u shpreh se vendimi që do të merrte Byroja Politike, të mbetej i mbyllur vetëm për përdorim të brendshëm në organizatat bazë të partisë në Sigurim dhe ushtri. Të metat dhe gabimet sipas Enver Hoxhës të viheshin në dukje vetëm shkurtimisht<sup>114</sup> dhe jo aq gjerë sa ç’i kishte përshkruar Mehmet Shehu. Pas disa diskutimeve të shkurtra, Enver Hoxha vendosi që vendimi i Byrosë Politike të mos i çohet organizatave bazë të partisë në rrethe, por vetëm Drejtorive Politike të Sigurimit dhe asaj të ushtrisë.<sup>115</sup> Mehmet Shehu e mbështet këtë vendim të Enver Hoxhës duke shtuar se njohja me vendimin e Byrosë Politike të bëhej gradualisht edhe në këto struktura.<sup>116</sup>

Vendimi i Byrosë Politike numër 443, i datës 2 nëntor 1953, i firmosur prej Enver Hoxhës<sup>117</sup> është një dokument me shumë rëndësi edhe pse nuk u bë asnjëherë publik në popull. Aty shkruhet e zezë mbi të bardhë se organet e Sigurimit kanë shkelur ligjet revolucionare, nuk kanë bërë detyrën dhe *“kanë bërë faj dhe krim ndaj popullit”*.<sup>118</sup> Sjellja e shumë funksionarëve të organeve të punëve të brendshme, thuhet në vendim, gjatë procesit të hetuesisë ka qenë në kundërshtim me sjelljen njerëzore për t’i bërë të pandehurit presion fizik që të depononte.<sup>119</sup> Ishin konstatuar mjaft raste të sjelljes imorale [përdhunime] ndaj grave të burgosura dhe të internuara.<sup>120</sup> Në vendim theksohet tendenca për të internuar sa më shumë njerëz qoftë edhe pa fakte të provuara për fajin e tyre.<sup>121</sup> Ofendimet me fjalë fyese ndaj individëve të lirë ishin një tjetër faj që evidentohet në vendimin e Byrosë Politike.<sup>122</sup> Sipas vendimit, sjellja të tilla dobësonin forcimin e lidhjeve të këtyre organeve me masat e popullit.<sup>123</sup>

Në fund të vendimit me anë të një shënimi të posaçëm dhe me urdhër të Enver Hoxhës, theksohet se ai duhej të punohej në byrotë e Komiteteve të Partisë në qarqe e rrethe, në organizatën e partisë të organeve të KQ dhe në të gjitha organizatat e partisë të organeve dhe

---

<sup>112</sup> Po aty, fl. 28.

<sup>113</sup> Po aty, fl. 147.

<sup>114</sup> Po aty, fl. 153.

<sup>115</sup> Po aty, fl. 154.

<sup>116</sup> Po aty.

<sup>117</sup> Po aty, fl. 50, fl. 60. Tiranë, më 2.XI.1953. Me autorizim të Byrosë Politike të K.Q.P.P.SH. Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Enver Hoxha, (firma, vula).

<sup>118</sup> Po aty, fl. 51.

<sup>119</sup> Po aty.

<sup>120</sup> Po aty.

<sup>121</sup> Po aty, fl. 52.

<sup>122</sup> Po aty, fl. 53.

<sup>123</sup> Po aty.



reparteve të Ministrisë së Brendshme.<sup>124</sup> Por, organizatat bazë të partisë do të njiheshin me vendimin e Byrosë Politike të tjetërsuar dhe pa vënë në dukje qartësisht “të metat” e Sigurimit vetëm më 29 janar 1954, të firmosur nga sekretari i Komitetit Qendror, Rita Marko dhe jo nga Enver Hoxha.<sup>125</sup>

### *Përfundime*

Personalisht, nuk mendoj se Enver Hoxha dhe Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH-së do të merrnin një vendim ku do të pohonin dhe pranonin dhunën e ushtruar ndaj të burgosurve dhe të internuarve po të mos kishte ndodhur rënia dhe ekzekutimi i Berias në Bashkimin Sovjetik. Fryma e re politike që kishte iniciuar Nikita Hrushovi pas ardhjes së tij në krye të BS, patjetër do të ndikonte edhe në udhëheqjen shqiptare. Në të gjithë Evropën Lindore, me ndryshimin e liderit në BS, filloi të kishte një qasje të re ndaj komunizmit dhe marrëdhënieve me aleancën perëndimore.

Në mbledhjen e Byrosë Politike të datës 28-29 shtator 1953, Mehmet Shehu do të ndodhej në një pozitë tepër të rëndë, ku mund të pritej shkarkimi, arrestimi dhe rrjedhimisht ekzekutimi, njëllëj siç ishte vepruar më 23 qershor 1953 me Berian në mbledhjen e Byrosë Politike të Partisë Komuniste të BS. Por, Shehu nuk pati fatin e Berias pasi u tregua i shpejtë për “të vajtuar” hallin e tij tek ambasadori sovjetik në Tiranë. Edhe pse u bë një autokritikë e hapur lidhur me dhunën e ushtruar nga punonjësit e Sigurimit në burgje e kampe, përsëri dhuna ndaj të persekutuarve vetëm sa u strukturua paksa, por nuk u ndal. Regjimi komunist shqiptar asnjëherë nuk u ndal së ushtruar dhunë në kuptimin e plotë të fjalës ndaj popullit shqiptar në përgjithësi, dhe kësaj klase të vuajtur në veçanti. Pranimi i krimeve të Sigurimit ndaj të burgosurve dhe të internuarve dhe popullit shqiptar në tërësi, nuk solli ristrukturimin e regjimit të Enver Hoxhës. Përkundrazi, Enver Hoxha në vendimin 443 të datës 2 nëntor 1953, kërkonte që Sigurimi të vijonte të ishte syri dhe veshi i partisë në luftën kundër armiqve. Kritikën që, sipas tij, po i bënte Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH-së, Sigurimit të Shtetit, nuk duhet të sillnin në asnjë çast dobësimin e vigjilencës ndaj luftës së klasave dhe armiqve të pushtetit popullor. Pushteti duhej të ruhej me çdo kusht, edhe me çmimin e mijëra viktimave të tjera, të pushkatuar, të burgosur, të internuar apo të izoluar, qofshin. Asgjë nuk kishte rëndësi përballë pushtetit absolut të Enver Hoxhës.

---

<sup>124</sup> *Po aty*, fl. 60.

<sup>125</sup> *Po aty*, fl. 159-161. Relacion mbi punimin e vendimit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH. “Mbi të metat n’organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme” nga relacionet e dërguara nga Byrotë e Partisë të qarqeve.

**Robërit gjermanë të luftës dhe puna e detyruar gjatë viteve 1944-1952**

**Abstrakt**

Punimi sjell të dhëna nga historia e robërve gjermanë të Luftës II Botërore prej mëse 17 vitesh (shtator 1939- 1956), kur u riadhesuan edhe ushtarët e fundit gjermanë nga kampet sovjetike, trajtimi i tyre në Europë, ku në vitet 1941-1956, robërit gjermanë kryen rreth dy miliardë ditë pune të detyruar. Vetëm në Europën Lindore, Qendrore dhe Juglindore, robërit gjermanë kryen rreth 1,4 miliardë ditë pune, më së shumti në Bashkimin Sovjetik. Edhe në Shqipëri u kapën robër gjermanë, të cilët u përqendruan në kape robërish, më saktë kampe pune të detyruar. Studiuesit vërejnë se ende nuk është bërë ndonjë studim shterues për robërit gjermanë të luftës dhe fatet e tyre; nuk ka një shifër të saktë të numrit të tyre, mungojnë të dhënat për trajtimin e tyre, punët që ata kryen në Shqipëri gjatë viteve të burgimit si edhe për procedurat e riadhesimit të tyre.

Historia e robërve gjermanë të Luftës së Dytë Botërore shtrihet në një hapësirë kohore prej më se 17 vitesh, qysh prej fillimit të luftës në shtator 1939, e deri në fillim të vitit 1956, kur u riadhesuan edhe ushtarët e fundit gjermanë nga kampet sovjetike. Rreth 11 milionë ushtarë gjermanë kishin rënë rob gjatë luftës në duart e Aleatëve, pjesa më e madhe e tyre në muajt e fundit të luftës. Ushtria gjermane “mbolli” robër luftime në 20 shtete të ndryshme, rreth 3.8 milionë në SHBA, 3.7 milionë në Britaninë e Madhe dhe rreth 3.2 milionë në Bashkimin Sovjetik.<sup>126</sup> Në të gjithë vendet, robërit gjermanë u përdorën në fronte të vështira punë, për të rindërtuar vendet e shkatërruara nga lufta.

Në vitet 1941-1956, robërit gjermanë kryen në gjithë këto vende rreth dy miliardë ditë pune të detyruar. Vetëm në Evropën Lindore, Qendrore dhe Juglindore, robërit gjermanë kryen rreth 1,4 miliardë ditë punë, më së shumti në Bashkimin Sovjetik.<sup>127</sup>

Statusi ligjor i të burgosurve të luftës u përcaktua në Konventën e Hagës të vitit 1907 "Mbi ligjet dhe zakonet e luftës" dhe në Konventat e Gjenevës të vitit 1929 "Për lehtësimin e fateve të të plagosurve dhe të sëmurëve në luftën ndërmjet ushtrive" si dhe "Për trajtimin e të burgosurve të luftës". Gjithsesi, përvoja tregoi që, si gjatë luftës ashtu edhe pas luftës, shtetet pjesëmarrëse në konfliktin botëror nuk i respektuan me rigorozitet këto ligje.

Edhe në Shqipëri, ashtu si në çdo vend tjetër ku shkeli këmba e ushtarit gjerman dhe u luftua ndaj pushtuesit, u kapën robër gjermanë, të cilët u përqendruan në kampe robërish, më saktë kampe pune të detyruar. Nëse në vendet e tjera është shkruar shumë për këtë fenomen, në Shqipëri ende nuk është bërë ndonjë studim shterues për robërit gjermanë të luftës dhe fatet e

---

<sup>126</sup> Jochen Oltmer, "Zuwanderung und Inegration in Deutschland seit dem Zweiten Weltkrieg", in: Frank Gesemann; Roland Roth (Hrsg.): *Lokale Integrationspolitik in der Einänderungsgesellschaft. Migration und Integration als Herausforderung von Kommunen*, Wiesbaden: 2009, f. 153.

<sup>127</sup> J. Oltmer, "Zuwanderung und Inegration in Deutschland seit dem Zweiten Weltkrieg ...", f. 153.

tyre. Madje, ende nuk ka një shifër të saktë të numrit të tyre. Po ashtu, mungojnë të dhënat për trajtimin e tyre, punët që ata kryen në Shqipëri gjatë viteve të burgimit si edhe për procedurat e riatdhësimit të tyre. Duke bërë një krahasim të burimeve gjermane dhe materialeve arkivore shqiptare, në këtë artikull do të mundohem të hedh sadopak dritë mbi këtë pjesë të pandriçuar të historisë sonë.

\*\*\*

Numri i robërve gjermanë të luftës në Shqipëri nuk është i saktë dhe paraqitet i ndryshëm, si në burimet shqiptare, ashtu edhe në ato gjermane. Në një informacion të hartuar në vitin 2000 nga Arkivi Qendror i Shtetit, arrihet në përfundimin e përgjithshëm se, pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri kanë qenë rreth 1523 robër gjermanë. Gjithsesi në këtë informacion theksohet nevoja e një verifikimi më të plotë, për të shmangur ndonjë përsëritje apo kryqëzim të dhënash. Po ashtu, në informacion janë përfshirë edhe robërit e zënë gjatë luftës.

Një të dhënë të përafërt me sa më sipër për numrin e robërve gjermanë jep edhe ish-robi gjerman Alfred Wagner, në një letër që ai i dërgon ish-ministrit bavarez Franz Josef Strauß, pasi ky i fundit vizitoi Shqipërinë në vitin 1984. Ai u kthye në shtëpi më 30 qershor 1950, pas gati gjashtë vitesh të vështira robërie në Shqipëri. Wagner shkruan se, në Shqipëri kishin qenë pothuajse 1000 robër gjermanë.<sup>128</sup> Më tej ai shkruan se qysh në vitet e para të robërisë, si pasojë e kushteve të këqija të jetesës dhe të punës së rëndë kish vdekur rreth 300 robër gjermanë.<sup>129</sup> Ndërsa një grup i vogël robërisht gjermanë, që ishin specialistë, trajtoheshin në mënyrë të diferencuar. Alfred Wagner ishte një nënoficer i Wehrmacht-it gjerman, i cili në vitet 1943-1944 u komandua në Shqipëri, si kryellogaritar dhe nënoficer furnizimi në batalionin e 999 të Wehrmacht-it. Në këtë batalion shërbenin ish-të dënuar politikë, kundërshtarë të regjimit nacionalsocialistë, ish-të burgosur etj., të cilët fillimisht ishin konsideruar si të padenjë për të shërbyer nën armë, por me rritjen e nevojës së Gjermanisë për ushtarë, u rekrutua edhe kjo kategori në reparte të veçanta.

Më 11 nëntor 1944 ai dhe katër shokë të tij u zunë rob nga partizanët gjatë tërheqjes në rrugën Librazhd-Elbasan. Mesa duket, kolona ku bënte pjesë edhe reparti i Wagner-it ishte pjesë e grupimit të Artilerisë që komandohej nga koloneli Styerer, e cila përbëhej nga forca gjermane të dislokuara në Greqi, të cilat në Strugë morën urdhër të marshonin në drejtim të Tiranës, për

---

<sup>128</sup> Arkivi i Volksbund Deutsche Kriegsgräberfürsorge e.V. Kassel, Dosja për Shqipërinë: Letër e Alfred Wagner drejtuar kryeministrit bavarez Franz Josef Strauß më 12 tetor 1984.

<sup>129</sup>Po aty.

të ndihmuar gjatë tërheqjes forcat gjermane që ndodheshin në Tiranë. Sipas tij, brenda një kohe shumë të shkurtër, sipas marrëveshjeve bilaterale ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, ushtarët italianë u lejuan të largohen për në vendlindjen e tyre, robërit gjermanë u përdorën për të kryer punë të ndryshme. Sa e rëndësishme ishte puna që bënin robërit gjermanë për vendin e shkatërruar të sapo dalë nga lufta e tregon fakti që, pas fillimit të negociatave për lirimin e robërve gjermanë që ndodheshin në Shqipëri, të organizuara në qershor 1950 nga Ambasada e Republikës Demokratike Gjermane në Rumani, instancat shqiptare u munduan të pengonin riatdhesimin e gati gjysmës së robërve gjermane duke ngritur akuza të paargumentuara, me qëllim shfrytëzimin e mëtejshëm të tyre.

Më 9 gusht 1951, ish-ushtaraku gjerman Friedrich Husselbach, i cili në Janar të po këtij viti sapo ishte kthyer nga Shqipëria, bëri në Qendrën për Kërkimin e të Humburve në Luftë, në Kassel, ku thekson se numri i robërve gjermanë të luftës në Shqipëri ishte rreth 650 burra<sup>130</sup>. Një pjesë e konsiderueshme e tyre kishin qenë efektiv i batalionit të të dënuarve 999 të Korfuzit<sup>131</sup>. Sipas tij, deri në vitin 1946, trajtimi i tyre si robër lufte ishte relativisht e mirë. Robërit lëviznin të pakufizuar dhe po ashtu kishin ushqim të mjaftueshëm. Por, situata ndryshoi menjëherë, pas mbërritjes së misionit të parë ushtarak sovjetik në Shqipëri, në vitin 1946. Duke thënë se robërit gjermanë do të riatdhesohen së shpejti, gjithë robërit gjermanët u grumbulluan në Tiranë. Sipas Husselbach-ut, prej këtyre ditëve filluan vuajtjet e robërve gjermanë. Ata u tërhoqën në punë të detyruar në kuadër të rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta. Uria dhe sëmundjet u bënë pjesë e pandarë e jetës së robërve gjermanë. Si pasojë, në vitet 1949-1951, vetëm 227 robër gjermanë arritën të riatdhesohen. Vetë Husselbach-u u kthye në shtëpi me transportin e fundit të organizuar në vitin 1951, me një anije sovjetike që u nis nga Durrësi, nëpërmjet Dardaneleve dhe mbërriti në Konstancë, Rumani. Prej Konstancës udhëtoi me tren në linjën Bukuresht-Budapest-Pragë-Dresden.

Ish-robi gjerman Friedrich Husselbach i cili ishte ndër robërit e fundit gjermanë të riatdhesuar arriti në Gjermani në janar 1951. Ai njoftonte qendrën e të humburve gjermanë të luftës në Kassel se, në Shqipëri kishin qenë rreth 650 robër gjermanë. Nga këta arritën vetëm 227 robër të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Kësisoj, sipas Husselbach-ut, rreth 423 robër gjermanë kishin humbur jetën në Shqipëri si pasojë e sëmundjeve, urisë dhe punës e jetesës së vështirë.<sup>132</sup>

---

<sup>130</sup> Arkivi i Volksbund Deutsche Kriegsgräberfürsorge e.V., Dosja për Shqipërinë: Aktenvermerk I, Kassel, den 10.8.51.

<sup>131</sup>

<sup>132</sup> Arkivi i Volksbund Deutsche Kriegsgräberfürsorge e.V., Dosja për Shqipërinë: Aktenvermerk I, Kassel, den 10.8.51.

Më 15 shtator 1948, Paul Kahlenberg, rob gjerman në Tiranë, shkruan një thirrje për ndihmë në Gjermaninë Lindore. Ai njoftonte se, në Tiranë ishin 217 robër gjermanë, dhe njëmbëdhjetë prej tyre antifashistë që kishin shërbyer në batalionin e të dënuarve 999 të Wehrmachtit gjerman. “Mos duhet që ne antifashistët të derdhim edhe për shumë vite gjak për klikën, ndërkohë që gjithë ish-nazistët janë kthyer në shtëpi”, shkruante Husselbach-u në thirrjen e tij.<sup>133</sup>

Një dëshmi të plotë për robërit gjermanë jep më 25. 06. 1949 edhe Walter Enge nga Auerwalde i Gjermanisë Lindore, pasi ishte kthyer nga kampet shqiptare: “*Si ish i dënuar politik unë u rekrutova në batalionin e të dënuarve 999. Në qershor 1944 ne u nisëm nga Baumholder [Gjermani – shën. im] për në Greqi – Follorinë, e prej andej në Shqipëri- Sarandë.*

*Më 16.11.44, gjatë tërheqjes të trupave [gjermane] nga Greqia/Shqipëria, së bashku me shokë të tjerë u dorëzuam në Tiranë vullnetarisht si robër lufte. Po ashtu, shumë shokë të tjerë ishin të detyruar të dorëzoheshin. Në fund të vitit 1944 (nëntor) për Shqipërinë mbaroi lufta. Gjithë pushtuesit e huaj (italianë, gjermanë) ose kishin kaluar kufijtë e vendit ose ishin në robëri. I gjithë vendi ishte një fushë e mjeruar, qytet, fshatrat, fushat, gjëja e gjallë, rrugët – kudo vetëm shkatërrim dhe gjurmë vuajtjesh të krimeve të Hitler-it dhe Mussolini-t. Dëmet e luftës ishin shumë të mëdha, por rindërtimi filloi shumë shpejt. Agresorët dhe ndihmësit e fashizmit u identifikuan shpejt. Mbreti dhe pronarët e mëdhenj u shpronësuan dhe humbën kësisoj pushtetin dhe të drejtat e tyre. Partizanët dhe gjithë njerëzit e tjerë ishin kokat drejtuese të shtetit të ri. Ishim të kënaqur që, edhe ne, si robër lufte morëm pjesë në pastrimin e kampeve të ish-agresorëve dhe të sabotatorëve aktualë të rendit të ri. Kësisoj ne shumë herë ndihmuam për transportin me kamionë të mallrave të konfiskuara si, makina, makineri, ushqime, vaj etj. Këto u vunë në dispozicion të ndërmarrjeve të reja për të rigjallëruar ekonominë e re. Partizanët (ushtarët), rinia, fëmijët që përbënin edhe pjesën më të madhe të popullsisë dhe që ishin analfabetë, tashmë filluan shkollën. Zhvillimi dhe përparimi shikohej kudo. Ne, si robër lufte kemi një meritë të madhe për rindërtimin [e Shqipërisë] dhe, kjo është e pamohueshme. Kjo gjë na u tha edhe kur na liruan. Ne ishim rreth 150 robër gjermanë dhe 800 robër italianë në kampin e Tiranës, te Autorepartit. Ne llogarisnim që, në gjithë Shqipërinë gjendeshin 6000-8000 italianë dhe rreth 800 robër gjermanë. Prej tyre në Tiranë 250/1000. Italianët u liruan qysh në vitin 1945.*

*Dhe tani për çështjen tonë. Jetuam një javë në një barakë. Ushqimi ishte çështje dytësore. Ende vendi [Shqipëria] ishte në luftë, prandaj kjo gjë ishte e kuptueshme. Pastaj u*

---

<sup>133</sup>Ba DY 34/16521, Band 3, S. 495.

dërguam në burgun qendror të Tiranës. Qelitë ishin aq të tejmbushura, sa që flinim ulur në çimento. Aty qëndruam 39 ditë, plot morra dhe gjysmë të uritur. 39 ditë pa një lugë gjellë të ngrohtë, pa ujë për t'u pastruar, 39 ditë pa parë dritë me sy, 39 ditë ku tre burra ndanin një bukë më pak se 0.5 kg. Për aq kohë sa unë qëndrova në kampin e robërve, vdiqën më shumë se 20% e shokëve.

Çka përmendëm më sipër, privimet nga lufta, ushqimi, malarja etj. ishin shkaqet e vdekjeve.

Më në fund pamë pak dritë në këtë errësi, na përfshinë në rindërtim dhe dëmet e luftës filluan të riparohen. Ne u dërguam në një kamp jashtë qytetit të Tiranës. Trupa të tjera filluan punën për ndërtimin e rrugëve, pastrimin e minave, punonin në bujqësi dhe u dërguan edhe gjetkë, si në Elbasan dhe Durrës. Tanimë u përmirësua disi situata për ne. Ndërtuam kapanonë gjumi dhe e përshtatëm kampin për të banuar, me ujë për t'u larë etj. Ushqimi u përmirësua në mënyrë të ndjeshme. Merrnim një herë në ditë ushqim të ngrohtë dhe rreth 0.5 kg bukë (bukë të bardhë) për person. Më vonë na jepnin dy herë në ditë ushqim të ngrohtë dhe 1 kg bukë (bukë të bardhë) për person. Kur na liruan nga kampi, ushqimi ishte i mjaftueshëm dhe i mirë (mish dhe vaj në drekë). Në fabrikën e Autorepartit ushqimi ishte i njëjtë, si për robërit ashtu edhe partizanët. Për herë të parë shkruam letra [për në Gjermani] në janar 1945. Na lejohej të shkruanim një letër në muaj dhe ta dërgonim nëpërmjet Kryqit të Kuq. Kuptoheshim shumë mirë me rojet dhe me popullsinë, nëse nuk i kishe rënë në qafë ndokujt. Oficerët robër, si edhe shokë që evidentoheshin që kishin bërë dëme luftime, trajtoheshin në mënyrë të veçantë.

Për fat të keq, më 28.7.1946 u liruar nga kampi Tirana-Autoreparti vetëm 18 burra, ish të dënuar politikë të rekrutuar në batalionin 999. Udhëtimi ynë vazhdoi nëpër Jugosllavi, Hungari, Austri dhe Lajpzig, ku edhe u liruar. U desh shumë punë dhe vendosmëri të arrinim këtë ditë. Në këtë kamp, d.m.th. në Tiranë ndodhen ende 8-10 të burgosur politikë (999) si edhe robër nga njësi të tjera. Nuk jam në gjendje të them sa 999-çat politikë janë ende në Shqipëri. Ama një gjë e di me siguri: të gjithë 999-çat janë liruar dhe dërguar nga Aleatët në Shqipëri, ndërkohë që vetëm Shqipëria është ende në listë. [...].<sup>134</sup>

Në arkivat tona nuk ka shumë të dhëna për robërit gjermanë të luftës. Në një raport të Drejtorisë së Policisë "Mbi gjendjen e burgjeve dhe kampeve të Republikës Popullore të Shqipërisë për muajin prill 1950"<sup>135</sup>, figurojnë 207 robër gjermanë. Në raport hidhet dritë edhe mbi kushtet e jetesës, gjendjen shëndetësore si edhe punët që bënin robërit gjermanë. Aty lexohet se kushtet e jetesës dhe ato higjieno-sanitare nuk ishin në gjendje të mirë, nevojtoret

<sup>134</sup>Ba DY 34/16521, Band 3, S. 500-501.

<sup>135</sup>AMPB, Fondi i Drejtorisë së Policisë Popullore, V. 1950, D. 391, fl. 28.

ishin shumë afër barakave dhe nuk kishte kanalizime. Gjithsesi, pastërtia personale e robërve gjermanë paraqitej e mirë, ndërkohë që punët sanitare nuk kryheshin me rigorozitet, ngaqë ato duhej të bëheshin nga vetë robërit. Në këtë muaj gjendja shëndetësore e robërve gjermanë paraqitej e mirë dhe vetëm gjashtë robër kishin shfaqur probleme shëndetësore. Pas trajtimit të tyre spitalor, ata u rikthyen në kamp me shëndet të përmirësuar. Në periudhën janar-mars 1950 robërit gjermanë punonin vetëm pesë orë në ditë, ndërkohë që pasditja shfrytëzohej për punë politike. Në muajin prill 1950 ata bënë 3420 ditë pune, me një vlerë prej 228.235 lekë. Nga kjo shumë, për ushqimin e robërve u shpenzuan 12.962 lekë,<sup>136</sup> ndërsa teprica “mbetet për t’u derdhur në favorin e kësaj Ministrije [...] për arsye se do të likujdohen defiçitet e muajve të kaluar mbasi kanë punuar 5 orë dhe kanë dalë deficit”, - shkruhet më tej në raportin e muajit prill.<sup>137</sup>

Në muajin qershor 1950, numri i robërve gjermanë në kampet e robërve jepet me nëntë robër, shtatë burra dhe dy gra.<sup>138</sup> Ky numër pasqyrohet edhe në statistikat e muajit korrik. Ndërsa në muajin gusht 1950, në kampet e internimit gjendeshin tetë gjermanë, gjashtë burra dhe dy gra.<sup>139</sup> Në muajin shtator numri i robërve gjermanë shkon në 12, konkretisht dhjetë burra dhe dy gra. Mesa duket, në paraverën e vitit 1950 u bë riatdhesimi i pjesës më të madhe të robërve gjermanë. Kjo shpjegon edhe faktin që, në raportin përmbledhës mbi gjendjen e burgjeve dhe të kampeve, në muajin maj nuk ka asnjë informacion për robërit gjermanë. Pjesa e mbetur në kampe, siç edhe është shkruar më sipër, janë ose robër që janë mbajtur për arsye të caktuara nga shteti shqiptar – me shumë gjasa këta janë specialistë, për të cilët shqiptarët kishin shumë nevojë në këtë periudhë, ose janë robër që janë grumbulluar me vonesë nga rrethet e tjera. Po ashtu, duhet theksuar që ndoshta në këtë raport nuk përfshiheshin gjermanët që dergjeshin bodrumeve të hetuesisë. Në këtë përfundim mund të arrihet nëse kujtojmë që në Shqipëri në këtë kohë gjendeshin tre robër gjermane, ndërkohë që raporti përmend vetën dy. Njëra prej tyre ishte ish-sekretarja e gjeneralit SS Fitzthum, e cila mbahej ende në hetuesi.

### ***Dita e të vdekurve – kujtime***

Në qershor 1987 ish-robi gjerman Alfred Wagner bëhet anëtar i Shoqatës së Miqësisë Gjermano-Shqiptare, Hamburg. Gjatë shfletimit të literaturës së ardhur nga Shqipëria, në faqen 248 të albumit “Epopeja e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e Popullit Shqiptar 1939-

---

<sup>136</sup>AMPB, Fondi i Drejtorisë së Policisë Popullore, V. 1950, D. 391, fl. 34.

<sup>137</sup>AMPB, Fondi i Drejtorisë së Policisë Popullore, V. 1950, D. 391, fl. 34.

<sup>138</sup>AMPB, Fondi i Drejtorisë së Policisë Popullore, V. 1950, D. 391, fl. 60.

<sup>139</sup>AMPB, Fondi i Drejtorisë së Policisë Popullore, V. 1950, D. 391, fl. 71. Raport mbi gjendjen e burgjeve dhe kampeve të internimit të republikës Popullore të Shqipërisë për muajin gusht 1950.

1944”, nën mbishkrimin “Dhe ja fundi i agresorëve”, ai shikon një foto të bërë më 2 nëntor 1946, ku ai së bashku me shokun e tij Bernhard Dziondziak është duke nxjerrë një kufomë nga një arkivol i hekurt për ta vendosur në shesh. Kjo foto e ngacmon Wagner-in, për të shkruar historinë e realizimit të kësaj fotografie, duke dhënë njëherazi edhe disa të dhëna për jetën e robërve gjermanë në Shqipëri<sup>140</sup>:

“Tashmë kishim kaluar dy vjet burgimi të vështirë. Kishim varrosur në dhe të huaj më shumë se një të tretën e shokëve tanë. Shumë prej tyre i kallëm në dhe lakuriq, pa asnjë teshë në trup. Rrekat që ata kishin veshur në trupat e tyre skeletikë ishin shumë të çmuara për ne të mbijetuarit. I vdekuri nuk mund t’i merrte ato me vetë nën dhe.

„Streha“ jonë ishte një bodrum tiranas i ftohtë dhe gjithë ujë. Fillimisht flinim përtokë. Me kalimin e kohës, gjithsecili prej nesh kishin sjellë prej kantierit të punës disa dërrasa dhe kishim sajuar me to një biçim krevati. Më pas filluan shirat. Uji derdhej shkallëve dallgë-dallgë dhe po ashtu, edhe nga themelet hynte ujë. Brenda një kohë të shkurtër uji arrinte deri në gju. U deshën shumë ditë që të ngrinim dyshemenë më gurë dhe të dilnim mbi sipërfaqen e ujit.

Asnjë nuk mendoi „Ditën e të Vdekurve“, kur atë mëngjes të 2 nëntorit 1946 dolëm nëpër ujë nga streha jonë. U nisëm për në punë. Rojet e përgjumur e të ngrirë nga i ftohti na vështronin nga kullat e vrojtimit pranë telave me gjemba. Javë të tëra jetuam në ujë, ku çdo gjë ishte e lagur dhe për muaj të tërë na jepnin vetëm 400 gram bukë në ditë – dhe pastaj prisnin që ne të punonim. Kush siguronte pak kripë dhe ndonjë kërcell preshi ishte një burrë për t’u pasur zili. Atë ditë kishim për të zgjeruar dhe thelluar një kanal.

Ishte një ditë si gjithë të tjerat; koha nuk ecte fare, uria të grinte dhe çdo sforcim shkaktonte marramendje. Sytë shikonin me padurim lartësinë e diellit, i cili hera-herës dilte nga retë dhe më tregonte kohën. Gjysmë ore para drekës i kërkova leje rojës për të kryer nevojat personale. Mora rrugën nëpër një fushe dhe, duke përfutur nga rasti, gjatë ecjes mblodha disa erëza të ngrënshme. Edhe sot gjeta radhiqe, të cilat do t’i haja në darkë me bukë, pas një dite të lodhshme pune. Ndërkohë u afrua një veturë e vjetër, e ndjekur nga një kamion. Pas një pëshpëritje të shkurtër me rojën tonë, zotëria që ndodhej në makinë na nguli sytë. Shoku im me goditi lehtë, - po kërkonin burra trupmëdhenj dhe, në dukje, deri diku të fuqishëm. Ëndërrova veten në një moment sikur gjendesha në një fermë shtetërore ku kishte ushqim të mjaftueshëm. Vendosa duart e mbledhur grusht në bel, bëra para dhe pas pak e pashë veten mbi kamion, së bashku me 16-18 burra të tjerë. Secili prej nesh shpresonte njësoj si unë dhe nuk hoqi dorë nga ky mendim edhe kur në kamion hipën edhe tetë policë të armatosur deri në dhëmbë. Policët nuk

---

<sup>140</sup>Arkivi i Volksbund Deutsche Kriegsgräberfürsorge e.V., Dosja për Shqipërinë, Alfred Wagner.



thanë asnjë fjalë për detyrën që duhej të kryenim. Gomat e kamionit ishin të forta, rruga edhe më mizerje, gropa-gropa. Pas rreth 18-20 km mbërritëm pranë një ure, të cilën e kishte prishur lumi. Në të dy anët e lumit ishin grumbulluar makina. Edhe fshatarët u kishin zbritur gomarëve të tyre, kishin ndezur shpejt e shpejt disa zjarre dhe të ulur në bisht diskutonin me gjallëri me njëri-tjetrin. Menjëherë na shoqëruan në anën tjetër të lumit, duke ecur mbi një urë provizore. Hundët na i shpoi një erë e rëndë kufomash. Diçka ka ndodhur, mos duhet të ndihmojmë? Jo -, por gjithë ëndrrat tona u shuan me një goditje të vetme. Një kolonë me kamionë të Wehrmacht-it plot me arkivole na priste në anën tjetër të lumit. Në kufirin shqiptaro-jugosllav ishte ngritur gjatë luftës një burg, në fakt kamp pune i Armës-SS, ku kishin vdekur qindra shqiptarë. Kufomat e tyre i kishin zhvarrosur, për t'i rivarrosur në Tiranë, poshtë një monumenti. Arkivolet ishin në gjendje shumë të keqe dhe ishin vendosur 3-4 mbi njëri-tjetrin. Shpesh ishin dy kufoma në një arkivol. Për fatin tonë të keq filloi përsëri një shi me gjyma.

Ishte një torturë. Me të drejtë. Arkivolet e rëndë mezi shkarkoheshin dhe duhej të mbaheshin në krah edhe 200-400 metër për t'u ringarkuar përsëri në kamionët e radhitur në anën tjetër të lumit. Me gjithë kujdesin e madh që treguam, arkivolet metalikë nga gërvishtën duart. Nga lëvizja, uji i shiut që ishte mbledhur brenda në arkivol, rrjedh nëpër të plasurat e arkivolit dhe një lëng i verdhë me erë të qelbur na qull nga koka te këmbët.

Rojet na grahin të punojmë sa më shpejt. Na urdhërojnë që 25 arkivolet e fundit t'i vendosim në një shesh në anë të rrugës. Çfarë kanë ndërmend të bëjnë tani? - pyesim veten. Na afrohet një polic, i cili mban në dorë një darë të madhe, që e huazoi te një shofer kamioni. Përkrah komandantit të rojeve qëndron një fotograf me aparat në dorë. Vetëm pasi na urdhëruan të hapim arkivolet e kuptuam se çfarë do të ndodhte dhe kundërshtuam. Shqelmat ranë si breshër mbi trupat tanë. Me darën në dorë u afruam për të hapur arkivolet. Fotografi i qeverisë fotografon me zell të madh. Na urdhërojnë të nxjerrim kufomat nga arkivoli dhe t'i vendosim përkrah njëri-tjetrit mbi lëndinë. Ne tentojmë edhe njëherë të kundërshtojmë. I treguam më kot komandantit të rojeve, një mjeku nga Tirana, duart tona të gjakosura! Meqenëse kundërshtuam, çdo çift të burgosurish u shoqërua nga një polic. Ndërkohë që disa policë na shtrëngonin të ecnim drejt arkivoleve duke na goditur pa mëshirë me qytat e armëve dhe grushte, pjesa tjetër na mori në shenjë dhe hoqën armët nga siguresa. Para se ndonjëri prej nesh ta paguante me kokë sepse me këta policë të veshur me uniformë blu nuk bëhet shaka, filluam të zbatojmë urdhrin, ndërkohë që shumë prej nesh villnin gjatë punës. Shpesh gjatë transportit krahët dhe këmbët e dekompozuar shkëputeshin nga trupi, çka ishte një dhunim i kufomave të heronjve shqiptarë, para se të bëhej nderimi i tyre sipas vendimit të qeverisë shqiptare. Fotografi merrte pamje nga çdo kënd i mundshëm. Pasi gjithë kufomat u rreshtuan mbi lëndinë përkrah njëra-tjetrës, ne

duhej që të gjithë të pozonim në grup mbi kokat e kufomave. Tani ishte e qartë për ne se përse në drekë u zgjodhën shokët me trupin më të madh. Nga fotografitë duhej të jepej mesazhi që gjermanët ishin duke kryer një masakër. Ne qëndronim me krahët dhe këmbët e kufomave në duar, ndërkohë që kufomat e shpërfytyruara dergjej nën këmbët tona. Pamja ishte më se e realizuar.

Më në fund kameramani u “ngop me foto”. Na u dha urdhër që të fusnim përsëri nëpër arkivole mbetjet trupore të heronjve shqiptarë. Morëm frymë thellë, ndonëse era ishte e padurueshme. Të gëzuar që kjo gjë mbaroi nuk u menduam më gjatë dhe ndodhi që në një arkivol futëm tre ose katër këmbë, ndërkohë që në arkivolet e tjerë ato mungonin.

Gjatë kthimit retë shkarkuan përsëri zhurmshëm. E mirëpritëm ujin e ftohtë të vrullshëm dhe mezi prisnim të na lagej çdo cep i lëkurës. Po pastroheshim! Një nga shokët, me një zë të ulët sikur po fliste me vete mërmëriti: “Sot është Dita e të Vdekurve”. Pavarësisht zhurmës së lartë të motorëve, të gjithë e dëgjuan këtë fjali. Çdo bisedë kishte ngecur dhe të gjithë ishin zhytur në mendime të thella

Robëria zgjati edhe katër vite të tjera. Kaluam edhe shumë herë të tjera mbi Ura-Zeze [ura mbi lumin e Zesës në Fushë Krujë - shën. im] dhe hera herës ndonjëri prej nesh thoshte: «kjo ishte dita e të vdekurve 1946»”.

\*\*\*

Profesor Paskal Milo në librin e tij “Udhëkryqe shqiptaro-gjermane” shkruan se, bazuar në një raport të vitit 1947, numri maksimal i robërve gjermanë në Shqipërinë e pasluftës ishte rreth 298 gjermanë.<sup>141</sup> Në fakt, siç edhe e shohim nga dokumentacioni i mësipërm dhe dëshmitë e robërve gjermanë, numri i robërve gjermanë në Shqipëri duhet të ketë qenë shumë herë më i madh. Rreth 300 ishte ndoshta numri i robërve gjermanë që u riatdhesuan, por nëse besojmë dokumentacionin e sipërpërmendur, e sidomos dëshmitë e ish-robërve gjermanë, ky numër duhet të ketë qenë shumë herë më i madh. Po ashtu, në këtë statistikë nuk është përfshirë numri i lartë i vdekjeve dhe, sidomos, ekzekutimet pa gjyq gjatë luftës, ndonëse konventat ndërkombëtare e ndalonin ekzekutimin e robërve. Gjithsesi, këto fenomene nuk u shfaqën vetëm në Shqipëri. Universalizimi i këtyre përvojave nuk është argument lehtësues për veprimin, por tregon që konflikte të kësaj shkalle e tejkalojnë logjikën njerëzore.

Nga burimet arkivore del që në Tiranë kanë qenë të paktën dy kampe robërish, në fakt kampe pune, një te Autorepartit (Laprakë) dhe një në Valias. Dëshmitë e robërve gjermanë japin të dhëna edhe për transferimin e robërve gjermanë në Elbasan dhe Durrës, ndonëse në vitin

---

<sup>141</sup>Paskal Milo, *Udhëkryqe shqiptaro-gjermane*, Tiranë: Toena, 2016, f. 186.

1946 ishte dhënë një urdhër për grumbullimin e tyre në Tiranë. Gjithsesi, ky urdhër nuk u zbatua me rigorozitet dhe numri i vërtetë i robërve gjermanë mbahej i fshehtë. Kjo për disa arsye. *Së pari*, qeveria shqiptare ishte e interesuar të mbante sa më gjatë specialistët gjermanë, aq të vlefshëm për rindërtimin e vendit. *Së dyti*, duke mos dhënë numrin e saktë të robërve, qeveria shqiptare nuk mund të fajësohej për trajtimin dhe kushtet e vështira të jetesës të robërve, gjë që çonte në vdekjen e tyre dhe, *së treti*, nëse jepej një numër i lartë robërish, qeveria shqiptare duhej të llogariste edhe orët e punës të robërve, gjë që nuk i interesonte asaj gjatë negociatave për pagesën e reparacioneve të dëmeve të luftës.

Nëse vlerësojmë në mënyrë racionale dokumentacionin e sipërcituar, numri i përafërt i robërve gjermanë në Shqipëri duhet të ketë qenë rreth 1000 gjermanë. Ajo që mund të themi me siguri është që, në vitet 1945-1951 u riatdhesuan jo më shumë se 217-298 robër gjermanë. Sipas burimeve të Lidhjes Popullore për Kujdesin e Ushtarëve Gjermanë të rënë gjatë të dy luftërave botërore me qendër në Kassel, numri i ushtarëve gjermanë të rënë në Shqipëri është 2400 dhe jo 3600, siç edhe vetë Lidhja Popullore pretendonte deri para disa vitesh. Nga këta 1800 ushtarë gjermanë të rënë njihen me emra.

## **Nevila Nika - Universiteti European i Tiranës**

### **Trajtimi i shtetasve italianë në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore- nga prof. Venanzio Lozzi tek At Giacomo Gardin**

#### **Abstrakt**

Mbarimi i Luftës II Botërore shënon për shtetasit italianë të mbetur në Shqipëri nisjen e një periudhe disavjeçare përpjekjesh për riatdhësim e njëkohësisht, përndjekjesh (ekzekutime, burgime, vdekje në kampe e burgje, kampe pune të detyruar), apo zhdukje pa asnjë gjurmë nga ana e pushtetit të ri të vendosur në Shqipëri. Janë shfrytëzuar dokumentet autentike nga Arkivi Qendror i Shtetit, Arkivi i Ministrisë së Jashtme, Arkivi i Ministrisë së Brendshme.

Kapitullimi i Italisë fashiste, më 8 shtator 1943 fatkeqësisht nuk përkoji edhe me mbarimin e luftës për italianët. Nga kjo ditë do të niste për qytetarët italianë kalvari i gjatë i vuajtjeve dhe i përjetimit të tmerreve të luftës tashmë në atdheun e tyre.

Italia u pushtua nga ushtria e ish aleatit të saj, Gjermania naziste e në këto kushte italianët, ushtarakë e civilë, që gjendeshin në Shqipëri, por edhe në vende të tjera e kishin pothuaj të pamundur të riatdhesheshin. Sipas mjaft burimeve, llogaritet në Shqipëri të kenë mbetur rreth 27.000 qytetarë italianë, përfshirë këtu edhe ushtarakë të të gjitha rangjeve dhe civilë të ardhur para e, sidomos, pas 7 prillit 1939.

Gjendja e krijuar në Shqipëri mbas kësaj date gjithashtu paraqitej mjaft konfuze pasi, pothuaj menjëherë në territorin shqiptar nuk vonojnë të hyjnë trupat gjermanë. Trupat ushtarakë italianë tashmë në përshtjellim të plotë për shkak të mungesës së një komande qendrore në Shqipëri, por edhe ndërprerjes së ndërlidhjes me Shtabin e Ushtrisë Italiane nën komandën e gjeneral Badoglio-s, që ndërkaq ishte vënë në dispozicion të trupave aleatë, lejon komandantët e të gjitha niveleve të ndërmarrin pa asnjë lloj koordinimi vendime në shumicën e rasteve të gabuara. Kështu, pati drejtues të formacioneve ushtarake që vendosën t'i binden urdhrat për të dorëzuar armët tek repartet e ushtrisë gjermane, të tjerë vendosën të largohen për t'u bashkuar me pjesën tjetër të formacioneve ushtarake që ishin të dislokuar në territoret shqiptare të bashkuara rishtas me shtetin amë, të tjerë vendosën të bashkohen me forcat partizane shqiptare e të tjerë thjeshtë të dezertonin e të gjenin strehë sidomos në zonat e thella rurale.

Pasojat do të jenë tejet të rënda për ushtarakët italianë. Ata komandantë, të cilët morën vendimin për të dorëzuar armatimin, praktikisht vendosën dënimin me vdekje të qindra mijëra ushtarakëve. Një pjesë prej tyre u vranë në territorin shqiptar e pjesa dërmuese përfundoi në kampet e shfarosjes. Po të njëjtin fat patën edhe ato trupa, komandantët e të cilëve menduan se mund të bashkoheshin trupat e tjera italiane në Strugë, prej nga mund të merrnin rrugën e

kthimit për në atdhe nëpërmjet portit të Selanikut. Mungesa e ndërlydhjes bëri që ata të mos ishin të informuar se ushtria gjermane kontrollonte të gjithë linjën hekurudhore për në Selanik dhe se urdhri i ardhur nga Berlioni ishte që të gjithë ushtarakët italianë, por edhe qytetarët e thjeshtë, cilësoheshin si armiq. Fati i tyre ishte i përcaktuar, të gjithë drejt kampeve të përqendrimit.

Më ndryshe ndodhi me ata që vendosën të bashkohen me forcat partizane apo që u strehuan pranë familjeve shqiptare në qytete e fshatra. Shumica e tyre ia doli t'i mbijetonte atyre 14 muajve, shtator 1943- nëntor 1944, të pranisë gjermane në Shqipëri. Gjithsesi, për hir të së vërtetës duhet të pranojmë se pati humbje si në radhët e partizanëve italianë ashtu edhe si pasojë e masakrave të kryera nga pushtuesi.

Por, fatkeqësisht largimi i trupave gjermane nga territori shqiptar në nëntor 1944 dhe mbarimi i Luftës së Dytë Botërore më 9 maj 1945 me kapitullimin pa kushte të Gjermanisë naziste, shënon nisjen e një periudhe tjetër vuajtjesh e mundimesh për qytetarët italianë të mbetur në Shqipëri.

Riatdhesimi përbën problemin apo shqetësimin më të madh të komunitetit italian në Shqipëri. Megjithëse edhe qeveria italiane nga ana e saj bën përpjekje maksimale në këtë drejtim, përsëri procesi i riatdhesimit has në vështirësi për shkak të qëndrimit të qeverisë shqiptare. Është shumë interesant një debat, pyetje e përgjigje, zhvilluar në Asamblenë Kushtetuese më 31 janar 1948 midis parlamentarit, inxhinierit e arkitektit Florestano Di Fausto<sup>1</sup> dhe ministrit të Jashtëm të Italisë, juristit Carlo Sforza.<sup>2</sup> Deputeti Florestano Di Fausto, i cili për shkak të angazhimit të tij si profesionist kishte jo pak njohuri për Shqipërinë e sidomos për komunitetin italian të vendosur atje qysh para Luftës, ka pyetur dhe ka kërkuar shpjegime nga ministri i Punëve të Jashtme rreth gjendjes së italianëve të mbetur ende atje.<sup>3</sup> Shkas për këtë pyetje bëhet ardhja e lajmit se tekniku Paolo Saggioti është ekzekutuar nga autoritetet shqiptare nën akuzën “se ka kryer sabotime”. Sipas Di Fausto-s kanë kaluar më shumë se tre vjet nga nënshkrimi i marrëveshjes Palermo-Hoxha, sipas të cilës parashikohej “prania në Shqipëri e disa kategorive të personelit të specializuar për një periudhë që mendojmë se është tejkualuar

---

<sup>1</sup>Florestano di Fausto- 1890-1965, inxhinier e arkitekt, deputet i Asamblesë Kushtetuese 25. 06. 1946-31. 01. 1948 e më vonë i Parlamentit Italian, 08. 06. 1948-24. 06. 1953. Di Fausto u angazhua me hartimin e Planit Rregullues të Tiranës; është projektuesi i kompleksit të ndërtesave të ministrive dhe sheshit kryesor të Tiranës “Skënderbe” më 1932; projekttoi Vilat Mbretërore në Durrës e Shkodër më 1928-30 dhe Shkollën Industriale Italiane po në Shkodër.

<sup>2</sup> Karlo Sforza (Kont), 1872-1952. Jurist e diplomat, antifashist. Mbas luftës zgjidhet deputet dhe mban postin e ministrit të Punëve të Jashtme nga 02.02.1947-16.07.1951. Nënshkruan Traktatin e Paqes midis Republikës Italiane e Fuqive Aleate më 1947; Paktin Atlantik më 1949; Marrëveshjen për krijimin e Këshillit të Europës dhe Traktatin e themelimit të Komunitetit Europian të Qymyrit e Çelikut më 1951.

<sup>3</sup>*Gazzeta Ufficiale*, vendi???31 Gennaio 1948.

gjatë tashmë”. Më tej ai shton se, “... për shkak të gjendjes tejet të rëndë të italianëve të mbetur ende në atë vend (Shqipëri – shën. aut.), bëhet fjalë për rreth 750 persona, nga të cilët më shumë se nja njëqind janë të burgosur, a nuk keni parashikuar mundësinë e një ndërhyrje të shpejtë në format që do të gjykohen të mundshme dhe të përshtatshme me qëllim lirim të të burgosurve dhe kthimin në Itali të të gjithë atyre që kanë mbetur në Shqipëri si pasojë e marrëveshjes së marsit 1945?”<sup>4</sup>.

Ministri Karlo Sforza në përgjigjen e tij shtjellon vështirësitë e hasura gjatë përpjekjeve për riatdhesimin e bashkatdhetarëve të mbetur në Shqipëri. Ai iu bën të ditur parlamentarëve situatën e krijuar për shkak të qëndrimeve aspak miqësore e bashkëpunuese të qeverisë shqiptare.

“Në momentin e çlirimit të Shqipërisë gjendeshin ende atje 20 mijë italianë, civilë, ushtarakë dhe të mobilizuar për shkak të Luftës. Qeveria italiane - deklaroi Sforza - u interesua menjëherë për riatdhesimin e tyre, ashtu siç ishte vepruar edhe për italianët e mbetur në Greqi, Bullgari e Rumani, mbas çlirimit të këtyre vendeve. Aleatët vunë në dispozicion anijet e nevojshme dhe UNRRA u deklarua menjëherë e gatshme për të lehtësuar asistencën për imbarkimin, ndërsa një Komitet Italian i ngritur enkas në Shqipëri ju kushtua marrjes kontakt me italianët e shpërndarë nëpër Shqipëri dhe ndihmuar ata me fonde”.<sup>5</sup> Por, po sipas Sforza-s, “... shumë shpejt na u desh të konstatojmë që nga ana e autoriteteve shqiptare nuk kishte ndërmend për t’i lënë që të largoheshin bashkatdhetarët tanë. Këta të fundit - konstatojmë Sforza - përdoren në pjesën më të madhe për punë të ndryshme, si teknike, si punonjës të specializuar ose jo. Autoritetet vetë kanë ndërmend të vazhdonin të përfitonin, duke i mbajtur italianët, shumë prej të cilëve ishin të liruar nga kampet e përqendrimit dhe të tjerë kishin marrë pjesë në luftën partizane shqiptare, sikur të ishin tamam robër lufte”.<sup>6</sup>

Ministri Sforza gjatë përgjigjes së pyetjes të deputetit Di Fausto shpjegon shkurtimisht për marrëveshjen e arritur më 14 mars 1945 midis nënsekretarit të shtetit për Luftën, Mario Palermo, i dërguar me mision special në Tiranë, dhe kryetarit Enver Hoxha.<sup>7</sup>

Kjo marrëveshje parashikonte që, duke filluar nga 15 prilli 1945 do të niste riatdhesimi i të gjithë italianëve civilë, ushtarakë e të mobilizuar. Në Shqipëri do të mbaheshin përkohësisht një numër i caktuar specialistësh të nevojshëm për rindërtimin e Shqipërisë. Por, këta nëse do

---

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Ministri Sforza e cilëson shprehimisht “Kryetar” dhe jo si kreu i Qeverisë, me sa duket me qëllim për ta identifikuar se ai, pra Hoxha, është kreu i gjithçkaje tashmë në Shqipëri.

të pranonin të rrinin do të kishin kontrata të rregullta pune, nëse nuk do të pranonin do të zëvendësoheshin me të tjerë që do të vinin nga Italia në bazë të një angazhimi të rregullt.

Sforza bën të ditur para Asamblesë se, “.. riadhesimi në masë i italianëve përfundoi gjatë verës 1945. Në korrik 1945 u dërgua në Tiranë misioni ynë, i cili u interesua për riadhesimet me dakordësi të specialistëve duke kërkuar me këmbëngulje nga Qeveria Shqiptare më shumë se njëherë por gjithnjë pa rezultat, listat e kategorive të specialistëve që asaj i nevojiteshin në mënyrë që t’ju jepej mundësia e riadhesimit atyre që nuk dëshironin të rrinin dhe dhënia e kontratave të rregullta të punës atyre që do të rrinin.”<sup>8</sup>

Por, më 17 janar 1946, qeveria e Tiranës njofton misionin italian, i cili sipas Sforza-s, “... me gjithë vështirësitë e ngadalësinë e detyruar nga gjendja në vend po përpiquej të zgjidhte këto çështje..”<sup>9</sup>, se duhej të largohej menjëherë nga Shqipëria pasi ka mbaruar detyrën për të cilën kishte ardhur.

“Mbas largimit nga Tirana të përfaqësisë tonë - vazhdon të përgjigjet Sforza - gjendja e italianëve të mbetur atje pa asnjë mbrojtje me shpejtësi u rëndua: pati arrestime, konfiskime, persekutime kundër klerikëve, procese. Sidomos teknikët e AGIP-it dhe mjekët e mbajtur si specialist qenë viktimat të të gjithë këtyre vuajtjeve. Të shtrënguar për të punuar në kushte të vështira morale e materiale, disa prej tyre u proceduan nën akuzën e zakonshme të sabotimit dhe në disa raste u pushkatuan.”<sup>10</sup>

Po cilët ishin ata që u përballën me burgjet, kampet apo akoma më keq me togat e pushkatimit? Sforza nuk përmend emra edhe pse njoftimet e para të ardhura nga përtej Adriatikut mund të kenë qenë konfuzë. Gjithsesi, qeveria italiane dinte se çfarë po ndodhte me bashkatdhetarët e vet të mbetur në Shqipëri. Çuditërisht trajtimi që ju ishte rezervuar italianëve në Shqipëri nga autoritetet shtetërore, por edhe nga popullata në qytete e fshatra, prej 8 shtatorit 1943 deri në nëntor 1944, kishte qenë mjaft dashamirës. Gjendja kishte ndryshuar rrënjësisht me ardhjen në pushtet të qeverisë komuniste. Moslejimi i riadhesimit të specialistëve nga ana e qeverisë shqiptare me pretendimin se, “duhej të mbaronin punimet e nisura”, apo se, “... duhej të kontribuonin në rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta”, apo thjesht se, “... nuk kemi mjaftueshëm specialistë”, rëndoi në shumicën e rasteve mbi ata shtetas italianë që kishin mbërritur në Shqipëri vite më përpara se ushtria italiane të zbarkonte këtu. Do të ishin pikërisht inxhinierët e teknikët që punonin në sektorin e industrisë minerare, kryesisht atë të naftës, që së bashku me familjarët e tyre, vendosen në Shqipëri në vitet '20-'30 të shekullit të kaluar.

---

<sup>8</sup>*Gazzetta Ufficiale*, 31 Gennaio 1948.

<sup>9</sup>Po aty.

<sup>10</sup>Po aty.

Numri i tyre do të rritet nga viti në vit dhe sipas burimeve italiane, “më 8 shtator 1943 në Shqipëri ishin 900 teknikë italianë dhe rreth 350 familjarë të tyre, që nuk ishin ende evakuar.”<sup>11</sup>

Qeveria e re e drejtuar nga komunistët që në javët e para të instalimit të saj zyrtar në Tiranë nis nga ushtrimi i dhunës e terrorit ndaj “elementëve antikomunistë”, “pjesëtarëve të klasave të përmbysura”, “elementëve armiq që sabotojnë pushtetin popullor” etj. Në këtë mënyrë, qeveria komuniste konsideronte armik që duhet eliminuar e nënshtuar me çdo kusht së bashku me bashkatdhetarët e vet edhe shtetasit e huaj që hipotetakisht mendohej se mund t’ia cenonin pushtetin.

Padyshim ndër të parët që do të bëheshin shembull ishin pikërisht shtetasit italianë që kishin shërbyer në Shqipëri prej vitesh në sektorët më strategjikë të ekonomisë tejet të dobët shqiptare. Inxhinieri Andrea Tarasconi, drejtor i AIPA-s, ia kishte dalë të mbronte impiantet dhe personelin edhe gjatë periudhës së pranisë së ushtrisë gjermane, por gjendja ndryshoi krejt pas mbarimit të luftës. Ai së bashku me teknikun Mario Cati qenë ndër të parët që e pësuan. U arrestuan në shkurt 1945 dhe nën akuzën e rëndomtë të gjoja “sabotimit” u pushkatuan më 28 shkurt. Fatkeqësisht nuk qenë të vetmit,<sup>12</sup> pasi regjimi i ri komunist i vendosur në Shqipëri nuk do të mjaftohet vetëm me kaq. Të tjerë specialistë italianë do të pësonin fatin e tyre.

Kështu kirurgu duarartë Venanzio Lozzi dënohet me vdekje nën akuzën “e tentativës për të nxjerrë monedha ari nga Shqipëria”.<sup>13</sup> Gjatë procesit hetimor rezulton se ai, “ka ndihmuar disa italianë të largohen nga Shqipëria; se po përgatitej edhe vetë me të tjerë për t’u larguar; dhe se ka dërguar në Itali shuma monedhë në ar për llogari të personave të tjerë”. Ekzekutohet më 16 gusht 1946 në bazë të vendimit të Gjykatës Ushtarake dhe vetëm pasi vetë Enver Hoxha siglon këtë dënim. Vallë dënimi ekstrem ishte një hakmarrje personale e Komandantit suprem të Shqipërisë apo ndonjë intrigë e ulët e bashkatdhetarëve të tij që militonin në Rrethin Demokratik “Giuseppe Garibaldi” dhe që i përkisnin të majtës italiane (komunistë apo socialistë). Profesor Lozzi e ka marrë me vete arsyen e vërtetë të këtij dënimi ekstrem. Gjithsesi, emri i tij ende edhe sot kujtohet me respekt e nderim për shërbimet e vyera që ai bëri në ato pak vite që jetoi e punoi në Shqipëri.

Një tjetër ndodhi e viteve të para të pasluftës që ka për protagonist një shtetas italian paraqet mjaft interes për të kuptuar gjendjen e italianëve të mbetur në Shqipëri. Bëhet fjalë për një specialist elektrikist, Augusto Betti, i mbajtur në Shqipëri në bazë të marrëveshjes Hoxha-

---

<sup>11</sup>Francesco Guidi, -“Albania: riabilitati e decorate dal governo di Tirana tre tecnici italiani uccisi alla fine della 2-a Guerra mondiale”, in: *L’Industria mineraria*, no.6, vendi ???1994.

<sup>12</sup>*Po aty*

<sup>13</sup>AIDSSh, Dosje hetimore-gjyqsore, f. ????



Palermo. Në letërkëmbimin e zhvilluar në vitin 1949 ndërmjet drejtuesve më të lartë të Partisë Komuniste Italiane me drejtues të lartë të partisë<sup>14</sup> në Tiranë, thuhet se në nëntor 1946, Augusto Betti elektrikist pranë AIPA-s i ardhur në Shqipëri në vitin 1936 së bashku me familjen, është arrestuar ndërsa gruaja e vajza e tij janë dërguar në kampin e internimit në Kamëz. Meqenëse nuk dihet asgjë për fatin e tij dhe të gruas e vajzës, familja në Itali i ka kërkuar ndihmë drejtuesve të Partisë Komuniste Italiane me shpresë se do të mund të ndihmonin të afërmit e tyre. Përgjigjja “e thatë” nga Tirana se, “Betti akuzohet për veprimtari armiqësore”, nuk lë vend për të shpresuar se ai mund t’i ketë shpëtuar ndonjë dënimi ekstrem.

Por rasti i teknikut tjetër të AIPA-s, gjeometrit Paolo Saggiottit, është me të vërtetë shumë domethënës për të kuptuar gjendjen realisht tejte të rrezikshme në të cilën jetonin e punonin ata që qenë të detyruar forcërisht të qëndronin në Shqipëri. Saggiotti çuditërisht përfshihet në një proces gjyqësor, të quajtur “Gjyqi i deputetëve”, kundër një grupi personalitetesh të akuzuar si kundërshtarë të qeverisë komuniste.<sup>15</sup> Në këtë grup bënin pjesë deputetë, profesorë, mjekë, inxhinierë, firmëtarë të Aktit të Pavarësisë, pinjollë të familjeve atdhetare, të cilët morën dënime të rënda nga ato kapitale deri tek ato afatgjata. Me sa duket regjimit të Tiranës i duhej t’i bashkëngjiste këtij grupi edhe një italian, kinse për të provuar se në bankën e të akuzuarve nuk janë vetëm ata [disa] shqiptarë që “kanë lidhje me Misionet Aleate dhe që nuk duan që në Shqipëri të vendoset regjimi komunist”, por edhe një shtetas i huaj nga një vend perëndimor. Saggiotti dënohet me vdekje së bashku me 11 të tjerë, midis të cilëve edhe inxhinieri i talentuar shqiptar Riza Alizoti, që gjithashtu punonte tek AIPA dhe ekzekutohen në tetor 1947.

Vala e arrestimeve të shtetasve italianë nis që në muajt e parë të pasluftës. Pushteti i ri nuk ka nevojë për shumë prova, për të mjafton fakti i të qenit shtetas i huaj e sidomos italian, për t’u konsideruar potencialisht i rrezikshëm. E këtu autoriteteve shqiptare jo pak i ka ardhur në ndihmë edhe Rrethi Demokratik “G. Garibaldi”, i cili drejtohej nga anëtarë tejet të devotshëm të Partisë Komuniste Italiane. Ishin shpeshherë drejtuesit e tij që informonin për veprimtarinë e bashkëkombësve të tyre apo gjykonin për radhën e riatdhesimit të tyre. Rrethi në fjalë në vitin 1945 mori përsipër të hartonte lista e kartela me të dhëna shumë të hollësishme të italianëve të mbetur në Shqipëri. Përveç emrit e mbiemrit, shënohej vendlindja, datëlindja, atësia, besimi, data e mbërritjes në Shqipëri, grada, përgjegjësia, gjendja civile (martuar ose jo), numri i fëmijëve, emri i gruas, qyteti, pjesëtarët e familjes, adresa, profesioni, data e zbakimit, periudha me partizanët, periudha e robërisë tek gjermanët, në spital, lokaliteti i punës me civilë

<sup>14</sup>Arkivi Qendror Shtetëror (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.), 14/AP-org. udh., Viti (më tej V.) 1949, L. 3, D.1.

<sup>15</sup>AIDSSh, Dosje Hetimore-Gjyqësore, f. ????

shqiptarë, puna ose detyra, në se dëshiron të rrijë ose jo në Shqipëri dhe, së fundi vendndodhja aktuale në Shqipëri<sup>16</sup>. Të gjitha këto të dhëna natyrisht që iu viheshin në dispozicion autoriteteve shqiptare për t'u përdorur prej tyre.

Gjithnjë lidhur me sa më sipër u tha, përbën rasti i ish-drejtorit të filialit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Vlorë, Giuseppe Terruzi. I arrestuar në ditët e para të dhjetorit 1945 akuzohet nga autoritetet shqiptare se, “ka qenë fashist, se i ka dorëzuar gjermanëve kur po iknin një sasi të hollash dhe se së bashku me Arturo Orlandon ka ndihmuar disa bashkatdhetarë të tyre të iknin nga Ushtria Nacionalçlirimtare për në Italinë e pushtuar nga nazistët”<sup>17</sup>. Megjithëse kundër Terruzit akuzat janë krejtësisht të pambështetura në prova e fakte, megjithëse janë mjaftueshëm në mbrojtje të tij deklaratat e banorëve të Vlorës, të cilët e kanë njohur ose kanë punuar me të, megjithëse nga Drejtoria Qendrore e Bankës në Tiranë jepet konfirmimi se Terruzi nuk ka shkakuar asnjë dëm financiar dhe se anëtarësimi në Partinë Fashiste ishte një detyrim, të cilit nuk mund t'i shmangej askush, ai dënohet me burgim. Por, gjatë procesit hetimor bie në sy fakti se do të jetë pikërisht një italian, kapiten Chilovi<sup>18</sup>, i cili pohon e nënshkruan kundër Terruzzit dhe disa të tjerëve. Bazuar në deklaratën e lëshuar më 19 shkurt 1946 nga Nicolo Delogu gjatë procesit hetimor mësojmë se ai së bashku me një tjetër italian të quajtur Picceci janë thirrur në Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit në Vlorë prej kapiten Chilovit, i ardhur nga Berati dhe kanë menduar se bëhej fjalë për zgjedhjet e Rrethit Demokratik “G. Garibaldi”, por në fakt janë pyetur për qëndrimet e pikëpamjet e të burgosurve Terruzzi, Belluzzi, Tagliani, Verde, Sinopoli e Orlandi. Sipas kësaj deklaratë, Delogu e Picceci nuk kanë firmosur kundra bashkatdhetarëve të tyre. Familja e G. Terruzzit mundi të riatdhesohet ndërsa ai do të ndërrojë jetë pas disa vitesh, në vitin 1952 në burgun famëkeq të Burrelit.

Lista e atyre që vuajtën në burgje e kampe, që humbën jetën apo edhe që punuan me detyrim në Shqipërinë e pasluftës është disi e gjatë, por do të doja të kujtoja këtu edhe disa prej klerikëve që kishin ardhur në Shqipëri për t'i shërbyer besimtarëve të krishterë. Pati prej tyre që u dënuan me vdekje, pasi kaluan kalvarin e torturave të padëgjua, e këtu mund të përmendim At Giovanni (Gjon) Faustin, i pushkatuar më 4 mars 1946 dhe i shpallur para pak vitesh “Martir i Kishës”.

Një tjetër klerik nga Italia, At Giacomo (Jak) Gardin i Urdhrit Jezuit, vuajti në burgjet shqiptare nga viti 1945 deri më 1955, kur edhe mundi të riatdhesohet. Kishte qenë mësues në

---

<sup>16</sup>AQSh, F. 445, V. 1945, D. 54, 54/1, 54/2, 54/3, 55, 75, 76, 88.

<sup>17</sup>AIDSSh, Dosje Hetimore-Gjyqsore, f.???

<sup>18</sup>Dokumenti është shtypur nga një nëpunës i Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit, më vonë Sigurimi i Shtetit, i cili nuk e ka shkruar si duhet.

Seminarin Papnor në Shkodër. Libri i tij “10 vjet burg në Shqipëri 1945-1955” është dëshmia më autentike e Shqipërisë të atyre viteve, por edhe të atyre që pasuan. Libri u shkrua pas kërkesave këmbëngulëse të eprorëve të tij, të cilët me të drejtë mendonin se ishte detyrë e atyre që kishin vuajtur në burgjet e kampet e përqendrimit të dëshmonin me shkrim para popullit shqiptar e para botës së qytetëruar se tmerret e diktaturës nuk kanë qenë një legjendë. Vepra u botua në vitin 1986 në Romë, në gjuhën angleze në SHBA në vitin 1988, në gjuhën shqipe në vitin 1992 po në Romë dhe, më vonë, është përkthyer edhe në gjuhën kroate.

E për t’u kthyer përsëri tek fjala e ministrit Sforza në Asamblenë Kushtetuese të Republikës Italiane vërejmë se përpjekjet për të mbrojtur shtetasit italianë të mbetur në Shqipëri kanë qenë pa asnjë rezultat. “Nëpërmjet Vatikanit, Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe UNRRAs, Ministria e Punëve të Jashtme është përpjekur t’ju vijë në ndihmë bashkëkombësve në Shqipëri dhe të mund të riatdheshojë ata që kanë mbetur - deklaroi Sforza - por asnjë nga këto organizata nuk mundi të zhvillonte as më të voglën veprimtari në këtë drejtim. UNRRA dhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar nuk kaloi shumë kohë edhe u përzunë nga Shqipëria”<sup>19</sup>.

“Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë bëri tentativa edhe pranë qeverive aleate. Ju drejtua edhe Përfaqësisë të BRSS - deklaroi Sforza - por në se në fillim u duk se do të ndihmonte (më vonë) u tërhoq. Amerikanët e britanikët lanë të kuptohej se interesimi i tyre do t’i dëmtonte më shumë se sa do t’i ndihmonte (italianët) duke pasur parasysh marrëdhëniet e tendosura të tyre me Qeverinë e Tiranës. Në fakt pas pak edhe misionet e tyre u larguan nga Shqipëria”<sup>20</sup>.

Në përfundim të kësaj trajtese të shkurtër, do të doja të jepja një shpjegim se përse në titullin e fjalës time kam përmendur vetëm dy emra prof. Lozzi e At Gardin. Profesionet e tyre mund të duken shumë larg nga njëri-tjetri, njëri mjek kirurg e tjetri klerik mësues, por që të dy gjithçka bënë në jetë, ishte e lidhur drejtpërsëdrejti me qenien njerëzore. I pari, mjekoi e shëroi me duart e tij të arta trupat e sëmurë e, i dyti me përkushtimin e tij nëpërmjet fjalës u mundua të shëronte shpirtrat e trazuar. Asgjë nuk mund të justifikojë veprimet e autoriteteve shqiptare të atyre viteve për dënimet ekstreme, për keqtrajtimin fizik e psikologjik të ushtruar ndaj shtetasve italianë që punuan e jetuan në Shqipërinë e para, gjatë pas Luftës së Dytë Botërore.

---

<sup>19</sup>*Gazzeta Ufficiale*, 31 gennaio 1948.

<sup>20</sup>*Po aty*.

**Vizatimi i fytyrës së “armikut të popullit” në vitet e para të regjimit komunist**

**Abstrakti**

Dhuna e ushtruar ndaj një kategorie të popullsisë nuk do të ishte e efektshme, nëse ajo nuk do të mbështetej, ose nuk do të kundërshtohet nga shumica, prandaj propaganda shtetërore shoqëronte çdo zbulim dhe dënim të të ashtuquajturve grupe armiqësore. Mekanizmat e dhunës dhe të propagandës që u përdorën nga organet shtetërore dhe partiake për të krijuar hendekun ndërmjet kundërshtarëve politikë realë apo potencialë me pjesën tjetër të popullsisë, u konsoliduan që në vitet e para të vendosjes së regjimit. Duke qenë se legjitimiteti i pushtetit të komunistëve buronte nga rezistenca e tyre gjatë Luftës II Botërore, analiza trajton tri kategori kundërshtarësh: të ashtuquajturit kolaboracionistë, antifashistët dhe njerëzit që gjatë luftës kishin qenë politikisht indiferentë.

Në filmin *Ditët që sollën pranverën*, prodhim i Kinostudios “Shqipëria e Re” i vitit 1979, ku trajtohen ngjarje të ndodhura në Malësinë e Madhe në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri zhvillohet një skenë shumë interesante. Aktori Robert Ndrenika në rolin e një partizani së bashku me një koleg të tij ishin caktuar nga Këshilli Nacionalçlirimtar i fshatit për të kontrolluar kishën. Partizani shpreh shqetësimin se ata nuk mund të shkonin në kishë; se kontrolli duhet bërë sipas rregullave që kishte caktuar Këshilli dhe se ata nuk mund të hynin në shtëpinë e popullit pa leje. Në këtë moment, Robert Ndrenika i kthen një pyetje shumë intriguese “Po pse, është prifti, popull?” Kjo pyetje e hedhur si një batutë kalimtare, u kthye në proverbiale dhe mjaft e përdorshme dhe në jetën e përditshme. Mesazhi që i transmetohej shoqërisë me anën e saj ishte i qartë: ekzistonte një kategori e shoqërisë që gëzonte të drejta, pra që për konceptin e regjimit ishte “popull” dhe një pjesë, e cila “nuk i meritonte” këto të drejta. Prifti katolik për të cilin flisnin dy partizanët ishte konsideruar nga regjimi si “reaksonar”, “armik” etj., dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet “popull” e, rrjedhimisht, nuk mund të gëzonte të njëjtat të drejta si pjesa tjetër e popullsisë.

Qëllimi i këtij punimi nuk është të analizojë konceptin “popull”, por, përkundrazi, të sjellë në vëmendje mekanizmat që u përdorën nga organet shtetërore dhe partiake për të krijuar imazhin e “armikut”, të atij që populli duhet ta shikonte si “të huaj” dhe se si, gradualisht u krijua një kufi ndarës ndërmjet “popullit” dhe kundërshtarëve politikë realë, apo potencialë të regjimit. Fokusi i punimit do të jenë vitet 1944-1949, pra vitet e vendosjes së regjimit, e cila është dhe periudha e ngritjes dhe konsolidimit të këtyre mekanizmave të dhunës dhe propagandës.

Të gjithë ata që kanë jetuar gjatë viteve të “diktaturës së proletarietit” nuk mund të mos e kujtojnë retorikën e vazhdueshme për “diktaturën e proletarietit si formë më e ashpër e luftës

së klasave”. Drejtuesit e PKSH/PPSH adaptuan teorinë e J. V. Stalinit sipas të cilës “Diktatura e proletariatit duhet për të zhvilluar një luftë të papajtueshme kundër elementëve kapitalistë, për të shtypur borgjezinë dhe për të shkukur kapitalizmin nga rrënjët. Po në qoftë se kapitalistët e qytetit dhe të fshatit, në qoftë se kulakët dhe koncesionarët integrohen në socializëm, a duhet pas kësaj diktatura e proletariatit dhe, po qe se duhet, për të shtypur cilën klasë?”<sup>1</sup>. Bazuar në këtë përkufizim, retorika politike e regjimit nuk e fshihte se “diktatura e proletariatit” ishte në thelb “një formë e veçantë e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë ... si pushtet i punonjësve, i shumicës mbi pakicën”<sup>2</sup>. Në këtë sistem politik kishte, pra një ndarje të papajtueshme midis këtyre dy klasave/grupeve shoqërore. Klasat e privileguara, borgjezët, tregtarët dhe pronarët e tokave ishin “armiqtë” natyralë të “popullit” (kupto: regjimit). Drejtuesit e lartë të PKSH-së u kujdesën në mënyrë të posaçme që këtë imazh ta gdhendin në mendjen e të gjithë shqiptarëve.

\* \* \*

Ngjitja në pushtet e PKSH/FNÇ ende pa u larguar ushtritë pushtuese nga Shqipëria, nuk siguroi qetësi për drejtuesit e saj. Ata ishin të vetëdijshëm se kishin shumë sfida dhe vështirësi në rrugën për konsolidimin e pushtetit të tyre. E nisur që në gjenezë si një regjim totalitar, i bazuar në modelin e shtetit sovjetik të drejtuar nga Stalini, qeverisja e re e drejtuar nga PKSH u bazua në të njëjtat metoda dhe metodologji. Teoritë e ndryshme politike i përkufizojnë regjimet totalitare si antidemokratike, pa strukturë efektive parlamentare, me një parti - të vetme, e cila kontrollon dhe drejton të gjitha pushtetet brenda shtetit. Filozofi i regjimit fashist, Gentile, argumentonte se totalitarizmi mbështetet mbi bindjen se “individit dhe shoqëria i përkisnin shtetit, i konsideruar jo vetëm si një entitet moral e shpirtëror i aftë që të përfaqësonte kombin, por edhe që të asimilonte tërësisht degëzimet e ndryshme të shoqërisë civile”<sup>3</sup>. Studiuesi tjetër italian C. W. Casinelli mendon se veçoria më e rëndësishme e regjimeve totalitare është “kontrolli i plotë dhe i detajuar i të gjithë ideve, besimeve dhe shprehjeve”<sup>4</sup>.

Pavarësisht në çfarë mënyre shprehen studiuesit e regjimeve totalitare, të gjithë bien dakord në faktin që këto regjime kërkojnë të krijojnë një shtet të uniformizuar dhe sigurojnë nga shoqëria bindjen e verbër kundrejt pushtetit. Arritja e një situatë të tillë, sigurisht, nuk është

---

<sup>1</sup> J. V. Stalin, “Mbi deviacionin e djathtë në PK(b) të BS”, në: Marks, Engels, Lenin, Stalin, *Për diktaturën e proletariatit*, Tiranë: 8 Nëntori, 1983, f. 580.

<sup>2</sup> Marks, Engels, Lenin, Stalin, *Për diktaturën e proletariatit...*, f. 5.

<sup>3</sup> Edlira Bitincka, “Totalitarizmi shqiptar në këndvështrimin teorik”, në:

<sup>4</sup> C. W. Casinelli, “Totalitarianism, ideology and propaganda”, in: *The Journal of Politics*, Vol. 22, No. 1 (Feb., 1960), pp. 68-95

proces i thjeshtë. Shoqëria njerëzore përmbledh njerëz me pikëpamje, bindje dhe besime të ndryshme. Një regjimi totalitar do t'i duhet të sigurojë bindjen e shumicës dhe të eliminojë me mjete e forma të ndryshme atë pakicë të padëshirueshme, e cila do të bëhej pengesë për regjimin.

Qeveria e PKSH/FNÇ që mori pushtetin menjëherë pas largimit të ushtrive pushtuese nuk e fshehu se e bazonte pushtetin e vet në dy shtylla të forta ideologjike: luftën e klasave dhe diktaturën e proletariatit. Ajo ishte e bindur se me rezistencën kundër pushtuesve gjatë Luftës së Dytë Botërore kishte fituar një bazë të qëndrueshme legjitimiteti për marrjen e pushtetit, por sa për sistemin politik dhe formën e regjimit që kërkonte të ndërtonte, çështja ishte më e komplikuar<sup>5</sup>. Drejtuesit e lartë të PKSH ishin të vetëdijshëm se shteti i sapokrijuar kishte kundërshtarë të shumtë dhe të gjithanshëm, për të cilët regjimi përcaktoi një model sjelljeje për secilën nga kategoritë e kundërshtarëve.

Studiues të totalitarizmit bien dakord se në regjimet totalitare dhuna dhe propaganda janë dy anë të së njëjtës monedhë. Studiuesi E. Kohn-Bramstedt shprehet se “Terrori pa propagandën do të humbte efektin e tij psikologjik, propaganda pa terrorin nuk do i jepte ‘dorës së fortë’ peshën e duhur”<sup>6</sup>. Unë personalisht mbështes mendimin e studiuesve të tillë Hannah Arendt, Richards Overy, të cilët mendojnë se përdorimi i dhunës dhe propagandës janë shoqërueset e përhershme të regjimeve totalitare. Intensiteti i përdorimit të njëjës apo tjetrës, ndryshon në vartësi të fazave në të cilat ndodhen regjimet totalitare. Kështu, Arendt argumenton se “Kur totalitarizmi posedon kontroll absolut, ai zëvendëson propagandën me indoktrinimin dhe përdor dhunën jo aq shumë për të frikësuar popullin (kjo bëhet vetëm në fazën përpara kur opozita politike vazhdon të ekzistojë), por për të rikujtuar vazhdimisht linjat e tij politike dhe doktrinarë”<sup>7</sup>. Sipas saj, në këtë fazë, propaganda “është një ndër instrumentet më të rëndësishme, në mos më e rëndësishme, të totalitarizmit për t’u përballur me botën jo totalitare;

---

<sup>5</sup> Sa i takon formës së regjimit që duhet të vendosej në Shqipëri, pakënaqësi dhe hezitime ekzistonin edhe brenda Frontit Demokratik (të krijuar në gusht 1945). Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe ministri i Arsimit, Gjergj Kokoshi ishte mjaft kritik ndaj politikave qeverisëse të adaptuara nga qeveria e përkohshme. Në mbledhjet e KPNÇ, Kokoshi disa herë ishte shprehur kundër politikave të ashpra ekonomike të ndërmarra kundër kriminelëve të luftës. Ai argumentonte se nuk mund të vazhdonin të merreshin masa kaq të rrepta ndaj anëtarëve të familjes së tyre, sidomos në rastet kur personi në fjalë kishte vdekur. Në rastin e miratimit të Ligjit mbi tatimin e jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës, ai bënte thirrje të kihej kujdes në zbatimin e këtij ligji, pasi kështu siç po zbatohet ai ishte kthyer në një makth për tregtarët. Po kështu, Shefqet Beja, Kostandin Boshnjaku, Selaudin Toto, të gjithë në strukturat drejtuese qendrore apo lokale të Frontit Demokratik, në artikujt e tyre të botuar në gazetën *Bashkimi* flisnin për ekonomitë të lirë dhe modele perëndimore qeverisjeje. Për më tepër shiko: Sonila Boçi, “The December 2nd, 1945 Albanian Elections: Legitimization, or Mere Formalization for Communist Power?” in: *Porta Balkanica* (7), 2005, p. 16, si dhe Sonila Boçi, Hamit Kaba, “Deputetët opozitarë përballë ndërtimit të ‘shtetit të diktaturës së proletariatit’”, në: *Studime Historike*, nr. 3-4, 2017, Tiranë: 2018.

<sup>6</sup>Hannah Arendt, *The origin of totalitarianism*, San Diego, New York, London: A Harvest Book, 1979, p. 333.

<sup>7</sup>Po aty

terrori në të kundërtën, është vetë thelbi i formës së tij të qeverisjes”<sup>8</sup>. Ndërsa për R. Overy-n në sistemet totalitare “represioni nuk u zbatua si qëllim në vetvete për të kërkuar bindjen për shkak të frikës. Represioni shënjoj grupë dhe individë të cilët u izoluan si kërcënim për prioritetet politike të të dy sistemeve”<sup>9</sup>. Të krijohet përshtypja se regjimet totalitare, kanë në një farë mënyre, nevojë për ekzistencën e “figurës së armikut”, si një instrument të domosdoshëm për të siguruar mobilizimin e masave.

Me këtë kombinim frikësimi, dhune dhe propagande filloi të ndërtohej edhe totalitarizmi në Shqipërinë e viteve 1945-1949. Në propagandën e saj, PKSh mendohej t’u shpjegonte masave se në Botë ekzistonin “dy lloj demokracish”: në njërin toleroheshin të gjitha llojet e partive, madje dhe ato fashiste. Ndërsa, në demokracinë që ofronin komunistët, “fashizmit i ndërtohej një barrierë e fuqishme ... Nëse ka njerëz të cilët e konsiderojnë këtë demokraci si diktaturë, ne i themi se një diktaturë që godet fort fashizmin dhe i jep të gjithë të drejtat dhe liritë popullit, është demokracia më e gjerë që ekziston në këto rrethana”<sup>10</sup>. Sipas kësaj logjike, të gjithë ata që nuk përkrahnin ideologjinë fashiste, duhet të përfshiheshin në Frontin Demokratik, ndërkohë që mospërfshirja të etiketonte menjëherë si “armik”.

Strukturat e reja qeverisëse përcaktuan disa kategori kundërshtarësh dhe, për secilën prej këtyre kategorive, u “vizatua” një profil dhe imazh i posaçëm. Kategoria e parë e kundërshtarëve politikë që u goditën ishin “kriminelët e luftës” dhe popullsia e atyre zonave të cilat nuk kishin mbështetur gjatë luftës, Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Që më 2 dhjetor 1944, Qeveria Provizore e E. Hoxhës nxori një udhëzim për të gjitha qarqet për hartimin e listave të kriminelëve të luftës. Kuptimi që ajo i dha konceptit të “kriminelit të luftës” ishte mjaft i gjerë. Sipas udhëzimit në kategorinë e “kriminelëve të luftës” u përfshinë krahas shqiptarëve të përfshirë në administratat e pushtimit italian e gjerman, “ata që kishin ndihmuar për mobilizimin e popullit kundër armikut, organizatorët dhe iniciatorët e organizatave të Ballit Kombëtar, Komanda e Rinisë, Gjindarmërisë, Legalitetit, Divizioni SS Skanderbeg”<sup>11</sup>. Në listën e “kriminelëve të luftës” u përfshinë edhe ata që kishin pasur marrëdhënie qoftë dhe ekonomike me pushtuesin<sup>12</sup>.

Qëllimi i pushtetit ishte margjinalizimi i plotë i kësaj kategorie të popullsisë, e cila në thelb përbënte jo vetëm kundërshtarët realë politikë të regjimit, por edhe elitën politike

---

<sup>8</sup> *Po aty*, p. 334.

<sup>9</sup> Richard Overy, *The dictators: Hitler's Germany and Stalin's Russia*, New York, London: W. W Norton. Co, 2006, p. 177.

<sup>10</sup> “Nga fjala e prof. Sejfulla Malëshovës”, në: *Bashkimi*, Tiranë, 27 shtator 1945.

<sup>11</sup> Xhafer Sadiku, *Genocidi mbi kulakët në Shqipërinë komuniste, 1948-1990*, Tiranë: ISKK, 2013, f. 21.

<sup>12</sup> *Po aty*, f. 22

tradicionale shqiptare. Dhuna ndaj kategorisë së cilësuar si “kriminelë luftime” ishte e gjithanshme. Ata që shpëtuan nga dënimet me vdekje nga gjykatat ushtarake të ngritura në të gjithë Shqipërinë, iu nënshtruan viteve të gjatë burgimi. Ligjet e njëpasnjëshme i zhveshën familjet e tyre nga të gjitha të drejtat civile dhe politike<sup>13</sup>. Dhuna nuk përfundoi me personat e akuzuar për “kriminelë luftime”, ajo u shtri edhe në familjet e tyre, madje në disa breza. Që në fillim të vitit 1945, shumë prej familjeve të “kriminelëve të luftës” u dëbuan nga qytetet kryesore të vendit, të tjerë u bënë banorë të kampeve të rrethuara me tela me gjemba në Krujë, Berat e më vonë në Turan, Tepelenë e Porto Palermo, për t’u zhvendosur vazhdimisht kudo që regjimi kishte nevojë.

Ndërsa shfrytëzoi klimën ndërkombëtare të krijuar kundër “kriminelëve të luftës” për të ngritur këto gjykata dhe për të dhënë dënime ekstreme ndaj kësaj kategorie njerëzish, regjimi u tregua shumë i kujdesshëm për të siguruar mbështetjen e gjerë të popullit. Në këtë proces, regjimi përdori sa dhunën, aq edhe propagandën dhe demagogjinë. Propaganda zyrtare i konsideroi këta “tradhtarë të atdheut”; “shitës së interesave të kombit”; “pazarexhinj”, madje dhe “hajdutë pulash”. Krahas udhëzimit për strukturat shtetërore të qarqeve, drejtuesit e lartë të PKSH u dërguan udhëzime edhe strukturave të tyre partiake dhe atyre të Frontit ku i udhëzonin që të mobilizonin të gjithë popullin të cilët duhet të përfshiheshin masivisht në hartimin e këtyre listave. Është interesante të theksohet fakti se sa i takon kësaj kategorie të “armiqve të popullit”, mobilizimi i popullit ishte i përgjithshëm, ai nuk kërkohet në emër të klasës. Këshillave nacionalçlirimtarë të qarqeve u kërkohet të mblidhnin dëshmi mbi veprimtarinë tradhtarë të “kriminelëve të luftës” duke theksuar se “nuk ishte e nevojshme që dëshmitarët t’i kenë parë me sytë e tyre faktin e raportuar, mjafton që të kenë dëgjuar të flitet për të në popull”<sup>14</sup>. Ndërkohë që nuk duhet të pranoheshin në asnjë mënyrë dëshmitë pozitive për “tradhtarët që gjendeshin të rreshtuar”. Nëse një gjë e tillë ndodhte, siç ishte p.sh. rasti i 53 burrave të fshatit Qytezë të cilët iu drejtuan Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe qeverisë me lutjen për faljen e jetës së Kolë Tromarës, i cili sipas tyre “gjatë kohës që kishte qenë prefekt i Korçës na ka mbrojtur në çdo mënyrë dhe [pa] ndërhyrjen e tij, katundi tonë i hedhur me lëvizjen nacionalçlirimtare do të qe bërë pluhur dhe hi”<sup>15</sup>, reagimi i strukturave partiake ishte i

---

<sup>13</sup> Neni 4 i “Ligjit për Listat e Zgjedhësve”, u hiqte të drejtën e votimit disa grupeve të qytetarëve shqiptarë. Përfshiheshin nga e drejta e votimit, ministrat dhe funksionarët shtetërorë të kohës së pushtimit, të arratisurit politikë, kriminelët e luftës dhe armiqtë e popullit. Për më tepër shih: Sonila Boçi, “Zgjedhjet shqiptare të 2 dhjetorit 1945: legjitimim apo ligjësim i pushtetit të komunistëve?”, në: *Studime Historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2008, f. 91.

<sup>14</sup>Xh. Sadiku, *Genocidi mbi kulakët...*, f. 33.

<sup>15</sup>Arkivi Qendror Shtetëror (më tej: AQSH), Fondi: më tej F.), 489, Viti (më tej: V.) 1945, Dosja (më tej: D.) 144, fl. 8. Letër e banorëve të fshatit Qytezë (Korçë) për Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar dhe Qeverinë e Përkohshme, 8 prill 1945.



menjëhershëm. Në fshat zbarkuan propagandistët partiakë për t'i bindur banorët në drejtësinë e vendimit të gjykatës speciale dhe në tradhtinë e Kol Tromarës. Ndërkohë që organeve të Divizionit të Mbrojtjes së Popullit iu kërkua të mbanin nën kontroll nënshkruesit e petitionit. Njëkohësisht me përpjekjet për denigrimin moral, material dhe politik të kategorisë së “kriminelëve të luftës”, filloi gjithnjë e më shumë të lartësohej figura e partizanit dhe pjesëmarrësve në lëvizje, të cilët padyshim ishin fituesit e luftës dhe shtylla e pushtetit të ri.

Në kategorinë e dytë të kundërshtarëve të regjimit ishte edhe popullsia në zonat veriore të vendit. Popullsia konservatore e këtyre krahinave, e lidhur fort me zakonet dhe traditat shekullore, tregoi hapur kundërshtimin ndaj vendosjes së regjimit komunist në vend. Ajo u bë baza e kundërshtimit me armë të regjimit komunist dhe një bazë e sigurt për strehimin e të gjithë anëtarëve të Ballit Kombëtar, Legalitetit dhe ish zyrtarëve të lartë që kishin shërbyer në administratat e pushtimit. Kelmendasit, mirditorët, lumjanët etj., organizuan rezistencë të armatosur ndaj vendosjes së regjimit komunist, rezistencë që i shkaktoi shumë kokëçarje drejtuesve të lartë të PKSH, të cilët mundën me shumë vështirësi ta vinin në kontroll vetëm nga fundi i viteve '40.

Në fillim të vitit 1945, qeveria ndërmori në të gjithë zonën e veriut një fushatë për çarmatimin e popullsisë dhe ngritjen e këshillave nacionalçlirimtarë. E gjithë situata u shoqërua me dhunë të ashpër. Sipas një raporti, të Divizionit III të UNÇ për komandën e qarkut të Shkodrës më 7 shkurt 1945 një valë masash represive ishin ndërmarrë në zonën e Malësisë së Madhe. “Janë djegur shtëpitë e Mark Sokolit e të Kol Tom Stakas nga Kopluku – thuhet në raport, - për arsye së ndodhen në arrati me Llesh Marashin. Është djegur gjithashtu shtëpia e Shuk Gjekës, nga katundi Sheldije për arsye se ndodhet në arrati së bashku me vëllan e tij. Është pushkatuar Tom Marku nga katundi Sheldije për arsye se duke pasur 9 armë tregoi vetëm një. Pushkatimi i tij është bërë në konferencë përpara popullit të katundit. Ky person bënte nga ana tjetër propagandë për mos dorëzimin e armëve”<sup>16</sup>. Dhuna ishte e tillë sa detyroi drejtuesit komunistë lokalë t'i tërhiqnin vërejtjen eprorëve të tyre mbi sjelljen e Divizionit të Mbrojtjes së Popullit, i cili po terrorizonte popullsinë<sup>17</sup>.

Ajo që vërehet nga letërkëmbimi ndërmjet drejtuesve komunistë është se dhuna e përdorur në veri, ndryshe nga ajo e përdorur ndaj “kriminelëve të luftës”, nuk synonte denigrimin e kësaj popullsie, por frikësimin dhe, më pas, nënshtrimin e saj. Në shkurt të vitit 1945, Mehmet Shehu urdhëronte shtabet e Brigadës I, XI, XXIII dhe XXIV që të fillonin sa më

---

<sup>16</sup> AQSH, F. 14/AP-str., V. 1945, D. 215, fl. 13. Raport i Divizionit III të UNÇ për komandën e qarkut të Shkodrës, 7 shkurt 1945.

<sup>17</sup> AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1945, D. 16. Raport i Sami Bahollit për KQ të PKSH, pa datë.

shpejt operacionin për çarmatosjen e popullsisë së veriut. Udhëzimet tregonin për një dhunë të diferencuar “në rast se ndokush gënjen – porosiste Shehu, - duke deklaruar vetëm një armë ose nuk deklaroi kurrëgjë dhe armët i mshef, karshi tij duket të merren masat ekstreme d.m.th. të pushkatohet në vend pa gjyq. Në rast se ndonjë katund ose ndonjë grup njerëzish do të guxojë të shtijën me armë kundra partizanëve, atëherë duhet të merren masa shumë të rrepta d.m.th. të sulmohen reaksionarët dhe, nga ato që do të kapen me armë të pushkatohen në vend pa gjyq elementat kryesorë, ndërsa elementat më pak të fajshëm por që kanë luftuar të shoqërohen të lidhur për këtu në Shkodër; elementi popull që ka qenë i gënjyer në këtë rast të lihet i lirë dhe të çarmatohet”<sup>18</sup>.

Qartazi regjimi kërkonte të shtrinte ndikimin në veriun e vendin, duke shkëputur masën e gjerë të fshatarëve të varfër nga bajraktarët. Enver Hoxha porosiste Mehmet Shehun që “Shtypi duhet të vë në dukje lodrën e fëlliqur të mbeturinave të reaksionit dhe tradhtarëve që u pushkatuan. Të vihet në dukje dora e hekurt e qeveris dhe e ushtrisë që mbron popullin. Parulla e mobilizimit të popullit rreth pushtetit dhe qeveris. Grusht të pamëshirshëm atyre që mashtrjnë popullin .....”<sup>19</sup>. Në këtë rast, regjimi kërkonte mobilizimin e popullit në emër të klasës, pra duhet të bëhej ndarja mes krerëve “reaksionarë” dhe popullit të gënjyer. Të parët duhet të izoloheshin dhe të dënoheshin, të dytët duhet të bashkoheshin me pushtetin e ri. Porosia ishte që krahas “me çarmatimin duhet të shkojë dhe riorganizimi i këshillave me anë konferencash në çdo katund. ... Nëpër konferenca i duhet shpjeguar popullit ç’është pushteti, ç’është lufta jonë, ushtria jonë. Të demaskohet reaksioni, t’i tregohet gjendja e jashtme, t’i premtohet lumturi dhe paqë, t’i tregohen vështirësitë që gjen pushteti sot dhe krijuesit e këtyre vështirësive. Me fjalë të tjera, ku shkelin forcat tona duhet të ngrehin pushtetin dhe të lënë gjurmë politike. Motoja e operacionit do të ishte “Reaksioni duhet të asgjësohet. Populli duhet organizuar dhe mobilizuar. Kujt t’i kërkohet arma duhet ta dorëzojë ose armën, ose shpirtin”<sup>20</sup>. Nga viti 1945-1949, popullsia e veriut kaloi në disa faza dhune dhe terrori<sup>21</sup>, por ajo iu nënshtrua

<sup>18</sup>AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1945, D. 215, fl. 29. Urdhër i Mehmet Shehut, komandanti i Korpusit III, Shkodër për shtabet e brigadave I, XI, XXIII, XXIV, 12 shkurt 1945.

<sup>19</sup>AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1945, D. 215, fl. 7, Radiogram tepër urgjent i Enver Hoxhës për Mehmet Shehun, 1 shkurt 1945.

<sup>20</sup>AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1945, D. 215, fl. 31. Urdhër i Mehmet Shehut, komandanti i Korpusit III, Shkodër për shtabet e brigadave I, XI, XXIII, XXIV, 12 shkurt 1945.

<sup>21</sup>Shtypja e kryengritjeve të Koplikut (janar 1945) dhe Postribës (shtator 1946) u shoqërua me pushkatime pa gjyq, dhunë dhe internime në masë të popullsisë së këtyre krahinave. Për më tepër *shih*: AQSH, F. 14/AP (Str), V. 1945, D. 215. Radiogramet të Enver Hoxhës drejtuar Mehmet Shehut në të cilat i kërkohet që të ndërpresë pushkatimet dhe për të gjithë dënimet kapitale të kërkojë mendimin e drejtuesve të lartë të PKSH. Dhuna e vitit 1949 në zonën e Mirditës që shoqëroi vrasjen e drejtuesit komunist Bardhok Biba ishte një nga më sinjifikantet në lidhje me sjelljen e qeverisë komuniste ndaj kësaj popullsie. Për më tepër *shih*: AQSH, F. 14/AP (Str), V. 1949, D. 172, fl. 20-23. Relacion mbi situatën në Mirditë pas vrasjes së sekretarit I të komitetit të partisë, Bardhok Biba.

gjithashtu edhe një procesi të fuqishëm propagande dhe indoktrinimi, e cila ishte bashkudhëtare e dhunës. Madje, që grupet e agjitacionit të kishin më shumë sukses, veçanërisht në zonat malore si në veri ashtu dhe në jug të vendit, sektori i agjitpropit pranë KQ të PKSH hartoi një udhëzues mbi zakonet dhe traditat që agjitorët partiakë duhet të kishin parasysh. Në propagandën zyrtare lavdëroheshin vlerat e malësorëve si: trimëria, besa, mikpritja, por njëkohësisht viheshin në dukje nevoja për të ndryshuar disa zakone të vjetra dhe prapanike, të cilat ishin mbajtur gjallë vetëm për ta mbajtur të nënshtruar dhe të varfër popullsinë e këtyre zonave. Veçanërisht pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945, filluan të goditeshin krerët e veriut, si fanatikë, injorantë dhe shkaktarë të prapambetjes ekonomike e arsimore të kësaj popullsie, si dhe të shitur tek të huajt.

Një kategori tjetër e konsideruar “armiqtë e popullit” ishin dhe shtresat e pasura të popullsisë (tregtarët dhe pronarët e mëdhenj të tokave), si dhe intelektualët që kishin studiuar jashtë. Që gjatë luftës propaganda e PKSH/FNÇ kishte përfshirë premtimet për ndryshime të thella me karakter social. Gjatë viteve 1944-1945, para zgjedhjeve të 2 dhjetorit për Asamblenë Kushtetuese, Qeveria Provizore nuk e pranonte haptazi se regjimi që po vendosej në vend bazohej në modelin sovjetik. Të konsideruar në mbledhje të ndryshme partiake si kundërshtarë natyralë të regjimit të ri, ai u tregua i kujdesshëm për t’ia “vizatuar” popullit figurën e secilës prej kategorive të kundërshtarëve politikë. Më 26 dhjetor 1944, Ministria e Financave u dërgoi një qarkore të gjitha Këshillave Nacionalçlirimtarë të qarqeve që të formonin sa më parë komisione për caktimin e fitimeve të luftës. Anëtarët e komisionit kërkoheshin të ishin “njerëz të vendosur të lëvizjes”, të cilët “njihen në popull për drejtësinë dhe paanësinë e tyre”, si dhe “njohin tregun e tregtarët dhe fitimet e tyre”<sup>22</sup>. Qarkorja kujdesej t’u kujtonte komisioneve se duhet të shënonin fitimet që janë bërë prej 7 prillit 1939, e këtej dhe jo pasurinë që ka pasur përpara kësaj date<sup>23</sup>. Si në rastin e tregtarëve e industrialistëve, ashtu dhe ndaj pronarëve të mëdhenj të tokave, ndonëse qëllimi final ishte të eliminoheshin si shtresë e popullsisë, dhuna e ushtruar ndaj tyre në fillim ishte selektive. Drejtuesit e lartë të PKSh kishin ende nevojë të legjitimonin pushtetin e tyre me anë të zgjedhjeve. Ata kishin nevojë që të mos e shpallnin hapur llojin e regjimit që synonin të vendosnin. Kështu, si për tregtarët e mëdhenj, ashtu dhe për pronarët e mëdhenj të tokave sulmi nuk ishte menjëherë në emër të luftës së klasave. Ajo u

---

<sup>22</sup>AQSH, F. 267/APL, V. 1944, D. 4, fl. 5. Qarkore e Ministrisë së Financave për gjithë këshillat nacionalçlirimtarë të qarqeve, 26 dhjetor 1944.

<sup>23</sup>AQSH, F. 267/APL, V. 1944, D. 4, fl. 5. Qarkore e Ministrisë së Financave për gjithë këshillat nacionalçlirimtarë të qarqeve, 26 dhjetor 1944.

drejtohej individëve që nuk u bindeshin urdhrave dhe ligjeve të pushtetit të popullit, jo të gjithë klasës së tregtarëve, industrialistëve dhe pronarëve të tokave.

Menjëherë pas fitores në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, situata ndryshoi. Më 11 dhjetor 1945, në mbledhjen e Byrosë Politike vija politike e Frontit Demokratik u konsiderua oportuniste. Drejtuesit më të lartë të PKSH e quajtën gabim zgjerimin e Frontit me elementë borgjezë, tregtarë, klerikë e intelektualë borgjezë<sup>24</sup>. Njëkohësisht në këtë mbledhje u konsiderua oportuniste edhe qëndrimi që ishte mbajtur ndaj Aleatëve Perëndimorë. Vetëm dy muaj më vonë, Plenumi V i KQ të PKSH përcaktoi luftën e klasës si filozofinë bazë ku do të mbështeteshin marrëdhëniet ekonomike dhe sociale të shoqërisë shqiptare<sup>25</sup>. Pikërisht në këtë moment filloi lufta e ashpër për të marginalizuar dhe më pas për ta eliminuar plotësisht pronën dhe pronarët në vend. Masat administrative të marra kundër shtresave të pasura dhe intelektualëve si: shtetëzimi i ndërmarrjeve, largimet nga postet administrative dhe shkollat të gjithë individët që i përkisnin këtyre shtresave u përshkallëzuan masa policore, dënime dhe dhunë të drejtpërdrejtë. Gjatë vitit 1946-1947 një numër rekord procesesh gjyqësore u zhvilluan ndaj individëve të kategorive të ndryshme: klerikë, pronarë tokash, tregtarë, intelektualë, të gjithë të akuzuar se vepronin kundër interesave të popullit. Gjuetia e shtrigave u shtri edhe ndaj personave antifashistë të cilët kishin pasur kontribut gjatë rezistencës kundër pushtuesit.

Dënimi i Rexhep Plakut është një nga më sinjifikativët në numrin e madh të dënimeve për shkak të kundërshtimit të Reformës Agrare, pasi ai kishte qenë një nga organizatorët kryesorë të rezistencës kundër pushtuesit në zonën e Konispolit, drejtues i njëjësive ushtarake që vepronin nën siglën e FNÇ dhe anëtar i Shtabit të Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastër. Pavarësisht kësaj, kontributi i tij në luftë nuk e shpëtoi nga dënimi i gjatë 30-vjeçar<sup>26</sup>. Po kështu u dënuan të tjerë pjesëmarrës në rezistencë, por që nuk mbështesnin formën e regjimit si: ish ministri i Arsimit, Gjergj Kokoshi, deputetët Riza Dani, Shefqet Beja, Selaudin Toto, Hysni Peja, Kostë Boshnjaku, Kol Kuqali etj.

Ndërsa dhuna shërbente për frikësimin e kundërshtarëve politikë, të gjitha proceset shoqëroheshin nga makina gjigante propagandistike që ishte krijuar, me të cilën kërkoheshin dhe sigurohej mbështetja e masës së gjerë të popullit. “Ju i patë, - i drejtohej Enver Hoxha banorëve të Vlorës më 20 shtator 1947, - veprat e atyre që u gjykuan në Tiranë, Abdyl Kokoshit, Sheh

---

<sup>24</sup>AQSH, F. 14/AP-organet udhëheqëse, V. 1945, D. 4, fl. 1-2. Shënime të mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH, 11 dhjetor 1945.

<sup>25</sup>Po aty.

<sup>26</sup>Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, Fondi Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, nr. 1/Dosjet Gjyqësore dhe Hetimore, V. 1946, D. 1070. Procesverbali i hetimit dhe gjyqimit të Rexhep Plakut, tetor-dhjetor 1946.

Karburnarës dhe tradhëtarëve që të lidhur me Ali Këlcyrën dhe Mit'hat Frashërin u përpoqën të riorganizonin Ballin dhe Legalitetin. Nën drejtimin direkt të amerikanëve, tradhëtarët sabotuan, bënë atentate, u përpoqën të rrëzonin regjimin e popullit”. Jo më kot, të gjitha proceset si pjesë kryesore të akuzave kishin bashkëpunimin e të akuzuarve me agjencitë të huaja amerikane, britanike, italiane apo greke. Këto i shndërronin kundërshtarët politikë në “armiq të popullit”, si dhe krijonin psikozën e pasigurisë për pavarësinë e sovranitetin e vendit. Duke binomizuar atdheun me partinë, njerëzit e zakonshëm shtrëngonin radhët me regjimin dhe kundërshtarët e tij izoloheshin gjithnjë e më shumë. Retorika çohet dhe më tej dhe merr karakter tërësisht klasor, “çfarë do të presë populli nga familja e Kokoshit, e Koculit, e Risilisë, e Sharrës, e Peshkëpisë”<sup>27</sup>. Qartazi faji i kësaj kategorie kundërshtarësh nuk mund të ishte individual. Për regjimin ata ishin kundërshtarë *sui generis* dhe si të tillë duheshin trajtuar për të mos i lënë të ngrenë kokë. Ata nuk do të pajiseshin me kartat e Frontit, duke i përjashtuar praktikisht nga jeta shoqërore.

Më 1950, regjimi thelloi diferencimin midis “popullit” dhe “armiqve” të tij. Stigmatizimi i tyre nuk do të prekte vetëm të tashmen, por edhe të ardhmen e tyre, madje edhe të fëmijëve të tyre. Në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH të 1 prillit 1950 u shqyrtua çështja e shpërndarjes së bursave të studimit. Sipas E. Hoxhës, “duke qënë se gjatë vjetëve të kaluara nuk ka patur një kriter të përcaktuar për dhëniet e bursave të jashtme, ka ndodhur që të përfitojnë bursë dhe elementë me qëndrim të keq politik, të shtresave të pasura, dhe të prekura nga reformat ekonomike të pushtetit tonë ... gjë që ka sjellë si konsequencë më 1949-1950 prerjen e një numri bursash për qëndrim të keq politik”<sup>28</sup>. Në bazë të kësaj platforme u vendos që bursat do të përfitoheshin më parë nga ish pjesëmarrësit në LNÇ, pastaj anëtarët dhe kandidatët e PPSH, dhe së fundi ata me rezultate të mira në mësim. Në të njëjtën kohë, u mor vendimi që administrata shtetërore të spastrohej nga elementët “reaksionarë”. Biografia filloi të shndërrohet në një barrë dhe në një pengesë të pakapërcyeshme për të gjithë ata individë që regjimi kishte vendosur t’i vizatonte si “armiq të popullit”.

---

<sup>27</sup>Enver Hoxha, *Vepra* 3, Tiranë: 8 Nëntori, 1979, f. 190.

<sup>28</sup>AQSH, F. 14/AP-organet udhëheqëse, V. 1950, D. 83, fl. 27. Platformë e Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi kriteret për akordimin e bursave për jashtë shtetit, 1 prill 1950.

## **Gjon Berisha - Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë**

### **Persekutimi i klerit katolikë nga Kosova që shërbeu në Shqipëri gjatë regjimit komunist.**

*Në listën e gjatë të martirëve të Kishës Katolike të persekutuar, burgosur dhe vrarë ndodhen edhe klerikë katolikë nga Kosova, të vrarë nga diktatura komuniste me arsyen se kryenin shërbesa në Shqipëri apo “ishin të lidhur me shërbime të huaja”. Shumica e tyre, përveç shërbesave fetare, kontribuuan në arsim, kulturë dhe në themelimin e organizata nacionaliste. Të tillë klerikë të lindur në Kosovë, e që shërbyen në Shqipëri, ishin edhe: At Serafin Koda, At Anton Muzaj, Dom Shtjefën Kurti, etj. Të gjithë këta gjeten vdekjen nga regjimi komunistë, përmes pushkatimit, internimit në kampet e përqendrimit me vite të tëra, dhe disa në pleqëri nga plagët dhe nga vuajtjet në burgje.*

*Në këtë punim, mëtojmë që përmes dokumenteve, të dala nga institucionet e shërbimit të shtetit, e që tani gjenden në Arkivin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (më tej: AIDSSH), të sjellim disa të dhëna, të njohura pjesërisht apo të panjohura mbi arsyet, shkaqet dhe “arsyetimet” që u bënë nga autoritetet e kohës me rastin e internimit apo ekzekutimit të tyre.*

Me marrjen në dorë të pushtetit në Shqipëri nga partia Komuniste, qëndrimi që kishte Kisha Katolike ndaj pushtetit të ri, nxiti një kalvar të paparë e të pa merituar ndaj saj nga viti 1945 për të vazhduar deri në fillim të viteve 90-ta të shek. XX. Për këtë arsye, kleri i saj u akuzua për komplete kundër qeverisë dhe u morën në shënjestër, duke e rritur pakënaqësinë e popullsisë ndaj pushtetit. Përkeqësimi do të shkonte deri në atë masë, sa që kleri katolik u cilësua si “bashkëpunëtorë” në shërbim të vendeve të huaja. Ky kategorizim, i jepte të drejtën Frontit Demokratik, të drejtuar nga Partia Komuniste e Shqipërisë, që të ketë si pretekst për të filluar përndjekjet ndaj klerit dhe Kishës Katolike.

Në Arkivin AIDSSH kishim fatin të kemi në dorë dosjet gjyqësore të tyre, të cilat janë voluminoze, të mbushura me “vendime në emër të popullit” e “dëshmi” të shumta të fabrikuara që binin mbi barrën e të akuzuarve.

Mirëpo, siç dihet, klerikët padyshim qenë patriotë të singertë, me opinione antikomuniste dhe me një besnikëri ndaj Kishës së përbotshme dhe atdheut. Kështu, ndjehej se fryma e përgjithshme e Kishës Katolike në Shqipëri, dhe gjithashtu pjesa më e madhe e

besimtarëve të saj, nuk e pranuan vullnetarisht komunizmin.<sup>29</sup> Që klerikët qenë njëzëri kundër sistemit komunist ateist dhe kundër përcaktimit të Shqipërisë përkrah bllokut lindor, tregon edhe fakti se ata ishin të angazhuar privatisht në organizata të ndryshme politike, si: partia Demokristiane, Partia e Legalitetit, Partia e Ballit Kombëtar, të cilat ishin kundër Partisë Komuniste.

Këtë komunitet, pushteti i ri po e shihte si pengesë, meqë ishte, pothuajse i vetmi zë që mund të dëgjohej këtu në Shqipëri ndër qarqet e Evropës Perëndimore, ku vendosej fati i kombeve.

Në këtë fushatë ndjekje e persekutimi, nuk u kursye as kleri dioqezan apo shekullar, nuk u mor në konsideratë as kontributi i tyre, në kulturë e arsim që ishte dhënë deri në atë kohë. Nuk u përfill as veprimtaria e tyre kombëtare gjatë gjithë historisë së ekzistimit të tyre. Edhe me keq, nuk u morë në konsideratë edhe fakti se një pjesë e tyre ishin të përndjekur në vendlindjen e tyre në Kosovë nga regjimi komunist jugosllav.

Komunizmi, me sa duket, në përgatitjen e meshtarëve shihte potencialin e vërtetë të kundërvënies ndaj një ideologjie të re, të panjohur më parë, por që kërkonte të imponohej përmes dhunës së egër të diktaturës ateiste.<sup>30</sup> Në realitet, gjuetia ndaj klerit u ndërmor për shkak se ata nuk përkrahën verbërinë e Enverit për tu bërë koloni e armiqve të vjetër sllav, por përkrahnin projektin anglez për një Shqipëri demokratike dhe properëndimore, siç theksonte, në të kohë, delegati Apostolik Leone Nigris,<sup>31</sup> ku në gjirin e saj, sipas disa mendimeve britanike, më një plebishit do të gjendej edhe Kosova.<sup>32</sup>

Në mesin e klerit që patën fatin tragjik të persekutimit nga regjimi komunistë kishte edhe të tillë që ishin nga Kosova, të cilët po shërbenin në Shqipëri. Në mesin e tyre, ne kemi marrë për trajtim tri portrete klerikësh, duke u bazuar në dokumentet e AIDSSH: At Serafin Koda (1893-1947), At Anton Muzaj (1921-1948) Dom Shtjefën Kurtin (1898-1971), dhe të cilët edhe janë objekt i trajtimit të punimit tonë.

Si kulminacion i armiqësisë së pushtetit komunist krijuar ndaj klerit katolik, ndër viktimat e para që u mbytën nga ata që kishin ardhur nga Kosova për të shërbyer në Shqipëri ishte At Serafin Koda.

---

<sup>29</sup> Zef Mirdita, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, Drita & Misioni Katolik Shqiptar në Zagreb, Prizren-Zagreb: 1998, f. 231; 320.

<sup>30</sup> Z. Mirdita, *Krishterizmi ...*, f. 230.

<sup>31</sup> Nik Ukgjini, *Kisha Katolike në trevat shqiptare (shek.XI-deri sot)*, Tiranë: Shoqata e Jezuitëve, 2016, f. 251.

<sup>32</sup> Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, Tiranë: Toena, 2014, f. 155, 167.

At Gjon Serafin Koda (1893-1947), i biri i Gasprit dhe nënës Ananijeta, u lind më 25 prill 1893, në Janjevë të Kosovës, në një familje me tradita fetare, patriotike e atdhetare, familje e Malësisë së Karadakut, zonë e njohur për heroizëm dhe atdhedashuri.

Nga emri i lindjes, Gjoni ishte edukuar që në fëmijëri me përkushtim ndaj atdheut. Studimet e larta i mbaroi në Austri. Sipas traditës së Fretërve, mori emrin Serafin. Meshën e parë e kremtoi më 30 Korrik 1925. Më pas, Frati nga Janjeva do të vijonte në udhën e bariut duke shërbyer edhe ndër vise të tokës mëmë, Shqipërisë, si në: Dushman, Shalë, Prekal, Bushkash, Vukël, Kelmend dhe, së fundi, u caktua në Dioqezën e Sapës së Lezhës. Kur Atë Serafini mbërriti në qytetin e vjetër të Lezhës, me atë zhgunin Françeskan e një konop lidhur mes trupit, ai meditonte me syrin e një njeriu që po i shkelte për herë të parë ato treva të panjohura për të. Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore dhe me vendosjen përfundimisht të regjimit komunist në Shqipëri, Atë Serafini dhe sivëllezërit e tij françeskanë, do të kalonin përmes një *kalvari* dhembjesh, nga krimet më të paskrupullta të regjimit, nëpërmjet Sigurimit policor famëkeq shqiptar. Arrestimi dhe burgosja Serafin Koda ndodhi deri sa ishte famullitar në Lezhë. Kjo ndodhi pasi punonjësit e sigurimit më parë bënë një takim, për të diskutuar rreth problemeve ekonomike, me Fretërit e Kuvendit, por në fakt, aty oficerët e sigurimit u aktivizuan sikur ndonjëherë për t'i dhënë kuptim politik. Ashtu të lidhur e veçojnë në një nga dhomat e Kuvendit, duke e torturuar me metodat më çnjerëzore, psikologjike dhe fizike, me alibi të sajuara, si: *“një ndër kundërshtarët e regjimit komunist dhe për rrëzimin e pushtetit të tyre”*. I kërkonin bashkëpunim, për të dëshmuar kundër klerikëve të tjerë, që Sigurimi i Shtetit të arrestonte inteligjencën e klerikëve. Ishte maji i vitit 1947, në moshën 54 vjeçare.

At Serafini ju nënshtrua pyetjeve nga hetuesit e Sigurimit të Shtetit, dhe torturave nga me çnjerëzoret. Të tre hetuesit që e kishin marrë në pyetje, u lëshuan mbi Atë Serafinin, duke e torturuar e rrahur barbarisht, derisa ai humbi ndjenjat. Ashtu i shtrirë në dysheme, i gjakosur, i dërmuar dhe i pavetëdijshëm, njëri nga hetuesit i fut duart në fyt, për ta mbytur meshtarin. Nga fyti filloi të rridhte gjak. Torturat vazhdojnë edhe për disa orë të tjera. Kur ata u larguan Atë Serafini po jepte shpirt në çimenton e ftohtë të dhomës. Nga mesnata e datës 11 maj 1947, Atë Serafini, i rënduar nga plagët, dha shpirt. Vëllezërit e tij klerikë e murrën për ta çuar tek infermierja.

Infermierja e atyre viteve Marie Ndoja, e cila mjekonte Atë Serafinin në momentet e agonisë së plotë, bëri të pamundurën ta shpëtonte, por plaga e madhe e dëmtimit të venave e rrjedhja e gjakut nga fyti ia morën jetën. Maria e varrosi me mjaft mundim e në fshehtësi të



plotë meshtarin trim, poshtë një ulliri, që ishte në oborrin e Kuvendit të Fretërve, në kodrën që populli e thërriste "Kisha e Dom Lleshit".<sup>33</sup>

At Anton Muzaj (1921-1948) u lind në Vërnakollë të Kosovës, më 15 maj të vitit 1921 nga prindërit Dedë dhe Dile. Shkollën fillore e kreu në Prizren, ndërsa të mesmen në Seminarin Papnor të Shkodrës. Gjatë studimeve në Seminar, pati fatin të takojë dhe mësojë nga mësimsdhënës italian dhe shqiptarë nga të cilët u pajis me një kulturë të lartë. Në vitin 1938 me autorizimin e argjipeshkvit të Shkodrës, u dërgua në Romë në *Kongregatën Propaganda Fide* ku dhe studioi teologji dhe filozofi në Universitetin Gregorian, të cilin e përfundoi në vitin 1945. Gjatë studimeve në Romë, më 1944 u vizitua nga argjipeshkvi monsinjor Thaçi, ku sipas procesverbalit gjyqësor ishte njoftuar mbi formimin e partisë së Balli Kombëtar dhe partisë Nacionalçlirimtare.<sup>34</sup> U shugurua meshtar më 19 mars 1944. Në vitin 1946 u kthye në atdhe. Pas arrestimit të Dom Tomë Lacajt, e zëvendësoi këtë si sekretar të Argjipeshkvisë së Shkodrës. Sipas aktit të gjykimit lëshuar në Shkodër, Muzaj, ishte arrestuar më 19 maj të vitit 1947 "*Për fajë kundër Shtetit dhe Popullit*", kurse të nesërmen, më 20 maj, me urdhër të prokurorit publik, sipas ligjit nr.372, datë 12.XII.1946, iu lëshua urdhri për burgosjen e tij për kohë të caktuar.<sup>35</sup>

At Anton Muzaj ishte dëshmitar dhe bashkorganizator në organizimin e ceremonisë së varrimit të argjipeshkvit të Shkodrës, Dom Gaspër Thaçit. Vdekja e argjipeshkvit imzot Gaspër Thaçit në Shkodër më 25 maj 1946, kishte vënë në alarm gjithë autoritetet e regjimit komunist. Nga regjimi, nën urdhrat e Koçi Xoxes, u bënë përgatitje të hollësishme për tu sabotuar pjesëmarrja masive e njerëzve në funeralin e lamtumirës së argjipeshkvit. Këtë atmosferë sabotimi e argumentojnë një sërë dokumentesh të Komitetit Qendror, ku janë urdhra dhe raportohen detaje për funeralin e mbajtur në Shkodër më 29 maj 1946. Sipas një dokumenti të Komitetit Qendror të lëshuar një ditë më herët, më 28 maj 1946, përveç tjerash thuhej: "*Nesër në mëngjes në ora tetë bëhet salikimi i trupit të tij [argjipeshkvit të Shkodrës]. Më këtë rast ata do të mundohen që ta bëjnë funeralin sa më madhështor. Kanë përgatitje të thërrasin sonte gjithë rininë katolike sigurisht për funeralin e nesërm. Marrim informata se na populli katolik janë duke përgatit kurora, po kështu edhe ndër lagje. Do të thirren edhe nga krahinat si edhe nga ...prefektura si Durrësi e Tirana. Ata kanë kërkuar nga pushteti bandën muzikore e policë. Nuk është çudi që famullitë ndër krahina të bëjnë agjitacion që të vijnë së bashku me popullin. Këtu ata kanë favor se nesër është ditë tregu dhe ora tetë është e favorshme që një pjesë e*

<sup>33</sup> Gj. Turmalaj, "Atë Serafin Konda: Mësojeni kohën të mos hajë bijtë e vetë", në: *Jeta Katolike*, nr. 1 (2009), f. 27-29.

<sup>34</sup> Arkivin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (*më tej: AIDSSH*), Dosja nr. 1303, fl. 3.

<sup>35</sup> *AIDSSH*, Dosja, nr. 1303, fl. 6.

popullit është katolikë si fshatar, zanatçi e tregtar përpara se të filloj punë të shkoj atje, kështu që një pjesë e tregut mund të mbyllet. Këtë përcjellje madhështore do të mundohen ta shfrytëzojnë shumë duke treguar lidhjen në popull, kundër nesh... Ne do të mundohemi ta sabotojmë nga poshtë...”.<sup>36</sup> Funerali i tij, ku morën pjesë mbi 1200 vetë, shihej si një rrezik i madh për regjimin komunist. Për këtë organizim dhe për numrin e madh të pjesëmarrësve u akuzua edhe At Anton Muzaj. Sipas akt-akuzës, Muzaj, gjoja kishte organizuar nxënësit që të lëshojnë mësimin dhe të marrin pjesë në këtë ceremoni. Megjithatë, ai në procesverbalin e gjykatës, e kishte mohuar kategorish tu kishte bërë thirrje nxënësve të dalin në rrugë, por e pohonte që së bashku me dom Tom Lacin, dom Mark Thaçin, dom Shtjefën Kurtin dhe dom Anton Zogaj-n, kishin marrë pjesë në organizimin sa më të mirë të funeralit të argjipeshkvit. Në mohimin e akuzës, ai deklaronte, se: “nuk është e vërtetë se unë ju kamë thënë të rinjve që të iknin nga shkolla nëse nuk ju lejojnë të merrni pjesë në këtë funeral. Vetëm ditën e funeralit kemi parë rinin studentore duke arrit e bashkëngjitur grupit”, ai po ashtu pranon se; “ishte shprehur në mënyrë të nënkuptueshme keq për arrestimin e klerit, duke i bërë thirrje popullit që të jetë i qëndrueshëm”.<sup>37</sup> Në të vërtetë, At Antoni ishte angazhuar edhe në sigurimin e korit të françeskanëve nën udhëheqjen e At Filip Mazrekut, që të marrin pjesë në meshën lamtumirës të argjipeshkvit, imzot Gaspër Thaçit.<sup>38</sup>

Më 6 janar 1948, së bashku me At Donat Kurtin dhe Dom Mark Hasin, At Muzaj, para trupit gjykues, sipas akt-akuzës akuzohet, se: “ka punue për përgatitur fushë të favorshme fashizmit italian në vendin tonë; ka tërhequr subvencione në të holla nga përfaqësuesit e imperializmit italian kundrejt shërbimeve që bënin në interes të okupatorit; pas çlirimit nën drejtimin e organizatës demokristijane dhe të krerëve fashistë klerikale ka punuar për rrëzimin e pushtetit me forcë...”.<sup>39</sup> Pas shumë torturash, u lirue. Vdiq shumë i ri, në moshën 29 vjeçare, në ndërtesën e Argjipeshkvisë së Shkodrës, në pranverë të vitit 1948, nga torturat që kish marrë në qeli.

Atë Zef Pllumbi, në librin e tij të mirënjohur “*Rrno vetëm për të tregue*” e përshkruan kështu takimin fundit me të, para një gjykate, që dënonte 12 vetë, të gjithë klerikë. Ndërmjet tyre, tre me pushkatim e dy me burgim të përjetshëm:

---

<sup>36</sup> Arkivi Qendror i Shtetit (*më tej*: AQSH), F. 14/AP, V. 1946, D. 50, fl. 63-64.

<sup>37</sup> AIDSSH, Dosja, nr. 1303, fl. 5.

<sup>38</sup> Po aty, fl. 5.

<sup>39</sup> Po aty, fl. 11.

*“Kur hyni trupi gjykues, u çuen të gjithë në kambë. Edhe na, përveç dom Anton Muzajat.... U lexue prej kryetarit vendimi i formuluem gjatë e stërgjatë, me ato provat bindse, që zakonisht bien të gjithë xhelatët e botës. Prova bindëse, që nuk bindin askënd...*

*... Mbas shpalljes së dënimit, filluen përshndetjet me ata, që niseshin për një jetë tjetër. Edhe përshëndetjet me dom Anton Muzajn kishin diçka të jashtëzakonshme. Vërtetë se vendimi i gjyqit ishte për lirim, por ai vetë e të gjithë, e dijshim se lirimi i tij ishte vetëm qiella”.*<sup>40</sup>

**Dom Shtjefën Kurti** (1898-1971), i cili ishte famullitar i Tiranës, para se të bëhej vetë viktime e regjimit, ishte dëshmitar i këtyre salvimeve. Ai, kishte marrë përsipër si obligim shpirtëror të kujdesej për të burgosurit, klerikë dhe besimtarët katolikë, të cilët, këta të fundit, sipas Kurtit, ishin më se njëqind vetëm në burgun e Tiranës, çfarë dëshmon dokumenti i datës 8 gusht 1945 dhe 24 dhjetor 1945. Sipas këtij dokumenti dom Shtjefni kishte dërguar një letër Drejtorisë së burgut ushtarak e civil të Tiranës, ku kërkonte që rrobat e siguruara nga ai, të shkojnë në dorë të burgosurve për Krishtlindje.<sup>41</sup> Deri sa ishte famullitar, kërkoi nga Ministria e Drejtësisë që të kenë të drejtën të celebrosin meshë private në burg, për të cilën, në letrën nr.906, datë 30 qershor 1945, jep për përgjigje pozitive duke përfshirë këtu edhe P.Anton Harapin.<sup>42</sup> Dom Shtjefni, në kërkesën e tij shkon edhe më tej, dhe përmes një letre që mbanë datën 2 qershor 1945, kërkon me këmbëngulësi nga komanda e përgjithshme N.Ç. shqiptare, që meshtari të jetë i pranishëm çdo herë që caktohet gjyqi politik për vdekjen e një besimtari, në mënyrë që tu jepej ritet e ngushëllimet e fesë.

Por, jo vetëm që nuk arriti tu delte në ndihmë sa dëshironte të burgosurve, por ai, shumë shpejtë do të bëhet edhe vetë viktimë e kësaj ndërmarrjeje komuniste.

Dom Shtjefni u lind në Prizren të Kosovës me 24 dhjetor 1898, në një familje patriotike të njohur kosovare, si fëmija i 6 prej 9 fëmijëve sa kishin prindërit Jak dhe Katarina Kurti.<sup>43</sup> Pasi mbaroi shkollën fillore në Ferizaj, vazhdoi Seminarin e Shkodrës. Sipas deklarimit të tij, para organeve gjyqësore, familja Kurti, ishte një familje e pasur tregtare, e cila merrej, kryesisht me tregtinë e drithit, Gjatë Mbretërisë SKS, pasuria e tyre ishte sekuestruar dhe rrënuar, dom Shtjefni jetoj në Ferizaj. Në qytetin Ferizajt e kreu shkollën fillore, kurse me kërkesën e argjipeshkvit të Shkupit, gjatë viteve 1914-1918 mbaron gjimnazin në shkollën e jezuitëve në Shkodër. Në vjeshtën e vitit 1918 shkon në Universitetin Shtetëror të Insbrukut (Innsbruck) për të studiuar teologjinë. Aty qëndroi për një dhe pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore,

<sup>40</sup> Zef Pllumi, *Rrno vetëm për të tregue*, Tiranë: 2006, f. 146-147.

<sup>41</sup> *AQSH*, F. 131, V. 1945, D. 6, fl. 8.; N. Ukgjini, *Kisha Katolike ...*, f. 251-252.

<sup>42</sup> *AQSH*, F. 131, V. 1945, D. 6, fl. 6; N. Ukgjini, *Kisha Katolike ...*, f. 252.

<sup>43</sup> *AIDSSH*, Dosja, nr. 2336/I, fl. 21.

fiton të drejtën për t'i vazhduar të njëjtat studime për teologji në Romë, duke i përfunduar me rezultate mjaft të mira dhe duke zotëruar pesë gjuhë të huaja, mes të cilave latinishten, gjermanishten dhe frëngjishten. Pas përfundimit të studimeve, megjithëse i propozohet të punojë në Selinë e Shenjtë, ai e refuzoi këtë ofertë, meqë dëshironte t'i shërbente me devotshmëri popullit të tij. Kështu, pasi shugurohet meshtar në Romë, më 13 maj 1921, fillimisht kthehet si priftë dhe sekretar i argjipeshkvit të Shkupit për 5-6 muaj, kurse pas transferimit të argjipeshkvit në Shkodër, dom Kurti kthehet në nënprefekturën e Gjakovës, në famullinë e Novosellës, në kohë shumë të vështira për popullin shqiptar të Kosovës.<sup>44</sup> Presioni dhe mizoritë ishin intensifikuar nga klika shoviniste serbe, prandaj edhe Dom Shtjefni bashkë me vëllezërit e tij, Dom Luigj Gashin dhe Dom Gjon Bisakun punonin ditë e natë për të mbrojtur popullin e shumëvujtur shqiptar të Kosovës nga sulmet shoviniste serbe.

Në Kosovë kaloi për rreth tetë vjet një jetë të re aktive si meshtar, baritor dhe fetar dhe shpeshherë vuri jetën në rrezik. Veprimtaria e tij në dobi të fesë dhe patriotizmit ra shpejt në sy të autoriteteve serbe, të cilat filluan kërcënimet.

Gjatë viteve që punoi në Kosovë, dom Shtjefën Kurti nuk reshti së punuari, veç të tjerash, edhe për mbledhjen e shumë materialeve dhe dëshmimeve mbi keqtrajtimet, Torturat dhe dhunën e ushtruar mbi popullsisë shqiptare të Kosovës nga sistemi diktatorial serb. Materialet e mbledhura janë sistemuar dhe radhitur në formë peticione e prej tyre lindi memorandum i tre klerikëve të shquar, drejtuar OKB-së, me 5 maj 1930, me seli në Gjenevë. Ky memorandum ishte konceptuar në 6 kapituj: Mbrojtja e jetës, mbrojtja e lirisë, e drejta e pronës, e drejta e përdorimit të gjuhës, e drejta e shkollimit dhe e drejta e ushtrimit të fesë për të gjithë shqiptarët pa dallim.<sup>45</sup>

Si rezultat i veprimtarisë së tij për çështjen kombëtare, dom Shtjefni u detyrua të largohej më 2 janar 1930 të arratisë nga vendlindja e tij, Kosova, për në Shqipëri. Pas ardhjes në Shqipëri, në vitin 1930, menjëherë filluan punën e meshtarëve, dom Shtjefën Kurti fillimisht u emërtua famullitar në Shën Premte të rrethit të Krujës, ku qëndroi pak kohë, vetëm dy vjet. Në nëntor të vitit 1932 shkon famullitar në fshatin Gurëz, ku qëndroi deri në vitin 1937, kurse nga prilli i vitit 1938 kaloi famullitar në Tiranë.<sup>46</sup> Por nuk do të kalonte shumë kohë dhe dallgët e historisë, të gatuar nga sistemi totalitar, do ta përplasnin dom Shtjefën Kurtin në brigjet e

---

<sup>44</sup> AIDSSH, Dosja, nr. 2336/I, fl. 21-22.

<sup>45</sup> "The situation of the Albanian minority in Yugoslavia Memorandum presented to the League of Nations by Gjon Bisaku, Shtjefën Kurti & Luigj Gashi (1930)", *Gathering Clouds The roots of ethnic cleansing in Kosovo. Early twentieth-century documents compiled, translated and edited by Robert Elsie*, Pejë: Dukagjini, 2002, pp. 22-45.

<sup>46</sup> AIDSSH, Dosja, nr.2336/I, fl.22.

dhunës, torturës çnjerëzore e më vonë, në qelitë e burgut komunist. Kjo ndodhi me 27 tetor 1946, ku pas rrethimit të famullisë, forcat e Sigurimit e arrestojnë me akuzën e sajuar: *“Bashkëpunëtor i organizatës terroriste të Sami Qeribashit, akuzohet për agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor”*. Në bazë të kësaj akuze, me vendim të Gjykatës ushtarake të Tiranës, më 17 prill 1947 dënohet më 20 vjet heqje lirie me punë të detyruar si dhe humbjen e të drejtave elektorale për 5 vite.<sup>47</sup> Ky arrestim erdhi si rezultat i mospranimit të një thirrjeje të bërë nga diktatori E.Hoxha, që dom Shtjefni të merrte në dorë drejtimin e fesë katolike dhe ortodokse në Shqipëri, me kusht që të hiqte dorë nga lidhjet me Vatikanin. Refuzimi i dom Shtjefnit ishte kategorik, ai u tha: *“Unë nuk mundem me tradhtue idealin tim, siç keni tradhtua ju Kosovën, dhe tani doni me i shit Titos Shqipërinë”*.<sup>48</sup>

Pas kësaj përgjigje, arrestimi nuk do të vononte. Kështu, në moshën 50-vjeçare detyrohet të provojë qelitë e ftohta të burgut. Fillimisht për të shfryrë urrejtjen ndaj tij, Gjykata Ushtarake e Garnizonit të Tiranës e dënoi me vdekje, por dënimi iu kthye në 25 vjet burg. U transferua në burgun e Burrelit.

Pas 17 viteve privim lirie, më 2 maj të vitit 1963, lirohet nga qelitë e burgut, për t’u ndjerë përkohësisht i lirë. Fillimisht shkoi në famullinë e Tiranës, ku ndenji pak kohë me Dom Mark Dushin, pastaj u kthye përsëri në kishën e Gurëzit. Kur në vitin 1967 u mbyllën kishat dhe xhamitë dhe vendi u shpall vend ateist, dom Shtjefni, fillimisht shkoi te vëllai i tij Kolë Kurti në Gurëz dhe pastaj u detyrua të punojë si punëtor në kooperativën bujqësore të fshatit ku kishte shërbyer një jetë të tërë. Por edhe jeta e re prej kooperativisti zgjati vetëm 3 vjet. Këtë periudhë e shfrytëzoi për të pagëzuar fëmijë fshehtas dhe për të bërë propagandë në besimin tek Zoti dhe urrejtjen ndaj sistemit totalitar.<sup>49</sup>

Më 5 qershor të vitit 1970 merret vendimi, kurse më datë 11 qershor, Organet e Punëve të Brendshme dhe të Prokurorisë së rrethit të Krujës e arrestojnë për herë të dytë dom Shtjefën Kurtin,<sup>50</sup> ku detyrohet t’u kthehet qelive të burgut. Arrestohet në fshatin Gurëz, të Kurbinut, me “konstatimin” e hetuesit, se: *“ka agjituuar e propaganduar për minimin e dobësimin e pushtetit popullor, krim ky i parashikuar nga Neni 73/I-rë i Kodit Penal”*. Me rastin e arrestimit, iu bastis shtëpia në Gurëz dhe iu konfiskua e gjithë pasuria që kishte.<sup>51</sup> dhe me akuzën qesharake: *“Ka*

---

<sup>47</sup> AIDSSH, Dosja, nr.2336, fl.25

<sup>48</sup> V. Prendi, “Jetë që u shkri për atdhe: Me rastin e 41-vjetorit të pushkatimit të Don Shtjefën Kurtit”, në: <https://www.idituri.com/jete-qe-u-shkri-per-atdhe/>

<sup>49</sup> Z. Simoni, “Persekutimi i Kishës Katolike në Shqipëri nga viti 1977-1990”, *Krishterimi ndër Shqiptarë (Simpozium Ndërkombëtar, Tiranë 16-19 nëntor 1999)*, Shkodër 2000, f. 384; *Gazeta Drita*, Ferizaj, nr. 3-4/1983, pp. 8-9;

<sup>50</sup> Vendimi për arrestimin e dom Shtjefën Kurtit *shih: AIDSSH, Dosja, nr. 2336/I, fl. 7-8.*

<sup>51</sup> Procesverbali mbi inventarizimin e pasurisë dhe Vendimi mbi sekuestrimin e pasurisë. *AIDSSH, Dosja, nr. 2336/I, fl.14-18.*

*kryer shërbime fetare dhe ka pagëzuar një fëmijë”*. Detyrohet t’u nënshtrohet tortura çnjerëzore, kësaj radhe në moshën 73-vjeçare. Madje u ngrit edhe hipoteza e ekzistencën së një grupi armiqësor që po “sabotonte” ekonominë bujqësore, duke i shërbyer kështu Beogradit. Gjatë procesit gjyqësor përjeton tortura të shumta, nga detyrohet të pranojë edhe akuza për veprime të cilat nuk i kishte bërë. Në procesverbalin e hetuesisë të datës 13 qershor 1970, dom Kurti rrëfen për bisedat që kishte bërë me bashkëpunëtorët e tij në lidhje me gjendjen ekonomike të vendit dhe zinë e bukës që vazhdonte të ekzistonte përkundër punës që bëhej: *“...po çuditë se ka njerëz edhe gjashtë vjet që është çliruar Shqipëria dhe nuk po zgjidhet akoma nga ky pushtet çështja e bukës, por populli mbeti duke thirrur bukë, bukë. Kam thënë se nuk është e drejtë dhe është e vështirë që punëtori të punojë gjithë ditën e ditës dhe të marrë shtatëqind gram bukë. Kam thënë se nuk është e drejtë që nuk shpërblehen njësoj si të rinjtë dhe të moshuarit, duke pasur parasysh se që të dy palët punojnë dhe derdhin energji. Kam thënë se nuk është aspak e drejtë, ashtu siç veprohet nga ky pushtet që, fshatari, i cili prodhon grurin, mishin, qumështin, gjalpin dhe të tjera artikuj ushqimorë, për vete nuk ka të hajë, mbasi të gjitha këto i merren nga ana e shtetit...”*<sup>52</sup>

Pasi denigrohen plotësisht, nxirren në gjyq ,me datë 30 korrik 1971, dhe trupi gjykues, duke improvizuar 40 dëshmitarë të rremë arriti të japë dënime absurd. Dom Shtjefën Kurti u dënua me vdekje-pushkatim.<sup>53</sup>

Pas 8 muajsh burg, me 29 shtator 1971 të lidhur këmbë e duar,e dërguar para togës së pushkatimit.

Lajmi i pushkatimit të Dom Shtjefën Kurtit ishte alarmi i parë në Evropë dhe në botë për gjendjen e mjerueshme të popullit shqiptar, të klerit katolik, të çdo njeriu në Shqipërinë komuniste enveriste. Ja si shkruante Ettore Petta: *“Gazeta zyrtare e sundimit komunist shqiptar “Zëri i Popullit” vërtetoi lajmin mbi pushkatimin e priftit katolik Shtjefën Kurti, që qysh më parë e shpalli shtypi ndërkombëtar... Gazeta e Tiranës në një komentim mbi këtë ngjarje tejet të vështirë pohon se ky prift qe dënuar me të drejtë si “spiun, bandit dhe avanturist”. Shtjefën Kurti do të ishte anëtar i “një bande revizioniste” e financuar nga Vatikani, që së bashku me amerikanët dhe anglezët do të kishte projektuar rrënimin e regjimit komunist. Zëri i Popullit ka shtuar lidhur me këtë që “agjentet e Kishës katolike kanë përgatitur në Shqipëri “magazine*

---

<sup>52</sup> Po aty, fl. 25.

<sup>53</sup> Vendimi për dënim me vdekje-pushkatim për dom Shtjefën Kurtin (vendim nr. 54, datë 30. VII. 1971): *“Pasi shqyrtoi materialet e hetuesisë, provat e marra gjatë zhvillimit të gjykimit, pasi dëgjoi prokurorin i cili kërkoi që të deklarohen fajtor të gjithë të pandehurit dhe të dënohen: Shtjefën Kurti me vdekje me pushkatim në bazë të nenin 72 të K.P., me 6 vjet heqje lirie në bazë të nenit 73, e duke bërë bashkimin në bazë të nenit 48 të K.P. të dënohet me vdekje me pushkatim, me konfiskim të pasurisë...”*. AIDSSH, Dosja, nr. 2336, fl. 215-216; 241; 248.

*armësh” dhe kanë organizuar “qendra për spiunime”. Po ashtu sipas Zërit të Popullit Dom Shtjefën Kurti “ka merituar këtë dënim”.<sup>54</sup>*

Agjencia katolike austriake “Kathpress”(Österreichische katholische Nachrichtenagentur) shkruan se Dom Shtjefën Kurti u dënua me vdekje sepse e pagëzoi një fëmijë në fushën e përqendrimit. Artikulli përfundon me këtë pohim: “Shqipëria është shpallur qysh në vitin 1967 shteti i parë ateist në botë”.

Për fund, duhet të themi edhe atë që përkundër asaj, se këta klerikë dhe shumë të tjerë, u larguan nga sistemi okupues jugosllav për në Shqipëri dhe aty gjeten vdekjen, megjithatë kleri katolikë nga Kosova u tregua shumë aktivë në demokratizimin e jetës në Shqipëri në fillim të viteve 90-ta.

Pas ndryshimeve të mëdha në Evropën Juglindore, në vitin 1989-1990, Argjipeshkvia e Tivarit, duke përfshirë edhe Kosovën, sipas fletushkës “Obavjesti-Lajmëtari”, ishte e para që dërgoi dy delegacione ilegalisht në Shqipëri, të cilat pas vizitës që bënë dhënë një raport me vlerë për kohën, për gjendjen e mjerueshme të Kishës Katolike, në këtë vend të shkatërruar prej regjimit komunist. Sipas këtij raporti, në vitin 1990, rezulton se nga diktatura komuniste, kishin mbetur gjallë 28 priftërinj, nga këta: 16 dioqezanë, 9 françeskanë, 2 jezuitë dhe 1 ipeshkëv. Të gjithë ishin në moshë të thyer, të kaluar vite të tëra nëpër burgje.<sup>55</sup>

---

<sup>54</sup> *Corriere della Sera*, 6 April 1973.

<sup>55</sup> N. Ukgjini, *Kisha Katolike ...*, f. 355-356.

## **Ermal Frashëri - Unversiteti i Harvardit, USA**

### **Një vështrim mbi rregullimin juridik të punës gjatë periudhës 1944-1991**

#### **Abstrakt**

Puna, ishte subjekt i rregullimit ligjor nga Kushtetuta, tërësia e normave të kodifikuara mbi punën, disiplinimi i individit, përfshirë edhe masat represuese ndaj tij. Instrumentet në dispozicion të shtetit përfshinin, jo vetëm mekanizmat dhe proceset penale, por edhe instrumentet administrative, si dhe një seri normash sociale mbi tipin ideal të njeriut të ri dhe pritshmërive shoqërore lidhur me të. Ky vështrim në thelbin e çështjes është i nevojshëm për të nxjerrë në pah sistemizimin e fenomenit - punë, objektifikimin e individit dhe disiplinimin e shoqërisë nëpërmjet punës.

#### **Hyrje**

Puna, ashtu si faktorë dhe aspekte të tjera të jetës gjatë regjimit komunist, si për shembull, kapitali, toka, mjetet e prodhimit, ideologjia, normat kulturore dhe sociale, nuk mund të ishte subjekt i pavarur i marrëdhënieve midis individëve ose individëve dhe institucioneve, si publike po ashtu edhe private.

Në ndryshim nga sistemet e demokracisë liberale, ku puna ka një trajtim vokacional, përveç atij si faktor prodhimi, dhe ku mund të flitet për zgjedhjen e profesionit në përputhje me interesat dhe dëshirat e individit, në sistemet totalitare, puna trajtohet kryesisht si faktor prodhimi. Roli i individit në shoqëri, si njësi përbërëse e saj, suprimohet nga koncepti agregat i interesit të shoqërisë dhe pozita që i jepet kolektivit për të diktuar fatet njerëzore. Si rrjedhojë, individualiteti minimizohet, individi humb unikalitetin e tij dhe kthehet në një ndihmues në realizimin e një qëllimi të përgjithshëm<sup>1</sup>. Maksimumi i hapësirës që i jepet individit, sipas kësaj qasje instrumentale, është të aspirojë dhe veprojë në funksion të përmbushjes së vullnetit të përgjithshëm.

Tipar dallues i regjimeve totalitare, dhe këtu hyn edhe versioni Shqiptar i komunizmit, është trajtimi dhe rregullimi në skaj i faktorëve kryesorë të jetës dhe prodhimit, dhe në këtë kontekst, ishte normale për atë sistem që puna të trajtohej ashtu si dhe faktorët e tjerë të prodhimit – si p.sh., toka, kapitali, ndermarrja – të cilat ishin të rregulluara dhe kolektivizuara në funksion të ndërtimit të socializmit. Pra, kur këta faktorë të tjerë rregulloheshin deri ekstrem, marrëdhëniet e punës nuk mund të ishin përjashtim nga standardi. Vlen për të sjellë në vëmendje se në një përfundim të tillë arrihet edhe nga gjyqësori i kohëve të fundit, sipas të cilit, nuk kishte mundësi që në kohën e regjimit komunist, një individ të mungonte pa dalë në punë<sup>2</sup>. Në çështjen

---

<sup>1</sup> *Shih* gjithashtu edhe punimin e Sonila Boçi, Fajtorë pa faj: dënimi i inxhinierëve të kënetës së Maliqit, pjesë e justifikimeve për dështimet e regjimit komunist, për të krijuar idenë e presionit shoqëror, mobilizimit të burimeve njerëzore dhe arbitraritetin në gjykimin e individëve nga regjimi komunist.

<sup>2</sup> Gjykata Apelit Tiranë, Çështje Nr. 1935 Akti, Nr. 2307 Vendimi (2013).



në fjalë të shqyrtuar nga gjykata, ku paditësja kërkonte të merrte pagën që i detyrohej kooperativa bujqësore, vlerësohet se marrëdhënia e punës nuk ka qënë një marrëdhënie e lirë, por marrëdhënie detyrimi<sup>3</sup>. Gjykata vazhdon arsyetimin duke thënë që sipas ligjeve të kohës, çdo person ka qënë i detyruar që të merrte pjesë në punë, në të kundërt mund të përballej me pasojat e ligjit mbi parazitizmin<sup>4</sup>.

Përveç dimensionit të punës si faktor prodhimi, gjatë regjimit komunist, puna kuadrizohej edhe si formë dhe mjet dënimi për akte që konsideroheshin vepra ose kundravajtje penale. Jo pa shkak është përfshirja si formë e dënimit me punë të detyruar në pothuajse gjysmën e veprave dhe kundravajtjeve penale, sipas Kodit Penal të kohës (1977). Regjimi e konceptonte punën e detyruar si mënyrë riedukimi për individin, njësoj si heqja e lirisë, gjobat, qortimet shoqërore, dëbimi dhe internimi. Gjithashtu, një dimension tjetër i punës mund të nxirret në kontekstin e raportit që kishte Partia e Punës së Shqipërisë me shtetin – aparatën burokratik, ku puna, në formën e qarkullimit të kuadrove në bazë, përdorej si instrument i rezistencës, presionit, dhe sanksioneve që Partia ushtronte mbi burokracinë shtetërore për ta mbajtur këtë të fundit të nënshtruar.

Puna si faktor prodhimi, si formë riedukimi, dhe si lokacion ku shprehej tensioni në marrëdhënien Parti – shtet janë tre nga disa dimensionet e rregullimit të përgjithshëm të saj gjatë periudhës së regjimit komunist 1944-1991. Ky punim synon të krijojë një kornizë kërkimore mbi konceptin e punës duke përdorur trajtimin që i bëhet punës nga kushtetutat e republikës socialiste të viteve 1946 dhe 1976, Kodi Penal, dhe dokumentet politike të Partisë së Punës. Si i tillë, ky punim tenton të shërbejë si platformë për të kryer në një fazë të dytë studime të thelluara mbi mënyrën e organizimit të punës nëpërmjet mekanizmave të tjerë ligjorë-administrativë, disiplinimit të individit dhe shoqërisë nëpërmjet saj, dhe mënyrës se si shteti koncepton dhe përdor të drejtën për të kontrolluar një fenomen shoqëror dhe vokacion njerëzor si puna.

Seksioni I i këtij punimi fokusohet tek trajtimi kushtetues i punës, seksioni II hedh një vështrim të përgjithshëm tek përfshirja e punës së detyruar si formë dënimi nga Kodi Penal, seksioni III përqendrohet tek trajtimi i punës si lokacion ku shprehej tensioni në raportin midis Partisë dhe shtetit dhe bazohet në disa dokumente kyç të PPSH, dhe seksioni IV përmban disa konkluzione dhe hapa të mëtejshëm për punën kërkimore në këtë drejtim.

### *Puna si faktor prodhimi nën këndvështrimin kushtetues*

---

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> Po aty.

Regjim i kushtetues u formalizua nëpërmjet dy kushtetutave: a) Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë të miratuar nga Asambleja Kushtetuese në vitin 1946 dhe i amenduar në vitin 1950, dhe b) Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë së vitit 1976. Edhe një lexim i thjeshtë i këtyre dy dokumenteve parësore të rendit ligjor në Shqipëri është i mjaftueshëm për të dalluar evoluimin dhe konsolidimin e regjimit komunist në vend gjatë një periudhe 30 vjeçare.

Statuti i RPSH i vitit 1946 njihet si iniciativë private, po ashtu edhe rolin që ka shteti në zhvillimin ekonomik të vendit, sikurse njihet pronësinë mbi tokën dhe masën e saj<sup>5</sup>. Statuti gjithashtu merr një sërë masash që mund të klasifikohen si të drejta sociale që i jepen individit, por njëkohësisht i gërrshet ato dhe me një konceptualizim të punës si detyrë e individit. Kështu, për shembull, neni 10 i Statutit mbrohet personat që merren në punë duke iu siguruar të drejtën e organizimit, duke rregulluar dhe kufizuar orët e punës dhe pagën minimale<sup>6</sup>. Njëkohësisht, parashikon përkrahjen nëpërmjet sigurimeve shoqërore të pushimeve vjetore, si dhe garanton mbrojtje të veçantë për punën e të miturve<sup>7</sup>.

Kurse në nenin 22, Statuti sanksionon se puna në Republikën Popullore është nder po ashtu edhe detyrë<sup>8</sup>. Këtu fillon të shikohet qartë disiplinimi i marrëdhënieve të punës në funksion të ndërtimit të socializmit, si dhe shihet për herë të parë ideja e detyrimit që ka individi ndaj shoqërisë dhe ekonomisë socialiste, dhe përdorimin e punës për shlyerjen e këtij detyrimi. Po në këtë nen, ndoshta për ta zbutur impaktin e fjalisë së parë, parashikohet se çdo shtetas ka të drejtën të shpërblehet sipas punës dhe aftësisë, dhe të marrë nga shoqëria aq sa i jep asaj<sup>9</sup>. Ky trajtim evoluon ose rëndohet me amendamentet e këtij statuti në vitin 1950. Këto të fundit e sjellin konceptin e punës në brendinë e jetës ekonomike. Konkretisht, neni 13 përcakton se puna është baza e rendit shoqëror të Republikës Popullore të Shqipërisë<sup>10</sup>. Po kështu, ky nen përcakton se puna për çdo shtetas të aftë për punë është detyrë dhe nder sipas parimit: “kush nuk punon, nuk ha”<sup>11</sup>.

Në këtë kontekst institucional, duket si çudi që shteti ndërsa kuadron punën si faktor prodhimi, po ashtu tenton të ofrojë garancinë e lirisë së punës shkencore dhe artistike, mbrojtjen e të drejtave të autorit, dhe përkrahjen e shkencës dhe artit me qëllim që të zhvillohej kultura

---

<sup>5</sup> Art. 10, Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar nga Asambleja Kushtetuese, 1946

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Art. 22, Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar nga Asambleja Kushtetuese, 1946.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Art. 13, Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Korrik 1950.

<sup>11</sup> Po aty.

dhe mirëqenia e popullit<sup>12</sup>. Sidoqoftë, jo shumë vonë nga koha e miratimit të kësaj kushtetute, Partia do të vendoste vulën e saj mbi shkencën dhe artin duke shuar kështu çdo iluzion që mund të krijohej duke lexuar parashikimet kushtetuese të vitit 1946.

Në ndryshim nga një qasje deri diku liberale, ose ndoshta e kujdesshme ndaj sensitivitetit ndërkombëtar lidhur me formulimet kushtetuese të Statutit të vitit 1946, që pasohet me ndarjen midis asaj çka ishte në letër dhe asaj që ekzistonte me të vërtetë në realitet, Kushtetuta e vitit 1976 nuk lë vend për dyzime ose pretendime të ekzistencës së një fryme progresive. Totalitarizmi ndihej komod në atë fazë të zhvillimit të tij për të formalizuar praktikat e tij që nuk toleronin mendimin o

ose veprimin alternativ nga interpretimi lokal i ideologjisë marksiste-leniniste. Kjo Kushtetutë, që në preambulën e saj, përdor një ton triumfalist për të deklaruar se vendin e pronës private dhe të ekonomisë shumëformëshe e ka zënë prona shoqërore mbi mjetet e prodhimit dhe sistemi i vetëm i ekonomisë socialiste në qytet dhe në fshat<sup>13</sup>. Sipas saj, ishin likuiduar klasat shfrytëzuese dhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut. Ndërsa puna e lirë, e njerëzve që ironikisht ajo i konsideronte të lirë, ishte bërë faktori vendimtar i lulëzimit socialist, po ashtu edhe i ngritjes së mirëqenies së përgjithshme dhe të çdo njeriu<sup>14</sup>. Neni 29 i saj vendos se e gjithë jeta ekonomike-shoqërore e vendit ka në themel punën<sup>15</sup>. Sipas saj, puna është burim kryesor i sigurimit të mjeteve të jetesës për çdo shtetas<sup>16</sup>. Shteti, sipas këtij koncepti, punon për ngushtimin e dallimeve midis punës mendore e punës fizike, midis punës në industri e punës në bujqësi<sup>17</sup>. Gjithashtu, shteti kujdeset dhe merr masa për mbrojtjen në punë dhe për kualifikimin e punonjësve, si dhe për gjetjen e punës për shtetasit (Neni 44)<sup>18</sup>. Sipas këtij rregullimi të fundit, individit në fakt nuk i lindte e drejta për të përcaktuar vetë vokacionin profesional, por i krijohej shtetit detyrimi që t'i caktonte një punë individit duke i dhënë përparësi interesit kolektiv mbi interesin personal.

Kushtetuta shkon më tej duke vendosur parimin socialist, “nga secili sipas aftësive, secilit sipas punës”, dhe sanksionon ushtrimin e kontrollit shtetëror mbi masën e punës dhe

---

<sup>12</sup> Art. 27, Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar nga Asambleja Kushtetuese, 1946.

<sup>13</sup> Preambula, Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, së vitit 1976.

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Neni 29, Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, së vitit 1976.

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Po aty.

<sup>18</sup> Po aty. Shih gjithashtu edhe Nenin 44, Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, së vitit 1976. Neni 44 parashikon se në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë shtetasit kanë të drejtë për punë, e cila garantohet nga shteti. Po ky nen ruan formulimin e Kushtetutës të vitit 1946 se puna është detyrë dhe nder për çdo shtetas të aftë për punë. Sipas tij, shtetasit kanë të drejtë të zgjedhin e të ushtrjnë profesionin e tyre sipas aftësisë e prirjeve personale dhe në pajtim me nevojat e shoqërisë.

konsumit<sup>19</sup>. Në të njëjtën masë, vihet re vëmendja për të garantuar barazinë formale të punës dhe shpërblimit, sipas të cilit, “për punë të barabartë garantohej pagë e barabartë.”<sup>20</sup> Shpërblimit material i ulet rëndësia dhe stimujt moralë marrin përparësi në nxitjen e punës për të dhënë rezultate më të shumta<sup>21</sup>.

Puna, si faktor prodhimi dhe element themelor i ndërtimit të socializmit, luan dhe një rol edukativ. Kështu për shembull, neni 33 thekson se arsimit në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë organizohet e drejtohet nga shteti dhe kombinon mësimin me punën prodhuese dhe me edukimin fizik e ushtarak<sup>22</sup>. Po në këtë frymë, Neni 34 nxjerr në pah se shteti organizon e drejton zhvillimin e shkencës e të teknikës në lidhje të ngushtë me jetën e me prodhimin, në shërbim të përparimit të shoqërisë e të mbrojtjes së atdheut<sup>23</sup>.

Këto parashikime kushtetuese shërbejnë për të na dhënë një ide mbi themelet e rregullimit të punës, të cilat më pas detajoheshin më tej me dokumentet e politikave të Partisë, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe praktikatat administrative. Mjafton ngritja e konceptit të punës si detyrim i individit ndaj shoqërisë që organet e Partisë dhe shtetit të çonin në ekstrem përdorimin e dhunës shtetërore për nënshttrimin e individit.

### ***Puna si formë dënimi nën këndvështrimin e Kodit Penal***

Siç u tha dhe më lart, përveç dimensionit të punës si faktor prodhimi, riedukimi nëpërmjet punës së detyruar është përdorur si mënyrë dënimi për veprat dhe kundravajtjet penale. Kodi Penal i vitit 1977 parashikon rreth 100 vepra dhe kundravajtje penale, nga pothuajse 200 të tilla, për të cilat parashikohet, midis të tjerave, riedukimi i individit nëpërmjet punës. Neni 20 i Kodit perkufizon riedukimin nëpërmjet punës si një detyrim të personit fajtor për të punuar për një kohë nga një muaj deri në një vit në qendrën e punës që caktohet me vendim të gjykatës ose në vendet që caktojnë organet e ekzekutivit<sup>24</sup>. Të dënuarit me riedukim nëpërmjet punës i ndalet në dobi të shtetit deri një e katërta e shpërblimit për punën që bën<sup>25</sup>. Neni 209 i këtij Kodi, ose siç njihet ndryshe në shoqëri si parashikimi kundër parazitizmit, sanksionon se moszbatimi nga ana e parazitëve i vendimit të organeve shtetërore për vendosjen

---

<sup>19</sup> Neni 30, Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, së vitit 1976.

<sup>20</sup> Po aty.

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Neni 33, Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, së vitit 1976.

<sup>23</sup> Neni 34, Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, së vitit 1976.

<sup>24</sup> Neni 20, Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (1977).

<sup>25</sup> Po aty.

në punë, i kryer më shumë se një herë, dënohet me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë deri në dy vjet<sup>26</sup>.

Sipas kuadrit ligjor të ngritur nga ky Kod, krimet kundër pasurisë socialiste si blerja e pasurisë socialiste që rrjedh nga një krim ose pranimi i saj (neni 66), shkatërrimi ose dëmtimi i pasurisë socialiste nga pakujdesia (neni 68), krimet kundër sistemit socialist të ekonomisë (si për shembull, nxjerrja e prodhimit me cilësi jo të mirë (neni 69), përdorimi ose ruajtja e pakujdesshme e makinerive dhe e pajisjeve teknike (neni 70), dëmtimi i veprave ujitëse dhe kulluese (neni 71), kontrabanda (neni 72), mashtrimi në peshë dhe matje (neni 74), shitja e mallrave me çmim më të lartë (neni 75), shkelja e dispozitave mbi valutën dhe arin (neni 77), dëmtimi nga pakujdesia i rrugëve dhe i mjeteve të komunikacionit (neni 79), shkelja e disiplinës së punës në transport (neni 80), shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor (neni 81), dëmtimi i kabllove dhe linjave (neni 82)) parashikojnë riedukimin nëpërmjet punës. Krimet kundër personit, si për shembull plagosja e lehtë (neni 93), mjekimi i pakujdesshëm (neni 96) përmbajnë riedukimin nëpërmjet punës si një nga format e dënimit. Kryerja e krimeve në ushtrimin e detyrës, si për shembull, shpërdorimi i detyrës (neni 106), qëndrimi i pakujdesshëm në detyrë (neni 108), mitmarrja (neni 109), falsifikimi (neni 110) përfshin gjithashtu dënimet nëpërmjet punës.

Krimet kundër rendit administrativ, si kundërshtimi ndaj përfaqësuesve të shtetit (neni 118), goditjet për shkak të detyrës (neni 119), fyerja e personit për shkak të detyrës (neni 120), falsifikimi i dokumenteve ose vënia në dorë e tyre me qëllim përdorimi (neni 121), humbja e dokumenteve (neni 123), shmangia nga detyrimet e mbrojtjes civile (neni 125), sjellja e padenjë në shoqëri (neni 129), shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë (neni 130), shkelja e rendit teknik në prodhim (neni 131), shkelja e rregullave në kryerjen e punimeve (neni 132), shkelja e rregullit në prodhim (neni 133), përgatitja ose shitja e lëndëve narkotike dhe helmuese (neni 134), janë të dënueshme edhe nëpërmjet punës.

Disa nga krimet ushtarake, si për shembull, moszbatimi i urdhrit (neni 142), kundërshtimi dhe shtrëngimi për të shkelur detyrën (neni 144), shkatërrimi i pasurisë ushtarake nga pakujdesia (neni 148), parashikojnë dënimin me riedukim nëpërmjet punës, midis formave të tjera të dënimit.

Në përgjithësi, shumica e kundravajtjeve penale, ku hynë edhe aktet në sferën familjare, kundravajtjet në fushën e ekonomisë dhe kundër pasurisë së shtetasve, kundravajtjet lidhur me të drejtën e zgjedhjes, kundravajtjet kundër drejtësisë, rendit administrativ, kundravajtjet në

---

<sup>26</sup> Neni 209, Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (1977).

fushën e mbrojtjes, kundër sigurimit shoqëror, kundravajtjet në fushën e shëndetësisë, kundër moralit shoqëror (luajtja e bixhozit), ato penale ushtarake, parashikojnë të gjitha riedukimin nëpërmjet punës si një nga masat që mund të merren ndaj individit<sup>27</sup>.

Kjo qasje gjithëpërfshirëse e punës si formë riedukimi e individit fajtor që prish normat sociale shërben për ta rrënjosur karakterin e punës si diçka që i shërben më shumë kolektivit sesa si një shprehje e preferencave individuale të njeriut.

### ***Puna si lokacion i tensionit në raportin parti – shtet***

Ndërsa dy seksionet e mëparshme fokusohen tek rregullimet ligjore të konceptit të punës si faktor prodhimi dhe formë dënimi, ky seksion përqendrohet kryesisht tek trajtimi i punës si lokacion ku shprehej tensioni në marrëdhënien midis Partisë dhe shtetit, dhe bazohet tek disa elemente të dokumenteve kryesore politike të Partisë së Punës së Shqipërisë. Ky seksion sjell në vëmendje se si trajtoheshin aspekte të ndryshme të organizimit të punës, si për shembull

---

<sup>27</sup> Këtu përfshihen përvetësimi i pasurisë socialiste të gjetur (neni 161), shkeljen e dispozitave mbi tregtinë e jashtme (neni 162), fshehjen e sendeve që janë objekt kontrabande (neni 163), ushtrimin e tregtisë së ndaluar (neni 164), ushtrimi i profesionit pa leje (neni 165), falsifikimi i vulave të njërive të matjes (neni 166), shkelja e rregullave në ndërtim (neni 167), dëmtimi i kabllave dhe i linjave (neni 168), pushtimi dhe shpërdorimi i tokës (neni 169), shkelja e dispozitave mbi karantinën e bimëve (neni 170), shkelja e dispozitave mbi veterinarinë (neni 171), trajtimi i pakujdesshëm i gjësë së gjallë (neni 172), prerja e paligjshme e pyjeve ose dëmtimi i tyre (neni 173), peshkimi i paligjshëm (neni 174), kanosja (neni 184), fyerja (neni 185), shpifja (neni 186), shkelja e fshehtësisë së korrespondencës (neni 187), shkelja e të drejtave të gruas (neni 188), fejesa e te miturve (neni 189), shpërblimi për martesë (neni 190), shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesën (neni 191), bashkëjetesa e ndaluar (neni 192), mbajtja e marrëdhënieve bashkëshortore me dy partnere (neni 193), shkelja e detyrimeve familjare (neni 194), shpërdorimi i pasurisë (neni 195), përvetësimi i një pasurie të gjetur (neni 196), falsifikimi i dokumenteve (neni 197), blerja e pasurisë së shtetasve që rrjedh nga një krim ose pranimi i saj (neni 198), shkatërrimi ose dëmtimi i pasurisë së shtetasve nga pakujdesia (neni 199), ndalimi i ushtrimit të së drejtës së zgjedhjes (neni 200), falsifikimi i dokumenteve të zgjedhjeve (neni 201), dëshmia, ekspertimi ose përkthimi i rremë (neni 202), mosparaqitja e dëshmitarit, e ekspertit ose e përkthyesit (neni 203), kundërshtimi ndaj përfaqësuesit të shtetit (neni 204), kundërshtimi ndaj aktivistëve shoqërorë (neni 205), fyerja e personit për shkak të detyrës (neni 206), kanosja për shkak të detyrës (neni 207), përvetësimi i titullit ose i detyrës (neni 208), shmangia e parazitëve nga puna (neni 209), vetëgjyqësia (neni 210), pengimet në ekzekutimin e vendimeve (neni 211), përgatitja e vulave, e stampave ose e formularëve falsë (neni 212), mos tregimi i emrit të anijes nga ana e kapitenit të saj (neni 213), mosdhënia e ndihmës në raste përplasjeje anijesh (neni 214), përvetësimi, shkatërrimi ose dëmtimi i materialeve të arkivave (neni 215), dëmtimi ose shkatërrimi i monumenteve të kulturës (neni 216), shmangia nga evidenca ushtarake (neni 217), shmangia nga shërbimi ushtarak (neni 218), shmangia nga detyrimi për dorëzim kafshësh, mjetesh ose pajisjesh (neni 219), hyrja pa leje në zonat ushtarake (neni 220), shkelja e dispozitave mbi përdorimin e radio instalimeve (neni 221), heqja ose prishja e shenjave topografike (neni 222), prodhimi, mbajtja, blerja ose shitja e armëve (neni 224), shkelja e dispozitave mbi armët (neni 225), shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse (neni 226), shkelja e rregullave mbi lëndët helmuese (neni 227), shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë (neni 228), shkelja e të drejtave të punonjësve (neni 229), shkelja e rregullit në prodhim (neni 230), Shkelja e rregullave në punime (neni 231), shkelja e rregullave për sigurimin nga zjarri (neni 232), ushtrimi i mjekësisë pa të drejtë (neni 233), përgatitja dhe shitja e prodhimeve ushqimore të rrezikshme për shëndetin (neni 234), ndotja e ambientit (neni 235), luajtja e bixhozit (neni 236), largimi pa leje i ushtarakut (neni 237), mosparaqitja në repart ose në vendin e shërbimit (neni 238), largimi pa leje i të thirrurve në stërvitje (239), moszbatimi i urdhrin (neni 240), vepra diskredituese për ushtrinë (neni 241), mos caktimi i rojave (neni 243), shkelja e rregullave të shërbimit të rojës (neni 244), dëmtimi i armatimeve nga pakujdesia (neni 245), shpërdorimi, shkatërrimi ose dëmtimi i sendeve të veshmbathjes (neni 246).

qarkullimi i kuadrove në rrethe, në kuadrin më të gjerë të luftës ndaj burokratizimit, luftë e cila përkufizon tensionin që kanë pasur në vetvete shteti dhe Partia në raport me njëri tjetrin.

Mënyra e lidhjes së Partisë me shtetin, temë e cila mund të ishte subjekt i një punimi shkencor të dedikuar, sugjeron se marrëdhënia midis të dyve nuk ka qenë e lehtë. Partisë vërtet i duhej aparati shtetëror për të realizuar vizionin e saj të rendit shoqëror dhe sidomos përdorimi i organeve të diktaturës për të ushtruar dhunë. Por aq sa i duhej aparati shtetëror, aq edhe Partia druhej nga forcimi i tij. Këtë frikë Partia e manifestonte nëpërmjet luftës kundër burokratizimit, e cila përmbante luftën kundër formalizmit që vinte nga sistemi ligjor dhe administrativ, dhe goditjeve sistematike që i jepeshin kuadrove që punonin në burokracinë shtetërore duke përdorur për këtë efekt qarkullimin në bazë. Këto masa kundër sistemit formal nga vetë Partia shtet merreshin për të krijuar një ndjenjë sistematike pasigurie në sistem, për të ndëshkuar individë që Partia i konsideronte si rrezik për të, dhe për të dobësuar vazhdimisht aparatën shtetërore që ky i fundit të ishte gjithmonë i varur nga Partia.

Si rrjedhojë, koncepti i punës nuk mund të shqyrtohet në izolim nga dokumentet politike të PPSH. Këto të fundit përmbajnë normat, pritshmëritë, direktivat lidhur me fenomene të ndryshme të jetës shoqërore në vend, të cilat më pas përktheheshin në akte ligjore dhe administrative që krijojnë norma detyruese për shtetasit dhe organet shtetërore. Duhet thënë që në fillim se fokusi i këtij punimi nuk ka qenë shterimi i shqyrtimit të dokumenteve të PPSH lidhur me konceptin e punës, kjo synohet të bëhet në studime të mëpasshme së bashku me filtrimin e akteve ligjore, nënligjore, dhe praktikave të organeve të diktaturës, por më tepër ka qenë drejt nxjerrjes në pah të disa trajtimeve si juridike ashtu edhe politike të konceptit të punës për të krijuar një ide mbi hapat e mëtejshëm kërkimorë që mund të merren në këtë drejtim.

Në mes të një morie aktesh të brendshme dhe publike të PPSH, vendimi i Komitetit Qendror të PPSH i janarit të vitit 1966 për qarkullimin e kuadrove përmban elemente që shpesh herë do gjejnë vend në dokumentet pasardhës<sup>28</sup>. Vendimi duket si një akt që më tepër njeh një situatë të krijuar nga poshtë – lart sesa një situatë që është drejtuar nga organet e larta të PPSH. Sipas tij, shumë kuadro, specialistë dhe punonjës të aparateve shtetërore e të Partisë, të qendrës dhe të rretheve, kishin shprehur vullnetin e tyre që të kalojnë nga zyrat drejtpërsëdrejti në prodhim<sup>29</sup>. Komiteti Qendror udhëzonte të gjitha strukturat e tjera të bënin ndërgjegjësimin e popullit mbi këtë iniciativë të vetë kuadrove, dhe instruktonte Këshillin e Ministrave, të gjitha organet qendrore e lokale të shtetit, si dhe komitetet e Partisë në rrethe, të interesoheshin në

---

<sup>28</sup> Vendim i KQ të PPSH mbi iniciativën patriotike të punonjësve të administratës për të kaluar në prodhim, janar 1966.

<sup>29</sup> Po aty.

mënyrë të posaçme për zgjidhjen e të gjitha problemeve që lindin aktualisht përpara punonjësve që shkojnë në prodhim<sup>30</sup>. Ata duhet të vireshin në lidhje të drejtpërdrejtë me vullnetarët e frontit të prodhimit, të interesoheshin pranë kooperativave bujqësore dhe qendrave të punës për t'u siguruar atyre punën, banesën, furnizimin e të tjera, në mënyrë që t'u krijoreshin kushtet për të filluar menjëherë nga puna<sup>31</sup>. Në të njëjtën kohë, Komiteti Qendror i bënte thirrje kooperativave bujqësore që të pranonin si anëtarë të tyre, me të gjitha të drejtat dhe detyrat, në bazë të rregullave, të gjithë specialistët dhe punonjësit e administratës që do të shkonin në kooperativat bujqësore, dhe të siguronin banesë, kur është e mundur, ose të ndihmonin organet shtetërore me mjetet dhe forcat e tyre për të rregulluar ose ndërtuar banesa të reja që nevojiteshin për strehimin e punonjësve dhe të familjeve të tyre që shkonin në kooperativat bujqësore<sup>32</sup>.

Një vit më pas, më 1967, Byroja Politike nuk ndalet vetëm në përshëndetjen e iniciativës së kuadrove për qarkullim në bazë, por miraton një orientim sipas të cilit, qarkullimi sistematik nga qendra në bazë dhe anasjelltas është një masë shumë e domosdoshme dhe e dobishme si për punën ashtu edhe për vetë kuadrot<sup>33</sup>. Disa nga kriteret për qarkullimin e kuadrove përfshijnë: a) nevojën për qarkullim të të gjithë atyre kuadrove që nuk kishin qenë asnjëherë në bazë, që nuk kishin përvojën e luftës e të jetës në bazë, por që kishin ardhur në aparatet qendrore drejtpërdrejt nga shkollat, b) nevojën për qarkullim të kuadrove të cilët megjithëse kishin qenë më parë në bazë, kishin mbi 10 vjet në aparatet qendrore, dhe c) nevojën për të mos lëvizur nga puna ku do të caktohen e as të ktheheshin në qendër pa mbushur një stazh prej 3 vjetësh. Kuptohet se goditja e kuadrove nëpërmjet qarkullimit në bazë nuk motivohej me rezistencën dhe luftën që Partia duhej t'i bënte shtetit për të ruajtur supremacinë e saj në çdo kohe. Ajo kuadrizohej shpesh në luftën ndaj burokratizimit, nevojës për revolucionarizimin dhe emancipimin e shoqërisë. Por pikërisht ishin këto elemente ekstra-shtetërore që e tradhtonin interesin e vërtetë të Partisë.

Tensioni që Partia kishte me shtetin mund të zgjatet edhe tek raporti që ajo merr me shoqërinë. Në këtë kontekst, në dokumentet kryesore politike të PPSH ndeshen edhe qëndrimi ndaj emancipimit të gruas si dhe ai ndaj punës private. Për hir të vështrimit të përgjithshëm mbi konceptin e punës, vlen për t'i sjellë shkurtimisht në vëmendje. Në vitet 1960, çështja e emancipimit të gruas dhe përfshirja e saj në masat punonjëse hyn në fokusin politik që më vonë pasohet me një fushatë sensibilizimi në terren dhe masa konkrete për zbatimin e politikës së re.

---

<sup>30</sup> Po aty.

<sup>31</sup> Po aty.

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> Orientime të përgjithshme të Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi qarkullimin e kuadrove, 28 prill 1967.



Një raport i Byrosë Politike për emancipimin e gruas, në qershor të vitit 1967, shprehimisht pohon se puna, prodhimi shoqëror, është baza e ekzistencës së njerëzimit dhe e zhvillimit të shoqërisë. Raporti citon Enver Hoxhën, sipas të cilit, faktori punë është një faktor i madh për çlirimin ekonomik, ideologjik dhe politik të gruas<sup>34</sup>. Kjo qasje instrumentale e lidh emancipimin thelbësisht me organizimin e punës dhe mobilizimin e gruas drejt prodhimit industrial dhe bujqësor dhe mund të interpretohet si një nga mjetet që përdorte PPSH për të stimuluar ndryshimet sociale në funksion të interesave të saj.

Por qarkullimi dhe emancipimi nuk ishin të vetmet fenomene që organizoheshin nga qendra. Si rast emblematic i rregullimit totalitar të marrëdhënieve shoqërore, Komiteti Qendror nëpërmjet një letre drejtuar organizatave bazë të Partisë i hap luftë ushtrimit të profesionit si një vokacion i pavarur nga shteti. Në këtë letër, Komiteti shprehet se një luftë më e madhe duhet bërë kundër ushtrimit të profesionit privatisht<sup>35</sup>. Profesionit privat stigmatizohet. Sipas Komitetit, “punët private i ushtrojnë njerëzit e pazënë në punë, disa prej të cilëve janë kthyer në matrapazë të vërtetë, ata që bëjnë punë sezonale, si dhe shumë punëtorë specialistë, të cilët punojnë privatisht pas orarit të punës, kryesisht me mallin e shtetit, që vidhet në forma të ndryshme”<sup>36</sup>. Komiteti thekson se “problemi i ushtrimit të profesionit në mënyrë private duhet parë gjerë, si një mungesë e ndërgjegjes së atyre që e ushtrojnë, por edhe si një dobësi serioze e atyre qytetarëve që pranojnë të kryejnë punë ndër privatë, të cilët me veprimin e tyre bëhen nxitës të këtij fenomeni të keq”.<sup>37</sup> Në këtë mënyrë, “lufta për parandalimin e këtyre shfaqjeve duhet të përfshijë edhe këta të fundit, mbi të cilët bien dhe pasojat e shijeve jo të shëndosha të atyre që ushtrojnë profesione të paligjshme”.<sup>38</sup> Dhënia e një dimensionit kulturor të punës si një fenomen i pandashëm nga morali socialist i njeriut të ri i jep një peshë të shtuar mbikëqyrjes që regjim i totalitar kishte mbi aktivitetin individual duke synuar kështu një lloj brendësimi të dogmës nga njeriu zakonshëm.

Kompleksiteti i konceptit të punës dhe vënia e saj në qendër të zhvillimit të vendit nëpërmjet industrializimit dhe kolektivizimit në bujqësi, formimit të njeriut të ri dhe zhvillimit të luftës së klasave duket qartë në llojshmërinë e çështjeve të ngritura nga PPSH në materialet dhe forumet e saj. Në një sërë dokumentesh, vihet re qartë që mbikëqyrjes së PPSH nuk i shpëtonin as normat e punës, shpërblimet, kualifikimet shkencore dhe trajnimet, pranimi ne

---

<sup>34</sup> Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi thellimin e mëtejshëm të luftës për emancipimin e plote të gruas dhe rritjen e rolit të saj në shoqërinë socialiste, 15 qershor 1967

<sup>35</sup> Letër e KQ të PPSH drejtuar gjithë organizatave-bazë të partisë për thellimin e luftës kundër disa shfaqjeve të huaja, 1 tetor 1980.

<sup>36</sup> Po aty.

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>38</sup> Po aty.

universitet dhe në trupat pedagogjike, shfaqet e huaja, ashtu si dhe rritja e rendimentit në punë. Të gjitha këto trajtoheshin në funksion të rritjes së prodhimit, ruajtjes së monopolit të PPSH mbi rendin social dhe politik në vend, dhe presionit të vazhdueshëm mbi aparatit shtetëror formal.

### ***Konkluzione***

Kur në objekt të studimit vihet koncepti i punës, kërkimet e mëposhme mund të marrin drejtime të ndryshme për të kuptuar dimensionet e saj dhe mënyrat e rregullimit në regjimin totalitar. Nga një anë, puna mund të trajtohet në mënyrë të përgjithshme për të kuptuar si e rregullonte atë ai regjim duke zbritur në një nivel më poshtë sesa kushtetutat nëpërmjet legjislacionit të punës dhe praktikave administrative, po ashtu edhe nëpërmjet dokumenteve politike për të mësuar më mirë vëmendjen dhe qasjen që kishte PPSH ndaj saj.

Nga një anë tjetër, puna mund të trajtohet në prizmin e detyrimit që kishte individit ndaj shtetit, qoftë si qytetar i “lirë” po ashtu edhe si formë dënimi. Në këtë kontekst të dytë, vlen për të nxjerrë në dritë rregullimin penal dhe administrativ që i bëhej punës si lokacion ku manifestohej lufta e klasave. Shqyrtimi i funksionimit të kampeve të punës ose internimeve, dosjeve individuale dhe udhëzimet e organeve të diktaturës janë drejtime potenciale të kërkimeve të mëvonshme në këtë fushë, të kombinuara me legjislacionin penal dhe administrativ.

Gjithashtu, ashtu siç përmendet dhe me lart, një drejtim tjetër mund të jetë zbërthimi i përdorimit nga shteti i të drejtës mbi punën dhe ngritja e një aparati burokratik për kontrollimin e marrëdhënieve në shoqëri. Kjo perspektivë ndihmon në formimin e kuptimit mbi rolin që ka administrata si pjesë përbërëse e shtetit në kontrollin ndaj këtij të fundit dhe në përcaktimin e marrëdhënies që burokracia ka me individin.

Kuptohet që këto drejtime janë më tepër drejtime potenciale të punës kërkimore që shërbejnë për të ilustruar punën e ardhshme, dhe inkurajojnë nxitjen e mendimeve dhe diskutimeve mbi aspekte apo drejtime të tjera që mund të marrë kërkimi shkencor në këtë fushë.

### Paligjshmëria e vendimeve të internim-dëbimit në periudhën 1944-1954

#### Abstrakt

Kumtesa trajton çështjen e internimeve dhe dënimeve në aspektin ligjor; veprimet krejtësisht abuzive të pushtetit komunist, të pambështetura në asnjë lloj ligji; izolimin e familjeve të personave kundërshtarë të regjimit në kampe internimi në mbikëqyrjen e ushtrisë ose policisë; situatën e paligjshmërisë kur mijëra vetë u internuan dhe mbaruan internimin përpara sesa të dilte ligji për internimet. Autori shtron pyetjen si mund ta përkufizojmë, në aspektin ligjor, zhvendosjen dhe izolimin e një mase të konsiderueshme qytetarësh, nga zyrtarët dhe institucionet e shtetit, ndërkohë që mungonin ligjet për një veprimtari të tillë.

Regjimi komunist u vendos në Shqipëri në fund të vitit 1944. Më 28 nëntor udhëheqja<sup>1</sup> e tij hyri në Tiranë dhe vazhdoi shtrirjen e kontrollit ushtarak në gjithë vendin. Përdorimi i dhunës së armatosur prej Ushtrisë Partizane<sup>2</sup> hasi në qëndresë të popullsisë, e cila, në shumë raste ishte, reciprokisht, e armatosur. Pasi mori kontrollin e institucioneve shtetërore, veç dhunës ushtarake, udhëheqja e regjimit përdori dhe forma të tjera për shuarjen e qëndresës. Një prej tyre ishte izolimi i familjarëve të personave të konsideruar në arrati në kampe të rrethuar me tela me gjemba, të ruajtur nga ushtarë ose policë. Ky lloj izolimi realizonte dy gjëra: zhdukte mundësinë që familjet të ndihmonin të afërmit e tyre në arrati dhe ushtronte presion ndaj të arratisurve, të cilët mund të ndiheshin përgjegjës për vuajtjet e familjarëve të tyre. Zyrtarisht izolimi quhej internim, ashtu siç ishte quajtur dhe më parë nga institucionet e shtetit shqiptar, por, në ndryshim nga tradita, në rastin e komunistëve nuk pati, për një kohë të gjatë, një ligj për internimet si dënime politike (dënim administrativ, në ligjërimin zyrtar). Në këtë studim, kur flasim për atë që zyrtarët e quanin internim, para daljes së ligjit të internimeve (1954), ne e quajmë thjesht izolim i paligjshëm, ndërsa dëbimin, edhe ky një koncept juridik, e quajmë – për kohën që u krye në mënyrë të paligjshme – shpërngulje e paligjshme nga vendbanimi (ose banesa). Ky studim trajton pikërisht aspektin ligjor për internimet dhe dëbimet gjatë regjimit komunist, duke u ndalur në momentet kryesore, për periudhën 1944-1954, kur numri i internimeve dhe dëbimeve ishte më i madh, ndërsa gjendja ligjore kaotike.

#### *Ligji i parë për dëbimet*

---

<sup>1</sup> Udhëheqja e regjimit komunist nënkupton Byronë Politike të PPSH, Këshillin e Ministrave, Kryesinë e KANÇ-it, para 1946, dhe Presidiumin e Kuvendit Popullor, pas 1946, të cilat ishin institucionet kryesore dhe në shumicën e tyre të përbëheshin nga të njëjtët persona.

<sup>2</sup> Emri i ushtrisë është shkurtim i emrit të saj të përkudorur në vendimet e KANÇ, në Kongresin e Përmetit, 24-28 maj 1944, si Ushtria Partizane Vullnetare Nacional-Çlirimtare.

Më 10 janar 1949, Këshilli i Ministrave diskutoi miratimin e një amnistie për të arratisurit politikë. Ministri i Drejtësisë, Manol Konomi, u shpreh se “paralel me këtë [amnistinë] është edhe projekt-ligji mbi internimet.”<sup>3</sup> Ai e kishte fjalën për një projekt-dekret që qeveria e miratoi dhe ia dërgoi për miratim Presidiumit të Kuvendit Popullor po atë ditë.<sup>4</sup> Projekt-dekreti, të cilit iu referua ai, ishte për zbatimin e vendimeve të dëbimit dhe konfiskimit, në të cilin, edhe pas kthimit në dekret, fjala internim nuk shfaqej në asnjë cep të tekstit. Konomi e përdori termin internim në vend të termit dëbim, siç bënin shpesh të gjithë zyrtarët komunistë e të gjitha niveleve.

Konomi pohoi, në praninë e gjithë anëtarëve të qeverisë, se deri atëherë regjimi komunist nuk kishte pasur një ligj për internimet, duke nënkuptuar se ajo qeveri nuk kishte bërë ligj për internimet. Mirëpo, kjo nuk do të thoshte se Shqipëria nuk kishte ligj, sepse, bazuar në një ligj të KANÇ, 17 maj 1945, shumica e ligjeve të periudhës para 7 prillit 1939, përfshi ligjin e internimeve, ishin ende në fuqi.<sup>5</sup> Ndërkohë izolimi i njerëzve – i quajtur internim zyrtarisht – ishte bërë në mënyrë masive nga komitetet ekzekutive, ushtria, etj, në kundërshtim me dekreligjin e vitit 1925.<sup>6</sup>

Sa u përket dëbimeve, gjendja e paligjshmërisë ishte e njëjtë. Në një rast u shpërngulën nga Tirana 48 familje njëherësh, me 201 persona, me vendim të zyrës së urbanizimit të Komitetit Ekzekutiv të nënprefekturës së Tiranës. Në shkresën e saj thuhej që vendimi ishte pa të drejtë apelimi, por nuk kishte asnjë referencë ligjore ku bazohej.<sup>7</sup> Në një rast tjetër, i cili mund të jetë unik në historinë e njerëzimit, institucionet e regjimit komunist shpërngulën nga Tirana në Fier, bashkë me anëtarët e gjallë të familjes, dhe kufomën e një fëmije 14-vjeçar.<sup>8</sup>

---

<sup>3</sup> AQSH, F. 490, V. 1949, D. 5, Fl. 1-2. Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, 10 janar 1949.

<sup>4</sup> AQSH, F. 490, V. 1949, D. 115, Fl. 1-2. Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 5, 10 janar 1949.

<sup>5</sup> AQSH, F. 490, V. 1945, D. 269, Fl. 1. Ligj mbi abrogimin e dispozitave ligjore të promulgua gjatë okupacionit të huaj, mbi pavlefshmërinë e vendimeve penale të dhëna gjatë asaj kohe prej autoriteteve ushtarake dhe mbi vleftën e dispozitave ligjore që ishin në fuqi para datës 7 prill 1939. *Shënim*: Ky ligj parashikonte që mbeteshin në fuqi ligjet, dekretet dhe rregulloret që nuk ishin “në kundërshtim me frymën e re demokratike dhe me deklaratat, vendimet dhe ligjet e promologuara prej Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë dhe me urdhëresat e dhëna prej qeverisë demokratike.” Ky përcaktim ishte spekulativ, sepse nuk i trajtonte ligjet në mënyrë nominale, përderisa s’kishte një institucion që përcaktonte cili ligj, dekret apo vendim ishte në kundërshtim me përkufizimin ligjor dhe cili jo. Nga ana tjetër, ligji dhe dekreti kishin përparësi mbi urdhëresat e qeverisë, kështu, në rast përplasjeje, përparësi kishin ligjet dhe dekretet e para 7 prillit 1939 dhe jo urdhëresat e “qeverisë demokratike.” Në një arsyetim alternativ, të njëjtin arsyetim mund ta bëjnë dhe kriminelët, duke pretenduar se ligjet bien ndesh me deklaratat e tyre, etj. Arsyet juridike që rrëzojnë pretendimet e kriminelëve janë të njëjta me ato që rrëzojnë arsyetimin “ligjor” të komunistëve.

<sup>6</sup> Ligj mbi ndryshimin e artikujve 1, 2 e 3 të ligjës mbi internimet e familjeve dhe konfiskimit të pasurisë së të arratisurve, në: *Ligje, dekretligje e rregullore të vjetit 1925* (Tiranë: 1938), 442.

<sup>7</sup> Katriot Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste* (Tiranë: ISKK, 2015), 9-10.

<sup>8</sup> Zoi Xoxa, ish-deputet dhe botues gazete, u dëbua nga Tirana familjarisht, në ditët e para të vendosjes së regjimit komunist. Ditën që shkuan për ta dëbuar, atij i kishte vdekur djali 14 vjeç, por përfaqësuesit e regjimit, të cilët shkuan për të realizuar dëbimin e familjes, nuk e lanë atë të kryente varrimin e djalit, por e detyruan familjen ta merrte kufomën me vete në Fier, aty ku ishte caktuar vendi i ri i banimit. *Shiko*: Katriot Dervishi, *Burgjet dhe*

### *Ligji i parë për internimet*

Dekretligji i parë i Kuvendit Popullor për internimet u miratua më 2 gusht 1954. Në relacionin shoqërues të projekt-dekretit,<sup>9</sup> dërguar për miratim më 22 qershor 1954, qeveria shpjegonte se e kishte marrë nismën e saj për dy arsye. Arsyeja e parë ishte se, më 22 mars 1954, Presidiumi i Kuvendit Popullor kishte miratuar një dekretligj, i cili ua kishte kaluar gjykatave të drejtën për dhënien e vendimeve të konfiskimit të pasurisë, duke e shfuqizuar dekretin ekzistues.<sup>10</sup> Deri atëherë kishte pasur një dekretligj të përbashkët për konfiskimet dhe dëbimet dhe, në arsyetimin e qeverisë, ai dekretligj nuk mund të vazhdonte më në formën që ishte ndaj ajo mendonte se ishte i nevojshëm një rregullim ligjor i ri për dëbimet dhe internimet. Arsyeja e dytë, sipas qeverisë, ishte se, në dekretligjin ekzistues për dëbimet, nuk ishin të qarta nocioni i dëbimit dhe internimit. Në gjykimin e qeverisë, kjo pengonte zbatimin e mirë të dekretligjit.<sup>11</sup>

Arsyetimi i dytë i qeverisë kishte nuanca skizofrenie, sepse paraqiteshin si reale argumente të bazuara në një realitet imagjinar. Në dekretligjin për zbatimin e vendimit të dëbimeve dhe konfiskimit të pasurisë (1949) nuk kishte asnjë lloj paqartësie mes koncepteve (nocioneve) të dëbimit dhe internimit, siç pretendonte qeveria në arsyetimin e saj. Në dekretligj trajtohej vetëm çështja e dëbimeve, ndërsa internimet (siç e kemi përmendur më sipër) nuk përmendeshin fare. Koncepti i internimit si masë administrative,<sup>12</sup> u shfaq për herë të parë në një dokument ligjor të regjimit komunist në dekretin Nr. 1906, 2 gusht 1954. Paqartësia e pretenduar nga qeveria nuk ishte në dekretligj, por në veprimtarinë e institucioneve. Ato kishin dhënë vendime për izolimin e paligjshëm, kishin ngritur kampet e izolimit dhe gjithë infrastrukturën për mbajtjen e tyre, kishin izoluar me mijëra njerëz, duke trajtuar si ligj për internimet dekretligjin për dëbimin dhe konfiskimin.

Nga dokumentet e Byrosë Politike të vitit 1954 mësojmë gjithashtu se, deri atëherë, nuk kishte asnjë ligj ose dekretligj që përdorte termin internim (si dënim administrativ). Në mbledhjen e Byrosë Politike, 8 shkurt 1954, Ministri i Brendshëm, Mehmet Shehu, paraqiti Platformën e Ministrisë së Brendshme, dhe, në gjykimin e tij, Platforma kishte disa probleme

---

*kampet e Shqipërisë komuniste* (Tiranë: ISKK, 2015), 8. Romani i Marçel Hilës, *Internimi i Kufomës* (2015), nis pikërisht me shpërnguljen me forcë nga Tirana të familjes Xoxa, ditën e fatkeqësisë.

<sup>9</sup> AQSH, F. 490, V. 1954, D. 215, Fl. 1. Relacion i Këshillit të Ministrave, 22 qershor 1954.

<sup>10</sup> Dekretligji për konfiskimet e shfuqizoi dekretligjin Nr. 649, 10 janar 1949, për zbatimin e vendimeve të dëbimit dhe konfiskimit, dhe në periudhën 22 mars – 2 gusht 1954 nuk kishte ligj për dëbimet.

<sup>11</sup> AQSH, F. 490, V. 1954, D. 215, Fl. 1. Relacion i Këshillit të Ministrave për projektligjin “Mbi internimin dhe dëbimin si masë administrative.”

<sup>12</sup> Koncepti i internimit dhe dëbimit si “masë administrative” ishte një sajësë e regjimit komunist për të fshehur ndëshkimin e njerëzve për arsye politike, sepse, realisht, ata ishin persona të dënuar, por që nuk kishin kryer ndonjë vepër penale.

të vogla, siç ishte, për shembull, fakti që në të flitej për internimet, ndërsa ekzistonte një ligj që fliste për dëbimet dhe konfiskimet. Shehu e gjykonte të pavend fjalën internim, sepse nuk kishte një ligj ku përdorej ky koncept. Ai tha gjithashtu se Ministria e Drejtësisë kishte propozuar që të bëhej një ligj për “internimet dhe dëbimet”. Ai pyeti në duhej ruajtur termi internim në tekstin e Platformës, gjë Enver Hoxha, drejtuesi i mbledhjes së Byrosë, e miratoi. Megjithatë, për t’u siguruar që e kishte dëgjuar mirë, Shehu pyeti sërish: “Domethënë, ta mbajmë termin internim[?]” Hoxha ia ktheu: “Po, ta mbajmë.”<sup>13</sup> Kështu, termi internim u fut në Platformën e Ministrisë së Brendshme, shtatë muaj e gjysmë më herët sesa miratimi i ligjit për internimet.

Fakti që ligji i parë për internimet doli më 1954 vërtetohet dhe nga dokumente të mëvonshme. Në një relacion të Ministrisë së Brendshme për Kryeministrinë, 17 janar 1962, thuhej: “Për problemin e t’internuarve deri tani janë dy dekrete: dekreti 1906, datë 2 gusht 1954... dhe dekreti 3027, datë 17 janar 1960...”<sup>14</sup> Konstatimi i këtij relacioni ishte i bazuar vetëm në dokumentet ligjore ekzistuese dhe jo në ligjërimin e përditshëm të zyrtarëve, të cilët në shumë raste i kishin përdorur gabimisht, njërin në vend të tjetrit, termat internim dhe dëbim.

Pas dekretimit të Statutit të Republikës, 14 mars 1946, vendimet e internimeve (deri më 1954) dhe dëbimeve (deri më 1949) të dhëna nga institucione të tjera, veç gjykatave, ishin antikushtetuese. Neni 19, paragrafi 6, i Statutit thoshte: “Asnjë shtetas nuk munt të nxirret jashtë shtetit ose të internohet brenda shtetit, veçse në rastet e parashikuara me ligjë.”<sup>15</sup> Çështja e dëbimeve brenda vendit nuk përmendej në Statut, por vendimet e dëbimeve ishin antikushtetuese, sepse jepeshin nga institucione shtetërore të cilat nuk ishin ligjërish të autorizuara për të dhënë vendime të tilla. Sipas Statutit (Neni 4, paragrafi 2), “të gjitha veprimet e organeve t’administratës së shtetit dhe të gjykatave duhet të jenë të bazuara në ligjë.”<sup>16</sup> Statuti kishte sanksionuar përparësinë e ligjit mbi institucionet. Asnjë institucion nuk mund të kryente një veprimtari të pa parashikuar në ligj.

### ***Motivet për rregullimin ligjor të dëbimeve dhe internimeve***

Dekretligji për zbatimin e vendimeve të dëbimit dhe konfiskimit të pasurisë (1949) dhe ai mbi internimin dhe dëbimin si masë administrative (1954) u krijuan më shumë si rrjedhojë e

---

<sup>13</sup> AQSH, F. 14/APOU, V. 1954, D. 7. Fl. 88. Proceverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 8 shkurt 1954.

<sup>14</sup> AQSH, F. 490, V. 1962, D. 293, Fl. 1. Relacion i Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Kryeministrisë, 17 janar 1962.

<sup>15</sup> “Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë,” *Gazeta Zyrtare*, Nr. 19 (19 mars 1946): 3.

<sup>16</sup> “Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë,” *Gazeta Zyrtare*, Nr. 19 (19 mars 1946): 1.

situatave politike, sesa si përpjekje e sinqertë e regjimit për të përmirësuar situatën ligjore kaotike.

Në pranverën e vitit 1948 nisi çarja e Bllokut Komunist, i cili, deri atëherë, kishte qenë monolit, nën kontrollin e Bashkimit Sovjetik. I pakënaqur me sjelljen e udhëheqjes jugosllave, Stalini e denoncoi atë për devijime ideologjike dhe veprimtari antisovjetike, ndërkohë që kërkoi nga vendet e tjera të Bllokut të bënin të njëjtën gjë. Me direktivën e Moskës nisi, në të gjitha vendet anëtare të Bllokut, gjuetia e të ashtuquajturve agjentë jugosllavë. Në zbatim të kësaj direktive, udhëheqja e PPSH arrestoi një grup zyrtarësh të lartë, të kryesuar nga ministri i Brendshëm Koçi Xoxe, të cilët i akuzoi si agjentë të Jugosllavisë dhe i bëri përgjegjës për veprimtarinë e dhunshme dhe të paligjshme të ushtruar deri atëherë nga Ministria e Brendshme dhe institucione të tjera.

Më 10 janar 1949, Kuvendi Popullor miratoi një dekretligj për amnistinë e arratisurve dhe pas ditë më vonë qeveria u dërgoi gjithë komiteteve ekzekutive të rretheve një qarkore,<sup>17</sup> ku pranohej se deri atëherë ishin përndjekur dhe burgosur edhe njerëz të pafajshëm, të cilët nuk kishin qenë të rrezikshëm për regjimin. Sigurimi i Shtetit akuzohej se, nën frymën “trocikiste” të Koçi Xoxes, kishte marrë masa të “paligjdhme dhe arbitrare”, me qëllim, thuhej në qarkore, “për të ndarë popullin nga pushteti [udhëheqja e regjimit]”. Qarkorja u kërkonte komiteteve ekzekutive që të shkonin “deri në kasollen më të largët të rrethit të tyre” për të propaganduar dekretligjin e amnistisë për të arratisurit.

Pjesë e kësaj fushate propagandistike, e cila synonte të parcelizonte përgjegjësinë për dhunën e ushtruar nga regjimi në vitet e para të regjimit komunist, duke ia faturuar grupit të të arrestuarve dhe të shfajësonte pjesën tjetër të udhëheqjes së PPSH, ishte dhe dekretligji për dëbimet dhe konfiskimet, i cili, së bashku me dekretligjin për amnistinë, u miratuan brenda të njëjtës ditë, si projekt-dekrete nga qeveria dhe si dekrete nga Kuvendi Popullor. Pjesë e të njëjtës strategji ishte amnistia për të burgosurit, me përgatitjen e së cilës merrej Ministria e

---

<sup>17</sup> AQSH, F. 490, V. 1949, D. 5, Fl. 9. Qarkore e Kryeministrisë drejtuar gjithë komiteteve ekzekutive të rretheve dhe qyteteve. Dokumenti ka vetëm vitin, 1949, pa datë, por kuptohet që është i janarit 1949, sepse, duke i referuar përmbajtjes, ka dalë menjëherë pas miratimit të projekt-dekretit mbi amnistinë për të arratisurit.

Brendshme, dhe mbyllja e kampit të izolimeve të paligjshme në Berat.<sup>18</sup> Amnistia për të burgosurit u dekretua në 27 prill 1949,<sup>19</sup> ndërsa kampi i Beratit u mbyll në maj po atij viti.<sup>20</sup>

Edhe dekretligji për internimin dhe dëbimin (1954), nevojën për të cilin qeveria e arsyetoi me daljen e ligjit të konfiskimeve dhe paqartësinë e nocioneve dëbim dhe internim në dekretin për dëbimin dhe konfiskimin, ishte përpjekje e regjimit për t'iu përgjigjur një situatë të re politike. Në ndryshimet ligjore të kësaj periudhe ndikuan zhvillimet brenda Bllokut Komunist. Pas vdekjes së Stalinit (5 mars 1953), në drejtimin e Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik kishin ardhur udhëheqës të rinj, të cilët kishin dhënë shenja për distancimin nga metodat shtypëse të periudhës së Stalinit. Gjatë vitit 1953, udhëheqja sovjetike thirri në takime udhëheqjet e gjithë partive komuniste të vendeve të Bllokut dhe u bëri të njohur drejtimet kryesore të politikës së Moskës. Në vija të përgjithshme, udhëheqja sovjetike u kërkoi vendeve satelite që buxhetet e tyre të shkonin më shumë për plotësimin e nevojave të popullsisë me produkte ushqimore dhe mallra konsumi, të zbatonin politika më liberale tregu dhe për shërbimet ndaj qytetarëve, të ndërprisnin krijimin e kooperativave bujqësore, të amnistionin në masë të arratisurit dhe të burgosurit, të mbyllnin kampet e punës dhe të internimit, dhe të liberalizonin kufijtë midis tyre.<sup>21</sup>

Udhëheqja e PPSH nuk ishte dakord me gjithçka që i kërkuan sovjetikët, por disa përshtatje i bëri. Sovjetikët i kërkuan Enver Hoxhës të hiqte dorë nga postet e shumta dhe të mbante vetëm postin e sekretarit të përgjithshëm të partisë.<sup>22</sup> Në mbledhjen e Byrosë Politike në muajin shkurt 1954, kur u paraqit Platforma e Ministrisë së Brendshme, Mehmet Shehu ishte Ministër i Brendshëm, ndërsa në gusht, kur u propozua dekret-ligji për internimet dhe dëbimet, ishte kryeministër, prej 12 ditësh. Brenda një viti, që nga takimi me udhëheqjen sovjetike në qershor 1953, Hoxha hoqi dorë nga posti i Ministrit të Jashtëm, Ministrit të Mbrojtjes, dhe nga

---

<sup>18</sup> AQSH, F. 490, V. 1949, D. 5, Fl. 1-2. Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, 10 janar 1949. Enver Hoxha tha në mbledhjen e qeverisë, 10 janar 1949, se “mendojmë” [mendonte Byroja Politike] të marrim dhe një masë tjetër, e cila ishte lirimi i grave dhe kalimajve të izoluar (internuar, sipas Hoxhës) në Berat, sepse kjo, sipas tij, do të kishte efekt të madh propagandistik për imazhin e regjimit. Sipas historianit Kastriot Dervishi, kampi i Beratit u mbyll sepse ishte e vështirë të menaxhohej dhe mund të jetë më afër të vërtetës. Po atë vit u krijua kampi izolimit (internimit, në ligjërimin zyrtar) në Tepelenë, dhe një pjesë e të izoluarve të Beratit, mes tyre gra e fëmijë, u dërguan në Tepelenë. Nuk dihet sa fëmijë e gra të izoluar në Berat u falën, nëse u falën, por fakt është që kampi u mbyll dhe qeveria mund ta përdorte atë si dëshmi të vullnetit të mirë të saj për t'iu distancuar nga koha e “dhunës së Koçi Xoxes.”

<sup>19</sup> “Dekret Nr. 819, 27 prill 1949, mbi faljen e dënimeve dhe zbritje dënimesh të disa të burgosurve ordinerë dhe të armiqve të popullit,” *Gazeta Zyrtare*, Nr. 40 (19 maj 1949): 1-44.

<sup>20</sup> Kastriot Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste* (Tiranë: ISKK, 2015), 15.

<sup>21</sup> Ana Lalaj, *Pranvera e rrejtshme e '56-ës* (Tiranë: Infbotues, 2015), f. 32.

<sup>22</sup> Ana Lalaj, “1953 – Udhëheqësit e rinj sovjetikë paralajmërojnë: ose ndryshime ose katastrofë,” *Studime Historike* nr. 1-2 (2010), 231.



ai i kryeministrit. Me heqjen dorë nga drejtimi i qeverisë, Hoxha nuk veshi më uniformë ushtarake në publik.

Pjesë e këtyre përshtatjeve ishte dhe Platforma e Ministrisë së Brendshme, e përgatitur me ndihmën e këshilltarëve sovjetikë, e cila nxiti krijimin e dekreligjeve të reja për konfiskimin, rekuizimin, shpronësimin, internimet dhe dëbimet. Kjo dinamikë legislative ishte në harmoni me porosinë që udhëheqja sovjetike i kishte dhënë delegacionit të udhëheqjes shqiptare në Moskë (qershor 1953): “Komiteti Qendror, qeveria, dhe Byroja Politike do të bëjnë ligje, urdhëresa, vendime për të vënë në jetë këto ndryshime [të propozuara prej sovjetikëve].”<sup>23</sup>

### ***Origjina e internimeve dhe dëbimeve të paligjshme***

Origjina e izolimit të paligjshëm të qytetarëve, vetëm se ata kishin lidhje gjaku me persona të konsideruar kundërshtarë të regjimit komunist, daton më herët se zaptimi ushtarak i institucioneve dhe territorit të Shqipërisë prej komunistëve. Në një raport<sup>24</sup> që komanda e Brigadës së 2-të partizane i dërgonte Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Partizane, më 25 qershor 1944, thuhej se forcat e kësaj Brigade kishin “arrestuar” dhe do t’i “internonin” të afërmit – baballarë dhe vëllezër – të disa personave, të cilët, sipas raportit, vazhdonin t’i qëndronin besnikë Ballit Kombëtar. Personat e konsideruar të arrestuar parashikohej të mbaheshin në “internim” derisa bijtë ose vëllezërit e tyre t’iu dorëzoheshin forcave partizane. Për të njëjtat arsye, partizanët kishin bërë dhe “sekuestrimin” e pasurisë – edhe këtu përdorej një koncept juridik - të disa qytetarëve në zonën e Dangëllisë, ku vepronte Brigada në atë periudhë. Në raport thuhej gjithashtu se “arrestimi” – një tjetër koncept juridik – ishte bërë me vendim të gjykatës së Brigadës, ndërsa “sekuestrimi” i pasurisë ishte bërë bazë të një rregulloreje.

Përmendja e vendimit të gjykatës dhe e rregullores tregon kujdesin e hartuesve të raportit – Beqir Balluku dhe Vasil Konomi – për të dëshmuar se veprimtaria e tyre ishte në përputhje me një kornizë të caktuar ligjore. Prej verës së vitit 1943 deri në 20 dhjetor 1944, gjyqet partizane “në bazë të rregulloreve provizore e shumë të thjeshta”<sup>25</sup> të miratuara nga Shtabi i Përgjithshëm, dhe jo nga KPNC (Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar ose KANÇ - Këshilli i Antifashist Nacional-Çlirimtar, siç u quajt pas 24 majit 1944), i cili luante rolin e

---

<sup>23</sup> Ana Lalaj, “1953 – Udhëheqësit e rinj sovjetikë paralajmërojnë: ose ndryshime ose katastrofë,” *Studime Historike* nr. 1-2 (2010), 230.

<sup>24</sup> AQSH, F. 41, V. 1944, D. 83, Fl. 5-6. Raport i Shtabit të Brigadës II për Komandën e Përgjithshme të ushtrisë partizane.

<sup>25</sup> AQSH, F. 41/APL, V. 1944, D. 56, Fl. 35. Qarkore e Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Partizane, 20 dhjetor 1944.

një organi ligjberës. Më 20 dhjetor, këto rregullore u zëvendësuan nga një rregullore e re, e cila ishte përkthim i një modeli të ushtrisë partizane jugosllave. Rregullorja e re nuk parashikonte masën e dënimit me internim ose dëbim; modeli jugosllav parashikonte vetëm dëbimin.<sup>26</sup>

Raporti i Brigadës së 2-të e pranonte që personat e ndaluar nuk kishin kryer asnjë krim, por ishin ndaluar për diçka që mendohej se e kishin bërë të afërmit e tyre. Në terma juridikë, “arrestimi” dhe “internimi” i tyre ishte privim i paligjshëm i lirisë. Fakti që për lirimin e tyre ishte vënë një kusht (braktisja e Ballit nga të afërmit) e bënte izolimin një akt pengmarrjeje, për qëllime përfitimi politik ose ushtarak, ose të dyja njëherësh.

### ***Internimet dhe dëbimet e ligjshme në periudhën 1944-1954***

Paligjshmëria e vendimeve të internimit dhe dëbimit ishte e theksuar në vendimet e konsideruara masë administrative. Në këto raste, ndëshkimi ishte politik;<sup>27</sup> vendimi merrej ndaj personave që nuk ishin fajtorë, ata ndëshkoheshin për shkak të lidhjes së gjakut që mund të kishin me persona, të cilët ishin në arrati brenda ose jashtë vendit. Në rastin e vendimeve si masë ndëshkimore penale, të cilat i jepte gjykata, kishte një farë baze ligjore. Gjykatat ushtarake, të cilat ishin shumë aktive në periudhën 1944-54, e bazonin dhënien e internimit si masë dënimi në dekretligjin Nr. 41, 14 janar 1945. Ky lloj dënimi jepej në rastet kur personi mendohej që kishte kryer një vepër e cila, bazuar në kornizën ligjore ekzistuese, konsiderohej vepër penale. Në Kodin Penal (1948), një nga format e dënimit që jepte gjykata ishte dëbimi, ndërsa internimi jo. Në Kodin Penal që u miratua më 1952, i cili shfuqizoi gjithë ligjet penale për gjykatat civile në fuqi nga 1946, u përfshinë të dy llojet e dënimeve: internimi dhe dëbimi.<sup>28</sup> E veçantë e këtij ligji ishte ndalimi i dënimit me internim të të miturve që kryenin krime,<sup>29</sup> ndërkohë që ata mund internoheshin – dhe interenhoshin, për shkaqe politike, në mënyrë masive. As dekretligji për dëbimet dhe konfiskimin (1949) dhe as dekretligji për internimet dhe dëbimet (1954) nuk i përjashtonin të miturit nga internimi ose dëbimi; ato nuk bënë asnjë lloj përjashtimi.

### ***Krahasimi i dekretligjeve të regjimeve të ndryshme***

---

<sup>26</sup> AQSH, F. 41/APL, V. 1944, D. 56/1, Fl. 4. Rregullore mbi gjyqet ushtarake, e ushtrisë partizane jugosllave (përkthyer në shqip).

<sup>27</sup> Në Platformën e Ministrisë së Brendshme (1954) thuhet se një kategori personash internoheshin për shkak se dënimi i tyre me anë të gjykatave ishte i pamundur, ngaqë nuk mund të vërtetohej fajësia e tyre. Pra, këto dënime, të cilat quheshin administrative, ishin dënime politike. *Shiko*: AQSH, F. 14/APOU, V. 1954, D. 7. Fl. 88.

<sup>28</sup> Kodi Penal i RP të Shqipërisë (Tiranë: 1952), 14-15.

<sup>29</sup> Kodi Penal i RP të Shqipërisë (Tiranë: 1952), 14.

Historia e internimeve në Shqipëri nuk nisi me regjimin komunist, ndaj po bëjmë një krahasim të dekretligjit Nr. 1906, 1954, mbi internimin dhe dëbimin, me dekretligjet e qeverisjes së Fan Nolit (1924) dhe qeverisjes së Ahmet Zogut (1925). Këto tre qeveri ngjanë me njëra-tjetrën nga mënyra si erdhën në pushtet. Duke marrë pushtetin me dhunë, Fan Noli dhe mbështetësit e tij prishën traditën e ndërrimit të qeverisjes me anë të zgjedhjeve, e pa ndërprerë që nga Kongresi i Lushnjës. Pushteti i Nolit zgjati prej 16 qershor – 23 dhjetor 1924; Ahmet Zogu ia mori pushtetin po në atë mënyrë që Noli e kishte marrë gjashtë muaj më herët. Dy dekada më vonë, komunistët bënë të njëjtën gjë, në përmasa më të gjera dhe më të dhunshme.

Në të tre rastet, grupi që rrëmbeu pushtetin mori masa për minimizimin e mundësisë së reaksionit të palës së humbur. Një ndër masat e marra ishte miratimi i dekretligjeve për internimin e familjarëve të të arratisurve (kundërshtarëve politikë). Qeveria e Fan Nolit nxori dy dekretligje për internimet,<sup>30</sup> brenda dy muajve të parë në pushtet, aq sa nxori dhe qeveria e Ahmet Zogut, pak a shumë brenda të njëjtës hapësirë kohore.<sup>31</sup> Edhe komunistët e zbatuan politikën e internimit që në ditët e para të pushtetit të tyre, por e bënë këtë pa miratuar ndonjë ligj; dekretligjin e parë e miratuan 10 vjet pasi kishin marrë pushtetin. Shpejtësia e qeverisë së Nolit dhe Zogut në nxjerrjen e dekretligjeve për internimin tregon kujdesin e qeverive respektive për rregullimin ligjor të veprimtarisë së tyre.

Të tre qeveritë i internonin propagandistët, por ligji i Nolit dhe Zogut ishin transparentë. Ata e theksonin në dekretligj që propagandistët ndëshkoheshin për vepra, të cilat nuk mund të provoheshin në gjykatë, ndërsa komunistët jo. Gjatë regjimit komunist personat që mendohej se bënë propagandë kundër regjimit dënoheshin me burg; propaganda ishte vepër penale që prej vitit 1946 deri më 1990. Komunistët dënonin me internim persona që kishin qenë zyrtarë në qeverisjet parakomuniste, por, meqë një gjë e tillë nuk mund të provohej si krim në gjykatë, ata persona internoheshin, me pretendimin se paraqisnin rrezikshmëri shoqërore. Në dekretligjin për internimet nuk thuhej se rrezikshmëria e tyre nuk mund të provohej në gjykatë, por kjo thuhej në Platformën e Ministrisë së Brendshme.<sup>32</sup> Transparenca në dekretligjin e Nolit dhe Zogut mund të shihet dhe si shenjë respekti e qeverive respektive nda procesit gjyqësor.

---

<sup>30</sup> “Dekretligjë mbi vrasjen e kriminelve të gjykuem, të pandehun n’aratië e t’internimit të familjeveve tyne,” *Fletore Zyrtare*, Nr. 28 (22 korrik 1924): 3; “Dekretligjë për internimin e auktorëve qi bajnë propaganda të rrezikshme dhe qi nuk provohen nga ana e Gjykatoreve,” *Fletore Zyrtare*, Nr. 30 (13 gusht 1924): 1.

<sup>31</sup> *Ligje, dekretligje, e rregullore të vjetit 1925* (Tiranë: Këshilli i Shtetit, 1938), 31, 50.

<sup>32</sup> AQSH, F. 14/APOU, V. 1954, D. 7. Fl. 88. Platforma e punës së Ministrisë së Brendshme miratuar nga Byroja Politike e KQ të PPSH, 8 shkurt 1954.

Dekretligji i Nolit dhe Zogut për të arratisurit parashikonin dhe internimin e familjeve të personave që mund të strehonin të arratisurit. Në dekretetligjin e Nolit nuk thuhej gjë për pasurinë e të internuarve, ndërsa Zogu dhe komunistët e shoqëronin internimin dhe me sekuestrimin e pasurisë. Në ndryshim nga komunistët, dekretligji i Zogut parashikonte që, me dorëzimin e të arratisurve, nëse faleshin nga Kryesia e Shtetit, atyre u kthehej pasuria ose vlera e saj në të holla.

Të dy dekretligjet e Zogut urdhëronin një institucion përkatës përgjegjës për caktimin e vendit të internimit; dekretligji për internimin e propagandistëve parashikonte që qeveria t'u siguronte strehimin dhe ushqimin. Kësi detajesh mungonin në dekretligjet e Nolit dhe ishin të pjesshme në ato të komunistëve, sepse ato ngarkonin një institucion që do të jepte vendimet e internimeve dhe dëbimeve, por nuk autorizonin kënd për përcaktimin e vendit të internimeve, ose nuk flisnin për ushqimin etj. Sa i përket regjimit komunist, në periudhën 1944-49 ushqimi i personave të konsideruar të internuar ishte vetëm një copë bukë të thatë, ndërsa, më 1949, qeveria mori vendim që t'u jepej “përveç bukës dhe nga një kg supë në ditë.”<sup>33</sup> Veç kësaj, në vitet e para të regjimit komunist, personat e izoluar në kampe me tela me gjemba (të internuarit, në ligjërimin e qeverisë) bënin punë të detyruar, në kushte çnjerëzore, pa shpërblim; një gjendje në përputhje me konceptin e skllavërisë.<sup>34</sup> Më vonë, të internuarit ushqeheshin me punën e tyre.<sup>35</sup>

Dekretligji i qeverisë së Zogut për internimin e familjeve të të arratisurve ishte më i mëshirshëm. Ai përjashtonte nga internimi anëtarët e familjes që ishin “uloga e studenta aktivë.”<sup>36</sup> Ky dekretligj, i ndryshuar në dhjetor 1925, përjashtoi nga internimet dhe vajzat e

---

<sup>33</sup> AQSH, F. 490, V. 1949, D. 234, Fl. 1. Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 476, 5 tetor 1949. *Shënim 1*: Të internuarit në Berat, kamp që u mbyll para daljes së vendimit të qeverisë për shtimin e supës në menunë e të internuarve, kanë dëshmuar më vonë që ushqimi i tyre ishte vetëm 600 gr bukë misri në ditë dhe asgjë tjetër. Shiko: *Zërat e Kujtesës III*, Agron Tufa dhe Luljeta Lleshanaku, redaktorë, (ISKK: Tiranë, 2016), 131.

<sup>34</sup> Në lidhje me punën e personave të izoluar në kampet e përqëndrimit, zyrtarisht të njohura si kampe internimi, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit ka botuar një seri intervistash me ish të përndjekur politikë, përfshi dhe persona që kanë jetuar në kampet e përqëndrimit, të cilët rrëfejnë dhe për punën që bënin në ato kampe. Këto libra janë pjesë e një kolane, *Zërat e Kujtesës* (ky është titulli i të gjithë vëllimeve), e cila botohet çdo vit që prej vitit 2014. Deri tani janë botuar katër vëllime, është në proces shtypshkrimi vëllimi i 5-të.

<sup>35</sup> *Shënim*: Trajtimi ekonomik i të internuarve, gjatë pushtimit italian, ishte shumë më i mirë se gjatë regjimit komunist. Kol Bib Mirakaj, ministër i Brendshëm i Shqipërisë (12 shkurt 1943-10 shtator 1943), shkruan se të internuarve shqiptarë në Itali u jepej një pagë e mjaftueshme nga qeveria italiane për jetesë. Familjeve të atyre që ishin dobët ekonomikisht u jepej një ndihmë mujore nga qeveria shqiptare e mjaftueshme për të përballuar jetesën, gjatë kohës që të afërmit e tyre ishin në internim. Nëpunësve të shtetit shqiptar, të cilët ishin të internuar, u ruhej vendi i punës, u jepej rroga mujore, u jepej dhe paga ditore e të internuarit në Itali. Lexo: Kol Bib Mirakaj, *Vetrasja e një Kombi* (Shkodër: Botimet Fiorentina, 2014): 158.

<sup>36</sup> *Ligje, dekretligje, e rregullore të vjetit 1925* (Tiranë: Këshilli i Shtetit, 1938), 50. *Shënim*: Nuk jam i sigurt në termi student përdoret për të rinj që vazhdonin universitetin apo gjimnazin, sepse ka pasur raste, që në tekste të ndryshe – jo ligjore, e kam gjetur këtë term me kuptimin e dytë. Nëse bëhet fjalë për universitarët, atëherë i takon që ata studionin jashtë vendit, sepse Shqipëria nuk kishte universitete.

fejuara, mbi 15 vjeç, të cilat nuk kishin dalë te burri.<sup>37</sup> Dekretligjet e Nolit dhe komunistëve nuk bënë përjashtime.

### ***Përfundime***

Kaosi ligjor lidhur me internimet dhe dëbimet që ekzistoi në Shqipëri në periudhën 1944-1954 ishte tërësisht zgjedhje e udhëheqjes së regjimit komunist. Ajo zgjodhi, në mënyrë të vullnetshme, të shkelte ligjet ekzistuese të shtetit shqiptar, megjithëse, ligjërisht kishte pranuar vazhdimësinë e tyre. Sjellja që dikur kishte qenë normale për botën e krimit u bë normale për institucionet shtetërore.

Të përmbledhura, përfundimet e këtij studimi, janë:

1. Të gjitha vendimet e konsideruara vendime internimi, me përjashtim të vendimeve të gjykatave, për periudhën 1944-1954, ishin të paligjshme. Sipas Kodit Penal të regjimit komunist, çdo vendim internimi ishte vepër penalisht e dënueshme, sepse, duke qenë të pabazuara në ligj, ato ishin vendime për kufizimin e paligjshëm të lirisë së personit.

2. Të gjitha vendimet e dëbimit të dhëna gjatë periudhës 1944-1949, përjashtoj vendimet e gjykatave, ishin të paligjshme dhe, bazuar edhe në ligjet e regjimit komunist, penalisht të dënueshme.

3. Vendimet e internimit dhe dëbimit, të dhëna në mungesë të ligjit, pas miratimit të Statutit të Republikës (1946), ishin në shkelje të Statutit.

4. Kampet e internimit ishin, për sa kohë që ekzistuan, të paligjshme. Edhe dekretligji i miratuar më 1954, për internimet dhe dëbimet si masë administrative, nuk parashikonte krijimin e kampeve të internimit, as institucionin që duhet të merrej me strehimin dhe ushqimin e të internuarve.

Përdorimi i koncepteve juridike si “internim”, “dëbim”, “sekuestrim”, etj., gjatë luftës civile e më pas, ishte një përpjekje e qëllimshme e komunistëve për të dhënë veprimtarisë së tyre autoritet institucional, ndërsa realisht veprimtaria e tyre ishte e paligjshme. Ky lloj artikulimi shërbente për të transferuar përgjegjësinë nga fajtori te viktima; për shembull, nga pengmarrësi te pengu ose nga hajduti te personi i vjedhur, etj.

---

<sup>37</sup> Ligj mbi ndryshimin e artikujve 1, 2 e 3 të ligjës mbi internimet e familjeve dhe konfiskimit të pasurisë së të arratisurve, në: *Ligje, dekretligje e rregullore të vjetit 1925* (Tiranë: Këshilli i Shtetit, 1938), 442.

## **Etleva Smaçi - Akademia e Forcave të Armatosura, Tiranë**

### **Shfrytëzimi i krahut të punës në repartet e Xhenios dhe Ndërmarrjet Ushtarake Bujqësore: trajtimi diskriminues i ushtarëve që vinin nga familjet e deklasuara**

#### **Abstrakt**

Diskutimi analizon shtrirjen e luftës së klasave edhe në shërbimin e detyrueshëm ushtarak, mungesën e besimit të fëmijët e “armiqtë të klasës”, për t’i pajisur me armatimin ushtarak, paracaktimi i tyre për shërbim të detyrueshëm në repartet e xhenios dhe pas viteve ’70 me krijimin e Ndërmarrjeve Bujqësore Ushtarake edhe në to. Volumi i punës ndërtimore që kryhej në xhenio ishte i barasvlefshëm me ato të veprave të mëdha dhe këta të rinj u përdorën si krah i lirë pune në ndërtimin e objekteve ushtarake të një vështirësie shumë të lartë. Repartet e xhenios që u përdorën për të ndëshkuar dhe izoluar të rinjtë që vinin nga familjet me një të kaluar të dyshimtë, mund të konsideroheshin kampe pune, ku liritë dhe të drejtat pothuajse nuk ekzistonin, mbijetesa në to ishte po aq e vështirë, sa edhe në kampet e punës të ngritura në zona të ndryshme internimi.

#### ***Repartet e Xhenios, repartet e të deklasuara***

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, arma e Xhenios u përdor gjerësisht për hapjen e rrugëve, ndërtimin e urave dhe veçanërisht objekteve ushtarake të rëndësisë së veçantë si p.sh., tunelet e Porto Palermos, tunelet e bazave ajrore Gjadër e Kuçovë, në ishullin e Sazanit etj., madje edhe në realizimin e fortifikimit masiv të vendit me sistem bunkerësh. Të gjithë dëshmitarët okularë, ushtarakë pjesëtarë të forcave të Xhenios, në intervista apo edhe në botime në formën e kujtimeve, pohojnë se “forcat e xhenios përveç, mbrojtjes së shtetit në rast lufte, punuan edhe për ndërtimin e objekteve social-ekonomike”.<sup>1</sup>

Por ajo që shpesh mungon në këto dëshmi, që kryesisht vijnë nga ushtarakët që kanë qenë drejtues të batalioneve, brigadave apo Divizionit të Xhenios, është fakti se këto reparte shfrytëzuan për ndërtimin e veprave të mëdha krahun e lirë të punës së ushtarëve si dhe faktin, se përzgjedhja e tyre për repartet e xhenios bëhej mbi kritere klasore.

Në një intervistë të dhënë për *Albanian Free Press*, ish oficeri i Xhenios në repartin ushtarak nr. 3205, Porto Palermo e më pas në Regjimentin e Fortifikimit në Qytetin Stalin, Ilirian Dhima duke përmendur punën e madhe që është bërë gjatë regjimit komunist për ndërtimin e veprave të mëdha të socializmit dhe objektet e rëndësishme ushtarake, i vetmi moment kur përmend faktin se repartet e xhenios kishin në përbërje të tyre ushtarë që vinin nga familjet që ishin të deklasuara, është episodi që lidhet me kohën kur ai punonte si ushtarak në repartin nr. 5100 me qendër në Qytetin Stalin në Regjimentin e Fortifikimit.

---

<sup>1</sup>“Intervistë e kryetarit të Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve të Xhenios, Aleksandër Mihali” në: *Shekulli*, 26 janar 2016.

Një ndër njësitë e këtij regjimenti ishte dislokuar në fshatin Brezhdan dhe, I. Dhima duke iu referuar atmosferës që ekzistonte në momentin e marrjes së lajmit të vdekjes së diktatorit Enver Hoxha pohon se: “Sa u takova me eprorët më thanë të shkoja urgjent në repart, pasi kishim kaluar në gatishmëri numër një. Komisari më bëri me dije të kisha kujdes, sepse atë kohë në Xhenio ishin ushtarët me biografi të keqe (kur e kujtoj sot qesh).<sup>2</sup> Në fakt, ata ishin ushtarë më liberalë dhe nuk kishin gatishmëri”. Kështu e mbyll rrëfimin e tij ky ish ushtarak. Fjalja e fundit që këta ushtarë nuk kishin gatishmëri për të gjithë ata që i njohin praktikën e organizimit të Ushtrisë Popullore, shpjegohet me faktin se ky kontigjent ushtarësh nuk konsiderohej si forcë aktive për përdorimin e armëve, pra ishin të përjashtuar jo ligjërisht nga detyra kushtetuese e mbrojtjes së atdheut.

Një ndër dëshmitë e para për punën e detyruar dhe mobilizimin ushtarak për plotësimin e brigadave të punës e gjejmë në raportin e SHBA-së në OKB për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, në vitin 1955, ku evidentohet fakti se “të rinjtë me biografi të papërshtatshme për regjimin thirren për të bërë Ushtrinë në brigade pune pa të drejtë arme.”<sup>3</sup> Njësitë ushtarake që u krijuan me bijtë e “të deklasuarve”, apo edhe me elementët e tjerë të cilët konsideroheshin nga regjimi si të pabesueshëm për të mbajtur armë, fillimisht ishin pjesë e një brigade ushtarake nën kontrollin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Sipas raportit vetëm njëra prej njësive të brigadës kishte 7700 rekrutë, të cilët ishin ndarë në tri batalione që vepronin në pjesë të ndryshme të vendit nga 16 orë në ditë në sektorë të vështirë si bujqësia dhe ndërtimi<sup>4</sup>.

Por rritja e volumit të punës nga ushtria bëri që repartet e xhenios të “specializoheshin në reparte pune me të rinjtë e deklasuar” veçanërisht me strukturimin e Ushtrisë Popullore pas prishjes me Bashkimin Sovjetik. Dokumentacion i mjaftueshëm në lidhje me këtë tematikë (por i padeklasifikuar në pjesën dërrmuese) gjendet në fondin e Drejtorisë së Xhenios dhe për repartet xheniere në Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura si dhe në Sektorin e Ushtrisë në Arkivin Qendror të Shtetit.

Në një informacion të Drejtorisë së Xhenios, përkatësisht të Organizatës Bazë të Partisë së Drejtorisë Politike, që lidhet me problemet e dala në mbledhjen e Komitetit të Partisë të Brigadës së 3-të xheniere në Elbasan, midis shqetësimeve të tjera, përmendet fakti se ushtarët me “qëndrim të keq” ishin inkuadruar gjithashtu në Ndërmarrjet Ushtarake Bujqësore. Këta

---

<sup>2/</sup> “Rrëfimi i Dhimes: kur Greqia merrte grurë nga Shqipëria dhe misioni i Kadri Hazbiut në Jug”, në: [www.albanianfreepress.al/news/2018/05/rrrefimi-i-dhimes-kur-greqia-merrte-grure-nga-shqiperia-dhe-misioni-i-kadri-hasbiut-ne-jug-9065](http://www.albanianfreepress.al/news/2018/05/rrrefimi-i-dhimes-kur-greqia-merrte-grure-nga-shqiperia-dhe-misioni-i-kadri-hasbiut-ne-jug-9065)

<sup>3</sup>“SHBA: në vitin 1955 Shqipëria kishte 40 kampe internimi me 49 000 prsona” në: [www.panomaram.com.al/shba-ne-vitin-1955-shqiperia-40-kampe-internimi-me-49-mije-veta/](http://www.panomaram.com.al/shba-ne-vitin-1955-shqiperia-40-kampe-internimi-me-49-mije-veta/), vizituar më 24 korrik 2018.

<sup>4</sup>Po aty.

ushtarë, duke qenë se përdoreshin si një forcë lëvizëse pune (krah pune i papaguar), konsideroheshin si ushtarë “bujtës”. Lëvizja e tyre “pastronte repartet e tjera, sidomos NBU-të nga ushtarët me qëndrim të keq”, të cilët sipas informacionit shtonin ngjarjet e jashtëzakonshme në atë brigadë.”<sup>5</sup>

Mjaft interesant gjejmë edhe rrëfimin e poetit të njohur Koçi Petriti, lidhur me eksperiencën e tij vetjake si ushtar i Ndërmarrjes Bujqësore Ushtarake Zall Herr, Tiranë. Në shënimet e tij personale, ai e konsideron vitin 1967 si “vitin e tij të zi”. Sipas një shkrese sekrete të mbërritur nga dekanati i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në zyrat e kuadrit në Librazhd, ai jo vetëm nuk duhet të punonte si arsimtar (në radhë të parë për origjinën e tij, ky ishte motivimi), por përjashtohej edhe nga zbori pasuniversitar, madje merret ushtar. Vetë poeti shkruan në shënimet e tij: “Merrem dhunshëm ushtar në Ndërmarrjen Bujqësore Ushtarake të Zall-Herrit që ishte repart pune me ‘të deklasuar’ ”.<sup>6</sup>

Dokumenti i një rëndësie të veçantë, që plotëson për ne “të panjohurat” e kampeve të punës në repartet xheniere si dhe në ndërmarrjet bujqësore ushtarake, është mbledhja e 14 dhjetorit të vitit 1983, e sekretarëve të Komitetit Qendror. Enver Hoxha në këtë mbledhje merret gjatë me çështjet e edukimit politik në sektorët e Ushtrisë. Pjesë e diskutimeve janë pyetjet dhe ndërprerjet e shpeshta ndaj ministrit të Mbrojtjes Popullore, në këtë periudhë Simon Stefani “se si është situata sa i takon edukimit politik në sektorët problematikë si ai i xhenios”<sup>7</sup>?

Simon Stefani gjatë raportimit, duke iu përgjigjur pyetjes së Enver Hoxhës, “nuk pyes kush shkon mirë, po dua të di ku shkojnë më dobët punët? Këtë dua unë të më sqarosh”, sjell në vëmendje disa probleme që ka me divizionet e Pukës dhe Shkodrës, ku në repartet e xhenios ishin shënuar edhe më shumë shkelje të disiplinës dhe të rregullave, duke e justifikuar këtë me rebelimin e djemve të rinj të mobilizuar në ushtri nga familje me qëndrim jo të mirë politik apo në radhët e ish të burgosurve.”<sup>8</sup>

Po cili ishte fati i këtyre ushtarëve? Cili ishte trajtimi i tyre si armiq të klasës, që po në të njëjtën kohë për paradoks kryenin shërbimin e detyruar ushtarak në mbrojtje të atdheut jo me pushkë por me kazma e lopata? Simon Stefani përgjigjet se “në këtë njësi ka thyerje të disiplinës

---

<sup>5</sup>Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (më tej: AQFA), Fondi (më tej: F.) i Drejtorisë Politike, Viti (më tej: V.) 1971, Dosja (më tej: D.) 63, fleta (më tej: fl.) 2. Informacion i Drejtorisë Politike, drejtuar Drejtorisë së Xhenios (Organizatës Bazë të Partisë së Drejtorisë Xhenios) për problemet që kanë dalë në mbledhjen e Komitetit të Partisë të Brigadës së 3- xheniere në Elbasan.

<sup>6</sup>“Kujtimet e Koçi Petritit” në: <http://www.panorama.com.al/kujtimet-e-koci-petritit-ngjarjet-qe-i-shenjuan-jeten/> vizituar më 20 gusht 2018.

<sup>7</sup>Arkivi Qendror i Shtetit [më tej: AQSH], F. 14/Arkivi i Partisë (më tej: AP)/strukturat (më tej: Str), V. 1983, D. 18, fl. 1, 13, 24-29, 35, 39. Realizimi i detyrave për hapjen e transheve dhe hendeklidhjeve nga popullata dhe përfundimi i këtij aksioni me ushtarët aktiv.

<sup>8</sup> Po aty.



nga ana e ushtarëve, po qëndrime jo korrekte ka edhe nga ana e oficerëve ndaj ushtarëve. Ai i shpjegon Enver Hoxhës se: “kur ushtarët shkelin disiplinën, kur shkelin rregulloret, apo kur largohen pa leje nga repartit, oficerët nuk përdorin si dhe sa duhet metodën e bindjes në bazë të rregulloreve, bile ka pasur raste që është përdorur edhe forca kundër ndonjë ushtari”<sup>9</sup>.

Në fakt, pohimi i Simon Stefanit për përdorimin e forcës ndaj këtyre ushtarëve zbulon vetëm majën e ajsbergut. Një ndër drejtuesit e batalionit të Xhenios në Porto Palermo, Xhoxhi Koçi, në intervistën e tij dëshmon se ndëshkimi fizik ndaj këtij grupimi ushtarësh ishte diçka e pranuar, madje ai disa herë është akuzuar për sjellje liberale ndaj ushtarëve të repartit të tij që largoheshin pa leje. Ndëshkimi fizik shoqërohej me masa izolimi e jo në pak raste me ndjekje penale. Për vitin 1983 në repartet 875, 879 dhe 8810 janë 16 ushtarë të çuar për ndjekje penale dhe 3 të tjerë janë dërguar për riedukim. Po kështu ai pohon se në numrin e rasteve të vdekjeve të ushtarëve që mesatarisht ishin 100 në vit në rang Republike, Arma e Xhenios ishte në vendin e parë me numrin më të lartë të aksidenteve në punë, vetëvrasjeve si dhe incidenteve mes ushtarëve dhe drejtuesve.<sup>10</sup>

### ***Reparte ushtarake apo kampe pune të papaguara***

Që repartet e Xhenios konsideroheshin më tepër reparte pune sesa reparte ushtarake që kishin si filozofi stërvitjen dëshmojnë procesverbalet e mbajtura në disa nga regjimentet më të rëndësishme të kohës, sidomos në periudhën e viteve 1970-1985, ku u krye dhe volumi më i madh i punës në objektet e një rëndësie të veçantë. Kështu në dokumentacionin e repartit Ushtarak nr. 3205, Vlorë ku përfshiheshin disa kantiere ushtarake si p.sh., Vërmik, Gusmar apo Sazan, theksohet se: “Për ndërtimin e veprave dhe objekteve fortifikuese të mëdha me qëllim që të mos mpleksen punonjës – ushtarë për çështje aktiviteti të pagave etj., mendojmë të organizojmë ndërmarrje ushtarake fortifikuese dhe këto të mbështeten në *fuqi punëtore ushtarë të reparteve xheniere fortifikuese*. Kjo është e domosdoshme në kushtet e zbatimit të kërkesave të politikës ekonomike të Partisë me të gjithë treguesit e vet”.<sup>11</sup>

Po cili ishte “shpërblimi” i fuqisë punëtore “ushtarë” që sipas dokumentacionit punonte me tri turne, madje edhe vetë kontrollet e ushtruara nga ekipet e Ministrisë së Mbrojtjes vinin në dukje faktin se komandat e këtyre reparteve i kishin kaluar të gjitha limitet e lejuara për përdorimin e kësaj fuqie punëtore. Ja çfarë shkruhet në aktkontrollin e ushtruar në periudhën

---

<sup>9</sup>Po aty.

<sup>10</sup>Xhoxhi Koçi ka kryer detyrën e komandantit të repartit xhenier në Porto Palermo në vitin 1983. Emri i tij gjendet në shumë prej akteve të kontrollit për sjelljet liberale dhe të buta ndaj ushtarëve të padisiplinuar.

<sup>11</sup>AQFA, F. i Drejtorisë së Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, Viti 1983, D. 8, fl. 3, Konkluzione të Komandës së Repartit Ushtarak nr 3205, mbi diskutimin e programit të përgatitjes politike –luftarake për vitin 1983.

15 deri më 17 korrik 1984 në repartin ushtarak nr. 6188 në Vlorë. “Në truprojat e batalionit teknik armët janë me ndryshk dhe me efektivin nuk është zhvilluar asnjë orë stërvitje. Koha e lirë, kultura masive e ora e studimit, aktivitete këto që zhvillohen mbasdite zihen me punë të ndryshme në objekt. Kjo është në kundërshtim me urdhrat e dhëna nga MMP dhe udhëzimet e Komitetit të Partisë dhe komanda e divizionit. Dukuri e veçantë është se nuk është zhvilluar asnjë orë stërvitje me kuadrot si në shtabin e regjimentit ashtu edhe në atë të batalioneve”<sup>12</sup>.

Trajtimi i këtyre reparteve si reparte pune, duke i shmangur nga elementët më sinjifikativ të shërbimit ushtarak, si stërvitja apo përgatitja për luftë duket se kishte ndikuar ndjeshëm në moralin dhe qëndrimin e pjesës dërrmuese të efektivëve. Në një prej raporteve të repartit ushtarak nr. 3205, midis të tjerave thuhet se efektivët shfaqin mendime se “ne jemi repart pune”, “se ku i kemi armët që të luftojmë” dhe gjithashtu pohohet se këto mendime “kanë ndikuar në realizimin e masave praktike”.<sup>13</sup> Volumi i punës së kryer nga këta ushtarë referuar statistikave të mbajtura në repartin nr. 3205 është ekstremisht i madh. Kështu referuar planit vjetor të vitit 1988 ditët e punës që duhet të realizoheshin ishin 27.560 ditë pune në fakt janë realizuar 24.147 ditë pune nga të cilat 20.000 ditë pune nga ushtarët (në punime përfshiheshin edhe punëtorë me pagesë).<sup>14</sup>

Këto reparte pune ishin ngarkuar me barrën e ndërtimit të veprave madhore si: tunele, bunkerë, apo dhe objekte të tjera ushtarake të rëndësisë së jashtëzakonshme. Sipas informacionit që zëvendësministri i Mbrojtjes Popullore Maliq Sadushi i jepte kryeministrit Mehmet Shehu në vitin 1975 jo vetëm punonin në kushte shumë të vështira, por kishin edhe mungesa të jashtëzakonshme në pajime. “Batalionet xheniere nuk kanë asnjë lloj teknike, por janë të pajisura vetëm me vegla pune kazma e lopata”.<sup>15</sup>

Kjo periudhë përkon me masivizimin e fushatës së fortifikimit të vendit me bunkerë. Pikërisht aty ku terrenet ishin më të vështira, por edhe ku kostoja e krahut të punës ishte më e madhe dhe ku gjithashtu nevojiteshin mjete të specializuara për gërmim, hapjen e terrenit malor u zgjodhën të dërgoheshin ushtarët e reparteve xheniere. Në një informacion që drejtori i Drejtorisë së Xhenios, Alfred Moisiu i dërgonte Mehmet Shehut në lidhje me punimet që do të

---

<sup>12</sup>AQFA, F. i Drejtorisë së Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, V. 1984, D. 2, fl. 2- 3, Konkluzione nga ndihma e kontrolli i ushtuar nga ekipet e repartit ushtarak Nr. 6188 dhe 3205 Himarë, 15-17/02 ... për vitin 1984.

<sup>13</sup>AQFA, F. i Drejtorisë së Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, V. 1983, D. 30, fl. 3. Raport i Komandës së Repartit Ushtarak Nr. 3205 “Për forcimin dhe përsosjen e elementeve të gadishmërisë luftarake e efektivit dhe ngritja e nivelit teorik e metodik për realizimin e qitjeve për realizimin e detyrave të planit të punimeve për shërbimin e autogregeve për detyrat ekonomike financiare për vitin 1983 dhe masat për vitin 1984”.

<sup>14</sup>AQFA, F. i Drejtorisë së Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, V. 1983, D. 3, fl. 11. Analizë e vitit 1988 në stërvitje, disiplinë, kushtet e jetesë dhe fortifikim, Rep. 3025, Vlorë.

<sup>15</sup>AQFA, F. i Drejtorisë së Xhenios, V. 1975, D. 118, fl. 1. Informacion i zëvendësministrit të Mbrojtjes Popullore, Maliq Sadushi, drejtuar ministrit të Mbrojtjes Popullore mbi gjendjen e reparteve xheniere të brigadave të tankeve (drejtuar Mehmet Shehut).

kryheshin në malin e Buretos dhe malin e Gjerë, të planifikuara të bëheshin nga popullsia e zonës, kërkon ndryshimin e planit të fortifikimeve për vitin 1975, duke ngritur pikëpyetje në lidhje me zëvendësimin e popullatës me forcat aktive ushtarake. Në përgjigjen e tij, Mehmet Shehu është shumë i qartë kur urdhëron që në këto zona duhen “përdorur vetëm ushtarët për ndërtimin e qendrave të zjarrit”.<sup>16</sup>

### *Ushtari i Xhenios, portreti migjenian i komunizmit*

Kantieret e reparteve të Xhenios të përshkruara nga vetë kontrollorët e regjimit komunist janë dëshmi se vlera e jetëve njerëzore që punonin në to vlente pak, sepse ishin “armiqtë e popullit”. Mungesa e higjienës, varfëria e tejskajshme në ushqimin e racionuar e, mbi të gjitha, problematikat e shpeshta që buronin nga moszbatimi i masave të sigurimit teknik, gjenden pothuajse në të gjitha dosjet që pasqyrohen kontrollat e përvitshme vjetore në këto reparte. Në këtë punim kemi sjellë disa dëshmi nga Reparti Ushtarak nr. 3025, nga kantieret e Vërmikut dhe Gusmarit në periudhën 1980 -1988.

“Fjetinat janë në gjendje shumë të keqe. Poshtë dyshekëve mbahen ndërresa të papastërta, gazeta, kanotiere, çorape. Komodinat mbahen keq dhe nuk kanë gjithë ushtarët. Ka xhama të thyera, kjo më e theksuar në batalionin e ndërtimit. Personeli i shërbimit nuk njih detyrat. Janë kthyer në civila me uniforma ushtari. Dokumentacioni i shërbimit nuk është i plotë, diku edhe nuk gjendet fare. Ka çarçafe të shkurtër, ndonjë edhe i grisur. Dyert përdoren shumë keq, më e theksuar në batalionin e ndërtimit. Gjendja e instalimeve në korridorin e kuzhinës së batalionit të ndërtimit është në kundërshtim flagrant me masat e sigurimit teknik”.<sup>17</sup>

Akoma edhe më tragjik është konstatimi i mjekut se “si rezultat i mbajtjes së papastër të territoreve në këto dy reparte ka një shtesë të madhe të mizave në kantier të cilat po bëhen premisë për sëmundjet epidemike në reparte.”<sup>18</sup> “Banja për larjen e ushtarëve nuk funksionon, ushtarët lahen në natyrë me ujë të ftohtë.”<sup>19</sup> Sipas një statistike shëndetësore të gjashtëmujorit të parë të vitit 1985, për repartin ushtarak nr. 3205 gati gjysma e ushtarëve vuanin nga sëmundjet infektive. Ky repart kishte në batalionet e xhenios 234 ushtarë, prej të cilëve 122 vuanin nga sëmundjet infektive. Po kështu i lartë mund të konsiderohet numri i sëmundjeve

---

<sup>16</sup>AQFA, F. i Drejtorisë së Xhenios, V. 1975, D. 197, fl. 3. Informacion i drejtorit të Drejtorisë së Fortifikimit, drejtuar ministrit të Mbrojtjes Popullore mbi disa probleme të punimeve fortifikuese në K2K si dhe përgjigjja (drejtuar Mehmet Shehut).

<sup>17</sup>AQFA, F. i Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, V. 1983, D. 32, fl. 9, Konkluzione të dala nga kontrolli i ushtuar nga grupet e Rep. Ushtarak nr. 3205 në repartet vartëse për krijimin dhe përsosjen e kushteve të jetesës gjatë vitit 1983. Akti i mbajtur në Gusmar më 10. 08. 1983.

<sup>18</sup>Po aty, fl. 9.

<sup>19</sup>Po aty, fl. 16.

nervore, nga të cilat vuanin 27 ushtarë, që përfaqësonin 10% të efektivit në tërësi (këto sëmundje janë veçuar në një kolonë më vete nga sëmundjet psikike, çka lë të nënkuptuar se janë forma depresioni, stresi, të ekzaminuara pas marrjes në shërbim).<sup>20</sup>

Në raportin e një kontrolli që daton dy vite më pas po për të njëjtat kantiere, Palermo, Vërmik, Gusmar, panorama ngelet e njëjtë. “Në Vërmik shoku S..., sigurimi teknik është jashtëzakonisht i dobët. Duhet të shkosh urgjentisht në repart të vihen masat e sigurimit teknik në nivelin e duhur, pastaj të futen ushtarët në punë. Kjo gjë është më keq në objektin e jetesës. Telat janë jashtë etj. Kushtet e jetesës janë më të këqia, pa këpucë, pa çorape, pa uniform. Ushtarët mbajnë rroba civile”.<sup>21</sup>

Shqetësimet e ngritura në mbledhjen e Komitetit Qendror mbi problematikat e reparteve të xhenios theksohen edhe më shumë pas vdekjes së Enver Hoxhës, që padyshim krijon shumë shpresë tek kjo kategori ushtarësh. Në raportin e vitit 1986, midis të tjerave kërkohet nga inxhinieri i punimeve fortifikuese të batalionit në drejtim teknik në Gusmar që “disiplina proletare në punë të çonte në çfrytëzimin në maksimum të kohës e të mjeteve të punës”.<sup>22</sup>

Mirëpo ky “çfrytëzim në maksimum” për fat të keq shoqërohej me aksidente të vazhdueshme në punë. Në një prej procesverbaleve (pjesa më e madhe janë të padeklasifikuara) që i takon vitit 1988 nga komanda e repartit pranohet se: “si raste të ngjarjeve këtë vit kemi plagosjen e dy ushtarëve dhe këto plagosje ndodhën për arsye se nuk u zbatuan “mirë” masat e sigurimit teknik. Shkeljet në drejtim të sigurimit teknik kanë të bëjnë me ruajtjen dhe administrimin e lëndëve plasëse, sidomos në objektin e Vërmikut”<sup>23</sup>. Ky procesverbal vetëm konstaton dhe për fat të keq dënimet e dhëna për aksidentet në punë janë qesharake. Personat përgjegjës thjesht janë transferuar në detyra të tjera.

Për sa i përket ushtarëve të plagosur ata konsiderohen po aq përgjegjës për moszbatimin e rregullave të sigurimit teknik. Madje, në ato raste kur prej tyre kërkohet raport mjekësor për paaftësi në punë kjo shihej me dyshim nga drejtuesit, si një shenjë parazitizmi.<sup>24</sup>

---

<sup>20</sup>AQFA, F. i Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, V. 1985, D. 197, fl. 1. Evidencë mbi aktivitetin e shërbimit shëndetësor të Repartit Ushtarak 3205.

<sup>21</sup>AQFA, F. i Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, V. 1985, D. 17, fl. 22. Konkluzione të dala nga ekipi i kontrollit ekonomiko-financiar, 13. 9. 1985, mbledhje analize me komandën e divizionit Vlorë, për repartet e Palermos, Gusmarit, Vërmikut.

<sup>22</sup>AQFA, F. i Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, V. 1986, D. 10, fl. 6. Thirrje në raport e inxhinierit të punimeve fortifikuese të batalionit në drejtimin teknik të Rep. ushtarak Nr. 3205, Gusmar, 24. 2. 1986.

<sup>23</sup>AQFA, F. i Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, V. 1988, D. 3, fl. 13. Analizë e vitit 1988 në stërvitje, disiplinë, kushtet e jetesës dhe fortifikim, Rep. 3025, Vlorë. Në shënimet e mjekut të Divizionit të Vlorës për vitin 1985, numri i plagëve me armë zjarri arrinte në 19. Po kështu i lartë është numri i sëmundjeve kirurgjikale të cilat arrinin në rreth 46 raste pa specifikuar arsyet e këtyre ndërhyrjeve. Të dhënat i referohen vetëm Rep. Ushtarak 3205 ku përfshihen Porto Palermo, Vërmiku dhe Gusmari, kështu që të dhënat janë disa herë më të larta për të gjithë repartet e xhenios.

<sup>24</sup>Po aty.

Viti 1988 shënon kulmin e mjerimit në repartet e Xhenios. Aktet e kontrollit flasin për racionim të bukës, mensa të papastruara, pa xhama, ushtarë të palarë “ushtarëve u kishte kaluar koha e larjes”. “U konstatua se buka ushtarëve u ndahej në 6:8:8 racione për shkak të peshës së bukës dhe u vu detyrë të që ajo të ndahej në 6:7:8 racione. Menca nuk ka xhama, çarçaf të palarë e të grisur, menca e papastruar dhe kishte dhe ndyrësira”. Ndarja e bukës në 8 racione zvogëlonte ndjeshëm sasinë e saj për një ushtar. Buka ishte edhe elementi bazik i dietës ushqimore për atë kohë dhe një pakësim i saj ndikonte drejtpërdrejtë në kequshyqirje.<sup>25</sup> Gjithashtu nuk mungonin rastet e abuzimit me produktet e tjera si zarzavatet apo qumështi. “Norma e plotë e zarzavateve nuk u jepet ushtarëve, u gjet qumësht pluhur dhe qumësht i kondensuar më shumë se sa 24 orë për efektivin. Kjo tregon se nuk është dhënë norma e plotë e qumështit ushtarëve dhe punëtorëve, problem ky që u ngrit edhe në takimin me ushtarët”.<sup>26</sup>

### *Përfundime*

Duket sikur dëshmitë e mësipërme janë një tablo unike për regjimin komunist e për Ushtrinë Popullore në përgjithësi, por realisht një gjendje kaq e mjerueshme si repartet e Xhenios zor se pasqyrohet në repartet e Armëve të tjera, që konsideroheshin si reparte elitare. Arma e Xhenios u pa fillimisht si një zgjidhje e duhur për të shmangur “armiqtë e popullit” nga repartet e rëndësishme ku ata mund të shfrytëzonin jo vetëm armatimin, por edhe informacionin ushtarak kundër pushtetit popullor.

Meqë pjesa dërrmuese e aktivitetit të këtyre reparteve lidhej me punën e krahut, kjo zgjidhje filloi të konsiderohej gjithashtu efikase duke synuar gjithnjë e më shumë me kalimin e viteve uljen e fuqisë punëtore me pagesë nga këto objekte dhe rritjen e numrit të ushtarëve aktivë si krahë pune, të cilët merrnin një pagesë qesharake, madje në disa raste kjo pagesë nuk jepej në kohën e duhur. Gjithashtu, kjo pagesë ishte më e vogël se ajo e ushtarëve të Gardës, edhe pse këta të fundit nuk përfshiheshin në punë të rënda fizike me orare të zgjatura dhe përfitonin edhe trajtim më të mirë ushqimor.<sup>27</sup>

Dëshmitë e sjella në këtë punim janë një numër shumë i vogël faktesh, pasi pjesa më e madhe e dokumentacionit që lidhet me veprimtarinë e reparteve ushtarake gjatë regjimit

---

<sup>25</sup>AQFA, F. i Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, V. 1988, D. 4, fl. 1. Konkluzione, akte të Repartit Ushtarak Nr. 3205 dhe të Repartit Ushtarak Nr. 6188, Nënrepartet e Sazanit.

<sup>26</sup>AQFA, F. i Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, V. 1983, Dosja 32, fl. 7. Konkluzione të dala nga kontrolli i ushtuar nga grupet e Repartit Ushtarak nr. 3205 në repartet vartëse për krijimin dhe përsosjen e kushteve të jetesës gjatë vitit 1983. Akti i mbajtur në Gusmar, 10. 08.1983.

<sup>27</sup> Po aty. Në akt-kontrollin gjendet shënimi se pagesat mujore të ushtarëve janë bërë me vonesë. Pagesa mujore për një ushtar ishte 10 lekë të reja. Kjo pagesë ishte e njëjtë me pagesat e reparteve të tjera, ku ushtarët përfshiheshin në punë fizike me aksione, si në të gjithë vendin, por nuk ishin reparte pune.

komunist janë në shumicën e rasteve të papërpunuar si fonde, por edhe ato që janë përpunuar janë të padeklasifikuara. E megjithatë, pjesa dërrmuese e ushtarakëve që kanë punuar në Ushtrinë Popullore gjatë regjimit komunist e dinë se Arma e Xhenios krahas “lavdisë” për ndërtimin e veprave më të mëdha publike në vend, apo për ndërtimin e objekteve ushtarake të rëndësishme së veçantë si dhe në marrëzinë e fortifikimit, mbart mbi vete njollën e errët të të qenit repart pune i detyruar, që binte në kundërshtim me ligjin e mobilizimit,<sup>28</sup> aq sa mes ushtarëve xhenierë në repartin e Moravës, Berat, “miku më i mirë konsiderohej shiu”, pasi nuk punohej në fortifikim apo hapje tunelesh.

Njëlloj si në kampet e punës së detyruar ku u ndoq ndarja e qartë krahinore (jugu në veri dhe veriu në jug), edhe përbërja e ushtarëve që mobilizoheshin në batalionet dhe regjimentet e Xhenios ishte e tillë. Mjafton të shikosh të dhënat e planifikimit të mobilizimit për vitin 1986 në repartin 3205, në specialitetin Xhenio, të cilët ishin të përqendruar në rrethin e Vlorës, Palermo, Vërmik, Gusmar, 70 ushtarë ishin nga Elbasani, 81 Shkodra, nga Durrësi 23, nga Tirana 24 etj.<sup>29</sup>

Për ta përmbyllur këtë punim, padyshim mund të pohojmë se regjimi komunist, e shkeli me vetëdije ligjin e mobilizimit ushtarak, duke krijuar brenda strukturave të Ushtrisë Popullore, reparte pune për dy qëllime kryesore: *së pari*, nisur nga mosbesimi ndaj ushtarëve që vinin nga familje kundërshtarë të regjimit dhe *së dyti*, për shkak të vështirësive të mëdha ekonomike që ndeshi në ndërtimin e veprave të rëndësishme që kishin një kosto të lartë të fuqisë punëtore. Dëshmitë tragjike që la pas janë shembuj të ndërthurjes së luftës së klasave me shfrytëzimin e egër dhe çnjerëzor për përfitime ekonomike dhe denigrim të figurës së “armikut të popullit”.

---

<sup>28</sup>Shërbimi ushtarak i detyruar ishte një e drejtë kushtetuese për të marrë pjesë në mbrojtjen e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Me ligjin e mobilizimit parashikohej që në bazë të detyrimit ligjor shtetasi, person fizik e juridik të merre pjesë për të siguruar plotësimin e njësisë dhe reparteve e strukturave ushtarake me personel, materiale, teknikë, kafshë, automjete dhe mjete të tjera të nevojshme. Ligji parashikon “shërbimin e detyruar me armë” dhe jo të kundërt, siç veprohej në repartet e Xhenios.

<sup>29</sup>AQFA, F. i Xhenios, Rep. Ushtarak 3205, V. 1986, D. 9, fl. 2. Plani i kompletimit me rekrutë të Repartit Ushtarak 3205 për vitin 1986.

## Selami Zalli - AIDSSH, Tiranë

### Shkodra në vitet e vendosjes së diktaturës, 1945-1953, nga këndvështrimi i Historikut të Sigurimit të Shtetit

#### Abstrakt

Fillesat dhe momentet kryesore të këtij opozicioni, të shprehura nëpërmjet reagimit dhe rezistencës individuale dhe qytetare, lëvizjet e para të armatosura si kryengritja e Malësisë së Madhe (janar 1945), kryengritja e Postribës (shtator 1946), lëvizjet e studentëve të Gjinnazit të Shkodrës dhe organizatat e ndryshme demokratike të krijuara e të kryesuara nga intelektualë të shquar. Përgatitja e terrenit për goditjen dhe nënshkrimin e Shkodrës, në mënyrë që ta nxirrnin atë nga roli progresist dhe misioni historik i saj, në rrafshin kombëtar dhe shtetformues.

Pa hyrë në rolin historik të Shkodrës si kryeqendër politike, ekonomike e kulturore ndër shekuj do të përpiqem që nëpërmjet këtij studimi të qëndroj brenda temës që përcakton kjo konferencë shkencore: *“Shkodra në vitet e vendosjes së diktaturës, 1945-1953, nga këndvështrimi i Historikut të Sigurimit të Shtetit”*, duke u përqendruar në disa probleme kryesore.

Me hyrjen në fuqi të ligjit 45/2015 dhe fillimin e aktivitetit nga AIDSSH-ja me marrjen në dorëzim të Arkivit ekzistues, i përbërë nga një fond i konsiderueshëm dokumentesh. Dokument me rëndësi, për studimin e kësaj periudhe, pjesë përbërëse e këtij fondi është dhe *“Historia e Sigurimit të Shtetit”* dhe *“Historiku i Degës së Punëve të Brendshme Shkodër”* të zgjedhura si material kryesor referues për bërjen e një analize, mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të kësaj strukture, pa paragjykime dhe reminishenca në vështrimin ligjor, analitik e krahasues, duke vënë në dukje dhe zhveshur nga hiperbolizimet (megalomania), pa synuar injorimin dhe denigrimin e saj, por vetëm nëpërmjet vështrimit në optikën e kohës, në plan krahasues.

#### *Shkodra para luftime në Historinë e Sigurimit të Shtetit*

Studimi i parë zyrtar i historikut të shërbimit sekret, “Historiku i Sigurimit të Shtetit” (HSSH), i cili rezulton të jetë bërë në vitin 1974 e ripërpunuar në vijimësi, dhe “Historiku i Armës së Sigurimit të Shtetit të Degës së Punëve të Brendshme të Rrethit Shkodër” (1941-1975), dëshmojnë se historia e shërbimit informativ, veprimtaria informative gjatë viteve (1941-1943), e konsideruar “syri dhe veshi i luftës”<sup>30</sup> gjatë Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) ka kaluar në dy faza:

---

<sup>30</sup> *Historisë së Degës së Punëve të Brendshme. Shkodër (1941-1975)*, botuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, 1974, f. 10.

- Mars 1943 – Maj 1944,
- Maj 1944 – 29 Nëntor 1944.

Sipas këtij studimi zyrtar, veprimtaria informative gjatë viteve (1941-1943), u ngrit pa definuar nga kush dhe si, me qëllim zbulimin e planeve të armikut dhe sulmimin në befasi të tij, si domosdoshmëri, për të depërtuar nëpër vendet kyçe në administratë, kuesturë, burgje e kudo.

Në pjesën hyrëse, në përshkrimin e gjendjes së brendshme dhe *“Intensifikimit të veprimtarisë së agjenturave të huaja”*<sup>31</sup> kërkohen dhe identifikohen “agjentë” të fashizmit në Shkodër, duke identifikuar si të tillë Anton Harapin, Patër Gjergj Fishtën<sup>32</sup> etj., të cilët *“... synonin asgjësimin e PKSH”*.

Nga studimi i këtij dokumentacioni, në prezantimin e gjendjes dhe situatës gjatë luftës, trajtohen ngjarje që meritojnë analizë dhe krahasim, të tilla si: panorama dhe trajtimi mbi situatën në vend, ekzistenca që në vitin 1937 e *“Organizatës Demokristiane Shqiptare”* e krijuar nga klerikët<sup>33</sup>, progresi dhe transformimi i saj, demonstratën e gjimnazit të Shkodrës më 28 nëntor 1939, me himnin e flamurit dhe parulla antifashiste, e shoqëruar me arrestimin e 4 studentëve ditën e nesërme, demonstratën e 30 janarit 1940 për kundërshtimin e fashistëve për përjashtimin nga shkolla të 71 aktivistëve, demonstrata e vajzave të shkollës *“Donika Kastrioti”*, 4 shkurt 1943, zhvilluar me parulla politike e cila u shpërnda. *Aksioni i të burgosurve politikë të Shkodrës, më 24 shkurt 1943*, për të mos lejuar transferimin e tyre në Itali. Protesta ka zgjatur 8 orë, ku të burgosurit goditën karabinierët me çdo mjet, duke marrë peng mareshalin fashist. Kjo solli tërheqjen e fashistëve nga vendimi i tyre<sup>34</sup>.

Nga përmbajtja e dokumentacionit nuk evidentohen masa represive të natyrës së vrasjeve, izolimit apo ridënimit të pjesëmarrësve në protestë nga radhët e të burgosurve. Gjej me vend të bëj një kapërcim për të krahasuar me ndodhinë e pas afro 30 vitesh në burgun politik të Spaçit<sup>35</sup>, ku ndonëse me kërkesa të ligjshme dhe thujse paqësore, u pushkatuan 4 të burgosur, u ridënuan 8 me nga 25 vite burgim dhe 56 të burgosur u ridënuan me nga mbi 10 vite burgim.

Për të gjitha ngjarjet e renditura më sipër, nga dokumentacioni i Sigurimit, nuk na rezulton të jenë marrë në analizë e trajtuar në detaje ngjarjet dhe masat represive që u ndërmorën nga fashistët, ndoshta për arsye të vetë bilancit të tyre?!

<sup>31</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 1 f. 9.

<sup>32</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...* Vol. 1 f. 11.

<sup>33</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, f. 8.

<sup>34</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...* f. 15-16.

<sup>35</sup> AIDSSH, FONDI, Viti, Dosja ORV, Rep. 303, Spaç, Nr.123, dt. 21.05.1979



Analizohet me kujdes dhe vëmendje të veçantë veprimtaria e spiunazheve të huaja në Shkodër, që sipas këtij dokumentacioni, e realizuar nëpërmjet konsullatave austro-hungareze, serbe, malazeze, italiane, angleze dhe gjermane. Deri me vendosjen e monarkisë kishte dominuar spiunazhi austro-hungarez. Me Zogun dominonte spiunazhi jugosllav, i cili synonte dhe punonte të krijonte bindjen e “*pamundësisë së ekzistencës së Shqipërisë si shtet*”<sup>36</sup> pa ndihmën jugosllave.

Sipas këtij historiku, para luftës, kjo gjendje motivoi dhe ***u bë frymëzim për persona jugosllavë, të emigruar në Shkodër për arsye ekonomike***, të cilët u bënë kontingjent i përshtatshëm në interes të zbulimit jugosllav, së bashku me parinë dhe klerët e klerit mysliman e ortodoks<sup>37</sup>.

Ky konstatim, i konsultuar me “Historikun e Sigurimit të Shtetit”, nuk vijon të figurojë si i tillë, në mënyrë të veçantë pasqyrimi i elementit jugosllav, i minoritetit të tij dhe klerit ortodoks. Arsyetim dhe vijueshmëri të cilën, nuk konstatojmë të figurojë apo të jetë objekt i punës së sigurimit dhe i masave represive pas lufte?!, në vitet 1944-1949, kohë kur veproi Divizioni i Mbrojtjes në Shkodër, deri kur dhe ndodhi “prishja” me jugosllavët.

Nuk mund të mos bjerë në sy dhe të tërheqë vëmendjen fakti që, drejtuesit kryesorë dhe më të spikatur të lëvizjes komuniste, në qarkun e Shkodrës, janë ky minoritet, të cilët në pjesën hyrëse të këtij dokumentacioni, figurojnë si emigrantë ekonomikë me origjinë jugosllave, kontingjente dhe me predispozicion për agjentë të zbulimit jugosllav. Konkretisht, sipas këtij dokumentacioni ishte Vasil Shanto, që drejtonte dhe mbante lidhjet me pjesën më të madhe të informatorëve dhe qendrave të informacionit.

Bazuar në këto fakte dhe rrethana, mbetet për zgjidhje e dhënë përgjigje disa pyetjeve që dalin natyrshëm, mbi faktorin emigrant ekonomik me origjinë jugosllave në Shkodër:

- Çfarë ndodhi me këtë faktor, i cili në kohën e Zogut konsiderohej kontingjent, tani jo?
- Ky faktor u bashkua në luftën kundër fashizmit apo kundër politikave të tij, ndaj çështjes shqiptare në raport me Jugosllavinë?
- Si shpjegohet që pranë këtij grupimi politik (PK), spikati dhe doli në krye duke pasur monopolin e gjithçkaje, si drejtimin, informacionin etj., kontingjenti me këtë përkatësi?

---

<sup>36</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ... f. 4.*

<sup>37</sup> *Po aty.*

- Si shpjegohet që në këtë dokumentacion dhe periudhë nuk figuron e as gjendet ndonjë e dhënë mbi aktivitetin dhe rolin e klerit ortodoks në Shkodër?!

Marrëdhëniet me jugosllavët<sup>38</sup> trajtohen si *ndihmesë e ndërsjellë*. Njëherazi, bëhet prezent dhe vihet theksi në ekzistencën e mercenarëve jugosllavë nga Kosova në Shkodër. Nëpërmjet një raportimi nga qarkori i PK Shkodër, i prezencës së 700 trupave kosovare, në përbërje të regjimentit “Kosova”, ndërkohë që drejtimi, dhe kontrolli i sektorit të informimit, ishin si më sipër.

Në gjithë dokumentacionin dhe tekstet e “Historikut të Sigurimit të Shtetit”, kur bëhet fjalë për konsullatën dhe zbulimin italian, vihet theksi (paraqiten) si kontingjente shtresat e pasura, çifligarët, tregtarët dhe bajraktarët e veriut, mbi të gjitha me rol predominues drejtuesit e klerit katolik, duke dalluar e shënjestruar të parin **Pader (At) Gjergj Fishtë**n, tashmë i njohur dhe gjithëpranuar si nacionalist dhe antijugosllav, predikuesin dhe një nga korifenjtë më të mëdhenj të çështjes shqiptare. Vepra e tij u ndalua nën ndikimin dhe presionin jugosllav, dhe u shpall herezi, mbajtja e propagandimi i saj. Problematikat dhe çështjet që trajton, shqetësuan të gjitha palët, për vlerën e saj si “*programi politik kombëtar*”, “*fjalori shpjegues*”, për bërjen e autopsisë (identikitit) të mikut dhe armikut të kombit shqiptar.

Në këtë dokumentacion anatemohen edhe priftërinjtë: Frano Gjini, Pal Dedaj, Bernardin Palaj etj.<sup>39</sup> për të cilët thuhet se idetë profashiste i propaganduan nëpërmjet organeve të shtypit të klerit katolik. Në atë kohë kishte 10 të tillë<sup>40</sup>, një pjesë e të cilit ka filluar të ribotohet, jo vetëm për vlerat e kohës, por tingëllojnë aktuale edhe sot (*Hylli i Dritës, Zonja e Shkodrës, Leka etj.*).

Në trajtesat e kësaj historie bie në sy, armiqësia dhe lufta ndaj shteteve të huaja kapitaliste që kishin synime të vjetra grabitqare ndaj vendit tonë, për ilustrimin e të cilave nuk përmendet vetëm Jugosllavia.

Në drejtësi, natyrisht edhe në shkencë, mund të përdoret dhe ka vend postulati “*Nuk ka krim pa gjurmë dhe të pazbulueshëm, por ka kërkues të këqij*”. Në favor të këtij argumenti shkojnë eksperiencat dhe përvoja arkeologjike, e cila nëpërmjet fosileve dhe objekteve të ndryshme, ka arritur të ndërtojë e interpretojë, si ka funksionuar shoqëria njerëzore që në lashtësi duke përcaktuar formacionin ekonomik-shoqëror, sistemin politik, nivelin e zhvillimit dhe të kulturës materiale e shpirtërore. Shembulli më domethënës mbetet djegia e Bibliotekës së Aleksandrisë, një thesar, por historia e Egjiptit është shkruar, mungesa e dokumentacionit

<sup>38</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ... f. 25.*

<sup>39</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ... f. 5.*

<sup>40</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ... f. 6.*

mbi Holokaustin dhe trajtimin e hebrenjve nga nazistët, por ama ata e kanë rikuperuar dhe shkruar historinë e tyre.

### *Veprimtaria e Sigurimit të Shtetit mbas luftime*

**Faza I** (dhjetor 1944 – shtator 1946) e njohur për Operacionet e pastrimit me forcat ushtarake të Mbrojtjes Popullore, të cilat u shtrinë në gjithë vendin, sidomos në veri<sup>41</sup>.

a) **Etapa I** (dhjetor 1944 – shkurt 1945) përfshin rezistencën kundër vendosjes së regjimit komunist në zonën Kelmend-Koplik.

b) **Etapa II** (mars 1945 – shtator 1946) përkon me kohën e ndryshimit të taktikës nga forcat e ndjekjes.

- krijimi i njësiteve të vogla në ndjekje (Jug);
- depërtimi me informatorë në radhët e bandave;
- kalimi në ofensivë me njësi të mëdha ushtarake (Veri).

**Faza II** (tetor 1946 – janar 1947) përfshin operacionet e spastrimit në veri. Në këtë periudhë Divizionit të Mbrojtjes iu shtuan katër batalione, u ngushtua dara dhe mbështetja nga aleati (pala jugosllave).

Kjo fazë karakterizohet nga *operacione ndëshkuese* për *çarmatimin e popullatës* shumë pak e hulumtuar. Në këtë proces, nga dëshmitë gojore të kohës, janë dëgjuar e përshkruar tmerre pafund. Njerëzit, nga format “demokratike” të përdorura, kanë marrë borxhe, kanë kaluar kufirin për të gjetur e dorëzuar armë, pasi oficerët e Sigurimit, nëse nuk dorëzoje armën, produkt i imagjinatës së tyre, nuk e kishin për gjë të vrisnin, duke thyer arra mbi kokën e viktimës.

Histori e ngjarje të tilla, janë treguar pafund edhe para viteve '90 me mburrje nga autorët e tyre, por fatkeqësisht, pak ose aspak janë dokumentuar dhe tashmë, dëshmitarët e gjallë janë pakësuar. Edhe hebrenjtë, krimet ndaj tyre nuk i kanë me dokumente zyrtare, pasi nazistët u përpoqën të fshinin gjurmët, por provat e gjalla njerëzore nëpërmjet kujtimeve ndërtnuan pazëllin. Në këto kujtime, revokohen vlerat, përshkruhet pamundësia e çdo pushtuesi për të çarmatosur këtë popull, me gjithë torturat dhe masakrat që kishin përdorur. “Këta” ia dolën me “bindje”, çka përbën paradoks.

Një nga format më efektive në këtë periudhë mbeti shfrytëzimi nga ana e Sigurimit të Shtetit i rritit të besës, e cila në asnjë rast nuk u mbajt nga kontraktuesit e saj në pushtet, po kështu përdorimit të amnistisë, pengjet familjare dhe nxitja e shfrytëzimi i grindjeve etj.

---

<sup>41</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 2, f. 195

Në dokumentet e Sigurimit, lëvizjet popullore antikomuniste emërtohen “banda”. Në asnjë fjalor, manual shpjegues, enciklopedi apo nga studiues serioz nuk mund të quhen e përkufizohen kështu. Kjo, për vetë territorin dhe shtrirjen që patën, pjesëmarrjen dhe mënyrën e organizimit, duke parë me objektivitet, në dritën e fakteve dhe të statistikave, veprimet dhe sjelljen e “çlirimtarëve”. Numri i anëtarëve të “bandave”, sipas këtij dokumentacioni, përbëhej nga 50-400 vetë dhe drejtoreshin nga ushtarakë karriere, të formuar në Perëndim.

Fakt interesant mbeten shifrat kontradiktore dhe të paqarta, kur bëhet fjalë për likuidim bandash. Ka një amulli për numrin e të vrarëve, të dorëzuarve, apo të atyre që mbetën në male ose u arratisën<sup>42</sup>. Në vëllimin II të Historisë së Sigurimit të Shtetit thuhet se në fund të operacionit të pastrimit të bandave në vitin 1947, u likuiduan 1764 banditë nga të cilët: të asgjësuar në vitet 1945 – 1947 ishin gjithsej 1194 vetë, prej të cilëve:

- 393 u vranë (pa gjyq)
- 601 u kapën (asgjë nuk thuhet për fatin e tyre të mëtejshëm)
- 770 u dorëzuan (asgjë nuk thuhet për fatin e tyre të mëtejshëm)
- 1764
- 1774 mbetën në male (bandat e vogla)

Gjithsej, **3538** vetë<sup>43</sup>.

Cila historiografi apo studiues serioz mund t’i njohë këto shifra, të quajë e përkufizojë si bandë e banditë, këta individë në përbërje të një formacioni të tillë luftarak, në kushtet e ekzistencës së një popullsie prej 800 000 banorësh.

Në këtë periudhë, lufta zbuluese dhe sukcesi i dedikohet, ndërtimit të rrjetit të informatorëve, denoncimeve nga populli, vëzhgimit dhe *të dhënave që dilnin nga hetuesia?!*

**Faza III** (janar 1947 - janar 1948), përkon me ndjekje masive me grupe të vogla sipas taktikës së bandave.

**Faza IV** (shkurt 1948 – gusht 1948) e quajtur faza e baticës e zbaticës, për shkak të veprimtarisë së Koçi Xoxes dhe ndërhyrjes së OZNA-s (Shërbimit Sekret Jugosllav) dhe nën maskën e ndihmës. Fakt interesant dhe me vlerë për të kuptuar më mirë organizimin, veprimtarinë dhe varësinë e Sigurimit të Shtetit nga jugosllavët (OZNA)<sup>44</sup>, rolin diktues e paternalist të tyre në Sigurim, ishte atashimi i zbuluesve shqiptarë jashtë vendit, nëpër përfaqësitë e tyre diplomatike dhe administrimin e marrjen në kontroll të të gjithë informacionit të shërbimit sekret të jashtëm.

---

<sup>42</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 2, f. 195, f. 210.

<sup>43</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 2, f. 206.

<sup>44</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 2, f. 230.

Nga studimi i këtij fenomeni dhe i individëve të trajnuar e shkolluar në Jugosllavi, apo të praktikave të zbulimit dhe rekrutimeve të Sigurimit, sidomos në sistemin e rekrutimit zinxhir, nëpërmjet analizës e deduksionit mund të arrijmë në përfundime të sakta, nëse arriti të shkëputet ndonjëherë Sigurimi i Shtetit nga tutorët e tij (jugosllavë apo sovjetikë), e parë kjo edhe nga goditjet e mëvonshme të grupeve antiparti në radhët e Sigurimit të Shtetit, ku edhe 90% e agjenturës në atë periudhë (1944-1949)<sup>45</sup> ishin anëtarë partie e njerëz të besuar të pushtetit.

Në materialet e Sigurimit të Shtetit, bëhet fjalë për ekzistencën *e listave të zeza*<sup>46</sup> të hartuara nga Sigurimi ku bënin pjesë edhe anëtarë të PKSH/PPSH. Imagjino si mund të kenë funksionuar këto lista ndaj qytetarëve të thjeshtë, sidomos në Shkodër (në to përfshiheshin tregtarët, të arsimuarit jashtë vendit, klerikët etj.). Për “elementin armik” të Shkodrës ekzistonin 6000 dosje.

Sipas kësaj historiografie në vitin 1948, në themel të veprimtarisë së Sigurimit u vu teoria e Zhakonovit<sup>47</sup>: “*Shpifja u bë arma bazë për të siguruar kontrollin mbi partinë*” edhe “... në qoftë se dëshiron të zbulosh çerdhet e fshehta të armikut, shiko se do ti gjesh pranë shpifjeve ...”.

Në shtator 1948 u mbajt Plenumi XI i KQ të PKSH, i cili praktikisht shkëputi Shqipërinë nga ndikimi jugosllav. Në dhjetor 1948, Byroja Politike e KQ, miratoi *Platformën e I Politike e Organizative të Sigurimit të Shtetit*<sup>48</sup>. Ajo që bie në sy dhe përbën paradoksin më të madh është *fakti i vendosjes së caqeve (kufijve)* për organet e Sigurimit të cilat, nuk mund të vendosnin në përpunim që nga anëtari i plenumit të KQ të partisë, anëtarët e plenumëve në rrethe, drejtuesit e organizatave të masave, anëtarët e qeverisë deri tek zëvendësministrat dhe anëtarët e partisë, me përjashtim të rasteve që do të paraqiteshin nevoja specifike. Kjo nuk do të thotë që këta ishin të përjashtuar nga detyrimi për dhënie informacioni. Kjo kategori ndalohej t’ia jepte atë organeve operative të Sigurimit, por ata ishin të detyruar të informonin në parti (varianti “çekist” i grumbullimit të informacionit).

Pretendohet se komunistët nuk kanë qenë bashkëpunëtorë të Sigurimit, pasi e kishin të ndaluar me ligj, duke bërë dy gabime njëherazi, njëri dhe mashtrim: Platformën e Byrosë Politike e quajnë ligj, kur në fakt është maksimalisht një aneks i Statutit të PPSH dhe mashtrimi se e paskan pasur të ndaluar të jenë bashkëpunëtorë e informatorë. Në fakt, e vërteta qëndron krejt ndryshe, pasi ishte e ndaluar vetëm të emërtoheshin agjent, por veprimtaria e tyre

<sup>45</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 2, f. 231.

<sup>46</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 2, f. 234.

<sup>47</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 2, f. 235.

<sup>48</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 2, f. 254.

informative kamuflohej me termin vigjilencë, patriotizëm dhe partishmëri, por ama platforma parashikonte edhe rastet përjashtuese “... kur e kërkonte nevoja”.

Këto kategori nuk mund të arrestoheshin pa aprovimin e KQ të PPSH, duke i pajisur me një “imunitet të çuditshëm”, çka tregon funksionimin dhe nivelin e “pavarësisë” së institucioneve ligjzbatuese: prokurorit, gjykatës, të cilët në të vërtetë nuk ishin gjë tjetër, veçse instrumente politike që diktoheshin e dirigjoheshin nga Sigurimi i Shtetit, pavarësisht se emërimi, rekrutimi i tyre në detyrë realizohej nëpërmjet mekanizmit të “zgjedhjeve” nga populli dhe vendimet i jepnin në emër të tij.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ekzistues, konstatohet fakti se Sigurimi i Shtetit deri në vitin 1948 vepronte vetëm me urdhra dhe vendime të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kombëtare. Ai ishte i organizuar sipas strukturës dhe përdorte format e OZNA-s<sup>49</sup> e transformuar në UDB, nga të cilat deklarohet se u hoq dorë pas prishjes me Jugosllavinë e Titos. Në të vërtetë, nga mjaft studime dhe publikime të deritanishme rezulton se asgjë nuk ka ndryshuar. Me kohën, u pasuruan me formën dhe praktikën ende më të vrazhdë sovjetike, e përcjellë me zëvendësimin e këshilltarëve jugosllavë, nga ata të KGB-së<sup>50</sup>.

Në aktet dokumentare të kësaj periudhe është pretenduar se do të hiqej dorë nga metodat e praktikave xoxiste<sup>51</sup> të vlerësimit të fajësisë për të dyshuarit në bazë të dyshimit formal, duke kaluar në veprimtarinë konkrete, heqjen dorë nga sugjestionimi, provokimet, torturat etj. Dokumentacioni dhe dëshmitë e gjalla tregojnë të kundërtën, veçanërisht në Shkodër, ku në vijimësi edhe përtej periudhës objekt i kësaj trajtëse, vdiqën në tortura dhe u vranë pa gjyq ajka e popullsisë së veriut, sidomos klerikët e famshëm.

Nëse vërejmë përbërjen e organikës së Sigurimit të Shtetit në vitet 50’, vetëm 9% e tyre nuk kishin marrë pjesë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare (LNC)<sup>52</sup>. Organikat e Sigurimit ishin mbushur me elementë të pashkolluar si duhet, madje edhe analfabetë (sipas të dhënave 77% e punonjësve ishin me arsim të plotë ose të pjesshëm fillor dhe gjysmë analfabet me kurse kundër analfabetizmit)<sup>53</sup>. Në vitin 1951, u emëruan si kryetarë degësh dhe shefa seksionesh 20 kuadrot e parë që kishin ndjekur kursin 1-vjeçar të Sigurimit në BS, të cilët instaluan metodat dhe praktikave të punës staliniste në këto organe<sup>54</sup>. Kjo mund të justifikojë faktin që format kryesore të punës në këtë periudhë ishin mjetet e forcës, dhuna fizike, psikologjike, ushtrimi i torturës

<sup>49</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 258, 266.

<sup>50</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 270.

<sup>51</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 280-281.

<sup>52</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 268.

<sup>53</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 269.

<sup>54</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 270.

në kuadër të hetimit intensiv, metodat e shtrëngimit nëpërmjet pengjeve familjare, premtimet për mosndëshkim (amnisti) të pambajtura etj. Në themel të punës u vu rekrutimi i agjenturës nga radhët e kontingjenteve “armike” e lidhjeve të tij, mbi bazën e materialit shtrëngues.

Kësaj periudhe i përket detyrimi për dokumentimin e veprimtarisë zbuluese e agjenturore me firmë e datën përkatëse dhe rregullat e ruajtjes së tyre<sup>55</sup>, por çuditërisht, ndonëse e detyrueshme me “ligjin” e tyre, aktualisht janë trashëguar dhe gjenden shumë pak dokumente të tilla. Kjo të bën të mendosh se, kohë pas kohe, autorët kanë fshirë gjurmët.

### ***Shkodra dhe diktatura komuniste shqiptaro – jugosllave***

Po e vijoj këtë trajtesë me togfjalëshin “*Diktatura komuniste shqiptaro – jugosllave*” sepse, për mendimin tim, dhe siç dëshmojnë burimet historike, gjatë Luftës së Dytë Botërore edhe pas saj në periudhën 5-vjeçare 1945-1949, egërsia komuniste e ushqyer vazhdimisht nga prania e Jugosllavisë titiste është shtrirë në të gjithë Shqipërinë, por veçanërisht në veriun e saj, sidomos në Shkodër.

Pas tërheqjes së trupave gjermane nga Shkodra me hyrjen në qytet të partizanëve shqiptarë, hynë edhe partizanët jugosllavë. Kjo shënon herën e parë në histori, që sllavët, hyjnë në këtë qytet pa luftë. Me këtë ngjarje lidhet tentativa për zhvendosjen e Shkodrës, bazuar në vlera, nga qendra në periferi dhe shënjestrimi i saj si “delja e zezë”. Në fillim, u goditën dhe shkatërruan vlerat e saj ekonomike, kulturore dhe, mbi të gjitha, ato njerëzore, nëpërmjet grabitjes së arkivave, bibliotekave, veprave të artit, si dhe çdo vlere tjetër të krijuar në shekuj, duke tentuar të zhdukin identitetin e kësaj treve.

Në studimet e linjës zyrtare deri më tani, nuk gjendeshin dokumente apo literaturë rreth këtyre ngjarjeve, përveç sa shkruante shtypi i kohës, i cili sigurisht jepte informacion të deformuar nën peshën ideologjike, se për kurrikula shkollore, apo studime të mirëfillta shkencore as që bëhet fjalë.

Në dokumentacionin e shfrytëzuar, konstatohen problematika në terminologji dhe shifra të cilat nuk rezultojnë precize e të definuara saktë, por të relativizuara si: “disa, dhjetëra, qindra, banda, kriminelë, të arratisur, asgjësim, spastrim”, deri “revoltë”, pa përcaktuar në asnjë rast palët dhe arsyet e saj, pa dhënë asnjë sqarim si dhe me ç’të drejtë ligjore apo morale mund të futet një popull apo një krahinë në karantinë, në një regjim ushtarak e policor duke u dhunuar, hequr të drejtat themelore, si e drejta e jetës, e pronës, e fjalës së lirë dhe e mundësisë për të vendosur vetë për fatin e tyre, nga një pushtet, që e quan veten popullor.

---

<sup>55</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 275.

Nuk mund të mos bien në sy pasaktësitë, në përshkrimin, emërtimet dhe informacionin e dhënë për ngjarjet në Shkodër, të cilat tregojnë jo vetëm nivelin e ulët të njohjes, por edhe deformimin me dashje të problematikës, ndërkohë që “pretendohej” dhe ende ka njerëz që besojnë se Sigurimi i ka ditur dhe kishte në kontroll situatën në qytet dhe krahina.

Gjatë gjithë trajtesave të paraqitura deri më tani, konstatohet paligjshmëria që shprehet nga ushtrimi i torturës, përdorimi i pengjeve, vrasjeve dhe “vetëvrasjeve” nëpër burgje, trajtimin e femrave, përdorimin e metodave antihumane në hetim, rekrutimet me mjete të dhunshme etj. Për ekzistencën dhe funksionimin e tyre nuk flitet fare, por mbeten në terma të përgjithshme, për t’u nënkuptuar e referuar në burime të tjera, por asnjëherë në dokumentacion zyrtar.

Që gjatë diskutimit në Këshillin e Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar, në fazën e përgatitjes për zgjedhjet e para për Asamblenë Kushtetuese, por edhe në Kuvendin Popullor që doli nga këto zgjedhje, ndër zërat e parë opozitarë do të ishin deputetët shkodranë, njësoj si në vitin 1921. Por ndryshe nga viti 1921, këtë radhë, egërsia e pushtetit do të ishte e jashtëzakonshme. Nisur nga prezenca jugosllave në mbikëqyrje edhe terren, përpjekja për ta anashkaluar e fshehur këtë, na shtyn të mendojmë e besojmë se mbrapa qëndronin jugosllavët, që lakmonin tokën dhe detin, të vetëdijshëm që nuk mund ta realizonin këtë synim, për sa kohë këtu të kishte shqiptarë “*për pa mbet Shqypnia n’vasha*”, ndaj e donin tokë të zbrazur. Qartazi konstatojmë në këto dokumente fobinë dhe tendencën e sajësës politike që po projektohej të vinte në pushtet, fatkeqësisht nën hundën e Aleatëve Perëndimorë, për të cilët historia dhe dokumentet nuk kanë arritur ende në një përfundim të qartë dhe shkencor, nëse gabuan apo kështu deshën.

### ***Dokumentacioni zyrtar mbi rezistencën antikomuniste në veri***

Sot, ne trashëgojmë dhe kemi studime historike në lidhje me shërbimin sekret shqiptar të Ali Pashë Tepelenës, të periudhës së Mbretit Zog, por një studim apo investigim zyrtar për periudhën e regjimit komunist në Shqipëri ende nuk e kemi. Në këto kushte mbetet të mbështetemi sërish mbi materialet e Historisë së Sigurimit të Shtetit (i ripërpunuar), dhe Historikun e Armës së Sigurimit të Shtetit të Degës së Punëve të Brendshme të Rrethit Shkodër për vitet 1941-1975, pa hyrë në thellësinë e dokumentacionit arkivor konkret të ngjarjeve të kohës.

Nga materiali i parë, *Historia e Sigurimit të Shtetit* e botuar në vitin 1974, duke e studiuar me kujdes, mund të nxirren mjaft të dhëna rreth shërbimit sekret shqiptar: organizimi, ecuria, format e punës zbuluese, goditëse dhe përparësive të tij. Shembujt e egërsisë, dhe pasojat që sollën mbi shoqërinë shqiptare në përgjithësi, janë të panumërta, por unë do të përqipem të



prezantoj disa nga ato që kanë të bëjnë dhe përfshijnë qytetin e Shkodrës dhe zonën e veriut në tërësi.

Persekutimin komunist në zonën e veriut në qendër të së cilës gjendet Shkodra, jam përpjekur ta trajtoj në disa rrafshje:

Në *rrafshin historik*, Shkodra jo vetëm nuk ishte nënshtruar, por as kishte gabuar në historinë e ekzistencës së saj, e vendosur gjithnjë në kahun e duhur, duke marrë përgjegjësitë dhe rolin që i takon.

Në *vështrimin gjeografik*, armiqtë e jashtëm historikë të popullit shqiptar, ata sllavë, orakujt dhe administratorët faktikë të elitës politike komuniste shqiptare, në të gjithë perimetrin linear kufizoheshin me Shkodrën, duke dhënë kontributin e tyre në shtypjet e të gjitha lëvizjeve e revoltave popullore antikomuniste, sidomos në Kelmend. Bashkërisht kishin përmbyllur Tivarin e të tjera “binjakëzime e partneritete të përbashkëta”, të njohura e të panjohura ende, dhe nuk përjashtohet mundësia të kenë qenë e të jenë kontrata apo marrëveshje afatgjata në vijimësi.

Në *aspektin religjioz*, sipas dokumentacionit të Sigurimit të Shtetit, prezantohen si rrezik dhe armiq, italianët dhe turqit për të justifikuar goditjen e klerit në tërësi, siç edhe ndodhi.

Në *aspektin klasor* dhe shtresëzimit shoqëror, përcaktohen si fokus për t’u goditur tregtarët, të arsimuarit jashtë vendit, ish pjesëtarë të administratave të pushtimit, të pasurit, përkrahësit e fashizmit të gjithë antisllavë etj.

Në vitin 1951 u bë evidentimi i përgjithshëm i elementit kundërshtar dhe kontingjentëve të zbulimeve armike<sup>56</sup> në të gjithë vendin, proces që në Shkodër kishte filluar më herët. Operacione pastrimi u zhvilluan në gjithë vendin, por më i ashpër dhe me forca të shumta ishte në veri<sup>57</sup>, në qytetin e Shkodrës. Shënjestra kryesore e Sigurimit ishin të arratisurit, familjarët, të afërmit e tyre dhe të të dënuarve, të prekurit nga reformat, ish nëpunësit, tregtarët etj. Nga ky dokumentacion bie në sy tendenca për komprometimin e kryengritësve, duke proklamuar shpresat e tyre tek ish Aleatët Perëndimorë të Luftës (reaksioni i jashtëm), duke shmangur nga trajtimi i barabartë me aleatët e tyre (vëllezërit sllavë), të pranishëm masivisht në territorin tonë shtetëror me trupa ushtarake, në disa operacione ndëshkimore, si në shtypjen e revoltës së Kelmendit për eliminimin e Preng Calit, të cilit nuk mund t’i falnin çështjen e vendosjes së kufirit verior. Kjo është koha dhe momenti, kur shigjetohet edhe kleri, veçanërisht ai katolik

---

<sup>56</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 422.

<sup>57</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 2, f. 45.

për ndërprerjen e lidhjeve të tij me Vatikanin<sup>58</sup>. Dhuna dhe persekutimi ndaj klerit në këtë periudhë përkon me ndryshimet e dhunshme në statutet e komuniteteve fetare.

Në këtë periudhë, megjithëse formalisht ishte shpallur dhe propagandohej ekzistenca e institucioneve dhe ligjeve vepruese. Në terren veprohej ndryshe, pushkatoheshin njerëz pa gjyq, digjeshin shtëpi, grabitej ushqimi e bagëtia, merreshin e mbareshin peng popullata e lirë, burgoseshin e internoheshin në mënyrë masive, duke e bërë gjendjen më të rëndë se çdo luftë.

### ***Të dhënat mbi operacionet e spastrimit të Veriut në periudhën 14 janar-16 shkurt 1945***

Në *Historinë e Sigurimit të Shtetit*, thuhet se goditja ndaj Kelmendit u realizua në 5 drejtime kryesore, “duke arritur asgjësimin e reaksionit, çarmatimin, mobilizimin e detyrueshëm ushtarak” (kjo situatë e njëjtë si dhe OZNA në Kosovë e veçanërisht në Drenicë, pas vrasjes së Shaban Polluzhës dhe mobilizimin me dhunë të popullatës për t’i nisur drejt Sremit e Tivarit). Kësaj faze i përkasin vrasjet pa gjyq në Vukël<sup>59</sup>, internimet në Kamëz, Berat, Porto Palermo për të përfunduar në *gulakun shqiptar*, në Tepelenë.

Në dokumentacionin zyrtar të të dy historikëve të Sigurimit, të atij qendror dhe lokal, ndeshen kontradikta mbi formën e realizimit të goditjes dhe forcat e përdorura. Ndërsa bëhet fjalë për sulm në 5 drejtime, nga një vështrim i vëmendshëm dhe analizë konkrete na rezultojnë vetëm 3 drejtime, dy prej të cilave jepen me emrat konkretë të drejtuesve të operacionit, duke i lënë në heshtje 2 drejtime të tjera, nga të cilat, në të vërtetë, u goditën pas shpine forcat e Kelmendit në Vermosh<sup>60</sup>.

Numri i drejtimeve nuk është kontradikta e vetme në dokumentacionin HSSH dhe HDPB Shkodër. Në dy botimet të tërheqin vëmendjen një numër i madh mospërputhjesh mbi rolin e oficerëve jugosllavë në përbërje të SEMP-it, mbi ndihmat me trupa nga ana e kufirit (pas shpine) apo mbi lejimin e kalimit dhe përdorimi i territorit jugosllav nga ana e trupave partizane. Moment i paqartë dhe i diskutueshëm janë gjithashtu edhe arsyet e mbulimit të këtij fakti, të cilat duhet të jenë thellësisht komprometuese për drejtuesit e lartë të PKSH. Ajo që më intrigon në këtë drejtim është këmbëngulja dhe insistimi për ta fshehur këtë moment, për të cilin vazhdimisht kanë folur studiuesit, pjesëmarrësit dhe dëshmitarët okularë në ngjarje.

<sup>58</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 427.

<sup>59</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 56.

<sup>60</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 67.

Sipas HSSH, sulmi do jepej në *pesë drejtime*, të përcaktuara *tre drejtime*, ndërkohë që prezantohen vetëm *dy emra* komandantësh. Sipas HDPBSH, sulmi në *tre drejtime*<sup>61</sup>, prezantohet lejimi i përdorimit të territorit shtetëror jugosllav nëpërmjet Tuzit, për t'u dalë pas shpine kryengritësve, që në fakt edhe kjo gjysmë e vërtetë, pasi forcat që kanë arritur të dëmtojnë e shkatërrojnë kryengritësit sipas kronikave, kanë hyrë nga ana e Plavës dhe nëpërmjet fshatit Martinaj e Gusi për të dalë në Vermosh.

Në këtë dokumentacion të ashtuquajtur historik, bëhet fjalë për gjykimin e dhjetëra kriminelëve në datat 14-19 maj, bashkëpunëtorë të Jup Kazazit e Llesh Marashit, ku gjithçka është e amullt dhe e paqartë, pa data, emra e kronologji. Botimet ishin parashikuar të ishin sekret për përdorim të posaçëm, të kufizuara vetëm për të besuarit. Hartuesit e tyre nuk e kishin menduar kurrë që do të mund të binte në dorë të publikut të gjerë dhe aq më pak të “armikut”, nuk kanë qenë në gjendje të jenë konkret në shifra, emra dhe ngjarje reale, duke përdorur si argument vetëm frymën politike dhe ideologjinë.

Flitet për kriminelë (ballistë) nga jugu, pa asnjë sqarim apo analizë se si dhe çfarë ndodhi, duke kompromentuar dhe krijuar përshtypjen e trukimit mbi këtë dokumentacion. Bëhet fjalë për pushkatime të dhjetëra personave (spiunë e kriminelë), sikur bëhet fjalë për dëmtime në të mbjella ose në blegtori, nga prania e ndonjë force madhore. Vrasjet dhe asgjësimet nuk prezantohen me emra individualë, as me numra, por me palë, dhjetëra e qindra, çka duhen verifikuar dhe dokumentuar.

Kontradiktat dhe konfuzioni në këto dokumente nuk kanë fund, ndërkohë që pretendohet spastrimi, pranohet fakti i ekzistencës së reaksionit në disa zona të veriut, ku ende janë 1850 persona si kryengritës me armë<sup>62</sup>. Pjesa dërrmuese e fakteve dhe rrethanave të paraqitura, në këtë dokumentacion zyrtar, i cili hedh dritë mbi mënyrën e veprimtarisë dhe “sukseset” e armës së Sigurimit të përforcojnë bindjen dhe nevojën si domosdoshmëri, për hapjen e procesit për rishikimin e historisë.

E gjej të domosdoshme të ndalem në faktin si e ka trajtuar historiografia komuniste dhe pikërisht, struktura mbajtëse e monopolit të sekreteve në dokumentacionin e saj, ngjarjen e njohur si “Masakra e Tivarit”. Nëse nuk do kishte ndodhur ajo çfarë ndodhi në Tivar, dhe këto pengje do lejoheshin të ktheheshin në shtëpi, kjo ngjarje nuk do mbetej pa emër, por do të quhej “Masakra e Urës së Tamarës” (500 të vrarë) ose masakra e çdo zone, ngjarje e vrasje të

---

<sup>61</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 13.

<sup>62</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 70.

ndodhura në territorin shtetëror shqiptar, i cili u finalizua në mënyrën më mizore në Tivar, emrin e të cilit mori.

Rreth kësaj ngjarje, ky historik tregon mjaftueshëm si pretendohet “padijenia” dhe deformohet informacioni dhe e vërteta nëpërmjet një fraze: “... *titistët e Beogradit, me qëllim provokimi kalonin në... (janar 1945) 7000 kosovarë përmes qarkut e qytetit të Shkodrës ... reparte bjellogardiste*<sup>63</sup> ...”. Një trajtesë e përshkrimi i tillë flet sa mijëra fjalë, me qëllim për të “vendosur brirë”, pasi është fakt i njohur botërisht marrëdhënia ndërmjet PKSH dhe PKJ, në atë kohë “*në muaj mjalti*”, aq sa nëpër mitingje e zyra dominonin thirrjet dhe portretet e binomit Enver-Tito.

Nëpërmjet këtij dokumentacioni historik, miratuar nga një këshill i posaçëm shkencor dhe ministri i kohës, vendosur në ruajtje dhe përdorim mbi bazën e rregullave të posaçme që për herë të parë materialet e tij, mund të shfrytëzohen për studim, e njohje. Shtoi këtij arsytimi mënyrën e funksionimit, varësinë e detyrimet për raportim e dhënie llogarie të vetë Armës së Sigurimit. Edhe i vetëm, ky tekst historie, i jep përgjigje çdo aludimi, duke i hequr mundësinë kujtdo që të pretendojë padijeninë e Partisë, të udhëheqësit dhe udhëheqësve kryesorë, pjesë të Sekretariatit dhe Byrosë Politike të KQ të Partisë, për çfarë do të ndodhte dhe ka ndodhur në Tivar, parë në frymën si është trajtuar e prezantohet kjo ngjarje në dokumentacionin e kohës.

Kalimi i kosovarëve nëpër Shkodër dhe sjelljet e vrazhda të shoqëruesve, përgjatë kalimit nëpër qytet, duke mos lejuar qytetarët shkodranë t’u japin bukë ose ujë dhe nëse dikush reagonte ndëshkohej, na shtynjë të mendojmë e studiojmë, që nuk ka ndodhur rastësisht ngjarja në Urën e Tamarës. Fshehja dhe deformimi i saj nga pushteti i kohës, nuk i lejon të dalin duar jashtë dhe na shtynjë të mendojmë se planet ogurzeza, mund të kenë qenë më të rënda e pse jo ta kthejnë Shkodrën në “arenë gladiatorësh” ku padronët, të argëtoheshin me “skllevërit”, të mundurit e tyre, si për të treguar që tani e tutje do të mbretërojmë qetësisht, dhe se, në themelet e pushtetit (pushtimit) të tyre, po hidhnin gjak të pastër shqiptar, deri tani i derdhur në luftërat për liri.

### ***Organizimi i organeve të mbrojtjes së popullit SEMP-it në Shkodër, detyrat e tyre***

Me qarkoren nr. 20, datë 24 shtator 1944 dhe 16 nëntor 1944 të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kombëtare, në dhjetor të vitit 1944 u krijuan Seksionet e Mbrojtjes së Popullit (SEMP), që vareshin nga Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit. SEMP-i për Shkodrën u krijua në

---

<sup>63</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 62.

mars 1945. Nga SEMP vareshin Komandat e Vendit, të vendosura në qytet dhe në qendrat e lokaliteteve.

Në qytetin e Shkodrës këto komanda u ngritën në Kiras, Rus, Manxhar, Ballabane, Pazar i vjetër, Perash dhe tek Dugajt e reja. Për mënyrën si ishin organizuar dhe nëse kishin burgje secila, nuk kemi asnjë të dhënë të dokumentuar deri në këtë moment. Shpresojmë në të ardhmen! Në fshatra komandat e vendit u ngritën nëpër qendrat e lokaliteteve si në Mjedë, Gur i Zi, Bushat, Velipojë, Oblikë, Vrakë, Mes, Shllak, Dajç, Shirokë dhe Zogaj. Sipas kësaj strukture, Seksionet e Mbrojtjes së Popullit u ngritën në gjithë qarkun e Shkodrës, brenda të cilit përfshiheshin rrethet Koplik, Pukë, Dukagjin, Lezhë e Mirditë.

Drejtuues i Seksionit të Mbrojtjes së Popullit për Shkodrën ishte major Zoi Themeli, zëvendës të tij ishin kapiten Nesti Kopali (i arratisur më vonë) dhe Fadil Kapisyzi. Puna agjenturore drejtohej nga oficerët: Rasim Dedja, Zoi Shkurti, Bashkim Kacaraho, Dul Rrjoli, Mit'hat Bushati, Fahri Kraja, Hysni Ndoja, Neki Ahmati etj. Vetëm për qytetin ishin oficerët Brahim Shpori, Kasem Troshani, Niko Pistulli, Ferit Mandia, Vehbi Fishta etj. Në sekretarinë e SEMP-it vepronin edhe komunistët Niqi Kosta, Vafie Tepelena (Kraja). Nëpër rrethe drejtonin të besuarit: Xhemal Selimi në Koplik, Bilo Bregu në Lezhë, Idriz Coba në Pukë, Xhevat Gavoçi në Dukagjin, Mat Deda në Shpal të Mirditës, Ndrek Nallbani në rrethin Qendër.

SEMP-i kishte detyrë pastrimin e territorit nga kriminelët e luftës të fshehur në qytete dhe Malësitë e Veriut. Për këtë qëllim, më 28 dhjetor 1944 në Shkodër u ngrit "Komisioni për përcaktimin e kriminelëve të luftës dhe për shqyrtimin e fitimeve të luftës nga tregtarët"<sup>64</sup>. Njëherazi, do të eliminoheshin kundërshtarët politikë dhe do të grabitej pasuria e të pasurve të Shkodrës dhe rrethinave, proces ky që komandohej nga Shefqet Peçi.

Sipas dokumentacionit (tekstit HDPB Shkodër), humbja që pësoi batalioni i parë i Brigadës I Sulmuese, më 15 janar 1945, tek Ura e Tamarës (37 partizanë të vrarë), justifikohet jo me qëndresën e kryengritjes, por me pamundësinë për futjen e agjenturës së duhur brenda radhëve të armikut. Në datat 18-19 janar u dërguan dy batalione, të cilat një ditë më vonë u detyruan të tërhiqen. Jehona e kësaj ngjarjeje (kryengritjeje) u shtri në të gjithë veriun. Për t'i bërë ballë kësaj situatë në krye të operacioneve të spastrimit në Shkodër, Kukës e Dibër, u vendos Mehmet Shehu, i njohur për egërsinë e tij dhe i sprovuar si gjakatar. Ndonëse kryengritja zhvillohej në Vermosh, operacioni vendoset të fillojë që në Shkodër, qytet i cili emërtohet "koka e reaksionit"<sup>65</sup>. Për këtë arsye, më 28 janar 1945 në qytetin e Shkodrës u shpall shtetrrrethimi. Operacioni kishte filluar edhe më herët (26 dhe 27 janar 1945), nga ana e forcave ushtarake dhe

<sup>64</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 7.

<sup>65</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 11.

të Mbrojtjes Popullore, duke kontrolluar çdo shtëpi, duke arrestuar çdo të dyshuar dhe pjesëtar të listës së përpiluar mbi “elementin armik”. Në këto ditë janë arrestuar në qytetin e Shkodrës 120 persona nga 240 që përmbante lista, pa përcaktuar se kush dhe çfarë përfaqësonin këta të arrestuar.

Sipas teksteve të Historisë së Sigurimit të Shtetit, kryengritja e Koplikut dështoi për shkak të moskordinimit dhe inkoherencës midis kryengritësve në veri dhe jug të Shkodrës. Kjo pasoi dhe me lëvizjen e grupit të deputetëve në Tiranë për kufizimin e opozitës nëpërmjet “Bashkimit Demokratik” dhe “Organizatës tekniko-intelektuale” dhe dy organizatat e Shkodrës “Organizata Demokristiane” dhe “Bashkimi Shqiptar”, siç dëshmojnë dokumentet e Sigurimit. Gjatë kryengritjes së Postribës u vranë 33 kryengritës, u gjykuan dhe u pushkatuan 8 vetë, 200 vetë u arrestuan dhe iu dhanë gjyqit. Nga forcat ushtarake u vra një dhe u plagosën dy oficerë. Me këtë periudhë, përkon dhe spastrimi në kuadër të forcimit të ushtrisë<sup>66</sup>, përpilimi i listave për të gjithë personat e dyshimtë që nga 7 prill 1939 - Janar 1945 (diferencimi). U ngritën sistemet e vëzhgimit, nëpërmjet depërtimit në radhët e të dyshuarve, ku si shembull sillet V. Daragjati, i cili akuzohet për lidhje me klerikët, bandat, misionet anglo-amerikane etj.

Siç është traditë në regjime ideologjike diktatoriale, me kalimin e kohës e të viteve, gabimet dhe dështimet gjenden tek të ikurit, të mundurit dhe të vdekurit. Për Kelmendin, Koplikut dhe Postribën, fajtorë u shpallën Tuk Jakova, Zoi Themeli dhe Koçi Xoxe.

Më pas, historitë e Sigurimit tregojnë sesi kishte vazhduar lufta për zbulimin dhe shpartallimin e organizatave klandestine “Bashkimi Shqiptar” dhe “Organizata Demokristiane”. Sipas tyre, “Organizata Demokristiane” u krijua më 18 nëntor 1944 në Kuvendin Françeskan, ndërsa organizata “Bashkimi Shqiptar” u krijua më 17 shkurt 1945, nga kleri katolik me urdhër të Vatikanit, “nga elementët armiq të pushtetit popullor pa dallime ideologjike dhe fetare, me qendër seminarin jezuit. Në rast mosbindje dhe dështimi të anëtarëve, - thuhet se, - do të ndëshkoheshin nga “Dora e Zezë” dhe do të mallkoheshin nga Papa”. Numri i anëtarëve, sipas këtyre botimeve, që kemi në shqyrtim???? ishte i madh dhe u shtri në Tiranë, Durrës dhe Krujë me objektiv tërë Shqipërinë. Më datë 27 nëntor 1945, u arrestuan të gjithë krerët e kësaj organizate.

Ajo çfarë të bën përshtypje dhe, kam mendimin, se është krijesë dhe fantashkencë konspirative, mbetet, sajimi dhe bërja prezente e organizatës terroriste “dora e zezë”, produkt i fantazisë dhe asistencës së specialistëve jugosllavë, nga e ka origjinën dhe ka ushtruar

---

<sup>66</sup> *Historisë së Degën e Punëve të Brendshme. Shkodër ...*, Vol. 3, f. 86.

aktivitetin kjo organizatë, e cila ka dëmtuar pafundësisht shqiptarët, sidomos gjatë ushtrimit të veprimtarisë në Kosovë.

### *Detyra dhe preventive për të ardhmen*

Pikëpyetje të mëdha, me rëndësi për t'u studiuar e dhënë fund njëherë e mirë përbaltjes, përbën zbardhja e së vërtetës mbi shumë figura me kontribute të mëdha në historinë e Shqipërisë, të paraqitur si “tradhtarë e armiq të popullit”, ndonëse kanë luftuar e janë vrarë me serbët dhe komunistët.

Nevojitet punë e madhe dhe e pandërprerë, për të hedhur dritë me dokumente mbi këtë periudhë, si ngjarjet e dendura që i përkasin kryengritjeve në Kelmend, Koplík, Postribë. Spiunët e sjellë nga rrethet si konviktorë dhe keqpërdorimi i tyre në Gjinnazin e Shkodrës, roli dhe aktiviteti i individëve me origjinë sllave dhe dominimi i tyre politik e ushtarak në qytet, organizatat, grupet e individët të cilët u rebeluan kundër regjimit.

Ashpërsimi dhe thellësia e goditjes së katolicizmit, i cili në parimet e tij ka dhe ritualin e “paqes kristiane”, por jo deri në ato përmasa sa të harrojë martirët e vet, për më tepër duke rënë në prehrin dhe pozitat e bashkëpunimit me dhunuesit dhe persekutorët, të cilët ende nuk kanë kërkuar as formalisht ndjesë. Kjo rrethanë do të legjitimonte dhunën e ushtruar dhe përsëritja do të ishte e justifikuar, njësoj si gënjeshtër për herën e dytë, duke marrë nga eksperiencia suedeze modele pozitive dhe jo “sindromën e njohur”.

Duhet të kontribuojmë në funksion të zbardhjes së të vërtetave dhe hedhjes dritë mbi këtë pjesë të historisë, në funksion të njohjes, kujtesës dhe krijimit të kushteve e premisave, që këto dukuri të mos përsëriten në të ardhmen. Nëpërmjet një dokumentimi të drejtë dhe faktik, identifikimit të ndershëm e shkencor, të dalë qartë se kush janë arsyet e krijimit të kësaj situatë, strukturat, autorët, organizatorët, ekzekutorët, ndihmësit dhe viktimat e regjimit komunist në Shqipëri.

Brenda këtij procesi të evidentohen e të dalin në pah: shtypja; qëndresa dhe qëndrestarët; solidariteti; autorët e krimeve dhe bashkëpunëtorët e tyre. Mbetet detyrim dhe domosdoshmëri që ky dokumentacion të konsultohet, shqyrtohet përpara çdo promovimi e dekorimi, sidomos për ata që nuk e pësuan në diktaturë, mbajtën poste dhe bënë jetë të rehatshme, qofshin këta persona publikë, shkrimtarë, artistë, profesorë etj. Për secilën nga këto dukuri ka parashikime të posaçme në Ligjin nr. 45/2015, i cili me gjithë mangësitë, ka vend e mundësi për përmirësime, por dhe në këtë gjendje duhen përpjekje për të shfrytëzuar çdo hapësirë dhe oportunitet, nisur nga qëllimi dhe vullneti i mirë.

# **Alma Liço Mirakaj, Merita Sauku Bruci - Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë**

## **Internim-dëbimet familjare në zonën e Dumresë 1968-1991: dëshmi dhe refleksione**

### **Abstrakt**

Alma Liço Mirakaj vjen me dëshmi direkte mbi periudhën e saj të internim-dëbimit dhe mbi kohën, shkakun, mënyrën se si u kryen, pasojat që tjetërsuan jetët e familiarëve të saj. Dëbimi nga qyteti i Tiranës u krye në vitin 1968, tok me 15-20 familje të tjera që u vendosën në zonën e Dumresë, në fshatin më të largët, Dragot, ku u trajtuan si armiq të partisë dhe të popullit. Shkaku i dëbimit: aktiviteti i gjyshit, Muamer Liço, që kishte studiuar për drejtësi në Universitetin e Harvardit, ishte avokat në qytetin e Korçës dhe si nacionalist, u përfshi në lëvizjen e Ballit Kombëtar. Persekutimi komunist viktimizoi katër breza në familjen e saj: gjyshi, i dënuar në vitin 1945 me pushkatim, dy prindërit e saj me tre fëmijët e tij për 23 vjet në internim – dëbim; si dhe fëmijët e vetë Almës, që u lindën dhe kaluan vitet e para të fëmijërisë në fshatin e dënimit.

Në këtë kumtesë vëmendjen tonë do ta përqendrojmë mbi arsytet e internim-dëbimit familjar, presionet e shpeshta dhe të vazhdueshme të Sigurimit të Shtetit mbi ne të internuarit, procedurën se si u krye, situatën në fshatin e internimit, mungesën e lirisë dhe mohimin e të drejtave themelore, problematikat me të cilat u përballëm ne dhe shumë familje të tjera në Dumre.

Paraprakisht, na lejoni të falënderojmë nismëtarët dhe organizatorët e zhvillimit të kësaj konference. Kanë kaluar njëzet e tetë vite nga rënia e regjimit dhe shumë pak është bërë për të vlerësuar në aspektin njerëzor dhe atë historik, atë periudhë të tmerrshme, që shkatërroi jetët e qindra, mijëra personave e familjeve të pafajshme. Aspak rastësisht, nga disa përfaqësues të shoqatave të të përndjekurve politikë, të disa institucioneve publike, jo publike, të politikës, të medias etj., ngrihet shqetësimi imediat i dekomunistizimit të shoqërisë, që vazhdon të mbetet gangrenë për të sotmen dhe të ardhmen e demokracisë shqiptare.

Jemi shprehur edhe më parë në medien e shkruar dhe atë vizive lidhur me këtë mungesë të theksuar vullneti për rivlerësimin e asaj periudhe të errët dhe aspak të largët të historisë së Shqipërisë. Edhe pas rënies së regjimit, Shqipëria është qeverisur me të njëjtën mendësi diktatoriale dhe përjashtuese ndaj kundërshtarëve politikë. Nuk ka si shpjegohet nostalgjia që ende ekziston për regjimin më gjakatar të Europës së pas Luftës së Dytë Botërore. Të dhënat që publikohen herë pas here nga studiues të ndryshëm për numrin e lartë të viktimave të pafajshme, të pakrahasueshëm me vendet e tjera, konfirmojnë faktin se shqiptarët jetuan diktaturën më të egër, që solli mjerim, ndasi dhe përçarje, pasojat e së cilës janë ende të pranishme.



*Quhem Alma Liço-Mirakaj. Kam lindur në Tiranë, më 23 shtator të vitit 1958. Jam bijë e një familjeje që vuajti dëbimin familjar nga qyteti i Tiranës, në fshatin Dragot të zonës së Dumresë. Në harkun kohor, ky dënim zgjati njëzet e tre vite. Në realitet, ai nuk do kishte asnjëherë fund, po të mos kishte ndodhur rënia e regjimit në vitin 1991. Si shkak për persekucionin e familjes sime, shërbeu dënimi i gjyshit (babai i tim eti), i quajtur Muamer Abidin Liço. I akuzuar si kriminel lufte dhe armik i popullit, me Vendim nr. 103, datë 31.05.1945, të Gjykatës Ushtarake të qytetit të Korçës, është dënuar me vdekje (pushkatim) si dhe konfiskim të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme. Në atë proces janë dënuar gjithashtu edhe pesëmbëdhjetë qytetarë të tjerë, nacionalistë të atij qyteti, nëntë prej të cilëve me vdekje (pushkatim), dhe gjashtë të tjerë me nga dhjetë e tridhjetë vite heqje lirie, deri në burg të përjetshëm. Ky Vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Naltë Ushtarake, më datë 15.06.1945 (konkretisht dy javë më pas).*

Me të ardhur në pushtet, Partia Komuniste ndërmori masa të menjëhershme represive kundër të gjithë atyre që ajo i konsideronte kundërshtarë politikë. Çdo ditë dalin në dritë fakte rrëqethëse të atyre krimeve monstruoze. Këto masa goditën pa mëshirë qindra, mijëra intelektualë nacionalistë, veçanërisht ata të arsimuar në shtetet perëndimore.

Dëshmojnë për këtë si vendimi i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, datë 15 dhjetor 1944, mbi krijimin e Gjyqit special në Tiranë për kriminelët kryesorë të luftës<sup>1</sup> ashtu edhe Udhëzimet e KQ të PKSH në lidhje me krijimin e komisioneve për zbulimin e kriminelëve të luftës, që mbajnë datën 28 dhjetor 1944<sup>2</sup>.

Një tjetër dokument, po i vitit 1944<sup>3</sup>, përcakton si kriminel lufte: inspiratorët, organizatorët, ata që kanë dhënë urdhra si dhe ndihmësit dhe ekzekutorët, pronarët ose drejtuesit e sipërmarrjeve në Shqipëri dhe në vendet e okupatorit, kryetarët dhe anëtarët e regjencës, kryetarët dhe anëtarët e qeverive, të dhomës koperative dhe të asamblesë kuislinge të Tiranës, organizatorët dhe inspiratorët e organizatave tradhtare mercenare, ushtria, milicia fashiste, Balli Kombëtar, Komanda e rinisë, Xhandarmëria, Legaliteti, Divizioni SS. Skanderbeg, ata që janë bërë vegla të propagandës armike si agjitorët, propagandistët dhe publicistët. Madje të tillë u konsideruan edhe avokatët që përfaqësuan dhe mbrojtën në gjyqe proceset e dënimit të tyre,

---

<sup>1</sup> Shih për këtë: *Dokumenta kryesore të Partisë së Punës së Shqipërisë*, Instituti i Historisë së Partisë pranë KQ të PPSH, Tiranë: 1960, f. 329.

<sup>2</sup> Shih për më shumë: “Udhëzime të KQ të PKSH në lidhje me krijimin e komisioneve për zbulimin e kriminelëve të luftës, komisioneve të asistencës sociale, komisioneve për shqyrtimin e fitimeve të luftës nga tregëtarët dhe në lidhje me punën që duhet të bëjnë këto komisione, datë 28 dhjetor 1944, botuar në *Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacional-çlirimtar, 1942-1944*, Instituti i Historisë së PPSH, Tiranë: 1962, f. 225.

<sup>3</sup> Shih për më shumë: *Arkivi Qendror Shtetëror* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: *F.*). 515/ Ministria e Drejtësisë, Viti (më tej: *V.*) 1944, D. 1, fl. 3.

sigurisht, ata që patën një të tillë, pasi ishin me qindra bashkëkombës që u ekzekutuan pa gjyqe. Si jurist dhe avokat me karrierë, në këtë grup, duket të jetë përfshirë edhe gjyshi im<sup>4</sup>.

Aktualisht, në kushtet e pluralizmit politik, është shumë e vështirë për brezin e ri të imagjinojë apo kuptojë dënimet e rënda, deri me ekzekutime ndaj personave që kishin pikëpamje të ndryshme politike nga ato të partisë-shtet. Këto tragjedi të pashembullta që shqiptarët ua shkaktuan bashkëqytetarëve të tyre, ndodhën në kohë paqeje, madje të shtrira mizorisht në një periudhë kohore që zgjati gjysmëshekulli. Por, ajo që i dha regjimit formën e një shteti të mirëfilltë terrorist, ishte përndjekja dhe trajtimi çnjerëzor që u shkaktoi në vijimësi, brez pas brezi, familjarëve të këtyre kundërshtarëve politikë. Pa hezitim, do ta konsideronim gjenocid atë që iu shkaktua mijëra nënave, baballarëve, motrave, vëllezërve, bashkëshorteve dhe fëmijëve të pafajshëm, në kampet e internimeve me dënime, që në aspektin e shtrirjes në kohë, nuk do të kishin asnjëherë fund.

Alma Liço rrëfen:

*E para përballje e vërtetë me tmerrin e barbarisë komuniste ishte dëbimi më 23 shtator të vitit 1968, i familjes sime. Atë ditë mbushja dhjetë vjeç. Sigurisht, në atë moshë, nuk mund të kisha as idenë më të vogël se çfarë përfaqësonte lufta e klasave dhe persekucioni politik që e shoqëronte atë. Askush nuk mund të fliste hapur rreth këtyre temave, për më tepër në prani të fëmijëve. Këtij ndëshkimi mizor, i kishin paraprirë disa goditje jo të vogla, por që unë nuk kisha arritur t'i kuptoj. Një vit më parë ishte dëbuar familjarisht nga Tirana, xhaxhai im, Ylli Liço, në fshatin Ndërmenas të Myzeqesë. Ndërkohë, im atë ishte shantazhuar për të bashkëpunuar me Sigurimin e Shtetit, dhe pas refuzimit për të kontribuar në monstruozytet e atij shërbimi famëkeq, prindërit e mi ishin flakur nga puna si mësues të ciklit të ulët të fshatrave të Tiranës dhe prej dy vitesh vërtiteshin të punonin në fermat rreth saj. Punonjës të Sigurimit të Shtetit, për disa muaj me radhë e rrëmbenin forcërisht tim atë, teksa kthehej nga puna dhe pasi e hipnin në një makinë, i lidhnin sytë dhe e plasnin në një zyrë të panjohur për të. Veprime të tilla banditeske janë të denja vetëm për bandat terroriste mafioze. Aty pritej nga zyrtarë të ndryshëm të atij shërbimi, të cilët në këmbim të një perspektive më të mirë për atë dhe familjen,*

---

<sup>4</sup>Alma Liço saktëson: *Im gjysh, Muamer Liço kishte studiuar për drejtësi në njërin prej Universiteteve prestigjioze të SHBA-ve, dhe në qytetin e tij të lindjes, Korçë, kish ushtruar profesionin e avokatit. Si nacionalist, ishte përfshirë në lëvizjen dhe aktivitetet e Organizatës së Ballit Kombëtar, në sektorin logjistik të saj.*

*Kur humbi të atin, babai im ishte vetëm shtatëmbëdhjetë vjeç. Meqenëse, shumë vite më parë, nga një sëmundje e pashërueshme kishte humbur dhe të ëmën, ai së bashku me dy motrat dhe vëllanë më të vogël mbetën jetimë. Por barbaria komuniste nuk u ndal këtu. Dënimi i të atit u shoqërua me konfiskimin e gjithçkaje që posedonin, përfshirë dhe shtëpinë ku banonin. Ishin katër fëmijë që u hodhën në rrugë të madhe, pa asnjë mjet jetese. Pas disa vitesh sorollatjesh nëpër Shqipëri, më së fundi u vendosën në Tiranë, tek një i afërmi i tyre, ku dhe u përpoqën të rindërtonin jetën, të bëheshin me familje dhe fëmijë.*

*i kërkonin bashkëpunim me atë shërbim. Ajo që kërkohej ishte të denonconte individë të rrethit të miqësisë dhe të njohurve, të cilët ishin të pakënaqur nga regjimi. Im atë ishte treguar shumë i kujdesshëm në refuzimin e tij, pasi i njëjta mjaft mirë pasojat mbi të dhe familjen. Kishte pasur mjaft shembuj të mëparshëm, të dhimbshëm të disa prej miqve që kishin kaluar në të njëjtin ferr. Pas refuzimit, gjuha e përfaqësuesve të Sigurimit të Shtetit kishte ardhur duke u ashpërsuar, deri në kërcënime të hapura për ardhmërinë e tij dhe atë të familjes. Po aq këmbëngulës ishin treguar edhe për detyrimin e ruajtjes së sekretit të takimeve me ta. Dhe koha vërtetoi se kërcënimet e tyre do të përmbusheshin brenda një periudhe shumë të shkurtër.*

Represioni shtetëror, i ricikluar aq dhunshëm në vitin 1966, ishte orientuar qartazi nga vendimet politike të partisë-shtet, e cila kontrollonte me “dorë të hekurt” çdo aspekt dhe qelizë të jetës. Kështu, sipas një dokumenti të klasifikuar “Tepër Sekret” të Komitetit të Partisë së Tiranës, (që mban firmën e shokut Manush Myftiu) me nr. prot.852, datë 14.07.1966, përcillet një relacion në KQ të Partisë së Punës, drejtuar shokut Ramiz Alia, me lëndë: “Mbi disa masa që duhet të ndërmerren ndaj disa elementeve armiq dhe të deklasuar”. Në këtë relacion shprehet shqetësimi i problematikave të të gjitha llojeve që ishin krijuar nga elementë armiq, të strehuar apo fshehur, sipas tij, në qytetin e Tiranës, dhe në këtë kuadër propozohet transferimi i 272 familjeve të cilësuar të tilla.

Dëbim-internimet masive të familjeve të pafajshme që u kryen në këtë periudhë, konfirmojnë faktin se ky propozim, i orientuar nga vetë politika e partisë për luftën e klasave, është miratuar pa asnjë hezitim.

Në kuadër dhe zbatim të kësaj politike, me Vendim nr.19, datë 29.04.1968, të Komisionit të Internim Dëbimeve, Tiranë, është vendosur internimi pesëvjeçar i 61 familjarëve, në fshatra të rrethit të Vlorës<sup>5</sup>. Ky dokument i klasifikuar “Tepër Sekret”, vendos në krye të kësaj liste të atin e Almës, Nevzat Muamer Liço. Motivacioni: “Për arsye se zhvillojnë veprimtari armiqsore dhe paraqesin rrezikshmëri të theksuar”... Për shkaqe të panjohura prej nesh, zbatimi i këtij vendimi për familjen e Almës, atë të hallës së saj, Lumturi Liço, dhe familjes së Luigj Frrokut (e përfshirë në atë listë), është shtyrë për afro pesë muaj në kohë, me destinacion një tjetër fshat, konkretisht në Dragot të Elbasanit. Ndoshta kjo ka ndodhur për

---

<sup>5</sup> Më 1968 janë marrë gjithsej 59 vendime të Komisionit Qendror të Internimeve. Zona e Dumresë ka një përqendrim të madh të elementit të internuar. Një pjesë e mirë e të internuarve që shkuan në Dumre vijnë nga Korça, Kolonja, Librazhdi, Peqini etj. Një vit më parë, 1967, me Vendim nr. 47, datë 5.10.1967 të Komisionit Qendror të Internimeve ishte bërë një spastrim i Tiranës duke internuar 174 persona. Duke marrë parasysh faktin se fëmijët nuk regjistroheshin, përlllogaritet që shifra të jetë rreth 500 persona. Shih për më shumë: Kastriot Dervishi, *Internimi dhe burgimi komunist në Shqipëri*, Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2016, f. 52-55.

mungesë kapacitetesh të këtyre fshatrave. Ndërkohë, nuk kemi dijeni për fatin e familjeve të tjera.

Alma Liço shprehet kështu lidhur me këtë vendim:

*Ndonëse kanë kaluar shumë vite nga periudha kur vuajta dënimin familjar, u drodha teksa lexoja këtë vendim. Sipas tij, im atë ishte kategorizuar person që zhvillon **veprimtari armiqësore dhe paraqet rrezikshmëri të theksuar**. Duke gëlltitur lotët, natyrshëm më lindi pyetja:*

*-Cilat ishin normat dhe kriteret ligjore që e përcaktuan atë të tillë? Cilat ishin shkeljet e këtyre normave nga ana e tim eti, dhe cili autoritet shtetëror i ndoqi, verifikoi dhe konkludoi në këtë mënyrë?*

*Ndoshta përgjigja është më e thjeshtë se vetë pyetja. Tim eti, prindit dhe qytetarit shembullor, burrit më të ndershëm, më human dhe paqësor që kam njohur në jetë, mësuesit të vlerësuar që edukoi për afro njëzet vite breza nxënësish të shkëlqyer, mund t'i ngarkoheshin dy mëkate:*

*I pari, se ishte bir i një intelektualit me bindje antikomuniste! Nuk kishte aspak rëndësi për kasapët e regjimit, se i ati e kishte paguar këtë fakt me jetën e tij, 23 vite më parë, duke lënë në rrugë katër jetimë.*

*Dhe i dyti, se ai refuzoi të bënte pakt me djallin. Dhe djalli u hakmor në mënyrën më mizore që orientonte dhe mundësonte politika e terrorit, e drejtuar nga partia-shtet.*

*Duke pretenduar dhe pritur se trajtimi çnjerëzor që pësoi im atë nga Sigurimi famëkeq i Shtetit, do të ishte pasqyruar në dokumentet respektive të asaj periudhe, një vit më parë, i kërkova Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, të dhënat që ky shërbim dispononte për të. Përgjigjja ishte vërtet zhgënjyese. Me shkresë nr.70/1, datë 23.06.2017, të këtij Autoriteti, informohem se në arkivat e ish Sigurimit të Shtetit nuk gjenden dokumente të përgatitura apo të dhëna që im atë të ketë qenë i survejuar, bashkëpunëtor apo i favorizuar nga ky shërbim.*

*E kam të vështirë të besoj, së gjithë ajo përndjekje që iu bë tim eti, të mos jetë evidentuar në dokumente apo raporte-shërbimi, çka më bën të dyshoj në asgjësimin masiv të tyre.*

Po le t' i rikthehem Vendimit të Komisionit të Internim Dëbimeve, Tiranë, të sipërcituar, i cili i referohet dhe mbështetet në Dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, nr.1906, datë 02.08.1954 "Mbi internimin dhe dëbimin si masë administrative"<sup>6</sup>. Paraprakisht, na duhet të theksojmë se ky vendim, dhe gjithë dënimet e këtij lloji, cenonin rëndë Kushtetutën

---

<sup>6</sup> Shih: *Gazeta zyrtare*, nr. 13, 31.8.1954, f. 425-426

e vitit 1950, (kapitullin III të saj), e cila me gjithë kufizimet që diktonte sistemi diktatorial, i konsideronte shtetasit të barabartë para ligjit; se askush nuk mund të dënohej pa një proces që të provojë fajësinë e tij dhe pa u dëgjuar.

Na lejoni të sjellim në vijim dy nenet e para të dekretit të sipërcituar.

*Neni 1 (paragrafi i parë) – internimi dhe dëbimi mund të vendoset:*

*Kundër personave që paraqesin rrezikshmëri shoqërore, mund të vendoset si masë administrative internimi dhe dëbimi.*

Alma Liço, në cilësinë e pësueses së drejtpërdrejtë dhe të dëshmitares së tejkalimit dhe shkeljes edhe të këtyre neneve, që ishin antihumane që në gjenezë, bën këtë arsyetim logjik:

*Siç shihet, ky paragraf ka si objekt persona që paraqesin rrezikshmëri për rendin shoqëror të Republikës Popullore të Shqipërisë, dhe person i tillë për atë regjim ishte konsideruar im atë. Por ne u dëbuam familjarisht. Mbi ç'bazë ligjore u dënua mama ime dhe ne, tre fëmijët e mitur? A nuk ishte ky veprim tërësisht arbitrar dhe në shkelje dhe dhunim të kësaj dispozite ligjore?*

*Viktima të këtij trajtimi çnjerëzor, kolektiv, ishin bërë dhe vazhduan të bëhen qindra familje në pozita të njëjta, apo të ngjashme me tonën, që u degdisën kampeve të internimit dhe fshatrave të izoluara të Shqipërisë.*

*Ndryshe nga të dëbuarit dhe të internuarit politikë, në mënyrë selektive, ky nen zbatohet ashtu siç ishte formuluar, vetëm për personat që akuzoheshin për veprime ordinere dhe akte rrugaçërie në vendbanimet e tyre. Në fshatin tonë, por dhe në fshatrat përreth, herë pas herë mbërrinin të internuar të kësaj kategorie. Megjithëse në shumë raste ata ishin kryefamiljarë, të martuar dhe fëmijë, këta individë nuk u dënuan së bashku me familjet respektive. Madje, lirimi dhe kthimi i tyre pranë familjes, realizohej shumë kohë përpara plotësimit të masës pesëvjeçare të internimit.*

Neni 2 përcakton:

*Internimi dhe dëbimi mund të vendosen edhe kundër pjesëtarëve të familjes së personave të arratisur brenda ose jashtë shtetit.*

*Quhen pjesëtarë të familjes personat që bashkëjetojnë me të arratisurin, si bashkëshorti, fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat, si dhe persona të tjerë që bashkëjetojnë me të dhe janë në ngarkim të tij.*

Në ndryshim nga neni i parë, ky nen përcaktonte vendosjen e masës së internim-dëbimit për pjesëtarë të familjeve të personave të arratisur, duke specifikuar se cilët konsideroheshin të tillë, dhe duke vendosur si kusht faktin e bashkëjetesës me ta. Por, me gjithë përmbajtjen arbitrare, e cila ligjëron dënimin kolektiv të familjarëve të pafajshëm, si u zbatua ai?

Alma Liço sqaron: *Në fshatin ku u dëbua familja ime, ishin dëbuar ose internuar gjithsej njëzet e dy familje, dymbëdhjetë prej të cilave për shkak të një familjari të arratisur. Vitet e pafundme që ndamë me këto familje të pafajshme, na bënë të mësojmë se shumë prej tyre nuk kishin qenë aspak në raport bashkëjetese me personin e arratisur. Pra, dhe kjo dispozitë, është zbatuar me abuzivizëm dhe në shkelje të plotë të përmbajtjes së saj.*

Arbitraritetin dhe vetëdijen e plotë të udhëheqësve të shtetit komunist, se internim-dëbimet ishin masa ndëshkuese që jepeshin nga Komisioni i Internim/Dëbimeve, ndaj personave/familjeve që nuk kishin kryer asnjë faj, e dëshmon edhe një projektligj i vitit 1969, ku u diskutua që internim/dëbimi të hiqej si masë administrative, dhe të lihej vetëm dhënia dhe zbatimi i vendimeve penale, dhënë nga gjykata, sipas dispozitave e neneve 21 dhe 22 të Kodit Penal<sup>7</sup>.

Sipas Mehmet Shehut, ky propozim nuk u pranua, sepse:

-Do sillte lirim të mirë të internuarve me vendim të Komisionit të Internim/Dëbimeve;

-Nuk mund të siguroheshin provat nga gjykata për aplikimin e internimit ndaj shtetasve.

Ky arsytim rëndohet akoma më shumë, kur është i njohur dhe provuar fakti se në praktikën gjyqësore të atëhershme, jepeshin vendime e dënime ndaj individëve, me prova të manipuluar. Ndonëse gjykatat ishin në shërbim të shtetit komunist, e kishin të vështirë të jepnin masa të tilla njëkohësisht për të gjithë anëtarët e familjeve, ku kishte gra, pleq dhe fëmijë të mitur.

Po si i kujton Alma Liço ato ditë të tmerrshme që kulmuan me dëbimin familjar?

*Ishte shtatori i vitit 1968. Tirana ishte përfshirë nga një terror i jashtëzakonshëm që lidhej me tronditjen e aleancave ushtarake të kohës. Sigurisht që shkaqet e atij terrori i mësova shumë më vonë, por ende sot e kësaj dite, nuk mund të harroj sirenat, që me tingujt e tyre të frikshëm lajmëronin rrezikun imagjinar ajror të ndonjë bombardimi. Pikërisht në njërin prej këtyre ditëve, në shtëpinë tonë mbërritën dy persona, të cilët njoftuan vendimin për dëbimin familjar nga qyteti i Tiranës. I njëjti njoftim iu bë dhe hallës sime të madhe, me të cilën banonim në të njëjtën lagje. Prindërit të helmuar, u munduan të më shpjegonin se duhej të përgatiteshim*

---

<sup>7</sup> Ky fakt citohet sipas pohimit gjatë paraqitjes së kumtesës nga bashkautorët Femi Sufaj & Marinela Sota: “Të mohuarit nga regjimi: Burgjet, sistemi internim - dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri 1945-1990” në konferencën shkencore ndërkombëtare *Të mohuarit nga regjimi: burgjet, sistemi internim - dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri (1945-1990)*, Tiranë, 29-31 tetor 2018. Hedh dritë mbi këtë fakt edhe një dokument zyrtar i Ministrisë së Punëve të Brendshme dërguar Mehmet Shehut më 30 shtator 1963. Mund të konsultohet në: Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, 1963, Dosja 168, si edhe në:

[https://kujto.al/dokumenti-i-rralle-i-1962-nje-skaner-per-te-internuarit-e-regjimit-te-hoxhes/?fbclid=IéAR1XpL8Ejyb-rPX4myYfkSJPVieiGy3fUcT4QP9\\_30Fjr\\_xhSRtK3Bd-gkA](https://kujto.al/dokumenti-i-rralle-i-1962-nje-skaner-per-te-internuarit-e-regjimit-te-hoxhes/?fbclid=IéAR1XpL8Ejyb-rPX4myYfkSJPVieiGy3fUcT4QP9_30Fjr_xhSRtK3Bd-gkA)

*për të banuar diku tjetër. Filloi paketimi i orendive modeste të shtëpisë, ndërsa disa nga të afërmit tanë vinin të shqetësuar dhe të ndrojtur në orët e vona të natës. Disa prej tyre i shihja të qanin dhe disa të tjerë mundoheshin të thoshin ndonjë fjalë ngushëlluese. I dëgjoja, por nuk arrija të kuptoja përmasat katastrofike të asaj që po ndodhte. Pas dy ditësh, pikërisht ditën kur mbushja 10 vjeç, para shtëpisë sonë ndaloi një kamion dhe prindërit e mi të dërrmuar filluan të ngarkonin dengjet që kishin përgatitur<sup>8</sup>.*

Si u pritën ata në fshatin e internimit dhe si trajtoheshin kategoritë e të dëbuarve? Alma Liço e ka një përgjigje për këtë:

*Atë ditë patëm disa kontakte me fqinjët e rinj të internuar apo dëbuar disa muaj para nesh, të cilët jo pa rezerva mundoheshin të ofronin eksperiencën e tyre për përshtatjen me jetën e atjeshme. Të internuarit dhe të dëbuarit konsideroheshin armiq të partisë dhe të socializmit. I tillë ishte orientimi. Gjithçka që lidhej me trajtimin e këtyre dy kategorive të dënuarish dukej në mënyrë të trishtueshme e barabartë. Jetonin në të njëjtin fshat dhe në të njëjtat kasolle. Punonin në të njëjtat brigada. Ndryshimi ndërmjet këtyre dy formave të dënimit, ishte kufizimi ekstrem i lëvizjes jashtë territorit të atij fshati për të internuarit. Nëse të dëbuarit mund të lëviznin me një leje verbale nga drejtuesit e sektorit, për të internuarit nevojitej miratimi nga Dega e Punëve të Brendshme, dhe vetëm për nevoja ekstreme fatkeqësish njerëzore (sëmundje, vdekje etj.). Ky institucion famëkeq ishte shumë i rezervuar në lëshimin e lejeve të tilla. Madje, kishte raste kur refuzoheshin edhe kërkesat për t'i dhënë lamtumirën e fundit një personi të afërm. Në mënyrë kategorike, këto kërkesa u refuzoheshin të rinjve, ndërsa me të moshuarit tregoheshin disi më “zemërgjerë”. Në ditë festash, ishte e ndaluar kategorikisht lëvizja për të dyja kategoritë.*

---

<sup>8</sup> Alma Liço rrëfen: “Nuk mbaj mend me saktësi sa orë zgjati ai udhëtim. Në të ngrysur mbërritëm në fshatin që ishte caktuar për familjen tonë, diku në kodrat e Dumresë. Makina ndaloi në mes të fshatit dhe rreth saj u afruan disa banorë të tij. Me një kuriozitet të natyrshëm, por dhe me një gëzim të lig se “armiqtë” kishin marrë “ndëshkimin e merituar”, u munduan të orientojnë shoferin të vijonte dhe disa metra më tutje drejt asaj kasolleje që ishte caktuar për ne. Nuk kisha parë kurrë diçka të tillë më parë. Ishte vërtet një kasolle e ndërtuar me shkarpa dhe e mbuluar me kashtë. Dyshemeja me dhe. Ishim të gjithë të mpirë. Më kujtohet se u futëm në kasollen e pandriçuar dhe prindërit e mi hapën një deng, ku ne fëmijët u shtrimë për të fjetur ... Ndërsa prindërit e mi e gdhinë tërë natën majë një dengu, ku bisedonin me zë të ulët dhe pinin cigare pa fund. Erdhi mëngjesi. Kisha shpresuar se ajo që ngjau një ditë më parë të ishte një ëndërr e shëmtuar, por jo, gjithçka ishte e vërtetë. Ndesha në vështrimin e pashpresë të prindërve të mi. I pashë të shkatërruar. Sytë e tyre ishin përhumbur poshtë rrathëve të zinj. Im atë më ftoi të afrohesha pranë, dhe për herë të parë në jetën e tij më shpjegoi atë që po ndodhte dhe shkaqet e saj. Më foli për diktaturën e proletariatit, për luftën e klasave, për të atin e tij intelektual të ekzekutuar nga komunistët dhe se ne duhej të paguanim për këtë. Im atë nuk po fliste me një fëmijë dhjetë vjeç, por me një të rritur, që duhej të ndërjegjësohej për atë që e priste. U ndjeva aq konfuze, sa nuk isha në gjendje të bëja asnjë pyetje. Vetëm përpiqesha të kuptoja. Brenda tri ditëve, çdo gjë ndryshoi në atë që ishte jeta ime, çdo gjë që kisha besuar apo dëshiruar në ëndrrat e mia fëmijore nuk ekzistonte më.

*Të internuarit kishin gjithashtu, obligimin torturues të paraqiteshin çdo mëngjes në zyrat e Këshillit të fshatit, për të vërtetuar prezencën e tyre.*

*Internimi ishte masë dënimi që jepej nga Komisioni i Internim Dëbimeve, me kohështrirje pesëvjeçare, por kjo masë përsëritej çdo pesë vjet, deri në pafundësi. Rrjedhimisht, si të internuarit, ashtu dhe të dëbuarit politikë ishin përjetësisht të dënuar.*

*Një ditë pas mbërritjes në fshat, prindërit e mi u thirrën urgjentisht në zyrat e Sektorit, për të nisur punën. Si gjithë të internuarve e të dëbuarve të tjerë, atyre iu rezervuan punët më të vështira dhe të keqpaguara të bujqësisë<sup>9</sup>.*

*Si reagues ndaj tyre banorët e atjeshëm? Po familjarët a vazhduan t'i mbanin lidhjet?*

*Alma liço dëshmon: Pas disa viteve qëndrimi dhe mbijetese në atë fshat, u bëmë më të pranueshëm për banorët e atjeshëm, kësajsoj komunikimi u bë më i lehtë. Madje, me shumë prej atyre njerëzve të thjeshtë, vendosëm marrëdhënie miqësore, e cila vazhdon e tillë edhe sot e kësaj dite. Të çliruar nga indoktrinimi i diktaturës, janë të vetmit që kanë shprehur pendesë për mënyrën si na kanë trajtuar.*

*Kujtoj gjithashtu me dhimbje, se pjesa më e madhe e të afërmve dhe miqve, i shkëputën lidhjet me familjen time, për shkak të frikës nga ndonjë ndëshkim i mundshëm i regjimit. Dhe ky gjykim nuk ishte i pabazë. Një i afërm i sime mëje, e pagoi me shkarkimin nga puna ndihmën dhe mbështetjen që ofroi për regjistrimin tim në Politeknikumin “7 Nëntori”, në Tiranë. E degdisën për shumë vite larg familjes, në një fshat të largët, si mësues. Kësajsoj, ajo tentativë e dëshpëruar e prindërve të mi, për të kryer shkollën e mesme pranë gjyshes në Tiranë, dështoi, pasi në fillim të vitit të dytë më përjashtuan nga shkolla, duke vrarë përfundimisht ëndrrën dhe nevojën e natyrshme të arsimimit.*

*Në kujtesën e Almës kanë mbetur edhe rrëfimet e të internuarve të tjerë në fshat:*

*Disa prej familjeve me të cilat ndamë vuajtjen e përbashkët të dënimit, kishin kaluar më parë në kalvarin e internimit në Krujë apo Tepelenë. Fqinja jonë, me të cilën ndamë për shumë vite të njëjtën banesë, e quajtur Pirraje Mustafaraj, një zonjë e moshuar me origjinë nga Vlora, me lot në sy kujtonte se pas arratisjes së të shoqit, së bashku me katër fëmijë të mitur ishte*

---

<sup>9</sup> Alma Liço kujton: *Kujtoj me dhimbje zvarritjen e prindërve të mi në atë kalvar cilitës, pasi nuk ishin në moshë aq të re për ta përballuar. Kujtoj gjithashtu edhe refuzimin përçmues të fshatarëve që i konsideronin ata armiq. I njëjti trajtim më priste dhe mua e vëllanë nga fëmijët e tjerë. I njëjti trajtim edhe nga disa mësues. Kujtoj me dhimbje se njëra prej tyre, një ditë ma përplasi në fytyrë, se sado të mësoja, kazma më priste...isha dhjetë vjeç. Një tjetër problem me të cilin u përballëm ishte dhe motra e vogël trevjeçare, e cila nuk mund të lihej vetëm në kasolle, ndërkohë që unë dhe vëllai ishim në shkollë, dhe prindërit në punë. Për një vit e kam tërhequr zvarrë, në mes të baltës motrën e vogël, në shkollë, bashkë me mua. Çuditërisht, u pranua që ajo të qëndronte në bankën e fundit. Si të kishte kuptuar situatën, ajo vogëlushe me pamje engjëjlore, qëndronte pa lëvizur dhe pa kërkuar asgjë.*



*internuar në Kampin e Krujës. Për shkak të kushteve të tmerrshme, shumë fëmijë humbën jetën në atë kamp, ndër të cilët edhe dy vajzat e saj të mitura, binjake.*

*Po aq e trishtueshme ishte edhe historia që na tregonte Luçie Mirakaj. Në ndryshim nga qytetarët e jugut të Shqipërisë që internoheshin në zonat veriore, kjo zonjë, qytetare e Shkodrës, së bashku me familjen e saj të madhe, ishin internuar në kampin me tela me gjemba të Tepelenës e atë të Porto-Palermos. Ajo kujtonte trajtimin çnjerëzor të stafit të kampit. Gra dhe vajza që për arsye nga më banalet, fshikulloheshin me kamxhik prej tyre. Ishte gati në kufijtë e të pabesueshmes, që në apelin, i cili kryhej tre herë në ditë, duhej të paraqiteshin edhe fëmijët. Vocërrakët që për shkak të moshës, nuk mund t'i përgjigjeshin apelit, duhej patjetër të qanin që të vërtetonin prezencën e tyre. Nënata e ngrata detyroheshin t'i lëndonin këta fëmijë, që t'u shkaktonin të qarën. Si të gjitha gratë e tjera që kishin fëmijë të mitur, Zonja Luçia, i nënshtrohej çdo ditë këtij rituali. Dy fëmijët e saj, e në veçanti i biri që ishte vetëm disa muajsh, duhej t'i përgjigjej apelit duke qarë.*

*Sa aktiv ishte Sigurimi i Shtetit dhe cilat ishin disa nga mënyrat se si shantazhonte?*

*Pas disa vite vuajtjesh në atë fshat, pati një tentativë tjetër nga ana e Sigurimit të Shtetit për të rekrutuar si bashkëpunëtore, mamën time. E mbaj mend shumë mirë atë ditë, pasi isha bashkë me të. Për të garantuar sekretin e kërkesës që do t'i bëhej mamës sime, ishte përgatitur edhe një skenar. Disa nga gratë e familjeve të internuara që posedonin makina qepëse në shtëpi, duhej të paraqiteshin tek Kryetari i Këshillit të NB Belsh, ku do t'u bëhej presion e do të kërcënoheshin për penalizime dhe dënime nëse përdornin makinat qepëse për nevojat të fshatarëve të tjerë. Dhe nuk kishte asgjë për t'u çuditur, pasi ligjet e asaj kohe ndalonin çdo aktivitet të ushtruar në mënyrë private. Madje, dy prej tyre ishin dënuar me gjoba të rënda për diçka të tillë. Këto gra të gjora, hynë një nga një në zyrën e kryetarit, ku siç ishte parashikuar, u shantazhuan pikërisht për këtë arsye. Ndërsa për mamën time ishte rezervuar diçka tjetër. Pasi e komplimentuan për qëndrimin e saj korrekt në ato vite, e joshën me të drejta studimi për fëmijët e saj, sigurisht në këmbim të bashkëpunimit me ta. U përsërit e njëjta situatë, sikurse me tim atë. Refuzimi i saj u shoqërua me përplasje grushtesh mbi tavolinë, me kërcënime për të ardhmen e fëmijëve, të cilët, sipas tyre do zvarriteshin e do vdisnin kodrave të Dumresë. "Premtim" i mbajtur. Asnjë nga fëmijët e familjeve të internuara nuk u lejua të arsimohej.*

*Në rrjedhën e atyre viteve pati ndonjë rast sporadik, ku individë që i përkisnin familjeve të persekutuar të binin pre e shantazhit të bashkëpunimit me Sigurimin e Shtetit. Në këmbim të disa favoreve shumë të vogla, ata u trajtuan shumë keq, duke u përdorur si dëshmitarë në gjyqe politike apo demaskime publike kundër bashkëvuajtësve të tyre. Ky fenomen e përshkallëzoi me tej frymën e pasigurisë dhe përkeqësoi frymën e mirëbesimit reciprok me ta,*

*aq të nevojshëm për mbijetesën në atë skëterrë. Pavarësisht këtyre rasteve, vuajtja e përbashkët në shumë vite, bëri që familjet e dëbuara dhe internuara të ndërtonin miqësi shumë të forta dhe të mbështesnin njëra-tjetrën. Shumë prej tyre u lidhën dhe me anë të krushqive, duke bashkuar fatet e fëmijëve me martesë.*

Alma Liço, në kujtimet e saj, sjell edhe këtë reflektim lidhur me ushtrimin e të drejtës së votës:

*Nuk mundem të harroj pjesëmarrjen time të parë në votimet farsë që siguronin vazhdimësinë e sundimit të shtetit komunist. Nuk kishte alternativa konkurruese. Kandidatët për të cilët do të hidhej një copë letër në kuti, ishin të përzgjedhur nga partia-shtet.*

*Prej mëse një muaji, nëpër muret e shtëpive dhe dyqaneve ishin ngjitur postera e zhgarravina slloganesh në të cilat shkruhej: “Votat tona plumb për armikun”. I lexoja me pësjtjellim, dhe natyrshëm më lindte pyetja... vallë kush ishte armiku?.....dhe po aq e qartë ishte dhe përgjigjja: ...sigurisht isha unë...ishin prindërit e mi...ishin të internuarit e tjerë... me pak fjalë, vota ime ishte plumb kundër vetes sime...qesharake dhe cinike njëkohësisht. Ashtu siç ma kishte përshkruar im atë, një anëtar i komisionit të votimit më zgjati një fletushkë në të cilën dallova disa emra të shkruara me dorë. Dhjetëra sy po ndiqnin me padurim dhe keqdashje lëvizjet e mia. Nën peshën e papërbalueshme të atyre vështrimeve, pa e zgjatur, e palosa atë fletushkë dhe e hodha brenda një kutie të mbështjellë me copë të kuqe. Në mënyrë të përshpejtuar, të njëjtin veprim bënë dhe prindërit e mi, dhe pas dy minutash morëm rrugën e kthimit për në shtëpi. Ajo maskaradë hipokrite, ajo gënjeshtër e madhe do të kulmonte në mbrëmje kur do të publikoheshin rezultatet e votimit...kishin marrë pjesë në proces 99.90% e personave të regjistruar dhe po i tillë ishte edhe rezultati i numërimit të votave. Asnjë votë kundër. Impresionuese.*

Është e pamundur që përjetimet e një jete të tërë, të mbushur me tmerre dhe privacione të të gjitha llojeve, të përmbliohen në një rrëfim të shkurtër. Kujtimet dhe refleksionet që lidhen me vitet e trishta të fëmijërisë, Alma Liço i ka përshkruar në librin e titulluar “Krahë të këputur” në dy vëllime, botimi i të cilit u mundësua nga Instituti i Studimit të Krimeve të Komunitetit.

Në këtë prezantim modest, homazh për të gjithë bashkëvuajtësit e saj të kudondodhur, Alma Liço sjell edhe refleksionet dhe zhgënjimet e saj për mënyrën se si u trajtuan dhe vazhdon të trajtohen ata edhe sot:

*Rënia e regjimit u pasua nga zhgënjimi që solli mosbërja e drejtësisë për krimet e tmerrshme që përjetuan. Në rrjedhën e viteve të postkomunitetit, kam vuajtur bashkë me ta sorollatjet e turpshme në kërkim të pronave të grabitura, që në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën e të Drejtave të Njeriut, nuk u kthyen kurrë, por u tjetërsuan në mënyrë më të*

*pacipë e mizore. Së bashku me ta, kam provuar shkarkimet nga detyra, me pasojë shkatërrimin e administratës shtetërore, në çdo rast të rotacionit të pushtetit. Të cfiltrur nga jeta, bashkëvuajtësit e mi, sigurisht ata që ende nuk ia kanë mbathur nga Shqipëria, po i kalojnë këto vite dyerve të gjykatave, në kërkim të një strehe, ose në pritje të lëmshave të kompensimit të turpshëm e mjeran. Kam vuajtur bashkë me ta mashtrimin e një dëmshpërblimi selektiv e të cunguar vetëm për një kategori të dënuarish. Kam parë lotët e nënave të kampit të Tepelenës, që besonin se ligji që parashikonte dëmshpërblimin e tyre, do të zbatohet ndonjë ditë. Por kjo kurrë nuk ndodhi, dhe nuk ka asnjë vullnet të ndodhë. Madje, evidentohet e kundërta. Ndryshimet ligjore të propozuara vitin e fundit, me një cinizëm e keqdashje të pashembullt, e minimizojnë në maksimum numrin e të persekutuarve politikë që meritojnë dëmshpërblimin e krimeve të pësuar.*

*Dëshmitë e paraqitura në këtë prezantim i konsideroj gjithashtu homazh për të katër brezat e familjes sime që kaluan nëpër këtë kalvar, e në veçanti për atin tim, i cili mbylli sytë katër vite më parë. Ai mori me vete brengën e madhe se kurrë nuk iu kërkua ndjesë për vuajtjet e pamerituara, kurrë nuk u kompensua për gjithçka iu grabit. Im atë mori me vete dhimbjen e së njëjtës luftë klasash, kur fëmijët e tij u flakën nga puna në rrugë të madhe.*

Për të gjitha këto arsye, në përfundim të kësaj trajtese, urojmë dhe shpresojmë që konkluzionet dhe rekomandimet e kësaj Konference, të përcjellin mesazhin e rritjes së vëmendjes e ndërgjegjësimit institucional dhe publik, për të kontribuar e orientuar drejt evidentimit të të vërtetave të mëdha tragjike që viktimizuan qindra, mijëra të pafajshëm, e për rrjedhojë dënimit institucional të atyre krimeve. Ky hap i domosdoshëm, do t'i shërbejë vendosjes së drejtësisë së munguar, do t'i shërbejë qetësimit të shpirtave të dhunuar, do t'i kontribuojë ekuilibrit të një shoqërie ende të përçarë e të lodhur nga tranzicioni i tejzgjatur.

## **Aneks**

### **I. Alma Liço Mirakaj - Profil**

Alma Liço Mirakaj vjen me dëshmi direkte mbi periudhën e saj të internim-dëbimit dhe refleksione mbi kohën, shkakun, mënyrën se si u kryen, pasojat që tjetërsuan jetët e familjarëve të saj. Dëbimi i familjes së saj nga qyteti i Tiranës, u krye në vitin 1968. Së bashku me 15-20 familje te tjera të internuara ose dëbuara, pak a shumë në të njëjtën periudhë, u vendosën në zonën Dumresë, në fshatin më të largët të saj, të quajtur Dragot. Atje u trajtuan si armiq të partisë dhe të popullit. Si pothuajse të gjitha internim-dëbimet e familjeve të konsideruara kundërshtarë të regjimit komunist, ai vazhdoi deri në rënien e tij në vitin 1991.

Familja e saj atëkohë përbëhej nga pesë anëtarë, dy prindërit dhe tre fëmijë të mitur. Në ditën e ekzekutimit të vendimit të dëbimit ajo mbushte 10 vjeç. Shkaku i dëbimit të familjes ishte i gjyshi, Muamer Liço, i cili kishte studiuar për drejtësi në Universitetin e Harvardit, dhe kish ushtruar profesionin e avokatit në qytetin e Korçës. Si nacionalist, ishte përfshirë në lëvizjen dhe aktivitetet e Ballit Kombëtar.

Persekucioni komunist viktimizoi katër breza në familjen e saj: gjyshi, i dënuar në vitin 1945 me pushkatim, dy prindërit e saj me tre fëmijët e tij për 23 vite në internim – dëbim; si dhe fëmijët e vetë Almës, që u lindën dhe kaluan vitet e para të fëmijërisë në fshatin e dënimit.

### *Të dhëna mbi familje të internuara në Belsh*

Ndërmarrja Bujqësore e Belshit ishte e përbërë nga disa sektorë bujqësorë, të cilat pas vitit 1967, u trajtuan për vendosjen e familjeve të internuara ose dëbuara. Kujtoj sektorin e Kosovës, Fierzës, Gjyralës, Xibrakës dhe Dragotit. Në këtë të fundit, ku jetoi familja ime, u vendosën 22 familje të internuara/dëbuara, me 106 anëtarë. Ndonëse nuk mund të jem plotësisht e saktë, pak a shumë një numër i ngjashëm familjesh u vendosën dhe në fshatrat e tjera.

Familjet dhe emrat e anëtarëve të tyre, dëbuar/internuar në fshatin Dragot:

	<b>Familja</b>	<b>Origjina</b>	<b>Dëbuar nga</b>	<b>Internuar nga</b>	<b>Shkaku</b>
1	Sali Doko dhe bashkëshortja	Kolonjë	Qyteti Elbasan		Një vëlla i arratisur
2	Sami Doko, bashkëshortja dhe dy djem të mitur	Kolonjë	Qyteti Elbasan		Një vëlla i arratisur
3	Bibjan Mirakaj, e ëma, bashkëshortja, dy fëmijë të mitur	Tiranë		Qyteti Tiranë	Babai i ekzekutuar
4	Gjolek Mustafaraj, e	Vlorë	Qyteti Elbasan		Babai i ekzekutuar

	ëma, e shoqja dhe tre fëmijë të mitur				
5	Jonuz Musai, e ëma, vëllai dhe dy motra. Ndërkohë i ati ishte dënuar 10 vite. Gjatë periudhës së dëbimit, u burgosën dhe Jonuzi me të vëllanë	Korçë	Qyteti Elbasan		Xhaxhai i arratisur
6	Nevzat Liço, bashkëshortja, tre fëmijë të mitur	Korçë	Qyteti Tiranë		Babai i pushkatuar
7	Lumturi Liço, i biri	Korçë	Qyteti Tiranë		Babai i pushkatuar
8	Imer Nerguti (familje e madhe me djem, nuse dhe fëmijë të mitur)	Kukës		Rrethi Kukës	Djali i arratisur
9	Hajdar Aliçka, bashkëshortja dhe dy djem	Kolonjë	Qyteti Elbasan		Një vëlla i arratisur
1	Luigj Frroku, e ëma, bashkëshortja	Tiranë		Qyteti Tiranë	Një vëlla i arratisur

	dhe tre fëmijë të mitur				
11	Safet Duro, bashkëshortja, i biri, e kunata dhe e mbesa	Përmet	Qyteti Elbasan		Një vëlla i arratisur
12	Fuat Çela, e ëma, bashkëshortja, tre fëmijë të mitur	Korçë	Qyteti Elbasan		vëllai i ekzekutuar
13	Familja Çekrezi, disa djem dhe familjet e tyre	Gramshi	Qyteti Elbasan		Kryefamiljari shumë vite burg
14	Agim Xhaferri, e ëma dhe dy motra	Dibër		Qyteti Tiranë	Një vëlla në burg
15	Gazi Aliçka, bashkëshortja	Kolonjë	Qyteti Elbasan		Kryefamiljari shumë vite burg
16	Ali Zita, bashkëshortja, katër fëmijë të mitur	Tiranë	Qyteti Tiranë		Një vëlla i arratisur
17	Zyhdi Zita, bashkëshortja, tre fëmijë të mitur	Tiranë	Qyteti Tiranë		Një vëlla i arratisur
18	Kadri Zita	Tiranë	Qyteti Tiranë		Një vëlla i arratisur

	bashkëshortja, tre fëmijë të mitur				
19	Ernest Andrachio	Shkodër		Qyteti Shkodër	E ëma dhe vëllai në burg
20	Hasan Kulla bashkëshortja, tre fëmijë të mitur	Korçë	Qyteti Elbasan		Të ekzekutuar dhe të burgosur familjarë
21	Zenel Qyteza, bashkëshortja, dy fëmijë të mitur	Korçë		Qyteti Elbasan	Një vëlla i arratisur
22	Fatime Zita dhe e bija	Tiranë	Qyteti Tiranë		Një djalë i arratisur

## Natasha Llanaj Perunja - Veprimtare e të drejtave të njeriut

### Qyteti minator i Selenicës në Vlorë

#### Abstrakt

Merret në analizë qyteti i vogël minator i Selenicës në Vlorë, i kthyer në vend internimi dhe izolimi për shumë kundërshtarë të regjimit. Ashpërsimit të luftës së klasave, humbjeve të jetës së minatorëve në galeritë e minierës, iu shtua dhe frika se kush e kishte radhën të merrej i detyruar apo kush po sillej me Gazin 69, i frikshëm jo vetëm të familjet direkt të goditura, por për gjithë qytetarët dhe më gjerë, për të gjithë lokalitetin me rrethinat, Lubonjë, Picar, etj

Modestisht dua të shpreh mendimin dhe qëndrimin tim të kahershëm dhe të sotshëm në raport me diktaturën komuniste të Shqipërisë sonë dhe falënderoj organizatorët që besuan tek unë dhe më dhanë mundësinë të shprehem. Nuk vij si historiane, por vij si studiuese, si qytetare bashkëjetuese në një vend të izoluar ose siç quhej vend internimi.

Secilin nga ne e ka munduar dhe e mundon pyetja, a kam bërë sa duhet, për çlirimin dhe demokratizimin e kësaj shoqërie që i ka munguar shumë liria? A i kemi njohur ne brezat me sakrificat e prindërve dhe gjyshërve të tyre, me kalvarin e vuajtjeve për mbijetese në një nga vendet me diktaturën më të egër? Sigurisht që ne të gjithë kemi një bilanc, por a ka qenë ky i mjaftueshëm? Unë them se jo, prandaj, siç thotë miku im, Visar Zhiti, edhe duke vrapuar, ne jemi të vonuar.

Këto kanë qenë disa nga arsyet që unë u përfshiva në projektin *Dialog dhe Informim për të shkuarën komuniste të Shqipërisë* dhe tani në këtë konferencë për të mohuarit nga regjimi, sepse e kaluara nuk harrohet ajo ka lënë gjurmë që janë pjesë e qenësishme e së tashmes. Për këtë iu ktheva kujtimeve sa familjare dhe shoqërore të qytetit të Selenicës në rrethin e Vlorës dhe jo vetëm. Kam shfletuar qindra faqe dokumentesh, ku në mënyrë rrëqethëse pasqyrohet mizoria e atij regjimi që burgosi, pushkatoi, dëboi dhe internoi shumë familje nga vatrat e tyre.

Por cilët ishin këta njerëz?

Këta njerëz ishin ajka e intelektualëve shqiptarë të shkolluar në Universitetet më të mira të Evropës, njerëz të guximshëm që donin të zbatonin modelet e shoqërive më të përparuara të Perëndimit, këta ishin njerëz që ishin kundër rrëmbimit të pronës së tyre, këta ishin njerëz që e kishin kuptuar rrezikun e instalimit të diktaturës dhe izolimit të vendit. Këta ishin njerëz që donin lirinë e tyre dhe e kuptuan që po ua rrëmbenin atë.

Në këtë burg të madh dhe të izoluar ku jetonim të tërë, ata ishin më të dënuarit, sepse edhe në se do të kishin fatin të dilnin gjallë nga burgjet e Spaçit dhe të Burrelit, ndjekja dhe përndjekja e tyre do të vazhdonte edhe me fëmijët në barkun e nënës të familjarëve të tyre.



Janë gjurmë që nuk harrohen të nderuar miq, por që fisnikërisht të mohuarit e regjimit, na treguan se janë modeli më i mirëi shoqërisë sonë, ata jo vetëm nuk u hakmorën për padrejtësitë që u bënë, por kanë qenë dhe mbeten modeli i tolerancës, bashkëpunimit dhe bashkëjetesës së shoqërisë sonë.

Po ata që shkaktuan këtë kalvar të vuajtjeve të këtij populli, të qindra e mijëra njerëzve të mohuar nga regjimi, që i burgosën, i varën, i pushkatuan, u morën pronat, shtëpitë, mbi të gjitha lirinë, çfarë bënë? A kërkuan minimalisht ndjesë? Mendoj se ende jo!

Çfarë mund të themi dhe si është e mundur të nderuar miq, që në emër të një jete ku do të hahej me lugë floriri, në krye të partisë-shtet, një grup njerëzish në plenum dhe komitete partie, apo edhe në Komitetin Qendror të merren vendime me vdekje, kur këto vendime qoftë edhe formalisht merren nga gjykatat! Që këtu shkelet e drejta e njeriut në mënyrë flagrante, qoftë edhe një rast i vetëm po të ishte. Të mbrosh sot Enver Hoxhën është si të mbrosh krimin me vetëdije apo pavetëdije, se shumë thonë e hëngrëm një copë bukë.

Dëshmitë rrëqethëse të shpalosura jo vetëm nga të mohuarit e regjimit, po edhe nga historianë seriozë, me fakte dhe dokumente, na ndihmojnë të gjithëve si qytetarë, të përgatisim të përballemi me guxim me të kaluarën. Është detyra jonë të përgatisim breza të rinj, për sot dhe për nesër, t'i bëjmë njerëz të drejtë dhe të virtytshëm të mbrojnë veten dhe shoqërinë. Të mbrojnë shoqërinë dhe të mos lejojnë të asfiksohet nga muret e dhunës dhe arrogancës së çdo lloj pushteti.

Vetëm në vitin 1983 sipas disa vendimeve të Komisionit të dëbim internimeve, janë dëbuar dhe internuar qindra familje dhe individë. /*Dosja 250 dhe 251, lista e dëbim internimeve*/. Po ju paraqesim vetëm disa vendime të vitit 1983 që kemi mundur të shfletojmë.

27 .12.1983, faqja 136, janë dëbuar dhe internuar në zonat dhe fshatrat më të thella të Vlorës dhe Selenicës 122 familje dhe individë.

53 Familje në datën 22 .10.1983, faqja 98, vetëm me 19.12.1983, /dosja 251, faqja 66/ janë dëbuar dhe internuar 119 familje dhe individë.

Vetëm me një vendim po të këtij viti janë dëbuar dhe internuar nga qyteti i Vlorës mbi 60 familje.

Nëse do të paraqitnim dhe shumë lista të tjera do të ishte një numër pafund. Por edhe një edhe dhjetë po të ishin, përse dhe për kë?

Përse do të shkatërrohej jeta e tyre dhe familjeve të tyre, ëndrrat dhe rinia e tyre do të vriteshin dhe ndërpriteshin, përse dhe për kë?

Kampet e izolimit ose kampet e hapura si Selenica dhe shumë zona të thella të Vlorës dhe të Shqipërisë nuk mund të krahasohen me burgjet e Spaçit dhe të Burrelit ku humbën jetën

dhe rininë e tyre shumë nga elitat e kombit, por ishte një jetë e vështirë nën vëzhgimin mbyttës të Sigurimit të Shtetit.

Në çdo hap të jetës që do të bëjë do të duhej miratimi i organizatave të Partisë, do të duhej miratimi i operativit të Sigurimit. Edhe për të shkuar në spital në Vlorë do të merrje lejen e operativit, nuk mund të takoje dhe të merrje pjesë në gëzimet dhe fatkeqësitë e të afërmeve, miqve sepse do të krijojë problem edhe për ata.

Dikush mund të më thotë se në atë qytet dhe ato zona të tilla jetonin edhe njerëz të tjerë, sigurisht atje jetonin dhe unë kam shumë respekt dhe mirënjohje për të gjithë ata njerëz që me mbështetjen e heshtur dhe herë të hapur ndaj të internuarve sfiduan regjimin. Por sigurisht një pjesë e mirë që diktatura i bëri qenie të modeluara shtetërore, me vigjilencën e tyre në thonjëza e bënë më të rëndë jetën e të internuarve, sepse nuk e dije nga do të ruheshe më parë.

Selenica është një qytet i vogël minatorësh me një nga minierat më të vjetra të Shqipërisë, me serën e së cilës ishin shtruar rrugët e Evropës, por 36 kilometrat e saj për në Vlorë nuk ishin shtruar kurrë. Qyteza mbliidhte punëtorë edhe nga fshatrat përreth. Vështirësia e punës në minierë, tymi dhe bloza e zezë e shkrirjes së serës shkatërronin mushkëritë jo vetëm të minatorëve që nuk i kalonin të 60-tat, por të gjithë qytetarëve.

Ekonomia familjare ishte shumë e varfër, ende i kam para syve fëmijët e vegjël duke trokitur tek njëri- tjetri për një lugë salcë apo një filxhan vaj, apo si e ndanin rrogën me njeri-tjetrin, kush e merrte i pari, dhe kështu qarkullonte në gjithë lagjen deri savinte rroga tjetër dhe shlyenin borxhet. Një varfëri që e kemi ndjerë të gjithë.

Këtyre pamjeve, iu shtuan netëve në errësirë edhe ardhjet e familjeve që kishin lënë të detyruara shtëpitë dhe vatrën e tyre.

Nëpër mend më kalojnë dëshmitë e gjalla të familjeve të paratë ardhura në këtë qytet të dëbuar dhe të ndëshkuar padrejhtësisht nga regjimi, familja Murtaç, Xhaferaj një familje me djem të talentuar që kontribuuan dukshëm në jetën e qytetit si piktorë dhe duarartë por që nuk patën fatin që fëmijët e tyre të shkolloheshin me arsim të lartë. Është një nga pengjet që mund të ketë jo vetëm prindi dhe fëmija, por edhe shokët dhe mësuesit e tyre për këtë ndalim në arsimimin e tyre.

Lufta e klasave kërkonte që këta të mos arsimoheshin më tej se bëheshin më të rrezikshëm për pushtetin e Diktatorit.

Familja Ndreu e vendosur në Lubonjë të Selenicës, historinë e ndëshkimit dhe burgosjeve të tyre e kemi dëgjuar në shumë dëshmi dhe studime të historianëve. Por unë doja vetë ta prekja nëpërmjet disa dokumenteve:“*fajin apo krimin*” në thonjëza të kësaj familjeje.

### ***Dosja Xhelal Ndreu***

Një familje me 70 anëtarë pasi Cen Elezi doli në mal si kundërshtar i qeverisë komuniste filloi një kalvar i vërtetë vuajtjesh, burgosjesh dhe internimesh për këtë familje.

Xhelal Ndreu kishte bërë Shkollën Teknike ku drejtor ishte Hari Fultz dhe me shpresën se pushteti komunist do të binte dhe do të ndërtohej një shtet perëndimor bashkëpunojnë me anglo-amerikanët. Të tjerë vëllezër nga frika e arrestimeve tentojnë të arratisen, por nuk mundën t'i shpëtojnë arrestimeve dhe dënimeve.

Bashkëpunimi i tyre me organizatën “*Bashkimi Demokratik*”, është një tjetër dëshmi e përpjekjeve të tyre kundër shtetit komunist dhe vendosjen e një shteti sipas modelit perëndimor.

U konfiskohet pasuria dhe fillojnë dëbim internimet e tyre në Berat, Tepelenë, Valias, Porto Romano, Kripore, Sevaster, Xhuherinë, Llakatund, Lubonjë.

Djemtë e kësaj familjeje bëjnë të gjithë së bashku rreth 130 vjet burg.

Një familje që pësoi një kalvar vuajtjesh dhe persekutimesh në burgje, kampe dhe zona të thella, pa asnjë të drejtë shkollimi të lartë, edhe pse ishin nxënës të shkëlqyer që do ndiqeshin dhe përndiqeshin në çdo hap edhe në bangat e shkollës me denigrimin si armiq të pushtetit. Edhe sot është në kujtesë reagimi i shokëve që e donin Cezar Ndreun shokun e tyre, ndaj mësueses kandidate partie që e denigronte hapur si djali i një familje armike të popullit. Gjithçka bëhej në emër të popullit, fatkeqësisht.

### ***Familja Hasanaj / Dosja Xhevdet Hasani.***

Në ligjëratë të zhdrejtë po mundohem të jap disa nga dëshmitë e tyre në hetuesi dhe në gjykimin e tyre për të kuptuar më mirë çfarë përfaqësonin dhe çfarë kërkonin këta njerëz që u arrestuan, u burgosën dhe u dëbuan nga shtëpitë e tyre.

Xhevdet Hasani, Pelivan Sako Hazizi, Guro Abazi, Irfan Shaska e shumë qytetarë të tjerë që përpiqeshin të reagonin mbas rrëmbimit dhe konfiskimit të pronës dhe varfërimit të njerëzve. Veprimtaria e tyre nënvizonte zgjimin e punëtorëve ndaj trajtimit të keqë pagë, gjendjes së rëndë ekonomike. Frymëzoheshin duke dëgjuar Zërin e Amerikës, Radio Londrën, Radio Komiteti /Shqipëria e lirë. Fjalimi i Ajzenhaurit që thoshte në atë kohë se duheshin bërë zgjedhje të lira në vendet e Demokracive Popullore, i frymëzonte këta njerëz për të kundërshtuar zgjedhjet e partisë që vendoste vetë përqindjen, siç shprehen në dëshmitë e tyre në hetuesi.

Rrëmbimi i pronës dhe lufta e egër e klasave shton revoltën e tyre dhe përpjekjet për të krijuar Partinë Agrare Demokratike “Vëllazërimi i fshatarëve për liri”.

*Parimi kryesor i saj do të ishte bashkëpunimi ndërkombëtar i partive fshatare kundër reformave komuniste, Kooperativat bujqësore janë krijuar me forcë duke shkelur të drejtat e*

*individit, pronësia mbi tokën.* Këto materiale, në ligjëratë të zhdrejtë, theksoj gjithnjë janë marrë nga procesverbalet e hetuesisë dhe gjykimit të tyre. Këta njerëz u burgosën me rreth 20 vjet burg secili, por edhe familjet e tyre u dëbuan dhe persekutuan gjithë vitet e regjimit, tentuan të arratisen por nuk ja dolën dhe vazhduan pa asnjë të drejtë shkollimi, traumat e të cilave i paguan deri vonë.

Në se do të ndalesha në çdo familje do të dëgjonim jo vetëm dëshmitë e përndjekjes dhe burgosjes së tyre, por do të kuptonim dhe ndjenim më mirë dhe nga afër vuajtjen shpirtërore të tyre dhe fëmijëve të tyre. Janë me dhjetëra dhe qindra familje që brenda ferrit të përgjithshëm komunist ishin më të ndëshkuarat.

Syri i Sigurimit të Shtetit dhe vigjilencës së partisë do t'i ndiqte në çdo hap deri edhe në vdekjen e tyre. Vetëm sepse ju dha një makinë miniere familjarëve të Selim Dalanit ish i burgosur politik, për ta përcjellë për t'u varrosur në vendin e tij, do të bëheshin mbledhje partie me orë të tëra, ku do të ndëshkoheshin edhe njerëzit e partisë për zbutjen e luftës së klasave, do të dëshmonte një ish komunist në atë kohë.

Familje të tëra si Dibra, Aliaj, Meminaj, Lepenica, Premto, Sharra, Beqiri, Shaska etj., që dallonin vetëm nga origjina dhe shkollimi perëndimor do të ishin mjaft të rezervuar deri edhe në krijimin e familjeve të reja të tyre, biografia do t'i ndiqte në çdo hap. Vëzhgimit të Sigurimit të Shtetit nëpërmjet operativëve të tyre nuk i shpëtonte asnjë dhe asgjë, edhe muret kishin veshë, ishin ndrydhur edhe fëmijët në barkun e nënës. Ata mobilizonin në emër të vigjilencës së partisë shumë njerëz për të ndjekur çdo veprim, çdo fjalë të këtyre njerëzve dhe të informonin operativin.

Varfëria dhe frika e arrestimit dhe dëbimeve mbizotëronte kudo, por megjithëkëtë kam një mirënjohje për njerëzit e thjeshtë të këtij qyteti që në mënyra të ndryshme herë heshtur dhe herë me guxim dinin si të gjendeshin pranë. Sa më shumë varfërohej vendi, aq më e egër bëhej lufta e klasave dhe thellohej ndarja. Hije që kanë lënë gjurmë edhe sot në shpirtrat e të gjithë njerëzve. Nënë Duda, tregon me lot në sy mbas viteve '90, se si nuk kish mundur të shkonte as në dasmën e nipit të saj nga motra sepse ajo ishte nëna e armiqve të popullit, i kishte djemtë në burg. Ndarja kish tronditur familjet e shqiptarëve, kush më shumë e kush më pak këtë e kemi ndjerë të gjithë.

Nënë Melua, ajo grua fisnike që e donte dhe respektonte gjithë lagjja edhe sot është në kujtesën e bashkëqytetarëve, nuk do të mundte dot të bënte një punë qoftë edhe pastruese në shtet, në një shkollë, në një spital edhe pse vuante nga zemra. Kishte shumë fëmijë, por atë e përndiqte biografia e keqe politike e armiqve të klasës. Një drejtor shkolle zemërmirë e mori

si pastruese, por edhe këtu e hoqën, sa zonjë ishte ajo grua, kur mund të gëzonte në demokraci ajo u shua dhe gjithë qytetit i erdhi keq.

Njerëz me diplomat e laurimit më të mira, me familjarët e tyre do të bënin jo vetëm punët më të vështira dhe të papërshtatshme, por nëpër brigadat ku punonin në bujqësi ose në minierë do të përjashtoheshin nga mbledhjet e punës si armiq të popullit se duhej thelluar ndarja, duhej ruajtur nga armiqtë. Veprime absurde, që sot duken të pabesueshme nga të rinjtë. Një fëmijë i një armiku nuk mund të merrte pjesë dhe të zgjidhej as në organet e pionierëve apo të rinisë në shkolla edhe pse mund të ishin nxënës nga më të mirët në mësim dhe në sjellje.

Këto janë gjurmë që dhembin, janë gjurmë që nuk harrohen.

Ishte jo vetëm e shëmtuar por edhe poshtëruese dhe e frikshme të shihje në mëngjes ose pasdite familjet e internuara të paraqiteshin tek operativi i degës së brendshme për prezencën. Qyteti shihte herë me çudi, herë me kënaqësi nga besnikët e partisë, dhe me frikë kush e kishte radhën e arrestimit. Pra në sytë tanë me vetëdije apo pa vetëdije ishte gjithë shoqëria e përfshirë, indirekt njerëzit duhet të ruheshin të mos kishin fatin e tyre.

Shfleton dhe lexon shumë dokumente të Sigurimit të Shtetit dhe ndihesh shumë e trishtuar, e revoltuar dhe të zgjohen shumë kujtime dhembjeje që dikush sot edhe të mundohet t'i relativizojë, janë gjurmë që nuk harrohen, vetëm ata që i kaluan dhe ata me zemër të madhe mund t'i kuptojnë.

Ajo që do më mbetet në mendje duke shfletuar dokumentet e dënimit dhe gjykimit të tyre nuk rezulton të jenë tradhtarë të Kombit, kurthet dhe intrigat për ta ngriheshin që të vdisnin fjalën e lirë, është frika e partisë, se do rrezikonin pushtetin. Pasi burgosi, pushkatoi dhe përndoqi e dëboi nacionalistët, pronarët, elitën e shkolluar në Perëndim, familjet e tyre, partia shtet do ta mprehte shpatën për bijtë e vet. Filloi lufta e egër brenda partisë, filluan burgosjet internimet me familjet e tyre, shumë familje erdhën në këtë qytet.

Familja e Pajo Islamit, familja Jakova, familja Belishova, Frashëri, Dermani, Ngjela, Hoxha, Dumi, Kerenxhi, Dishnica, Mamaqi, Dermani, Kruja, Cako, Themeli, Bedri Spahiu, Balluku e shumë e shumë të tjerë.

**Gazet 69**, / *kështu quheshin makinat e sigurimit*/ do të vini ditën natën, arrestonin, sillnin të tjerë. Të gjitha këto reflektonin frikë dhe ankth në gjithë qytetin. Një pjesë e këtyre njerëzve më parë në poste të larta shtetërore ishin përgjegjës dhe vendimmarrës të burgosjes dhe internimeve dhe kalvarit të vuajtjeve të të persekutuarve antikomunistë. Një pjesë panë dhe prekën nga afër se ëndrrat e tyre për një shtet të drejtë ishin një iluzion, një pjesë edhe reagues. Dënimi, burgosja, dëbimi dhe poshtërimi i tyre do të ishte po aq i egër nga partia e tyre sa edhe të tjerëve antikomunistë më parë. Ruheshin këta nga kontaktet me njerëz, ruheshin njerëzit nga

kontaktet me ta dhe rituali i paraqitjes së përditshme tek operativi i degës. Qytetarët e kuptonin ardhjen e tyre nga lëvizjet e sigurimit, bëheshin gati shtëpitë e tyre me aparaturat e përgjimit dhe në mesnatë ishin aty.

Ku do të punonin? lind pyetja. Sigurisht në punët më të vështira që nuk kishin asnjë lidhje me diplomimin e tyre. Familjet dhe fëmijët e tyre e vuanin edhe më shumë qoftë edhe për faktin kishin jetuar më mirë se të tjerët, qoftë edhe për faktin cili ishte faji i tyre. Kishte pamje nga më të ndryshmet në qytet, frikë dhe ankth për të nesërmen. Skërmitje dhëmbësh mbledhje për forcimin e vigjilencës së partisë, kinezëria me nxënës shkollash duke kaluar para shtëpive të tyre duke bërtitur në kor: Parti / Enver!

Varfëria rritej çdo ditë dhe njerëzit që pritnin me shpresë, antikomunistët e parë që merrnin zemër dhe thoshin me njëri-tjetrin se po i vjen fundi këtij regjimi, gjithçka mendonte ai qytet. Po çfarë gjen duke shfletuar dokumentet e tyre të hetuesisë dhe gjykimit, në shumicën e rasteve nuk bien dakord me thellimin e luftës së klasave dhe ndarjen në armiq, gjen reflektim tek ta për qëndrimin ndaj të persektuarve antikomuniste si Liri Belishova, etj.

Pra prirja për refleksion ekziston tek të gjitha qeniet humane. Por a mund ta bëjnë këtë ekzekutorët dhe përgjegjësit e gjallë të këtij gjenocidi? Do të ishte gjest jo vetëm i mirëpritur moral, por reflektimi i tyre do të besohej duke u larguar nga çdo hallkë dhe qelizë shtetërore që mund të jenë, do të bashkëpunonin për gjetjen edhe të eshtrave të shumë viktimave të pafajshme ku familjarët e gjenocidit komunist të kishin një varr për të ngushëlluar familjarët e tyre.

Në brezin e dytë të internuarve nga radhët e partisë, përveç refleksionit ndaj të persektuarve antikomunistë, bie në sy një element tjetër, ata nuk pranojnë të quhen armiq të popullit, *armik i partisë po*, do të shprehej Pajo Islami apo Dashnor Mamaqi. Në dosjen 12552/A të hetuesisë dhe gjykimit të Dashnor Mamaqit, 22 dhjetor 1975, lexojmë,

*“Unë kam pasur pikëpamje të kundërta me Partinë në drejtim të luftës së klasave. Nuk kam qenë dakord me Partinë se në socializëm, lufta e klasave nuk shuhet... Nisur nga kjo pikëpamje unë gjatë gjithë kohës kam mbajtur qëndrime të pajtimit e të afrimit me elementë të damkosur e armiq, duke i marr këta në mbrojtje nga goditjet që u bëheshin...”*

*“Pikëpamja ime ka qenë se në situatat e një qetësie relative në marrdhëniet ndërkombëtare duhet të zbutet lufta e klasave. Në vlerësimin e kuadrit kam vënë profesionin mbi politikën...”*

Çfarë do të ndodhte me të dhe familjen e tij? Do të burgosej dhe nuk do të dilte i gjallë nga burgu, familja e tij do të ndiqej dhe do të përndiqej edhe aty ku i sollën në Selenicë. Vajzave do t’iu shkatërrohej familja dhe nuk do të mund të jetonin pranë fëmijëve të tyre. Me gjithë

shkollimin dhe profesionalizmin e tyre të njohur do të bënin punë nga më të rëndomtë në bujqësi. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për familjet e tjera Jakova, Ngjela etj. Kadri Hoxha, shef i misionit ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Bari, do të dënohej, internohej në Selenicë për bashkëpunim me elementë antiparti dhe mbështetës i anglo-amerikanëve. Edhe aty do të ndiqej dhe denigrohej me vajzën e tij, apo trauma e vajzës së Tuk Jakovës.

***Dosja Pajo Islami, dosja e animizuar.***

Pajo Islami një nga figurat qendrore të partisë do të kishte fatin e shumë dhe shumë njerëzve të tjerë që u burgosën dhe u internuan. Në Konferencën e Tiranës ai do shprehej kundër kultit të individit dhe do të shprehte zhgënjimin e tij për udhëheqjen e partisë, privilegjet e familjarëve dhe indiferentizmin ndaj kushteve të vështira të punës dhe jetesës së punëtorëve. Do të dëbohej familja e tij në disa vende, Lubonjë, Selenicë etj. Duke shfletuar në dosjen e tij *Dosja e animizuar Pajo Islami*, një pasqyrë të funksionimit të strukturave të Sigurimit që të duken absurde dhe të pabesueshme. Me dhjetëra njerëz gjithë sy e veshë për të ndjekur një njeri. Kudo ku shkonte kishte një njeri mbrapa, operativi instruktonte njerëz të ndryshëm të rrethit edhe miqësor dhe shoqëror, shokë pune, shofer, që do ta ndiqnin.

*“Një do të thoshte e takova para disa kohësh tek Banka dhe më tha ,që përjashtimi yt nga Partia nuk është i drejtë./ një dëshmitar.*

*“Një tjetër do të informonte e takova tek hotel “Dajti” dhe më tha, si e kish kundërshtuar Adil Çarçanin”.*

Një tjetër do ta ndiqte edhe kur dilte me familjen deri tek kodra dhe do të informonte... Një makinë e tërë njerëzish mbas një njeriu, kjo është një dëshmi për funksionimin e gjithë të dëbuarve dhe njerëzve të lirë në thonjëza dhe jo të lirë. Lexon letrën e përletur të nënës së Pajos drejtuar Mehmet Shehut, që kërkon t’ia sjellin djalin pranë dhe zbulon fytyrën e regjimit.

Pafund dëshmi dhe njerëz që do ta provokonin dhe do t’i hiqeshin si miq. Ky ishte shteti që shkatërroi dhe burgosi një popull të tërë shpirtërisht dhe fizikisht partia. Letra anonime pafund që morën në qafë shumë njerëz.

Ky, ishte qyteti im, në kohën e diktaturës.

Shpresoj sadopak të kem kontribuar në atë që kemi ndjerë duke jetuar atje , dhe disa dëshmime që kemi mundur të shfletojmë. Për një gjë ju siguroj, që gjithçka është e vërtetë, por është vetëm minimumi i asaj që ka ndodhur. Duhet më shumë punë nga të gjithë ne për të njohur nga afër të shkuarën për t’i shërbyer të tashmes dhe të ardhmes së vendit tonë. Qëndrimin e mbajtëm në 90-tën, por përballja vazhdon. Ende sot sheh shumë nga përgjegjësit e këtij gjenocidi edhe në poste dhe detyra shtetërore dhe kjo është për të ardhur keq.

# Fiona Todhri, Eris Dhamo - Universiteti i Tiranës

## Identiteti dhe profili i grave të dënuara politike në periudhën komuniste (1946-1990)

### Abstrakt

*Sot, shoqëria jonë ndihet në borxh ndaj figurave historike të dënuara politikisht gjatë periudhës komuniste, për njohjen dhe përcjelljen brez pas brezi të vlerave shumëdimensionale të tyre përmes fakteve, dëshmive dhe përvojave të të gjitha grave e burrave që vuajtën dhe u privuan pa të drejtë jo vetëm nga liria, por dhe nga ëndrra e tyre për një vend më të mirë dhe të lirë. Me këtë fokus ky studim përshkruan në mënyrë të detajuar fakte rreth figurës dhe qëndresës së gruas intelektuale gjatë sistemit të mëparshëm komunist. Studimi i referohet periudhës historike 1946-1979, e cila përkon me përfundimin e L2B dhe fillimin e rendit të ri politik në vend. Kusht i përzgjedhjes së figurave të marra në studim janë gratë e dënuara politike.*

*Metodologjia e përdorur është ajo kërkimore historike. Studimi kaloi nëpërmjet një procesi sistematik të ekzaminimit të dokumentacionit, fakteve, procesverbaleve, fotove të së shkuarës për të kuptuar qëndrimet dhe sjelljen e grave, në referencë të hapave të ndryshëm të persekutimit historik. Për këtë studim janë përdorur të dhëna parësore të dokumenteve origjinalë të AIDSSH<sup>1</sup>; janë rreth 821 faqe format A4 me të dhëna nga disa institucione aktive të ish-sistemit komunist si ish-Gjykata e Lartë Ushtarake, ish-Sigurimi i Shtetit, Hetuesia.*

*Autenticiteti i dhënave është i garantuar nga Institucioni përgjegjës dhe burimet e informacionit të të dhënave parësore janë rikonfirmuar rast pas rasti nga burime të tjera zyrtare të kohës.*

*Referuar analizës së proces-verbaleve gjyqësore që janë mbajtur për këto gra të dënuara politike, letërkëmbimeve, mbrojtjes, deponimeve, si dhe akuzave të bëra gjatë gjykimit ose/dhe mungesës së gjykimit, dorëshkrimeve, punimeve dhe mbrojtjes së disertacioneve, rezulton shprehja e forcës së mendimit, qëndresës, idealeve dhe temperamente të hekurta, pavarësisht vuajtjeve apo përdhosjes së dinjitetit që i bëhej nga pushteti i asaj periudhe. Analizimi dhe interpretimi na prezanton dhe disa karakteristika, përshkrimi i të cilave qoftë me fjalë me kuptim të drejtpërdrejt apo të figurshëm (me anë të epiteteve, metaforave etj.), nuk do të mjaftonte për të ndërtuar një kuadër të plotë të figurës së tyre, duke u ndalur sidomos në vlerësimin e vetëdijes intelektuale, integritetin, si dhe frymën idealiste që i karakterizonte.*

*Rezultoni se gratë e marra në studim hodhën themelet e para dhe tentuan krijimin e një shoqërie demokratike dhe të lirë.*

### Hyrje

Ngjarjet fillojnë dhe zhvillohen në një vend që sapo ka dalë i shkatërruar pas luftës së '44-ës dhe rrymës së re, si edhe formës së pushtetit që kërkon të uzurpojë vendin dhe gjithë shoqërinë e atyre viteve. Sa shume ngjarje, përjetime, emocione gjejmë tek këto figura historike shqiptare që hodhën themelet e para dhe tentuan krijimin e një shoqërie demokratike dhe të lirë. Nuk është e lehtë për një studiues të analizojë dhe të interpretojë faktet dhe dorëshkrimet në kohë dhe sisteme politike krejtësisht të ndryshme.

Ky punim është një përpjekje për të zbardhur disa fakte, dëshmi dhe, mbi të gjitha, përjetime të ndryshme, por që kanë të përbashkëta midis tyre. U lexuan dhe u përdorën për analizë rreth 821 faqe dokumentesh të cilat administrohen nga AIDSSH. Punimi nuk paraqet mendimin e asnjë institucioni, partie politike, organizate. Të gjitha interpretimet janë të autoreve.

---

<sup>1</sup> Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit



Nëse do t'i referohemi procesverbaleve gjyqësore që janë mbajtur për këto gra të dënuara politike, letërkëmbimeve, mbrojtjes, deponimeve, si dhe akuzave të bëra gjatë gjykimit ose/dhe mungesës së gjykimit, dorëshkrimeve, punimeve dhe mbrojtjes së disertacioneve, në rreshtat e tyre gjejmë forcë mendimi kritik, ideale, personalitete të hekurta, të forta, pavarësisht vuajtjeve apo përdhosjes së dinjitetit që i bëhej nga pushteti i asaj periudhe. Gjatë shfletimit të dosjeve, të bien në sy kryesisht disa karakteristika, përshkrimi i të cilave qoftë me fjalë me kuptim të drejtpërdrejt apo të figurshëm (me anë të epiteteve, metaforave etj.), nuk do të mjaftonte për të ndërtuar një kuadër të plotë të figurës së tyre, duke u ndalur sidomos në vlerësimin e vetëdijes intelektuale, integritetin, si dhe frymën idealiste që i karakterizonte.

Nëpër rreshtat që janë shfletuar e lexuar, vërehet ndjenja e shpresës, optimizmi, spikat vetëbesimi, portretizimi i grave që nuk u dorëzuan kurrë, edhe kur u torturuan, edhe kur u dëbuan në skutat më të errëta të vendit të tyre.

### ***Metodologjia***

Metodologjia e përdorur është ajo kërkimore historike. Historianët përdorin fakte të mbledhura nga burimet kryesore të provave dhe më pas i formojnë në atë mënyrë që audiencia e tyre të mund t'i kuptojë dhe t'i japë kuptim. Ky proces, ku historiani mund t'i japë kuptim të së kaluarës, quhet interpretim<sup>2</sup>.

Dokumentet, janë dëshmitë më reale për të kaluarën, ato janë vërtetësi për një ngjarje të kaluar, pasi në to zakonisht, janë të shkruara mendimet politike, ushtarake administrative, por dhe private e biznesore të kohëve të ndryshme. Me rritjen e rëndësisë të dokumenteve u rrit dhe rëndësia për t'i ruajtur ato në një vend të caktuar, kështu lindën arkivat e para. Në përgjithësi, arkivat përbëhen nga të dhënat që janë përzgjedhur për ruajtje të përhershme ose afatgjatë në bazë të vlerës së tyre të qëndrueshme kulturore, historike ose dëshmuese.

Në marrëdhënien tonë me historinë dhe të kaluarën, shpesh shprehet dëshira për të gjetur të vërtetën për një ngjarje të caktuar. Prandaj, historianët, përpiqen të rikrijnë një ngjarje, sikur të ishte hetues i skenës së kriminit. Ata mbledhim provat dhe përmes përdorimit të metodologjisë historike dhe teoritë arrijnë konkluzione në bazë të asaj që dëshmitë tregojnë. Pothuajse në mënyrë të paracaktuar, provat janë të pakta, kontradiktore dhe të dëmtuara<sup>3</sup>.

Studimi kaloi nëpërmjet një procesi sistematik të ekzaminimit të dokumentacionit, fakteve, procesverbaleve, fotove të së shkuarës për të kuptuar qëndrimet dhe sjelljen e grave,

---

<sup>2</sup> <http://facingthepastshapingthefuture.com/teacher-guidance/teaching-learning-strategies/history/teaching-interpretations-at-ks1/>

<sup>3</sup> <https://ehkern.com/2013/06/20/historical-truth-vs-historical-validity/>

në referencë të hapave të ndryshëm të persekutimit historik. Për këtë studim janë përdorur të dhëna parësore të dokumenteve origjinale të AIDSSH; janë rreth 821 faqe format A4 me të dhëna nga disa institucione aktive të sistemit komunist si ish-Gjykata e Lartë Ushtarake, ish-Sigurimi i Shtetit, Hetuesia.

### ***Formimi intelektual***

Jeta dhe aktiviteti i Musine Kokalarit i referohet kryesisht përvojës së saj akademike, pasionit të saj për letërsinë, që përbën fushën e studimeve të saj universitare. Pasioni për të shkruar dhe afërsia e saj me librat, e bëjnë një figurë të formuar intelektuale. Musineja kishte dhe një librari të cilën e administronte dhe kalonte kohën më të madhe, ku edhe ushtronte veprimtarinë dhe angazhimet e saj politike. Referuar raportimeve dhe proces-verbaleve të mbajtura gjatë gjykimit të saj, pohohen vazhdimisht takimet e saj me grupet e interesit, si aktiviste dhe mjaft e përfshirë në jetën politike të vendit si gjatë luftës, dhe pas saj. Përveç pasionit të saj për të shkruar, ku mund të përmendim disa libra, si: “*Seç më thotë nëna plakë*”, “*Rreth vatrës*”, ajo drejtonte dhe shkruante për gazetën “*Zëri i Lirisë*”, të cilën e konsideronte si një mekanizëm mjaft të rëndësishëm për të shpërndarë në mbarë vendin dhe jashtë tij bindjet dhe frymën politike jo vetëm të saj, por edhe të disa grupeve të tjera në vend.

*Musine Kokalari: - Gazeta “Zëri i Lirisë, gjatë okupacionit botohej prej Partisë Social-Demokrate që ishte në bashkëpunim me Ballin Kombëtar, por si grup i veçantë<sup>4</sup>.*

*... Përgjegjëse e Gazetës “Zëri i Lirisë” kam qenë unë, edhe kam shkruar.*

*Nuk di nëse gazeta ishte legale apo ilegale, por unë e drejtoja dhe shpërndahesh prej disa të rinjve.....<sup>5</sup>*

Musineja kreu studimet për letërsi në Romë dhe pasionin për të shkruar nuk e ndali asnjëherë. Duke iu referuar dosjes dhe procesverbaleve të mbajtura gjatë gjykimit të saj, vërejmë se ajo kujdesej për paraqitjen dhe përpilimin e mjaft dokumenteve politike, që nga hartimi i Statutit të Partisë Socialdemokrate, deri tek Programi i Koalicionit Demokratik.

*S.C:- Për paraqitjen e programit bëmë nga një koncept 3-4 veta dhe më në fund u pëlqye i Musines.<sup>6</sup>*

---

<sup>4</sup> Republika Popullore e Shqipërisë; Gjykata e Lartë Ushtarake; Nr.11. Rregj. Themel.V.F.L.P N.64 I Vendimit, Date 27/2/1951 Proces Verbal.

<sup>5</sup> Republika Popullore e Shqipërisë; Gjykata e Lartë Ushtarake; Nr.11. Rregj. Themel. V.F.L.P N. 64 I Vendimit, Date 27/2/1951 Proces Verbal.

<sup>6</sup> Republika Popullore e Shqipërisë; Gjykata e Lartë Ushtarake; Nr.11. Rregj. Themel. V.F.L.P N. 64 I Vendimit, Date 27/2/1951 Proces Verbal.

### ***Aktiviteti politik***

*Ngjarjet zhvillohen gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe pas saj (1939-1946)*

Aktiviteti i saj politik duket shumë i ngjeshur dhe me shumë kontakte pothuajse në të gjithë Shqipërinë. Raportohet një bashkëpunim edhe me grupime të tjera që pothuajse kishin të njëjtat ambicie për zhvillimin e vendit, dhe përfaqësimin e tyre në nivele të larta vendimmarrëse, si: Balli Kombëtar, Monarkistët, Grupi i Rezistencës, ku ky i fundit u pagëzua nga vetë M. Kokalari.

Para zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945, Musineja së bashku me aleatët kërkonte të vendoste kandidaturën për zgjedhjet parlamentare. Ky grupim politik, i ashtuquajtur Koalicioni Demokratik, u angazhua për nënshkrimin e 75 firmave, duke ia parashtruar Misionit Britanik dhe atij Amerikan. Sipas raportimeve të bëra nga vetë M. Kokalari, del se kjo lëvizje dështoi për shkak të pamundësisë së mbledhjes së firmave dhe të vonësive në kohë, të konstatuara nga Misioni Anglo-Amerikan.

Vërehet një këmbëngulje dhe rezistencë e M. Kokalarit për ta përçuar më tej shqetësimin e saj mbi zhvillimet politike në Shqipëri. Ajo kërkonte takime të vazhdueshme me gazetarët anglezë, për t'u shprehur rreth situatës që po krijohesh dhe frikës prej kësaj situatë të nderë që i referohej vendosjes së regjimit komunist në vend.

Ajo që të bie në sy nga procesverbalet dhe deklaratat e të pandehurve, lexohet qartazi në lidhje me përfshirjen dhe angazhimin maksimal të Musinesë në të gjithë veprimtarinë e grupimeve politike. Ajo, jo vetëm që ishte e pranishme në pjesën më të madhe të takimeve, por edhe i drejtonte ato. Dokumentet që prodhoheshin në kuadër të lëvizjes (trakte, nota verbale, programe etj.), nuk mund të merrnin formën e prerë pa miratimin e Musinesë. Një rol të rëndësishëm në këto vendimmarrje luajti edhe formimi akademik universitar i saj në lëmë të letërsisë.

*“Mbas këtij diskutimi Musineja na bëri një ekspozitë mbi Partinë Socialdemokrate e mbas saj u vendos për t'u mbledhur”.*<sup>7</sup>

*“Mbledhjen e hapi Musineja, duke folur për notën që do t'u dërgohej Anglo-Amerikanëve”* (fl.4)<sup>8</sup>.

Në lëvizjen e saj fokus të veçantë kishin të rinjtë dhe gratë, të cilët i angazhonte duke marrë pjesë në mbledhje, në zgjerimin e partisë dhe rritjen e përfaqësisë në popull.

---

<sup>7</sup> Republika Popullore e Shqipërisë; Gjykata e Lartë Ushtarake; Nr.11. Rregj. Themel.V.F.L.P N.64 I Vendimit, Date 27/2/1951 Proces Verbal.

<sup>8</sup> Republika Popullore e Shqipërisë; Gjykata e Lartë Ushtarake; Nr.11. Rregj. Themel.V.F.L.P N.64 I Vendimit, Date 27/2/1951 Proces Verbal.

Musineja krijoi Partinë Socialdemokrate me qëllimin e rritjes së frymës opozitare në vend dhe përfaqësimin e saj në parlament. Programi i partisë përmbante disa pika: 1) Sigurimin e një Shqipërie Indipendente në kufijtë e saj etnike (të pavarur); 2) Reforma Sociale duke u ruajt gjithnjë traditat e mira dhe zakonet kombëtare; 3) Reforma me karakter ekonomik; 4) Mbajtja e një Xhandarmërie për ruajtjen e rendit publik; 5) Shpallja e neutralitetit të Shqipërisë të garantuar nga Fuqitë e Mëdha Ndërkombëtare; 6) Administrimin e Shqipërisë me një sistem demokratik perëndimor; 7) Shpallja e lirisë së besimit, të fjalës, të shtypit e të tjera; 8) Sigurohet barazia e të drejtave të qytetarëve.

Musineja ishte përgjegjëse e gazetës “Zëri i Lirisë”, ku dhe ka botuar mjaft artikuj, ndër të cilat: *Çështja e Kosovës në bazë të Kartës së Atlantikut, mbi demokratizimi i vendit*. Gazeta botohej në shtypshkronjën Gutenberg.

*Musineja ishte prekur për çështjen e Kosovës*

*“Më ka dhënë një trakt Musine Kokalari që thoshte: “Poshtë Komunizmi” shqiptarë për Shqipërinë Demokratike”<sup>9</sup>.*

Atdhedashuria për vendin dhe vëmendja e saj e vazhdueshme mbi çështjet etnike, liria e fjalës së shtypit, drejtësia sociale, ishin fjalët kyçe të gjithë aktivitetit të saj politik. Si demokracia e vendit, por dhe Kosova, perceptohen si lufta e saj me aleatët brenda dhe jashtë vendit.

### ***Mbrojtja në gjyq***

Musineja, ndryshe nga të pandehurit e tjerë, nuk pranoi të mbrohej nga një avokat i caktuar nga gjykata ushtarake. Në shfletimin e dosjeve gjejmë vetëmbrojtjen e saj, në një dorëshkrim origjinal të saj, fjalën e saj kundër akuzave të ngritura nga pushteti i asaj kohe. Gjatë vetëmbrojtjes dalin në pah mjaft cilësi të personalitetit të M. Kokalarit. Në fjalimin e saj nuk është e domosdoshme të përpiqesh për të lexuar apo nënkuptuar midis rreshtave, sepse ajo është mjaft e drejtpërdrejtë, e artikulon kthjellët e qartë mendimin dhe qëndrimin e saj dhe të grupit mbështetës. Fjala e saj nuk dridhet dhe mendimi ka logjikë/arsyetim konsekuent. Nuk trembet për asnjë çast. Nuk mund të themi që e ka parashikuar fundin e saj, por, deri në çastin e gjykimit, ajo mbeti e palëkundur nga ideali dhe aspirata e saj.

Formimi i saj universitar, njohja e kontekstit shoqëror që po jetonte, pjesëmarrja në luftë dhe gjithë veprimtaria e saj politike, i krijonte një vetëdije intelektuale të konsoliduar dhe i jepte forcë për të vazhduar luftën e saj me pushtetin e asaj kohe.

---

<sup>9</sup> Republika Popullore e Shqipërisë; Gjykata e Lartë Ushtarake; Nr.11. Rregj. Themel.V.F.L.P N.64 I Vendimit, Date 27/2/1951 Proce Verbal, fl. 140

*“Duke parë zhvillimin e procesit, e shoh të arsyeshme të them vetë se i gjithë aktiviteti i atij grupi të vogël Social Demokrat nuk është gjë tjetër veçse një notë e drejtuar aleatëve të Perëndimit për shtymjen e votave kur qeveria u njoh me të drejt opozitë. Një hap i tillë nuk do të thotë përmbysje e pushtetit të sotëm me violencë se ne, 37 të pandehurit, në bankën e të akuzuarve nuk jemi pjesëtarët e një organizate por anëtarët e katër korentëve të ndryshme, tre jashtë fronit dhe i katërti i dalë nga gjiri i tij dhe i shkëputur qandej. Katër korente me koncepte politike –shoqërore të ndryshme dhe vet-vetiu me veprimtari të përshtatur që pas frymës që përmban, duke qenë sejcili përgjegjës për veten ...”<sup>10</sup>*

Pavarësisht fuqisë së mendimit dhe fjalës së përdorur në gjyq për të argumentuar qëndrimin e saj ideologjik, por dhe veprimtarinë e saj gjatë Luftës dhe pas Luftës Nacionalçlirimtare, nuk arriti dot të ndikojë apo ndryshojë “vendimin e paracaktuar” të gjykatës ushtarake të asaj periudhe. Në analizën narrative të dosjes së saj vërejmë qëllimet dhe aspiratën e saj për një shoqëri pluraliste dhe, mbi të gjitha, ngritja e një zëri opozitar ku do ta ndryshonte sadopak ose do të sillte frymë perëndimore në Shqipëri. Pikërisht një nismë e tillë do të fillonte me përfaqësimin e tyre në parlament e më gjerë.

Gjatë gjithë hulumtimit dhe dëshmime shohim M. Kokalarin aktive në të katërta rrymat që ajo citon më lart, e në të njëjtën kohë ajo ishte themeluese e Partisë Socialdemokrate. Musineja drejtonte e takohej me gratë dhe të rinjtë e Ballit Kombëtar dhe njëkohësisht kishte ngritur Koalicionin dhe Grupin e Rezistencës, të cilët përgatiteshin për mbledhjen e firmave dhe përfaqësimin e tyre në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945.

*“Duke parë rindërtimin e vendit i dalë nga lufta me dëme të mëdha, me plagë të shumta materiale dhe morale, në pragun e zbatimit të reformave shoqërore ku cenohen interesat e një klase të privilegjuar der dje, d.m.th, në përmbysjen e një bote feudale drejt ngrehjes të një koncepti demokratik ku baza e jetës është puna dhe e gjen një pjesë të popullit shqiptare jashtë Frontit...”<sup>11</sup>*

Ajo nuk ndalej nga vizioni i saj për ardhmërinë e shoqërisë, pasi vetë Musineja vinte nga një familje me të ardhura ekonomike dhe me një pozitë të caktuar shoqërore. Ajo po ndjente persekutimin e shtresës së përkëmbur shqiptare, kryesisht ajo intelektuale dhe tregtare. Ndër të pandehurit gjendeshin dhe tregtarë të cilët akuzoheshin se nuk paguanin taksat e vendosura nga pushteti i asaj kohe, dhe veprimi i tyre kishte dëmtuar vendin dhe popullin. Disa grupime kishin vënë re luftën që po i bëhej dhe kishin filluar rezistencën e tyre ndaj reformave që po ndërmerreshin në atë periudhë nga pushteti i asaj kohe.

<sup>10</sup> AIDSSH, F. AMPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. *Mbrojtja*.

<sup>11</sup> *Po aty*.

Formimi i saj në letërsi e lejonte të pandehurën të përdorte një gjuhë të figurshme (të konotuar) gjatë fjalimit të saj për vetëmbrojtje. Ajo përdorte figura të tilla letrare, si epitete, metafora etj. (*ftohtësi shpirtrash*), përmes të cilave duket se synonte të sillte në vëmendje gjendjen e saj të rënduar shpirtërore dhe frikën e intelektuales largpamëse, e jo faktin e paraburgimit dhe gjyqin që po i bëhej, por pamundësinë e saj për të realizuar ëndrrën e një Shqipërie pluraliste dhe demokratike.

“Elementët jashtë frontit që një çast kërkon të shkëputet si pjesë e vogël si ç’është nga gjithë sa e rrethon, duke gjetur një urë kalimi me anë të një korenti demokratik, për të hyrë në gjirin e një familje demokratike, për të ndjekur një vijë të vazhdueshme politike, drejt një uniteti moral të një pakice me shumicën, për ekuilibrimin e ideve dhe divergjencave që në të vërtetë nuk kanë kundërshtime, për sa iu përket reformave shoqërore drejt të cilave po shkojmë përpara, por sa me tepër *ftohtësi shpirtrash*, konsequencë e së kaluarës, d.m.th. *Drejt harmonizimit të një bote mendore rreth një ideali të përbashkët.*”<sup>12</sup>

Në paragrafin e mëposhtëm na paraqitet një panoramë e plotë dhe perceptim i qartë i gjendjes tranzitore pas lufte që po kalonte vendi. Duket sikur ajo kishte parashikuar interesat e një/dy personave për të uzurpuar shtetin dhe gjithë instancat e tij. Ajo hodhi akuza të forta për shumë krime që u bënë në frontin e Luftës Nacionalçlirimtare në emër të pushtetit dhe të qëllimeve të tij.

“Nga çlirimi i Shqipërisë dhe gjer në njohjen e qeverisë kaloi një mot kohe. Oshilacione mendimesh, konfuzion idesh dhe një propagande e fortë nga jashtë. Lëkundje mendore duke folur gjithmonë për elementë jashtë frontit ku mbretëronte një gjendje kaotike. Një mozaik idesh, personash dhe interesash”. Politike personale, feudale, kriminele lufte, kuislinge me një të kaluar të mirë politike nëpër male, tregtarë të taksuar, nënpunës të përjashtuar, idealistë, të cilët të gjithë pa përjashtim trumpetojnë idealizma, nacionalizma...”<sup>13</sup>

Paralelizmi që i bënte grupeve të ndryshme shoqërore, rrymave dhe qëndrimeve të asaj kohe, duket sikur kërkonte t’i çirrite maskën disa kategorive të caktuara, që në vetvete nuk kishin në fokus vendin dhe interesat e tij, por interesat e tyre personale, dhe në emër të pushtetit donin të arrinin qëllimet e tyre.

Gjithashtu, në paragrafin e dytë, kërkonte të qartësonte ambiciet e grupeve të tjera politike, që në sytë dhe në bindjen e saj ishin më atdhedashës dhe kishin një perspektivë më ambicioze për vendin e tyre, pjesë e së cilës ishte dhe ajo vetë.

---

<sup>12</sup> Po aty.

<sup>13</sup> Po aty.

“Elementë, 80% të interesuar për interesa private që bëhen heronj, nacionaliste dhe që mbajnë shternguar 20 % të elementit idealist, i cili lëkundet mbasi s’ka një vijë të qartë politike dhe që vihet në lëvizje nga rrethanat e kohës duke u bërë mburojë e atyre që kërkojnë të lozin prapa skenës, nga brenda dhe jashtë”.

“Propaganda e shëndoshë e trumpetuar për rezistencë që i ve të rinjtë në lëvizje, të cilët duke mos patur një kriter të shëndoshë ideologjik, të ushqyerjes vetëm me fjale nacionalizmi. Të thotë, të cilët duke mos kuptuar se lufta që i bëhet Ballit ose Legalitetit është luftë kundër një vije politike kompromisi ose koncepti shoqëror feudal ....”<sup>14</sup>

Musineja ishte një grua e guximshme që mbrojti deri në fund idealin e saj. Nuk u frikësua për asnjë çast nga sistemi i asokohe dhe gjyqi publik që iu bë. Ky fakt bie në sy dhe gjatë marrjes së dënimit. Ajo besoi dhe kërkoi deri në fund të drejtën e saj. Mbase nuk e kishte parashikuar fundin, por ajo ende shpresonte për një shoqëri demokratike dhe të lirë. Aleancat e saj me grupimet e tjera politike synonin t’u kujtonin dhe një herë arsyet se përse kishin luftuar gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

“I drejtohem trupit gjykues, me respekt që ta shqyrtojë edhe një herë përsa i përket aktivitetit tim dhe, në rast se rezulton e kundërta përsa i përket qëllimeve të sipër treguara, pranoj me kënaqësi edhe dënimin më të rëndë”<sup>15</sup>.

### ***Karakteristikat e personalitetit***

Musineja ishte vetëm 28 vjeç. Ajo nuk u ndal asnjëherë në përmbushjen e aspiratave të saj për liri dhe demokraci. Dy fusha spikatën në jetën e saj: *Politika* dhe *Letërsia*.

Veprimtaria e jetës së saj u përqendrua në fuqizimin e grupeve opozitare për të përçarur fjalën e lirë, por edhe në krijimin e veprave letrare, të cilat nuk i ndau për asnjë çast edhe kur vuante dënimin.

Transparenca e mendimit dhe veprimeve janë elementë që vihen re në procesverbalet e mbajtura gjatë ditëve të gjykimit të saj.

*E pandehura Musine Kokalari: \_ Grupi jonë e firmosi notën, nënshkruam unë, ...*<sup>16</sup>

*E pandehura Musine Kokalari - Grupin e Rezistencës e kam pagëzuar unë, kur mora vesh se kishte lidhje me ato të maleve.* (fl. 49)

---

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> Procesverbal nr. 5 i Librit Themelor të Gjykatës së Naltë Ushtarake të Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë.

Musineja u paraqit në të gjitha seancat e gjykimit mjaft e ftohtë dhe nuk u tërhoq për asnjë çast nga idealet e saj. Ajo, gjatë gjithë seancave, mbajti të njëjtin qëndrim, e qëndrueshme dhe këmbëngulëse në bindjet e saj përballë pushtetit, duke mos iu trembur kurrë gjykimit përfundimtar.

*“Merret në pyetje e pandehura Musine Kokalari e cila pas këndimit të akuzës tha: Akuzat që më bëhen nuk i pranoj!”*

*Musine Kokalari:- Kërkoj drejtësi, veprimtarinë t’ime e shpjegova në mbrojtje.<sup>17</sup>*

M. Kokalari karakterizohej nga një besim i fortë në vetvete, e kjo mbase buronte edhe nga fuqia dhe aftësia e saj për të mbledhur rreth vetes shumë aktivistë të tjerë në luftën e tyre të përbashkët kundër pushtetit asokohe.

Mund të themi se Musineja ishte e vetmja grua në krye të lëvizjes, si edhe e vetmja grua që drejtoi një parti politike në atë kohë. Përveç se ndiqte me kujdes takimet me aleatët dhe shkruante vazhdimisht në gazetë, ajo gjithashtu përhapte parime shoqërore, ideologjike e politike novatore për atë kohë dhe përballë atij pushteti, dhe punonte kryesisht me gratë e grupimeve të tjera dhe të rinjtë.

*Musine Kokalari dhe Gj. K, refuzuan avokatët mbrojtësa, tue marrë përsipër ata vetë mbrojtjen e tyre. (fl.175)<sup>18</sup>.*

Nga procesverbalet e mbajtura gjatë gjykimit, theksohet vendosja në dispozicion e avokatëve mbrojtës për të pandehurit. Siç citohet dhe më lart, Musineja e refuzoi atë, duke kërkuar të vetëmbrohet. Kapaciteti i saj, njohja dhe vetëdija e saj intelektuale e vendosën në një nivel të lartë përfaqësimi, sidomos në ditët e gjykimit të saj.

### **Gjykimi**

*Ngjarjet zhvillohen në vitet 1939-1946.*

*“Sot, më 17 Qershor 1946, pranë kinema “Nasional” Tiranë, mbledhet trupi gjykues dhe nis gjykimin për 37 të pandehur, me akuzën: Të organizuar në grupe klandestine për të përmbysur pushtetin demokratik në lidhje me kriminelët e luftës në arrati dhe me reaksionin e jashtëm; kanë kryer dhe kanë tentuar të kryejnë vrasje kundra njerëzimit dhe funksionarëve të pushtetit popullor si dhe akte të tjera sabotazhi; u kanë dhënë informata ushtarake, politike dhe ekonomike të huajve , etj, etj., duke vepruar kështu kundra interesave të larta të atdheut e të popullit.”<sup>19</sup>*

<sup>17</sup> Procesverbal nr. 5 i Librit Themelor të Gjykatës së Naltë Ushtarake të Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë.

<sup>18</sup> Procesverbal nr. 5 i Librit Themelor të Gjykatës së Naltë Ushtarake të Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë.

<sup>19</sup> Vendim; “N’ emer te popullit shqiptar”, Gjykata e Naltë Ushtarake,, ... fl. 177.



*Të akuzuarve ju janë vënë në dispozicion avokat për tu mbrojtur mbi akuzën e ngritur. “Dhe filloi vazhdimi i gjykimit botërisht e me dyer të çelura. U sollën nga burgu rregullisht të shoqëruar të 37 të pandehurit, te cilët duke qenë të lirë u vunë në vendet e posaçëm”<sup>20</sup>*

Ndër 37 të pandehurit radhitet dhe një vajzë 28 vjeçare, Musine Kokalari, e bija e Reshatit dhe Hanushes, e lindur në Adana të Turqisë, banuese në Tiranë. Ka një librari, që shpeshherë gjatë procesverbaleve përshkruhet dhe me termin *librare*. U arrestua më 23/01/1946 me akuzën e lartpërmendur.

Në vijimësi të dosjes, gjatë bisedave të mbajtura me procesverbal, të pandehurit akuzohen të jenë pjesë e disa grupimeve politike.

*Vendim*

*“N’ Emër të Popullit Shqiptarë”*

*Gjykata e Naltë Ushtarake*

*...mbasi dëgjoji në seanca publike gjithë çështjen prej datës 17 Qershor deri më 30 Qershor 1946, sot më datë 2 korrik 1946, e mbledhur në sallën e Kinemas ‘Nasional’ në Tiranë, duke gjykuar të pandehurit: <sup>21</sup>*

*13) Musine Kokalari, e bija e Reshatit dhe Hanushes, e lindur në Adana të Turqisë, banuese në Tiranë. Librare, me arsim të lartë (universitet letërsije në Romë), e pamartuar e padënuar e arrestuar më 23.I.1946-*

*T’akuzuar: ...*

*Gjykata*

*Vendosi*

*Fajtorine e të pandehurve, cilësimin e tyre si armiq të popullit dhe sabotatorë të pushtetit dhe ndërshkimin e tyre si vijon ...*

*Musine Kokalari dënohet me 20 vjet heqje lirie, punë e detyrueshme, humbjen e të drejtat civile e politike për aqë-kohë, konfiskimin e pasurisë së tyre të luajtshme dhe të paluajtshme në bazë të dispozitave ligjore në fuqi <sup>22</sup>.*

### ***Përfundime***

Analizimi dhe interpretimi na prezanton dhe disa karakteristika, përshkrimi i të cilave qoftë me fjalë me kuptim të drejtpërdrejt apo të figurshëm (me anë të epiteteve, metaforave etj.), nuk do të mjaftonte për të ndërtuar një kuadër të plotë të figurës së Musine Kokalarit, duke

<sup>20</sup> *Vendim; “N’ emer te popullit shqiptar”, Gjykata e Naltë Ushtarake,, ... fl. 177.*

<sup>21</sup> *Vendim; “N’ emer te popullit shqiptar”, Gjykata e Naltë Ushtarake,, ... . fl. 177.*

<sup>22</sup> *Vendim; “N’ emer te popullit shqiptar”, Gjykata e Naltë Ushtarake, ... . fl. 177.*

u ndalur sidomos në vlerësimin e vetëdijes intelektuale, integritetin, si dhe frymën idealiste që i karakterizonte. Rezulton se gratë e marra në studim hodhën themelet e para dhe tentuan krijimin e një shoqërie demokratike dhe të lirë.

**Mnemozina e topikëve të trishtë letrarë**

**Abstrakt**

Punimi rimerr çështjen e inxhinierëve të kënetës së Maliqit, të trajtuar artistikisht në dy romane: “Kënetë” i F. Gjatës, shkruar gjatë regjimit diktatorial sipas skemave të luftës së klasës që falsifikoi të vërtetën historike (Romani, është botuar mbi tetë herë me tirazh llahtarisht të madh, i përfshirë në të gjitha tekstet shkollorë-universitare, i botuar në kolanën “seria e romanit të zgjedhur”, i detyrueshëm për lexim në shkollat tetëvjeçare, të mesme dhe universitare, i përfshirë në të gjitha antologjitë shkollorë) dhe “Kënetë e vdekjes” e Makensen Bungos, shkruar pas 1990. Shkrimtari Makensen Bungo që punoi atje si i dënuar, përshkruan llahtarin, ujërat e turbullta të kënetës, që ikin duke marrë me vete kufoma dhe skelete njerëzish. Përballë kësaj të vërtete tragjike, romani “Kënetë” është vetëm kënetë e Partisë.

***Në burimet e Hipokrenës***

Kujtesa si organ psikologjik i përjetimit të kohës mbetet e vetmja ndërmjetëse që na garanton unitetin e thelbit të qenies, të projektuar në një shkallë vetënjohjeje individuale dhe kolektive. E them në një shkallë vetënjohjeje, sepse kujtesa, siç e thamë, është organ psikologjik dhe se vetë psikologjia njerëzore, individuale qoftë ajo apo shoqërore, gjendet në kushtet e një trysnie të përhershme që e relativizon, e deformon, e transformon apo e çorodit krejtësisht psikikën njerëzore, po të merren parasysh dramat individuale dhe kolektive. Psikologjia është e varur nga psikika, pasi kjo e dyta është tregues i shëndetit të së parës. Rrjedhimisht edhe kujtesa, duke qenë organ psikologjik i përjetimit të kohës dhe shprehje vetidentifikuese e totalitetit organik të qenies në kohë, relativizohet, shformohet, manipulohet dhe na prezanton marrtas, në pajtim me thelbin e deformuar të vetes sonë.

*Kujtesa e manipuluar* është një togfjalësh që shpreh reflektimin kritik, të ndërgjegjshëm e oponencial nga pikëpamja e dikujt që zotëron një përvojë krahasimore në lidhje me origjinën e njohjes dhe gjendjeve stadiale të trajtores së kujtesës, prej nga zë fill tjetërsimi dhe manipulimi i saj. Ky proces nuk ka gjë të përbashkët me idiomën e përvojave individuale “*më tradhëton kujtesa*”, pasi si akt ndërgjegjësimit, kjo shpreh riaftësimin dhe ripërftimin e po asaj kujtese vetidentifikuese, për t’u pozicionuar mandej, në masën e vetëdijësimit, për një përballje raportesh me të.

Fjala, më konkretisht, është për kujtesën historike apo kolektive, që deri më tash ekziston kryesisht në po ato forma që e mendonin grekët e lashtë, në trajtën e *mneme-së*, *anamnez-isit* dhe *mnemozinës*. *Mneme* paraqet një aftësi të dhënë fiziologjike të çdo organizmi për ta ruajtur informacionin e ndërallur në të. “Nga perceptimet ndjesore lind, siç themi ne, aftësia e kujtesës”, thotë Arsitoteli. Ndërsa nga ndërmendjet e shpeshta për të njëjtën gjë lind përvoja,

sepse një numër i madh kujtimesh përbëjnë së bashku njëfarë përvoja. Nga përvoja pra, nga tërësia e përvojës që ruhet në shpirt, nga përvoja e vetme, e ndryshme prej shumicës, nga përvoja vetjake që paraqitet si identike në gjithë këtë shumësi, e ka zanafillën arti dhe shkenca: arti, nëse kemi të bëjmë me krijimin e diçkaje, dhe shkenca, nëse kemi të bëjmë me thelbin dhe esencën"<sup>1</sup>.

*Anamnezisi* – është ndërmendja (të kujtuarit). Ajo e ruan informacionin e futur në të, por e ruan në atë mënyrë, që informacioni gjithmonë përplotësohet dhe pasurohet me përvojën individuale, duke u realizuar jo rrallë në letërsi në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale – nga rikrijimi artistik i ngjarjeve të kaluara deri tek historiografia, që del jashtë sinoreve të *mnemesë* (si tek Herodoti, Taciti apo Mishlje). Në kulturën europiane, *anamnezisi*-i ka hyrë kryesisht në atë kuptim të saj, siç e pati themeluar dhe përdorur Platoni: “Kur shpirti që ka humbur kujtesën mbi ndjesitë apo dijet, e thërret sërish atë dhe përpiqet ta përtërijë në vetvete, atëherë këtë ne e quajmë ndërmendje”<sup>2</sup>. Kurse në një vend tjetër, Platoni thotë: “Prit pak, o Sokrat, - e ndërpreu Kebeti, - mendimet e tua na shpien edhe në një përfundim tjetër, nëse është e saktë ajo që ti e përsërit shpesh, se pikërisht dija nuk është gjë tjetër përpos se ndërmendje: atëherë, atë që ne po ndërmendim tani, duhet ta kemi nxënë në të kaluarën, - ja pra se çfarë nxjerrim nga ky konkluzion. Por kjo do të kishte qenë e pamundur po qe se shpirti ynë nuk do të kishte ekzistuar në ndofarë vendi tjetër, përpara se të lindej në trajtën tonë njerëzore”<sup>3</sup>.

Në një formë të ndryshuar, përfytyrimi mbi *anamnezisin* si një fundament i aspektit frymor ka hyrë në kristianizëm: “Pastaj mori bukën, u falenderua, e theu dhe ua dha e tha: Ky është korpi im, që flijohet për ju. Bëni këtë në përkujtimin tim”<sup>4</sup> (Luka 22. 19). Përjetimi platonian i *anamnezisit*, që mbijetoi deri në shekullin XX, përbënte bazën e simbolizmit edhe si filozofi, edhe si drejtim letrar, në botën e krishterë. Një ndër poetët dhe teoricienët e simbolizmit rus, Aleksandër Bllok, shprehej se: “Rruga e simboleve është rruga nëpër gjurmët e harruara... rruga e mbërritjes së dijes si ndërmendje (Platoni)”<sup>5</sup>.

*Mnemozina*. Mbi këtë nocion qendror të imazhit për analizën tonë na takon të flasim pak më gjerë. Në rendin e numërimit paraprak të atyre mishërimeve kryesore në të cilat ka ekzistuar për grekët e lashtë kujtesa e tyre historike dhe kulturore, mjafton t’u referohemi

<sup>1</sup>Arsistoteli, “Analitika e dytë (Vtoraja analitika)”, kap. 19 100a, në: Aristotel, *Vepra e plotë*, Vëll 2. Moskë: Mendimi (Mysl), 1978. f. 345.

<sup>2</sup>Platon, “Thilebi”, 34 c., në: Platon, *Vepra e plotë*, Vëll 1. Moskë: Mendimi (Mysl), 1971. f. 41.

<sup>3</sup>Platon, “Fedoni” 72e ..., vëll. 2, f. 34.

<sup>4</sup>*Bibla*, përkth. Dom Simon Filipaj, Ferizaj: “Drita”, 1994, f. 1498.

<sup>5</sup>*Bllok A.* “Krijimtaria e Vjaçesllav Ivanovit” (Tvorçestvo Vjaçesllava Ivanova) nga botimi // *Bllok Aleksandër*. *Vepra e plotë* në 8 vëllime, vëll. 5, Moskë: “Letërsia artistike” (Hudozhestvjennaja literatura), f. 10.

tipareve të Mnemozinës, siç na paraqitet ajo në të vetmin burim – në veprën “Teogonia” të Hesiodit, ku për grekët ajo është, para së gjithash, nëna e muzave.

Mircea Eliade, në njërin prej librave të tij, ka shkruar një skicë mbi mitologjinë greke të kujtesës. Ai na ndërmend që hyjnesha Mnemozina, motra e Kronosit dhe Oqeanit, quhej nënë e muzave. N’akord me Hesiodin, Mnemozina ruante kujtesën për gjithçka që ajo ka qenë, por kishte dijeni edhe për ato që do të ndodhnin. Kur muzat e përndritin poetin, ai bëhet i aftë për dijen e Mnemozinës, njohjen e zanafillave të para. Muzat këndojnë, *tue u nis ç’prej zanafillave* ato rrëfejnë për origjinën e zotave dhe njerëzve. Poeti përmes muzave fiton kujtesën *mbinjerëzore* të Mnemozinës.

Por këto realitete parazanafillore, pikërisht ngase janë të lidhura me burimet, nuk hyjnë në sferën e jetës së tashme, ato janë të *pambrrijshme* për përvojën e përditshme. Prandaj, pra, poeti që ka fituar këtë dhunti *mbikujtesore* prej duarve të Mnemozinës, shtyhet, si të thuash, prej saj në një botë tjetër, botën e së shkuarës dhe harresës, e cila identifikohet me vdekjen. Lumi i harresës, Leta, që rrjedh në Aid, e shkatërron kujtesën e të vdekurve, duke i shndërruar ata kesisoj në të vdekur. Por, vëren Eliade, me shfaqjen e doktrinës së transmigrimit (rimishërimit) të shpirtave ndryshon edhe mitologjia e kujtesës. “*Është e rëndësishme tashmë të mbash mend jo burimet dhe parazanafillat, por jetën paraardhëse të shpirtit, që shënon humbjen e kujtesës së shpirtit në lidhje me ekzistencat e tij pararendëse. Dhe rishmi vdekja në këtë kontekst del si kthim në një botë tjetër, botën e zanafillave dhe mbikujtesës. Vetëm pak të zgjedhurve të muzave dhe profetëve, Mnemozina ua lë kujtesën e ekzistencave pararendëse dhe parazanafillave. Dhe ata përpiqen t’i bashkojnë fragmentet e shkalafitura, t’i përfshijnë ato në një zinxhir të vetëm, që të mbërrijnë kuptimin e fatit të tyre. Sepse ngjitja e fragmenteve të memories së historisë, që s’kanë asnjë lidhje mes vedi, do të thotë “lidhja e fillesës me fundin”* (Eliade, 1988:156).

Këta poetë dhe orakuj, që rrahin të ribëjnë e ringjallin një tekst të lidhur prej fragmentesh të bëra fir në kujtesë, përmbushin punën e kulturës – të shqyer, fragmentare, të shkërmoqur në arkivin e padukshëm heterogjuhësor, por ama janë ata që gjakojnë të përftojnë tërësinë, unicitetin, logjikën. Në thelb, çdocili tekst i bart në vetvete këto fragmente, herë të dukshme e herë të maskuara dhe rreh t’i ndërtojë ato n’akord me logjikën e rrëfimit.

Ndër orakujt të cilëve zotat ua ruajtën kujtesën pas vdekjes, spikat njëri ndër më të njohurit – Tiresia. Ç’prej kohës së djalërisë, ai pa rastësisht, tek po lahej cullake në burimet e Hipokrenës, hyjneshën Atena dhe shi për këtë shkak i plasën sytë e mbeti i verbër, por njëkohësisht u pajis me dhuntinë e profecisë. Mandej, duke bredhur nëpër krepat e maleve të

Kilenit, ai, po rastësisht, pa shlligat që po ndërzheshin dhe për disa vite u shndërrua në femër. Ky verban dygjinish u zgjodh prej zotave që të bartë përjetësisht një kujtesë të pashqimur.

### *Topikë të trishtë*

Burgjet, kamp-burgjet, kampet “me tela me gjëmba” dhe kampet e zakonshme të internimit me punë të detyrueshme, përbëjnë, përveçse topografi të dhimbjes e terrorit, edhe një topikë të trishtë të shkrimit në letrat shqipe. Zhanret e shkrimit janë të larmishme; ato prekin romanin, tregimin, poezinë, kinematografinë, përkthimin artistik e shkencor, poezinë dhe memuaristikën, deri dhe disa lloje të pikturës e skulpturës (gdhendje të ndryshme, statueta, punime të holla artistike etj).

Prania e kësaj topike të trishtë burgjedh e kampesh nuk e ka pushuar jehonën e vet traumatike edhe sot e kësaj dite, ndonëse që nga viti 1991 kur ato u mbyllën dhe u braktisën kanë kaluar mbi një çerek shekulli. Realet e këtyre “kronotopeve” ushqejnë ende vepra letrare e narrativa memuaristike. Disa piktorë si Maks Velo, Ali Oseku e sidomos Valer Dyrzi vazhdojnë t’i kthejnë jehonën e transfiguruar arstistikisht përjetimeve nga kjo topografi makthesh. Narrativa letrare, e drjtëpërdrejtë apo fiktion na i sjell këto vende me një metonimi diskursi alegorik, simbolik apo filozofik, si në veprat e Kasëm Trebeshinës ("Odin Modvalsen"), Makensen Bungo (romani "Kënetë e vdekjes" dhe memualet), Pjetër Arbnori "Vdekja e Gëbelsit" dhe memualet), Petro Marko ("Retë dhe gurët"), Jamarbër Markos (poezitë), Fatos Lubonjës ("Ridënimi"), Henrik S.G (romanet Metamorfoza e brezit të humbur", "Gjuetia e pëllumbave"), Bashkim Shehut ("Angelus Novus", "Loja, shembja e qiellit" dhe një varg romanesh), Visar Zhitit (poezitë "Hedh një kafkë në këmbët tuaja", memuaristika, etj).

Letërsia e këtyre “topikëve të trishtë” është legjtësisht e evidentueshme. Mjafton t’i qasemi secilit topos ku vuajtën autorët e dënuar politikisht, për të hartuar mandej një repertor të pasur e të larmishëm tekstesh e veprash.

Nëse studimet letraro-kritike shqiptare apo studimet sociologjike letrare do ta kishin marrë në konsideratë faktologjinë e këtij shkrimi, të cilin me të drejtë poeti Visar Zhiti e quan “Burgologji”, atëherëdo të na përftoheshin korpuse të veçanta, blloqe tekstesh e narrativash në repertorin e gjerë të “burgologjisë”. Kështu do të dallonim qartë “tekstet e Burrelit”, “tekstet e Tepelenës”, “tekstet e Kënetës së Maliqit”, “tekstet e Spaçit dhe Qaf-barit”, etj, etj.

Herëdokur studiuesit e kësaj fushe që do të merren me fenomenologjinë e këtyre teksteve, do të prekin vëretësinë simbolike të titullit të mësipërm: “Topikë të trishtë letrarë”. Të trishtë këto tekste i bën jo aq topika si vend vuajtje e torture, por nonsensi, paradoksi dhe absurdi i fatit të vuajtësve, të cilët ishin qenie me rrënjë të thella në dije dhe kulturë, përkundër nivelit

katastrofik të xhelatëve të tyre. Në njëfarë mase persekutimi komunist mbi këta njerëz, që ishin, pa asnjë fije dyshimi, elita e kulturës shqiptare, ajka e inteligjencës, njerëzit më të ditur e të shkolluar të Shqipërisë së pasluftës. Mjafton të përmendim dis syresh: Petro e Jamarbër Marko, Astrit Delvina, Arshi Pipa, Mitrush Kuteli, At Zef Pllumi, Sami Repishti, Kasëm Trebeshina, Mustafa Greblleshi, At Konrad Gjollaj, Ejell Çoba, Makensen Bungo, Uran Kalakulla, Guljelm Deda, Havzi Nela, Pjetër Arbnori, Lekë Previzi, Lekë Tasi, Fatos Lubonja, Visar Zhiti, Bashkim Shehu etj. Veprat e tyre ilustrojnë një kronotopi të fatit të intelektualit në diktaturë dhe janë i vetmi repertori i moralshëm i shkrimit që rivendos dinjitetin e raporteve me të Vërtetën, një raport, i cili, jashtë këtij kronotopi, ishte përkeqësuar, fshehur, deformuar e shfityruar nga censura dhe autocensura komuniste.

Termi “Kronotopos” për këtë korpus tekstesh nuk e ka këtu funksionin e nocionit estetik bahtinian, pasi ai nuk zbatohet në botën e trilit artistik. Ai thjesht ndodh dhe lind brenda një realeje konkrete kohë-hapësinore, aty ku është e mbërthyer në kryq ekzistenca, mbijetesa e autorit që përpiqet të ruajë fizionominë e vet njerëzore.

Një ndër këto kronotope, që ka determinuar lindjen e një repertori të veçantë tekstesh letrare në prozë, poezi, memuaristike, kinematografi e, madje, edhe në zhanret kronikale ideologjike të historisë zyrtare, sikundërse dhe të shkrimit diplomatik, është Këneta e Maliqit me kampin famëkeq të Vloçishtit përgjatë periudhës 1946-1950. Këneta e Maliqit është njëmend, jo vetëm “topikë e trishtë” letrare. Tekstet që ka prodhuar ky topos janë kundërthënëse e diametralisht të kundërta. Nga njëra anë kemi tekste autoriale intencionalisht ideologjike, propagandistike, manipuluese në raport me të Vërtetën dhe, nga ana tjetër, kemi tekste autoriale autobiografike, që këmbëngulin në raportet dëshmuuese me të Vërtetën tronditëse.

### ***Konfrontimi i kujtesave letrare***

Në këtë kundëvënie spikasin më fort tekstet letrare konfrontuese në gjininë e romanit. Përkatësisht kemi:

1. Fatmir Gjata me romanin “Këneta”. Romani qe pjesë e srz (seria e romanit të zgjedhur), deri në vitin 1991; ishte një vepër letrare e programuar me detyrim në kurrikulat shkolllore/universitare, e shkruar në përputhje me tezat e doktrinës së realizmit socialist. Romani paraqet versionin komunist të "heroizmit epik popullor", ku masat e udhëhequra nga mësimet e partisë, përmes heroit pozitiv, sekretarit Stavri Lara, kapërcejnë gjithë vështirësitë mungesave teknologjike, por më fort punën sabotuese të inxhinjerëve "të degjeneruar" e "armiq të popullit", qëgjoja janë rekrutuar si spiunë nga ish mësuesi i tyre Harry Fultz. Se çfarë origjine etike e humane ka ky pushtet i ri, këtë në roman mund ta përkapim lehtë nga dialogu i protagonistit

Stavri Lara, sekretarit të partisë. Stavri është përfaqësuesi i atyre që kanë ardhur në pushtet dhe do të themelojnë moralin e ri të drejtësisë, barazisë e vëllazërisë. Po sa çuditshëm tingëllon, kur pasi ka treguar mes familjarëve të tij tërë mikro-Odisenë e tij romantike të mbijetesës nga kampet naziste, zhvillon, që nga dushi ku po lahet, këtë bisedë me të ëmën:

*"- Ku e keni gjetur këtë peshqir? Sa i madhe e i bukur qenka!*

*- Se mos kemi vetëm këtë. E kemi mbushur shtëpinë. Kemi marrë kolltukë, një raft me pasqyra, dy qilima, perde, takëme për të ngrënë bukë me dymbëdhjetë peceta. Janë të atyre borgjezëve <...> Ç'e do kur s'morëm edhe ca! Po s'desh yt atë! "Të marrin edhe fukarenjtë e tjerë", thoshte! Po shtëpia si të duket? Nuk është si pallat?*

*- S'e kam parë mirë, po pallat më duket!*

*- A e di se e kujt është? E atij që rri tani në kotecin tonë.*

*- Ashtuu? E atij burrit me gjyzlykë?*

*- Hëëë! Ç'ka qenë ai! Të vëllanë ia pushkatuam. Një djalë e ka të arratisur në Itali. I kanë hedhur një milion franga tatim<sup>6</sup>".*

Vullnetarët dhe populli i thjeshtë ia dalin mbanë, falë vigjilencës dhe mësimëve të partisë. Triumfon suksesi, Këneta thahet.

2. Makensen Bungo me romanin "**Këneta e vdekjes**" jep një version të përmbysur të realeve të Fatmir Gjatës për të njëjtën Kënetë, për të njëjtin proces. Rrëfimi është shkruar nga perspektiva e narratorit që dëshmon në mënyrë kronikale përditshmërinë e detajuar të një realiteti permanent vdekjeprurës në kënetë, ku ndaj të burgosurve ushtrohen sistematikisht, ditë e natë, eksperimentet më çnjerëzore, të tilla që mund t'i ndeshesh vetëm në arsenalin e torturave nëpër kampet naziste të shfarosjes.

Tipologjia zhanrore e këtij rrëfimi auto(biografik) në veprën letrare është, tashmë, gjerësisht i njohur në repertorin e krijimtarisë letrare, që e merr lëndën drejtpërdrejtë nga përvoja reale e kampeve dhe burgjeve, të tilla si romanet e Primo Levit ("A është vallë njeri ky?"), Imre Kertezhit ("Romani i një të pafati") Aleksandër Sollzhenicinit ("Arkipelagu Gulak", "Një ditë e Ivan Denisoviçit", "Pavioni i kancerrozëve" etj), rrëfimet e Varllam Shallamovit ("Tregimet e Kolimës"), Fatos Lubonjës ("Ridënimi"), Atë Zef Pllumit ("Rrno vetëm për me tregue"), Visar Zhitit ("Rrugët e ferrit", "Ferri i çarë") etj.

Përmes një realiteti ngjethës, që mpikset deri në makabritet, Bungo vizaton një tjetër të vërtetë në kronotopin e Kënetës dhe këtë e bën me realizmin e detajeve ngjethëse e shokuese. Autori, një i mbijetuar i Kënetës, na rrëfen fatin tragjik të një grushti studentësh

---

<sup>6</sup> Fatmir Gjata, *Këneta* roman, Tiranë: "Naim Frashëri", 1973, f. 26.



nacionalistë të Normales së Elbasanit. Pasi lënë qelitë e burgut të qytetit të tyre dhe vetë profesorin e tyre të dashur, shkrimtarin Et'hem Haxhiademin, që po jep shpirt aty, ata dërgohen të vuajnë dënimin në Maliq. Parakalon në rrëfim figura e shkrimtarit Mitrush Kuteli në Kënetë, sikundërse dhe e profesorit-poet, Arshi Pipës, që dërgohet në spital. Romani mbyllet më kthimin e përgjysmuar të atij grushti miqsh idealistë. Dikush ka vdekur nga puna e sfilisë, sëmundja dhe uria; dikush tjetër nuk e ka duruar sprovën e rëndë të mbijetesës dhe është bërë spiun, për një copë bukë, e më në fund, i turpëruar e i vetëneveritur var veten. Skenat e dhunës, torturës psikologjike, rrahjeve e poshtërimeve, zhburrërimet e nëpërkëmbjet e nderit janë norma e përditshme në kamp. Heroizmi masiv i punëtorëve vullnetarë nga romani propagandistik i F. Gjatës, ia lëshon vendin të vërtetave pataksëse e të shëmtuara: janë realisht të dënuarit politikë, rreth 2500 skllëvër, që janë dëguar aty për të mos dalë gjallë, çka përputhet saktë me faktet reale zyrtare në dokumnta, raportime e dëshmi të tjera.

### ***Kronotopia e Kënetës si strumbullar intertekstual***

Përveç romaneve "Kënetë" të Fatmir Gjatës dhe "Kënetë e vdekjes" të Makensen Bungos, episodi historik dhe topografik i Kënetës së Maliqit ka ushqyer në letërsinë shqipe dhe një radhë tekstesh letrare të zhanrit memuaristik. Shkrimtarët memuaristë rreth kësaj realeje historike e toponimike kanë qenë, kuptohet, vetë të burgosur, që u shfrytëzuan si skllëvërit e faraonëve për tharjen me krahë të kënetës. Mbresëlënëse e ngjethëse mbi punën në këtë kënetë janë memualet e At Zef Pllumit, Ejëll Çobës ("Jetë e humbun") dhe Sulejman Xhixhës. Praqet interes në këtë drejtim memuaristika e Ejëll Çobës për faktin, se dorëshkrimi i tij është shkruar në vitin 1975, çka na garanton parimisht, se koha kur e ka shkruar, nuk ka qenë aspak e volitshme për çfarëdo tundimi "hiperbolizues". Si Çoba, ashtu dhe Atë Zef Pllumi e Sulejman Xhixha përshkruajnë për afërsisht të njëjtin realitet konkret, të ngjashëm me romanin "Kënetë e Vdekjes" të Makensen Bungos, por aspak të ngjashëm me romanin "Kënetë" të Fatmir Gjatës. Këtyre dëshmime u bashkohen edhe kujtimet e Skënder Stefanllarit dhe e Ylber Merdanit, ish të burgosur politikë, që kanë përjetuar punën e detyruar në kampin e Maliqit<sup>7</sup>. Por më i afërt me versionin e M.Bungos është poema sonetike "Kanali" e Arshi Pipës, e cila është e pajisur me një komentari të hollësishëm që sqaron kontekstin e poezive.

Përftohet, kështu, një repertori i larmishëm tekstesh letrare, historike, kinematografike e memuaristike rreth të njëjtës realeje historike të një vendi të caktuar e veprimi të caktuar: tharja e Kënetës së Maliqit (1946-1949), ose në terminologjinë e Mihail Bahtin-it, një *kronotopi*

---

<sup>7</sup>Videoregjistrime bisedash, arkivi i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK, 2014).

tekstesh të ndryshme, që përbëjnë një *intertekst* brenda një teksti të kulturës, ndonëse kundërthënës.

Vendi qëndron në kujtesën tonë kulturore ku i përket kujtesës individuale për ta rizgjuar dhe vënë në lëvizje. Ky është kuptimi i thellë i kësaj thirrjeje të vazhdueshme, për metonimi, të interteksteve<sup>8</sup>. Për ne ka rëndësi rizgjimi dhe lëvizja e këtij repertori tekstesh për *vendin* dhe *kujtesën* duke i konfrontuar ato për hir të ndriçimit të raporteve që ata mbajnë me të Vërtetën. Teskti socrealist i Gjatës u shndërrua në një *metaforë* po aq edhe *metonimi* intertekstuale, duke manipuluar me të Vërtetën në shërbim të ideologjisë. Pra kronotopia e Kënetës këtu na shërben në cilësinë e kujtesës intertekstuale të autorëve që përmendin e përshkruajnë të njëjtin referent (tharjen e kënetës). Identiteti kulturor i një vendi shfaqet kështu në i rëndësishëm se sa pamja e tij ngushtësisht gjeografike; janë lidhjet e tij me letësinë ato që kanë rëndësi, pasi ato na përplasnin në një një të dukuptimtë kohore të historisë dhe kulturës. Në fakt rishkrimi i tekstit të *kënetës* është bërë pa ndonjë polemizim të drejtpërdrejtë me të parin tekst nistor, atë të F. Gjatës, por ekskluzivisht si zotërim e dominim të "unit" të projektuar e të dëshmuar nga rrëfimi auto(biografik) e memuaristik, sikundër edhe letrar. Në këtë mënyrë, rishkrimi i një teksti nga këndvështrime të ndryshme përvojash empirike, i mbivendoset tekstit të më parshëm duke e fshirë atë nga gjithë rrafshet e të vërtetave. Në këtë mënyrë historia e vendit dhe kujtesës së parë vjen në një pikë të tillë, sa nuk njihet më. Fakti që ne mund të thërrasim, në lidhje me një kronotopi kulturore një shumësi tëksteksh që e përmendin atë, tregon qenësinë e përhershme dhe gjallërinë e letërsisë.

Interteksti është pra strumbullari rreth të cilit lidhen subjekti, shkrimi dhe kujtesa. Qenësia e përhershme e vendit duhet në fakt të dëshmojë, para së gjithash, për shndërrimin e unit dhe cënueshmërinë e tij themelore: nëse vendi mbetet, subjekti (i lexuesit, psh) i cili rikthehet aty ka ndryshuar thellësisht<sup>9</sup> nga ballafaqimi me tekstet e tjera rreth të njëjtit kronotop. Referenca kulturore, ngaqë ajo është rrjedhojë e një kujtese të gjallë dhe vepruese, dëshmon për vazhdimësinë dhe lidhjen e unit. Uni këtu mund të shfaqet si parim identiteti: është uni ai që i bashkon copëzat e teksteve të ndryshme dhe i mbledh përtej ndarjes së kohërave dhe veprave. Puna e kujtesës rreth veprave mbi *kënetën* nxjerr në sipërfaqe copëza të së kaluarës dhe këtu është pushteti i saj kryesor: përreth ndërgjegjes së një subjekti mund të rrotullohen copa e fragmente tekstesh, të cilat përmbajnë realitetin që ato thonë. Intertekstualiteti është në zemër të marrëdhënies që subjekti mban me kujtesën, realitetin dhe letërsinë. Kështu të gjitha tekstet autoriale që janë shkruar me referencë tharjen e Kënetës së Maliqit kanë brenda tyre

---

<sup>8</sup>Nathalie Piégay-Gros, *Poetika e intertekstualitetit*, Prishtinë: "Parnas", 2011. f. 119.

<sup>9</sup>N.Piégay-Gros, *Poetika e intertekstualitetit* ..., f. 121.

konceptimin e tyre të realitetit: subjekti është para së gjithash mbartës i një kulture dhe i një tradite shkrimi që duhet t'i zgjojë. Përlllogaritja e shkrimtarit profesionist të realizmit socialist, Fatmir Gjata, ka qenë themelimi i një tradite të re leximi dhe ndjeshmërie të lexuesit, që tash e mbrapa do të lidhet jo me vërtetësinë e fakteve, por me shfrytëzimin koniunktural të tyre në shërbim të botëkuptimit të ideologjizuar komunist; që lexuesit duhet t'i afrohet një model manipulativ "edukimi të ndjenjave" të "njeriut të ri", pavarësisht çmimit të së Vërtetës. Tekstet që pasuan për romanit të Fatmir Gjatës nuk hynë në polemikë me romanin, por e "skartuan" atë, e fshinë, duke ofruar në vend të trillit të tij manipulativ një realitet empirik tronditës me gumëzhimat e rënda mortore me të burgosur që përpiqen të mbijetojnë në zgrip të eksistencës fizike. Intertektualiteti i këtij repertori është pra vendimtar për të ndriçuar raportet e shumta estetike, etike, psikologjike e metafizike që ka Letërsia me të vërtetën dhe moralin e shkrimtarit. Interstektualiteti është vendimtar gjithashtu, sepse shkrimi nënkupton gjithmonë një kujtesë tekstesh, kujtesë e cila dëshmon njëkohësisht për vazhdimësinë e unit dhe për rrjedhjen e kohës: thirrja e këtyre teksteve e lejon subjektin të nënshkruahet brenda realitetit, historisë dhe letërsisë<sup>10</sup>

Një tjetër dëshmi ngjethëse nga makabriteti i Kënetës na e sjell me mjetet e kurrsyera të poezisë, poeti Arshi Pipa me poemën e tij sonetike "Kanali" (26 sonete). Pa ndonjë ekzagjerim dhe brenda thelbit krahasimor të realeve, poema është ekuivalentja e "Ferrit" të Dantes në letërsinë shqipe. Vargjet e saj poeti i shkroi i sëmurë, përmbys, në spitalin e Korçës, mbi letra cigarjeje. Dorëshkrimi origjinal ruhet sot tek e mortra e poetit. Ia vlen të ngremë paksa "velin" e këtij peisazhi dantesk në dy sonetet e para:

### **Kanali**

#### **1**

Nga Korça bumbullon. Currila shiu  
rrjedhin prej mushamás mbi krena e shtroje.  
Pështillen, struken gjindja ndër mbuloje:  
Nji lamsh ku qelben recka e mish njeriu.

Mbramje. Dikush përbrí qet gjak për goje.  
Këndon letas mbatanë nji fmí arxhiu.  
Ky grindet për pak uj qi shoku i piu;

---

<sup>10</sup> *Po aty*, f. 122.

Ai shán se i vodhën bukën. Hín nji roje.

Shkopinj e shqelma. Britma. Frín bilbili.  
Pushim. E dergjet lodhja, prân secili,  
E flên kush mundet për atë natë me fjetë.

Si lazaret rënkon e fshân baraka.  
Nesër të gjithë i pret kanali, brraka,  
veç atyne qi pret nji vorr i shkretë.

## 2

Rreshtohet puntorija: ndahet çorba,  
dy-trí patate qi vozisin n'uj.  
E shtrîhen duert e dridhshme... Por shumkuj,  
Pse normën nuk e kreu, s i njomet vorba.

Ky ngjyen bukën me krypë, ai nji këpujë  
Qepe qëron. E shkunden xhepa e torba.  
Për nji fundrrí kazani mu si korba  
T'etshëm mbi kërma sulen me rrëmujë.

Mbasdreke. Diell. Tash lahen, hjekin llucën  
Nga kofshët; terin petkat; ngjesin arna.  
Dikush morritet. Njeni zien do barna,

Si shtesë për darkën; tjetri qepë këpucën.  
Nji professor me syza vetullçil  
Bythça duhani mbledh e i ban fitil.

## 3

A mund të quhen njerëz? Qe, shikoj.  
Fëtyra dheu ku sít e shojtun ngrohen  
Kur shofin bukën; faqe qi gropohen  
E nofulla qi dalin si patkoj.

Kambët s i mbajnë e krahët u rrëzohen.

Si dordoleca lkunden qi vendoi

Mbi hunj kopshtari. Njerz kta ksisoj?

Shauretën janë qi nga vorrezat çohen.

Njerëz kanë qenë. Sot janë veç zhele mishi,

Automa kockash, një bërsí, një pleh,

Ku veç prej emnave dallon e njeh

Bujkun nga beu, tregtarin nga dervishi,

kusarin, simahorin, lakanderin

prej atdhetarit qi luftoi për nderin.

### ***Raporti me të vërtetën në tektet mbi Kënetën e Maliqit***

Nëpërmjet romani "Kënetë" të Fatmir Gjatës, që njeh mbi tetë ribotime me tirazh llahtarisht të madh, të përfshirë në të gjitha tekstet shkollorë-universitare, të përfshirë në kolanën “seria e romanit të zgjedhur (srz)”, të përcaktuar si lexim të detyrueshëm në shkollat tetëvjeçare, të mesme dhe universitare, të përfshirë në të gjitha antologjitë shkollorë, shto këtu dhe versionin e tij filmik "Vitet e para", një mikster manipulativ të memories – u ndërtuan deri në vitin 1990 perceptime të rrejshme mbi të vërtetën. Thelbi i romanit “Kënetë” të shkrimtarit komunist Fatmir Gjata, nisët nga një e vërtetë, por shkrimtari i partisë këtë të vërtetë e shndërron tërësisht të përmbysur, të falsifikuar dhe në fakt, falsifikimi i kësaj të vërtete është një rivrasje e shëmtuar e viktimave dhe martirëve që u dënuan. Personazhet e veprës – Abdi Sharra, Kujtim Shaqiri, Vasil Minga, Zyraka, Enxhenio Skutarini, Harry Fulci, në roman paraqiten si sabotarë, armiq të popullit e të partisë dhe agjentë të ndryshëm e sidomos të imperializmit amerikan. Prandaj si të tillë duhej të dënohen dhe vërtet janë dënuar. Përballë tyre del ndonjë personazh letrar me ideale të reja socialiste, me një zgjuarsí të veçantë për “zbulimin e armiqve të popullit” dhe me besnikëri të plotë ndaj idealeve të partisë. Tema e romanit është tharja e kënetës së Maliqit në vitin 1946, kur sapo ka zënë rrënjë regjimi komunist. Brezat shkollorë që e kanë lexuar kanë krijuar një pështypje të veçantë nga vepra, kanë ndjerë kënaqësi dhe i kanë urreyer “armiqtë e popullit”! Mirëpo me kalimin e kohës, me ndryshimin e rrethanave politike, me të dhënat e bazuara në të vërtetën e kësaj ngjarjeje, na del një realitet tjetër, të cilin shkrimtari Fatmir Gjata nuk kishte guxuar ta paraqiste si të tillë. Nuk ishin ushtri të huajsh ata që varnin

të shkolluarit në Perëndim, por ishin dora vetë, komunistët shqiptarë, që ngritën trekëmbëshat në vjeshtën e fundit të vitit '46. Partia Komuniste shqiptare me levat e saj të propagandës e përdori gjerësisht si referencë dhe edukim për brezat gënjeshtër e madhe të “inxhinierëve sabotatorë”. Mjafton të kujtojmë demarshin e kësaj propagande në artin socrealist.

Çfarë ka të vërtetë në realet historike të romanit të F. Gjatës? Pas largimit të *paralajmëruar* të misionit amerikan nga Shqipëria, Sigurimi i Shtetit, me orientim "nga lart", filloi me ngut hartimin e listave të individëve proamerikanë, për të vazhduar spastrimet e përgjakta të radhës. Në këtë kuadër u përgatit dhe u zbatua skenari për ndëshkimin e të ashtuquajturve "sabotatorë" të tharjes së Kënetës së Maliqit. Anëtarët e grupit ishin inxhinjerë dhe quadro të aftë, që kishin mbaruar politeknikumin e Harri Fulcit, mandej studimet e larta në universitetet e Europës dhe shikoheshin me frikë patologjike si kundërshtarë të regjimit komunist, sikundër ngjau, pa përjashtim, më vonë, me të gjithë elitën intelektuale properëndimore.

Gjyqi-skenar nisi pak ditë para largimit të misionit amerikan nga vendi ynë, nën tamburet e një propagande frenetike që mbyste çdo mendim e qëndrim të ndryshëm nga opinioni publik i kohës. Dështimi i tharjes së Kënetës së Maliqit në afatet e vëna palogjikshëm nga partia komuniste, ishte vetëm sfondi ku u lujat ndëshkimi tragjik për "koka turku" mbi inxhinjerët e pafajshëm. Ky gjyq synonte, me gjasë, për të deskretitur Harri Fulcin dhe për ta shmangur ndikimin e shkollës teknike amerikane në prag të kthesës dhe izolimit të plotë të Shqipërisë nga Perëndimi<sup>11</sup>. Të japim disa të dhëna në përballje me romanin “Kënetë”:

– **Avdi Sharra**, si personazh letrar, është *Avdyl Sharra* i vërtetë, 35 vjeç, inxhinier i ndërtimtarisë i diplomuar në Romë, i caktuar si kryeinxhinier në tharjen e kënetës së Maliqit. Më vonë i dënua me varje!

- **Kujtim Shaqiri**, personazh letrar, është *Kujtim Beqiri* i vërtetë, 30-vjeçar, inxhinier, fitues i medaljes së artë në Universitetin e Vjenës. I caktuar si drejtor i punimeve në kënetë. I dënua me varje!

- **Vasil Mano**, personazh letrar, me emër të vërtetë *Vasil Minga*, mbaron fakultetin e inxhinjerisë në Kroaci dhe kthehet në Shqipëri, së bashku me bashkëshorten e tij

- **Zyraka Mano** (kroate), e cila del në roman me po atë emër letrar. Të dy dënohen me pushkatim për sabotim dhe “tradhti” ndaj popullit dhe atdheut! Para ekzekutimit ajo i drejtohet të shoqit dhe një inxhinjeri italian ne fjalët: "Ngrini sytë nga qielli të na shikojë Zoti, se Ai dhe

---

<sup>11</sup>Agim Musta, *Antologji e Krimet Komunist*, Tiranë: Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, 2006, f. 81.

ne e dimë që jemi të pafajshëm!"<sup>12</sup>, fill pas të cilave pushkatohet dhe ajo, edhe pse ishte shtatzanë. Po ashtu dënohen me pushkatim drejtori i shkollës, Fulci dhe inxhinieri italian, **Eugenio Scaturo**, në roman, *Skutarini*. Dhe gjithnjë, duke gjurmuar shkrimet rreth kësaj ngjarjeje mësojmë se në tharjen e kënetës së Maliqit *nuk ka marrë pjesë populli, as punëtorë vullnetarë të partisë*, por të burgosurit politikë nga të gjitha burgjet e Shqipërisë, nën masa të rrepta sigurie e në kushte e masa ndëshkuese mesjetare. Kënetë e Maliqit ishte shndërruar në një kamp të tmerrshëm ku bëhej shfarosja e “armiqtë të popullit e të partisë”! Prandaj është e qartë se ngjarjet rreth kënetës së Maliqit janë shtrembëruar dhe janë hartuar ashtu siç i ka pëlqyer regjimit komunist.

A do ta shkruante ndryshe shkrimtari Fatmir Gjata po të ishte gjallë?! Përveç romanit ka edhe një film të kinostudios “Shqipëria e Re” (“Vitet e para”) për ta kanonizuar masivisht versionin zyrtar komunist, po ashtu edhe dokumentarë mbi këtë diavoliadë. Në kënetën e Maliqit, sipas versionit të propagandës komuniste punonte “populli, rinia jonë heroike”, ndërsa e vërteta është krejt ndryshe: Kontigjenti që realizoi në kushte naziskine këtë vepër, ishin të burgosurit politikë. Disa nga shifrat që afrohen janë se rreth *tre mijë* të burgosur kanë punuar atje. 63 vetë kanë vdekur në punët e vështira, janë pushkatuar, janë varur në kohën e tharjes së kësaj kënete. Masat represive që u ushtruan në kënetën e Maliqit u përkasin metodave të nazistëve. Përditshmëria e të burgosurve kalonte nëpër kushtet ekstreme: mushkonjat, norma e rëndë e punës, ushqimi i pakët, rrahja, ndëshkimet poshtëruese deri te groposja në kanal, mungesa e teknologjisë (mjetet përbëheshin prej lopatës, kazmës, tokmakut, dekovilit, dinamiti). Tharja e kënetës kërkoi shfrytëzimin mizor të energjive të mijëra vetëve, ndërkaq shteti refuzonte kredi dhe makineritë moderne që përdorte bota në tharjet e kënetave.

### ***Tekste të tjera të kronotopisë së Kënetës së Maliqit***

Një korpus më vete përbën repertori i dëshmimeve memuaristike. Janë përvoja në lëkurë, përjetime të vetë autorëve. Autorët më të spikatur midis dhjetrave, janë: Beqir Ajazi, At Zef Pllumi, Ejëll Çoba, Sulejman Xhixha, Arshi Pipa, Sami Repishti etj. Ky i fundit i përshkruan të burgosurit si “kufoma lëvizëse”, “leckamanë të mbuluar me baltë”, që transportoheshin të lidhur me zinxhirë.

Tekste politike, ideologjike e diplomatike. Këtu mund të përfshihen në një repertor më vete të gjitha tekstet e Historisë së Shqipërisë së pasluftës, Historia e PPSH, tekstet shkollorë apo universitare të Historisë. Te këto tekste mund të përfshihet dhe një tekst diplomatik, Raporti

---

<sup>12</sup> *Po aty*, f. 83.

i qeverisë Amerikane i paraqitur në OKB në shkurt të 1955, prej 10 faqesh, ku flitet hollësisht për mënyrat çnjerëzore të trajtimit të të burgosurve politikë në Shqipëri, në këtë kamp shfarosjeje.

Nëse do të përmblihdeshin të gjitha tekstet e repertorit të Kënetës së Maliqit në një antologji të kësaj “topike të trishtë”, atëherë në letrart shqipe do të kishim rreth 2000 faqe tronditëse në disa zhanre.

Pasi kujton thënien e Danillo Kishit se “shkrimtarët nuk janë ndërgjegjja e kombit, sepse në mesin e tyre ka shumë qelbanikë e kriminelë”, në çast të dalin përpara personazhet e Fatmir Gjatës nga romani “Kënetë”.



# Leonora Laçi - ISKPK, Tiranë

## Totalitarizmi shqiptar përmes disa shkrimtarëve

### Abstrakt

Studimi ka qëllim analizues tiparet e fenomenit totalitar dhe shfaqjet e tij në Shqipëri gjatë viteve 1945-1990 dhe si këto tipare u adaptuan në Shqipëri. Burim kryesor referencial janë shkrimtarë si: Atë Zef Pllumi, Arshi Pipa, Sami Repishti, Visar Zhiti, etj.

### Hyrje

Tiparet e totalitarizmit botëror tashmë janë të njohura dhe deri diku të studiuara nga filozofë, studiues, shkrimtarë e politologë të huaj si: Raymond Aron, Hannah Arendt, Leon Poliakov, Berzhinski, A.Solzhenitsin etj. Ndërsa në Shqipëri studimet mbi totalitarizmin shqiptar janë Të pakta dhe vetëm vitet e fundit përmes krijimit të muzeve, mediave, emisioneve të ndryshme, shihet një tendencë deri diku serioze për të hedhur dritë mbi të kaluarën, për këtë na vijnë në ndihmë edhe kujtimet e të mbijetuarve apo dhe botimet e studiuesve në formë narrative e letrare.

Ky studim ka qëllim analizues të tipareve të fenomenit totalitar dhe shfaqjet e tij në Shqipëri gjatë viteve 1945-1990, studimi do të përqendrohet tek mënyra sesi këto tipare u adaptuan në Shqipëri dhe të veçantat e tij. Pra do përpiqemi të sjellim disa nga karakteristikat e shfaqjes së totalitarizmit në vendin tonë dhe burimi kryesor referencial do jenë shkrimtarë si: Arshi Pipa, Sami Repishti, Visar Zhiti etj. Se si këta i përshkruajnë fenomenet e ndryshme totalitare, do të jetë një paralelizëm mes realitetit dhe veprave që shkruhen për këtë realitet.

Totalitarizmi gjenë përhapje në ato vende ku ka autoritarizëm apo ka destabilitet politik. Është sistem që vepron aty ku mungon demokracia. Çdo regjim diktatorial është në vetvete totalitar. Totalitarizmi nuk është një ideologji, totalitarizmi qendron mbi ideologjit, është gjithëpërfshirës, është mbi regjimet diktatoriale, është boshti në të cilën janë shfaqur dhe krijuar ideologjit, si dhe burimi i nazizmit, fashizmit, komunizmit, anti-semitizmit.

### *Tiparete regjimeve totalitare të përmbledhur nga studiues të huaj*

Fillimisht po shpjegojmë termin totalitarizëm sipas studiuesve të huaj si Berzhinski dhe Raymond Aron, siç shihen më poshtë. Në këtë studim do flasim për rastin konkret, Shqipërinë.

**Totalitarizmi sipas Berzhinski;** Totalitarizmi është një ideologji e bazuar mbi një doktrinë zyrtare e cila ezauron të gjitha fushat e jetës ku përfshihet e gjithë shoqëria. Kjo ideologji është e drejtuar drejtë përzgjedhjes së një stadi përfundimtar në botën ku është stadi

final dhe perfekt i njerëzimit. Krijimi i një partie të vetme të drejtuar nga një person ose një grup personash, ku antarët e së cilës nuk janë më shumë se 10 % e popullsisë. Kjo parti është e përbërë nga një grup idealistësh të përkushtuar ndaj ideologjis dhe po kështu konsiderohet si një institucion mbi institucionet shtetërore. Partia është mbi shtetin. Sistemi i terrorit që është viziv, psikologjik i ushtruar nga partia nëpërmjet Policisë sekrete, ndaj armiqve të modelit. Monopol mbi mjetet e komunikimit që vendosën në duart e partisë e përdoren për propogand. Kontroll i të gjitha armëve nga shteti qoftë ushtrisë, artilerisë, bombës atomike. Ekonomi e centralizuar.

**Ndërsa Raymond Aron, filozof-politolog, shkroi në vitin 1965 për dukurin e totalitarizmit;** Fenomeni totalitar shfaqet në atë regjim, që i jep një partie të vetme monopolin e veprimtarisë politike. Partia monopolistë është e frymëzuar dhe e armatosur me një ideologji, së cilës i atribuon një autoritet absolut dhe që, për rrjedhojë, arrin të bëhet e vërteta zyrtare e shteti. Për përhapjen e kësaj të vërtete zyrtare, shteti merr përsipër nga ana e tij një monopol të dyfishtë, monopolin e mjeteve të forcës, si dhe atë të lavazhit të truve. Tërësia e mjeteve të medias: radioja, televizioni, shtypi drejtohen dhe komandohen nga shteti dhe nga ata që e përfaqësojnë. Shumica e veprimtarive ekonomike dhe profesionale i nënshtrohen shtetit dhe këto, njëfarë mënyre, janë pjesë përbërëse e tij. Ashtu si shteti është i pandarë nga ideologjia e vet, po ashtu edhe veprimtaritë kryesore ekonomike e profesionale marrin ngjyrën e së vërtetës zyrtare. Që nga çasti në çasti që çdo veprimtari është shtetërore dhe i nënshtrohet ideologjisë, një gabim i kryer në një aktivitet ekonomik a profesional është njëkohësisht edhe një gabim ideologjik. Si përfundim, kjo shpie në politicizmin e shoqërisë, në marrjen e ngjyrës ideologjike të të gjitha gabimeve të mundshme të individëve dhe, në shkallë të fundit, në një terror policor e në të njëjtën kohë edhe ideologjik.

### ***Totalitarizmi në Shqipëri përmes veprave të shkrimtarëve të burgut***

Përpyekjet e këtij studimi janë që të vihen në dukje aspekte të totalitarizmit shqiptar në veprat e shkrimtarëve të cilët janë persekutuar dhe kanë vuajtur në burgjet komuniste. Shkrimtarët shqiptar përmes romaneve, poezive apo studimeve kanë shprehur më së miri aspekte të tipareve totalitariste të shfaqura në Shqipëri. Tiparet ku jemi perqendruar janë; totalitarizmi dhe ideologjia, roli i të tretit, perndjekja e librave, roli i intelektualit jokomunist, konceptimi i lirisë, tjetërsimi i njeriut.

### **-Totalitarizmi dhe ideologjia**

Shqipëria kishte një komunizëm shumë ortodoks. Regjimi i saj ishte një përzjerje mes stalinizmit, nacionalizmit etnik dhe elementeve të maoizmit në pushtet do thoshte kryeredaktori i “Gazetës së zgjedhjeve” polaku Adam Micnik në një intervistë të vitit 2009.<sup>1</sup>

Ndersa Visar Zhiti shkruan: -“Në këtë dyzim a dyfytërsi e personalitet të dyfishtë që krijonte ndër njerëz, sistemi njëfytërsë totalitar a fare i pafytërsë e shpersonalizues arrinte të sundonte dhe të përhapej duke molepsur dhe brendësitë, duke krijuar gjendje të përgjithshme down, duke bërë që artistët të ndihen të lumtur keqas si hendikapatë, të paktën në dukje, me Narcistin e shëmtuar në shpirt ...”<sup>2</sup>

Filozofi Artan Fuga ndanë një mendim krejt të kundërt, ai do ta konsideroj “falsitet” shpjegimin e sotëm mbi ideologjinë e djeshme: - “false ideologjia e regjimit të shkuar, fals edhe shpjegimi i sotëm mbi atë falsitet.”<sup>3</sup>

Ndërsa A.Pipa e ilustron me përjetimin personal: - “Pas daljes time nga burgu më 1956, e kisha shumë të vështirë të siguroja jetesën. I kercenuar nga uria, vendosa të takoja Ramiz Alinë, Ministrin e Arsimit, që kishte qenë student imi në Liceun e Tiranës me 1943-1944. Pritja ishte qytetare dhe menjëherë pas kësaj më caktuan mesues të gjuhës shqipe në një shkollë fillore. Librat në përdorim ishin të renduar nga letërsia e Partisë. Gramatika duhej të mesohej nga shartimi i këtyre në mendjet brishta të nx`nesve (...) **Politika e gjuhës që fillonte në shkollën fillore me prostituimin e gramatikës me ideologjinë staliniste**, ishte kurorëzuar me pseudokryeveprën e quajtur “Shqipja letrare e unifikuar” që ishte në fakt gjuha e fitimtarëve komunistë toskë e imponuar mbi gegët e mundur.”<sup>4</sup>

Arshi Pipa do i hyjë më thellë studimit mbi “ideologjinë”, e vazhdon mendimin diku më tutje: - Sa herë që një ngjarje nuk i përshtatet pikëpamjes së tyre ideo-politike apo ideo-shkencore, ata ose e shpërfillin atë tërësisht apo e shfytyrojnë atë deri aty sa ta bëjnë të panjohur.<sup>5</sup> Një ideologji e huaj, e importuar, e imponuar në popull me brutalitet maksimal, komunizmi mbeti deri në këtë ditë më i huaj se kurrë. Ndryshe nga shumë vende të tjera të sunduara nga komunistët që komunizmi ka thithur diçka nga karakteri kombëtar, Shqipëria nuk merr parasysh të tilla karakteristika të veçanta. Komunizmi shqiptar është thjesht një kopje e bolshevizimit, pa asnjë origjinalitet të vetin.<sup>6</sup> Si një ideologji tërësisht totalitare, Stalinizmi depërton në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore, si politika, etika, ekonomia, filozofia, arti

<sup>1</sup> Fatos Tarifa, Romeo Gurakuqi, Ermal Hasimja, *Politika dhe historia*, Tiranë: UET PRESS, 2012, f. 232.

<sup>2</sup> Visar Zhiti, *Si na erdhi ai, I NDALUARI*, Tiranë: OMSCA-1, 2017, f. 83.

<sup>3</sup> Artan Fuga, *Monolog*, Tiranë: Dudaj, 2010, f. 19.

<sup>4</sup> Arshi Pipa, *Stalinizmi shqiptar- anatomia e një patologjie politike*, Tiranë: IKK & Princi, 2007, f. 217-218.

<sup>5</sup> A. Pipa, *Stalinizmi shqiptar ...*, f. 256.

<sup>6</sup> A. Pipa, *Stalinizmi shqiptar ...*, f. 43.

dhe shkencat dhe çdo formë tjetër të menduarit dhe praktikë. Fjalori Stalinist përfshin bashkime që thekson parësinë e ideologjisë mbi të gjitha këto sfera dhe forma. Dy prej tyre shumë të përdorshme janë “ideo-politike” dhe “ideo-shkencore.”<sup>7</sup>

S.Repishi shkruan:-Çdo ditë e ma shumë kisha përshtypjen se, eksperiencia komuniste në Shqipni, kishte marrë karakterin e aventurës që shkelmonte logjikën e përfundimet logjike.”<sup>8</sup>

Arshi Pipa vazhdon: “Ndërsa Stalinizmi shqiptar nuk është tërësisht produkt i .E.Hoxhës, ideologjia që frymëzoi PKS-h-në është plotësisht e tij. Udhëheqësit e Partisë dhe inteligjenca vetëm përsërisin apo perifrazojnë çfarë thotë ai apo çfarë shkruan ai.”<sup>9</sup>

### ***Roli i të tretit***

Shkrimtari Visar Zhiti ndalet në një aspekt të rëndësishëm që pa të, ekzistenca e komunizmit nuk do të ishte aq e gjatë, ndonëse ai nuk e përmend termin “spiun”, por preferon ta quaj “I treti”, ku në një bisedë mes dy vetëve ekzistenca e një personi të tretë vinte në rrezik jetën e dy të tjerëve, problem ishte se ti nuk e dije se kush mund të ishte ai, nganjëherë mund të dyshoje dhe në vetvete.

Ja si shkruan Visar Zhiti:-“Në regjimet totalitare, në të gjithë popujt e perandorisë komuniste, sidomos në Shqipërinë diktatoriale, u fut i “treti”, ai që do të ishte lajmëtari i fshehtë i bisedave kokë me kokë, që do t’i çonte ato të plota si ata shakujt e erës në mitologji(...) Në çdo tre veta, njëri është yni, përhapte dyshim e ankth njëra nga thashethemnat e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kujdes nga i treti, ti s’e di cili është ai dhe kur vjen, kurse ai ju ka dëshmitarë jut ë dyve. Po ia the edhe një treti, e di e gjithë bota. Ruaju! (...) Pse fole, ishe i pakënaqur, mjerë ti, do ta pësosh!... Nuk të pëlqen buka e socializmit? As poezia e realizmit socialist?! Futeni në dhomat e torturës...Je kundër regjimit, nuk e do këtë udhëheqje? Koka të ikën!...Dhe çfarë, do të ikësh, do të arratisësh? Po kush të lë, plumbat të presin...!”<sup>10</sup>

### ***-Përndjekja e librave***

Një nga tiparet e totalitarizmit është dhe monopol mbi mjetet e komunikimit që vendosën në duart e partisë e përdoren për propogand. Shkenca, arti, letërsia, historia, institucionet arsimore vihen në shërbim të partisë-shtet, çdo devijim quhej sabotim.

<sup>7</sup> A. Pipa, *Stalinizmi shqiptar ...*, f. 248.

<sup>8</sup> Sami Repishi, *Nën hijen e Rozafës - narrativë e jetueme*, Tiranë: Botimet Onufri, 2007, f. 309.

<sup>9</sup> A. Pipa, *Stalinizmi shqiptar ...*, f. 115.

<sup>10</sup> V. Zhiti, *Si na erdhi ai ...*, f. 16-17.

## **Nuk përndiqeshin vetëm njerëz, por edhe libra, sidomos dorëshkrime, copa letrash mbi të gjitha...**<sup>11</sup>

Shkrimtari Visar Zhiti shkruan se: “Diktatori shkonte në teatër, vizitonte ekspozita dhe studio, takonte shkrimtarë e artistë, kishte marrë pjesë në mbledhjet e tyre, kongreset, jepte direktiva, krijonte përçarje dhe mbante anën e një grupi, sipas interesit, herë të më të rinjve, kur dhe vetë ishte më i ri, dhe herë të konservatorëve, fanatikëve, kur po plakej dhe ishte bërë i gjithëpushtetshëm etj., etj., dhe vazhdimisht theksonte që shkrimtarët dhe artistët janë të Partisë, ajo i rriti dhe i edukoi dhe veprat e tyre i shërbejnë çështjes, kauzës, socializmit etj., etj.”<sup>12</sup>

E gjithë letërsia e socrealizmit është si një import, kryesisht nga Bashkimi Sovjetik.<sup>13</sup>

Në vendet socialiste poeti shihej si misionar i masave; në vendet kapitaliste si shenjt... i vetvetes(...) Poezia në diktaturë ishte dhe “detyrë partie” dhe poetët-ushtarë të atij ideali sundimtar, i arritur nëpërmjet gjakut dhe që mbahej me një luftë të ashpër, thënë troç, me terror. Poetët e diktaturës gëzonin të gjitha privilegjet që të jepte diktatura, e kam fjalën për një lloj mirëqenieje në krahasim më të tjerët, hierarkinë e famës, por edhe frikën se mos i humbisje të gjitha një ditë. Kontrolli dhe përndjekja vazhdonin pa ndërprerje dhe të më të rinjtë, që të parandalohej, se jo kushdo mund të bëhej shkrimtar, poet, piktor, aktor, muzikant.<sup>14</sup>

Në poezinë e socrealizmit kishte baltë, rrallë e më rrallë “pozitive”. Teksa mbetën domëthënëse vargjet e njohura të një poeme të Dritëroit:”paskam marrë baltën tënde arave...për t’ia sjellë Lidhjes së Shkrimtarëve. Në kundërshtim me krenaritë tona atavike, mision do të ishte që dhe poezinë ta çonin te balta, si arritje e njeriut që e mposht atë. Baltë internimesh, burgjesh, baltë tradhtish... e çuan në baltë, u zhyt në baltë... pra ra në të keqen, meriton baltën...”<sup>15</sup>

Visar Zhiti poetët e realizmit socialist i konsideron si ato kërpurdhat helmuese, por me rol të kundërt. Helmin e mbledhur nuk e përdornin kundër regjimit, por të helmonin shijet, dëshirat, arsyen e një populli.<sup>16</sup>

### ***-Roli i intelektualit jokomunist***

E një rendësie të veçantë për tu studiuar si element është dhe fati i intelektualit antikomunist, fillimisht po e paralelizojmë me atë çfarë shkruan shkrimtari Jean Amery në një ese të titulluar” Kufijtë e intelektit”, ai merret me fatin e intelektualit në kampet e përqendrimit.

<sup>11</sup> V. Zhiti, *Si na erdhi ai ...*, f. 47.

<sup>12</sup> V. Zhiti, *Si na erdhi ai ...*, f. 58.

<sup>13</sup> V. Zhiti, *Si na erdhi ai ...*, f. 61.

<sup>14</sup> V. Zhiti, *Si na erdhi ai ...*, f. 81.

<sup>15</sup> V. Zhiti, *Si na erdhi ai ...*, f. 89-91.

<sup>16</sup> V. Zhiti, *Si na erdhi ai ...*, f. 81.

Së jashtmi, situatë e një intelektualit rezultoi më e pafavorshme se e një njeriu që merret me punë fizike: të burgosurit që zotëronin një zanat të thjeshtë kishin shans të ishin më të nevojshëm se një intelektual. Ndaj edhe konkurrenca për ta ulur veten sa më poshtë ishte shumë e madhe; kush kishte qenë profesor, thoshte se ishte mësues, kush kishte qenë gazetar thoshte se ishte tipograf e kështu me radhë. Sepse kush nuk zotëronte një zanat mbeste të hapte gropa. Dhe këtu hynin intelektualët. “Intelekti në totalizimin e tij në kamp u shpall jokompetent. Si vegël e vlefshme në përballimin e detyrave të vëna para nesh, ai abdikoi.”<sup>17</sup>

Ndërsa studiuesi Arshi Pipa në analizat e tij për këtë temë shkruan: “Tani pak fjalë për intelektualët. Ata që nga fillimi i kanë treguar komunizmit një fytyrë të ftohtë, duke i provokuar komunistët deri në tërbim. Shumë shfaqje gjyqesh në Shqipëri kumbojnë nga emrat e doktorëve dhe avokatëve, profesorëve dhe shkrimtarëve, teknikëve dhe inxhinierëve, që nuk janë përkulur para regjimit despotik. Shumë prej tyre u pushkatuan apo u varën dhe një pjesë e madhe janë zhdukur dhe janë duke u zhdukur në birucat komuniste dhe në kampet e skllëvërve të punës. Historia e tyre është një kapitull më vete e komunizmit shqiptar, më e turpshme dhe më e shëmtuara. Shqipëria mund t’i falë ndoshta komunizmit shumë krime, por jo atë të privimit nga energjia mendore dhe shpirtërore e bijve të saj, kapitalit më të çmueshëm të kombit(...)Udhëheqësit komunist përpiqen t’i joshin intelektualët në rangjet e tyre. Duke qenë të paktë ata që u afruan me ta, ata iu drejtuan dhunës. Duke vrarë dhe burgosur një numër të konsiderueshëm të tyre, ata i detyruan të tjerët të nënshtroheshin apo të topiteshin. Ndërkaq, ata vazhduan me shpejtësi të ethshme të ngrinin inteligjencën e tyre. Këtu, deri tani, ata kanë ndeshur në dështime. Përveç një numri fanatikësh, shumica e intelektualëve të rinj i bëjnë një shërbim thjesht verbal ideologjisë komuniste; sytë e tyre janë kthyer drejt Perëndimit. Trashëgimia e brezit të kalaur të intelektualëve, të gjithë të nginjur me civilizimin perëndimor, është shumë e gjallë për brezin e ri të bëhet fanatike e një ideologjie e cila është e huaj për gjendjen shpirtërore dhe traditat e popullit shqiptar.”<sup>18</sup>

### ***-Konceptimi i “Lirisë”***

#### **Po LIRIA ?! Çfarë ishte ajo në komunizëm?! A ia doli të jetë fitimtare ?!**

V.Zhti shkruan: “Fitorja s’është gjithmonë liri, po emocionohesha së brendshmi, madje s’do të thotë liri. Ndonjëherë nuk janë bashkë e ndonjëherë janë dhe kundër e vrasin njëra-tjetrën, po mendoja. Liria, ku janë sheshet e lirisë, statujat dhe shatërvanët e saj? Njerëzit e lirisë, poetët...? Kjo është dhe përvoja e vendit tim, ku as ne nuk kemi shesh të lirisë, p.sh.,

<sup>17</sup> Anila Shuka, “Kur intelektet nuk të hyn në punë”, në: *Revista Saras*.

<sup>18</sup> A. Pipa, *Stalinizmi shqiptar ...*, f. 40-41.

obelisk të lirisë, park të lirisë(...) Ka fitore pa liri, ka liri pa fitore, ka.. këtu çmpleksen shqetësueshëm e dhëmbshëm. (...) Në burg t'i marrin liritë të gjitha, ti shpik tëndën, të fshehtën, të leckosurën, që duket sikur nuk e përdor dot, por që është thelbi yt, rrugëdalje s'ka, vetëm të shikosh lart, nga Qielli.<sup>19</sup>

Dom Simon Jubani ka rrefyer kështu:” Unë e tregoj tragjedinë e jetes sime, dëshiroj të baj skenen e shpirtit katedër të humanitetit. Kam kry Universitetin e burgut komunist. Mësova me folë e me shkruar latinisht, greqisht, italisht, frëngjisht, anglisht... Gjatë torturave m'i thyen të gjithë dhambët. **Vuejtjet ma mprehen trunin, kisha mbetë njeri i lirë.**<sup>20</sup>

Sami Repishti shkruante: “Ngrehu, o qenie njerëzore që më jep ndjenjën e kryenaltësisë për emnin që mbaj! E ti, o zemër, mbushë sot me vner e ideal, shpërthe, trego se jeton akoma, e se jetën e ke në duert tuej, po ta dëshirosh ti, ti vetë, e vetëm ti...! E ju,”të tjerët”, bashkatdhetarët e mi të nënshtruem e vllazën, nëqoftëse zgjedha e tiranisë nuk ju rrjep lëkurën e zverkut, nëqoftëse samari i diktaturës nuk jua ban kurrizin me plagë, nëqoftëse ajri i ndytë i organizmit të gënjeshtres e mashtrimit të pafund nuk ju zen frymën e nuk pengon ajrin e domosdoshëm me rruajtje pastërtinë e gjakut tuej, atëherë, o tungjatjeta, shtypja asht bashkudhëtarja juej, ajo asht kalorsi i stërvitun që shijon rehatllekun e një shale të punueme për të e për kurrizin tuej, o ju të mjerë, që preferoni me qenë kafshë nga frika e qenies njeri, o ju që nuk njihni thirrjen madhështorëe të dinjitetit që ndryni Brenda vetes, ju o landë e patrajtë që lindni e vdisni, pa pa, pa ndie, e pa jetue...!”<sup>21</sup> “Isha i ri, e dojsha jetën. Isha i ri e frikësohesha nga vdekja. Por isha i vendosun me kërkue jetën e lirë, mos me pranue vite të gjata poshtnimi, skllvënimi e torture, në burg e kampe pune të detyrueshme..!”<sup>22</sup>

### ***-Tjetërsimi i njeriut***

Tjetërsimi i njeriut bëhej në disa forma me dhunë fizike, piskologjike e verbale. Por pati dhe nga ata që i qendruan tjetërsimit, e sfiduan atë siç ishte rasti i shkrimtarëve. Tjetërsimi bëhej si aty ku mungonte liria pra në burg, por dhe në liri pasi fakti që mund të ishe pa pranga duarve nuk do të thotë se nuk kishe pranga gojës e mendjes. Toksikimi pa pranga ishte më i vështirë të përballohej. Më poshtë po japim disa raste të trajtimit të tjetërsimit e dehumanizimit.

Visar Zhiti në poezinë “Medaljoni i diktatorit” shkruan: Kaq dëm këtu s'kanë bërë përmytjet/ as edhe luftrat, jo asnjëherë/ u prish njeriu, u prishen virtytet, nga humnerat e diellit/ biem në ferr<sup>23</sup>.

<sup>19</sup> V. Zhiti, *Si na erdhi ai ...*, f. 186-187.

<sup>20</sup> Fatbardha Mulleti-Saraçi, libër dorëshkrim, në process botimi.

<sup>21</sup> S. Repishti, *Nën hijen e Rozafës*, f. 310-311.

<sup>22</sup> S. Repishti, *Nën hijen e Rozafës*, f. 316.

<sup>23</sup> V. Zhiti, *Si na erdhi ai ...* .

Ndërsa Kurt Kola thotë: “Na u bënë helm zemrat/ aty ku shpirti na që nxirë/ atje ku ruanim vetëm emrat/ e bënim ujdi me vdekjen e pështirë/... shihnim njëri-tjetrin të drobitur në pranga/ si gamile të lodhura në shkretëtirë.”<sup>24</sup>

Në poezinë Kanali, A.Pipa përshkruan më së miri situatën vetjake në të cilën gjendet dhe kjo është një dëshmi që duhet marrë në konsideratë, dhe konkretisht shkruan:- A mund të quhen njerëz? Qe, shikoj/ fëtyra dheu ku syt e shojtun ngrohen/kur shofin bukën: faqe qi gropohen e nofulla qi dalin si patkoj/ kambët si mbajnë e krahët u rrëzohen/ si dortoleca lkunden qi vendoi/mbi hunj kopshtari. Njerëz kta ksisoj?/ Shauretën janë qi nga vorret çohen/ Njerëz kanë qenë. Sot janë veç zhele mishi/ automa kockash, një bërsi, një pleh/ku veç prej emnave dallon e njeh.<sup>25</sup>

Ndërsa Havzi Nela në poezinë” E randë qenka shtypja, o shokë!- Ashtu dhe njeriu kur rron pa liri/ec kuturu si në rrugë pa krye/ Ç’po ban e ku shkon as vetë s’e di/ Nën shtypjen e randë pa gaz e shije!/ Pa gaz e shije përplasen në jetë/ Gjithmonë me ankth, trishtim e tmerr, Posi ai lepurit me veshët përpetetë/ Kur ruhet e druhet i strukun nën ferrë.”<sup>26</sup>

### ***Konkluzione***

Ky punim është maja e ajsbergut lidhur me paraqitjen e tipareve totalitare të regjimit komunist në Shqipëri, ku syinimi pra është paraqitja e mendimeve të disa shkrimtarëve që kanë vuajtur persekucionin, dhe ajo çfarë bie në sy është se interpretimet e tyre janë të përafërta me njëri-tjetrin. Këta shkrimtarë kanë të përbashkët burgun, lirinë shpirtërore që mbeti pa iu cenuar dhe shkrimin e përjetimeve të tyre për realitetin që provuan, por kjo nuk i përjashton shkrimtarët e tjerë që nuk janë bërë pjesë e këtij studimi.

---

<sup>24</sup> Kurt Kola, *Në Shqipërinë burg, Çfarë ndodhi? Çfarë pashë? Çfarë hoqëm?*, Tiranë: UET PRESS, 2016, f. 400.

<sup>25</sup> Arshi Pipa, *Libri i burgut*, Tiranë: Rilindja, 1994, f. 64-65.

<sup>26</sup> Havzi Nela, *Si shpend i ngujuem ...*, Tiranë: OMBRA GVG, 2015, f. 44-45.



## Kejsi Ziu - Universiteti i Tiranës

### **Spiunë dhe sabotatorë: Sakrifikimi i inxhinierëve të Maliqit dhe akuza për mision agjenturor amerikan gjatë regjimit komunist shqiptar**

#### **Abstrakt**

Punimi trajton probleme si lufta e klasave dhe survejimi i vazhdueshëm, si instrumente të fuqizimit dhe konsolidimit të pushtetit politik, goditja e konceptit juridik të pronës private; shtetëzimi i saj, nxitja e luftës së klasave; goditja e njerëzve të shkolluar në perëndim si “sabotatorë”, organizimin e gjyqeve të manipuluar nga pikëpamja juridike si dhe goditjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA që e la Shqipërinë pa mbështetje ndërkombëtare.

*Që* në fillimet e ekzistencës së tij, regjimi komunist në Shqipëri u karakterizua nga shkelje të së drejtave më themelore të njeriut si mjet i vazhdueshëm pune duke nisur që nga eliminimi i pronës private, te përdorimi i punës së detyruar, trajtimi çnjerëzor e poshtërues dhe burgimi, vrasja e kundërshtarëve politik apo individëve të tjerë të kapur në shakullinë shkatërruese të agresionit komunist. Një shembull konkret i kësaj politike thellësisht çnjerëzore e antishqiptare është arrestimi i grupit të inxhinierëve të ngarkuar me detyrën e tharjes së Kënetës së Maliqit, të akuzuar nga regjimi si sabotatorë dhe bashkëpunëtorë të spiunazhit amerikan në Shqipëri.

Disa nga çështjet për diskutim janë: A ishte i ashtuquajtur “grupi teknik” realisht sabotues dhe “agjentë të paguar nga misioni amerikan në Shqipëri” apo kjo ishte një akuzë e përdorur nga regjimi për të eliminuar ndikimin e SHBA-së në Shqipëri? A e përdori Sigurimi i Shtetit arrestimin e grupit të inxhinierëve dhe të teknikëve të Maliqit për të larguar ndikimin e frymës perëndimore demokratike nga Shqipëria dhe për ta kthyer Shqipërinë në një vend pa asnjë lloj transparence demokratike dhe llogaridhënieje për veprimet qeverisëse? Cilat ishin akuza dhe e vërteta e inxhinierit më të ri në moshë, Kujtim Beqiri? Cili ishte pozicioni dhe roli i Fultzit në Shqipëri?

#### ***1. Eliminimi i konceptit të pronës private nga regjimi socialist si mjet për luftën e klasave***

Modeli i ekonomisë shqiptare në periudhën komuniste u përqendrua në eliminimin gradual të të gjitha formave të pronës private, nëpërmjet shtetëzimit të plotë të degëve të ekonomisë e tregtisë dhe të kalimit në planifikimin tërësisht të centralizuar. Instrumenti kryesor ligjor që në fillimet e shtetit komunist, ishte Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë e vitit 1946. Funkzioni kryesor i kësaj Kushtetute ishte rrëzimi i gjithë sistemit të mëparshëm të

drejtësisë dhe krijimi i një sistemi të ri. Frymëzimi kryesor i hartimit të saj dhe i të gjithë akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në vitet 1945-1946, ishte eksperiencia e Bashkimit Sovjetik.

Me Kushtetutën e vitit 1946 u shpall: “Republika Popullore e Shqipërisë është shtet i punëtorëve dhe i fshatarëve punonjës” (neni 2), sikurse “Puna, për çdo shtetas të aftë për punë, është detyrë dhe nder sipas parimit: “kush nuk punon, nuk ha” (neni 13).

Duke e shpallur veten përfaqësuese të popullit, pra, të punëtorëve dhe të fshatarëve që kishin si mjet të vetëm jetese vetëm punën, krijohej hendeku ndarës me të gjithë shtresat që zotëronin një lloj prone dhe i hapej fushë veprimi luftës së klasave: pronarë- jo pronarë. Pasi justifikoi me kushtetutë këtë situatë të luftës së klasave, në vitet 1945-1946 shtetëzimi i pronave private nga shteti u krye me ritme shumë të shpejta dhe propaganda e kohës e konsideronte si një prej sukseseve më të mëdha të regjimit komunist.

Në Kushtetutën e 1946, neni 35, theksohej se çdo shtetas shqiptar *detyrohej* të ruante dhe të forconte pasurinë shoqërore (shtetërore dhe kooperativiste), e cila konsiderohej si “*bazë e shenjtë dhe e paprekshme e demokracisë popullore, burim i fuqisë së Atdheut, i mirëqenies dhe i kulturës së të gjithë punonjësve*”. Sipas kësaj dispozite, ata që preknin pasurinë shoqërore konsideroheshin si armiq të popullit. Thellimi i mëtejshëm i luftës së klasave u sanksionua edhe në Kushtetutën e 1976, neni 4, që theksonte se: “*Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë zhvillon pa ndërprerë revolucionin duke iu përmbajtur luftës së klasave dhe ka për qëllim të sigurojë fitoren përfundimtare të rrugës socialiste mbi rrugën kapitaliste, të arrijë ndërtimin e plotë të socializmit e të komunizmit.*”

Ishte kjo ideologji e luftës së klasave që u përdor masivisht për të përndjekur dhe eliminuar fizikisht shtresën e intelektualëve shqiptarë dhe të gjithë ata që nuk ishin dakord me regjimin sllavo-komunist. Në këtë shtresë intelektualësh bënin pjesë edhe disa inxhinierë dhe personel tjetër teknik që punonin në tharjen e Kënetës së Maliqit - edukimi akademik e profesional i të cilëve binte në kundërshtim me ideologjinë e regjimit komunist.

## **2. Propaganda dhe e vërteta mbi grupin e inxhinierëve të Kënetës së Maliqit**

### **2.1. Skenari për “sabotim” dhe akuza publike**

Siç rezulton edhe nga dosjet hetimore-gjyqësore<sup>1</sup>, pjesëtarët kryesorë të grupit që u akuzuan për sabotim, ku bënin pjesë edhe inxhinierët drejtues të punimeve për tharjen e kënetës,

---

<sup>1</sup>*Shih: AIDSH, F. 1/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 5. “Pretenca e prokurorit dhe vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake mbi gjykimin dhe dënimin e grupit sabotator tekniko-intelektualë të Maliqit”, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Dega e III-të, 15.11.1946 – 25.11.1946. Shih: edhe dosjen e marrë nga AQSH, “Procesi i sabotatorëve të punimeve për tharjen e liqenit të Maliqit”, Tiranë, Nëntor 1946, deklasifikuar me vendimin Nr. 2, dt. 16. 06. 2017 nga AIDSSH.*

ishin: Abdyl Sharra, Kujtim Beqiri, Vasil Mano, Zyrika Mano, Mirush Përmeti, Paolo Saggioti, Eugenio Scaturro, Pandeli Zografi, Aleks Vasili, Mihal Stratobërdha, etj. Dokumenti që përmban akt-akuzën e ngritur nga Prokuror Haznedari<sup>2</sup> i akuzoi si “organizatë tekniko-sabotatore, e cila ka kryer vepra sabotazhi me stil të gjerë dhe në mënyrë sistematike me qëllim ngadalësimin e rindërtimit ekonomik të Shqipërisë, si dhe për kryerje të veprave të spiunazhit në favor të agjentëve të huaj”. A. Sharra dhe më pas, K. Beqiri ishin drejtuesit e punimeve në Kantierin e Maliqit, siç rezulton edhe nga relacionet e Sigurimit për zhvillimin e punimeve atje<sup>3</sup>, ndërsa pjesa tjetër shërbenin si punonjës në kantier në pozicione si inxhinierë, gjeometër, llogaritar, etj.

Përjashtim bënte Zyrika Mano, e cila ishte një shtetase me origjinë kroate, e martuar me njërin prej inxhinierëve, Vasil Mano. Ajo u akuzua si personi që realizonte komunikimin midis Fultzit dhe grupit të inxhinierëve. Prokuroria në këtë akt-akuzë, përveç Fultzit, implikonte dhe 2 misionarë të UNRRA-s si bashkëpunëtorë në sabotim.

Implikimi i punonjësve të UNRRA-s në gjyqin dhe dënimin e grupit të inxhinierëve “sabotatorë” të Kënetës së Maliqit rezulton nga procesverbali i dëshmimeve të Vasil Manos dhe Kujtim Beqirit, që tregonin se punonjësit e UNRRA-s kishin ardhur 3 herë në Maliq, një herë në 15 maj, një herë në 13 qershor dhe një herë në muajin korrik, për të pyetur mbi detajet dhe statistikat e punimeve të kanalit të Maliqit<sup>4</sup>.

E analizuar nga një pikëpamje juridike, pretenca e prokurorit fillon duke theksuar rëndësinë e veçantë që kishte ky gjyq për Shqipërinë, për nga niveli i tradhtisë që grupi i inxhinierëve kishin treguar. Sipas pretendës, nëpërmjet sabotimit me stil të gjerë, në strukturën ekonomike dhe më pas politike të shtetit, synimi final i grupit të inxhinierëve, të cilët cilësoheshin “reaksonarë ndërkombëtarë”, ishte të vendoste në rrezik integritetin e vendit dhe të mashtronte pushtetin dhe popullin.

Pretenca nuk ka pothuajse asnjë argument juridik. Nga fillimi në fund ajo përmban një diskurs të ndikuar politikisht. Vetë prokurori nuk kishte formim arsimor në fushën e së drejtës.

---

<sup>2</sup>Po aty.

<sup>3</sup>Shih: Dosja Nr. 3 “Relacion dërguar Komitetit Qendror të Partisë mbi zhvillimin e punimeve për tharrjen e Liqenit të Maliqit, vështirësitë, pengesat dhe sabotimi i ing. A.Sharrës”, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Dega e III-të, 24.09.1946. Shih: gjithashtu Relacionin e Sigurimit mbi zhvillimin e punimeve në Kantierin e Maliqit, 01.07.1946, f.17.

<sup>4</sup>Shih: Dosja Formulare Nr.1080/2, “Kujtim Ali Beqiri”, Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit, Nr.Regj.557, Kategoria IIB TEPËR SEKRET, deklasifikuar me vendimin Nr.2, dt.16.06.2017 nga AIDSSH, fl. 2). Për më shumë informacion, shih: O. Pearson, *Albania in the Twentieth Century, A History: Volume III: Albania as Dictatorship and Democracy, 1945-99*, f. 113.

Qëllimi i tij i shprehur në pretencë ishte të “demaskonte” grupin e inxhinierëve. Bie në sy fjalori i përdorur për të formuluar akuzat, paraqitja e provave të mundshme, deri përdorimi i fyerjeve kundrejt të pandehurve me cilësimet “mbeturina balliste dhe fashiste”, “banditë”, “katilë”, “spinë të poshtër”, apo cilësimet “egoist, kriminel i shitur” për Kujtim Beqirin, etj.<sup>5</sup>, element inekzistent ky në procese gjyqësore të rregullta. Për shkak të mosekzistencës ende të një Kodi Penal, e vetmja bazë ligjore për ngritjen e akuzave ndaj të pandehurve ishte Ligji nr.21, datë 15.12.1944 "Mbi sabotatorët e Luftës Nacionalçlirimtare".

## 2.2. Gjyqi

Sistemi gjyqësor në 1945 ishte i ndërtuar në bazë të Ligjit nr. 41, datë 14.1.1945 "Mbi organizimin e funksionimin e gjykatave ushtarake", neni 79 i të cilit parashikonte se drejtësia në Republikën Popullore të Shqipërisë do të jepej nga Gjykata e Lartë e Republikës Popullore të Shqipërisë, nga gjykatat popullore dhe nga gjykatat ushtarake. Gjykata e Lartë Ushtarake, që gjykonte çështjen e kënetës së Maliqit përbëhej nga tre anëtarë, përkatësisht një nënkolonel dhe dy kapitenë ushtarakë. Fillimisht kjo gjykatë krijohej si gjykatë *ad hoc* për të shqyrtuar dhe zgjidhur çështjet që kishin të bënin me krime të tradhtisë së lartë apo krime të tjera politike. Ajo që vihet re nga shqyrtimi i dosjes që përmban proces-verbalet e seancave gjyqësore, është se gjyqi për “sabotatorët e Kënetës së Maliqit” zgjati vetëm 16 ditë ; Seancat gjyqësore u mbajtën në mjediset e Kinemasë “17 Nëntori”. Përgjatë gjithë kohës iu bë një publicitet shumë i madh. Mediet e kohës pasqyronin në mënyrë të vazhdueshme pamje nga gjyqi, duke përdorur një gjuhë agresive fyerjesh për të përshkruar grupin e inxhinierëve, me qëllim ushqyerjen e propagandës. Gazeta “Bashkimi”, 1946, publikonte vazhdimisht artikuj kundër grupit të inxhinierëve dhe detaje nga seancat gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës është shumë i shkurtër -vetëm 4 faqe- dhe përsëri aty nuk përmbahen argumente juridikë për të mbështetur apo kundërshtuar pretencën e prokurorit dhe dënimin e dhënë. Nga ana tjetër, mbrojtja e paraqitur nga avokatët mbrojtës është shumë e dobët dhe e shkurtër. Bie në sy se të pandehurit i kanë pranuar “fajet” dhe tregojnë pendesë të thellë për veprimet e tyre. Në procesverbalin e mbrojtjes të hartuar nga avokati Vasil Xhaja, i pandehuri Kujtim Beqiri kërkon falje të dënimit prej gjykatës, sepse ishte kryefamiljar dhe kishte 8 persona në ngarkim, megjithëse ende shumë i ri në moshë.

Në përfundim, vendimi, që mori gjykata për shumicën e të pandehurve, ishte ai i dënimit me vdekje. Inxhinierët Kujtim Beqiri dhe Abdyl Sharra u dënuan më varje në litar, ndërsa

---

<sup>5</sup>*Shih*: Dosja Nr. 5 “Pretenca e prokurorit dhe vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake mbi gjykimin dhe dënimin e grupit sabotator tekniko-intelektualë të Maliqit”, Drejtorja e Sigurimit të Shtetit, Dega e III-të, 15.11.1946 – 25.11.1946, f.2-3.

Zyrika Mano me të shoqin me pushkatim. Për sa i përket dënimit të Zyrikës, shumë studiues kanë diskutuar se Zyrika ishte shtatzënë në kohën e pushkatimit<sup>6</sup>, element shtesë ky që dëshmon përsëri mbi shkeljet e pastra që i bëheshin të drejtave të njeriut në kohën e regjimit komunist.

### **2.3 Kujtim Beqiri: Procesi gjyqësor dhe e vërteta mbi të**

Kujtim Beqiri u arrestua nga sigurimi i shtetit në 24 tetor 1946 dhe bazuar në proces-verbalin e mbajtur nga ky i fundit, u mor në pyetje tre herë, në datat 4, 6 dhe 9 nëntor 1946.<sup>7</sup>

Sipas dëshmisë së dhënë prej tij<sup>8</sup>, në mënyrë të përmbledhur, ai dhe “elementë të tjerë të pakënaqur” ishinkontaktuar dhe rekrutuar nga Fultzi pas çlirimit të Shqipërisë (1943), në kohën që ai punonte pranë Ministrisë Botore. Fultzi i propozoi krijimin e një organizate me elementë teknikë – intelektualë, në krye të së cilës duhet të ishin ish-nxënës të tij, me qëllimin për të pritur në gatishmëri momentin kur qeveria e atëhershme, e përkohshme, të zëvendësohej me një qeveri pro anglo-amerikane. Puna e kësaj organizate do të përmbledhej në sabotimin indirekt të ndërtimit të vendit dhe si rrjedhojë, duhet të kishte të dëmshme për qeverinë për sa i përket ekonomisë dhe vijës së saj politike.<sup>9</sup>

Përveç ndihmës nga misioni amerikan, duhej që teknikët dhe *përgjithësisht intelektualët* të sabotonin ritmin e punës së rindërtimit e për rrjedhojë, të ndikonin në humbje të “*kredibilitetit të qeverisë ndaj popullit*”. Në këmbim të sabotimit, Fultzi do t’i jepte Beqirit një shpërblim financiar prej 200 e ca stërlinash floriri, të cilat ai do t’ia shpërndante pjesës tjetër të grupit.

Këto sabotime do të shpreheshin nëpërmjet mospërfundimit të punimeve në kohë dhe kryerje të propagandës në favor të demokracisë amerikane tek punëtorët që punonin në Maliq. Në kohën kur kantierin e Maliqit e drejtonte Kujtim Beqiri, akuzohet se janë provokuar greva të ndryshme nga punëtorët dhe kanë dezertuar rreth 100 punëtorë dhe kjo ka ardhur për shkak të punës politike që ka bërë ky së bashku me bashkëpunëtorët e tjerë<sup>10</sup>.

Pseudonimi i tij i vendosur nga Fultzi, sipas dëshmisë, ishte “Kab”<sup>11</sup>. Ky është tjetër element që tregon se Sigurimi donte t’i nxirrte inxhinierët si organizatë kriminale e organizuar në mënyrë të sofistikuar, deri në atë pikë sa të kishin edhe pseudonime me njëri-tjetrin. Përsëri në bazë të dëshmisë së dhënë prej Beqirit, tregohet se Fultzi e kishte instruktuar që të sabotonte

---

<sup>6</sup>Shih për shembull Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë: Kumi, 2009 (ribotim), fq. 5. Agron Tufa, “Apologjia e gënjeshtres dhe shumëfishimi i krimit: [kënetat e Maliqit, këndvështrime të ndryshme të pasqyrimin në romanin shqiptar]”, në: *Almanak*, Nr. 1, 2011.

<sup>7</sup>Shih: Dosja Formulare Nr. 1080/2, “Kujtim Ali Beqiri”, Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit, Nr.Regj.557, Kategoria IIB TEPËR SEKRET, deklasifikuar me vendimin Nr.2, dt.16.06.2017 nga AIDSSH, fl. 13-17.

<sup>8</sup> Po aty, fl. 20-26.

<sup>9</sup> Po aty, fl. 21.

<sup>10</sup> Po aty, fl. 112-113.

<sup>11</sup> Po aty.

edhe vepra të tjera me ndërtimin e të cilave ishte ngarkuar, përpara se të caktohej me punë në Maliq në vend të Abdyl Sharrës. Shembuj të përmendur aty janë ndërtimi i rrugës së Bicaj apo ura e Rrogozhinës mbi Shkumbin, e cila ishte ndërtuar fillimisht nga italianët në kohën e Ahmet Zogut, u hodh në erë gjatë luftës nga gjermanët dhe ishte rindërtuar menjëherë pas çlirimit, në vitin 1945.

Këto vepra për të cilat komunistët ngritën pretendime si të sabotuara, në realitet, jo vetëm mbijetuan gjatë gjithë periudhës së diktaturës duke kryer plotësisht funksionin e tyre, por disa prej tyre ekzistojnë ende sot, gjë që dëshmon se ishin ndërtuar sipas parametrave të duhur teknikë. Ato janë dëshmi edhe e seriozitetit dhe përkushtimit profesional të inxhinierit Kujtim Beqiri, që drejtoi punën për ndërtimin e tyre.

Pas transferimit të tij në Maliq, supozohet se Kujtim Beqiri së bashku me inxhinierët e tjerë të akuzuar më lart, me të cilët mblidhej rregullisht fshehurazi për të diskutuar mbi vazhdimësinë e sabotimit, hartonte raporte periodike për Fultzin mbi vijimin e sabotimit, të cilat i dërgonte nëpërmjet Zyrakës apo nëpërmjet komunikimeve verbale që bënte me vetë atë. Sipas procesverbalit të dëshmisë së Kujtim Beqirit, gjithsej ishin organizuar 4 mbledhje, ku në dy prej tyre ishte diskutuar mbi raportet që do t'i dërgoheshin Fultzit nëpërmjet Zyrika Manos. Sipas akuzës, këto letërkëmbime, ai pasi ua lexonte anëtarëve të tjerë të grupit, i griste.

Por si qëndron e vërteta? Kujtim Beqiri ishte një student i shkëlqyer i Universitetit të Vjenës, Austri. Ai kishte refuzuar një pozicion si pedagog në këtë universitet për t'u kthyer e për të kontribuar në rindërtimin e vendit të tij. Rezultatet e tij të shkëlqyera akademike dëshmohen më së miri nga kopja e diplomës që vetë ky universitet ka lëshuar, të paraqitur më lart.

Niveli i tij i profesionalizmit del në pah edhe nga vetë raportet e Sigurimit, pavarësisht gjuhës së përdorur mbi figurën e tij: Nga studimi i dosjeve që përmbajnë dëshmitë e Kujtim Beqirit dhe të inxhinierëve të tjerë, duket qartë se ato janë marrë në kushte presioni dhe torturash të llojeve të ndryshme (fizike dhe psikologjike), pa vullnetin e tyre të lirë. Një detaj konkret që e vërteton më së miri këtë ndodhet në një pjesë të dëshmisë së Beqirit, e cila pasi është shtypur me makinë shtypi, është korrigjuar nga i pandehuri me shkrim dore.<sup>12</sup> Në dosje gjendet edhe inventari i sendeve dhe pronave që i janë gjetur të pandehurit në momentin e arrestimit, të cilat në përputhje me ligjet e kohës, u konfiskuan nga shteti, i cili përveç heqjes së lirisë fizike, i privonte individët edhe nga prona e tyre e luajtshme dhe e paluajtshme.

---

<sup>12</sup>*Po aty*, fl. 14

Një arsye më tepër për dënimin e inxhinierëve ishte dhe justifikimi i qeverisë komuniste për dështimin në tharjen e Kënetës së Maliqit, punimet për të cilën duhet të përfundonin brenda tetorit të vitit 1946, por për shkak të fondeve të pamjaftueshme dhe mjeteve primitive të punës, ky plan nuk u realizua. Gjatë dhënies së dëshmisë në zyrat e sigurimit, Kujtim Beqiri vë theksin te mungesat financiare dhe materiale, gjer te mjetet primitive të punës, si pengesë për kryerjen me ritme të shpejta të punës. Për këtë arsye ai kishte hartuar një plan të ri për zhvillimin e punimeve, që nuk kishte aspak qëllime sabotimi, siç dhe u akuzua.

Propaganda e regjimit komunist për të nëpërkëmbur figurën e inxhinierit të talentuar Kujtim Beqiri dhe të intelektualëve të tjerë u manifestua jo vetëm te qëndrimet e institucioneve të administratës shtetërore, por u bë subjekt edhe në vepra letrare të kohës si romane apo filma të kohës,<sup>13</sup> me qëllimin për të përjetësuar në sytë e popullit shqiptar inskenimin e kryer nga regjimi si një të vërtetë.

Në përfundim të jetës së tij, pak përpara përfundimit të gjyqit të inskenuar ku Kujtim Beqiri u dënua me vdekje, ai i dërgon një letër lamtumire familjes së tij. Në nënshkrimin e vendosur në përfundim të letrës, duket qartë që e vetmja dëshirë e tij është që pas vdekjes të mos e mbanin mend për sabotues dhe kriminel i vendit të tij siç u akuzua, por si profesionist të përkushtuar, ashtu siç ishte edhe e vërteta.

### **3. Marrëdhëniet diplomatike SHBA-Shqipëri: Gjendja e pasluftës dhe ardhja e misioneve anglo-amerikane**

#### **3.1. UNRRA dhe OSS**

Në periudhën 1945-1946, në vend zbarkuan misione të ndryshme me qëllime humanitare, siç ishte UNRRA, i financuar nga Forcat Aleate, kryesisht nga qeveria amerikane, për të ndihmuar Frontin Nacionalçlirimtar, ndihmë ekonomike e më vonë, në rimëkëmbjen e popullit shqiptar. Kjo organizatë drejtohej nga Frank Woodard, i cili mbante postin e Drejtorit të Divizionit Bujqësor për Shqipërinë. Pas përfundimit të Luftës së II Botërore, misioni i UNRRA-s ishte të siguronte ndihmë ekonomike për kombet evropiane pas Luftës së Dytë Botërore dhe të riatdhente dhe ndihmonte refugjatët që do të vinin nën kontrollin e Aleatëve. Qeveria amerikane financoi afërsisht gjysmën e buxhetit të UNRRA-s. UNRRA nuk vepronte vetëm në Shqipëri, por në të gjitha shtetet të cilat kishin pësuar humbje ekonomike gjatë

---

<sup>13</sup>*Shih:* për shembull Fatmir Gjata, *Këneteta*, Tiranë: Naim Frashëri, 1973 dhe filmin e prodhuar nga Kinostudio "Shqipëri e Re" i bazuar mbi këtë roman, me titull "Vitet e para" (1965).

Luftës.<sup>14</sup> Misione të tjera të ardhura në Shqipëri në atë periudhë ishin me natyrë ushtarake, si ai amerikan, me në krye Harry T. Fultz, si dhe ai i dërguar nga qeveria angleze.

Mbërritja e misionit të UNRRA-s në Shqipëri e ashpërsoi akoma edhe më shumë luftën e klasave. Sipas komunistëve, UNRRA do të përdorte “logjikën e saj imperialiste”, për t’u angazhuar në rrjet spiunazhi dhe sabotimi. Duke përdorur Sigurimin e Shtetit, synohej të mbahej nën kontroll të vazhdueshëm veprimtaria e punonjësve të kësaj organizate, sepse i druhej ndonjë indoktrinimi të mundshëm të popullit shqiptar me frymën demokratike perëndimore.

Dy dosje të deklasifikuaratë Sigurimit të Shtetit, specifikisht Dosja Nr. 20 “*Korrespondenca e shkëmbyer në mes të personelit të UNRRA-s dhe misionit ushtarak në Shqipëri mbi veprimet e tyre në vendin tonë*”<sup>15</sup> dhe Dosja Nr. 80 “*Të dhëna informative nga burime agjenturiale mbi veprimtarinë e misionarëve të UNRRA-s dhe elementët armiq e të dyshimtë shqiptarë*”<sup>16</sup> dëshmojnë më së miri mbi survejimin e aktivitetit të UNRRA-s, të manifestuara qoftë nëpërmjet raporteve të hartuara nga vetë punonjësit e Sigurimit, ku detajohej çdo lëvizje apo diskutim i tyre, qoftë nëpërmjet dëshmimeve periodike të rrjetit të bashkëpunëtorëve të Sigurimit mbi ta, të cilët në shumicën e rasteve përmenden nëpërmjet pseudonimeve. Misionet ushtarake anglo-amerikane që zbarkuan në territorin e Shqipërisë së sapoçliruar në 1944 i përkisnin organizatave SOE (Special Operations Executive/Ekzekutivi i Operacioneve Speciale) dhe OSS (Office of Strategic Services/Zyra e Shërbimeve Strategjike).

Qëllimi i përbashkët zyrtar i të dyja misioneve ishte të ndihmonin me trupa të armatosura në Luftën Nacional-Çlirimtare si dhe të hapnin negociatat me qeverinë e sapoformuar komuniste, për t’u siguruar që kjo e fundit do të respektonte përkatësisht: kryerjen e zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe vazhdimësinë e detyrimeve të traktateve bilateralë ndërmjet saj dhe SHBA-së (të ndërmarra nga qeveria paraardhëse). Megjithatë, duhet theksuar se funksionet kryesore të OSS / SOE ishin ato të një agjencie inteligjence.

Nga dalja në dritë e dokumenteve të reja të deklasifikuara që i përkasin asaj periudhe, vërtetohet se misionet e dërguara prej tyre kishin si objektiv të njohnin gjendjen politike në të cilën ndodhej Shqipëria. Rrjedhimisht, rezulton se agjencitë e inteligjencës që operonin në Ballkan, duke përfshirë Shqipërinë në kohën e Luftës së II Botërore, ishin kryesisht amerikane dhe angleze dhe ardhja e misioneve të dërguara prej tyre u mundësuan vetëm përmes

---

<sup>14</sup> Për më shumë informacion, *shih*: marrëveshjen e lidhur ndërmjet qeverisë komuniste shqiptare dhe kësaj organizate, me qëllim ardhjen e saj në territorin shqiptar, 11 prill 1945. Aksesohet në: <https://www.loc.gov/law/help/us-treaties/bevans/b-al-ust000005-0028.pdf>

<sup>15</sup> Dosja është hapur më 08.12.1944 - 30.12.1944 nga Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Dega e I-rë;

<sup>16</sup> Dosja është hapur për periudhën 13.05.1946 – 31.07. 1946 nga Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Dega e I-rë;



marrëveshjeve të fshehta të bashkëpunimit midis OSS nga njëra anë dhe SOE-së nga ana tjetër, në qershor 1942 dhe gusht 1943 (Arkivi i Shtetit Amerikan - NARA, 1943: 1-23).

Në Shqipëri, rolet e tyre ishin të ndryshme: detyra kryesore e misionit të OSS ishte të hartonte raporte të vazhdueshme inteligjence lidhur me marrëdhëniet që kishte lideri i sapovendosur në krye të shtetit shqiptar, E. Hoxha, me Bashkimin Sovjetik, ndikimin që mund të kishte ky i fundit në vend dhe në marrëdhëniet SHBA-Shqipëri në të ardhmen<sup>17</sup>, ndërsa misioni anglez kishte synim të ndërtonte një rrjet më aktiv agjentural.<sup>18</sup>

Në nëntor të 1943, misionin e OSS në Shqipëri e mori nën drejtim Harry T. Fultz<sup>19</sup>, një veteran i Luftës së Parë Botërore dhe ish – drejtori i Shkollës Teknike në Shqipëri (1922-1931), tashmë në rolin e një civili, që deri në atë moment kishte drejtuar Seksionin Shqiptar të OSS-së në Bari,<sup>20</sup> si rrjedhojë e njohurive të forta mbi Shqipërinë.

Diçka e tillë vërtetohet edhe nga një korrespondencë telegrafike midis J. Jacobs<sup>21</sup> dhe Departamentit Amerikan të Shtetit, ku Fultz, ishte planifikuar të hynte në territorin shqiptar fillimisht si një anëtar i misionit të OSS dhe më vonë do të shërbente si Këshilltar Ekonomik i Departamentit Amerikan të Shtetit. Për më tepër, telegrami instruktonte se pas ardhjes së misionit të OSS nga Italia në Shqipëri, duhet të koordinohej puna e kryer deri atëherë nga stafi paraardhës amerikan me atë të Fultz-it. Pothuajse që në momentin që Fultz u rikthye në jetën politike të Shqipërisë, filloi të survejohej nga Sigurimi i Shtetit, ashtu siç dëshmohet edhe nga një dosje e deklasifikuar e Sigurimit mbi të, Dosja Nr.100<sup>22</sup>, ku përveç survejimit të përditshëm të veprimtarisë së tij, përshkruhet me detaje jeta e hershme, aktiviteti si drejtor i Shkollës Teknike në Tiranë, si dhe roli drejtues në OSS.<sup>23</sup>

---

<sup>17</sup> Shumë historianë amerikanë pohojnë se shërbimet inteligjente amerikane në fillimet e tyre ishin të një cilësie kaq të dobët, sa nuk ishin në gjendje të parashikonin asnjë nga lëvizjet e rëndësishme politike në Evropë, të ndërmarra nga gjermanët apo italianët. Duke parë këtë dobësi të madhe të politikës ndërkombëtare amerikane, dhe duke pasur parasysh se amerikanët do të hynin shumë shpejt në fushën e Luftës Botërore, presidenti Roosevelt nënshkroi urdhrin presidencial për krijimin e OSS (1942 -1945), e cila u krijua pak a shumë në modelin britanik të SOE. OSS, e drejtuar nga William Donovan (kur ky i fundit e ktheu vëmendjen e tij drejt Ballkanit) u kthye në një organizatë inteligjence shumë e rëndësishme gjatë Luftës së Dytë Botërore.

<sup>18</sup> Disa studiues madje aludojnë për një rivalitet të këtyre dy agjencive përgjatë veprimtarisë së kryer në Shqipëri. Bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy misioneve përmendet edhe në veprën Th. Bare, *Historia e Armës së Sigurimit të Shtetit*, Pjesa II (Nëntor 1944-1948), Tiranë: Janar 1974.

<sup>19</sup> Emri i koduar: “Gates” ose “Plak”.

<sup>20</sup>Shih: P. Lucas, *The OSS in World War II Albania: Covert Operations and Collaboration with Communist Partisans*, f. 23.

<sup>21</sup> Joseph Jacobs, pjesëtar i Misionit Civil Amerikan në Shqipëri, i cili mbërriti në Shqipëri në maj 1945. Pjesë e këtij Misioni ishte dhe Harry Fultz.

<sup>22</sup> Dosja Nr. 100 “Të dhëna biografike dhe informative mbi veprimtarinë armiqësore kundër vendit tonë nga Harry Fultz”, filluar më 1945 e mbaruar në 1946, fl. 148.

<sup>23</sup> Po aty, fl. 2, 12.

Misionit të OSS-së i ishte dhënë leja nga qeveria komuniste për të përdorur ndërtesat e Legatës (Ambasadës) Amerikane në Tiranë si seli te përkohshme,<sup>24</sup> element i cili shfaqet shpesh edhe nga dosjet e hartuara nga Sigurimi, ku shumica e survejimeve që i janë bërë Fultzit dhe anëtarëve të tjerë të misionit amerikan e kanë pikënisjen aty. Një element që vlen për t'u theksuar për sa i përket mënyrës sesi Sigurimi i Shtetit operonte është fakti se ky i fundit shkelte të drejtën e privatësisë jo vetëm ndaj Fultzit dhe anëtarëve të tjerë të misionit, por edhe atë të familjarëve të tij, siç dëshmon dosja survejuese e vajzës së tij, Joana, e cila në atë kohë ishte vetëm 21 vjeçe.<sup>25</sup>

### ***3.2 Rreth figurës së Harry Fultzit dhe përfshirjes së tij në “sabotimin” e Kënetës së Maliqit***

Në periudhën kur ka drejtuar Shkollën Teknike<sup>26</sup> (1922 -1931), ai ka qenë gjithnjë në rolin e edukatorit për popullin shqiptar, sepse ndihmoi në edukimin e shumë brezave në shkencat natyrore dhe gjuhën angleze. Fëmijët e tij<sup>27</sup>, dëshmojnë se ai u kishte trashëguar dashurinë për popullin shqiptar. Djali i tij, Dave, një figurë e shquar akademike në SHBA, gjatë një intervistë të dhënë në vitin 1993, ka diskutuar gjerësisht mbi kontributin e të atit në vendin tonë. Ai e përshkruante këtë lloj përkushtimi si ngjithës, deri në pikën ku ai vetë ishte frymëzuar për të ndjekur një karrierë në fushat shkencore si rrjedhojë e viteve që kishte kaluar në Shqipëri, duke studiuar në shkollën e të atit.<sup>28</sup>

Gjatë periudhës kur Fultzi kryente rolin e drejtorit të Shkollës Teknike (deri në vitin 1933) nuk ka asnjë dokument që të provojë se ai kishte lidhje me shërbimet e inteligjencës amerikane.

Përfshirja e tij me OSS rrjedhimisht ka ardhur gjatë kohës së Luftës II Botërore. Ky detaj konfirmohet, së pari, nëpërmjet dosjes së tij si personel i OSS, e cila është tashmë e deklasifikuar,<sup>29</sup> ashtu si edhe nga mikrofilmat e gjetur që përmbanin dosjet agjenturiale të

---

<sup>24</sup> Telegram i adresuar nga Jacobs drejt Sekretarit të Shtetit të Ministrisë në Egjipt (Tuck), “Efforts by the United States to arrive at satisfactory arrangements for the establishment of diplomatic relations with the Albanian Government”, 2 Janar 1945. Gjetet në: <https://history.state.gov/historicaldocuments/frus1945v04/ch1>

<sup>25</sup> Dosje Nr. 90, “Materiale Agjenturiale në ngarkim të së bijës së Fultzit, Joana Fultz”, 1945 - 1946, fl. 76.

<sup>26</sup> Sot kësaj shkolle, i është dhënë emri i tij.

<sup>27</sup> Shih: Joan Fultz-Kontos, *Kryqi i Kuq, Shqiptarja e Zezë*, Monografi për Evropën Lindore, Bibliografi e Shkollës Teknike Shqiptaro-Amerikane të Tiranës, 1994.

<sup>28</sup> Intervista me Dave Fultz, fq.4,5,13. E aksesueshme në:

<https://opensky.ucar.edu/islandora/object/archives%3A7598/datastream/OBJ/view>.

<sup>29</sup> Gjetet në: <https://catalog.archives.gov/id/2173377>.

Donovan-it, shefit të OSS, të deklasifikuara dhe të zbardhura nga Arkivi Shtetëror Amerikan, ku H.T.Fultz rezulton si subjekt i rekrutuar në këtë agjenci.<sup>30</sup>

Gjithashtu, sipas një rrëfimi të bërë nga ish- kapiteni të OSS, që operoi në Shqipëri në ato vite, James “Jim” Hudson për një gazetë shqiptare në 2012, ishte kjo periudhë (pas 1943) kur Harry Fultz mund t’u jetë drejtuar të gjithë ish-nxënësve të tij si dhe profesorëve të dikurshëm të Shkollës Teknike me qëllim rekrutimin e një rrjeti informatorësh shqiptarë, të cilët potencialisht mund të përdreshin prej OSS edhe pas vendosjes së regjimit komunist.<sup>31</sup> Historia mbështet faktin që ka pasur përpjekje nga OSS për të rekrutuar eksponentë shqiptarë të diasporës, që ishin kundër regjimit të Hoxhës për të kryer veprimtari agjenturiale (ky grup quhej the Albanian Subversion ose Komiteti për Çlirimin e Shqipërisë – Committee Free Albania), por kjo ka ndodhur në 1949, vite më vonë nga arrestimi dhe dënimi i grupit të inxhinierëve, ashtu si dhe nga largimi i misionit amerikan nga vendi. Ky operacion rekrutimi ishte rezultat i një bashkëpunimi ndërmjet misionit amerikan me atë anglez dhe mbante emrin OBOPUS / BGFIND.<sup>32</sup>

Sipas një memorandumi të Zv/Drejtorit Për Koordinimin e Politikave në Washington DC, të deklasifikuar vitet e fundit nga CIA, që mban datën e nëntorit 1949, përmendet se: *“Informacioni (i CIA-s) është marrë nga një burim i mirëfilltë që këshilltari kryesor i Komitetit për Shqipërinë e Lirë, gjatë vizitës së tij të fundit në Washington, ishte Harry Fultz, i njohur mirë nga intelektualët shqiptarë, sepse ka qenë për shumë vite Drejtor i Shkollës së Kryqit të Kuq Amerikan në Tiranë. “... Në bisedimet me shqiptarët, thuhet se ai do të donte ta shihte vendin ku ai kaloi kaq shumë vite të çliruar nga komunizmi dhe ai premtoi gjithë mbështetjen e tij personale... (Jemi njoftuar) se ai i dha secilit anëtar të Komitetit për Çlirimin e Shqipërisë një shpërblim prej \$ 5,000.00. (Një raport tjetër nga i njëjti burim kishte treguar se anëtarët e këtij Komiteti kishin marrë secili nga dhjetë mijë dollarë nga Departamenti i Shtetit)”*.<sup>33</sup>

<sup>30</sup> Arkivi Kombëtar Amerikan, Washington, DC 20408, “GENERAL WILLIAM J. DONOVAN, SELECTED OSS DOCUMENTS, 1941-1945 MICROFILM ROLL LIST AND INDEX RECORD GROUP 226 ENTRY 180, File 57-58”, korrespondencë e Donovan-it me Brennan, me subjekt H. T. Fultz, 8/5/44, fq.3. E aksesueshme në <https://www.archives.gov/files/iëg/declassified-records/rg-226-oss/directors-microfilm-roll-list.pdf>.

<sup>31</sup> Marrë nga intervista e A. Tare, titulluar “Misioni im në Shqipëri” – Intervistë me Kapiten James HUDSON për misionin e tij në Shqipëri gjatë viteve të luftës së dytë botërore”, botuar në Gazetën “SHQIP”, 2012. Pyetjes së intervistuesit nqs Fultz e kishte instruktuar për të krijuar një rrjet spiunazhi, që do të përdorej edhe pas Luftës Nacional – Çlirimtare, Hudson i përgjigjet se pavarësisht se ai asnjëherë nuk ia kishte shprehur në mënyrë eksplicite këtë gjë, ishte e nënkuptuar. Për më shumë, *shih*: intervistën e plotë, e aksesueshme në: <https://www.scribd.com/doc/145100586/MISIONI-IM-NE-SHQIPERI-Interviste-me-Kapiten-JAMES-HUDSON-per-misionin-e-tij-ne-Shqiperi-gjate-viteve-te-luftes-se-dyte-botrore>.

<sup>32</sup> *Shih*: Raportin e deklasifikuar të CIA-s në: <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/CIA-RDP91T01172R000300290022-1.pdf>.

<sup>33</sup> Raport i deklasifikuar nga CIA, i aksesueshem në

Në materialet e gjetura në dosjet e deklasifikuara të Sigurimit për grupin e inxhinierëve dhe për Harry Fultzin, deri tani nuk ka rezultuar asnjë provë e drejtpërdrejtë, e shkruar, që të mbështesë teorinë se këto rekrutime përfshinë edhe grupin e inxhinierëve të Maliqit. Ky fakt vërtetohet nga raportet survejuese të gjendura mbi lëvizjet dhe veprimtarinë e Fultzit, në të cilat nuk ka asnjë gjurmë të takimeve të tij me ndonjë prej inxhinierëve apo me Zyrika Manon, e cila u akuzua si ndërlidhësja mes tyre.

Duke iu referuar përsëri rrëfimit të James Hudson të përmendur më lart, pyetjes nëse kishte ndonjë të vërtetë në faktin se Enver Hoxha e akuzonte Fultzin se ai ishte një spiun i amerikanëve dhe se përdorte ish-studentët e tij për të mbledhur informacione, ai i përgjigjet se të paktën deri në vitin 1944, Fultzi ishte dakord me marrëveshjen apo me vendimin e anglezëve për të pajisur partizanët me armatime kundrejt Ballit Kombëtar. Ai pohon se Fultzi ishte një njeri shumë serioz, i përkushtuar ndaj punës së tij dhe më e rëndësishmja, *“ai ishte “një djalë Tirane”, ai kishte jetuar në Tiranë dhe e njihje mirë qeverinë. Ai nuk ishte tipi i Hoxhës. Atë nuk do ta shihje nëpër male, ishte një djalë qyteti i shkolluar, i mprehtë dhe shumë i zgjuar. Nuk më la në asnjë moment përshtypjen se pas luftës do të bënte diçka kundër dikujt. Mendoj se ai po luante drejt dhe ishte pjesë e ushtrisë amerikane, duke u munduar të fitonte luftën.”*

Ekziston një fotografi shumë domethënëse e Fultzit, e shkrepur jashtë ndërtesës së shkollës Teknike në vitin 1945, ku ai është i rrethuar nga dyzet prej studentëve të tij të mëparshëm, disa të veshur me uniformën partizane. Pa kaluar shumë kohë pasi ishte bërë fotografia, Fultzit iu desh të dëshmonte sesi studentët e tij po vrisnin njëri-tjetrin. Në një letër drejtuar një kolegu të tij në kohën e gjyqit të grupit të inxhinierëve, Fultzi vuri në dukje se kreu i Gjykatës së Lartë Ushtarake në Tiranë, që kishte qenë një prej të diplomuarve në shkollën e Fultzit, kryesonte dënimin e 37 burrave të akuzuar si armiq të popullit dhe njëkohësisht ish-nxënës të shkollës së tij”.<sup>34</sup>

Dënimi i grupit “sabotator” të Kënetës së Maliqit u konsiderua një sukses politik nga ana e Sigurimit të Shtetit, siç rezulton nga një shkresë adresuar Seksionit të Sigurimit në Korçë nga Ministria e Punëve të Brendshme.<sup>35</sup>

Menjëherë pas shpalljes së vendimit për të dënuar grupin e inxhinierëve, Departamenti Amerikan i Shtetit nxori një deklaratë ku kategorikisht mohonte pohimet e bëra në gjyq, e

---

[https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/OBOPUS%20BGFIEND%20%20%20VOL.%2014%20%20\(BGFIEND%20OPERATIONS\)\\_0078.pdf](https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/OBOPUS%20BGFIEND%20%20%20VOL.%2014%20%20(BGFIEND%20OPERATIONS)_0078.pdf)

<sup>34</sup>Po aty, P. Lucas, *The OSS in World War II Albania ...*, f. 187.

<sup>35</sup> Dosja Formulare Nr.1080/2, “Kujtim Ali Beqiri”, Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit, Nr.Regj.557, Kategoria IIB TEPËR SEKRET, deklasifikuar me vendimin Nr.2, dt.16.06.2017 nga AIDSSH, fq.44-45.

publikuar në buletinin mujor të këtij Departamenti: *“Gjykimet (e inxhinierëve) që po ndodhin në Tiranë janë padyshim një përpjekje e regjimit shqiptar për të përjetësuar veten me anë të shtypjes dhe terrorizimit të elementeve liberale, patriotike dhe opozitare shqiptare. Akuza se të akuzuarit ishin të lidhur me anë të pagesës ose shërbimit ndaj Shteteve të Bashkuara, apo të ndonjë përfaqësuesi të saj në Shqipëri nuk ka ndodhur në asnjë mënyrë dhe është krejtësisht e pavërtetë”*<sup>36</sup>.

Në ndryshim nga pjesëtarët e tjerë të misionit, (si p.sh. Jacobs, që e konsideronte eksperiencën e tij në Shqipëri si “purgator Ballkanik” dhe vazhdimisht riafirmonte besimin e tij se “ditëve të tij në Shqipëri po u vinte fundi.” “Pas një viti që po merrem me ta, - vazhdonte ai, - nuk mundem dot më”), Harry Fultzi dëshironte ende të qëndronte, duke u quajtur kështu nga kolegët e tij si “ai i cili e kërkon me zor ndëshkimin”.

Në zbatim të politikës së qeverisë, Sigurimi i Shtetit u soll ashpër ndaj pjesëtarëve të misionit amerikan, gjatë largimit të tyre nga porti i Durrësit në nëntor 1946. Kjo dëshmohet nga një letër e gruas së Henderson (pasardhësi i Fultzit në detyrë për shumë pak muaj përpara se SHBA ta tërhiqte misionin amerikan përfundimisht nga Shqipëria), drejtuar një mikut të saj në Departamentin Amerikan të Shtetit. Aty përshkruhen peripecitë e hequra, që nga flakja e plaçkave të tyre me forcë në anije, deri te keqtrajtimi fizik i vajzës së Fultz-it, Joana<sup>37</sup>, me qëllim denigrimin e tyre moral.

Në mes të nëntorit 1946, kur misioni amerikan u largua nga Tirana, pjesëtarët e tij do t'i referoheshin Qeverisë së atëhershme si "barbare", "e pamëshirshme" dhe "e paskrupullt". Menjëherë pas ngjarjes në Shqipëri, anëtarët e misionit amerikan u drejtuan drejt Liberisë, ku në foton më sipër është fotografuar edhe Fultzi bashkë me të bijën.

#### **4. Përfundime**

Pavarësisht faktit se elementë të regjimit komunist shqiptar ndryshonin nga regjimet e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore e si i tillë ai regjim mund të quhej unik, vetëm për Shqipërinë, përsëri mund të nxjerrim mësim të rëndësishme universale. Mësimi kryesor është potenciali i tmerrshëm që mund të ketë “demonizimi” i personit për shkak të ideologjisë së urrejtjes të sanksionuar nga shteti. Ky mësim i përbuzjes apo ky proces dehumanizimi, siç ishte

---

<sup>36</sup>Shih: Jakov Aleksandrovich Malik., Department of State Bulletin, Nov. 17, 1946.

<sup>37</sup> Letra është botuar në AMERICAN FOREIGN SERVICE JOURNAL, VOL. 24, NO. 1, Janar 1947, THE NATIONAL WAR COLLEGE, WASHINGTON, D.C, fq.33, 52.

E aksesueshme në:[http://www.afsa.org/sites/default/files/fsj-1947-01-january\\_0.pdf](http://www.afsa.org/sites/default/files/fsj-1947-01-january_0.pdf)

lufta e klasave, ishte baza e persekutimit dhe e internimit të mijëra personave si dhe shkelja sistematike e të drejtave të tyre më thelbësore.

Shqipëria ende ndodhet sot relativisht në mes të procesit të demokratizimit të saj, ashtu si në hapat e parë drejt objektivit të anëtarësimit në Bashkimin Europian. Për këtë arsye, duhet të respektojë dhe inkurajojë angazhimin për të përkujtuar viktimat e regjimit komunist, për të respektuar të mbijetuarit e tij dhe për të riafirmuar aspiratën e përbashkët për solidaritet dhe drejtësi.

## Kujtesa dhe historia në diskursin post-totalitar

### Abstrakt

Punimi trajton çështje aktuale si përballja e shoqërisë shqiptare me qasjen ndaj së kaluarës komuniste totalitare; në ç'mënyrë drejtohem tek e kaluara; vëmendja ndaj dëshmimeve të mbijetuarve të terrorit komunist; raportet e reja ekzistenciale mes historisë dhe kujtesës; dallimi kujtesë-histori; krijimi i një shoqërie ku dinjiteti i personit të përbëjë parimin themelor të ndërtimit të institucioneve të reja demokratike dhe të shtetit të së drejtës; përse çdo histori është një histori bashkëkohore, siç shprehej Kroçe. Orientimi nga një analizë shkencore e së kaluarës nevojitet për rindërtimin shpirtëror të brezave të rinj dhe të atyre që kanë njohur vetëm një histori të manipuluar, atë zyrtare komuniste.

*« Ne që kemi jetuar nga kampet e përqendrimit nuk jemi dëshmitarët e vërtetë. Është një ide shqetësuese, me të cilën unë jam bashkuar pak nga pak duke lexuar atë që të mbijetuar të tjerë kanë shkruar, përfshirë dhe mua, kur unë kam lexuar shkrimet e mia pas disa vitesh. Ne, të mbijetuarit, jemi vetëm një minoritet i parëndësishëm, por ama të jashtëzakonshëm. Ne jemi ata që shkelja e detyrës, shkathtësia ose shansi që na ka ndihmuar, nuk e prekëm kurrë fundin. Ata që e prekën dhe që panë fytyrën e Gorgonës, nuk u kthyen prej andej, ose u kthyen pa fjalë »*

Primo Levi

Shpërthimi i kujtimeve nga ana e viktimave të komunizmit dhe diskutimet ndërmjet historianëve shtrojnë dy pyetje të rëndësishme, prej të cilave varet kuptimi i kohës sonë. Një pyetje është me natyrë faktike: çfarë vendi zë kujtesa dhe historia në kulturën tonë? Pyetja tjetër është e natyrës teorike: cili duhet të jetë kuadri konceptual ku vendosen refleksionet tona?

Nga përgjigjja e këtyre pyetjeve thelbësore varet ajo, që në gjuhën filozofike quhet kuptimi i thelbit shpirtëror të epokës sonë. Kështu, analiza dhe kapja e thelbit shpirtëror të një epoke bëhet një detyrë, për të cilën punojnë historiani, përmes investigimit kritik të fakteve dhe filozofi përmes imagjinatës teorike, detyrë për të cilën historiani duhet të bëhet filozof dhe filozofi historian. Këtu historiani gjen përfundimin e një kërkimi thelbësor të konfigurimeve të mëdha historike dhe filozofi gjen më shumë bazën dhe presupozimet që i mundësojnë atij të formojë normat dhe gjykimet vlerore, përmes të cilave do të vlerësojë realizimet e një epoke. Kjo detyrë imponohet për çdo të tashme, sado komplekse qoftë ajo. Sigurisht gjërat janë shumë të thjeshta për epokat e hershme, perspektivat e të cilës janë bërë më të qarta, por një e tashme si kjo e jona e bën këtë detyrë edhe më urgjente, pavarësisht vështirësive dhe rezervat që ajo nxit. Përmes kësaj rruge ne do të jemi në gjendje që të përcaktojmë edhe Shqipëri, jo në

kuptimin gjeografik të termit, pasi vetëm kështu ne mund të veprojmë ndaj të tashmes. Shkurt ne kemi nevojë për një vetëreflektim për të kuptuar qenien e të qenurit tonë.

Që të kuptojmë botën tonë të sotme, kjo nënkupton të kuptojmë se si kjo botë shpirtërore post-totalitare lidhet me forcat e botës së kaluar, forca që janë ende në veprim, por që sot synojnë të paraqiten në një formë të re shpirtërore. Për këtë qëllim, kjo botë moderne duhet kapur në gjenezën e saj dhe kondensimin e saj progresiv. E parë në mënyrë të thjeshtë dhe për t'i ikur çdo reflektimi, siç ndodh nga disa, mund të thuhet se kjo botë post-totalitare përbën një formacion mjaft kompleks. Entuziastët e progresit, ashtu si dhe kundërshtarët konservatorë e paraqesin këtë kohë si një unitet, por ndërsa të parët duan ta kurorëzojnë siç stoliset koka e një zoti, të tjerët duan ta shkelin me këmbë, siç shtypet koka e një gjarpri. Në të vërtetë, bota e sotme përshkohet nga kundërshti dhe tensione, të cilat mund të shpjegohen si produkt praktik të një bashkimi aspektesh dhe rrethanash nga më të ndryshmet.

Për të kuptuar këtë botën tonë, ku vihen re kaq urrejtje dhe shpirtra të trazuar, duhet që ta copëtojmë në pjesë më të vogla, dhe për secilën prej tyre të tregojmë se si format moderne veprojnë mbi jetën tonë dhe mbi shpirtin e të gjithëve, pasi është veprimi i bashkuar dhe reciprok i këtyre pjesëve që prodhojnë sinteza relativisht të bashkuara, si prirjet kulturore, programet, partitë, drejtimet shpirtërore. Për këtë duhet ndalur edhe në përbërësit më të thjeshtë dhe fluidë, domethënë ato që lidhen me etikën, fenë dhe vizionin mbi botën, mbi të renë dhe të vjetrën. Parimet e mëdha dhe të qëndrueshme ndodhen nga ana praktike dhe institucionale, në formacionet politike, sociale dhe ekonomike, ndërsa komponentët që lidhen me opinionin dhe ndjenjat, ndodhen më shumë tek instiktivja dhe gjysmë e ndërgjegjshmja, në format e përditshme të jetës, si dhe në imazhet e artit, ato që i japin shprehje jetësore instinktit dhe e mbajnë edhe atje ku ndërgjegjja arrin një nivel shumë të lartë. Duke marrë parasysh të kaluarën tonë të afërt totalitare dhe të tashmen tonë bëhet imperative një jetë mendore për ta kuptuar thelbin shpirtëror të epokës tonë, me qëllim që njerëzit të mos mbesin më viktima të mashtrimit dhe të vetëmashtrimit. Me pak fjalë, ne përsëri ndodhemi para detyrës, e shtruar që në vitet '30, por e ndërprerë brutalisht gjatë regjimit totalitar, për një *rilindje të jetës mendore*.

Në filozofinë e historisë është kthyer në maksimum se, që të kuptojmë se çfarë jemi, më parë duhet të mësojmë se çfarë kemi qenë dhe çfarë kemi bërë. Që të kuptojmë se çfarë kemi qenë, duhet të njohim të menduarit në të kaluarën tonë. Që në vitin 1932, kur fliste për riorganizimin e sistemit tonë arsimor, Branko Merxhani do të shkruante: “Misioni ynë është të pastrojmë nga gurët e nga gjëmbat udhët që shpien në rilindjen mendore të popullit” (Branko Merxhani, 2003, f. 117), pasi “jemi krejt të çveshur në pikëpamjen shoqërore dhe krejt të varfër në pikëpamjen mendore”. Natyrisht, kjo kërkonte që të bëhej diagnostikimi i të keqes, sepse pa



këtë diagnostikim nuk mund të gjendeshin ilaçet për ta shëruar këtë të keqe. Me të drejtë ata theksonin se vërtetimi i të keqes, është më i dobishëm nga sundimi i lirë dhe i pa fre i së rremes, kjo i lartëson njerëzit dhe kombet dhe jo vetglorifikimi romantik. Sigurisht, më 1912, ne përfunduam rilindjen kombëtare, por çfarë bëmë për rilindjen tonë mendore? Ata kishin realizuar, në këndvështrimin e tyre, se kombet përparonin kur zhvillonin një jetë mendore të gjallë dhe aktive.

Është e qartë se rilindësit i përmbushën detyrat për rilindjen dhe pavarësinë kombëtare. Mendimtarët e viteve '30 deshën të ndërmerrnin veprën e rilindjes mendore. Ata e kuptuan se pavarësia dhe liria do të mbeteshin të kërcënuara për aq kohë sa nuk do të fillohej me rilindjen mendore të popullit, pa krijuar një jetë mendore. Rilindja mendore e një populli është një punë shumë e vështirë dhe kërkon edhe kurajë intelektuale, pasi të vërtetat nuk u pëlqejnë njerëzve që duan të dëgjojnë vetëm gjëra të bukura dhe preferojnë të përkunden në djepin e iluzionit dhe të vetglorifikimit shterp mendor, mbeten skllëvër të paragjykimeve dhe kështu mund të veprojnë lirshëm “zuzarët e errësirës”. Ata e kërkonin rilindjen e jetës mendore për ta futur Shqipërinë në rrethin e popujve të qytetëruar. Por, çdo të thotë të krijosh një jetë mendore? Le ta dëgjojmë përgjigjen nga B. Merxhani, pasi është tepër aktuale. “Dhe jetë mendore do të thotë për Shqipëri, jo krijim shfaqjesh tipografike, as ngrehje qendrash dëfrimesh, pa princip, por çap, kurajo për gjurmim shkencor, serioz, të vazhduar, për analizimin dhe shpjegimin e vonesave historike dhe sociologjike të jetës kombëtare. Vetëm mbi një punë të tillë mund të mbështetet mendimi dhe sistemi i reformave. Dhe vetëm pas një zbatimi besnik të kësaj pune, do të mundemi dhe ne të hyjmë një ditë në qarkun e popujve të qytetëruar” (Branko Merxhani, 2003, f. 20). E thënë në mënyrë filozofike, jeta mendore jona do të thotë që të kuptojmë qenien e të qenurit tonë, që do të thotë që ta hedhim vështrimin brenda vetes tonë, “brenda në Unën tonë shoqërore”, do të shprehej Merxhani. Kjo do të thotë se rrugët që na shpien në thellësi dhe në rrënjët e ekzistencës sonë hapen vetëm përmes një pune mendore. E thënë ndryshe, ne ende kemi nevojë që të reflektojmë dhe të njohim sa më mirë kushtet dhe mënyrën tonë të ekzistencës. Shkurt, mbetet ende shumë punë për të krijuar një “Shqipëri mendonjëse”. Një “Shqipëri mendonjëse” krijohet në qoftë se mbahet parasysh edhe një kusht tjetër, nderimi për bindjet e të tjerëve. Por edhe këtu ndeshim një të metë tjetër, që Anton Harapi e shpreh qartë kur shkruan: “Po t’ia bajmë diagnozën shpirtit të shqyptarit në skajin ma të fundëm, kemi për të gjetë këtë fenomen të çuditshëm: kush nuk mendon si unë, thotë, ai asht kundërshtari em. Ky paravendim antishoqruer shfaqet jo vetëm në lamën fetare, politike e shoqërore, por dhe në lamën diturore”. (Anton Harapi, 1999, f. 331). Ky digresion në të kaluarën tonë tregon nevojën për shoqërinë tonë, sidomos për të rinjtë, që të mos i largohen mendimit, pasi ky është rreziku

më i madh që i kërcënon jo vetëm shoqëritë moderne, por sidomos shoqëritë posttotalitare, pasi kohë të tilla favorizojnë daljen e sharlatanëve, jo vetëm në politikë, por edhe në fushat e tjera të dijes dhe, ca më keq, daljen e “politikanëve të birrarive”, siç shprehej Niçe.

Kjo domosdoshmëri e të menduarit dhe të gjykuarit është një domosdoshmëri për shoqëritë posttotalitare, jo vetëm për të parë marrëdhëniet me të kaluarën, por edhe për të ditur si të organizohet liria e sapofituar dhe kjo nuk është thjesht një çështje njohjeje. “Shfaqja e erës së mendimit, shkruante Hannah Arendt më 1971, nuk është njohja; është aftësia për të thënë atë që është e drejtë dhe atë që nuk është e drejtë, atë që është e bukur dhe atë që është e shëmtuar. Dhe kjo mund të pengojë katastrofat, të paktën për unin, në momentet kryesore”. (Hannah Arendt, 2009, f. 246). Në fakt, koha jonë ka nxjerrë termin “detyra e kujtesës”, por del pyetja: Nga vjen kjo shprehje? Si është imponuar në gjuhën tonë të përditshme? Vetë përdorimi i këtij termi na tregon se ndodhemi në terrenin moral, pra të gjykimit.

Situata të ngjashme prodhojnë po ashtu mënyra të menduari të ngjashme. E tillë është edhe mendësia që shfaqet në periudhat posttotalitare, ndaj të cilave ja vlen të marrim në shqyrtim disa mendësi që Arendt kritikon në Gjermaninë e pas luftës, por që kanë ngjashmëri edhe me disa mendësi që janë shfaqur në diskursin tonë pas rënies së regjimit komunist. Një mendësi që ajo kritikon bazohet në tezën se askush nuk mund të gjykojë, ndërkohë që nuk ka qenë prezent. Pra, çështja mbi të drejtën ose aftësinë për të gjykuar prek çështjen morale më të rëndësishme. Këtu dalin dy pyetje: së pari, si mund të them unë se çfarë është e drejtë ose e padrejtë, në qoftë se shumica ose gjithë ambienti im është paragjykses ndaj përgjigjes? *Kush jam unë për të gjykuar?* Së dyti, në çfarë mase mundemi ne t'i gjykojmë ngjarjet ose rrethanat, në të cilat ne nuk ishim prezent? Kjo e dyta, thotë Arendt, shoqërohet edhe me një akuzë arrogante, në kuptimin se duke gjykuar një veprim të keq a presupozon kjo se unë nuk do të isha i aftë ta bëja? Ajo kritikon një frikë në shoqëri për të gjykuar që nuk ka asnjë lidhje me thënien biblike: “Mos gjyko, në qoftë se ti nuk do të gjykohesh”. Mirëpo, nën këtë refuzim për të gjykuar, nënkupton të thuash: “Ne jemi të gjithë njëjloj, të gjithë po aq të këqinj dhe ata që përpiqen ose pretendojnë të përpiqen që të jenë pak të përshtatshëm janë ose shenjtorë ose hipokritë; në të dy rastet atë duhet të na lenë” (Arendt, 1971, f. 60). Ky tip argumenti e shfaqëson ngjarjen ose aktorin veprues duke i bërë thirrje tendencave historike, ose lëvizjeve dialektike, pra një lloj domosdoshmërie misterioze që qëndron pas shpinës së njerëzve. Kështu, për të justifikuar veprimet e Hitlerit shkohet te Platoni, Giocchino da Fiore, te Hegeli ose te Niçe, ose te shkenca dhe teknologjia moderne, ose te nihilizmi apo Revolucioni Francez dhe gjithçka shkon për bukuri. Kjo mënyrë arsyetimi bazohet në konceptin e fajësisë kolektive, mirëpo në qoftë se të gjithë janë të fajshëm, atëherë askush nuk është i fajshëm. “Ajo që unë dua të tregoj,

shkruan Arendt për këtë formë arsytimi,... është fakti se deri në çfarë pike duhet të jetë e thellë frika për të dhënë një gjykim, për të dhënë emra dhe për të shpallur një gabim – për fat të keq, veçanërisht ndaj njerëzve që kanë qenë në pushtet ose të rëndësishëm, që kanë vdekur ose që janë gjallë – në qoftë se i bëjmë thirrje këtij lloj manovrash intelektuale të dëshpëruara” (Hannah Arendt, 1971, f. 61). Edhe justifikimet që i bëjnë thirrje të drejtës kur kanë ndodhur ngjarjet dhe kur kanë vepruar këta individë nuk ka bazë, pasi problemet juridike dhe ato morale nuk janë të njëjta, por kanë afërsi me njëra-tjetrën pasi presupozojnë fuqinë për të gjykuar. Për më tepër, kjo formë arsytimi synon shmangien ndaj përgjegjësisë personale, prandaj Arendt, ndaj këtij argumenti konkludon: “Nuk ekziston aspak diçka e tillë si fajësia kolektive ose pafajësia kolektive; fajësia ose pafajësia kanë kuptim vetëm të zbatuara ndaj individëve” (Arendt, 1971, f. 70).

Argument tjetër, ndërmjet shumë të tjerëve, që ja vlen të theksohet, por që ndeshet shumë edhe në diskursin tonë, është ai se ata kanë zbatuar urdhrat që vinin nga lart, pra ishin pjesë e ingranazhit të pushtetit dhe nuk mund të dilnin dot jashtë tij. Arsytimi është i njëjtë për çdo organizim shoqëror; çdo organizim kërkon që t’i bindesh drejtuesve të lartë si dhe ligjeve të vendit. Në këtë kuptim bindja është një virtyt politik dhe pa të asnjë trup politik nuk do të mund të mbijetonte. Liria e ndërgjegjes pa shtrëngim nuk ekziston asgjëkund. Për më tepër, çdo qeveri bazohet te pëlqimi i qytetarëve, madje edhe tiranitë. Ku qëndron sofizmi i këtij arsytimi? Gabimi, thotë Arendt, qëndron në ekuacionin ndërmjet pëlqimit dhe bindjes. Përdorimi që i bëjmë fjalës “bindje” na vjen nga koncepti i vjetër politik, që nga Platoni dhe Aristoteli, që na thotë se çdo trup politik përbëhet nga qeveritarë dhe të qeverisur, të parët japin urdhra dhe të dytët duhet të binden. Në kontekstin tonë, kjo do të thotë se çdo njeri, ciladoqoftë forca e tij, nuk mund të realizojë diçka, të drejtë apo të padrejtë, pa ndihmën e tjetrit. Gjejmë këtu nocionin e barazisë: shefi është *primus inter pares*, i pari ndërmjet të barabartëve. Ka pasur njerëz, nën diktaturë, që nuk kanë pranuar të jenë pjesë e ingranazhit të pushtetit, por a do të thotë se ata janë të papërgjegjshëm? “Është e lehtë të imagjinohet, shkruan Arendt në veprën *Përgjegjësia dhe gjykimi*, se çfarë do të ndodhte në secilën nga këto forma qeverisjeje në qoftë se shumë njerëz do të kishin vepruar në mënyrë të “papërgjegjshme” dhe të kishin refuzuar mbështetjen e tyre, edhe pa rezistencë dhe as rebelim dhe do të shikonin se sa armë efikase do të ishte ky qëndrim” (Hannah Arendt, 1971, f. 90). Prandaj, përfundon ajo, pyetja që duhet t’u shtrohet atyre që kanë marrë pjesë dhe u janë bindur urdhrave nuk duhet të jetë: “Përse jeni bindur?” por: “Përse keni dhënë mbështetjen tuaj?” Ky ndryshim verbal nuk është pa rëndësi semantike për ata që e njohin ndikimin e fortë që ushtrojnë fjalët mbi shpirtin e njerëzve, që janë kafshë që flasin. Dhe përfundimi i Arendt mbetet shumë aktual për të tashmen dhe të

ardhmen. “Do të fitohej shumë nëse do të eliminohej nga fjalori i mendimit tonë moral dhe politik kjo fjalë e dëmshme ‘bindje’. Në qoftë se ne do i shikonim këto çështje imtësisht, ne do të mund të rigjenim një besim të caktuar te ne dhe madje një lloj krenarie, domethënë atë që dikur quhej dinjitet ose nder i njeriut: ndoshta, jo për llojin njerëzor, por të statusit të të qenurit njeri” (Arendt, 1971, f. 91).

Si t’i shikojmë kujtesën dhe historinë? Fillimisht e rëndësishme është që të bëhet dallimi ndërmjet « kujtesës » dhe « historisë ». Kjo çështje, pas Luftës II Botërore, nuk trajtohet më në mënyrë pozitiviste, por ka një qasje fenomenologjike. Fenomenologjia e kujtesës, sipas Ricoeur, presupozon një strukturë rreth dy pyetjeve: *Për çfarë ka kujtime? Për kë është kujtesa?* E para mund të përcaktohet si një marrëdhënie empirike, në pjesën më të madhe irracionale dhe e nënkuptuar, që shoqëria vendos me të kaluarën e saj, ndërkohë që historia është një ndërmarrje racionale dhe shpjeguese për qartësimin e kësaj marrëdhënieje. Ciladoqoftë shkalla e shkencëtarisë të prodhimit historik, historia racionalizohet, ajo është rezultat i punës së dijetarit në një kuadër institucional. Sigurisht, historia që prodhohet nga historianët, është një pikturë imagjinare për të kaluarën, por ky konstruksion i nënshtrohet rregullave që synojnë objektivitetin, në mos përshtatshmërinë e dijes me objektin në studim, të paktën si objektivizim i një procedure të caktuar. Konstruksioni historik, përmes shumë përpjekjesh, materializohet në librat e historisë që i shkojnë publikut të gjerë dhe në manuale shkollorë, që hyjnë në shkollë. Kjo është më se e qartë. Përkundrazi, « kujtesa kolektive » është një koncept që ka nevojë për analizë, por që ka parasysh një realitet të vështirë për t’u kapur, sidomos kur shtrohet çështja se si ndërtohet ajo. Një nga aspektet themelore të kësaj çështjeje është që të kuptohet se cili është roli i historisë në këtë konstruksion, gjë që shtron problemin e edukimit historik, problem shumë i mprehtë mbas përmbykses së regjimit komunist, kur njerëzit ishin mësuar me « historinë objektive » zyrtare. Këtu vlen të bëhet një sqarim. Kur kritikojmë “historinë objektive” komuniste, kjo nuk nënkupton se objektiviteti nuk kërkohet në histori. Nisur nga analiza e Paul Ricoeur, objektiviteti duhet kuptuar në sensin strikt epistemologjik; domethënë është objektiv një produkt, që mendimi metodik e ka përpunuar, e ka rregulluar dhe e ka bërë të kuptueshme. Në këtë kuptim, ne presim nga historia që ajo të na fusë te e kaluara e shoqërive njerëzore me të njëjtin dinjitet objektiviteti si edhe shkencat e natyrës. “Kjo pritshmëri, shkruan Ricoeur në veprën *Historia dhe e vërteta*, implikon një tjetër: ne presim nga historiani një cilësi të caktuar subjektiviteti, jo një subjektivitet çfarëdo, por një subjektivitet që të jetë saktësisht i përshtatshëm me objektivitetin që i përshtatet historisë. Pra, këtu bëhet fjalë për një subjektivitet të implikuar, të implikuar përmes objektivitetit të pritshëm. Për pasojë, ne parashtrijmë se ka një subjektivitet të mirë dhe një të keq dhe ne presim një vendim mbi subjektivitetin e mirë dhe

të keq, përmes vetë ushtrimit të zanatit të historianit” (Paul Ricoeur, 1967, f. 28). Pra, ka një sintezë historike, sepse, më së pari, historia është një analizë dhe jo një kohëzgjatje emocionale. Vlen të theksohet ky element epistemologjik, po të shikojmë se rolin e historianit e kanë marrë të gjithë, përfshirë dhe gazetarë dhe opinionistë.

Për qartësimin e këtij diskutimi dallimi ndërmjet kujtesës dhe historisë është i domosdoshëm, megjithëse, në praktikë, ky dallim është tepër i vështirë. Ashtu si historia kontribuon në ndërtimin e kujtesës, praktika e historianit lidhet pashmangësisht me kujtesën e shoqërisë prej nga ka dalë. Siç shprehet Paul Ricoeur, “dëshmia përbën strukturën thelbësore të kalimit ndërmjet kujtesës dhe historisë” (Paul Ricoeur, 2000, f. 26).

Gjithashtu duhet kuptuar edhe marrëdhënia ndërmjet dëshmitarit dhe personit që merret me mbledhjen e dëshmive. Me qëllim që dëshmitari të japë dëshminë e tij, i duhet një bashkëbisedues i besueshëm, pranë të cilit ai ndjehet në siguri gjatë kohës së dëshmisë. Mbledhësi i dëshmive është pikërisht ky bashkëbisedues që i siguron dëshmitarit se fjala e tij nuk do të jetë pa jehonë dhe nuk do të bjerë në të njëjtin boshllëk si ai që ka vuajtur gjatë persekutimeve. Nocioni i dëshmimbledhësit tregon një funksion aktiv që nuk konsiston vetëm në marrjen e dëshmisë, të lehtësojë tregimin e dëshmitarit përmes një prezence të angazhuar miqësore në këtë çast të rëndësishëm. Dëshmitari dhe dëshmimbledhësi janë të lidhur me një lloj pakti që mund të quhet « pakt dëshmues » dhe që paraqitet si një kontratë morale ndërmjet dy palëve, në angazhimin e dëshmitarit për të dhënë një tregim sa më të vërtetë që të jetë e mundur që bëhet gjatë angazhimit etik të dëshmimbledhësit për të lehtësuar ligjërimin e dëshmitarit. Ai që pranon të bëhet dëshmitar i dëshmitarit duhet të dijë se rrezikon të futet në një rrugë të ngushtë ndërmjet nevojash komplekse dhe shpesh kontradiktore të dëshmitarit dhe pamundësisë së pjesshme, në të cilën ai do të duhet të japë përgjigje. Në këtë kuptim mund të thuhet se dëshmimbledhësi është një figurë e pamundshme, pasi i kapur ndërmjet dëshirës së tij për reparacion ndaj vuajtjes së dëshmitarit dhe vështirësisë së misionit të tij, ai shpesh mund të ndihet i padobishëm, i frustruar, sepse nuk po ja del mbanë që ta çlirojë dëshmitarin nga barra e tij. Megjithatë, ai duhet të pranojë të përdoret nga dëshmitari, duke e lënë mënjanë narcizizmin e vet.

Ndërsa për dëshmitarin, ky është një çast i rëndësishëm, pasi edhe pse mund ta përsërisë ose ta ketë për herë të parë, dhe ai shpreson të dëgjohet në mënyrë sa më të drejtë dhe pa pasur frikë. Marrëdhënia ndërmjet dëshmitarit dhe dëshmimbledhësit përbën një sfidë për të dy palët, sepse duke u ndërtuar në formë dialogu, dëshmia duhet të ndërtohet në rrugën e reciprocitetit dhe empatisë, të cilat i kanë munguar dëshmitarit gjatë persekutimeve. Dhe në këtë takim, mbledhësi i dëshmive përbën gurin e themelit, detyra delikate e të cilit konsiston, para së

gjithash, që të bëhet i « ngjashëm me të afërmin e vet ». E theksojmë këtë moment, pasi mbledhja e dëshmimeve i është lënë spontaneitetit, ose personave që nuk kanë njohuritë e duhura shkencore dhe komunikative.

Për më tepër, forca dhe veçanësia e diskutimeve të të mbijetuarve shqetëson edhe një bashkësi që dëshiron normalitetin dhe harresën, ndërkohë që jeton një realitet dramatik në të tashmen. Kjo kohë nuk është e lehtë për askënd dhe shumë njerëz përshkohen nga një ndjenjë fajësie, ndërkohë që fajtorët e vërtetë nuk e pranojnë fajësinë e tyre. Pra, historia e detyrës së kujtesës shkruhet në fushën e historisë së kohës së tashme. Ajo ve në skenë aktorë, shumica e të cilëve janë ende gjallë, shkruhen nga një autor që i përket të njëjtës kohë si ata dhe ve në shenjë një objekt që është në fuqi. Një veçanësi e tillë ka edhe pasoja sociale dhe politike, prandaj ka edhe shumë debate. Origjina e termit “detyrë e kujtesës” lidhet me detyrën e të mbijetuarve nga kampet e vdekjes për të dëshmuar eksperiencën e këtyre kampeve. Shpesh origjina e këtij termi i akordohet shkrimtarit italian Primo Levi, i mbijetuar i kampeve të shfarosjes, si një thirrje ndaj të mbijetuarve për të dëshmuar. Por, pas viteve '90, ky term ka hyrë në diskursin europian dhe të drejtën europiane. Kështu, në larminë e diskutimeve dhe debateve në lidhje me marrëdhënien ndërmjet kujtesës dhe historisë është e domosdoshme të sqarohet përmbajtja e këtyre termave.

Historia, në fakt, përfaqëson një proces të njohjes të së kaluarës, e cila synon një kuptim dhe interpretim të së kaluarës, qoftë kjo një e kaluar e largët apo e afërt, bazuar mbi analizën e gjurmëve të të gjitha llojeve të mbetura nga aktiviteti njerëzor. Ajo shkruhet me pikëpamje, këndvështrime si dhe në përgjigje të pyetjeve të shumta dhe të larmishme. Por, në kushtet e lirisë, mund të kemi një histori zyrtare që zë vendin kryesor në gazeta, ose bankat e shkollës, histori diplomatësh, politikanësh, gjeneralësh, të dënuar apo të padënuar gjatë regjimit komunist, të cilat bien ndesh me botime individuale historish subjektive që bazohen në një kujtesë fragmentare, të mbushur me emocione se sa arsytime, të burrave dhe grave, që të japin përshtypjen se ata më shumë i kanë pësuar ngjarjet se sa kanë marrë pjesë në këto ngjarje. Në këtë pikëpamje, historia mund të shikohet më shumë si arti për t'i folur të kaluarës se sa të një shkence mbi të kaluarën. Në këtë shpërthim kujtimesh, historia ka forcën që t'i bëjë ato të transmetueshme përmes shpjegimit.

Kujtesa gjithnjë e më shumë po pushton hapësirën publike. Madje, marrëdhënia ndërmjet të kaluarës dhe të tashmes është bërë një element përcaktues i përkatësisë ndaj një komuniteti. Nga pikëpamja psikologjike mund të flitet për një “kujtesë negative” që bën të mundur dallimin e kujtimeve të mira, që lidhen me emocione pozitive, nga ato të këqija, që lidhen me emocione të këqija. Por, kujtesa historike lidhet më shumë me ngjarjet e dhunshme

(luftëra, masakra...) se sa me progresin e njerëzimit. Kështu, në histori, “kujtesa negative” ka të bëjë me politika ose veprime publike që lidhen me të kaluarën dhe që mbajnë gjallë kujtimin e një krimi, ndaj të cilit një bashkësi është, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përgjegjës ose fajtor dhe se ajo duhet të ketë turp dhe se duhet ta riparojë në një farë mënyre. Kjo kujtesë është negative nga përmbajtja, por pozitive nga objektivat qytetare dhe morale. Prandaj bëhet e domosdoshme “detyra e kujtesës”. Nëse në fillim kjo detyrë kishte të bënte me gjenocidin ndaj hebrenjve, pas viteve '90, detyra e kujtesës mori edhe një objektiv pedagogjik: të njohë gjeneratat e reja me krimet e regjimit totalitar, me qëllim që ata të mos harrojnë dhe të veprojnë ndaj racizmit, ksenofobisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kështu, dëshmia e viktimës ka rëndësi edhe si një virtyt terapeutik si për çdo njeri ashtu edhe për shoqërinë. Për historianin, Pierre Nora, i pari që e përdori këtë shprehje, me detyrë të kujtesës nuk duhet të kuptojmë një lloj borxhi ndaj të vdekurve, se sa si një detyrë ndaj humbjes së shpejtë të njohurive për të kaluarën e afërt. Në fillim, detyra e kujtesës kishte të bënte me detyrimin për ta parë në sy shkatërrimin e hebrenjve në Europë dhe lidhej me imperativin e një drejtësie përmes akteve konkrete: ndjekjen penale dhe dënimin e kriminelëve. Pas viteve '90, kjo shprehje përmbledh shumë problematika, pranimin e krimeve të së kaluarës, proceset, përkujtimin, borxhin ndaj të vdekurve, dëshmitë individuale, detyrën e transmetimit të kësaj të kaluarë (shkolla, memorialet) dhe ruajtjen e kësaj trashëgimie.

Prandaj, detyra e kujtesës është bërë një “formulë” si për historianët, ashtu edhe për median dhe politikën. Kjo shprehje është bërë shumë prezente në shtypin e shkruar, në televizione, në radio, pra në tërë hapësirën publike, por ajo nuk duhet të mbetet një komoditet gjuhësor nga aktorë dhe kontekste të ndryshme, por duhet ndalur seriozisht, politikisht dhe juridikisht, nëse duam një përtëritje shpirtërore të njerëzve.

Sigurisht, bartësit e këtyre kujtimeve (dëshmitarët, përfaqësuesit e një komuniteti etj.) ndikojnë në punën e historianëve, prandaj, tashmë, historia shkruhet edhe nën presionin e kujtesës kolektive dhe mund të ndikojnë në interpretimet e tyre, por është gabim të shkruhet një histori nën interesat e çastit të tashëm. Është e qartë se asnjë histori nuk mund të shkruhet pa marrë në konsideratë kujtimet. Historiani nuk duhet t'i shmangë, sepse ato janë një objekt për historinë, por puna e tij konsiston në kapërcimin e tyre. Historiani nuk është një gjyqtar. Kjo do të thotë se më shumë se sa detyra e kujtesës, kemi nevojë për të vërtetën dhe analizën kritike. Kështu, kujtesa përmban njëherazi “refuzimin e harresës” dhe dëshirën për të ditur në detaje atë që ka ndodhur. Vetëm në këtë mënyrë puna e kujtesës nuk mbetet një mësim morali pompoz, nëse nuk shoqërohet nga detyra për të vërtetën. Detyra e kujtesës nuk konsiston në një homazh ndaj viktimave të regjimit diktatorial, por të qartësohen në mënyrë sa më shkencore të

mundshme realitetet historike si kanë ndodhur ngjarjet (konteksti, aspektet, shkaqet, pasojat...), sepse të kujtosh një ngjarje nuk shërben për asgjë, edhe me shqetësimin që ngjarje të tilla të mos përsëriten, nëse këto ngjarje nuk shpjegohen. Në qoftë se ne duam që të jemi aktorë të përgjegjshëm për të ardhmen tonë, ne më së pari, duhet të kemi një detyrë historike. Këtij procesi duhet t'i bashkëngjiten edhe politikat për kujtesën, çështje kjo që kërkon trajtim të veçantë.

Në mënyrë skematike kemi tri kujtesa që ndërveprojnë: kujtesa historike, kujtesa orale nga tradita dhe kujtesa kolektive. Nisur nga pluraliteti i kohëve dhe historive, mund të thuhet se nuk ekziston një "kalendar" i vetëm, por disa, sipas individëve dhe grupeve shoqërore dhe kulturore. Kjo do të thotë, për historianin, se nuk ka kujtime të kulluara. Të gjitha kujtimet janë rikonstruksione që përcaktohen edhe nga përkatësitë sociale, të kaluara dhe të tashme, madje edhe koncepti ngjarje historike është relativ, por historiani përpiqet që ta shikojë jashtë interesave dhe pasioneve. Kur flasim për pasionet ne kalojmë në nivel tjetër, gjë që do të thotë se duhet të merret parasysh dhe e pandërgjegjshmja, pra edhe psikoanalitika. Në këtë aspekt, për historianin ka rëndësi depërtimi në anën e errët të qenies humane. Në jetën e individëve, të popujve dhe kombeve, plagët sedimentohen ndërkohë që minutat, muajt, vitet dhe shekujt kalojnë, por ato nuk zhduken kurrë nga e pandërgjegjshmja. Pra, e kaluara është prezente te ne te e pandërgjegjshmja, janë këto gjurmë të së kaluarës që organizojnë një kujtim, apo kujtimet, që mbajnë emocionet dhe modelojnë format e dëshirës. Në qoftë se do të shpreheshim me gjuhën psikoanalitike, zgjidhja individuale, ose sociale e ndrydhjes mund të marrë forma sublimimi (si zëvendësimi i një objekti seksual nga një objekt joseksual) të muzika, arti, letërsia dhe realizimet e tjera sociale dhe humanitare.

Në këtë aspekt, edhe puna e historianit ngjan me atë të psikoanalistit. Ata e trajtojnë kujtesën si gjurmë të së ndrydhurës që ata duan ta zbulojnë. Kështu, për ne kujtesa më e dukshme është ajo e të kaluarës komuniste, por kemi shfaqje që na vinë nga mbi-uni (censurat individuale, por edhe ato sociale, historia zyrtare që diktojnë se çfarë duhet thënë). Kështu, formohen kujtime-ekran që funksionojnë si censura ndaj kujtimeve të tjera nga e kaluara. Pikërisht, këto kujtime-ekran funksionojnë si mbi-unë, domethënë ato grumbullohen te e pandërgjegjshmja, të gjitha ato kujtime që mund të bien ndesh me vizionin korrekt, shpesh politikisht dhe shoqërisht të pranueshme, nga e kaluara. Por, edhe në këtë rast mbetemi në gjendjen e fajësisë, pasi, edhe pse të ndrydhura, këto kujtime nuk zhduken. Kjo perspektivë duhet mbajtur parasysh për të kuptuar skizofrenitë sociale që edhe mund të përsëriten nëse harrohen.



Kështu, historianit i bie detyra që t'i kapë këto kujtime nën formën që i paraqiten atij, si dokumentet e shkruara - që dalin nga pushteti shtetëror ose institucionet e tjera, shtypi, kujtimet e shkruara të dëshmitarëve, intervistat, poemat, tregimet, romanet, këngët, muzika dhe ai duhet të punojë me to si për çfarëdolloj dokumenti. Në fakt, çdo dokument duhet parë nga historiani si bartës kujtese, domethënë ia nënshtron kritikës së metodës historike: kritikës nga jashtë (Dokumenti është i vërtetë apo i rremë? Nëse është i rremë, nga çfarë lloj falsifikimi rrjedh?, por edhe kritikës së brendshme (A është vetë dokumenti mashtrues? A na mashtron ai? Në qoftë se po, pse?). Kjo punë duhet shoqëruar edhe me konfrontimin me dokumente të tjera, me qëllim krahasimi për ta bërë historinë sa më produktive, në sensin historik të termit. Sigurisht, që kjo punë duhet kryer jashtë presioneve politike dhe ideologjike, të cilat janë ende të forta në shoqërinë tonë posttotalitare dhe çdo kërkuesi i duhet të përballet me historinë zyrtare të dikurshme. Në të vërtetë, vepra e historianit nuk ka asgjë të përbashkët me apologjinë.

Natyrshëm del pyetja: përse duhet ta lodhim mendjen për gjithë këto gjëra? Përgjigjja është për dy arsye: për të krijuar një « Shqipëri mendonjëse » dhe për të ndërtuar një jetë sa më dinjitoze në kushtet e lirisë së sapofituar. Kjo bëhet imperative edhe për t'u distancuar nga një e kaluar që është ende prezente rreth nesh dhe ngandonjëherë edhe brenda nesh. Por, përballë transformimeve të domosdoshme, që ne duhet të kuptojmë, ne nuk duhet të kërkojmë revansh. Duhet që lidhja me të keqen të zgjidhet nga një moment në tjetrin. Kjo nuk nënkupton refuzimin e të keqes, por të kalojmë në ndjekjen e të mirës. Ne duhet të frymëzohemi nga shembujt e atyre që luftuan për lirinë dhe deshën ta ndriçonin popullin. Të gjithë popujt e qytetëruar europianë kanë kërkuar ringritjen shpirtërore për t'u përballur me të keqen. Këtë gjë shtroi Hyserli në vitin 1936, me qëllim që Europa të mos binte në një barbari të re, prandaj ai kërkoi një ripërtëritje të re shpirtërore duke iu kthyer filozofisë, duke filluar që nga filozofia e lashtë. Edhe ne duhet të kërkojmë një ripërtëritje të re shpirtërore dhe kjo mund të realizohet përmes punës së secilit mbi baza të reja konceptuale, bazuar në idenë se çdo qenie njerëzore është një vlerë absolute, në kuptimin se njeriu është më shumë nga ajo që dihet rreth tij, se tipari themelor i njeriut është liria.

Realizimi i kësaj lirie kërkon edhe një kurajë të lartë dhe, në qoftë se ne nuk do e kemi këtë kurajë, jo vetëm kombi, por edhe njeriu do të humbasë. Ne, si njerëz të lirë, duhet të kërkojmë së bashku daljen e të vërtetës. Sigurisht ne duhet t'ia nënshtrojmë të kaluarën kritikës sa më të ashpër, por me një *apriori* të simpatisë për njeri tjetrin. Një nga rrugët për të realizuar një shoqëri të lirë është edhe historia. Kjo do të thotë se liria nuk lind nga hiçi. Ajo nuk është as arbitrare, as një opinion i padrejtë. Liria realizohet vetëm në nënshtrimin ndaj të vërtetës. Po kështu, nuk ka një paqe sociale pa liri, por nuk ka as liri pa të vërtetë. Kjo duhet të përbëjë pikën

themelore në arsyetimet tona rreth të kaluarës dhe të vërtetës së saj. Në qoftë se ne duam lirinë dhe paqen, ne duhet të qëndrojmë në terrenin e të vërtetës, e cila është e papajtueshme me një qëndrim partizan apo personal. Kjo është arsyeja pse Kroçe, historinë që shkruhej nën frymëzimin e një pikëpamjeje të caktuar, qoftë ajo marksiste, iluministe, romantike etj., e quante histori partizane dhe jo histori shkencore. Ne kemi vuajtur nga historitë partizane. Le të fillojmë ta kuptojmë historinë tonë në përgjithësi dhe atë të kaluarës komuniste në veçanti. Pra, në qoftë se duam të jemi të lirë dhe të vërtetë, ne duhet të kthehemi te ky terren i përbashkët, pasi këtu ne mbetemi solidarë edhe kur ne kundërshtojmë njëri-tjetrin.

E vërteta nuk qëndron, para së gjithash, te përmbajtja, por edhe te mënyra se si mendohet përmbajtja, si përcaktohet dhe diskutohet. E thënë filozofikisht, në mënyrën e të menduarit të arsyes. Kjo e vërtetë pushon së qeni nga momenti që secili qëndron me kokëfortësi në pozicionin e vet, nga momenti që komunikimi ndërpritet. I kemi shembujt përditë në faqet e gazetave dhe debatet televizive. Prej këtej buron një atmosferë e helmuar, atmosferë që karakterizohet nga frika se asgjë nuk do të qartësohet, formohet një lloj solidariteti i ngushtë ku vetëm një opinion është i mirë dhe gjithë opinionet e tjerë skandalozë. Krijohen pulsione negative, që duket në gjuhën e egër të rrjeteve sociale dhe në media, dhe ata që duan të thotë të vërtetën duket sikur ndodhen para një muri. Por, edhe të heshtësh për të vërtetën, atëherë gënjeshtria do të mbijetojë. Në qoftë se duam të jemi të përgjegjshëm për të ardhmen, kjo kalon vetëm përmes rrugës së lirisë dhe të vërtetës, qoftë ajo e hidhur për disa.

Por, këtu ndeshemi me problemin e faljes. Shumë të paktë kanë qenë ata që kanë kërkuar falje për mizoritë e kryera. Meqë shembujt janë shumë të rrallë, nuk na mbetet gjë tjetër veçse ta trajtojmë filozofikisht këtë çështje, dhe jo rastësisht epilogu i veprës së Paul Ricoeur ka një refleksion mbi faljen. Në qoftë se gabimi përbën shkakun për falje, kjo e fundit i jep tonin tërë diskutimit tonë dhe ky ton « është ai i një eskatologjie të paraqitjes së të kaluarës. Falja, në qoftë se ka sens dhe në qoftë se ekziston, ajo përbën horizontin e përbashkët të kujtesës, historisë dhe harresës... trajektoria e faljes e merr origjinën në disproporcionin që ekziston ndërmjet dy poleve të fajit dhe të faljes... Ky polaritet është thelbësor në ekuacionin e faljes: poshtë pohimi i fajit, në lartësi himni i faljes » (Ricoeur, 2000, f. 593). Duke qenë një problem ekzistencial i vështirë, kjo sipas tij, përcakton edhe pamundësinë e institucioneve politike autentike të faljes. Por, kjo nuk e pengon një shoqëri demokratike që të përballlet me këtë problem, ashtu siç theksohet në Rekomandimin 1283 (1996) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Në rastin tonë na intereson reflektimi filozofik mbi faljen dhe të reflektuarit ndaj faljes, me shpresën se ky refleksion do t'i lehtësojë shumë shpirta të trazuar në shoqërinë tonë posttotalitare.

Sipas Ricoeur, mund të ketë falje vetëm aty ku mund të akuzohet dikush, prezumohet ose deklarohet fajtor. Marrja e përgjegjësisë së fajit kërkon pohimin e fajit, por ky akt lidhet me rikujtimin. Pa u ndalur në një fenomenologji të kujtesës, e rëndësishme është pohimi i fajit, përmes karakterizimit të fajit si një e keqe, sigurisht e keqe morale, por gjithsesi mbetet një e keqe. Në këtë çiftëzim të fajit dhe të keqes, referimi ndaj të keqes sugjeron idenë e një eksesi, e diçkaje të pasuportueshme, të së keqes që njeriu bën ndaj tjetrit dhe që shkon drejt « ligësisë intime të kriminelit ». Këto mizori të kryera ndaj njeriut, pasojat e të cilave janë të pariparueshme dhe ndaj tyre nuk mund të aplikohet parimi i parashkrueshmërisë penale, apo pafajësia nga pikëpamja e gjykimit moral. Në qoftë se faji qëndron kaq poshtë, në çfarë lartësie vendoset falja? Në qoftë se faji, në një regjim të tillë e meriton fjalën « i pafalshëm », kjo fjalë zbatohet edhe ndaj lidhjes që bashkon vepruesin dhe veprimin, fajtorin në krim. Prandaj, sipas Ricoeur, « Edhe në qoftë se fajësia nuk është fillestare, ajo është përherë radikale. Është kjo lidhje e fajësisë me kushtin njerëzor që e bën jo vetëm të pafalshme në fakt, por të pafalshme edhe nga e drejta » (Ricoeur, 2000, f. 603). Kjo është arsyeja pse parimi i parashkrueshmërisë që përdoret në të drejtën penale, nuk ka vend ndaj krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit. Në qoftë se ky parim penal nuk duhet të shtrihet ndaj këtyre krimeve, kjo do të thotë se përjashtohet një parim që pengon ushtrimin e veprimit publik. Duke e hequr afatin e ndjekjes së një krimi, parimi i paparashkrueshmërisë autorizon ndjekjen pafundësisht të autorëve të krimeve të mëdha. Shkurt, falja, që është një veprim moral shumë i lartë krahasuar me poshtërinë e krimit, nuk mund të ratifikojë pandëshkueshmërinë, pasi kjo do të ishte një padrejtësi tjetër akoma më e madhe në dëm të ligjit dhe më shumë akoma në dëm të viktimave. Konfuzioni krijohet edhe nga fakti se përballë madhësisë së krimeve nuk mund të zbatohet parimi i proporcionit që rregullon marrëdhëniet ndërmjet shkallës së krimit dhe ndëshkimit. « Nuk ka një ndëshkim të përshtatshëm ndaj një krimi disproporcional. Në këtë kuptim, të tilla krime përbëjnë një të pafalshme faktike » (Po aty, f. 613).

Këtu vlen të sqarohet edhe nocioni i përgjegjësisë politike të qytetarëve si dhe politikën e përgjegjësisë kriminale të gjykuara nga gjykatat. Kjo rezulton nga përkatësia faktike e qytetarëve në trupin politik, nën emrin e të cilit kanë qenë kryer krimet. Në këtë sens mund të flitet për përgjegjësi kolektive « në kushtin që të mos kriminalizohet: nocioni i popullit kriminal duhet të flaket qartësisht. Por, kjo lloj fajësie i angazhon anëtarët e bashkësisë politike, pavarësisht akteve të tyre individuale ose shkallës së përfshirjes së tyre në politikën shtetërore. Kush ka përfituar nga privilegjet e rendit publik, në një farë mënyre duhet të përgjigjet ndaj të këqijave të krijuara nga shteti, pjesë e të cilit ai ishte » (Ricoeur, 2000, f. 615). Ky është një parim shumë i vlefshëm për të kuptuar përpjekjet që vihen re për të shfajësuar nomenklaturën

komuniste duke ia kaluar përgjegjësinë vetëm diktatorit. Mbas përmbysjes së komunizmit gjithçka u mbulua me parullën « Të gjithë bashkëvuajtës, të gjithë fajtorë ». Në këto raste, më i rëndësishëm se ndëshkimi, por edhe reparacioni, është fjala e drejtësisë që përcakton publikisht përgjegjësitë e secilit nga protagonistët dhe përcakton vendet respektive të agresorit dhe të viktimës në raport me një distancë të drejtë.

Kur flasim për përgjegjësinë morale këtu ndalet përgjegjësia kolektive e natyrës politike dhe fillon përgjegjësia personale. Ricoeur bashkohet me Jaspersin, i cili në një ese « Fajësia gjermane », shkruante: « Instanca kompetente është ndërgjegjja individuale, është komunikimi me mikun dhe të afërmin, me vëllain njerëzor të aftë për të dashur dhe për t'u interesuar për shpirtin tim » (Ricoeur, 2000, f. 616). Pse këto dy përgjegjësi janë të ndara ? Sepse kolektiviteti nuk ka ndërgjegje morale. Megjithatë mbeten disa pyetje: A mund të falet ai që nuk e pranon fajin e tij ? A duhet ai që jep faljen të jetë i ofenduar? A mund të falet vetvetja? Jemi ende në kohë që të përballemi me këto pyetje ekzistenciale me qëllim që të krijohet një jetë e denjë për t'u jetuar, të mos qahemi ndaj historisë sonë, por ta mendojmë të kaluarën tonë dhe kështu do të krijojmë një "Shqipëri mendonjëse". Në vend që të qahemi ndaj historisë, le të bashkohemi me fjalët e Paul Ricoeur: "Atëherë, a do të flasim ne për një histori fatkeqe? Nuk e di. Por unë nuk do të thosha: histori fatkeqe. Në fakt, ka një privilegj që nuk duhet t'i refuzohet historisë, ai që jo vetëm e zgjeron kujtesën kolektive përtej çdo kujtimi afektiv, por për të korrigjuar, për të kritikuar, madje të përgënjeshtrojë kujtesën e një bashkësie të caktuar, kur ajo mblidhet dhe mbyllet nën vuajtjet e veta deri në pikën sa bëhet i verbër dhe shurdh ndaj vuajtjeve të komuniteteve të tjera. Është në rrugën e kritikës historike që kujtesa takon sensin e drejtësisë. Çfarë do të ishte një kujtesë e lumtur nëse nuk do të ishte gjithashtu një kujtesë e drejtë?" (Ricoeur, 2000, f. 650).

## Bibliografia

Paul Ricoeur, *Histoire, mémoire, oubli*, Paris, Le Seuil, 2000.

Paul Ricoeur, *Histoire et Vérité*, Paris, Le Seuil, 1967.

Paul Ricoeur, *Parcours de la reconnaissance*, Gallimard, 2004.

Henry Rousso, *Hantise du passé*, Paris, Textuel, 1998.

Pierre Nora, *Les lieux de mémoire*, Paris, Gallimard, 1993.

Hannah Arendt, *Responsabilité et jugement*, Payot & Rivages, Paris, 2005.

*GERMAN ESSAYS ON HISTORY*, Continuum, New York, 1991.

Branko Merxhani, *Vepra*, Plejad, Tiranë, 2003.

Anton Harapi, *Kulla e Babelit*, Phoenix, 1999.

*Plagët tona*, Dija, 2000.

Gjergj Sinani, *Filozofia e historisë*, SHBLU, 1999.

## Enriketa Pandlejmoni (Papa) - Universiteti i Tiranës

### Kujtesa dhe rrëfimi i historive jetësore mbi kampet e punës së detyruar, internimet dhe burgjet në Shqipërinë Komuniste

#### Abstrakt

Kujtesa kulturore e shprehur në tekste, ceremoni, imazhe, arkitekturë, monumente, etj, ofron një narrativë publike të ngjarjeve historike. Rrëfimet jetësore të ish-të burgosurve politikë analizohen për të rikonstruktuar të vërtetën e persekutimit komunist dhe një qasje të re drejt kujtesës historike.

#### *Historia dhe kujtesa në shoqërinë posttotalitare*

Kohët e fundit në Shqipëri ka disa përpjekje nga institucione të ndryshme publike, shkencore apo OJF të ndryshme për t'u marrë me komunizmin dhe rishikimin e periudhës komuniste në Shqipëri nga këndvështrime të reja bazuar kryesisht në materiale të reja arkivore, por bazuar dhe nga qasje të ndryshme shkencore. Në prill 2018, historiani shqiptar i mesjetës Pëllumb Xhufi,<sup>1</sup> rihapi debatin mbi periudhën komuniste si dhe mbi vendet e kujtesës, për shkak të deklaratave të tij mbi kushtet në kampin e punës së detyruar të Tepelenës. Deklaratat e Xhufit u pasuan nga një numër artikujsh dhe debatesh televizive mbi komunizmin në Shqipëri dhe kampet e punës së detyruar dhe burgjet. Nga këto konstatime duket se shoqëria shqiptare është tejet sensitive kundrejt së shkuarës së saj komuniste. Kjo ishte konstatuar më parë edhe nga përfundimet e anketës së kryer nga Prezenca e OSBE në Shqipëri,<sup>2</sup> ku u theksua nevoja për ndërtimin e një diskursi më të gjerë mbi të kaluarën komuniste të Shqipërisë, i cili vazhdon të paraqitet si një nga diskurset më polarizuese dhe kontroversiale mbi kulturën e kujtesës në Evropë. Ndërsa disa vende të ish Bllokut Lindor e kanë përdorur të kaluarën e tyre për të ndërtuar identitetet kombëtare, të tjera vende tentojnë drejt krijimit të kujtesave nostalgjike të jetës përgjatë komunizmit. Disa qeveri në fillim të rënies së Perdes së Hekurt e përkrahën dhe e nxitën investigimin e krimeve të komunizmit në vendet e tyre, ndërsa në disa vende të tjera u vu re një lloj mohimi dhe idealizimi të asaj periudhe.

Sot ka një numër të madh të studimeve mbi kujtesën, në kuptimin që i ka dhënë historiani francez Pierre Nora, *lieux de memoire* apo “vende të kujtesës”,<sup>3</sup> të ekspozuara përmes monumenteve, memorialeve dhe veprave të artit, si dhe në librat shkollorë. Qasja e Noras mbi

<sup>1</sup> Më 2 prill 2018, historiani shqiptar Pëllumb Xhufi deklaroi gjatë një emisioni televiziv, se kushtet në Kampin e punës së detyruar në Tepelenë nuk ishin dhe aq të këqia, në krahasim me kushtet e Shqipërisë së atëhershme.

<sup>2</sup> Citizens understanding and perceptions of the Communist past in Albania and expectations for the future. [online: <https://www.osce.org/albania/286821?download=true>].

<sup>3</sup> Pierre Nora (ed.), *Les lieux de memoire*, 7 vols. (Paris: Gallimard, 1984).

kujtesën gjeti përhapje ndër shumicën e studiuesve që merren me memorien dhe madje, shërbeu dhe në “konstruimin e identiteteve nacionale”. Sot ka edhe qasje të tjera, të cilat edhe e kundërshtojnë Nora, por prapë qasja e tij mbetet ndër kryesoret, kur duam të konfigurojmë dhe ndërtojmë të kaluarën.

Pas rënies së komunizmit, në të dy anët e Perdes së Hekurt, u duk një lloj boom-i në shpërthimin e kujtimeve mbi atë periudhë. Si kujtimet personale dhe ato kolektive u çliruan nga kufizimet që shteti i mëparshëm kishte vënë, në kuptimin e ideve “mik-armik”, të asociuara me Luftën e Ftohtë.<sup>4</sup> Ndaj rikthimi tek studimet mbi kujtesën kanë ndodhur në shumë plane dhe në shumë nivele dhe gjithmonë mbeten një “*nachholende Prozess*” në ndërtimin e kujtesës së mbarë kombit, ku përfshihen të gjitha llojet e kujtesave.<sup>5</sup> Trajtimi i së kaluarës së një shoqërie posttotalitare kërkon së pari të institucionalizohet kërkimi shkencor nëpër institucione shkencore apo qendra kërkimore që trajtojnë të kaluarën. Por, siç ka shkruar dhe Todorova, për Evropën Lindore duket se euforia që u vu re pas fundit të socializmit – hapja e arkivave, shpërthimi i kujtesave, parashikimet jomodeste, por as entuziaste mbi zhvillimin e një revolucioni historik – do të ndodhte kudo në Evropën Lindore. Por, nga çka ndodhur që atëherë, kjo nuk ndodhi.<sup>6</sup> Sot ende mbetet shumë për t’u bërë në kërkimet shkencore, qoftë nga ana përshkrimore, por dhe kualitative në gjithë Evropën Lindore.<sup>7</sup>

Në kuadër të rishkrimit të historisë, pas rënies së komunizmit në Evropën Lindore, sipas Haider kujtesa mbetet një fushë e rëndësishme, kur duam të kuptojmë të kaluarën. Kujtesa, ndërgjegjja historike dhe identiteti janë të pasqyruara dhe të krijuara madje, në ato që dokumentohen dhe shkruhen në tekstet e historisë, dhe sidomos në tekstet shkollore.<sup>8</sup> Por ky proces i rishkrimit të historisë dhe të të kuptuarit të së kaluarës komuniste në Evropën Lindore mbetet ende një proces i ngadaltë dhe tepër sensitiv. “Rikthimi i historisë” në Evropën Lindore kërkonte që të zbulohej e kaluara ashtu siç kishte ndodhur vërtetë (*eigentlich gewesen*), duke dekonstruktuar narrativën e vetme komuniste. Një proces ky tejet sfidues, plot me ambiguitete që rezultoi fillimisht në një “harresë” të së shkuarës komuniste, më pas në rishikime e rishkrime të shumta së të kaluarës, ku siç ka pohuar Judt, rezulton se e kaluara nuk do të dukej më e njëjtë

---

<sup>4</sup>Jan-Werner Müller, ‘Introduction: The power of memory, the memory of power and the power over memory’, in Jan-Werner Müller, *Memory and Power in Post-War Europe. Studies in the Presence of the Past*. (Cambridge University Press, 2004. 3-35. 19.

<sup>5</sup>Po aty, 37.

<sup>6</sup>Maria Todorova, Introduction. The Process of Remembering Communism, in Maria Todorova, *Remembering Communism. Genres of representation*, (New York 2010), 9-34, 9-10.

<sup>7</sup>Po aty.

<sup>8</sup>Haider, H. Rewriting history textbooks, in Stan L.; Nedelsky N. (eds.) *Encyclopedia of Transitional Justice*, Cambridge, Cambridge University Press.

si më parë në asnjë shtet.<sup>9</sup> Ndaj dhe Mazower në mënyrë ironike ka theksuar se, ndonjëherë është më lehtë të ëndërrosh ëndrrat e vjetra sesa të ëndërrosh nga e para, pasi mund të ndodhi që do të shfaqen edhe makthe dhe do të zgjohesh e do gjendesh para realiteteve të panjohura më parë.<sup>10</sup> Megjithatë në realitetet e reja të post-1989 natyra pluraliste e shoqërisë të ofron interpretime të ndryshme mbi të shkuarën, të cilat ndonjëherë mund të jenë edhe kontradiktore.<sup>11</sup>

Në Shqipëri kërkimi shkencor mbi komunizmin, kujtesën mbi të dhe vendet e kujtesës është ende në fillimet e tij. Literatura mbi komunizmin dhe kujtesën është e mangët dhe mund të përmblihet në artikuj gazetash dhe në botimet e ish të përndjekurve politikë.<sup>12</sup> Krimet e komunizmit nuk janë studiuar thellësisht dhe ndër studimet serioze mbi dhunën dhe terrorin komunist në Shqipëri mund të përmendim botimet e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, sidomos Enciklopedia e Viktimave të komunizmit në Shqipëri dhe kolana e botimeve të tyre.<sup>13</sup> Ndërsa studimi i komunizmit dhe i kujtesës mbi të nga këndvështrimi i studimeve kulturore konsiston vetëm në disa botime të fundit me intervista mbi kujtesën kolektive.<sup>14</sup> Por studime të tjera të qenësishme mbi komunizmin, të kaluarën komuniste dhe kujtesën ende mungojnë.

Duke pasur si fokus të studimit tim periudhën komuniste me interes ndjek herë pas here botimet e reja mbi periudhën komuniste, sidomos ato të karakterit bibliografik dhe memuaristik, këto të fundit sidomos botime të Institutit për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, si “Zërat e Kujtesës”, dokumentarët e ndryshëm me fokus rrëfimet jetësore mbi vuajtjet dhe terrorin në kampet e burgjet e komunizmit në Shqipëri si dhe intervistat që ish të burgosur politikë, ish të internuar politikë japin mbi atë periudhë. Por, si historiane gjithnjë kam një dilemë mbi mënyrën e rikonstruimit objektiv të së shkuarës komuniste në Shqipëri, duke e konsideruar si një nga periudhat më problematike e më delikate për t’u trajtuar nga konditat e sotme, posttotalitare të një shkence të lirë e të pacensuruar. Metodologjikisht ky rikonstruim

---

<sup>9</sup> Tony Judt, *The Past in another country; myth and memory in post-war Europe*, in Jan-Werner Müller, *Memory and Power in Post-War Europe. Studies in the Presence of the Past*. (Cambridge University Press, 2004, 157-183, 179.

<sup>10</sup> Mark Mazower, *Dark Continent: Europe’s Twentieth Century* (London: Penguin, 1998), 403.

<sup>11</sup> Gabriel Marin, *Tackling Agora Problems of the Present from Pandora’s toolbox of the past. How teaching history can democratize the ‘Other Europe’*, in Raluca Grosescu (ed.), *Teaching History of Communism in Eastern Europe. Compendium of Good Practices*, (Bucharest 2013), 15-36, 17.

<sup>12</sup> Uran Butka, *21 vjet burg komunist 1961-1982. Kujtime, mbresa, portrete dhe refleksione*, Tiranë, 2001; Amik Kasaruho, *Një ankth gjysmëshekullor: Shqipëria e Enver Hoxhës*, Tiranë: 1996; Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Tirane: 2007; Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Tirane: 2007; Tomor Aliko, *Genocidi gjysëm shekullor në Shqipëri*, Tiranë: 2010.

<sup>13</sup> *Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist* (Vol. I-V), Tiranë, 2015-2017.

<sup>14</sup> Fabian Kati, *Formësimi i kujtesës kolektive. Ngjarjet e Dukagjinit, Malësia e Madhe, Postrribë, 1945-1946*. Tiranë: UET Pres, 2015.



duhet të mbështetet në qasje multidisiplinore dhe kësisoj metodologjia e ndjekur në të është e gërshetuar nga analiza e diskurseve kryesore teorike mbi kujtesën dhe ndikimin e saj në procesin e të mbajturit mend dhe përkujtimit të së shkuarës nga grupet kolektive apo komunitetet etnike dhe kombëtare, nga qasja, jo vetëm e analizës së dokumenteve arkivore apo legjislativonit të kohës, por edhe mbi historitë gojore të bashkëkohësve të komunizmit në Shqipëri. Pra, nga kujtesa e njerëzve mbi komunizmin.

### ***Kujtesa dhe raporti me historinë***

Kujtesa historike karakterizohet nga ndryshimi i vazhdueshëm i kontekstit historik. Ndryshime ndodhin në shoqëri, në politikë, në mënyrën e jetesës, mentalitet dhe kjo shkakton nevojën e njerëzve për të zbuluar të kaluarën. Konstruktimi historik apo lidhjet/vendet e kujtesës nga ana tjetër janë të bazuara mbi faktet historike dhe rekonstruimin njerëzor. Pra, studimi i historisë apo i lidhjeve me vendet e kujtesës nuk është vetëm studimi i realitetit, por më shumë studim i realitetit të rikonstruktuar dhe bashkë me të dhe i asaj, sepse njerëzit rikrijojnë realitetin në mënyra të ndryshme. Riinterpretimi konstant i historisë sipas periudhave të ndryshme historike, ku disa heronj të një periudhe ktheheshin në armiq të një tjetre, apo e kundërta, të gjitha këto interpretime të vazhdueshme të historisë shqiptare mund të kthehen edhe në eksperiencë tronditëse për dikë që ka qenë gjallë dhe i ka përjetuar gjatë këto periudha të ndryshme historike, gjë që mund të shkaktojë edhe një mpirje/ngrirje të disa njerëzve përkundrejt interpretimeve të historisë. Nga ana tjetër, ky reflektim historik i kujtesës mbi të kaluarën është gjithashtu një burim i mirë i të kuptuarit të asaj që çfarë mendojnë njerëzit në të tashmen mbi të kaluarën e dhimbshme të komunizmit.

Kujtesa në vetvete, siç pohon, Geoffrey Cubitt mund të kuptohet në mënyra të ndryshme. Ajo mund të jetë shumë personale dhe individuale, por ajo mund të lidhet edhe me institucionet sociale dhe të ketë formë kulturore, për disa ajo është çka mbetet nga eksperiencat e së shkuarës, për të tjerë ajo është thjeshtë një rikonstruktim i eksperiencave të së shkuarës, por nga këndvështrimi i së tashmes.<sup>15</sup> Por, “historia” sipas Hegelit në studimin e tij “Leksione mbi Filozofinë e Historisë” përshtat dhe anën objektive dhe anën subjektive në rrëfenjën e saj. Jo më kot, sipas Hegelit, “pa kujtesën e së shkuarës nuk mund të ketë histori”, në kuptimin e ngjarjeve, të cilat janë domethënëse mbi eventet e përbashkëta të përjetuara nga një komunitet kolektiv i ndërgjegjshëm për ato ngjarje që kanë ndodhur në të kaluarën. Prandaj ndërgjegjësimi kolektiv nënkupton dhe një kujtesë të përbashkët, pasi pa të nuk mund të ekzistojnë as ligje as

---

<sup>15</sup> Cubitt, Geoffrey, *History and Memory*, Manchester University Press, 4.

drejtësia, as struktura politike dhe as objektiviteti kolektiv. Prandaj, përfundon Hegel, pa historinë, nuk ka histori, nuk ka shtet.<sup>16</sup>

Nga ky këndvështrim duket se kujtesa ka të bëjë së pari me fiksimin e ngjarjeve të së shkuarës dhe shkrimin e historisë. Pra, si i dimë informacionet mbi të kaluarën e largët nga perspektiva e kujtesës kolektive? Një nga burimet kryesore konsiston në materialet e shkruara, të cilat hedhin dritë mbi ato ngjarje që kanë ndodhur dikur, duke nxjerrë në pah dhe perceptimin e konceptuar në Lashtësi apo Mesjetë, se pa shkrimin nuk mund të ketë histori, aq më tepër që “ajo çka vlen të mbahet mend medoemos që do të jetë shkruar nga një dëshmitar, i cili konsiderohej atëherë si historiani më i mirë”.<sup>17</sup>

Njerëzit tentojnë të komunikojnë përmes kujtesës kolektive dhe kujtesa kulturore e një komuniteti kryesisht bazohet në tekste, në ceremoni, imazhe, arkitekturë dhe monumente, të hartuara për të kujtuar ngjarje të rëndësishme për këtë grup. Të gjitha këto memoriale sanksionohen nga instancat shtetërore, qeveria apo nga vetë komuniteti i qytetarëve. Kujtesa kulturore ofron kështu një narrativë publike të ngjarjeve historike, bazuar në versionet zyrtare të historisë, por edhe në ato versione multivokale, të vetë narratorëve të ngjarjeve. Këto narrativa historike plotësojnë nevojat për një histori të përbashkët, për një identitet të komunitetit dhe janë pjesë të rëndësishme në jetët e njerëzve dhe komuniteteve.

Por, nga historianët duket se në përgjithësi ka një lloj skepticizmi kur vjen puna tek trajtimi i së shkuarës bazuar edhe mbi studimet e kujtesës. Historianët theksojnë se, kujtesa është një proces rekonstruktivist, duke e ndërtuar të kaluarën nga perspektivat aktuale. Ndaj mendoj se kur duam të konstruktojmë të kaluarën, sidomos të kaluarën e një shoqërie totalitariste mendoj se metodologjikisht ka disa qasje që duhen cekur. Ndryshe do të hasim vështirësi në zbërthimin e kujtesës. Kështu, një aspekt përfshin analizën fenomenologjike të procesit të mbajturit mend, siç duhet konsideruar dhe saktësia dhe vërtetësia e të dhënave, të cilat rikujtohen në rrethana të caktuara. Tjetër është edhe analiza e formave të narrativave që përdoren në rikujtimin e ngjarjeve të së shkuarës. Me rëndësi po ashtu është edhe analiza e kontekstit social në të cilin njerëzit kujtojnë. Të gjitha këto analiza dhe shqyrtime gërshetohen në disa disiplina që kanë fokuse të ndryshme mbi kujtesën, duke e konsideruar kujtesën herë si diçka personale apo individuale, por ka dhe disiplina si historia p.sh. që e konsideron kujtesën

---

<sup>16</sup>G.H.F. Hegel, *Vorlesungen über die Philosophie der Geschichte*, Stuttgart, 1928, 97-98.

<sup>17</sup> Amos Frankenstein, “Collective Memory and Historical Consciousness”, *History and Memory*, Vol. 1, No. 1, 1989, 5-26. 5.

si subjektive apo ka dhe disiplina që e shohin kujtesën si diçka të jashtme, që nuk prek thelbin e fenomenit/ngjarjes që ka ndodhur në të shkuarën.<sup>18</sup>

Por a konsiston kujtesa vetëm në rizbulimin e atyre që kanë ndodhur vetëm me anë të shkrimit, apo ndodhin dhe procese të tjera mendore, konjitive e psikologjike, të cilat ngurtësojnë momente domethënëse të së kaluarës në ndërgjegjen individuale apo më gjerë, në ndërgjegjen kolektive të një grupi, etnie, kombi? Të mbajturit mend është një veprim mendor dhe kështu është personal dhe patjetër që në këtë proces duhet bërë dallimi midis asaj që mbajmë mend nga përvojat personale të ngjarjeve të së kaluarës dhe atyre që na injektohen nga burime të ndryshme informacioni mbi të kaluarën. Madje, as memoria e njerëzve okularë në ngjarje të përbashkëta nuk është e njëjtë, por varion nga individ në individ, bazuar dhe në perceptimet, ndjesitë dhe asociimet personale të gjithsecilit në ngjarjen në fjalë. Kujtesa kulturore i referohet kryesisht dimensionit të jashtëm të memories njerëzore, të cilën ne e konceptojmë si një memorie krejtësisht të brendshme – e lokalizuar brenda trurit të individit, përmbajtja e së cilës studiohet nga shkenca e encefatologjisë, neurologjisë apo psikologjisë dhe aspak nga studimet kulturore. Por, sipas Assmann, pikërisht përmbajtja e memories, mënyra se si memoriet organizohen, kohëzgjatja e tyre, janë më shumë jo pjesë e një magazinimi apo kontrolli të brendshëm, se sa kanë të bëjnë me kushtet e jashtme të imponuara nga shoqëria dhe nga konteksti kulturor.<sup>19</sup> Pra, kujtesa është një veprim mendor vetjak i ndërgjegjshëm, qoftë kur ka lidhje me ngjarje personale, qoftë me ngjarje të përbashkëta me shoqërinë ku jeton. Por, ama, në të gjithë procesin personal të të mbajturit mend, kujtesa mbi ngjarjet e së shkuarës nuk mund të shkëputet nga konteksti social, pasi identiteti personal i individit është ndërtuar mbi identitetin kolektiv social të komunitetit, etnisë, kombit të cilit i përket. Unë si person nuk jam i/e shkëputur nga komuniteti kolektiv të cilit i përkas dhe i gjithë identiteti im personal është i ndikuar nga institucionet sociale, shtetërore, kolektive dhe eventet, simbolet e përbashkëta, njerëzit me të cilët jam hasur në të qenit tim pjesëtar i një komuniteti të caktuar social. Ndërgjegjësimi im mbi të shkuarën ka lidhje me ndërgjegjësimin tim si anëtar/e i/e komunitetit social e kolektiv ku jam pjesë. Por, kujtesa individuale dhe lidhja e saj me ndërgjegjësimin kolektiv mbi të kaluarën sot në një periudhë postnacionaliste dhe multikulturore duket se nuk është patjetër e njëjtë. Prandaj dhe Pierre Nora e ngre problemin e kujtesës kolektive në varësi të periudhës dhe vendit, ku identiteti kolektiv sipas Nora nuk është më aq i qartë siç ka qenë më

---

<sup>18</sup> Cubitt, Geoffrey, *History and Memory*, Manchester University Press, 7.

<sup>19</sup> Jan Assmann, *Cultural Memory and Early Civilization. Writing, Remembrance, and Political Imagination*, Cambridge University Press, Cambridge, 2011, 5.

parë.<sup>20</sup> Ndaj, historia e kujtesës është shumë e rëndësishme jo vetëm për faktin se, ajo studion mënyrat se si e shkuara përfaqësohet sot, le të themi në një muze, por edhe me faktin se ajo merret edhe me studimin e mentalitetit të njerëzve në të shkuarën, mbi përzierjet fetare, praktikat dhe përfaqësimet simbolike, të cilat së bashku formojnë perceptimet e njerëzve mbi të kaluarën.<sup>21</sup> Nga ky këndvështrim, historia e kujtesës synon dhe rindërtimin e modeleve të sjelljes, të formave shprehëse dhe mënyrave të heshtjes, me të cilat kuptohen botëkuptimet dhe sensibilitetet kolektive. Elementët kryesorë janë edhe përfaqësimet, imazhet, mitet dhe vlerat e njohura dhe të toleruara nga grupet shoqërore apo nga e gjithë shoqëria, të cilat së bashku formojnë psikologjinë kolektive.<sup>22</sup>

### ***Historia gojore dhe kujtesa mbi të shkuarën***

Studiuesit që merren me historinë gojore fokusohen mbi mënyrat se si rikujtimet individuale inkuadrohen në shkrime dhe modele mendore. Prandaj dhe studimet mbi kujtesën lidhen edhe me studimet mbi historinë gojore. Studimet e historisë gojore patën një hov të zhvillimit të tyre përgjatë viteve 1970 me studimet e një sërë autorësh si, Ronald Grele, Luisa Passerini, Alessandro Portelli apo Michael Roper, studime të cilat shënojnë edhe një ndryshim epistemologjik të modelit interpretues të historisë gojore. Shumë historianë filluan t'i kushtojnë vëmendje formave të narracionit dhe dimensionit kreativ të rrëfjave gojore dhe u riorientuan në studimet e tyre mbi kujtesën, mbi të shkuarën nga shkencat sociale dhe kulturore. Ky ndryshim në metodologji u shfaq dhe në të ashtuquajturën “*linguistic turn*” (kthesa linguistike), qasje që merr në konsideratë edhe rolin e madh që gjuha dhe diskursi kulturor kishin në formimin e interpretimeve individuale të eksperiencave të së shkuarës.<sup>23</sup>

Megjithatë historia gojore si lëmi shkencor që ndërthur në fokusin e saj të studimit ndërdisiplinaritetin merret gjerësisht me kujtesën dhe rrëfimet e individëve mbi përjetimet e tyre. Historia gojore nuk interesohet thjesht për të zbuluar dhe analizuar burimet që përfshijnë kujtesën personale, por historianët që merren me *oral history* aktivizohen fuqishëm për ta përfshirë kujtesën si një evidencë (provë) dokumentare por fluide, e cila është një element intrigues në procesin historik, dhe ndaj të cilës studiuesit duhet të gjejnë mënyrat si t'i qasen.<sup>24</sup>

---

<sup>20</sup> Pierre Nora, “Between Memory and History: Les Lieux de Memoire”, *Representations* 26, 1989, 7-24.

<sup>21</sup>Po aty, 1389.

<sup>22</sup>Për më shumë mbi psikologjinë kolektive dhe mentalitetet shih studimin analitik të Robert Mandrou, *Historie/ L’Histoire des mentalités*, in *Encyclopaedia universalis*, Paris, 1971.

<sup>23</sup> Green, Anna 2004. Individual Remembering and ‘Collective memory’: Theoretical Presuppositions and Contemporary debates. *Oral History*, Vol 32, No. 2. *Memory and Society*, 35-44.

<sup>24</sup> Po aty.

Brenda studimeve të historisë gojore sot ka një tendencë për t'u përqendruar jo më mbi kontekstin individual, por mbi atë social dhe kulturor, në të cilin ndodh eventi. Kështu, historia gojore po konverton me studimet mbi kujtesën kolektive, në të cilën kujtesa individuale është e zhytur brenda kujtesës kolektive.

Studiuesit që merren me historinë gojore shikojnë tek memoriet e informantëve të tyre mjetet për të rikonstruktuar të kaluarën nga këndvështrime që neglizhohen nga master-narrativat e historianëve, nga historitë publike, apo nga ato që janë konsideruar nga Yerushalmi si “makineri të kujtesës”<sup>25</sup> si librat, filmat, muzetë, përvjetorët etj.<sup>26</sup>, që na ndihmojnë të formojmë njohuritë kulturore të përbashkëta dhe t'ua transmetojmë brezave pasardhës.

Siç ka pohuar një ndër historianet më me zë të historisë gojore, Luisa Passerini, “ajo që i intereson nuk është gjallëria e rikujtimit, jo aq saktësia ndaj realitetit të dala prej intervistave, të cilat do të ishin burime sekondare për një historian, por më shumë ajo që më intereson është versioni i historisë së treguar prej informantëve”.<sup>27</sup> Kështu, siç pohon antropologu Marc Augé eksperiencat e së kaluarës përballen me rrezikun e harresës, sipas të cilit ‘*memories are crafted by oblivion as the outlines of the shore are crafted by the sea*’. Augé diskuton mbi raportin e harresës dhe përkujtimit, duke theksuar dhe “detyrën” që pasardhësit kanë për të kujtuar dhe ruajtur të kaluarën e paraardhësve të tyre.<sup>28</sup> Ndaj kujtesat nuk shihen asnjëherë përfundimisht, ato lënë gjurmë dhe vazhdojnë të ndikojnë jo vetëm në sjelljen tonë, por edhe në mënyrën si kujtojmë.

Sot teoritë interpretuese të historisë gojore apo narratives jetësore konsistojnë në tre modele që interveprojnë me njëri-tjetrin, të cilat mund t'i kategorizojmë si kulturore, sociale dhe psikologjike. Modeli kulturor kryesisht analizon për shembull se si individët bazuar mbi mite arkitime formojnë dhe ndjekin zhanre/mënyra të veçanta të të treguarit të historisë dhe forma të caktuara narrative. Ky model bazohet, së pari, në teoritë antropologjike dhe letrare, sipas të cilave, mitet kulturorë dhe narrativa tradicionale në një farë mënyre influencojnë edhe ndërgjegjen historike, të shfaqur me format e të shprehurit gojor.<sup>29</sup> Por, megjithatë tjetër gjë është të “shpalosësh/zbulosh” narrativën individuale, duke përdorur metodologjinë e analizave kulturore; dhe tjetër gjë është të përcaktosh shkrimet publike kulturore, brenda të cilave duhet të përshtaten apo futen edhe narrativat individuale.

---

<sup>25</sup> Termi “makineri të kujtesës” është përdorur nga Yosef Haim Yerushalmi në studimin e tij mbi *Hebrenjtë dhe kujtesën*, Yerushalmi, Y H, Zakhor, Jewish History and Jewish Memory, Seattle, 1982.

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> Passerini, Luisa, *Autobiography of a Generation: Italy*, 1968 (Hanover, NH and London, 1996), 23.

<sup>28</sup> Augé, Marc, *Oblivion*, Minneapolis, 2004, 20.

<sup>29</sup> Samuel, Raphael; Thompson, Paul, *The Myths We Live*. London: Routledge, 1990.

Ndërsa modeli social dhe psikologjik i teorisë interpretuese të historisë gojore, kryesisht fokusohet mbi atë se në cilin kontekst rikujtimi ndodh, dhe mbi imperativa psikologjike të përbashkëta, të cilat janë në themel të konstruimit të historive mbi të kaluarën. Kjo kërkon që kujtesa individuale, tregimet personale mbi të shkuarën të mos jenë të izoluara nga narrativa publike, por madje të veprojnë sipas kësaj narrative.<sup>30</sup> Siç e përmend dhe Passarini, në jetën e përditshme, sidomos në regjimet totalitare, kemi të bëjmë me “nxitjen e memories fallse” nga ana e shtetit e publikes, të cilat prodhonin një kujtesë të homogjenizuar dhe artificiale,<sup>31</sup> përkundrejt asaj individuale pluraliste. Një nga pikat kyçe në diskutimet në studimet mbi historinë gojore është edhe lidhja midis memories individuale dhe përkujtimit publik. Pra e mënyrës se si formimi i modelit individual personal/individual influencohet dhe pranohet nga modeli publik mbi të shkuarën. Sipas Dawson, kompozimi subjektiv individual i ngjarjeve ndikohet edhe nga fuqia e faktit që duhet të konvertojë me versionet edhe të njerëzve të tjerë, pra me versionin “zyrtar” publik.<sup>32</sup>

### ***Rrëfimet e historive jetësore mbi kampet e punës së detyruar dhe burgjet komuniste***

Për ta konkretizuar teorinë me rikonstruktimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri, duhet të theksoj se, për të rikonstruktuar të kaluarën, qoftë dhe të një eventi të përveçëm për nga rëndësia historike, qoftë edhe të një eventi të dhimbshëm, siç mund të jetë rasti i Tepelenës, studiuesit duhet të marrin parasysh jo vetëm ato dokumente arkivorë, që i kanë mbijetuar amullisë së postkomunizmit në Shqipëri. Përkundrazi, në analizën historike duhet marrë parasysh edhe kujtesa mbi atë ngjarje apo historitë gojore mbi të kaluarën komuniste në Shqipëri.

Në rastin e kampit të Tepelenës duhet konsideruar dhe kujtesa e të mbijetuarve të tij, ajo që rëndom quhet “kujtesë kolektive” e grupit të “banorëve” të Tepelenës apo Kampit të Turanit. Kujtesa kolektive është një paraqitje e së kaluarës e një grupi apo komuniteti të përbashkët. Kujtesa është një pleksje kujtimesh individuale dhe kolektive të atyre ngjarjeve që individi mban mend vetë sa është gjallë në këtë jetë, por dhe shndërrohet në memorie kolektive dhe sociale, kur ngjarja në fjalë rikujtohet dhe rrëfëhet brenda komunitetit. Siç ka theksuar studiuesi gjerman, Jan Assmann, kujtesa sociale mbi një ngjarje apo event të së kaluarës do të

---

<sup>30</sup> Roper, Michael, Remembering the Soldier Hero: The Psychic and Social Construction of memory in Personal Narratives of the Great War, History Workshop Journal, no 50, 2000, p. 183.

<sup>31</sup> Passerini, Luisa, Introduction, *Memory and Totalitarianism* (Luisa Passerini ed), Transaction Publishers, New Brunswick, London, 2008, p. 8.

<sup>32</sup> Dawson, Graham, Soldier Heros: British Adventure, Empire and the Imaging of Masculinities. London: Routledge, 1994, p. 23.

ndryshojë me kalimin e kohës, pasi personi a personat që e mbajnë mend ngjarjen nuk do të jenë më gjallë për ta treguar “si ka ndodhur vërtetë”, nga këndvështrimi apo nga eksperiencia e tyre personale. Sipas Jan Assmann, ky është momenti i kalimit nga *kujtesa komunikuese* (*kommunikatives Gedächtnis*) tek kujtesa kulturore (kulturelles Gedächtnis) e gjithë komunitetit. Pikërisht gjatë këtij kalimi ndodh edhe konflikti midis “historisë dhe kujtesës”, ku në thelb të historisë qëndron diskursi kritik që është jokompatibël ndaj kujtesës. Historia gjithnjë është dyshuese ndaj kujtesës. Ambicia e historisë (historianëve) sipas historianit francez Pierre Nora, nuk qëndron tek ekzaltimi, lartësimi, por tek zhdukja/asgjësimi i asaj ngjarjeje që nuk i përshtatet versionit zyrtar mbi të kaluarën. Një histori e përgjithësuar pa dyshim që do të ruajë disa muze, disa medalje e monumente – le të themi materialet e nevojshme për punën e saj – por ajo do t’i boshatisë ato nga ato që për ne (komunitetin) do të mund të ishin *lieux de mémoire* (vendet e kujtesës).

Megjithatë kur duam të analizojmë kujtesën dhe historitë e rrëfyera me qëllimin e rikonstruimit të së shkuarës totalitare, duhet të kemi parasysh, se në publik konstruimi i së shkuarës, i cili shpeshherë i përshtatet narracionit publik, mbart edhe efektin psikologjik mbi individin që rikujton, i cili në këtë përpjekje për një “rikujtim të përshtatshëm” eliminon edhe memoret e dhimbshme të së shkuarës dhe në një mënyrë të pandërgjegjshme individi i përshtat të kaluarën individuale interpretimit të sotshëm, duke e vështirësuar më tej procesin e studimit të memories dhe “objektivitetit historik” në konstruimin historik të së shkuarës. Por ka dhe individë, që përballë traumës së një të kaluarë të dhimbshme harrojnë ose dëshirojnë të heshtin, përballë traumës dhe tronditjes që e kaluara shkakton tek ta, siç ka dhe individë, të cilët fillojnë dhe rrëfejnë historitë e tyre të kaluara. Historitë e këtyre të fundit, qëllon shpeshherë të mos merren seriozisht për t’u studiuar nga historianët tradicionalë, pasi ato nuk bazohen në dokumentet e kohës’, “nuk vërtetohen nga dokumentacioni arkivor” dhe kështu edhe instrumentalizohen si subjektive.

Por nga aspekti i analizës së procesit të të kujtuarit dhe historisë gojore, këto rrëfime jetësore janë të rëndësishme, pikërisht për të mësuar mbi traumën individuale dhe kontekstin social ku individi ndihej i goditur në kushtet e një regjimi totalitar. E rëndësishme mendoj se sot është, të studiohet mënyra se si njerëzit kujtojnë dhe se si njerëzit e rrokin jetën e tyre nën diktaturë përballë qasjes me kujtesën publike apo rikonstruimin e së kaluarës nga instancat shtetërore apo publike. Ky është një proces i vështirë, pasi së pari kemi të bëjmë me njerëz, të cilët rrëfejnë përmes së kaluarës së tyre edhe dhimbjen dhe psikologjikisht mbart nota të rënda emocionale. Megjithatë përballë instrumentalizimit të së kaluarës përmes hegjemonisë së historisë zyrtare apo publike, këto rrëfime kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për të kuptuar

se çfarë ka ndodhur me njerëzit, aty ku dokumenti arkivor është i papërdorshëm ose është i manipuluar.

Një tjetër domosdoshmëri për të marrë në konsideratë historitë gojore të dëshmitarëve të dhunës, dhe sidomos viktimave të krimeve gjatë periudhës së komunizmit është dhe rreziku i harresës. Siç ka pohuar Maria Todorova, sot jemi përballë një urgjence ekzistenciale për të nxitur njerëzit të dëshmojnë mbi eksperiencat e tyre gjatë regjimit komunist, pasi këto lloj eksperiencash jetësore rrezikojnë të vdesin. Ata që kanë lindur gjatë komunizmit dhe kanë kaluar vitet e maturisë nën atë regjim, pra ata që janë tek të dyzetat e deri tek të shtatëdhjetat, po adaptojnë dhe po harrojnë çka ndodhur.<sup>33</sup>

Sot komunizmi në Shqipëri kujtohet në mënyra nga më të ndryshmet, qoftë nga perspektiva personal a publike. Njerëzit evokojnë të kaluarën të nxitur edhe nga debatet publike, nga fjalori politik apo ngjarjet me reminishencë nga e kaluara komuniste. Rasti më i fundit debati mbi kthimin në Shqipëri të Mit'hat Frashërit, debat që nxiti antikomunistët, studiuesit dhe nostalgjikët të përballeshin edhe njëherë me të shkuarën komuniste dhe narrativën legjitimuese të të konsideruarit të kundërshtarëve politikë si “armi” dhe “fajtor”. Megjithatë, mendoj se pavarësisht debateve dhe diskursit delikat mbi komunizmin, ende pak është bërë, sidomos në këndvështrimin e historive personale të njerëzve që jetuan në komunizëm.

Çfarë dimë mbi burgjet e komunizmit? Çfarë dimë mbi njerëzit që dënoheshin në bazë të Nenit 55/2 për agjitacion dhe propagandë? Cilat ishin vendet e dënimit? Cila ishte rutina e përditshme e njerëzve të dënuar për krime politike nëpër burgje e kampe pune? Si ushqeheshin? Në ç'ambiente punonin? Cilat ishin kampet e punës dhe vendet e internimit? Cila ishte përditshmëria e fëmijëve të internuar? Sa fëmijë kanë qenë të internuar? Cila ishte historia e tyre? Sa fëmijë vdiqën? A ekzistojnë statistika për numrin e të përndjekurve politikë, të të dënuarve me vdekje, me internime, me burgime?

Deri diku edhe ekzistojnë përgjigje të pjesshme, por më rezulton se panorama që mund të krijohet nga përgjigjet e pyetjeve të sipërpërmendura apo edhe të shumë të tjerave që mund të bëhen, rezulton jo e plotë. Ndaj nevojitet që sidomos historianët, antropologët apo në përgjithësi studiuesit e shkencave humane dhe sociale të kthejnë interesin e studimeve të tyre edhe nga zbardhja e së kaluarës së dhimbshme të komunizmit në Shqipëri.

Duke analizuar rrëfimet e personave që kanë vuajtur në kampet e punës, si në Tepelenë vihet re një lloj uniformiteti të historive vernakulare të rrëfyera nga ato që kanë vuajtur në të, ku në sy të bie uria, vuajtja, trauma e deportimit, skamja e periudhës së kaluar në kamp. Kështu

---

33 Todorova, Maria, *Remembering Communism. Private and Public Recollections of Lived Experience in Southeast Europe*, In. Todorova, Maria; Dimou Augusta; Trobst, Stefan. CEU Pres: Budapest, New York, 6-7.



Asije Habili,<sup>34</sup> e internuar familjarisht më 1945 në Berat, Turan e Tepelenë 1949, rrëfen se, “Në Tepelenë nuk e dinim çna priste, dhe as që e përfytyronim dot gjithësesi. Por, çfarë vuajtëm dhe hoqëm ishte jashtë çdo imagjinate. Na lanë 8 ditë rresht pa bukë dhe asnjë mundësi për t’u ushqyer. Njerëzit filluan të vdesin nga uria. Ndërkohë drurët e shkurret rrotull kampit u ‘pastruan’ nga gjethet, që filluam t’i mbledhnim e t’i ziejmë në formë lakrash, me një dore oriz, sa për të shuar urinë.”<sup>35</sup>

Nga rrëfenja e dëshmitares shfaqet trauma, pazotësia për të ndihmuar në rast vdekje të fëmijëve, si dhe dhuna e autoriteteve të kampit. Histori të tilla i gjejmë në versione të ndryshme nga shumë persona që kanë rrëfyer historitë jetësore të tyre të botuara nga ISKK në kolanën “Zërat e kujtesës”.

Po nga rrëfimi i historisë së Asijes, mësojmë mbi dhimbjen dhe kushtet mjerane dhe abandonimin e viktimave dhe në rast morti:

*“Xhevati u sëmur të premtën e dha shpirt të shtunën pas 8 ditësh. Ishte vetëm 13 vjeç.*

*Nana niset për në Drejtorinë e Kampit. Takohet me Nëndrejtorin, i cili mbaj mend që quhet Syrja. E njofton se i ka vdekur djali dhe i lutet t’i thotë një polici të shkojë në Tepelenë sa për t’i blerë pak metra kambrik, për qefinin.*

*I drejtohet me fjalët:*

- *Zotni më ka vdekur djali!*
- *Mirë e ka bërë! – i përgjigjet ai.*
- *Mirë thua ti, por unë kam hall ta varros, e s’kam qefin!*
- *Ka sa të duash fier, gur e dhé – ia kthen zyrtari me emrin Syrja.*

*Nana kthehet në kazermë, gris disa rroba e sajon me to një qefin. Ndërkohë kishim lajmëruar një hoxhë, të internuar kuptohet, i cili i bën adetet e xhenazes, sipas rregullit mysliman duke e larë e pastruar. Ndërsa një plak tjetër na ndihmon ta rregullojmë një arkivol, i cili u sajua prej një arke dërrase që kishim me vete. Kishim nijetin që t’ia merrnim eshtrat Xhevatit prej aty, e t’ia varrosnim në Krujë.”<sup>36</sup>*

Ndërsa nga rrëfimi i Lek Previzit të internuar në Porto Palermo, Turan e Tepelenë me familjen e tij, mësojmë po histori të ngjashme mbi kushtet mjerane të kampit:

*“Tepelena ka histori të gjatë, se ku i hoqën nga Berati familjet për t’i dërguar në Tepelenë. Nuk ishte krijuar akoma kampi i Tepelenës, por i strehuan në disa baraka në Turan, që kishin qenë baraka për italianët dhe në Veliçor. I kanë futur drejt e në rifuxhio, pa asnjë*

<sup>34</sup> Zërat e Kujtesës., Vëll. IV, 2017, 74.

<sup>35</sup> Po aty, 77.

<sup>36</sup> Po aty, 80.

*pajisje, asgjë fare. Kur i internonin njerëzit, i merrnin me rrobat e trupit. Të internuarit flinin në gurë ose mbi dërrasa... I transferuan atje 40 makina, me rreth 2000 e ca vetë brenda, dhe i hodhën në rifuxhio, pa asnjë konditë, pa banjo ku edhe uji u jepej me racion nga një depo e madhe me çimento, me nga një sapllakë në ditë. Kjo situatë ka qenë në Turan. Për t'u larë s'kishte asgjë; u duhej të merrnin ujë nga një vijë, por, që ishte edhe e pisët. Buka e të internuarve vinte nga Berati; ishte bukë misri.... Të internuarve u jepej vetëm atë bukë, nga 500 gramë në ditë. Në këto kushte menjëherë plasën sëmundjet. Kjo ka ndodhur në Turan, para se të zhvendoseshin në Tepelenë. Filluan të sëmuren në masë dhe të vdisnin shtatë vetë në ditë... Mjek jo, ilaçe jo, ushqim jo, e si do shkonte ndryshe? Vetëm brenda një nate, në një kazermë vdiqën 33 fëmijë”.*<sup>37</sup>

Ndërsa Azis Ndreu që ka vuajtur punën në Kampin e Turanit e Tepelenës rrëfen:

*“Kështu filluam jetën në Kampin e Turanit. Bukën shkonim dhe e merrnim në krah punëtorët në Tepelenë, në qytet. Tepelena nuk ishte e përgatitur për të furnizuar me bukë 2000 vetë, plus dhe buka e misrit vinte krejt e papjekur, vetëm se e ngrohnim. E qullët, baltë. Dhe nga 600 gramë që kishim racionin, na jepnin 500 gramë, se pjesa tjetër ishte firo. Ishte baltë, jo bukë.” “... Pjesa tjetër prej atyre që mund të ishin për punë, duke filluar nga mosha ime, 13 vjeç e lart, i nisën për të hapur rrugën Veliçot-Memaliaj, sepse atëkohë, nuk kishte rrugë nga krahu këtej; kishte vetëm në krahun matanë Vjosës. Dhe kështu ngrejtnë dhe një kamp pune në Memaliaj. Për punëtorët filloi gjella. E kam fjalën, supa e orizit a diçka e ngjashme, sepse racioni i bukës mbeti i njëjtë. Kurse shumica mbeti në Turan... Pastaj vdekja erdhi e u bë një gjë e zakonshme. Ulërimat që dikush vdiq ... Nuk di ç'të thuash më përpara. Unë i kam të gjalla të gjitha në mendje...”.*<sup>38</sup>

Kushte të ngjashme ka rrëfyer dhe Gani Kupi mbi Kampin e punës së Maliqit më 1947: *“Kam parë edhe burra shumë të mirë, të cilët mbledhnin duqë duhani dhe i thithnin. Kam parë njëherë një të burgosur, i cili mbasi shikoi anash me kujdes që të mos e shihnin të tjerët kapi një lëkurë bostani në gropën e mbeturinave, i ra dy herë pantallonave me të për ta fshirë dhe filloi ta hante.”*<sup>39</sup>

Kushtet e vështira dhe dhuna e ushtruar nëpër burgje e kampe të punës, duket se ndahet nga shumë ish të dënuar dhe internuar dhe në versionet e tyre është pikërisht dhuna që theksohet, e cila është vështirë të dokumentohet nga dokumentet e kohës. Po të mos ishte për rrëfimet jetësore të viktimave, është e vështirë dokumentimi i saj.

<sup>37</sup>Zërat e Kujtesës, Vëll. I, ISSK: Tiranë, 2014, 320.

<sup>38</sup>Zërat e Kujtesës, Vëll. III, ISSK: Tiranë, 2016, 244-245.

<sup>39</sup>Zërat e Kujtesës, Vëll. I, ISSK: Tiranë, 2014, 18.

Nga dëshmia e Mark Alisë, që vuante dënimin në Kampin e Thumanës: *“Mbah mend Vangjel Rrëmbecin, kur përdorte korentin në kampin e punës në Thumanë. Operatori ulte voltazhin, e lidhnin të burgosurin me hekura gjermane, e lagnin çimenton me ujë, e ulnin të burgosurin në të dhe i lëshonin korrentin në dy gishtat e këmbës.”*<sup>40</sup> Ndërsa Ndrek Bazhdari i burgosur 17 vjeç në burgun e Burrelit rrëfen se, “.. mbas nja dy javësh në birucë erdhi një komision mjeko-legal ushtarak dhe, kur hapën derën e birrucës sonë, njëri prej tyre, kur më pa mua ashtu të dobët e të verdhë krejt, u shtang: Uaa!! Po ky fëmijë, çfarë do këtu? Është i burgosur, - i përgjigjet njëri prej mjekëve”.<sup>41</sup>

Ndërsa Lavdosh Beqo i dënuar me 18 vjet burg, rrëfen se, *“Burreli ishte shumë i ashpër, si nga trajtimi, ashtu edhe nga klima. Por edhe për shkak të ujit. Burgu furnizohej me ujë nga një pus. Pusi infektohej nga enët e palara që futeshin për të marrë ujin. Dhe shpesh binte diarreja. Me këtë shkak shumë vetë gjetën vdekjen nga dehidratimi i organizmit dhe mungesa e ilaçeve.”*<sup>42</sup>

Rrëfim të ngjashëm tregon edhe Uran Kostreci mbi burgun e Burrelit, *“Një kapter i burgut, Asllan Uka quhej, me një pamje të rreptë siç ishin të gjithë këta kapterët e burgjeve, i lig, megjthëse kishte edhe më të ligj se ai, gjëja e parë që na tha, ishte: - Hm! Këtu i thonë Burrel, kuu hyn e nuk del!. Ishte tamam si përshëndetja e Karontit të “Ferri” i Dantes.”*<sup>43</sup>

Intervista dhe rrëfime të tilla nga ish viktimat e regjimit komunist në Shqipëri janë të shumta. Për ta konkretizuar kërkimin e objektivitetit historik në analizën e atyre ngjarjeve që kanë ndodhur në kampet e punës dhe burgjet do të konstatoja, se nëse këto rrëfime do të hidhen tutje, refuzohen si të pavërteta, si të pabazuara në dokumente të arkivave të shtetit komunist, atëherë do të shkojmë drejt humnerës së harresës, amnezisë kolektive. Siç ka pohuar dhe historiani Peter Burke, “historia edhe mund të harrohet nga fitimtarët”, duke lënë në hije ngjarje që nuk u interesojnë apo që duan t’i anashkalojnë e lënë në harresë. Kështu, do të jetë shumë e kollajtë më pas ta rikonstruktojmë historinë e së shkuarës përmes varianteve “zyrtare”, duke pretenduar se regjimi i Enver Hoxhës “nuk ka qenë dhe aq i keq”. Na duhet edhe kujtesa e atyre që i mbijetuan atij kampi apo kampeve e burgjeve të komunizmit, na duhen rrëfimet e jetëve të tyre, na duhet historia e jetuar e tyre, për të kuptuar së pari si ka funksionuar ai sistem dhunues i lirive dhe të drejtave të njeriut dhe më pas, për të analizuar mjetet e dhunës komuniste. Pa

<sup>40</sup>Zërat e Kujtesës, Vëll. I, ISSK: Tiranë, 2014, 16-17.

<sup>41</sup>Zërat e Kujtesës, Vëll. II, ISSK: Tiranë, 2015, 34.

<sup>42</sup>Zërat e Kujtesës, Vëll. II, ISSK: Tiranë, 2015, 146.

<sup>43</sup>Zërat e Kujtesës, Vëll. III, ISSK: Tiranë, 2016, 210.

“vendet e kujtesës” një histori e komunizmit bazuar vetëm në dokumente arkivore, do të jetë e mangët.

Diskursi i të kujtuarit të diktaturës komuniste po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme si për të tashmen, por dhe për të ardhmen e shoqërisë shqiptare. Krahasuar me disa vende të tjera ish komuniste të Evropës Lindore, ky moment mund të duket i vonuar. Por ,pavarësisht kësaj, angazhimi për të reflektuar mbi të kaluarën komuniste të Shqipërisë është esenciale për të krijuar një hapësirë të përbashkët e një common sense, për kujtesën kolektive të Shqipërisë postkomuniste. Trajtimi i së kaluarës së Shqipërisë nën diktaturën komuniste ka një rëndësi të madhe për shoqërinë shqiptare, duke e konsideruar atë, jo vetëm si një proces shërimi, nga këndvështrimi i drejtësisë tranzitore, të atyre të drejtave njerëzore që u mohuan dhe dhunuan gjatë asaj periudhe, por përbën dhe një shans për ndërtimin në të ardhmen të një kulture sa më demokratike për Shqipërinë postkomuniste.

*Literatura:*

Agim Musta, Libri i zi i komunizmit shqiptar, Tirane: 2007.

Amik Kasarhuo, Një ankth gjysmëshekullor: Shqipëria e Enver Hoxhës, Tiranë: 1996.

Amos Frankenstein, “Collective Memory and Historical Consciousness”, *History and Memory*, Vol. 1, No. 1, 1989, 5-26.

Anna Green, 2004. Individual Remembering and ‘Collective memory’: Theoretical Presuppositions and Contemporary debates. *Oral History, Vol 32, No. 2. Memory and Society.* 35-44.

Augé, Marc, Oblivion, Minneapolis, 2004.

Cubitt, Geoffrey, History and Memory, Manchester University Press.

Fabian Kati, Formësimi i kujtesës kolektive. Ngjarjet e Dukagjinit, Malësia e Madhe, Postribë, 1945-1946. UET Pres, Tiranë 2015.

Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist (Vol. I-V), Tiranë, 2015-2017.

G.H.F. Hegel, Vorlesungen über die Philosophie der Geschichte, Stuttgart, 1928.

Gabriel Marin, Tackling Agora Problems of the Present from Pandora’s toolbox of the past. How teaching history can democratize the ‘Other Europe’, in Raluca Grosescu (ed.), Teaching History of Communism in Eastern Europe. Compendium of Good Practices, (Bucharest 2013), 15-36.

Graham Dawson, Soldier Heroes: British Adventure, Empire and the Imaging of Masculinities. London:Routledge, 1994.

Haider, H. Rewriting history textbooks, in Stan L.; Nedelsky N. (eds.) *Encyclopedia of Transitional Justice*, Cambridge, Cambridge University Press.

Jan Assmann, *Cultural Memory and Early Civilization. Writing, Remembrance, and Political Imagination*, Cambridge University Press, Cambridge, 2011.

Jan-Werner Müller, 'Introduction: The power of memory, the memory of power and the power over memory', in Jan-Werner Müller, *Memory and Power in Post-War Europe. Studies in the Presence of the Past*. (Cambridge University Press, 2004. 3-35.

Luisa Passerini, Introduction, *Memory and Totalitarianism* (Luisa Passerini ed), Transaction Publishers; New Brunswick, London, 2008.

Luisa Passerini, *Autobiography of a Generation: Italy, 1968* (Hanover, NH and London, 1996).

Maria Todorova, Introduction. The Process of Remembering Communism, in Maria Todorova, *Remembering Communism. Genres of representation*, New York. 2010, 9-34.

Maria Todorova, *Remembering Communism. Private and Public Recollections of Lived Experience in Southeast Europe*, In. Todorova, Maria; Dimou Augusta; Trobst, Stefan. CEU Pres: Budapest, New York, 2014.

Mark Mazower, *Dark Continent: Europe's Twentieth Century*, Penguin: London, 1998.

Pierre Nora, "Between Memory and History: Les Lieux de Memoire", *Representations* 26, 1989, 7-24.

Pierre Nora (ed.), *Les lieux de memoire*, 7 vols. Gallimard: Paris, 1984.

Robert Mandrou, *Historie/ L'Histoire des mentalités*, in *Encyclopaedia universalis*, Paris, 1971.

Roper, Michael, 'Remembering the Soldier Hero: The Psychic and Social Construction of memory in Personal Narratives of the Great War', *History Workshop Journal*, no 50, 2000.

Samuel, Raphael; Thompson, Paul, *The Myths We Live*. Routledge: London, 1990.

Tomor Aliko, *Genocidi gjysëm shekullor në Shqipëri*, Tiranë, 2010.

Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Tirane, 2007.

Tony Judt, 'The Past in another country; myth and memory in post-war Europe', in Jan-Werner Müller, *Memory and Power in Post-War Europe. Studies in the Presence of the Past*. (Cambridge University Press, 2004, 157-183.

Uran Butka, *21 vjet burg komunist 1961-1982. Kujtime, mbresa, portrete dhe refleksione*, Tiranë, 2001.

Yosef Yerushalmi, Y H, *Zakhor, Jewish History and Jewish Memory*, Seattle, 1982.

Zërat e Kujtesës. ISSK: Tiranë, Vëll. I, 2014.

Zërat e Kujtesës. ISSK: Tiranë, Vëll. II, 2015.

Zërat e Kujtesës. ISSK: Tiranë, Vëll. III, 2016.

Zërat e Kujtesës. ISSK: Tiranë, Vëll. IV, 20

## **Erald Kapri - Autoriteti i Mediave Audiovizive**

### **Vështrim krahasues mbi rehabilitimin e viktimave të komunizmit, rasti çek, gjerman, polak, estonez dhe rumun**

#### **Abstrakt**

Qëllimi i këtij punimi do të jetë qasja krahasimore e rehabilitimit të viktimave të diktaturës komuniste në vende të Evropës Lindore. Ky kërkim konsiston në njohjen e përvojës së ndryshme mbi mënyrën se si po trajtohen viktimat pas rënies së diktaturës. Kërkimi do të shqyrtojë rastin çek, gjerman, polak dhe rumun duke përfshirë një për zgjedhje sa më përfaqësuese në vendet evropiane.

Çështja e rehabilitimit të viktimave të ish diktaturës komuniste mbetet një temë e nxehtë pothuaj në të gjitha vendet evropiane që përjetuan diktaturën komuniste. Me nisjen e tranzicionit, rehabilitimi i viktimave ishte një parim i gjerë pranuar por format e aplikimit, mënyra, pamundësia financiare apo arsytet politike ishin disa prej pengesave kryesore.

Studimi do të përfshijë kuadrin ligjor të zbatuar nga këto vende, statusin e të rehabilituarve, programet dhe format e kompensimit, organizimin e viktimave në grupe interesi, përfitimet sociale si dhe mësimet e përfituara. Përmes këtij krahasimi, ky kërkim do të japë disa përgjigje të nevojshme për të kuptuar përvojën evropiane në rehabilitimin e viktimave. Krahasimi i përvojës së këtyre vendeve do të vijë përmes rekomandimeve të përfituara nga problematika e tyre. Po ashtu, ky punim do synojë të japë përgjigje mbi disa prej çështjeve kyçe të këtij procesi në Shqipëri. Njohja e kësaj përvoje mund të shërbejë në aplikimin në vend përmes përvojave më të mira të rehabilitimit dhe përfitimeve sociale të këtij procesi. Studimi do të përdorë burime parësore dhe dokumentare të mbledhura kryesisht nga Instituti Cevro në Çeki dhe disa studimeve të tjera. Si përfundim, punimi do të ofrojë një këndvështrim të gjerë mbi përvojën dhe nevojën e rehabilitimit të pasojave të diktaturës.

#### **Hyrje**

Shqipëria përfaqëson një eksperiencë unike në lidhje me çështjen e rehabilitimit të viktimave të ish-sistemit diktatorial komunist. Prej vitit 1991, ka një legjislacion të gjerë për këtë shtresë të popullsisë, i cili ende në pjesën më të madhe të tij është i pazbatuar. Mbi 25 vite nga rënia e regjimit komunist, Shqipëria nuk ia ka dalë dot të kryejë një rehabilitim të qenësishëm ndaj shtetasve që vuajtën në diktaturë. Të dhënat e fundit nga Ministria e Financave flasin për një faturë financiare prej 750 milionë dollarësh, nga të cilat janë shlyer 230 milionë dollarë, ku 178 milionë përmes kësteve dhe pjesa tjetër përmes letrave me vlerë dhe apartamente për strehim. Por nëse shtohen edhe fatura për kompensimin e pronave, atëherë shifra i tejkalon 2 miliardë dollarë. (Ahmetaj 2018, 12 Shtator).

Kësisoj, Shqipëria çështja e rehabilitimit të viktimave të ish diktaturës komuniste është një “patate e nxehtë” e cila ende shqetëson shoqërinë e në veçanti politikbërësit. Nisur nga ky realitet, çështja që shtrohet është mundësia reale për të pasur një rehabilitim cilësor dhe real ndaj dhe eskperienca në vende të ngjashme për të mësuar mbi rehabilitimin e viktimave është thelbësore.

Ekspierienca e vendeve që kaluan në tranzicion dekadat e fundit tregojnë se përballja me të kaluarën e në veçanti me rehabilitimin e viktimave është vendimtare për të kontribuar në një shoqëri të drejtë dhe demokratike. Në rastin shqiptar, kur çështja e pronës e cila është e lidhur

ngushtësisht me rehabilitimin e viktimave, është po ashtu thelbësore për një ekonomi të zhvilluar. Ky punim nuk ka për qëllim të vendosë në pah marginalizimi i historisë dhe gabimet e së kaluarës, por ka si synim të përcjellë eksperiencat e vendeve që po kalojnë një vështirësi të ngjashme, si një mënyrë për të mësuar sistemin ligjor, edukimin dhe kujtesën e shoqërisë dhe nevojën për të vlerësuar viktimën dhe dënuar fajtorët. Ky vështrim krahasues për vendet evropiane me të kaluar komuniste si Gjermania, Çekia, Polonia, Estonia dhe Rumania mund ndihmojë në përfundimin e përvojës së tyre për tu aplikuar më pas në Shqipëri për të përmirësuar sadopak gabimet e tranzicionit.

### **Rasti gjerman**

Eksperienca gjermane konsiderohet shpesh më e vlerësuar në shumë aspekte që kanë të bëjnë me të kaluarën. Kjo për shkak se gjermanët patën një eksperiencë të mëparshme me denazifikimin e vendit ndërsa më pas me procesin e demokratizimit pas bashkimit të Gjermanive, pjesa perëndimore pati mundësinë financiare dhe një vullnet të shtuar për të realizuar një proces të qëndrueshëm rehabilitimit të viktimave të ish diktaturës komuniste.

Debati për çështjen e kompensimit dhe rehabilitimit të viktimave të komunizmit nisi mjaft herët në Gjermani, fill pa shembjes së Murit të Berlinit. Së pari, çështja që u trajtua fillimisht si mundësi për tu sqaruar ishte aspekti ligjor për të përcaktuar persekutimin dhe pa favorizimin për arsye politike për të kaluar më pas në një rehabilitim ligjor të viktimave. Të dhënat flasin për rreth 200 deri në 250 mijë të burgosur politikë në ish Gjermaninë Lindore ose në afërsisht 1 milionë vite burg. Vlen të theksohet se legjislacioni gjerman njohu çdo formë persekutimi i cili meritohej të rehabilitohej. (Kaminsky 2017, p 32)

Akti i parë ligjor u miratua në shtator 1990 dhe më pas me ribashkimin e Gjermanive, hyri në fuqi Akti i rehabilitimit në nëntor të vitit 1992. Hapësira ligjore u përmirësua më vonë në vitin 1994 me ligjin e njohur si “Zgjidhja e Padrejtësive të Partisë Socialiste të Unitetit Social” i cili rregulloi pjesën administrative dhe atë profesionale. Por që nga akti i parë, ka pasur edhe 5 amendime të tjera të rregulloreve për të përfshirë kategori të tjera siç ishin të rinjtë e dërguar me forcë në shkolla të caktuara apo fëmijët e mbyllur në shtëpitë e fëmijëve që u cilësuan si burgje. Në vitin 2007, hyri në fuqi një akt i ri që u quajt "Ndihma e Veçantë për Viktimat e Burgjeve", duke prezantuar “pensionin e viktimës” në një shumë prej 250 euro (pas 2014 është 300 euro) për këdo që kishte bërë më shumë se 180 ditë burg, dhe ofrohej nëse viktima ishte i papunë dhe i pacenuar kur dilte në moshë pensioni. Nga rreth 206 mijë aplikime



për ndihmë të vecantë, përfituan 170 mijë persona me një faturë financiare prej 660 milionë euro (Kaminsky 2017, p 32)

Koncepti gjerman për rehabilitimin e viktimave përkufizohet si “përkrahja sociale” e viktimave, të cilët ndonëse e vështirë, duhet të provojnë vuajtjen gjatë dikturës komuniste në mënyrë që askush të mos ndihej i përjashtuar. Aktet për përfitimin e pension nuk përjashtojnë askënd që provojnë vuajtje për shumë kategori të veçanta siç mund të jetë të dëbuarit për punë të detyruar në Siberi, të dëbuarit, vuajtja gjatë regjimit në aspektin profesional dhe privat, si dhe çdo akt administrativ apo mase që kufizonte shtetasit nën regjimin e ish Republikës Demokratike Gjermane. Kjo qasje u vendos edhe si mundësi për të mos përsëritur eksperiencat jo fort të kënaqshme me viktimat e regjimit nazist. Qeveria gjermane ka ndërmarrë edhe shumë akte të tjera ndihme siç është ndihma prej rreth 50 milionë eurosh që ka përfituar organizata e ish të burgosurve. Kjo ndihmë e akoruar në vitin 2016, do perdoret edhe si fond special për të gjithë shtetasit gjermanë që u detyruan me forcë të internoheshin në ish Bashkimin Sovjetik, nga viti 1939 deri me 1956. Shpërblimi për këtë kategori është 2500 euro në muaj. (Kaminsky 2017, p 36)

Forma e kompensimit për rehabilitimin e viktimave nuk kaloi pa debate në Gjermani. Ish të persekutuarit protestuan ndaj faktit që persekutorët e tyre merrnin pensione më të mira duke iu njohur puna në organet shtypëse të regjimit si vite pune, ç’ka reflektohej në pensione më të mira për ta në krahasim me viktimat të cilët për shkak të persekucionit nuk kishin vite të mjaftueshme të njohura për kontribute pensioni. Në debat u përfshi edhe Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane e cila përmes një rezolute u shpreh se legjislacioni për pensionet smund të jetë një legjislacion ndërshkues. Sistemi i mbështetjes me pension prej 300 eurosh pati kundërshti të shumta pasi shumë prej viktimave theksonin se humbjet e tyre ishin të pallogaritshme. Ky debat ka qënë prezent prej 25 vitesh në Gjermani. Në vitin 2002, historiani i njohur gjerman Jorg Siegmund do të deklaronte përmes një punimi për Shoqatën e ish viktimave të komunizmit se “*interesat e tyre nuk janë mbështetur nga shoqëria*”. (Siegmund 2002, p 32)

Studiuesja Kaminsky shprehet se eskperienca gjermane tregon se është tepër e rëndësishme për të ndërtuar struktura publike në mënyrë që të edukojnë shoqërinë për të pranuar të kaluarën e viktimave, për të njohur krimet dhe vuajtjen e tyre. Kjo duhet të arrihet përmes ngritjes së institucioneve të pavarura dhe të shëndosha financiarisht për të çuar para axhendën e tyre, përmes ndërtimit të memorialeve, monumenteve, vendeve të kujtesës, krijimit të qendrave të posaçme ky viktimat të kenë mbështetje të vazhdueshme psikologjike si dhe

mundësinë që ata në mënyrë të pavarur të paraqesin e të llobojnë në jetën politike. (Kaminsky 2017, p 35)

### ***Rasti Rumun***

Eksperienca rumuna ngjason në shumë pikëpamje dhe qasje me eskperiençën shqiptare në rehabilitimin e viktimave të ish regjimit komunist. Rumania filloi të rehabilitojë financiarisht viktiat tepër vonë, pas vitit 2009 dhe në tërësi gjatë viteve, përkrahja dhe mbështetja konsiderohet si simbolike në aspektin financiar dhe moral.

Ligji i parë i miratuar në vitin 1990 përcaktoi një kompensim financiar simbolik prej 200 lei që jepej çdo vit, dhe kompensimi jepej për këdo të burgosur, të dëbuar, etj. Ligji ofronte asistencë falas mjekësore dhe ilaçe, përdorim i lirë i transportit publik dhe mjete dhe përjashtime nga taksat mbi të ardhurat. Këtu është e rëndësishme të theksohet se një kategori më e madhe e personave (personat në pension për shembull) kanë përfituar nga masa të ngjashme. Koha e kaluar në burg, në kampet e punës ose në internim u njoh si kohë pune për përfitim pensioni. Sipas ligjit polak, gjatë llogaritjes së të drejtave të pensionit, çdo vit i persekutimit llogaritet si tetëmbëdhjetë muaj. Këto të drejta iu dhanë edhe personave që nuk mund të punonin sepse Sigurimi Polak i monitoronte për arsye politike. Për më tepër, të afërmit e gjallë të viktimave mund të kërkonin këto të drejta të vogla pensionale tek pasardhësit. (Jinga, 2017, p 31 )

Për dy dekada, kompensimi për viktiminat ishte në këto masa simbolike por anëtarësimi në Bashkimin Europian si dhe presioni më i madh i organizatave të ish të të përndjekurve politikë, bëri që qeveria të miratojë një ligj të ri në 2009. Ligji njohu të gjithë format e persekutimit por vendosi që barrën e provës ta ketë viktimat dhe duhet ta provonte me një vendim gjykatë, e cila do të përcaktonte edhe masën e dëmshpërblimit. Por personat gjallë për kompensim të drejtpërdrejtë ishin mjaft të paktë pasi pjesa më e madhe kishin humbur jetën. Në 2010, vetëm 174 raste u paraqitën në gjykatë të cilët përfituar masa dëmshpërblimi nga 300 euro deri në 1 milionë euro. (Jinga, 2017, p 31 )

Kompensim direkt mujor përfituan shtetasit që morën pjesë në revolucionin e vitit 1989 duke përfshirë kompensimin mujor prej 3,672 Lei (ekuivalent me 900 euro), për personat me aftësi të kufizuara të dëmtuar gjatë ngjarjeve u vendos 2,200 Lei (500 euro), strehim pa pagesë, transport publik falas si dhe edukim falas parashkollor për fëmijët e tyre. Vlen të theksohet se gjeveia vendosi më pas përmes një amendimi ligjor që masa e dëshpërblimit në gjykatë të mos kalonte 10 mijë euro për personat e dënuar me burg politik, për bashkëshortët jo më shumë se 5 mijë euro dhe për trashëgimtarët jo më shumë se 2500 euro. Ky amendim erdhi pasi gjykata

vendosi vetëm në një rast të vetëm një dëmshpërblim prej 500 mijë eurosh për Ion Diaconescu, politikan dhe ish-i burgosur politik. (Jinga, 2017, p 33)

Në total, në Rumani pati përfitime dhe pensione mujore simbolike për mbi 63 mijë qytetarë ndërsa numri i tyre vijon në bjerë në vite. E vetmja masë e qendrueshme kompensimi e amenduar me ligj është kompensimi mujor që u rrit në 400 Lei, ose 90 euro pas vitit 2015. Çdo familje e përndjekur, aktualisht, merr këtë mbështetje sociale nga shteti. Në tërësi, sipas studiueses Jinga, rasti rumon është disi kaotik pasi ende ka debat në shoqëri për mënyrën e rehabilitimit të viktimave, ndërsa shumë prej ish të përdjekurve vdiqën pa pasur asnjë lloj përkrahje. (Jinga, 2017, p 33)

### ***Rasti Polak***

Në shkurt të vitit 1991, Polonia miratoi ligjin e parë që njihje sakrificën e shtetasve polakë në egzistencën dhe pavarësinë e vendit të tyre . Ndyshe nga shumë vend etë tjera, Polonia i njohu viktimat si martirë të shtetit polak duke e konsideruar komunizmin si pushtim sovjetik ndaj vendit të tyre. Studiuesi Radoslav Peterman, thekson se ligji polak njohur të drejtën e kompensimit për çdo dëm të kryer nga regjimi, ndërsa ky i fundit do të varej rast pas rasti, që nga kompensim i plotë deri në forma simbolike përmes pensioni.

Polonia ngriti një institucion të veçantë për mision rehabilitimin e ish viktimave përmes politikës se pensioneve të përnuajshme. Këto pensione u vendosën mbi bazën e pensioni mesatar në Poloni, megjithatë pas shumë peripecish ligjore ku u përfshi edhe Gjyqta Kushtetuese, vetëm pas vitit 2015 filloi dhënia e ndihmës pas asnjë kushtëzim. Vlen për tu përmendur se qeveria polake vendosi të ulë pensionet për të gjithë ish puonjësit e ministrisë së Brendshme apo të Mbrotjes, në mënyrë që pensioni i tyre të barazohej me atë të viktimave. Në këtë çështje u përfshi edhe Gjykata Europiane e të drejtave të Njeriut e cila i dha të drejtë qeverisë polake për këtë vendim. Polonia i kushtoi një rëndësi më të madhe nderimit të viktimave dhe antikomunizmit në shoqëri duke e përcaktuar si një mision kombëtar të saj. (Peterman, 2017, p 31)

### ***Rasti estonez***

Estonia ka një ngjashmëri me rastin polak, nisur nga fakti që komunizmi u cilësua si një pushtim i vendit të tyre nga ish Bashkimi Sovjetik. Por Estonia, ripërcakttoi mjaft më gjerë spektrin e viktimave që nis që nga viti 1939. Në vitin 1995, estonia përfitoi një masë të konsiderueshme dëmshpërblimi nga Gjermania si dëmshpërblim për krimet naziste gjatë viteve 1941-1944.

Ligji për kompensimin e viktimave ishte ndër të parët fill pas Estonia fitoi pavarësinë nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1991. U vendos që viktimat të trajtohen me një politikë të

veçantë pensioni. Sipas ligjit të vitit 1991, i cili është amenduar dhe përmirësuar gjatë viteve, u vendos që pensionet e viktimave të ish diktaturës të jetë në masën mbi 20 % më të larta krahasuar me pagën minimale. Ndërsa për personat që kanë qenë në burgime, në paraburgime, të depërtuar, të internuar, pensioni iu trefishua dhe përfitohej 5 vite para moshës së daljes në pension. Kjo ishte një masë e mirëpritur pasi viktimat përfituan pothuaj menjëherë. Ndërkohë, shteti estonez njohu çdo dhunim pasuror çka viktimave iu riktheu menjëherë ose masa e barabartë e kundër vleftës së pronës së grabitur apo të shkatërruar. (Hiio, 2017, p 32)

### ***Rasti Çek***

Çekia përfaqëson një eksperiencë unike të rehabilitimit të viktimave të regjimit, kjo pasi gjatë regjimit komunist në vitet 60 pati tentativa për të lehtësuar viktimat e dënuar nga regjimi. Pas vitit 1989, nisi një kalvar i gjatë ligjor për të ridimensionuar formën e rehabilitimit dhe kompensimit të shtetasve çek nga qeveria e tyre.

Ligji i parë u miratua në vitin 1990, i cili u njohur statusin për rehabilitim të paktën 260 mijë personave që morën statusin e viktimës. Ligji përcaktonte se viktimat duhet të plotësonin formularët përkatës, në një proces që ndiqej nga ministria e Mbrojtjes. Por mënyra e kompensimi u kthyen në një betejë ligjore mes qeverive dhe organizatave në mbrojtje të viktimave duke mbyllur këtë betejë në vitin 2009. Me marrjen e statusit të viktimës, qeveria i njohje çdo viktimit një shumë fillestare kompensimi prej rreth 100 mijë CZK ose rreth 4 mijë dollarë. Gjithashtu, një viktimit do të gëzonte një pension mesatar me arritjen e moshës përkatëse. Në rastin çek, u arrit që regjimi komunist të dënohet e të cilësoj si kriminal në vitin 1993, dhe ky akt zhvlerësonte vendimet e ish institucioneve të regjimit komunist, duke i dhënë hapësirë çdo viktimit që ti drejtohej gjykatës për çdo padrejtësisë, që nga dënimet e padrejta e deri tek vjedhja e pasurive të ndryshme. (Bartova, 2017)

### ***Përfundime***

Rehabilitimi i viktimave të regjimit komunist nuk ka një praktike të unifikuar në shumë prej vendeve evropiane. mënyra e tranzicionit demokratik, limimet ekonomike dhe mungesa e një qasje të hapur, ka krijuar mjaft probleme me rehabilitimin e këtyre viktimave.

Rasti gjermane i cili përcaktoi një formë pensionimi për viktimat është marrë për bazë në shumë prej vendeve që kaluan diktaturën komuniste. Vendosja e një pensioni sa më dinjitoz për viktimat u pa në shumë prej këtyre vendeve si mënyra më e mirë për të ndihmuar rehabilitimin e viktimave.

Vlen të theksohet se çdo vend ka specifikën e vet dhe ndryshon nga natyra represive e regjimit. Konkretisht, çështja e kompensimit pati një trajtim më të mirë në mjaft vende.

Nisur nga eksperiencat e vendeve të ndryshme, rasti shqiptar është unik nisur nga fakti se ka ndërmarrë hapa ligjore për një kompensim financiar të konsiderueshëm e në të njëjtën kohë të papërballueshëm për buxhetin e shtetit. Një politikë pensionimi mund të ishte më efektive për viktimat ndërsa çështja e pronësisë vijon të mbetet një problem më thelbësor.

## **Bibliografia**

Ahmetaj, A. (2018, 12 Shtator). Te perndjekurit dhe Pronaret, Ahmetaj:Fatura arrij 2 miliarde dollare. *Gazeta Panorama*.

Bartova, M. (2017). *Rehabilitation of victims, Memory of Nations: Democratic Transition Guide – The Czech Experience*. . Prague: Cevro Institute.

Hiio, T. (2017). *Rehabilitation of victims, Memory of Nations: Democratic Transition Guide – The Estonian Experience*. Prague: Cevro Institute.

Jinga, L. (2017). *Rehabilitation of victims and Compensation, Memory of Nations: Democratic Transition Guide – The Romanian Experience*. Cevro Institute. Prague.

Kaminsky, A. (2017). *Rehabilitation of victims, Memory of Nations: Democratic Transition Guide – The German Experience*. Cevro Institute.

Peterman, R. (2017). *Rehabilitation of victims, Memory of Nations: Democratic Transition Guide – The Polish Experience*. . Prague: Cevro Institute.

Siegmund, J. (2002). *Opfer ohne Lobby*. Berlin.

**Sara Çapaliku - Juriste**

## **Interesi publik në Shqipëri: Ballafaqimi me të shkuarën komuniste, në kontekstin e Integritimit Evropian**

### **Abstrakt**

Procesi i hapjes së dosjeve dhe zbatimi i ligjit të lustracionit krahasohet me përvojën e implementimit të këtij ligji në Gjermaninë Lindore dhe Poloni. Pyetjet kërkimore bazohen kryesisht në aspektin pragmatist dhe realist të hapjes së dosjeve, si dhe në atë të vlerave e moralit, porë edhe nga këndvështrimi i aktorëve ndërkombëtarë e opinionit i shoqërisë civile.

### ***Hyrje***

Interesi personal: hulumtimi im mbi këtë temë vjen si rezultat i një reflektimi të shumanshëm si pjesëtare e brezit shqiptar të tranzicionit, si trashëgimtare e kujtimeve të familjes sime të asaj kohe, si pjesë e atij brezi të të rinjve që po ashtu do të arrijnë të përjetojnë edhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian (BE); si mbrojtëse e respektimit të të drejtave dhe dinjitetit të njeriut, e po ashtu, si pjesë e një shoqërie në formim, me njohuri të copëzuara mbi të kaluarën e prindërve e gjyshërve të vet, që për rrjedhojë, mbart në kurriz shumë pikëpyetje rreth identitetit të tij e vlerave që kërkohet të fitojnë më shumë peshë në rrugëtimin e një sistemi post-diktatorial drejt demokracisë. Duke u nisur nga përpjekjet inekzistente të sistemit edukativ në Shqipëri për të informuar brezat e rinj mbi krimet e komunizmit dhe braktisjen e kësaj memorie kolektive në mëshirë të trashëgimit gojor vullnetar dhe informal, shtroj pyetjen se çfarë do të ndodhë me të? Për sa kohë do të trashëgohet e kultivohet kjo memorie kolektive, që nxjerr kryet herë pas here, e pakonsoliduar?

Në aspektin profesional, ky punim studimor vjen si vazhdimësi e hulumtimit tim të mëparshëm si temë e mbrojtjes së diplomës së Masterit. Gjithashtu, përfaqëson interesin tim në rritje në fushën e drejtësisë, të të drejtave të njeriut dhe edukimit të brezave të rinj mbi mësimet e së kaluarës, për të evituar rrezikun e përsëritjes së historisë. Me bindjen se komunizmi vazhdon të formësojë dhe brezat e sotëm të tranzicionit, si produkt i një shoqërie të paorientuar mes të shkuarës diktatoriale dhe të ardhmes evropiane, procesi i arritjes në një gjykim të “shëndetshëm” rreth përjasjeve me të shkuarën paraqet një sfidë që na përket.

Me të drejtë Umberto Eko në një “lectio magistralis” mbajtur pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 2013 “Kundër humbjes së kujtesës”, thotë se civilizimet nuk mbijetojnë dot pa kujtesën kolektive. Kur ndonjë akt censure përpiqet të zhdukë një pjesë të kujtesës së një shoqërie, kjo shoqëri pëson krizë identiteti. Në një botë në të cilën tentohet të

harrohet apo të injorohet shumë, rizbulimi i së shkuarës sonë kolektive duhet të jetë projekti themelor i së ardhmes<sup>1</sup>.

Pyetjet që udhëheqin punimin tim e kanë pikënisjen pikërisht tek togfjalëshi i fundit i citimit të fragmentit të Umberto Ekos - "projekti themelor i së ardhmes", me synimin që jo vetëm të jemi transparent ndaj së kaluarës, por edhe të ndërtojmë një strategji për kultivimin e memories kolektive në funksion dhe për hir të interesit publik. Për qartësi, në hulumtimin tim, me "interes publik" dua të nënkuptoj të mirën e përbashkët publike, që në këtë kontekst do të sugjeroja integrimin e vendit tonë në Bashkimin Evropian. Si dhe, konsiderimi i një procesi të suksesshëm të ballafaqimit me të shkuarën si një urë lidhëse me "vlerat evropiane", mbështetet në ato çfarë BE identifikon si vlera bazë të çdo shteti pjesëtar: "respekti për dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut, liria, demokracia, barazia dhe shteti ligjor". Shprehimisht, BE-ja në përkufizimin e "Vlerave dhe Objektivave" të saj, përjashton nga familja e vet çdo shtet që nuk është i gatshëm të bëjë pjesë të vet këto vlera.

Në përmbyllje, si ide kryesore të këtij kërkimi, synoj të theksoj impaktin etik dhe pozitiv që përballja me të kaluarën e kultivimi i memories kolektive do të ketë në imazhin e Shqipërisë gjatë rrugëtimit drejt demokratizimit dhe integritetit evropian.

#### Studimi ndalet në këto pika kryesore:

1. A është e mjaftueshme hapja e dosjeve të ish-sigurimit të shtetit shqiptar për të konsideruar të mbyllur procesin e ballafaqimit me të shkuarën dhe për t'i dhënë një imazh të besueshëm vendit në procesin e integritetit evropian?

2. Çfarë e bën Shqipërinë një rast ndryshe nga vende të tjera post-komuniste të Evropës Lindore dhe Qendrore? A është kjo mungesa e vullnetit politik për t'u ballafaquar me të kaluarën dhe për të implementuar një ligj si ai i lustracionit (pastrimit të figurës publike) dhe një vështrim në retrospektivë të përpjekjeve për vënien në fuqi të ligjit të lustracionit në Shqipëri.

#### Sa i përket çështjes së parë

Më 30 prill 2015, Parlamenti shqiptar miratoi me 84 vota pro dhe 22 kundër, projektligjin "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të

---

<sup>1</sup> "Lecture by prof. Umberto Eco at the United Nations headquarters in New York on against the loss of memory (October 21, 2013)." Rappresentanza Permanente - Onu New York. October 25, 2013. Accessed June 20, 2018. [https://italyun.esteri.it/rappresentanza\\_onu/en/comunicazione/archivio-nees/2013/10/2013-10-21-eco-onu.html](https://italyun.esteri.it/rappresentanza_onu/en/comunicazione/archivio-nees/2013/10/2013-10-21-eco-onu.html).

Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë". Ky ligj u garanton të gjithëve të drejtën e informimit mbi këto dosje. Një projektligj tjetër u propozua nga shoqëria civile, (nga dy deputetë - një iniciativë joqeveritare), por që u refuzua nga shumica në Parlament. Projektligji tjetër i pa miratuar, përfshinte në titull, përveç zbulimit të dosjeve, edhe "procesin e Lustracionit". Pra, qëllimi i tij shkonte përtej ligjit që arriti të miratohej nga Parlamenti. Ky i fundit, i jep akses publikut në të gjitha dosjet që mbahen në arkiva, në zyrat e autoriteteve publike, të mbajtura nga individë apo institucione private. Ai përmban edhe një listë të zyrtarëve që janë të detyruar të rrëfihen mbi të kaluarën e tyre nëse ata janë në pozita të larta të larta, përfaqësuese të shtetit<sup>2</sup>. Siç u tha më lart, me qëllimin për të dhënë vetëm një përshkrim shumë të shkurtër për atë që rregullon ky ligj, është e dukshme se ai nuk prek asnjë pjesë të procesit të lustracionit, duke lejuar ende ata të mbajnë poste të tilla të larta në institucionet zyrtare, deri në momentin që mund të lindë ndonjë dyshim nga autoritetet e caktuara nga ky ligj. Në Nenin 29 të këtij ligji renditen figurat e Përfaqësuesve të Lartë të Shtetit, informatat personale të të cilëve mund të kërkohen nga Institucionet Kushtetuese dhe nga autoritetet publike, gjatë fazës kur këta persona janë kandidatë për pozitat e listuara. Sipas ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", Neni 29 citon<sup>3</sup>:

*"Neni 29: Kërkesa për informim mbi zyrtarë përpara emërimit ose ngritjes në detyrë:*

*1. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka detyrimin t'i përgjigjet çdo kërkesë të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u emëruar ose ngritur në detyra si: a) President i Republikës; b) anëtarë të Këshillit të Ministrave, zëvendësministra, funksionarë politikë, anëtarë të trupës së nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore dhe pozicione të barasvlershme me to; c) anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtarë e prokurorë në gjykatat e prokuroritë e të gjitha niveleve; ç) anëtarë të Gjykatës Kushtetuese; d) funksionarë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, Gardën e Republikës, oficerë*

---

<sup>2</sup> E. Alliaj. "Kuvendi miraton ligjin për hapjen e dosjeve, ja çfarë parashikon." Balkanweb.com – News24 – Kryesore. April 30, 2015. Accessed June 25, 2018. <http://www.balkanweb.com/site/kuvendi-miraton-ligjin-per-hapjen-e-dosjeve-ja-çfare-parashikon/>.

<sup>3</sup> "Ligj Nr. 45/2015 Datë 30.4.2015 për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", në: *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, botim i QB, Viti: 2015, Nr. 88, f. 4671.



me gradën “Gjeneral” dhe “Kolonel”; dh) prefektë; e) drejtues dhe punonjës të Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes dhe çdo njësi tjetër të inteligjencës; ë) drejtues në Policinë e Shtetit deri në nivel qarku dhe komisariati; f) drejtues të përfaqësive diplomatike; g) guvernatorë dhe zëvendësguvernatorë të Bankës së Shqipërisë; gj) anëtarë të Akademisë së Shkencave, rektorë, zëvendësrektorë, dekanë, zëvendësdekanë në universitetet publike; h) Drejtor i Përgjithshëm dhe zëvendësdrejtorë të Radiotelevizionit Publik Shqiptar; i) Drejtor dhe Zëvendësdrejtor i Agjencisë Telegrafike Shqiptare; j) çdo person tjetër i dekretuar nga Presidenti apo i zgjedhur nga Kuvendi.

2. Autoriteti i përgjigjet institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike për zyrtarin që emërohet ose ngrihet në detyrë, përkatësisht nëse: a) ka qenë ose jo person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; b) ka qenë ose jo bashkëpunëtor aktiv i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji; c) figuron ose jo në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

3. Institucionet kombëtare dhe autoritetet publike, në kuadër të transparencës dhe në funksion të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të zyrtarëve, përpara emërimit ose ngritjes në detyrë, udhëhiqen nga parimi i mosndëshkimit kolektiv dhe respektimit të të drejtave dhe interesave të individit”.

Është e vërtetë që ky nen ngre çështjen e moralit për ata që mbajnë poste të larta zyrtare përfaqësuese të shtetit, por është gjithashtu e qartë se ai nuk ndalon mbajtjen e posteve të tilla. Ky ligj garanton akses në dosjet e tyre, por nuk i detyron ata që të heqin dorë nga kandidatura e tyre. Për të shtuar edhe faktin tjetër, se ky akses i jepet vetëm institucioneve zyrtare sipas Kushtetutës.

*Reflektim:* Një nga detyrimet kryesore që Shqipërisë iu vendos kur mori statusin e vendit kandidat më 24 qershor 2014 ishte ndërmarrja e reformave cilësore përsa i përket 5 çështjeve kryesore të konsideruara të paarritura, duke përfshirë garantimin e shtetit ligjor dhe të drejtave themelore të njeriut<sup>4</sup>. Duke vijuar më tej, unë do ta shikoja këtë çështje jo vetëm si detyrim ndaj BE, por si një çështje që përmban një dozë morali të fortë përballë interesit publik të shqiptarëve. Mosprania e një ligji që ndalon ata që kanë qenë të përfshirë në strukturat e ushtrimit të dhunës në regjimin e kaluar, të jenë pjesë e institucioneve të sotme, e bën situatën krejtësisht të pamoraloshme. Prandaj, ngre pyetjet: a është i mjaftueshëm ky ligj për të përmbushur kushtet për një zhvillim të ardhshëm demokratik? A është ky ligj gjithçka që mund të bëjnë ligjvënësit e këtij vendi për garantimin e drejtësisë, transparencës, vlerave

---

<sup>4</sup> European Commission. "Albania 2014 Progress Report"

morale dhe ndërtimit të besimit për rrugëtimin drejtë Bashkimit Evropian? Siç është komentuar edhe nga shkrimtarët Robert Austin dhe Jonathan Ellison në librin e tyre kushtuar çështjes së Drejtësinë së Tranzicionit në Evropën Lindore, "nuk ka pasur ndonjë përpjekje serioze apo të qëndrueshme nga liderët e Shqipërisë për t'iu përqasur efektivisht të kaluarës komuniste"<sup>5</sup>.

#### Sa i përket çështjes së dytë

Sipas një studimi mbi përvojën e lustracionit të Evropës Qendrore dhe Lindore, ai ka ndodhur si rezultat i një kombinimi të thirrjeve vendore dhe ndërkombëtare. Drejtësia hyri në një periudhë tranzicioni me kërkesën e vetë njerëzve, të cilët u nxitën nga ndryshimet e shumta në sistemin qeverisës. Gjithashtu, nevoja për procesin e lustracionit erdhi nga jashtë si një kërkesë nga vendet fqinje për stabilitet. Ndryshe nga përvoja shqiptare me lustracionin, ku partitë politike morën qëndrime të ndryshme ndaj ligjeve dhe iniciativave, në shumicën e vendeve të tjera që kaluan nëpër të njëjtin proces, partitë politike ranë dakord. Ka pasur gjithashtu raste të mosmarrëveshjes, por vetëm shkaktuar nga mbetjet e ish-Partisë Komuniste. Shembujt vijnë nga Hungaria dhe Çekosllovakia (në atë kohë), ku Partia Socialiste në Hungari dhe Komunistët në Çekosllovakia kundërshtuan ligjet e lustracionit. Përndryshe, në Poloni dhe Sllovakia, procesi u mbështet nga shumica e deputetëve<sup>6</sup>.

Rezultatet e njëjta kanë treguar edhe një studim tjetër, duke dëshmuar se procesi i lustracionit në ditët e sotme është pranuar si një metodë e rëndësishme e adresimit dhe korrigjimit të shkeljeve të së drejtave të njeriut nga regjimet e ish-komunistëve. Çekosllovakia bëri histori me aprovimin e Ligjit të parë të Lustracionit, me ndikim të madh publik, pasuar nga vende të tjera post-komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore, si Gjermania, Lituania, Polonia etj. Në mënyra dhe mënyra të ndryshme, shumica e vendeve post-komuniste të Evropës Lindore dhe Qendrore përqafuan këtë metodë të largimit nga e kaluara dhe pastrimin e rrugës për të ardhmen<sup>7</sup>.

Shembuj të variacioneve në procesin e lustracionit të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore<sup>8</sup>:

---

<sup>5</sup> R. Austin & J. Ellison, *Albania, In Transitional Justice in Eastern Europe and the Former Soviet Union, Reckoning with the Communist Past* (1st ed.). New York: Taylor & Francis e-Library, 2008, p. 176.

<sup>6</sup> C. M. Horne, M. Levi, "Does Lustration Promote Trustworthy Governance? An Exploration of the Experience of Central and Eastern Europe", in: *Building a Trustworthy State in Post-Socialist Transition. Political Evolution and Institutional Change*, Kornai J., Rose-Ackerman S. (eds), New York: Palgrave Macmillan, 2004.

<sup>7</sup> E. Bala, *Si janë hapur dosjet e Sigurimit, gjithë spiunët e Lindjes Komuniste*, Tiranë: 2014.

<sup>8</sup> C. M. Horne, M. Levi, "Does Lustration Promote Trustworthy Governance? An Exploration of the Experience of Central and Eastern Europe" ... .

	Konkurrencë ndërpartiake	Parti të fuqishme socialiste	Ndërhyrja e Gjykatës Kushtetuese	Presioni ndërkombëtar për ndryshimin e ligjeve
Zgjerimi i fushë veprimit të ligjit	Republika Çeke Hungaria Polonia Bullgaria		Republika Çeke Letonia Lituania Polonia	
Ngushtimi i fushë veprimit të ligjit		Polonia Lituania Bullgaria	Shqipëria Hungaria Bullgaria	Republika Çeke Shqipëria
Zgjatjen e kohë veprimit të ligjit	Republika Çeke Hungaria Polonia		Letonia Lituania	
Shkurtimin e kohë veprimit të ligjit		Republika Çeke Bullgaria		Republika Çeke

#### Rasti Shqiptar:

Në një intervistë për BBC, ish-udhëheqësi i Partisë së Punës të Shqipërisë, Ramiz Alia, i cili më vonë u bë Presidenti i parë që sundoi vendin në periudhën post-komuniste, megjithëse me fjalë trishtimi dhe keqardhjeje për 6,000 ekzekutime, ai shpreh dëshirën e tij që Shqipëria të "lërë të kaluarën aty ku është". Sipas mendimit të tij, drejtësia duhet të vihet në vend për viktimat dhe familjet e tyre, megjithatë, duke cituar fjalët e tij, "është mirë që Shqipëria të mos merret me të kaluarën, por me të tashmen e saj"<sup>9</sup>. Prandaj, zgjedha të paraqes këtu një këndvështrim të shkurtër dhe të përgjithshëm mbi problemet e zhvillimit demokratik politik, që, sipas mendimit tim ndikuan në mënyrë drastike në mirë-funksionimin e "drejtësisë së tranzicionit". Për të filluar me ekzistencën e një klase elitë të së kaluarës, e cila, nisur nga zhvillimet historike të postkomunizmit, vërtetoi se vazhdonte të prodhonte fuqi politike, në shumë raste, edhe direkte. Sidoqoftë, historikisht, shumë përpjekje u bënë nga partitë politike njëra pas tjetrës, për të paraqitur projektligjin mbi lustracionin në Parlament. Po i quaj "përpjekje" për arsyen e thjeshtë se ato u shfuqizuan çdo herë me vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Deklarata për falje nga Parlamenti më 1991 ishte një hap i parë drejt njohjes së krimeve të viteve të komunizmit dhe njohjes së vuajtjeve e padrejtësive të mijëra viktimave të sistemit. Në vitin 1993, Ligji i parë i Lustracionit drejtuar avokatëve erdhi në fuqi, por u

<sup>9</sup> "Albania Struggles to Deal with Communist past", në: *BBC News*. April 02, 2010. Accessed April 9, 2018. <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/8599574.stm>.

konsiderua anti-kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, po atë vit. Dy vite pas këtij anulimi, Parlamenti miratoi ligjin “Anti-genocid dhe kundër krimeve të njerëzimit”, pjesë e të cilit ishin krimet e kryera gjatë komunizmit. Pas kësaj, "Ligji për verifikimin" erdhi në pushtet duke lejuar "verifikimin" e "së kaluarës së pastër" paraprakisht të personave që do të zgjidheshin për tu caktuar në pozita përfaqësuese të Shtetit. Ky përsëri u shfuqizua nga Gjykata në vitet në vijim. Edhe ligji i mëpasshëm i miratuar nga shumica në Parlament duke mbrojtur parimin e “mos përfshirjes së përfaqësuesve të lartë të shtetit në të kaluarën komuniste”, u anulua me vendim të Gjykatës Kushtetuese pas shumë vitesh.

Siç u tha dhe më lartë, pas 7 vitesh, në 2015-tën, Shqipëria arriti të ketë një ligj "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", që shënon gjithashtu lëvizjen më të fundit drejt transparencës. Ky akt që hedh dritë mbi atë që deri më vonë është mbajtur sekret, është rezultat i një procesi të gjatë e plot vërejtje dhe nga shoqëria civile e institucione të tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare<sup>10</sup>. Në një kronikë të BBC-së mbi vendet postkomuniste, gazetari Iain MacInnes shprehet: “Që nga rënia e Komunizmit në Evropën Lindore në 1989-tën, shtetet kanë eksploruar mënyra të ndryshme për t’u ballafaquar me të shkuarën e tyre. Shqipëria mori një rrugë krejtësisht të ndryshme nga shumica, çka po sjell efektet e tij ende në ditët e sotme”<sup>11</sup>. Pa u shkëputur nga ky qëndrim, do arsyetoja se e lidhur ngushtë me të është mungesa e një zëri të fortë nga shoqëria civile, e një pranie të vazhdueshme të saj, që të ketë funksionin e një “grupi presioni” të qëndrueshëm. Në debatin publik thuajse inekzistent përreth temës së ballafaqimit me të kaluarën, mund të vëmë lehtësisht re mungesën e pranisë së këtij grupi presioni.

Gjatë një interviste të para disa viteve drejtuar Zj. Mesila Doda, mbështetëse e draftit të ligjit të lustracionit në 2015-tën, ajo theksoi se arsyeja kryesore për mungesën e një ligji lustracioni në Shqipëri është mungesa e vullnetit politik. Sipas saj, ka pasur dhe të tjera iniciativa për të propozuar një ligj të tillë, të cilat ajo i konsideroi të braktisura. Ajo argumentoi më tej se ky fenomen ndodh në Shqipëri për shkak të faktit se një iniciativë e tillë bie ndesh me interesat personal të shumë prej politikanëve e gjykatësve.

Zj. Doda shprehu bindjen se këto pengesa janë po ato që do të krijojnë një problem të madh në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE: “pa një reflektim mbi të kaluarën,

---

<sup>10</sup> “Ligji i Lustracionit, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese Shqiptare ndër vite”, në: *Shekulli*, Nëntor 10, 2010. <http://shekulli.com.al/>

<sup>11</sup> "Albania Struggles to Deal with Communist past", në: *BBC News*. April 02, 2010. Accessed April 9, 2018. <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/8599574.stm>.

është e pamundur të ndërtohet një vizion i qartë për të ardhmen e Shqipërisë”. Ajo vuri në dukje që ekziston një ndryshim i madh mes opinionit publik dhe interesit të politikanëve mbi këtë çështje: 70% e Shqipëtarëve ishin shprehur pro procesit të lustracionit, që do të thotë qartazi se mungesa e tij vjen si pasojë e konfliktit me interesat personal të politikanëve.

Sa i përket rolit të shoqërisë civile, Zj. Doda kritikoi qëndrimin e saj politizuar të shfaqur kryesisht gjatë kohës së debatit parlamentar të draft-ligjit të propozuar nga Shoqata për të Drejtat e Njeriut dhe ish-studentave të demonstratës së vitit 1990. Sidoqoftë, përtej këtyre përcarjeve në shoqërinë civile, publiku i përgjithshëm ka treguar gatishmëri për tu shkëputur nga e kaluara. Në të njëjtën linjë, duhet thënë se tashmë organizatat ndërkombëtare apo dhe shumë institucione i janë përkushtuar kësaj çështje duke drejtuar vëmëndjen e publikut nga ajo dhe duke ngacmuar një debat politik-civil mbi të.

### ***Përfundime dhe rekomandime***

1. Arritja e një ekuilibri ndërmjet "interesit publik" dhe "të drejtave individuale" duhet të jetë një parim për të udhëhequr procesin e ligjit të lustracionit në Shqipëri.

2. Hapat e Shqipërisë drejt BE duhet të jenë paralele me hapat drejt procesit të lustracionit në administratën e saj, Gjykatat, dhe pozicionet politike.

3. Përvoja evropiane na orienton drejt vlerave të BE për demokraci të qëndrueshme, një luftë serioze kundër korrupsionit dhe një ideologji demokratike në çdo element të aparatit të tij publik.

Në përmbyllje, komunizmi me qëllimin e tij për të ndërtuar “Njeriun e Ri”, arriti të zhdukte që nga gjeneza, çdo përpjekje për kultivimin e mendimit kritik, mendimit të lirë e të pavarur dhe nguliti thellë në mentalitetin e njerëzve konceptin e frikës. Ndaj, konsolidimi me të shkuarën dhe edukimi i brezave të ardhshëm mbi krimet e komunizmit do të përkthehej ndryshe në ripërfitim të këtyre vlerave të humbura njerëzore, etike e të drejta, për t’i hapur rrugën zhvillimit të shëndetshëm e të qëndrueshëm demokratik të vendit.

# **Etleva Demollari - Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"**

## **Muzeu kombëtar i përgjimeve "shtëpia me gjethe" në përballje me të kaluarën**

**(Pasqyrimi i burgjeve dhe i kampeve të internimit të regjimit komunist në muze)**

### **Abstrakt**

Hidhet një vështrim në të kaluarën komuniste me dhunë fizike e sidomos psikologjike e në burgjet dhe kampet e internimit dhe si pasqyrohet ajo në Muzeun Kombëtar të Përgjimeve: "Shtëpia me Gjethe" si një nga ish-institucionet kryesore të ushtrimit të kësaj dhune.

Ky punim ka për qëllim të tregojë rolin e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe" në përkujtimin e dhunës në kuadër të drejtësisë tranzicionale si muze, memorial dhe vend kujtese i një trashëgimie të vështirë, dhe mënyrën se si mësohet mbi komunizmin (në këtë punim mbi burgjet dhe kampet e internimit gjatë regjimit komunist) në muze.

Trashëgimia kulturore materiale mbart nocionet e vazhdimësisë së njerëzimit dhe lidh të tashmen me të kaluarën. Mirëpo trashëgimia materiale nuk shihet vetëm si një bartës ose një përfaqësim i identiteteve, por dhe si materializim apo objektizim i identitetit. Trashëgimia fizike është një dëshmi se e kaluara ka ekzistuar dhe ende ekziston sot. Kur identiteti i materializuar i trashëguar është një identitet që njerëzit sot nuk duan ta kenë ky mund të bëhet problematik.<sup>1</sup>

Kur një diktaturë lë mbetje fizike, a është e mundur që popullata të ndjejë se kjo trashëgimi u takon atyre, pjesë e identitetit të tyre, diçka për të cilën ata duhet të jenë përgjegjës për ta ruajtur dhe për ta përdorur si pasuri?

### ***Qasja ndaj trashëgimisë së vështirë komuniste***

Trashëgimi tradicionalisht është konsideruar pjesa e madhërishtme dhe unike e së kaluarës sonë, por koncepti i trashëgimisë është zgjeruar dhe tashmë edhe vendet e dhimbjes dhe traumës mund të përfshihen në trashëgimi.<sup>2</sup> Përkufizimi i UNESCO-s për *trashëgiminë kulturore* në Draft Planin Afatmesëm të viteve 1990-1995: "Trashëgimia kulturore i jep çdo vendi të veçantë karakteristikat e veta të njohura dhe është depoja e përvojës njerëzore"<sup>3</sup> e

---

<sup>1</sup> Sheron Macdonald, *Difficult heritage: Negotiating the Nazi Past in Nuremberg and Beyond*. London: Routledge, 2009. p. 10.

<sup>2</sup> David Lowenthal, *Possessed by the past: the heritage crusade and the spoils of history* New York: Free Press, 1996, p. 14; si dhe *Places of pain and shame: dealing with "difficult heritage"*, edited by W. Logan, & K. Reeves, Abingdon: Routledge, 2008, p. 1.

<sup>3</sup> J. Jokilehto, "Definitions of Cultural Heritage References to Documents", in: *History*, ICCROM Working Group 'Heritage and Society', 2005, p. 5 in: [http://cif.icomos.org/pdf\\_docs/Documents%20on%20line/Heritage%20definitions.pdf](http://cif.icomos.org/pdf_docs/Documents%20on%20line/Heritage%20definitions.pdf), vizituar më 12 dhjetor 2018.

përcakton trashëgiminë si një magazinë të përvojave tona gjë që nuk do të thotë që ajo duhet të jetë diçka pozitive ose diçka që një shumicë dëshiron ta ruajë. Trashëgimia në këtë kuptim mbart kujtimet e shoqërisë dhe ka të bëjë me progresin dhe suksesin, ashtu si dhe me dështimet dhe vuajtjet.

*Trashëgimia komuniste* përfshin ndërtimin dhe përdorimin e ndërtesave dhe monumenteve nga periudha 1945-1990 në Shqipëri. Trashëgimia është "ajo pjesë e së kaluarës që ne zgjedhim në të tashmen për qëllime bashkëkohore, qofshin ato ekonomike, kulturore, politike apo sociale"<sup>4</sup>, por siç është shkruar më lart, trashëgimia është një depo e përvojave njerëzore, duke përfshirë vuajtjet dhe dështimet që i japin karakterin një vendi. Macdonald e përkufizon trashëgiminë e padëshiruar si "një trashëgimi që shumica e popullsisë nuk do të preferonte ta kishte"<sup>5</sup> ndërsa Light e etiketon trashëgiminë e periudhës socialiste në Rumani si të padashur nga rumunët.<sup>6</sup> Megjithatë, mendojmë se trashëgimia nga periudha komuniste në Shqipëri është një *trashëgimi e kundërshtuar dhe e vështirë*, për shkak të kontrollit të rreptë që praktikonte regjimi komunist dhe për shkak të afërsisë në kohë. Supozimi se kjo është një trashëgimi e vështirë mbështetet edhe nga numri i pakët i ekspozitave apo projekteve ku të theksohet e kaluara komuniste si dhe nga vendimet e argumentet për heqjen e mozaikut të Muzeut Historik Kombëtar,<sup>7</sup> për prishjen e Piramidës, nga debatet mediatike mbi ndërtimin e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve: "Shtëpia me Gjethe"<sup>8</sup> apo mbi Memorialin e kampit të Tepelenës.<sup>9</sup>

Ruajtja e trashëgimisë së periudhave dhe ngjarjeve të vështira vjen nga dëshira për të ruajtur kujtimet e një periudhe të rëndësishme në histori dhe për të mos lejuar që historia të përsëritet.<sup>10</sup> Macdonald shkruan për "sipërmarrësit e kujtesës", njerëz që përpiqen të nxisin kujtesën publike. Ata veprojnë kështu sepse kanë qenë viktimë ose sepse ndiejnë një detyrim

---

<sup>4</sup> Graham, B., Ashworth, G. J. & Tunbridge, J. E. "The uses and abuses of heritage" in: *Heritage, museums and galleries: an introductory reader* edited by Corsane, G. London: Routledge, 2005, p. 15.

<sup>5</sup> Sharon Macdonald, *Undesirable Heritage: Fascist Material Culture and Historical Consciousness in Nuremberg*, New York: Free Press, 2006, p. 9.

<sup>6</sup> D. Light, "An Unwanted past: contemporary tourism and the heritage of communism in Romania" in: *International Journal of Heritage Studies* 2000, p. 22.

<sup>7</sup> Në vitet e para të demokracisë, flamurit në qendër të mozaikut iu hoq ylli me pesë cepa dhe germat PPSH. Për shkak të ideologjisë komuniste të shprehur nga kjo vepër arti, ka pasur mendime kontradiktore mbi ruajtjen e tij. <https://www.shqiperia.com/Te-hiqet-mozaiku-ideologjik-nga-Muzeut-Historik-Kombetar.3269/>

<sup>8</sup> Debati ndërmjet gazetarit Robert Rakiplari me kryeministrin Edi Rama në emisionin 'Studio e Hapur', në: <http://www.hapur.al/2018/03/22/teatri-kombetar-rakiplari-nuk-preket-asgje-nga-arkitektura-sovjetike-shtepia-giethe-behet-shtepi-muze-tk-prishe/> Gazetari Robert Rakiplari në emisionin 'Studio e Hapur' gjatë debatit me kryeministrin, Edi Rama.

<sup>9</sup> <http://www.gsh.al/2018/03/30/debati-mbi-komunizmin-xhufi-tepelena-ska-qene-aushvic-tufa-enverist-vjeter-ja-deshmite/>

<sup>10</sup> D. Light, "Gazing on communism: Heritage tourism and post-communist identities in Germany, Hungary and Romania" in: *Tourism Geographies* 2000:2 p. 157. Ashworth vë në dukje se ky argument nuk qëndron pasi dhuna dhe represioni përsëriten edhe pse njohuritë tona rreth dhunës në të kaluarën janë rritur. Ashworth (2008) fq. 241

moral për të theksuar kujtimet e së kaluarës të vështirë, duke synuar që historia të mos përsëritet.<sup>11</sup>

Këtij veprimi i kundërvihet qëndrimi i atyre që argumentojnë se ruajtja e një trashëgimie të vështirë mund të kuptohet si një kremtim dhe përkujtim i regjimit të kaluar, pasi vendet ose objektet të cilat janë etiketuar si trashëgimi, tradicionalisht janë parë si pjesë të së kaluarës që meritonin admirim. Për më tepër ekziston rreziku që siti i trashëgimisë të kthehet në një vend pelegrinazhi për njerëzit që nderojnë regjimin e kaluar, i cili ka qenë një argument i fuqishëm në debatin lidhur me paraqitjen e trashëgimisë naziste në Gjermani.<sup>12</sup>

Disa kërkojnë prishjen apo braktisjen dhe argumentojnë se ruajtja e trashëgimisë nga një regjim i mëparshëm mund të jetë pengesë për zhvillimin e vendit dhe për ndërtimin e një identiteti të ri kombëtar, si për shkak të nevojës për të harruar dhe për të ecur përpara, ashtu edhe për shkak se çdo sistem politik duhet të ketë peizazhin e vet që simbolizon vlerat e veta.<sup>13</sup> Të tjerë, në kundërshtim me këtë, argumentojnë se nuk duhet të përsërisim sjelljen e regjimeve shtypëse dhe të prishim çdo gjurmë të së kaluarës.<sup>14</sup>

### ***Trashëgimia komuniste dhe drejtësia tranzicionale***

Ballafaqimi me trashëgiminë e së kaluarës është subjekt i drejtësisë tranzicionale, e cila bazohet në supozimin se çdo formë e tranzicionit nga dhuna në bashkëjetesë paqësore kërkon zbulimin e ngjarjeve të kaluara dhe krijimin e një forme të drejtësisë për viktimat në veçanti dhe për shoqërinë në përgjithësi<sup>15</sup>. Në mënyrë konvencionale, *drejtësia tranzicionale*, term i lindur në fund të shek. XX, përfshin një numër mekanizmash si komisionet e së vërtetës, gjykatat, lustracionin, dëmshtëpërblymjet dhe kohët e fundit edhe veprat e kujtesës, duke përfshirë muze e memorialë që trajtojnë padrejtësitë e kaluara.

Përkujtimi dhe drejtësia tranzicionale janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Ballafaqimi me padrejtësitë e kaluara gjithmonë kërkon njëfarë "kthimi" drejt tyre, qoftë nëpërmjet nocionit të së vërtetës, mbledhjes së dëshmive, apo vendosjes të dëshmive historike në kontekstin e një salle gjyqi. Për më tepër, nga një perspektivë normative, po shfaqet një "paradigmë e re përkujtimi, e orientuar drejt së ardhmes që kërkon të përdorë

---

<sup>11</sup> Sh. Macdonald, *Difficult heritage: negotiating the Nazi Past ...*, p. 5.

<sup>12</sup> *Po aty*, p. 3.

<sup>13</sup> D. Light, "Gazing on communism: Heritage tourism ...", p. 159.

<sup>14</sup> C. Long, & K. Reeves, "Dig a hole and bury the past in it: reconciliation and the heritage of genocide in Cambodia" in: *Places of pain and shame: dealing with "difficult heritage"* eds. Logan, W. & Reeves, K. Abingdon: Routledge, 2008, p. 78

<sup>15</sup> S. Romeike, (2016) *Drejtësia Tranzicionale në Gjermani pas 1945 dhe pas 1990* Tiranë: International Nuremberg Principles Academy, botim special, f. 10. [www.ahrg-al.org](http://www.ahrg-al.org)



njohjen e së kaluarës, veçanërisht traumën dhe dhunën e saj, për të krijuar një të ardhme më të mirë"<sup>16</sup>.

Një pikë e përbashkët e muzeve dhe e drejtësisë tranzicionale lidhet me rëndësinë që u japin ato gjithnjë e më shumë viktimave. Në shumë nisma të drejtësisë tranzicionale ka një kujdes gjithnjë në rritje për nevojat dhe shqetësimet e viktimave, duke i përcaktuar ato si një nga grupet kryesore të synuara të procesit. Kjo gjithashtu shprehet nga një rritje e përkujtimeve përmes muzeve e memorialeve si një mekanizëm i drejtësisë tranzicionale, duke plotësuar komisionet e së vërtetës, gjykimet, proceset e lustracionit dhe të tjera të ngjashme, ku ato janë kryesisht të përfshira në rubrikën e dëmshpërblimeve simbolike për viktimat e padrejtësive<sup>17</sup>.

### *Shqipëria në ballafaqim me të kaluarën e saj komuniste*

Më datën 25 janar 2006, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi një rezolutë, me anën e së cilës dënonte krimet e komunizmit duke i cilësuar ato si ekuivalente me krimet e nazizmit<sup>18</sup>. Shqipëria, votoi pro kësaj rezolute por ka pasur një fillim të ngadaltë për krijimin e një kuadri më të gjerë në të cilin të angazhohet për t'u përballur me të shkuarën komuniste. Dy rezolutat për dënimin e krimeve të komunizmit<sup>19</sup>, Ligji për hapjen e dosjeve të ish Sigurimit të Shtetit më 2015, nismat e ndërmarra prej Autoritetit të Informimit mbi Dosjet e Sigurimit të Shtetit, prej Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, Institutit për Demokraci Media dhe Kulturë, si edhe nga organizata dhe shoqata të ndryshme, tregojnë për një angazhim më aktiv me të kaluarën, në fusha të ndryshme, por ajo që ne do të shohim më nga afër në prezantimin tonë: kujtimi përmes institucioneve të trashëgimisë kulturore të cilët përbëjnë, siç e shprehëm më lart, një formë të dëmshpërblimit moral për viktimat dhe një nga mekanizmat e funksionimit të drejtësisë tranzicionale.

Që më 23 maj 2017, Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe" i është shtuar hartës së "Rrugëve të Kujtesës"<sup>20</sup>, si vend kujtese i diktaturës komuniste duke zënë vend krahas

---

<sup>16</sup> L. Bickford and A. Sodaro, 'Remembering Yesterday to Protect Tomorrow: How the Current Paradigm of Memorialization Relies on Assumptions about the Relationship between Past and Future', in *Memory and the Future. Transnational Politics, Ethics and Society*, edited by Y. Gutman, A. Brown and A. Sodaro, Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2010, pp. 67. 66–88.

<sup>17</sup> S. Buckley-Zistel dhe S. Schäfer, *Memorials in times of transition*, UK: Intersentia Publishing Ltd, 2014, p. 27.

<sup>18</sup> *Dokumenti i plotë i KE për dënimin e krimeve të komunizmit*, "Expres", 26 janar 2006, f.10.

<sup>19</sup> Rezoluta 'Për dënimin e Krimeve të kryera nga Regjimi komunist në Shqipëri' u miratua nga Kuvendi dhe hyri në fuqi më 30 tetor 2006, ndërsa ajo "Për dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtjen e vlerave demokratike dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut" në nëntor 2016. *Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 30 tetor 2006, në gazeta "55"*, 1 nëntor 2006, f. 16.

<sup>20</sup> <https://www.pressreader.com/albania/gazeta-shqiptare/20170913/281891593438681>

institucioneve të tjera kulturore dhe edukative me misionin: *përkujtimi i dhunës psikologjike dhe i kontrollit të qytetarëve gjatë regjimit komunist përmes ish Sigurimit të Shtetit, duke inkurajuar dialogun me dhe midis qytetarëve për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen shqiptare*<sup>21</sup>.

Projekti për transformimin e “Shtëpisë me Gjethe”, që në dokumentet e Sigurimit të Shtetit kodifikohej me emrin "Gjethi", në Muzeun Kombëtar të Përgjimeve, u iniciua nga Ministria e Kulturës në vitin 2014 dhe u mbështet nga një ekip shumëdisiplinor historianësh, shoqatash të viktimave, institucioneve, inxhinierësh dhe mjeshtërish nga vende të ndryshme. Debatet publike që shoqëruan hapjen e tij<sup>22</sup> dhe që ende vazhdojnë kanë të bëjnë me trashëgiminë e vështirë komuniste.

### ***Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe" si vend kujtese***

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe" është një vend autentik kujtese. Termin vend kujtese e përdorim sipas përkufizimit që i ka dhënë Pierre Nora<sup>23</sup> në *Lieux de Memoire*: “Një objekt bëhet vend kujtese kur ai i shpëton harresës, për shembull me vendosjen e pllakave përkujtimore dhe kur një komunitet e rivlerëson atë me ndjenjat dhe emocionet e veta”.

Deri në vitin 1991, kjo shtëpi modeste në mes të Tiranës, ka shërbyer si selia e drejtorisë së teknikës operative të Sigurimit, që veproi gjatë gjithë diktaturës së gjatë të Enver Hoxhës. Vendndodhja e saj ishte vendimtare në gjeopolitikën e qytetit, sepse kishte pamjen "normale" të një vile, por në fakt ishte vendi nga ku kryheshin përgjimet telefonike të ambasadave, hoteleve, zyrave e shtëpive dhe kontrolli i letërkëmbimeve të personave të dyshuar nga regjimi. Vendet autentike janë veçanërisht të dobishme për të dhënë informacion në lidhje me epokën e kaluar. Çdo hapësirë është e hapur për publikun, duke e lejuar shtëpinë të flasë vetë. Asgjë nuk është hequr, as letrat, vizatimet, dhe natyrisht as qindra pajisje teknike. Përveç përshkrimit të pajisjeve, origjinës së tyre, kohës së blerjes dhe të përdorimit, objektet shoqërohen me dokumentet e shkruara të marra nga Arkivat të cilat dëshmojnë për pasojat e përgjimit. Fuqia e vendeve autentike dhe e objekteve autentike ofron një mundësi unike për të kuptuar më mirë

---

<sup>21</sup> Në Rregulloren e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve: “Shtëpia me Gjethe”.

<sup>22</sup> <http://www.kultura.gov.al/fjala-e-ministres-se-kultures-znj-mirela-kumbaro-ne-takimin-vendet-e-kujteses/> dhe <http://time.ikub.al/16-09-01-Gjethi-muzeu-i-pergjimit-komunist-pa-dokumentet-e-ndihmen-e-SHISH/Gjethi-muzeu-i-pergjimit-komunist-pa-dokumentet-e-ndihmen-e-SHISH.aspx>

<sup>23</sup> *Les Lieux de mémoire*, Gallimard (Bibliothèque illustrée des histoires), Paris, 3 vëllime: vëll. 1 *La République* (1 vol., 1984), vëll. 2 *La Nation* (3 vol., 1986), vëll. 3 *Les France* (3 vol., 1992), fq 8.

të kaluarën. Të njëjtën fuqi kanë dhe dëshmitarët e kohës - njerëz që mund të përshkruajnë funksionimin e diktaturës nga përvoja e tyre.

### ***Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe" si muze dhe memorial***

Ndërkohë që një muze konsiderohet konvencionalisht si një institucion që i dedikohet ruajtjes së objekteve me vlerë dhe edukimit të publikut<sup>24</sup>, me qëllim që të ruajë, të regjistrojë dhe të prodhojë trashëgimi kulturore të së kaluarës dhe të së tashmes<sup>25</sup>, memorialet janë në funksion të nevojave të qytetarëve, kontribuojnë në shërbimin publik duke përkujtuar të kaluarën dhe/ose duke i dhënë vlerë morale të kaluarës<sup>26</sup>. Muzetë që trajtojnë shtypjen komuniste, terrorin nazist dhe/ose komunist gjatë kryerjes së funksioneve tradicionale muzeore, përpiqen të bëhen memoriale, me funksione të dobishme dhe me qëllime sociale<sup>27</sup>.

Një tipar i rëndësishëm që tregon se Muzeu Kombëtar i Përgjimeve është dhe memorial është pjesa më e shquar e repertorit arkitekturor të memorialeve në përgjithësi: emërtimi i viktimave (të ekzekutuar dhe të burgosur)<sup>28</sup>. Më së shumti, në memorial, emrat janë të gdhendur në mure guri. Ndërsa kjo praktikë është përdorur tashmë në lidhje me përkujtimin e ushtarëve të vrarë gjatë Luftës së Parë Botërore, me kalimin e kohës u transferua tek viktimat civile. Për shembull, në Sallën e Emrave në Yad Vashem, emrat lexohen me zë të lartë. Gjithashtu, në Muzeun Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe", fotografitë e viktimave shfaqen në vend të emrave të thjeshtë<sup>29</sup>. Të dyja mjetet, listat e emrave dhe fotografitë, synojnë të personalizojnë atë që ndryshe do të ishte një numër abstrakt i atyre që vdiqën, u zhdukën apo u dënuan pa të drejtë. Në rastet kur viktimat u shpërfytyruan ose në të cilat nuk mund të gjendet asnjë trup, kjo praktikë përkujtimore kërkon t'i rifitojë të vdekurit si një qenie njerëzore dhe simbolikisht të zhbëjë dehumanizimin e autorëve. Përveç kësaj, projektet përkujtimore që trajtojnë incidentet e kontestuara ose të mohuara të dhunës, shërbejnë si një mjet për të pohuar vërtetësinë e ngjarjes së përkujtuar. **Fig.1 dhe 2**

Muzeu në fakt i vë theksin më shumë pasojave të përgjimit sesa kuriozitetit të mënyrës së përgjimit. Përveç pajisjeve të sofistikuara të përgjimit dhe ekspozimit të dosjeve të

<sup>24</sup> S. Crane, "Memory, Distortion, and History in the Museum", in: *History and Theory*, vol. 36, no. 4, Teme Issue 36: Producing the Past: Making Histories Inside and Outside the Academy, December, 1997, p. 44.

<sup>25</sup> *Po aty*, p. 48.

<sup>26</sup> Mayo J. M., "War Memorials as Political Memory", in: *Geographical review*, vol. 78, no. 1, January, 1988, p. 62.

<sup>27</sup> Funksionet kryesore janë ruajtja dhe edukimi. Qëllimet sociale kanë të bëjnë me identitetin, shërbimin, nderimin, humanitarizmin.

<sup>28</sup> Në dhomën nr. 14 të muzeut. Gjithashtu shih: *Udhërrëfyes i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"*, Tiranë: 2017, f. 45.

<sup>29</sup> Në dhomën nr. 13 të muzeut: "Proceset politike". Gjithashtu shih : dhe *Udhërrëfyes i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"*, Tiranë: 2017, f. 43.

bashkëpunëtorëve, vihet në pah humbja e jetëve, burgimet, internimet, dëbimet, degradimi shoqëror e profesional. Muzeu përdor statistika, të dhëna, grafikë dhe tekste në mure, në perde dhe në shumë sipërfaqe të tjera, për t'i dhënë një zë shtëpisë por njëkohësisht duke lënë të dëgjohen zërat e njerëzve, historitë e viktimave të cilëve ai u dedikohet<sup>30</sup>.

### ***Mësimi mbi komunizmin (mbi burgjet dhe kampet e internimit) në muze***

Muzetë historikisht janë projektuar për të edukuar. Në mënyrë të qëllimshme apo jo, muzetë japin pikëpamjen e vet rreth asaj që është e vlefshme për t'u nxënë, dhe mënyra sesi paraqiten objektet dhe materialet historike - nga ekspozimi tek arkitektura e deri tek tekstet përmbledhës apo diçiturat - shprehin pikëpamjet e muzeut mbi ngjarjet e kaluara. Muzetë nxisin të nxënit aktiv i cili ndodh kur njerëzit e shtyjnë mendjen e tyre të ndërveprojë me informacionin dhe përvojën që u jepet. Si teatro të të mësuarit aktiv, muzetë dallojnë nga shkollat dhe mjediset e tjera formale arsimore sepse ata i bëjnë ofertat e tyre edukuese në heshtje dhe pa kërkesa. Në muze, vizitorët janë të lirë të lëvizin me ritmin e vet dhe të vendosin rrugëtimin e tyre. Ata janë të lirë të zgjedhin nëse duhet të lexojnë tekstin përmbledhës apo të dëgjojnë gjuhën, të lirë të ndjekin drejtimin e rekomanduar në një ekspozitë ose të zgjedhin rrugën e tyre. Sigurisht, liria e zgjedhjes në muze nuk është e pakufizuar, e as nuk duhet të jetë. Ka shumë rregulla për t'u ndjekur, shumë informacione udhëzuese rreth asaj se çfarë duhet të shikohet. Por, në përgjithësi, muzetë më shumë ftojnë për të nxënë sesa e kërkojnë atë, prandaj shpesh quhen "zgjedhje e lirë" ose mjedise informale të të nxënit. Ky është një tipar i të nxënit më të mirë në përgjithësi. Studimet tregojnë se kur njerëzit kanë njëfarë lirie zgjedhjeje për formën dhe drejtimin e të nxënit - mësimi tenton të jetë më kuptimplotë dhe më i fuqishëm<sup>31</sup>.

### ***Rrëfimi në muze bëhet nga pikëpamje të ndryshme:***

Nëpërmjet paneleve, diçiturve, statistikave jepet **pikëpamja e Muzeut**. Që në fillim të vizitës, vizitori njihet me dhunën e torturat çnjerëzore që shoqëronin arrestimin e hetimin<sup>32</sup>, në shkelje flagrante të të drejtave të njeriut. Torturat e ndryshme të përdorura në hetuesi deri në vitin 1948, dëshmohen nga një oficer i Sigurimit të Shtetit, Kapiten i Klasit I-rë: Muço Saliu me anë të dokumentit nr 2. Ndërsa dokumenti nr.1 është kopje e *Relacion në lidhje me të paraburgosurin Mahmut Raufi* nga hetuesi: toger Haki Kota, i cili jep udhëzime për përdorimin

<sup>30</sup> Deklaratë në hyrje të muzeut. *Shih: dhe Udhërrëfyes i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethë"*, Tiranë: 2017, f. 5.

<sup>31</sup> Sh. Tishman, *Learning in Museums*, 2005 <https://www.gse.harvard.edu/news/uk/05/09/learning-museums-0>

<sup>32</sup> Në dhomën nr. 2 të muzeut: "Dhoma e Hetuesisë". Gjithashtu *shih: Udhërrëfyes i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethë"*, Tiranë: 2017, f. 19.

e torturës mbi një të arrestuar për ta detyruar të rrëfëhet. Për të pasur një impakt edhe më të madh mbi vizitorin, disa lloje torturash janë të skicuara në mur.

Më pas pasqyrohen foto të personave të dënuar nga regjimi komunist për arsye politike në gjyq dhe jepet informacioni i mëposhtëm: *Në Shqipëri, gjatë periudhës së diktaturës (në një popullsi prej 1 milion banorësh më 1945 dhe prej 3 milionësh afërsisht më 1990), janë burgosur për motive politike rreth 18 000 vetë, nga të cilat gati 8 000 gra; kanë vdekur në burgjet politike mbi 1000 vetë (më tepër se 1 në çdo 20 të burgosur); kanë humbur aftësitë mendore nga torturat mbi 400 vetë; janë internuar mbi 20 000 familje dhe kanë vdekur në internime mbi 7 000 qytetarë nga të gjitha moshat; janë ekzekutuar me ose pa gjyq për motive politike mbi 6 000 vetë, nga të cilët 450 gra (eshtrat e shumë prej tyre ende nuk janë gjetur)*<sup>33</sup>.

Në dhomën nr. 14 të muzeut janë listuar emrat e të burgosurve dhe të ekzekutuarve politikë, ndërsa në perden e dritares së dhomës është printuar informacioni i mëposhtëm në lidhje me burgjet dhe kampet në Shqipëri në kohën e komunizmit:

*Me një popullsi të vogël prej 1.2 milionë banorësh në vitet e para të pasluftës, pasojat e terrorit komunist në Shqipëri ishin shkatërrimtare dhe u përjetuan në mënyrë dramatike. Në vitin 1947, Shqipëria komuniste kishte tashmë 18 burgje, 8 nga të cilët për të “burgosur politik”, 7 për ordinerë dhe 3 të përzier. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, në vitin 1955 kishte 5 burgje kryesore, të emërtuara në mënyrë ushtarake si “reparte”: Reparti nr. 315 (Shkodër), Reparti nr. 319 (Vlorë), Reparti nr. 317 (Korçë), Reparti nr. 313 (Tiranë), Reparti nr. 321 (Burrel).*

*Kapaciteti i burgjeve komuniste në vitin 1950 ishte rreth 3 000 të burgosur. Ndërsa në një statistikë të vitit 1951, në burgje ndodheshin 7 168 të burgosur, të dënuar për “krime politike dhe ordinere”. Përveç burgjeve, regjimi komunist hapi edhe kampe të punës së detyruar, në të cilat të burgosurit shtrëngoheshin të punonin në kushte shumë të vështira për të ndërtuar hekurudha, rrugë, fabrika, miniera etj. Kampet e punës u hapën në të gjithë vendin dhe sipas statistikave të MPB në vitin 1953, në to punonin më shumë se 6 700 të burgosur. Ky dimension i terrorit të viteve të para vazhdoi gjatë gjithë kohës së regjimit komunist deri në rënien e tij më 1991.*

### ***Këndvështrimi i të dënuarve të regjimit komunist jepet përmes dëshmime gojore***

Në muze janë përdorur dokumentarë e intervista të shumta të të persekutuarve politikë gjatë regjimit komunist dhe të familjarëve të tyre të cilat janë realizuar nga: Instituti i

---

<sup>33</sup> Në dhomën nr. 13 të muzeut: “Proceset politike”.

Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Albanian Human Right Project, Arkivi Qendror i Shtetit, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Radio Televizioni Shqiptar etj. Në shumë prej tyre flitet për burgjet dhe kampet e internimit<sup>34</sup>.

Por, për herë të parë në Shqipëri, një muze, Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethë” ka realizuar vetë intervista dhe ka marrë dëshmi gojore. Pra, është vetë Muzeu që përdor Historinë e treguar si një metodë, një mënyrë për të mbledhur informacion nga njerëz që kanë pasur kontakt me historinë, me Sigurimin e Shtetit, që kanë jetuar përmes ngjarjeve ose periudhave dhe që kanë dëshirë të reflektojnë jo vetëm mbi atë që ndodhi por dhe mbi atë se si ata e kanë përjetuar atë periudhë.<sup>35</sup>

Nga ana tjetër, programet edukative që organizon muzeu synojnë rehabilitimin e të dënuarve dhe të mbijetuarve pasi ata ftohen të flasin në mënyrë sistematike në muze jo vetëm për vuajtjet e tyre në burgje e kampe internimi por dhe për qëndresën, u japin mësim të rinjve si të kenë një qëndrim kritik në jetë<sup>36</sup>.

### *Dosjet e Sigurimit të Shtetit ekspozohen për herë të parë*

Në dosjet dhe dokumentet e tjera arkivore të kohës jepet **pikëpamja e Sigurimit** të Shtetit mbi bashkëpunëtorët apo viktimat e terrorit komunist. Përmes tyre, në mënyrë të tërthortë mund të kuptohen dhe metodat që përdorte Sigurimi për rekrutimin e bashkëpunëtorëve. Kështu, tregohet se si rekrutohet një i burgosur<sup>37</sup> duke na dhënë informacion për presionin dhe dhunën psikologjike që ushtrohej mbi të burgosurit<sup>38</sup>. Në këtë mënyrë, vizitori mund të kuptojë se si funksiononte procesi i rekrutimit të bashkëpunëtorëve, se si bashkëpunëtori vetëkontrollohej nga oficeri i Sigurimit, si funksiononte regjimi totalitar.

---

<sup>34</sup> Në dhomën nr. 26 “Propaganda e përditshme”, në dhomën nr. 13 “Proceset politike” dhe në intervistat në dhomën nr. 31, “E kaluara e pakryer”.

<sup>35</sup> Ndërmjet tyre janë përjetimet e Adrian Katit në internim e që rrëfen ndjesitë e të qenit i përgjuar në dhomën 26.

<sup>36</sup> Programi Edukativ: “Kujtojmë për të mos harruar”, në: [www.muzeugjethi.gov.al](http://www.muzeugjethi.gov.al)

<sup>37</sup> Në dokumentin nr. 6 të dosjes së bashkëpunëtorit “Bufeja e Madhe”, në dhomën nr. 11, Sektori 2: *Mikrofonat e Gjallë*.

<sup>38</sup> Kastriot Dervishi, *Sigurimi i Shtetit 1944 – 1991*, Tiranë: “55”, 2012, f. 67.

Në muze janë ekspozuar vendime të ndryshme gjyqësore kundër “Grupit të agjentëve të shërbimit sekret grek”<sup>39</sup>, kundër “Grupit të naftës”<sup>40</sup>, kundër piktorit Edison Gjergo<sup>41</sup> në bazë të të cilëve shumë njerëz u dënuan me vdekje ose me burgim.

Në dhomën nr. 10, vizitorët mund të dëgjojnë përgjimin origjinal të kryer ndaj Koço Plakut, kur ndodhej në qeli. Zëri i tij jo vetëm që e bën më mbresëlënëse vizitën duke ndikuar emocionalisht mbi vizitorin por është dëshmi autentike e shkeljes së të drejtave të njeriut.

### ***Muzeu si aktor në ballafaqimin me të kaluarën***

Përzgjedhja e citimeve në sektorin e fundit të ekspozitës në sektorin IX: *E kaluara e pakryer* dhe në dalje të muzeut shpreh qartazi pikëpamjen e Muzeut mbi procesin e ballafaqimit me të kaluarën. Muzeu përcjell idenë se plagët e së kaluarës komuniste në Shqipëri ende nuk janë shëruar dhe se varrosja e së kaluarës komuniste nuk sjell as shërim e as drejtësi për ata që e pësuan: *Vetëm duke treguar atë që ka ndodhur mund të "kapërcehet" me të vërtetë e kaluara.*<sup>42</sup>

*E kaluara nuk vdes kurrë. Ajo madje as ka kaluar*<sup>43</sup> sepse ne bartim kujtimin e saj. E kaluara është pjesë e pandarë e jona. Çdo çast i së kaluarës sonë ndërton atë që ne jemi. Kështu që e kaluara jeton brenda nesh. Historia përsëritet, ata që e harrojnë të shkuarën janë të destinuar ta përsërisin. Ndaj asgjë s’duhet të kalojë në heshtje. Asgjë s’duhet të mbetet e pandëshkuar: *Atëherë ndoshta nuk e kuptoja, por më vonë e kam menduar se paskan pasur një kurajë të pacipë këta njerëz që nuk kanë kërkuar falje*<sup>44</sup>... **Fig.3**

Kërkesa për falje, ose njohja e krimeve të kryera dhe marrja e përgjegjësisë, ka potencialin për të qenë një mekanizëm i suksesshëm i drejtësisë tranzicionale. Kjo vlen veçanërisht kur nuk ka asnjë ndjekje penale të autorëve kryesorë. Gjithashtu, falja është një hap i madh drejt kapërcimit të së kaluarës për shkak edhe të rivendosijes së identitetit të viktimave që ajo mund të ofrojë. Regjimi komunist synonte të fshinte identitetet dhe t’i kthente individët

<sup>39</sup>Procesverbal i vendimit të Gjykatës të Rrethit Lushnjë më dt. 17. 03. 1987, nr. 22 i Regjistrimit Themeltar Vendimi kundër “Grupit të agjentëve të shërbimit sekret grek”, në bazë të të cilëve Bujar Jazexhiu dhe Mazllëm Kasa do të dënoheshin me vdekje, ndërsa Sefer Tarelli, Behar Myrto, Qani Braho, Sali Tarreli, Xhevat Tarreli, do të dënoheshin me 15 deri 25 heqje lirie. Në sektorin VII, dhoma nr. 27, *Zëra nga e kaluara*.

<sup>40</sup> Vendim i Gjykatës së Lartë me nr. 12, Regjistri Themeltar dhe nr. 13 Vendimi kundër “Grupit të naftës” që akuzoheshin se kishin sabotuar prodhimin e naftës dhe dëmtuar ekonominë socialiste. Koço Plaku dhe Milto Gjijkopulli u dënuan me vdekje, ndërsa Filip Nashi, Beqir Alija, Protoko Murati, Jani Konomi, Dhimitër Stefa dhe Nuredin Skrapari me burg. Në sektorin 7, dhoma nr. 27, *Zëra nga e kaluara*.

<sup>41</sup> Në sektorin VI të muzeut: *Jeta e Përditshme*, dhoma nr. 25: *Viktima*.

<sup>42</sup> Citim i Hannah Arendt, në sektorin IX: *E kaluara e pakryer*, dhoma nr. 31. Shih dhe *Udhërrëfyes i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethë"*, Tiranë: 2017, f. 73.

<sup>43</sup> Citim i William Faulkner, në sektorin IX: *E kaluara e pakryer*, dhoma nr. 31. Shih dhe *Udhërrëfyes i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethë"*, Tiranë: 2017, f. 73.

<sup>44</sup> Citim i Amik Kasoruhos, në dalje të muzeut. Gjithashtu shih: *Udhërrëfyes i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethë"*, Tiranë: 2017, f. 74.

në matricat e përsosura të rendit të ri socialist. Ishte në natyrën e tij të mos shpjegonte kurrë, kurrë të mos kërkonte falje. Prandaj, një kërkesë faljeje ose të paktën pranimi i krimeve të kryera me siguri do të bënte ndryshim, duke rivendosur dinjitetin e të burgosurve dhe të internuarve politikë, dhe ndoshta duke i ekspozuar disa që ende përfitojnë nga pozicionet që kanë pasur dikur si dhe duke i bërë ata që "vetëm kanë jetuar" nën atë regjim, të reflektojnë mbi të.

### ***Konkluzione***

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe” sikurse gjithë muzetë memorialë e vendet e kujtesës e ka potencialin për të përmirësuar proceset e drejtësisë tranzicionale, duke u mbështetur në të gjitha palët që punojnë së bashku drejt një dobie më të madhe: njëfarë drejtësie dhe parandalimi të përsëritjes së dhunës. Muzeu duke shfrytëzuar të gjitha mjetet muzeografike dhe duke paraqitur këndvështrime të ndryshme jep një kontribut të vyer në diskursin aktual mbi të shkuarën, në njohjen e fakteve, në rivendosjen e dinjitetit të viktimave, në nxitjen e debateve të hapura midis padrejtësive të kaluara duke siguruar dhe një vend për reflektim. Duke e përqendruar aktivitetin e tij kryesisht tek brezi i ri, muzeu synon të nxisë një qytetari aktive dhe e angazhuar me vetëdije, liri dhe frymëzim si mënyra më e mirë kundër abuzimit me të drejtat e njeriut, për ta ndaluar abuzimin para se të fillojë. Ky mund të jetë një drejtim shumë i rëndësishëm në një shoqëri në tranzicion.

### **Bibliografi**

#### **Literaturë**

Buckley-Zistel, S. dhe Schäfer, S., *Memorials in time of transition*, UK: Intersentia Publishing Ltd, 2014.

Crane S., “Memory, Distortion, and History in the Museum”, in: *History and Theory*, vol. 36, no. 4, Teme Issue 36: Producing the Past: Making Histories Inside and Outside the Academy, December, 1997.

Dervishi, K. *Sigurimi i Shtetit 1944 – 1991*, Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2012.

Graham, B., Ashworth, G. J. & Tunbridge, J. E. (2005) “The uses and abuses of heritage” në: *Heritage, museums and galleries: an introductory reader* ed. Corsane, G. London: Routledge.

Jokilehto, J. (2005) *Definitions of Cultural Heritage References to Documents in History* ICCROM Working L. Bickford and A. Sodaro, ‘Remembering Yesterday to Protect Tomorrow: How the Current Paradigm of Memorialization Relies on Assumptions about the Relationship between Past and Future’, in Y. Gutman, A. Brown and A. Sodaro (eds.),



*Memory and the Future. Transnational Politics, Ethics and Society*, Palgrave Macmillan, Basingstoke, 2010, 66–88.

Light, D. (2000) “Gazing on communism : Heritage tourism and post-communist identities in Germany, Hungary and Romania”, in: *Tourism Geographies* 2000:2 .

Light, D. (2000) “An Unwanted past: Contemporary tourism and the heritage of communism in Romania” In: *International Journal of Heritage Studies* 2000.

Long, C. & Reeves, K. (2008) “Dig a hole and bury the past in it': reconciliation and the heritage of genocide in Cambodia” In: *Places of pain and shame: dealing with "difficult heritage"* (2008) eds. Logan, W. & Reeves, K. (eds.) (2008) *Places of pain and shame : dealing with "difficult heritage"* Abingdon: Routledge

Lowenthal, D., (1996) *Possessed by the past: the heritage crusade and the spoils of history* New York: Free Press.

Macdonald, S. (2006) *Undesirable Heritage: Fascist Material Culture and Historical Consciousness in Nuremberg*.

Macdonald, S. *Difficult heritage: Negotiating the Nazi Past in Nuremberg and Beyond* London: Routledge, 2009.

Mayo J. M., “War Memorials as Political Memory”, in: *Geographical review*, vol. 78, no. 1, January, 1988.

Nora, P., *Les Lieux de mémoire*, Gallimard (Bibliothèque illustrée des histoires), Paris, 3 vëllime : vëll. 1 *La République* (1 vol., [1984](#)), vëll. 2 *La Nation* (3 vol., [1986](#)), vëll. 3 *Les France* (3 vol., [1992](#)).

Romeike, S. *Drejtësia Tranzicionale në Gjermani pas 1945 dhe pas 1990* International Nuremberg Principles Academy, Tiranë : 2016, botim special.

*Udhërrëfyes i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"*, Tiranë: 2017.

### **Burime nga Interneti**

<https://www.gse.harvard.edu/news/uk/05/09/learning-museums-0>

[www.muzeugjethi.gov.al](http://www.muzeugjethi.gov.al)

<http://www.gsh.al/2018/03/30/debati-mbi-komunizmin-xhufi-tepelena-ska-gene-aushvic-tufavenverist-vjeter-ja-deshmite/>

<http://www.hapur.al/2018/03/22/teatri-kombetar-rakiplari-nuk-preket-asgje-nga-arkitektura-sovjetike-shtepia-gjethe-behet-shtepi-muze-tk-prishe/>

<http://www.kultura.gov.al/fjala-e-ministres-se-kultures-znj-mirela-kumbaro-ne-takimin-vendet-e-kujteses/>

<http://time.ikub.al/16-09-01-Gjethi-muzeu-i-pergjimit-komunist-pa-dokumentet-e-ndihmen-e-SHISH/Gjethi-muzeu-i-pergjimit-komunist-pa-dokumentet-e-ndihmen-e-SHISH.aspx>

<https://www.shqiperia.com/Te-hiqet-mozaiku-ideologjik-nga-Muzeut-Historik-Kombetar.3269/>

[www.ahrg-al.org](http://www.ahrg-al.org)

<https://www.pressreader.com/albania/gazeta-shqiptare/20170913/281891593438681>

## Roland Qafoku - TV Channel One

### Persekutorët përballë të persekutuarve pas rrëzimit të komunizmit

#### Abstrakt

Zbulimi i së vërtetës si ballafaqim i shumë burimeve vjen përmes intervistave të personazheve të diktaturës komuniste dhe të personave që u persekutuan prej tyre, me një vështrim krahasues mbi ndjenjat e persekutoreve dhe të të persekutuarve si dhe qëndrimet e tyre ndaj asaj që ka ndodhur në diktaturë.

Pas 28 vjetësh, mund të themi se për ne shqiptarët rrëzimi i komunizmit ka qenë një zjarr i shuar keq. Një nga arsytet më të rëndësishme është mungesa e njohjes së atij sistemi dhe media ka pasur dhe ka rolin e vet në këtë histori. Gazetari amerikan Arthur Hays Sulzberger (The publisher of the New York Times from 1935 to 1961) ka thënë: *“Gjykimi i njeriut nuk mund të jetë më i mirë se informacioni që merr. Jepini atij të vërtetën dhe ai do ecë drejt”*. Mbështetur mbi këtë idiomë, në karrierën time kam qenë shumë i tërhequr nga figurat e sistemit komunist. Natyrisht unë rrezikoja të paragjykoheja dhe të gjykoheja nga një pjesë e publikut, por unë gjithnjë kam këmbëngulur ta njoh sa më mirë atë sistem nëpërmjet një rruge që është pjesë e profesionit tim: duke i intervistuar personazhet e atij sistemi dhe jo duke u qëndruar larg atyre. Nëse nuk do ta kisha bërë do ta njihja shumë pak atë sistem dhe, natyrisht, jo siç e njoh tani.

Sa më mirë ta njohësh diktaturën, aq më mirë e ndërton demokracinë. I bindur se e vërteta gjendet në përplasjen dhe ballafaqimin e shumë burimeve, deklaratave, prononcimeve dhe dokumentimin e tyre, unë do përpiqem të sjell sot dhe të vendos përballë njëri-tjetrit personazhe të diktaturës komuniste me personazhe të cilët u persekutuan nga regjimi komunist. Është një punim i bazuar mbi punën time si gazetar në 22 vjet e cila më ka dhënë mundësinë të intervistoj dhe bisedoj me personazhe të regjimit komunist, por edhe me viktimat e tyre. Besoj se është shumë interesante dhe e vlefshme të intervistosh Nexhmije Hoxhën, por edhe Ajnëshah Vlorën; Ramiz Alinë, por edhe Leka Zogun; Hekuran Isain, por edhe Ismail Kadarenë dhe kështu me radhë. Besoj se kështu kupton më qartë se çfarë ka ndodhur gjatë sistemit komunist dhe si e percepton shoqëria shqiptare në ditët e sotme atë që ka ndodhur gjatë asaj kohe.

Kemi 28 vjet që ndërtojmë demokracinë si shoqëri dhe që mjekojmë plagët e marra në 46 vjet komunizëm dhe mund të themi se ende si shoqëri nuk na ka dalë narkoza e komunizmit. Rrjedhimisht, jo vetëm për brezin e ri, por edhe për ata që kanë jetuar edhe në regjimin komunist dhe jetojnë edhe sistemin demokratik, janë një aradhë me pyetje, përgjigjet e të cilave tregojnë shumë: A kanë ndryshuar qëndrimet e ish funksionarëve të regjimit pas rrëzimit të diktaturës?

A janë penduar personazhet e diktaturës, por edhe fëmijët e tyre? Cili është qëndrimi i tyre përballë personazheve që janë persekutuar? A shërben vazhdimi i glorifikimit të rezistencës së Luftës së Dytë Botërore për të përlligjur sistemin komunist? Si e kujtojnë jetën gjatë komunizmit ish funksionarët por edhe të persekutuarit? Cilat janë ndjenjat e tyre ndaj ish persekutorëve? Çfarë kërkojnë ata sot?

Duhet thënë se terreni armiqësor mes këtyre dy kategorive vazhdon të ekzistojë. Personazhet vazhdojnë të jenë armiq me njëri-tjetrin. Edhe pse nuk ka asnjë hakmarrje, sulm fizik apo vrasje, ekziston një polarizim në koncept mes atyre që janë persekutuar dhe persekutorëve apo edhe pasardhësve të tyre. Përse personazhet e sistemit komunist vazhdojnë të jenë magnetikë për medien, rrjedhimisht edhe për shoqërinë tonë? Janë disa arsye madhore:

**E para** lidhet me interesin për të ditur dhe mësuar atë që ka ndodhur në të vërtetë gjatë diktaturës. Për 46 vjet censura, mungesa e informacionit, indoktrinimi ishin ato që shërbyen të përmbysnin realitetin dhe pasi sistemi komunist pushoi së funksionari është detyrë e medias dhe e studiuesve të zbulojnë se çfarë ka ndodhur në realitet. Në këtë kontekst, masa e madhe e njerëzve duan të njihen por edhe të dinë se çfarë mendojnë personazhet që kishin pushtet gjatë regjimit komunist dhe çfarë mendojnë ende për atë kohë. A kanë ndryshuar mendim dhe nëse po përse është ndryshuar ky mendim?

**E dyta** lidhet me nostalgjinë ndaj atij sistemi. Ka një rregull të pashkruar në medien print në këto 28 vjet; nëse do të shesësh gazetën, titull të madh vendos një lajm të fortë aktual politik dhe titull të dytë, pra atë të fotografisë, vendos një dossier me histori nga komunizmi dhe personazhe si Enver Hoxhën, Mehmet Shehun, Kadri Hazbiun etj. Sidomos me këtë të dytën, shitjen e ke të garantuar.

Nisur nga ato që ka ndodhur me medien në këto 28 vjet, duhet theksuar se në aspektin e komunikimit dhe mediatizimit të historisë, periudha pas rënies së komunizmit e deri më sot, ka kaluar në 3 faza.

1. *Faza e parë lidhet me periudhën nga viti 1990 deri në 1997 me dekomunistizimin shtetëror dhe instalimin e institucioneve të reja demokratike. Kjo solli një tulatje të shoqërisë shqiptare duke dënuar, në dukje sistemin, por jo në thelb. Kjo periudhë lidhet edhe me arrestimet dhe dënimet e shumë anëtarëve të dikurshëm të Byrosë Politike dhe shumë funksionarëve të asaj kohe si Ramiz Alia, Nexhmije Hoxha, Rita Marko, Simon Stefani, Hekuran Isaji etj., me akuzën e rëndë gjenocid, për të cilën dënimi ishte vdekje. Arrestimi i tyre dhe ecuria e proceseve gjyqësore u bë një lëndë e parë për medien e asaj kohe dhe publikun.*

2. *Faza e dytë 1997-2007, lidhet me daljen në media gjithnjë e më shumë të figurave të kohës së komunizmit. Të gjithë të arrestuarit e akuzuar për gjenocide u liruan dhe pjesa më e madhe morën pafajësinë. Kjo u cilësia si një fitore e gjyqit të kafeve, për shkak të procesit ndaj të vesë së Enver Hoxhës, Nexhmije Hoxhës. Pa asnjë ndjenjë droje, që nga Ramiz Alia e deri te Nexhmije Hoxha dhe deri farë oficerë sigurimi, gati me mburrje, jepnin intervista duke sjellë fakte sipas tyre për t'u krenuar për kohën e komunizmit. Ata u bënë heronjtë e faqeve të para të gazetave dhe rubrika Dossier u shndërrua në Dossiermani në të gjitha gazetat ditore, revistat javore dhe botime periodike. Gazetarë me edukim ose jo, u specializuan posaçërisht për këtë rubrikë duke i dhënë një rëndësi të veçantë dhe duke e parë si faqet më të lexueshme. Rubrika Dossier ishte magneti i menaxherëve të shitjes së gazetave.*
3. *Faza e tretë është pas vitit 2007 deri në 2017. Ka një selektim të daljes së figurave. Një pjesë e tyre ndërruan jetë dhe në media gjithnjë e më shumë ishin prezent të persekutuarit e sistemit komunist. Personazhe të kësaj klase dhe fëmijë të tyre janë ata që mbizotërojnë medien.*

Por në këto 28 vjet janë disa çështje për të cilat persekutorët dhe të persekutuarit janë shprehur ndryshe. Nëse deklaramet e tyre vihen përballë krijohet një mozaik vërtetë interesant që tregon thelbin dhe mentalitetin e shoqërisë shqiptare në këto 28 vjet.

**1. *A kanë ndryshuar qëndrim për diktaturën komuniste personazhet e komunizmit, dhe si e vlerësojnë komunikimin pasardhësit e tyre:***

Vetë aktorët e diktaturës komuniste rezulton se nuk kanë ndryshuar qëndrim për 46 vitet e diktaturës. Duke përdorur frazën magjike “ka patur edhe gabime” apo “ashtu ishte sistemi”, ata edhe në 28 vite pas rrëzimit të asaj diktature vazhdojnë të përlligjin ato që ndodhnin gjatë diktaturës: Ja çfarë tha për mua Ramiz Alia në një intervistë në vitin 2006:

Ramiz Alia, ish sekretar i Parë i KQ, ish kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, 2006, gazeta “Tirana Observer”:

*“Duan apo jo simpatizantët ose kundërshtarët e tij, Enver Hoxha për afro 5 dekada ishte në krye të shtetit shqiptar. Ka patur edhe gabime e veprime të padrejta, për të cilat mban përgjegjësi Enveri si dhe gjithë udhëheqja e partisë. Por është fakt që nën udhëheqjen e Hoxhës vendi hodhi hapa të rëndësishëm përpara në zhvillimin ekonomik, arsimor e kulturor. Ruajtja e integritetit territorial, zhdukja e analfabetizmit që në 1945 arriti 80 për qind dhe përpjekja për ngritjen e infrastrukturës së vendit janë meritë e sistemit komunist”.*

Në të njëjtën linjë është edhe e veja e diktatorit Enver Hoxha teksa në një intervistë për mua tha:

Nexhmije Hoxha, e veja e Enver Hoxhës, 1 shtator 2014, emisioni “Debati në Channel One”.

*“Braktisja e Ahmet Zogut që e kam përjetuar është tradhëti, mbi tradhëti. Nuk i falej një mbreti që të lërë vendin në atë gjëndje, që të sabotojë ushtrinë e tij, pasi ushtria ishte e papërgatitur, e vodhi thesarin. Është tradhëti që se luan topi. Për sa i përket eshtrave të tij, që u sollën në Shqipëri, kjo është fare normale mendoj, që eshtrat e çdo shqiptari që mbetet jashtë, të prehet në tokën anëtare. Por kjo mund të behej nga familja. Janë absurde dhe të pavend, organizimi skandaloz me homazhet në Pallatin e Brigadave, nuk e meriton. Ai ishte mbret, por tradhëtoi. Ai Pallatit të Brigadave nuk i dha asnjë kacidhe, nuk fjeti asnjë natë. Për mendimin tim, ishte skandaloze mënyra si u bë dhe monumenti që ju vendos në Tiranë. Aq meriton. Pse u bënë të dyja? Sepse shqetësimi i Sali Berishës ishte të evitonte, një figurë, siç qe ajo e Enver Hoxhës, që kishte meritat e gjysmës së këtij 100 vjetori. Këtë se bënte dhe donte medoemos që pas Ismail Qemalit, të cilin edhe atë e poshtëroi”.*

Ilir Hoxha, djali i Enver Hoxhës më 7 prill dhe 8 prill 2006, gazeta “Tirana Observer”, vijon të jetë në një linjë. Madje jep edhe argumentin juridik.

*“Për ata që kanë bërë burgje, të hapen dosjet përse akuzohen dhe pastaj të akuzojnë. Duhet bërë e qartë se ata nuk i ka dënuar Enver Hoxha por ligjet e asaj kohe të sistemit komunist të vendosur nga deputetët e zgjedhur nga populli”.*

Teuta Hoxha, mbesë e Ramiz Alisë dhe nusja e djalit të Enver Hoxhës, më 14 mars 2013 gjatë emisionit “Debati në Channel One” tha:

*“Me xhaxhain (Ramiz Alinë)unë kam pasur marrëdhënie shumë të veçanta dhe jam rritur në shtëpinë e tij, sepse edhe dy vëllezërit kanë pasur një marrëdhënie të ngushtë mes tyre. Unë jam krenare për të dyja familjet, si nga babai ashtu edhe nga im shoq. Pa diskutim që nuk mund të bëj krahasime, pasi Enver Hoxha ishte tjetër. Por gjëja që më ka bërë më shumë përshtypje te xhaxhai im ishte zemra e tij e madhe, ai falte. Ishte një njeri i zgjuar, me ideale dhe që i ruante idealet e tij. Një vlerë e madhe e tij është fakti i ndryshimit të sistemit që u bë pa u derdhur gjak. Ju shikoni që ndodh një demonstratë, një rotacion pushteti nga një parti në tjetrën dhe ka të vrarë për të mos folur më pas për 97. Kurse ajo ishte një ndryshim sistemi dhe kaloi paqësisht”.*

Persekutor dhe viktimë, familjes së kryeministrit Mehmet Shehut duket sikur i ka dalë narkoza pasi provoi të njëjtat krime në kurrizin e vet. Skënder Shehu, djali i kryeministrit Mehmet Shehu, 23 janar 2013, emisioni “Debati në Channel One”:

*“Babai im ka qenë ministër i Brendshëm dhe kryeministër, numri dy i atij sistemi. Ai ka përgjegjësinë e tij në ngritjen e atij sistemi. Dhe gjatë luftës ka eksese dhe vëllai im Bashkimi*

ka thënë se në fund babai është penduar. Pas goditjes së Koçi Xoxes, ata kishin vënë Sigurimin mbi partinë, Mehmeti vuri partinë mbi Sigurimin dhe babai ka hartuar platformën, ai ka përgjegjësi për formimin e sistemit. Më kujtohet që kur mbarova gjimnazin dhe do vijoja shkollën e lartë i thashë se doja të bëhesha inxhinier ose jurist. Babai më tha bëhu ç'të duash vetëm mjek dhe jurist mos u bëj. Mendova se ç'të përbashkëta kishin këto? Ai nuk ma tha por besoj se babai e kishte fjalën se nëse bëhesh jurist do isha i detyruar të dënoja të pafajshëm, prandaj them se ai ka qenë shpesh i detyruar të merrte vendime për të cilat ka reflektuar është penduar më vonë. Ka qenë i detyruar të merrte vendime por ka reflektuar... Gjithë ajo periudhë ishte një gabim”.

## **2. Të gjithë personazhet e diktaturës tregojnë bëmat e tyre dhe i cilësojnë arritje ato që kanë bërë.**

Lidhur me figurën e Enver Hoxhës, pasardhësit e tij nuk ndjejnë asnjë lloj faji e pendese për të. Ja çfarë thotë Ilir Hoxha, djali i Enver Hoxhës më 7 prill dhe 8 prill 2006, gazeta “Tirana Observer”: “Enver Hoxha konsolidoi shtetin shqiptar, ishte arkitekt dhe projektoi politikën e jashtme. Ndërtoi vepra duke zbatuar reformën agrare. Gjatë sistemit komunist u emancipuarin dhe gruaja dhe u zhduk gjakmarrja. Historia 50-vjeçare nuk është e Enver Hoxhës por e popullit shqiptar”.

## **3. Të gjithë të persekutuarit tregojnë vuajtjet me detaje.**

Disa kanë vuajtur shpirtërisht dhe disa të përndjekur, të burgosur dhe të vrarë. Ja si i tregojnë vuajtjet e tyre të intervistuarit e mi.

Ismail Kadare, shkrimtar, emisioni “Debati në Channel One”, 28 prill 2014.

“Është e vërtetë që është rast i rrallë, mesa e njoh unë jetën e shkrimtarëve, kolegëve të mi në shtete të ndryshme komuniste. Ka patur kurthe të vazhdueshme, të ngritura por që të ekzistojë një letër e tillë ose e ngjashme, sigurisht që kanë ekzistuar, por një rrëfim i tillë ndaj shefit komunist të një vendi, unë nuk di të ketë ndodhur. Ose të paktën nuk është botuar, nuk është bërë e njohur. Ngjarjen e kam ditur gjithmonë, ka ndodhur gjysmë shekulli më parë, por letrën nuk e kam ditur as që ekzistonte pale të kem ditur përmbajtjen e saj.

Ishte sistemi natyrisht. Nuk ka gjë sporadike, nuk ka gjë të pazakonshme, është në logjikën e mbrapshtë të gjërave të një diktature. Zakonisht në një diktaturë shkrimtarët e njohur, filozofët e njohur, artistët e njohur janë në përgjim. Kur ka diktaturë në një vend ka përgjim njerëzish të shquar qofshin këta të sferave politike, artistike, filozofike. Kështu që nuk ka ndonjë gjë të jashtëzakonshme. E jashtëzakonshme është tregimi me pasion i këtij aksioni, sesi është e mundur që njeriu që e ka bërë këtë përpjekje për të futur në kurth një njeri tjetër, një koleg të saj artist, nuk ka kurrfarë pendimi, madje ka një lloj krenarie. Kjo tregon që edhe ai që e merrte

*denoncimin, edhe ai që e përgatiste, se këtu ka dy anë. Njëra anë që përgatit kurthin i kërkon denoncuesit të ngrejë kurthin, pastaj ai që e merr këtë rezultat për ta shfrytëzuar. Këtu ka ndodhur një gjë pak e çuditshme. Ka një mister, që jo gjithçka kuptohet e qartë. Njeriu që e ka marrë këtë, udhëheqësi i vendit, diktatori, shefi si ta quajmë ka ditur diçka apo s'ka ditur asgjë. Personazhi nuk është gjallë që të japë sqarime. Ndoshta ka dokumenta të tjera të fshehura me shumë kujdes”.*

Prifti Ernest Troshani bëri 27 vjet burg sepse kreu një meshë për presidentin e SHBA-së John Kennedy. Ja si vuante ai në burgun e Spaçit.

Ernest Troshani, kardinal në Vatikan, emisioni “Debati në Channel One”, 20 tetor 2016:

*“Në mënyrë që të flisja më shtrënguan prangat aq fort, sa të më fryheshin damarët dhe që të kaloja në infarkt. Në një moment e panë që po vdisja, më hodhën një kovë ujë të ftohtë dhe shpëtova, nuk vdiqa. Vetë fjala dënim i koncepton të gjitha këto. Për 3-4 vjet ishim në Rubik, më pas në Laç, më pas në Elbasan dhe pastaj në minierën e Spaçit. Atje punonim në galeritë e nëntokës dhe prodhonim bakër. Paga ishte 10-12 mijë lekë në muaj me rrogat e asaj kohe por ne na jepnin vetëm 1-2 mijë lekë të vjetra. Paratë e mbetura nga rroga ime shkonin në Ministrinë e Brendshme. Në maj 1973 u bë një farë gjoja revolte. Mua më akuzuan se prifti i ka ngritur peshë të burgosurit. Feçorr Shehu që ishte ministër i Brendshëm, i kishte kontrolluar të gjitha, na mblodhi të gjithëve dhe ka thënë “të djegim gjallë Dom Ernestin”. Për të dytën herë më ka shpëtuar i madhi Zot nga pushkatimi, nga dora e Feçorrit”.*

Eugjen Merlika, nipi i kryeministrit Mustafa Merlika, emisioni “Debati në Channel One”, 11 prill 2016:

*“Më vonë provuam se Mustafa Kruja ishte në shënjestër të komunizmit. Babai u arrestua, edhe xhaxhai, filloi kalvari i burgjeve i nënës sime. Unë isha 2 vjeç. Më 1947 ne jetonim me shtëpi me qira në Tiranën e Re, që kishte marrë babai kur u martua. Një ditë na vjen lajmërimi se duhet të linim Tiranën, nuk ishte internim, por format e urbanizimit. Ku ishim ne ishte një jugosllave, nuk e di çfarë funksioni kishte saktësisht, dhe kjo krijoi një farë miqësie me nënën time, flisnin frëngjisht, të dyja njihnin mirë operën. Ajo pyeti nënën time se çfarë kishte dhe i ofroi ndihmë. Por nuk arriti të na ndihmonte, pasi kërkoi ndihmë nga Koçi Xoxe, që të anulonte vendimin, ai i kishte thënë se ndërhynte për këdo përveçse për familjen tonë. Në shkua te 4 rrugët e Shijakut në një kasolle me baltë përtokë. Aty ndenjëm 1 vit, pastaj na çuan në Krujë. Përpara se të na hiqnin nga Tirana nëna kërkonte punë dhe shkoi te profesor Aleksandër Xhuvani me të cilin kishte punuar për Fjalorin e madh të Gjuhës Shqipe, që është vepra e Mustafa Krujes, por fatkeqësisht e zhdukën. Ajo kërkoi ndihmë të punonte në bibliotekë, pasi edhe bibliotekën tonë na e zhdukën. Ai iu përgjigj sikur në gjithë Ballkanin të kërkonte dikë*



*për këtë punë s' do e gjente më të mirë se nëna ime, por nuk mundi ta ndihmonte. Pastaj shkuam në Krujë dhe erdhi vendimi i internimit. Në Krujë kam filluar shkollën. Nga Kruja shkuam në Tepelenë”.*

Ajnishah Vlora, vajza e Eqrem Bej Vlorës, emisioni “Debati në Channel One”, 31 gusht 2015:

*“Më 1944 babai u largua nga shtëpia dhe që nga ajo ditë filluan vuajtjet tona. Na nxorën nga shtëpia e hallës sime, duke lënë plaçkën të gjithë. E dolëm në rrugë vetëm me rrobat e trupit. Vajtëm në Babrru, ishte një mikeshë e nënës. Po atje na diktuan, e na çuan në Durrës. E aty na ndoqën. Shkuam në Rrogozhinë, në fshatrat e Kavajës. Çdo bënte një grua me dy fëmijë jetim? Megjithatë nëna ime u bë e fortë dhe gjeti një shtëpi me qira. Atëherë disa shoqe të motrës sime Lela, i thanë babait për këtë vuajtje. Ai nisi të na dërgonte rrobë e lekë. Motra vrau veten. Mbarova gjimnazin në Kavajë, por nuk vazhdova shkollën e lartë. Regjimi na godiste, madje na linin pa ngrënë. Pas shkollës punova në fermë. Punoja tokën me shatë. Për mua ishte punë shumë e rëndë dhe nuk e përballoja dot. U sëmura rëndë. Ne kur shkonim në Tiranë ose në Durrës, kishim të shkruar shkronjën “D” që do të thonte e dënuar. Kontrolloheshim për gjithçka. I kam rritur fëmijët me një vështirësi të madhe, me fukarallëk të madh e një dëshpërim të thellë. Janë rritur para kohe, unë isha e sëmure tërë kohës”.*

Harallamb Kotta, pasardhës i Kostaq Kottës, dy herë kryeministër, i vlarë në burgun e Burrelit, 30 maj 2016, emisioni “Debati në Channel One”:

*“Sepse jo për 30 vjet por për asnjë ditë nuk kishte prova. Pas dënimit me 30 vjet burg Koçon e dërguan në burgun e Burrelit, një burg që ai e firmosi për ta ndërtuar vetë kur ishte kryeministër. Po a e dini ju që kryeministri Kotta ka ndërtuar bulevardin e madh të Tiranës, ndërtesat e ministrive dhe shumë e shumë vepra të tjera, rrugë, shkolla e ura. Dhe natyrisht do ndërtonte edhe burg. Por pikërisht aty gjeti vdekjen. Nga të gjitha dëshmitë e bashkëvuajtësve, nga dokumentet arkivore dhe nga rrëfimet e të afërmve ishte e parapërgatitur që Koçoja duhet të vdiste. Torturat ishin çnjerëzore. Në fillim ai u fut në qelinë numër 7 të burgut. Të burgosurit bënin humor me Koçon. Një prej tyre ka treguar se i ka thënë: “Koço, mirë ta bënë që të futën këtu, sepse nuk e ke bërë të mirë këtë burg”. Më pas u fut në qelinë pa numër. Aty gjithçka ishte në kufijtë e të paimagjinueshmes. E lanë pa bukë e ujë, i jepnin kripë, e godisnin me ç'të mundnin deri me bajonetë dhe thirrjet e tij ishin dëshpëruese. Të burgosurit kanë treguar se dëgjonin për orë të tërë fjalën bukë, bukë, bukë, deri sa kjo erdhi duke u zbehur dhe më pas nuk dëgjohej asnjë zë. Mish i në trup nisi të plasaritej nga kjo situatë dhe më pas zëri i tij nuk po dëgjohej fare. Gardianët e pamëshirshëm në vend ta ndihmonin dhe mjekonin e çanin me bajonetë në mish në ato vende ku ishte plasaritur. Deri sa erdhi edhe vdekja e tij përfundimtare.*

*U varros në oborrin e burgut në atë që quhet e famshmjia qershi. Kryeministri Koço Kotta u torturua deri në vdekje,. U varros dhe më pas ia zhdukën edhe eshtrat. Sot ai është një nga kryeministrat e vrarë të shtetit shqiptar, pra edhe një nga kryeministrat që nuk ka varr. Ai u eliminua sepse ishte kundërshtar i nacionalistëve fqinj antishqiptarë që synonin marrjen e trojeve dhe viseve shqiptare.”*

Daut Gumeni, mësues, i dënuar politik, emisioni “Debati në Channel One”, 9 tetor 2017:

*“Unë nuk isha në dijeni të kësaj dosjeje. Është një letër që Sekretari I Partisë së Tepelenës ia ka dërguar Hysni Kapos dhe Kapo ia ka dërguar mëkëmbësve të tij dhe ata ia dërguan gjykatës. E kisha dhuratë nga Komiteti i Partisë. E ka firmosur një lummadh atje. Unë nuk e njoh fare atë. Quhej Sherif Toraj. Ai kishte qenë minator dhe kaloi në komitetin e Partisë. Nuk ishte njeri i keq. Ishte i leshtë por jo i lig. Nuk hakmerrem. Unë hakmarrjen e quaj dobësi. Forcën e gjej atje ku kam lindur unë, ka më shumë gurë se sa baltë. Ajo nuk është poetike, por nuk jam unë i vetmi që kam vuajtur. Të tjerët e pësuan atë kërkesë. Pra vdiqën dhe u pushkatuan. Ndërsa unë u dënova vetëm më burg. Për mua nuk e zbatuan. Po unë isha. Unë jam edhe tani armik. Isha edhe atëherë”.*

Dukej sikur shpëtuan, por ata kundërshtarë që jetuan jashtë Shqipërisë ishte edhe më e rëndë, sepse për ta vuajti familja.

Hëna Këlcyra, vajza e Ali Këlcyrës, 20 mars 2012, emisioni Arena televizioni “Planet”:

*“Unë kam qenë gjithnjë e përgatitur që im atë do vdiste, jo nga Zoti por nga rreziku për ta vrarë. Në Paris dhe Vjenë e gjurmonte Sigurimi i Shtetit”.*

Sejfi Protopapa, kryetar i Rinisë Balliste qarku Berat, 2010, televizioni “Ora News”:

*“Në vitin 1987 më sjellin në shtëpi në Wayland të Massachusetts një kasetë me filmin shqiptar “I teti në bronx”. Nuk e kuptova mirë përse duhet ta shihja. Por kur e pashë e kuptova. Isha bërë personazh i keq dhe isha bërë Sali Protopapa. Mirë unë por të gjithë ata që kisha lënë në Shqipëri me mbiemrin tim kishin vuajtur në një mënyrë që disa kishin arritur të ndërronin mbiemrin. Në vitin 1991 erdha në Shqipëri dhe takova vetë autorin Dritëro Agolli. I shkova në shtëpi dhe iu prezantova. Por ai më tha me Sali Protopapën kam mbaruar punë. Por në fakt unë isha gjallë. Veçse më mbajti për darkë dhe pimë raki dhe unë u deha vërtetë si në film”.*

Vuajtja arriti deri në art. Agim Krajka, kompozitor, emisioni “Debati në Channel One”, 14 dhjetor 2015, tregoi gjatë intervistës:

*“Tre muaj pasi u hoq dhe u ndalua të transmetohej kënga ime “Lemza”, mbaj mend që kam qenë në radhën e qumështit dhe kishte shumë zhurmë. Në një moment dëgjova dikë që tha mos bëni zhurmë sepse po dëgjohet lemza. Edhe djaloshi dhe shiu doli nga transmetimi. Kur*

morëm pjesë në festival me këngën “Kafe Flora burra plot” më lajmëruan se më kërkonin në Degën e Brendshme. Kryetari i degës ishte Mëhill Doçi. Sa më pa tha: “Ku je se po na shkatërrojnë rininë”. I thashë se ajo ishte një këngë pogonishte. Pas pak më nxori prangat dhe tha do t’i kisha vendosur në vend, por përpara se ti vë ty, duhet t’ia vendos fëmijëve tanë që e dëgjojnë gjithë ditën këtë këngë. Pas festivalit të 11-të u izolova totalisht nga ansambli 10 vjet. Kudo që shkonin jashtë, provat i bëja unë, deri ditën e fundit, dhe më pas gjenin dikë tjetër, mua më izoluan totalisht. Sigurimsat mua më kanë ndenjur 6 javë përpara shtëpisë sepse më kishte ardhur djali i tezes nga Dibra e Madhe. Edhe kur iknim jashtë na shoqëronin punonjës të sigurimit”.

#### **4. Të gjithë personazhet e diktaturës që kanë dhënë intervista mbështeten te Lufta e Dytë Botërore, flamuri i tyre i krenarisë ishte lufta.**

Ramiz Alia, pasardhës i Enver Hoxhës, ish sekretar i KQ, gazeta “Tirana Observer”, 2006:

“Busti i Enver Hoxhës duhet të vendoset në Gjirokastrë, për kontributin që ai ka dhënë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare”.

Nexhmije Hoxha, e veja e diktatorit Enver Hoxha, emisioni “Debati në Channel One”, 1 shtator 2014:

“Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare që u zhvillua në vendin tonë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, është lufta më e madhe, më e organizuar, më e lavdishme në historinë e popullit shqiptar për çlirimin e vendit. Është lufta që arriti unitetin në shkallën më të lartë popullore, pa dallim feje, krahine dhe ideje dhe kjo u realizua për herë të parë, sipas ëndrrës së rilindasve tonë të mëdhenj, të cilët me fjalën poetike kërkonin këtë unitet të popullit shqiptar. Sipas mendimit tim, është lufta, që hodhi themelet e para të shtetit të ri në vendin tonë, shtetit modern, demokratik, popullor. Është lufta që i hapi rrugën dijës dhe përparimit, për emancipimin e shoqërisë shqiptare dhe veçanërisht të gruas shqiptare. Këto dhe të tjera vlera të kësaj lufte, kanë ndikuar në gjithë zhvillimet e mëvonshme në vendin tonë e deri në ditët e sotme. Bindja time e patundur në këtë drejtim, është që Lufta Nacional-Çlirimtare ka qenë një luftë e pastër dhe nuk mund të mendohet ndryshe. Ky është realiteti që ka ekzistuar, realiteti që kam njohur personalisht. Nuk ka qenë as luftë civile, as me elementë civile. Kjo është e përcaktuar edhe në protokollet juridike ndërkombëtare, që në një vend që ka pushtues të huaj, nuk ka luftë civile, por luftë kundër pushtuesit. Për sa i përket atyre që thonë se Lufta Nacional-Çlirimtare është luftë civile, ato e përmbysin komplet, kjo bëhet sipas interesave të tyre sepse duan të mbulojnë faktin që ata nuk morën pjesë në luftë dhe që e paraqitën këtë si një luftë të huaj, sikur nuk ishte luftë e shqiptarëve. Për mendimin tim, nuk kishte as elementë të luftës civile. Është fakt, siç e

*përmenda më lart që janë në protokollet juridike ndërkombëtare, që këtu u bë lufta kundra okupatorit. Në qoftë se elementë të ndryshëm shqiptarë, u bënë parzmore e këtyre reparteve pushtuese, i çonin pushtuesit në çerdhet partizane dhe morën pjesë në arrestime e pushkatime të këshilltarëve, kjo është fakt. Në qoftë se kërkojnë elementë të luftës civile, mund ta kërkojnë tek këta njerëz që qenë mbështetës të okupatorëve dhe çonin vëllezërit e tyre. Megjithatë as kjo nuk qëndron. Për mendim tim, qe luftë e pastër nacional-çlirimtare”.*

Ilir Hoxha, djali i Enver Hoxhës, gazeta “Tirana Observer”, 7 prill dhe 8 prill 2006:

“Fitorja e LANÇ është gjëja më pozitive që ka bërë babai im”

Ndërsa ndryshe e tregojnë luftën ata që vetë morën pjesë në luftë por ishin kundërshtarë të asaj lufte; Sejfi Protopapa, ish komandant i Rinisë Balliste, qarku Berat, televizioni “Ora News”, 2010:

*“Takova Abas Ermenjin dhe më tregoi një urdhër të Partisë Komuniste që të vriteshin të gjithë ballistët. U tmerrova. Kishte filluar lufta civile”*

##### **5. Personazhet që ishin me pushtet gjatë diktaturës nuk kanë kërkuar falje.**

Askush prej atyre që kishin pushtet nuk kërkuan falje. Nuk kanë pendesë, ndjehen madje të mbështetur. Gjatë intervistave që unë kam marrë, vetëm dy personazhe e kanë bërë këtë. Madje, nuk ua ka kërkuar kush dhe më e rëndësishmja nuk kishin gjë në dorë dhe nuk mbanin poste drejtuese. Liri Belishova, ish anëtare e Byrosë Politike, gazeta “Tirana Observer”, 2005: *“Ju kërkoj falje të gjithë shqiptarëve që mbështetëm dhe ndërtuam komunizmin dhe atë regjim. Ishim idealistë por nuk duhet ta kishin bërë atë gjë. E dëmtuam shumë këtë popull”.*

Fatos Kongoli, emisioni “Periskop”, televizioni “Ora News”, dhjetor 2010:

“Unë i kërkoj falje publike Hysenil Dumes, sepse kamë dëshmuar në gjyq kundër tij. Ai nuk u dënua falë asaj që bëra unë, por unë dëshmova dhe ndjehem në faj. Nuk duhet të kisha dëshmuar”.

##### **6. Të gjithë të persekutuarit i kanë falur, me përjashtime, si Bedri Blloshmi.**

Bedri Blloshmi, emisioni “Debati në Channel One”, 9 prill 2018:

*“Më dërguan në hotel turizmin e Librazhdit. Ishte vatër e Sigurimit atje. Atje bëheshin të gjitha. Nuk më zuri gjumi tërë natën. Në mëngjes erdhën dhe më morën. Përsëri nuk pranova të bashkëpunoja. Pra mua që më kishin arrestuar dhe dënuar pothuajse të gjithë paraardhësit të bëhesha bashkëpunëtor i tyre?! Ishte e papranueshme. Më futën në burg me akuzën agjitacion e propagandë dhe përpjekje për rrëzimin e pushtetit popullor. Më pas arrestuan dhe vëllanë Vilsonin. Sipas atyre që kam zbuluar im vëlla Vilsoni ndiqej nga 11 bashkëpunëtorë,*

*ndërsa unë nga 3. Në jetë të jetëve nuk do t'i fal kurrë ata që më dënuan. Nuk jam hakmarrë por nuk do t'i lë kurrë. I kam kërkuar instancave që ata të dënohen por nuk e kanë bërë. Më kanë marrë jetën. Nuk i fal”.*

Mënyra se si fal dom Ernest Troshani, kardinal në Vatikan, emisioni “Debati në Channel One”, 20 tetor 2016, është unikale. Ajo që më ka thënë gjatë intervistës më la pa fjalë.

*“I ka falur Zoti të gjithë për fenomenet që ndodhin. Kisha pastë mëshirë për të gjithë. Krishti ka thënë të duam edhe armiqtë, ti falim e të lutemi edhe për ta. Jam lutur edhe për armiqtë. Jam lutur edhe për Enver Hoxhën”.*

Por ndërsa dom Ernestin e mbanin parimet e Krishtit, vajzën e Eqrem Bej Vlorës teksa fali publikisht Enver Hoxhën e mbajtën parimet e familjes së vet.

Ajnishah Vlora, vajza e Eqrem Bej Vlorës, emisioni “Debati në Channel One”, 31 gusht 2015:

*“Të gjithë këtë vuajtje në jetë e kisha dhe e kishim nga Enver Hoxha dhe regjimi komunist. Nëse do ta takoja një ditë Enver Hoxhën do ta nderonim e s’do ti thoshim asgjë. Asnjë hakmarrje nuk do të kemi. Se gjaku i babait tim, nuk bënte të liga por vetëm të mira. Ai nuk i bënte keq njeriu edhe nëse e kishte hasëm”.*

Gati kalorsiak është mendimi i një të vuajtori tjetër kur e pyeta për hakmarrjen. Daut Gumeni, mësues, i dënuar politik, emisioni “Debati në Channel One”, 7 tetor 2017:

*“Unë nuk jam hakmarrë sepse nuk bëhet garë me të keqen. Garë bëhet me të mirën. Duhet të kesh fuqi. Mua më ka mbetur aq fuqi të mos heq dorë nga gara me të mirën”.*

### **7. Ish-hetuesit rrëfejnë**

Riza Icka, ish hetues i Ismail Kadarese, gazeta “Tirana Observer”, dhjetor 2005:

A mund të na e thoni fjalë për fjalë se çfarë ka shkruar Kadareja?

“Me sa më kujtohet, ka qenë një faqe formati A4 dhe ai e ka shkruar me stilolapsin e tij, dhe po të gjendet kjo ka vlera edhe pse është shkrimi i tij aty, shkrimi i një shkrimtari të madh(qesh). Ai i kërkonte hetuesisë që ky djalë të mos arrestohej dhe të mos dënohej për atë që kishte bërë në lidhje me marrëdhëniet me familjen Kadare. Këtë ia kërkonte institucionit. Ai erdhi në zyrë dhe unë i thashë për respekt të figurës së tij, se përse s’më thirri në shtëpi. Ai më tha se kishte ardhur zyrtarisht dhe se donte ta bënte këtë gjë personalisht. Unë kisha porosi të veçantë nga Koço Josifi, që të kisha kujdes në sjelljet me të se ai ishte figurë. E kam takuar Kadarenë edhe më vonë. Unë e pushova çështjen, s’e çova në gjykatë. Nuk e mbaj mend, por atë çunin e lirova që atë ditë”.

### **8. Historia ndryshe**

Debatet për historinë kanë qenë lënda e parë për medien. Unë këtu nuk po shtjelloj përplasjet për historinë e Shqipërisë, por përplasjet për historitë e familjes. Vajza e Ali Këlcyrës nuk quan ditë të zezë kur ka lexuar për akuzat ndaj të atit në aspektin politik, por atë të aspektit familjar. Hëna Këlcyra, vajza e Ali Këlcyrës, 20 mars 2012, emisioni “Arena”, televizioni “Planet”: *“Jam ndjerë një herë shumë keq. Pasi në maj 2007 më ra në dorë një gazetë që shkruhej: Ali Këlcyra tradhtar i madh i kombit. Deri këtu nuk më bëri përshtypje se isha mësuar por kur shkruhej se babai im nuk ishte shqiptar dhe familja e tij gjithashtu. Në gazetë shkruhej se gjyshi kishte harxhuar shumë para për të arsimuar babanë tim në Itali prandaj ishte filoitalian. Apo për Dalmazzo Këlcyra. Vetë gjeneral Dalmazzo ka shkruar një libër ku thoshte se nuk ka qenë marrëveshje por një propozim më 1943 pas kapitullimit udhët e Shqipërisë mos të përdorëshin më ”.*

#### **9. Hapja e dosjeve, çudia - persekutorët dhe persekutuesit kërkojnë hapjen e dosjeve**

Lidhur me hapjen ose jo të dosjeve, edhe pse publikisht personazhet e pranojnë që duhet të hapen, artikulimi është i formave aspak besuese. Kjo është arsyeja që, ajo që thotë Ismail Kadare i tremb ose i shqetëson ata që dikur kanë bashkëpunuar me Sigurimin e Shtetit.

Ismail Kadare, shkrimtar, emisioni “Debati në Channel One”, 28 prill 2014:

*“Pra mendimi im ka qenë i prerë që duhen hapur dosjet, duhen hapur arkivat e fshehta. Duhet që çdo vend kur kapërcen, kalon nga një diktaturë, gjëja e parë që bën shqyrton pjesën e keqe të ndërgjegjes së vet. Pa këtë nuk ka asnjë emancipim. Ose duket sikur ka ecje përpara, por në fakt ka ngecje në vend. Është kriminale të mos hapësh dosjet”.*

### **KONKLUZIONE**

Nga e gjithë kjo përballje mund të nxjerrim si konkluzion:

1. Përplasia nëpërmjet komunikimit me medien të persekutorëve me të persekutuarit, ka sjellë më shumë të mirë se sa kthim në të shkuarën komuniste. Duke i dhënë vend në gazeta, televizione dhe portale opinionit publik i ka njohur më mirë persekutorët dhe të persekutuarit.
2. Edhe pse kanë kaluar 28 vjet komunizëm shoqëria shqiptare nuk e ka bërë në mendësi dekomunistizimin e vet.
3. Në këto 28 vjet nuk ka pendesë për atë që ka ndodhur gjatë regjimit komunist nga përgjegjësit dhe autorët e të gjithë krimeve dhe kjo mungesë mund të vijojë edhe për dekada të tjera nga pasardhësit e tyre.

4. Pas 28 vjetësh rezulton vetëm 2 persona që kanë kërkuar falje. Vetëm një ish funksionar i lartë ka kërkuar falje për atë që ka ndodhur në 28 vjet dhe një shkrimtar për të cilin sipas tij një koleg u dënua.
5. Si kompensim klasa e personave që drejtuan shtetin shqiptar gjatë diktaturës dhe pasardhësit e tyre e përdorën rezistencën gjatë Luftës së Dytë Botërore si kundërpeshë më të madhe dhe justifikim të asaj që ndodhi më pas nga viti 1944 deri më 1990.
6. Dekomunistizimi nuk është një proces vetëm shtetëror nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm si hapja e dosjeve, por është një ndryshim mentaliteti në ndërgjegjen e të gjithë shoqërisë shqiptare.
7. Dekomunistizimi vjen vetëm nëpërmjet transparencës dhe komunikimit. Sa më shumë publikime të persekutorëve dhe të persekutuarve të kemi aq më shumë dhe aq më mirë do jetë shoqëria në gjendje të kuptojë se çfarë ka ndodhur në 46 vjet diktaturë komuniste.

# **Edlira Agolli - Prezenca e OSBE në Shqipëri**

## **Roli i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në mbështetjen e dialogut kombëtar për të kaluar komuniste në Shqipëri**

### **Abstrakt**

Studimi flet për anketimin mbi perceptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri dhe mbi rëndësinë e ligjit për hapjen e dosjeve; koordinimin e një debati mbarëkombëtar për periudhën komuniste në Shqipëri; bashkërendimin dhe bashkëpunimin e institucioneve dhe organizatave; riintegrimin dhe rehabilitimin e viktimave të komunizmit; kontributin e OSBE-së për shtresën e viktimave të regjimit komunist.

### ***Hyrje***

Kjo ese ka për qëllim të paraqesë një trajtim të punës së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri (më tej: Prezenca) në lidhje me mbështetjen e dialogut kombëtar për të kaluarën komuniste në Shqipëri.

Përveç trajtimit të punës së Prezencës, në të synohen të jepen disa argumente se përse ka qenë i rëndësishëm ky dialog për Shqipërinë, si dhe në fund të jepen disa rekomandime se si duhet vazhduar të mbështetet ky dialog nga aktorë të fushës, nga rinia dhe nga vetë shoqëria shqiptare.

### ***Të drejtat e njeriut në fokus të Prezencës***

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri u krijua në vitin 1997, për të ndihmuar në stabilizimin e vendit dhe për të koordinuar ndihmën ndërkombëtare. Që nga viti 2003, Prezenca ka mandat të përkrahë demokratizimin, shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut, si dhe të konsolidojë institucionet demokratike në përputhje me parimet, standardet dhe angazhimet e OSBE-së.

Në botimin e vitit 2012, “Key Issues and Recommendations of the Workshop on “Towards a Strategy for Reconciliation in the OSCE Area” (Çështjet kryesore dhe rekomandimet e seminarit “Drejt strategjisë për pajtim në vendet e OSBE-së), Sekretari i Përgjithshëm i OSBE-së, Lamberto Zannier shprehej se: “[duhet të njihet] roli instrumental i padrejtësive të rrënjosura thellë, i perceptimeve të gabuara dhe mosbesimit, si dhe fuqia që trashëgimia historike dhe kujtimet përçarëse kanë në nxitjen dhe mbajtjen e tensioneve dhe “armiqësinë e zgjatur”, madje edhe për brezat. “[Kështu, pajtimi] ... mban perspektivën e



thyerjes së ciklit të armiqësisë duke krijuar ose ‘ri-krijuar’ marrëdhëniet konstruktive politike dhe shoqërore dhe duke bërë të mundur lëvizjen përpara<sup>1</sup>”

Prezenca mori parasysh, nevojën e vazhdueshme për të kuptuar se pajtimi luan një rol parësor në stabilizimin e një vendi. Gjithashtu, mori në konsideratë pakënaqësitë e shprehura publikisht ndër vite të viktimave të regjimit komunist në Shqipëri. Prandaj, duke parë se momenti për ndryshimin e narrativës së shoqërisë shqiptare në lidhje me të kaluarën komuniste po merrte një hov të ri në trajtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë atij regjimi duke pasur në fokus dialogun dhe historitë e vetë viktimave, vendosi të kishte një rol iniciator në këtë dialog.

Që prej vitit 2011 u zhvilluan takime informuese me shoqatat e viktimave të komunizmit, me Institutin për integrimin dhe rehabilitimin e ish-të përndjekurve, me Institutin e sapoformuar të studimit të krimeve të komunizmit dhe me Organizata të shoqërisë civile (OSHC) që punon në këtë drejtim. Qëllimi i këtyre takimeve ishte që të kuptohej situata dhe shqetësimet e viktimave të regjimit.

“Në fund të shtatorit dhe në tetor 2012, një grup prej rreth njëzet ish-të përndjekurish politikë nisën një grevë urie, në një rrugë në qendër të Tiranës, duke kërkuar një pagesë me të shpejtë të kompensimit për viktimat e regjimit të kaluar komunist. [...] Bashkë me aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, Prezenca bëri thirrje për dialog mes qeverisë dhe grevistëve, për të ulur tensionin dhe për të gjetur një zgjidhje të pranueshme bashkërisht.<sup>2</sup>”

Në po të njëjtin raport prezantohet përjasja e parë që pati Prezenca me një projekt të posaçëm në këtë drejtim. “Po në këtë vit, duke parë se riintegrimi i plotë në shoqëri i ish-të përndjekurve politikë mbetet shqetësim. Në kuadër të qëllimit të përgjithshëm të edukimit për të drejtat e njeriut, Prezenca organizoi takime mes studentëve dhe ish-të përndjekurve politikë, në katër universitete. Takimet u përqendruan në rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut gjatë regjimit komunist në Shqipëri.<sup>3</sup>”

Po në mbështetje të dialogut dhe në ndihmë të viktimave, vlen të përmendet se Prezenca monitoroi proceset gjyqësore të ish-të përndjekurve, si dhe me kërkesë të Kuvendit të Shqipërisë përgatiti komente teknike mbi të dy projektligjet për hapjen e dosjeve që u diskutuan në këtë institucion në dhjetor 2014-qershor 2015.

---

<sup>1</sup>Towards a Strategy for Reconciliation in the OSCE Area, OSCE, 2012, fq.1.

<sup>2</sup>Pjesë e situatës së përgjithshme nga Raporti i mbajtur nga Ambasador Eugen Wollfarth në takimin e Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, 2013, fq. 3

<sup>3</sup>Po aty, fq. 13

### ***Respektimi i të drejtave të njeriut dhe reagimi mbi problemet e rehabilitimit dhe integritetit të viktimave të regjimit komunist***

Në ngjashmëri me vendet e tjera me të kaluar komuniste, Shqipëria ende përballet me çështje të pazgjidhura të të drejtave të njeriut sidomos të lidhura me atë periudhë. Për ta ilustruar këtë kemi nxjerrë këtë paragraf nga “Raporti i Auditimit të Performancës- Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve”, Kontrolli i lartë i Shtetit: “Nga krahasimi dhe analiza e realizimit në kohë të masave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, nga neglizhenca në hartimin dhe mosnxjerrja në kohë e akteve nënligjore nga organet shtetërore, për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në ligjet e mësipërme, ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nuk përfituan plotësisht dhe në kohë nga zbatueshmëria e plotë e kuadrit ligjor, për rrjedhojë kanë krijuar pasoja serioze dhe në rehabilitimin e tyre<sup>4</sup>”.

Prezenca e mirëpriti *momentum*-in i ri, që u krijua në vitin 2015, kur autoritetet shqiptare morën iniciativën që të hapnin për viktimat, kërkuesit dhe publikun dosjet e ish-sigurimit të shtetit të periudhës 1944-1991, një proces ky që do drejtohej dhe zbatohet më vonë nga Autoriteti mbi informimin për dosjet e ish-Sigurimit të shtetit (AIDSSH).

Gjatë aktiviteteve të zhvilluara me studentët e katër universiteteve publike në vitin 2013, u vu re një interes i të rinjve dhe një mungesë informimi formal mbi të kaluarën komuniste në Shqipëri. Nga diskutimet me studentët u evidentua, gjithashtu, se institucionet e edukimit edhe media kishin një rol sipërfaqësor në formësimin e të rinjve mbi të kaluarën, por edhe në trajtimin e saj.

Ndërkohë, duke pranuar shtysën e krijuar, Prezenca u bë iniciatore kryesore e dialogut kombëtar mbi të kaluarën komuniste në Shqipëri duke filluar nga viti 2015, projektin 4-vjeçar “Mbështetja e një platforme për dialog kombëtar për shkeljet e të drejtave të njeriut të ish-regjimit komunist të Shqipërisë”. Në këtë projekt, Prezenca mbështeti shqiptarët për të zhvilluar një dialog të depolitizuar, dhe konstruktiv kombëtar për regjimin e mëparshëm komunist dhe për të rritur dhe promovuar me sukses bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale, organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe qytetarëve dhe vetë viktimave të regjimit komunist.

Projekti u krijua me një objektiv të dyfishtë. Së pari, të ndihmonte procesin e informimit dhe përgatitjes më të mirë të shoqërisë shqiptare për të trajtuar historinë ende të panjohur të vendit; dhe së dyti, të mbështeste punën e Autoritetit të sapokrijuar. Projekti ka arritur objektivin e tij përmes një shumëllojshmërie aktivitetsesh, nga kryerja e anketave, aktiviteteve

---

<sup>4</sup>Raporti i Auditimit të Performancës-Rehabilitimiti i ish-të Përndjekurve”, Kontrolli i Lartë i Shtetit 2016, fq. 66

të kontaktimit dhe trajnimit, përfshirjes së publikut më të gjerë në ngjarje të fokusuara në diskutim dhe përfshirjes së të rinjve në hulumtime tematike, për të mbështetur drejtpërdrejt institucionet publike përgjegjëse me ekspertizë teknike.

### ***Anketa për perceptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri dhe mbi rëndësinë e ligjit për hapjen e dosjeve***

Për të mbështetur dialogun e papolitizuar për një të kaluar jo shumë të largët, u pa e nevojshme të zhvillohej një anketë, ku të diskutohej perceptimi që kishin qytetarët shqiptarë mbi të kaluarën komuniste të Shqipërisë. Kjo anketë, e zhvilluar në bashkëpunim me IDRA-n, u konceptua në katër pjesë: rezultatet në lidhje me perceptimet për trashëgiminë e komunizmit si problem aktual; gjetjet rreth pritshmërisë dhe shqetësimeve në lidhje me mënyrat e ndryshme të mundshme për të trajtuar të shkuarën komuniste; njohuritë rreth regjimit mëparshëm; të dhëna rreth perceptimeve për regjimin komunist të Shqipërisë dhe jetesës gjatë asaj periudhe. Rezultatet e kësaj ankete treguan se: “[...] ka dallime të dukshme njohurish, perceptimesh dhe pritshmëri ndërmjet personave që i përkasin gjinive, moshave, niveleve arsimore dhe vendbanimeve të ndryshme si dhe ndërmjet atyre që kanë vuajtur persekutimin dhe atyre që nuk e kanë vuajtur atë. Një gjë e tillë e thekson më tej nevojën për një qasje të shumëngjyrshme dhe gjithëpërfshirëse gjatë përpjekjeve për të trajtuar të shkuarën komuniste në Shqipëri<sup>5</sup>.” Anketa u debatua shumë në media dhe në qarqet akademike dhe u pa si e vlefshme edhe si një bazë solide për politikëbërësit, gazetarët, akademikët dhe shoqërinë civile për ta përdorur për studime e kërkime të tjera.

### ***Fokusi te të rinjtë***

Pra, anketa tregoi se ka një dimension më të rëndësishëm për t’u ballafaquar me të kaluarën komuniste dhe ky është dialogu. Prandaj Prezenca vazhdoi iniciativën e vet për të trajtuar të kaluarën komuniste të fokusuar në dialog dhe nisi platformën “#Fillojmë të flasim”

Fokusi te informimi i të rinjve mbi të kaluarën dhe ndërgjegjësimi i tyre mbi të përbënte një nga elementët kyç të projektit dhe të punës së Prezencës, në përgjithësi. Prezenca, në bashkëpunim me organizata të ndryshme të shoqërisë civile që e trajtonin këtë temë organizoi shumë sesione informative dhe dialogu me të rinjtë, në të gjithë Shqipërinë. Në vijim të projektit, Prezenca bashkëpunoi për këto sesione edhe me Muzeun “Gjethi”. Përreth 1500 të rinj morën pjesë në këto aktivitete në të gjithë Shqipërinë. Formati i aktiviteteve përmbante

---

<sup>5</sup>Rezultatet e anketës “Njohuritë dhe perceptimet e publikut për të shkuarën komuniste në Shqipëri dhe pritshmëritë e tyre për të ardhmen”, OSBE: IDRA, 2016.

shfaqjen e një filmi me tematikë nga e kaluara ose të ekspozitave apo muzeve në internet, si dhe rrëfimin e vetë viktimave të komunizmit, parë, prej tyre, në një këndvështrim krejtësisht individual. Për të rritur kapacitetet e ish-të përndjekurve, Prezenca organizoi edhe një seminar trajnimi për ta, në mënyrë që të fiton shprehi të prezantimit dhe të pasqyrimit të jetës së tyre. Ky format me filma, foto, rrëfime u zgjodh për të tërhequr të rinjtë në këto diskutime, por edhe për të dhënë një pasqyrim sa më të plotë të asaj që ka kaluar vendi ynë.

Puna me të rinjtë, në kuadër të këtij projekti, u shtri edhe në organizimin e shkollave verore universitare, gjatë dy viteve të njëpasnjëshme, ku më shumë se 80 studentë dëgjuan lektorë vendas e ndërkombëtar, dëshmitë personave të persekutuar dhe vizituan vendet e kujtesës të periudhës komuniste, të tilla si ish-burgu dhe kampi i punës i Spaçit.

Një tjetër aspekt i punës me të rinjtë është edhe mbështetja që Prezenca u dha kërkuesve të rinj, të cilët donin të hulumtonin dosjet e ish-Sigurimit të shtetit. Ky aktivitet u zhvillua në bashkëpunim me AIDSSH-në.

### *Sesioneve të diskutimit me publikun e gjerë*

Prezenca zgjodhi të komunikonte me publikun nëpërmjet shfaqjes së dramës “Ata hyjnë pa trokitur” të Armand Borës. Kjo dramë trajtonte persekutimin dhe përndjekjen e qytetarëve shqiptarë në të kaluarën komuniste, por synonte të kishte edhe një këndvështrim më universal mbi persekutimin e mënyrën se si ndikoni në jetë e njeriut dhe të shoqërisë regjimet totalitare. Shfaqja e saj në disa rrethe të Shqipërisë u shoqërua me diskutime me publikun dhe u prit me mjaft interes, sidomos nga ish-të përndjekurit. Drama, gjithashtu, në vetvete, pati një sukses ndërkombëtar duke u shfaqur në një tur evropian në vitin 2016 dhe u shfaq edhe në Kroaci në vitin 2017 dhe në Australi në vitin 2018.

Një tjetër përfaqje në debatin me publikun ishte Leximi i dosjeve të viktimave të përndjekjes. Prezenca, në bashkëpunim me Institutin për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC) dhe AIDSSH-në organizoi në Ditët e kujtesës leximet e dosjeve të Musine Kokalarit dhe Gëzim Peshkëpisë. Leximet e dosjeve u ndoqën me interes nga publiku i gjerë. Këto aktivitete synuan të nxirrnin në pah shtypjen dhe persekutimin nga regjimi komunist ndaj viktimave, si dhe të hidhnin dritë mbi represionin komunist, teknikat operative të Sigurimit të shtetit dhe vuajtjen e viktimave, në një përpjekje për të inkurajuar diskutimet mbi riparimin e shoqërisë dhe rehabilitimin e viktimave.

### *Media*

Me qëllim që të arrihej një audiencë më e gjerë në diskutimin për të kaluarën e vendit, Prezenca bashkëpunoi me Radio Televizionin Shqiptar (RTSH) dhe mbështeti një seri diskutimesh mujore mbi tema të tilla si kampet e internimit dhe përpjekjet e hershme për hapjen e kulturës nga shtypja. Gjithashtu, Prezenca mbështeti RTSH-në për të prodhuar 13 dokumentarë lidhur me aspekte të ndryshme të jetës nën regjimin komunist në Shqipëri, duke pasur si risi dëshmitë e viktimave dhe persekutuesve të tyre.

Për më tepër, në vitin 2015, Prezenca zhvilloi një seminar informues për gazetarët, për mënyrën se si mund të lexonin ligjin për hapjen e dosjeve, trajtimin e këtij ligji krahas ligjit për të drejtën e informimit dhe ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndërkohë, Prezenca po përgatit një Manual për median dhe kërkuesit e rinj për mënyrën se si të aksesojnë arkivin e AIDSSH-së, si ta trajtojnë informacionin dhe si të kenë parasysh çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të etikës.

### ***Mbështetje për AIDSSH-në***

Në fjalën e mbajtur në hapjen e Konferencës Shkencore, në 29 tetor 2018, Kryetari i Prezencës së OSBE-së, Ambasador Bernd Borchardt, shprehet se: “Ofrimi i informacioneve specifike për viktimat në lidhje me dosjet e tyre të Sigurimit është një pjesë e rëndësishme në këtë proces të shërimit social: njerëzit mund ta kuptojnë më mirë krimin e kryer kundër tyre, ata mund të përballen me një traumë, ndërkohë që institucionet shtetërore më në fund mund të trajtojnë krimin, autorët (kur është e mundur) dhe të ofrojnë ndihmë për viktimat.”

Duke konsideruar rolin e rëndësishëm të AIDSSH-së në kontekstin e një narrative të re për trajtimin e së kaluarës në Shqipëri, Prezenca e ka mbështetur vazhdimisht këtë institucion. Prezenca ka promovuar hapur nevojën për krijimin e AIDSSH-së dhe pas krijimit të këtij institucioni ka promovuar punën e vazhdueshme të tij në të mirë të viktimave të komunizmit, qytetarëve, medias, studiuesve dhe vetë shoqërisë.

Mbështetja e Prezencës për AIDSSH-në ka qenë përmes ekspertizës teknike nga ekspertë vendas dhe ndërkombëtare për përpilimin dhe shqyrtimin e Rregullores së Autoritetit, si dhe për procedurën për ngritjen dhe funksionimin e arkivit të institucionit. Gjithashtu, janë zhvilluar edhe disa vizita studimore dhe aktivitete të tjera për rritjen e kapaciteteve të stafit.

### ***Koordinimi i aktorëve të fushës***

Një nga elementët më të rëndësishëm të mbështetjes së dialogut kombëtar për të kaluarën komuniste të Shqipërisë ishte koordinimi nga ana e OSBE-së i grupit të aktorëve që punojnë në këtë fushë. Në 4 vjet, Prezenca organizoi periodikisht takime me këta aktorë që

ishin: ish-të përndjekur, institucione publike qendrore dhe vendore, organizata të shoqërisë civile dhe të ftuar nga institucione ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë. Roli që pati OSBE-ja në koordinimin e një debati mbarëkombëtar për periudhën komuniste në Shqipëri është i vlefshëm për faktin se të gjithë aktorët u ulën bashkë, shpërndanë informacion, prezantuan dhe diskutuan projektet e tyre, gjetën hapësirë për bashkëpunim dhe bashkërendim për një qëllim të përbashkët- që ishte përballja me të kaluarën komuniste në Shqipëri.

Gjithashtu, vlera që gjeti OSBE-ja në këtë koordinim ishte fokusi i veçantë te shoqëria civile dhe institucionet e pavarura publike. Bashkëpunimet që patën në zhvillimin e aktiviteteve ndihmoi në rritjen e kapaciteteve të këtyre organizmave, në mënyrë që gjithë njohuria e shprehur dhe vazhdimësia e aktiviteteve tëprojektit të kalonte te partneret lokalë.

Prezenca, gjatë takimeve koordinuese me aktorët e interesuar e kësaj fusheka promovuar rolin e OSHC-ve dhe institucioneve të pavarura në zhvillimin e dialogut.

### ***Ri-integrimi dhe rehabilitimi i viktimave të komunizmit***

Gjithë ky aktivitet ka pasur spunto nga nevoja qëPrezenca shihte për të përkrahur respektimin e të drejtave të njeriut, rehabilitimin dhe ri-integrimin e ish-të përndjekurve ose më saktë, viktimave të regjimit komunist në Shqipëri. Për këtë, Prezenca ka përkrahur gjithmonë kërkesat e tyre, duke pasur parasysh, në veçanti, shkeljen e të drejtave të njeriut gjatë periudhës komuniste në Shqipëri.

Ish-të përndjekurit kanë qenë pjesëmarrës aktivë në çdo aktivitet të zhvilluar në kuadrin e projektit. Ata janë ftuar që të ndajnë me të rinjtë dhe me publikun historitë e tyre. Gjithashtu, e përmendëm edhe më lart se në kuadër të aktiviteteve të zhvilluar me të rinjtë në bashkëpunim më Muzeun “Gjethi” rreth 15 ish-të përndjekur janë trajnuar në lidhje me mënyrën se si ta tregonin historinë e tyre nxënësve dhe studentëve. Për më tepër, në kuadër të rehabilitimit dhe ri-integrimit, në një prej takimeve koordinuese në vitin 2017 Prezenca ftoi një përfaqësuese nga Ministria e drejtësisë e Republikës Federale Gjermane për të sjellë shembuj nga praktika gjermane në këtë fushë.

E përsërisim se leximet publike të dosjeve të tyre, duke hapur një dritë mbi persekutimin e vazhdueshëm dhe sistematik synojnë nxjerrjen në pah të shkeljeve të të drejtave të njeriut, por edhe dhënien e një mundësie për ish-të përndjekurit për të folur me publikun dhe shoqërinë në përpjekje për të kaluar traumën e tyre.

### ***Konkluzione dhe rekomandime***

Ndonëse nuk është kurrë e lehtë për të folur për një të kaluar të dhimshme, shoqëria shqiptare ka nevojë të dëgjojë të kuptojë historitë e të mbijetuarve dhe viktimave të komunizmit, në mënyrë që të kuptojë shkallën e shkeljeve të kryera nga regjimi i kaluar. Dialogu mbi të kaluarën është mënyra më efiçente për t'i siguruar Shqipërisë një të ardhme demokratike. Procesi i hapjes së dosjeve nisi në vitin 2015 me miratimin e ligjit për krijimin e një organi shtetëror përgjegjës për kryerjen e këtij procesi. Prezenca e OSBE-së e mirëpriti dhe e promovoi këtë narrativë të re të historisë së Shqipërisë.

Qasja gjithëpërfshirëse e Prezencës në dialogun për të kaluarën e Shqipërisë ka qenë çelësi i suksesit të projektit. Mbështetja ndaj OSHC-ve dhe kalimi i njohurive dhe vazhdimësisë së aktiviteteve ka qenë veçanërisht i rëndësishëm në këtë projekt, gjë që ka ndihmuar në përcaktimin e disa prej qëllimeve dhe pritjeve kryesore të aktiviteteve të propozuara nga qeveria.

Ndërsa gjithnjë e më shumë informacion në lidhje me periudhën komuniste në Shqipëri po i jepet publikut të gjerë, kërkesa për të dhëna sa më të sakta dhe të qarta po rritet. Projekti i Dialogut Kombëtar të Prezencës mbaron këtë dhjetor pasi qëllimet e tij janë arritur në masë të madhe.

Prezenca do të punojë për të mbështetur një dialog kombëtar më të avancuar duke shkuar drejt drejtësisë tranzicionale në tërësi, me fokus të veçantë në shkeljet e të drejtave të njeriut nën regjimin komunist shqiptar. Prezenca tani synon që rezultatet e projektit të jenë sa më të qëndrueshme dhe do të vazhdojë përpjekjet e saj për të ofruar mbështetje për respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Por, për të arritur këtë qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të dialogut nga aktorët që kontribuojnë në këtë fushë, do rekomandoja të merreshin parasysh pikat e mëposhtme:

- Bashkëpunimi i ish-të përndjekurve, institucioneve publike, institucioneve të pavarura, universiteteve, organizatave të shoqërisë civile etj. duhet të jetë i vazhdueshëm dhe frytdhënës, në shërbim të kauzës së përbashkët. Vlen të përmendet se bashkërendimi i aktiviteteve luan një rol të rëndësishëm;
- Fokusi te të rinjtë është një nga elementët kyç të një dialogu të vazhdueshëm. Informimi i tyre mbi të kaluarën nëpërmjet librave shkollorë, vizitave në muze, takimeve me të mbijetuarit e regjimit dhe përfshirja aktive në aktivitete krijuese janë të domosdoshme. Përdorimi i historisë gojore (oral history), në mbledhjen e dëshmimeve të viktimave të komunizmit për të treguar persekutimin, por edhe për të dhënë një qasje personale dhe kolektive të asaj kohe, vlen për të rinjtë, por edhe për të pasuruar kurrikulën e shkollave;

- Një aspekt më domethënës në zhvillimin e kërkimit akademik në fushën e dhunimeve të të drejtave të njeriut bën të mundur që e gjithë shoqëria të mësojë, të reflektojë dhe të kuptojë se çfarë ka ndodhur gjatë regjimit komunist, si dhe të kontribuojë në një dialog racional për një të kaluar të vështirë dhe të dhimbshme. Prandaj, mbështetja e studiuesve dhe drejtimit rreth kësaj teme përbën një nevojë për vazhdimësinë e dialogut.
- Rehabilitimi dhe ri-integrimi ish-të përndjekurve duhet të jetë në vizion të çdo aktiviteti që zhvillohet në këtë fushë. Problematikat e tyre janë të shumta dhe duhen konsideruar dhe trajtuar gjerësisht dhe qartësisht.
- Roli i medias mbetet shumë i rëndësishëm dhe po aq të rëndësishme janë rritjet e kapaciteteve të saj në këtë drejtim. Mesazhet e medias janë shumë të fuqishme në dhënien e informacionit, por edhe në trajtimin e këtij informacioni. Ajo është faktor kyç në proceset e drejtësisë tranzicionale, por edhe të demokratizimit të shoqërisë në tërësi. Rritja e kapaciteteve të saj në drejtim të etikës dhe trajtimit të respektimit të të drejtave të njeriut mbetet me rëndësi dhe duhet konsideruar nga aktorët që punojnë në këtë fushë.
- Vlen të përmendet se debati publik, qoftë bashkangjitur një ngjarjeje artistike, leximit të një dosjeje të ish-të përndjekurve apo i zhvilluar në media janë pjesë të dialogut që mbeten të rëndësishmë dhe duhen prekur vazhdimisht.
- Nevoja për një anketim tjetër, që të masë se si kanë dryshuar perceptimet e shoqërisë dhe publikut shqiptar mbas këtyre viteve të ndryshimit të narrativës duhet konsideruar nga institucionet dhe OSHC-të.
- Roli i OSHC-ve në këtë dialog është i padiskutueshëm dhe i vlen një mendimi të pavarur, civil mbi temën duke ushqyer trajtimin e informacionit, shpërndarjen e njohurive, mbledhjen e dëshmive, ri-integrimit dhe rehabilitimit të të mbijetuarve dhe gjithë sa thamë më lart.



**Referenca:**

Mandat i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, 2003: <https://www.osce.org/presence-in-albania/mandate>

Përmbledhje e veprimtarisë së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri (factsheet), 2017: <https://www.osce.org/resources/factsheets/presence-in-albania>

Workshop on “Towards a Strategy for Reconciliation in the OSCE Area” Key Issues and Recommendations, 2012, <https://www.osce.org/sg/98698?download=true>

Njohuritë dhe perceptimet e publikut për tëshkuarën komuniste në Shqipëri dhe pritshmëritë etyre për të ardhmen, OSCE, IDRA, 2016 <https://www.osce.org/albania/286821>

Raporti i Prezencës në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së, 31 tetor 2013 (<https://www.osce.org/albania/107715?download=true> )

Raporti i Auditimit të Performancës- Rehabilitimi i ish-të përndjekurve në periudhën e tranzicionit”, Kontrolli i lartë i Shtetit, 2016 9

[http://www.klsh.org.al/previewdoc.php?file\\_id=2592](http://www.klsh.org.al/previewdoc.php?file_id=2592))

Fjala e mbajtur nga Kryetari i Prezencës së OSBE-së, Ambasador Bernd Borchardt, mbajtur në hapjen e Konferencës Shkencore, 29 tetor 2018

## **Diktatura nga këndvështrimi i të prekurve: Roli i familjes**

### **Abstrakt**

Punimi sjell një këndvështri psikologjik të pasojave të dhunës diktatoriale. Mungesa apo shkelja e të drejtave të njeriut gjatë dhe pas diktaturës apo konflikteve etnike ndikon negativisht në shëndetin mendor të të prekurve. Studimet mbi traumën shqyrtojnë rolin e ndryshimeve pas diktaturës apo konflikteve. Studimi vë në dukje ndikimin negativ që ushtron te të mbijetuarit mungesa e mjedisit shoqëror ku të shprehen për atë çfarë kanë përjetuar.

### **Hyrje**

Regjimi komunist në Shqipëri zgjati më shumë se 45 vite dhe pati viktima në më shumë se një gjeneratë. Krimet e regjimit komunist përfshinë ndër të tjera vrasje pa gjyq, burgime, internime, mungesë mbrojtjeje ligjore në gjyqe dhe shumë shkelje të së drejtave të tjera të karakterit politik, civil, por dhe ekonomik, social dhe kulturor. Shembuj të këtyre shkeljeve të të drejtave përfshijnë të drejtën e punës, të arsimimit, të mbrojtjes shëndetësore, të drejtën e strehimit, lëvizjes së lirë, lirisë së fjalës, lirisë së besimit e shumë të tjera. Shumë nga këto shkelje janë dokumentuar qartë në literaturën shqiptare dhe atë botërore (p.sh. Llashanaku & Tufa, 2014, 2015, 2016, 2017). Ndërkohë, ka pak studime psikologjike mbi pasojat e këtyre krimeve.

Në aspektin psikologjik, këto lloj krimesh shoqërohen me vështirësi shumë të mëdha dhe jo rrallë mund të lenë pasojat e viktimit të tyre. Pavarësisht nivelit të dhunës, jo çdokush vuan nga pasojat psikologjike të përhershme, të tilla që pengojnë rikthimin në jetën e mëparshme. Kjo ndodh sepse aftësia për t'i mbijetuar traumës varet nga shumë faktorë. Studimet psikologjike tregojnë se pasojat e traumës varen nga kuptimi që individët i japin asaj (p.sh. çështje ideologjike), prania e mbështetjes së familjes dhe miqve (në të tashmen dhe të ardhmen), reagimi i të tjerëve pas ngjarjes (p.sh. heshtja ndaj dhunës seksuale) si dhe nga çfarë ndodh pas ngjarjes (p.sh. ndryshimet ligjore, shoqërore etj.). Asnjë nga këto procese nuk ndodh në nivel individual. Ato varen nga prania e të tjerëve dhe mënyra sesi individit ndërvepron me të tjerët. Ky punim i qaset traumës si fenomen shoqëror, bazuar në teorinë e identitetit social. Teoria e identitetit social (*Social Identity Theory/Self Categorisation Theory*) e përcakton identitetin e individit në bazë të grupeve/identiteteve ku ata/ato bëjnë pjesë dhe që i konsiderojnë të rëndësishme (Tajfel, 1981; Turner, 1985; Tajfel & Turner, 1979). Në këtë punim dy grupet/identitetet sociale kryesore janë ish-të përndjekurit politikë dhe ish-

komunistët. Kur niveli i dedikimit është i lartë, mendimet, ndjenjat dhe veprimet e individit përcaktohen dhe ndikohen nga tiparet, vlerat dhe përvojat e grupit (Ellemers, Spears & Doosje, 2002). Pjesë e rëndësishme e teorisë është përcaktimi i të tjerëve si ‘pjesëtarë të grupit (tonë)’ apo ‘pjesëtarë të një grupi tjetër’. Këtu e kanë burimin dhe shumë fenomene të psikologjisë sociale si dehumanizimi, paragjykimi, nënvlerësimi dhe konflikti ndërgrupor.

Në një studim bazuar në teorinë e Lazarus dhe Folkman (1984) mbi stresin dhe përballjen me të, Këllezi dhe Reicher (2012) tregojnë sesi përkatësia grupore ndikon në më shumë se një aspekt të traumës. *Së pari*, individët bëhen pre e krimeve në bazë të grupimeve dhe të identiteteve ku ata bëjnë pjesë (p.sh. *Konflikti në diktaturë, Kosovë, Irlandën e Veriut*, Këllezi & Reicher 2012; Stevenson 2018). Në shembujt e mësipërm individët kanë rënë pre e krimeve sepse, duke qenë pjesë në njërin kah të konfliktit, janë vënë në shënjestër nga krahu tjetër. *Së dyti*, të kuptuarit dhe rëndësia që i jepet traumës (p.sh. ‘trim’/’dhunuar’ Këllezi & Reicher, 2012; 2014) ndikohet nga vlerat dhe normat e grupeve të caktuara. Për shembull, Këllezi dhe Reicher (2014) shqyrtojnë në studimin e tyre dhunën seksuale pas luftës në Kosovë. Kuptimi negativ i dhunës aty rezulton i dyfishtë: jo vetëm akti i dhunës në vetvete por edhe reagimi më pas i familjes dhe i komunitetit, ku viktimat shpesh u izoluan dhe u bënë të ndihen fajtores për dhunën e ushtruar ndaj tyre. Kjo e bëri krimin fillestar edhe më të vështirë për viktimat. *Së treti*, një pikë që lidhet ngushtë me argumentin e mëparshëm, është prania ose jo e mbështetjes për të përballuar traumën (Këllezi & Reicher 2012; Muldoon, 2012). Sa më shumë mbështetje të ketë viktimat nga miqtë dhe familjarët, aq më i lehtë bëhet përballimi i traumës. *Së fundmi*, në situatë konflikti, përjetimi i traumës së shkuar ndikohet edhe nga frika se ndaj tyre mund të ushtrohen përsëri krime në të ardhmen.

Jo shumë vëmendje i është kushtuar ndikimit të familjes si identitet më vete, qoftë në literaturën psikologjike, por dhe në atë mjekësore dhe sociologjike. Nga këndvështrimi i identitetit social, ka disa studime që sugjerojnë se familja ka ndikim pozitiv në situata të vështira si stresi apo trauma. Për shembull, Sani et al, (2012) në studimin e tyre zbuluan vlerën që ka identifikimi me familjen (ku anëtarët ndihen se janë pjesë e rëndësishme dhe kanë shumë të përbashkëta me anëtarët e tjerë të familjes) në mbrojtjen nga stresi dhe depresioni. Po ashtu, Këllezi, Reicher dhe Cassidy (2009) zbuluan se të mbijetuarit e luftës në Kosovë e patën më të lehtë të përballonin traumën në rastin kur patën mbështetje nga familja. Nga ana tjetër, refuzimi dhe mungesa e mbështetjes së familjes, si në rastet e dhunës seksuale në luftë ndikoi në nivele më të larta stresi për viktimat (Këllezi & Reicher, 2014). Po ashtu, pamundësia e mbajtjes së kontaktit me familjen në momente të vështira shkakton stres (Sani et al., 2012; Këllezi et al., 2018). Këto studime tregojnë se identiteti familjar është i rëndësishëm për të kuptuar dhe për të

përballuar traumën në këto situata por nuk është e qartë nëse këto procese vlejnë edhe për viktimat e diktaturës në Shqipëri.

Një tjetër problem lidhur me studimin e traumës është përqendrimi në tiparet e individit para traumës si dhe çfarë ndodh gjatë traumës. Për shembull, ka shumë studime që tregojnë qartë rolin që familja mund të luajë në shtimin e rrezikut të ndikimit negativ të traumës. Ky rol lidhet me faktorë të ndryshëm, si për shembull depresioni tek prindërit, abuzimi me substancat nga prindërit, dhuna në familje apo abuzimi dhe moskujdesja ndaj fëmijëve (Bronfenbrenner & Ceci, 1994; Tol et al., 2013; Maercker & Hecker, 2016). Ka dhe studime që tregojnë sesi lloji i traumës ka shumë rëndësi në pasojat që le. Për shembull, Santiago et al (2013), në një studim përmbledhës të literaturës zbuluan se llojet e traumës që përfshinin dëmtim të qëllimshëm (si për shembull dhuna fizike) në krahasim me dëmtime jo të qëllimshme (si për shembull fatkeqësi natyrore) shoqërohet me nivele më të lartë të stresit posttraumatik, të depresionit dhe ankthit. Ndërkohë, shumë pak vëmendje i është kushtuar asaj çka ndodh pas traumës, sidomos kur shumë viktima kanë rënë pre e krimit të organizuar nga grupe apo shtete të caktuara. Deri më sot, mungon një analizë psikologjike sistematike e ndikimit të ndryshimeve në nivel shoqëror të shëndeti mendor i viktimave.

Një fushë që jep kontribut në kuptimin e këtyre ndryshimeve, një fushë relativisht e re ku bashkohen politika, historia, jurisprudenca dhe sociologjia, është ajo e ‘drejtësisë në tranzicion’ (*transitional justice*). Pas diktaturave apo konflikteve që kanë çuar në shkelje masive të të drejtave të njeriut, shoqëritë mundohen të bëjnë ndryshimet e nevojshme që dikton drejtësia në tranzicion për vendosjen e paqes, dënimin në masë të fajtorëve dhe vendosjen e rendit publik apo sistemin demokratik (Teitel, 2000). Disa studiues kanë parashtruar nevojën për t’i shqyrtuar këto ndryshime në psikologji (Këllezi & Reicher, 2012; 2014; Muldoon & Lowe, 2012). Sipas këtyre studiuesve, kur dikush bëhet pre e dhunës së qëllimshme nga njerëz të tjerë, viktimat me të drejtë kërkojnë rivendosjen e të drejtave të tyre, dhe indinjohen nga mungesa e ndryshimeve që i përkasin drejtësisë në tranzicion. Këto përfshijnë ndryshime politiko-ligjore (amnisti, lustracion), ndryshime shoqërore (kujtesa, mbështetja e të prekurve), trajtimi i krimeve në media, vepra të historisë, artit, shkencës si dhe edukimi i brezit të ri. Për shkak të nivelit të lartë të krimeve, praktikisht këto ndryshime nuk mund të ndodhin në nivel individual por në atë grupor dhe, për rrjedhojë, duhen analizuar në këtë prizëm. Për shkak se është e mundur që këto ndryshime të ndikojnë në terapitë dhe praktikën psikologjike, edhe studimet e paraqitura në këtë punim i përkasin një qasjeje ndërdisiplinore ku ndërthuret psikologjia me të drejtat e njeriut.

## Qëllimi i këtij punimi dhe i studimeve të prezantuara

Ky punim prezanton dy studime krahasimore të cilat po zhvillohen në Shqipëri, Kosovë, Kroaci dhe Irlandën e Veriut. Në këtë punim, analiza do të përqendrohet vetëm te të dhënat e mbledhura në Shqipëri dhe në rolin e familjes në këto tre procese:

1. Cili është roli i familjes në përjetimin, interpretimin dhe përballimin e traumës?
2. Si i përjetojnë të prekurit proceset politiko-ligjore në tranzicion dhe cili është roli i familjes në këto përjetime?
3. Sa e rëndësishme është familja për shtresën e ish të përndjekurve politikë?

### *Studimi i parë*

Qëllimi i këtij studimi sasior është të përcaktojë rolin e familjes në përjetimin e krimeve gjatë diktaturës komuniste dhe në ditët e sotme te shtresa e ish të përndjekurve politikë.

### *Metoda*

Të dhënat u mbledhën me anë të 100 pyetësorëve të shpërndarë në 100 pjesëtarë të shtresës së ish të përndjekurve politikë. Përkatësia gjinore e kampionit ishte 42% femra dhe 58% meshkuj, kurse mosha varionte nga 28 deri në 90 vjeç, ku shumica dërrmuese kishin lindur para vitit 1970 (92%).

### *Rezultatet*

Rezultatet në vijim paraqesin një përshkrim të përqindjeve në secilën kategori. Këto rezultate tregojnë rolin e familjes në përjetimin e krimeve dhe mohimin e të drejtave gjatë diktaturës komuniste si dhe rëndësinë e familjes në ditët e sotme. Tabela e parë paraqet përvojën personale dhe familjare të ish të përndjekurve politikë që morën pjesë në studim, ku pasojat më të shpeshta përfshijnë humbjen e statusit shoqëror, mohimin e të drejtës së besimit, kritikën publike, humbjen e punës, marrjen e pronës, vuajtjen nga uria, izolimin nga komuniteti si dhe humbjen e shtëpisë. Tabela e dytë paraqet përmbledhtazi arsyet për të cilat pjesëmarrësit mendojnë se u përndoqën gjatë regjimit komunist. Përqindja dërrmuese është për pasojë të pushkatimit apo të dënimit të një pjesëtari të familjes (mbi 75%). Kjo shifër mund të jetë më e lartë duke qenë se një pjesë e pjesëmarrësve nuk e deklaruan arsyen.

Tabela 1: Llojet e krimeve të përjetuara si individ dhe si familje (numrat i përkasin përqindjes së pjesëmarrësve që raportuan këtë shkelje të së drejtës)

U burgosët	Po, personalisht	19%	Po, familja ime	40%
------------	------------------	-----	-----------------	-----

U internuat	Po, personalisht	33%	Po, familja ime	48%
Humbët shtëpinë	Po, personalisht	48%	Po, familja ime	60%
Humbët punën	Po, personalisht	51%	Po, familja ime	78%
Ju mohua e drejta e shkollimit	Po, personalisht	64%	Po, familja ime	58%
Ju morën pronat	Po, personalisht	64%	Po, familja ime	70%
Familja u nda	Po, personalisht	31%	Po, familja ime	31%
U izoluat nga komuniteti	Po, personalisht	62%	Po, familja ime	64%
Keni vuajtur nga uria	Po, personalisht	68%	Po, familja ime	66%
Ju mohua shërbim mjekësor që të tjerët e kishin	Po, personalisht	38%	Po, familja ime	37%
U vutë në shënjestër të mbledhjeve apo të kritikave publike	Po, personalisht	68%	Po, familja ime	74%
Ju kanë vrarë një familjar të afërt			Po, familja ime	54%
Ju mohua e drejta e fesë/besimit	Po, personalisht	76%	Po, familja ime	74%
Humbët statusin shoqëror	Po, personalisht	68%	Po, familja ime	81%
Pësuar dëmtim fizik	Po, personalisht	19%	Po, familja ime	2%
Përjetuar ngacim seksual	Po, personalisht	7%	Po, familja ime	11%

Tabela 2: Arsyet e përndjekjes

Ekzekutimi i një pjesëtari të familjes	25%
Agjitacion dhe propagandë, krime kundër shtetit, armik i popullit	6%
Arratisje vetë ose pjesëtar i familjes	11%
Familja	40%
Arsye tjetër	18%

Në tabelën e tretë shohim rëndësinë që ka familja për ish të përndjekurit politikë. Të gjithë pjesëmarrësit pa përjashtim e mendojnë veten si pjesëtarë të familjes (100% bien dakord), janë krenarë për familjen e tyre (100% bien dakord) dhe kanë lidhje të forta me familjarët e tyre (100% bien dakord). Këto janë rezultate shumë të larta përkatësie familjare. Kjo reflektohet dhe deri diku shpjegohet në bazë të niveleve të larta të mbështetjes që pjesëmarrësit marrin nga familjarët e tyre, siç tregon tabela 4. Shumica dërrmuese e pjesëmarrësve raporton se marrin mbështetje emocionale, ndihmë dhe këshillat e nevojshme nga pjesëtarët e familjes.

Tabela 3: Identifikimi me familjen

E shoh veten si pjesëtar të familjes sime	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As pajtohem, as refuzoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
	0	0	0	27%	73%
Jam krenar që jam pjesëtar i familjes sime	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As pajtohem, as refuzoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
	0	0	0	23%	77%
Ndiej që kam lidhje të forta me familjarët e mi	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As pajtohem, as refuzoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
	0	0	0	25%	75%

Tabela 4: Mbështetja nga pjesëtarët e familjes

Unë marr mbështetjen e nevojshme emocionale nga pjesëtarët e familjes sime	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As pajtohem, as refuzoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
	0	0	1%	31%	68%
Unë marr ndihmën që më duhet nga pjesëtarët e familjes sime	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As pajtohem, as refuzoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
	0	1%	1%	33%	65%
Unë marr këshillat e nevojshme nga pjesëtarët e familjes sime	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As pajtohem, as refuzoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
	0	0	0	36%	64%

Tabela e pestë tregon se një rezultat tjetër i rëndësishëm është besimi se, si familje, ata janë në gjendje që t'i përballojnë vështirësitë me të cilat ndeshen në jetë. Ndërkohë që vetëm një numër i vogël pjesëmarrësish nuk kanë besim se familja mund të përballojë vështirësi të ndryshme në jetë, shumica shprehet besimplotë ndaj forcës së familjes. Ky rezultat mund të reflektojë situatën e përgjithshme të familjeve të ish të përndjekurve politikë, ku shumica ka besim tek aftësia për të përballuar vështirësitë si familje.

Tabela 5: Aftësia për të përballuar vështirësitë si familje

Familja ime ka besim se mund të përballojë ngjarjet e paparashikuara	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As pajtohem, as refuzoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
--	--------------------	--------------	-------------------------	----------	---------------------

	0	4%	11%	71%	16%
Familja ime ruan gjakftohtësinë kur përballet me momente të vështira, pasi ne jemi të aftë t'i përballojmë ato	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As pajtohem, as refuzoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
	0	2%	5%	80%	13%
Familja ime gjithnjë arrin t'i zgjidhë problemet e vështira nëse përpiqemi fort	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As pajtohem, as refuzoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
	0	5%	5%	69%	21%
Kur përballemi me një problem, ne si familje gjejmë shpesh më shumë se një zgjidhje	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As pajtohem, as refuzoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
	0	5%	12%	67%	16%
Familja ime mund të përballojë gjithçka që hasim në jetë	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As pajtohem, as refuzoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
	3%	7%	17%	58%	15%

Së fundmi, tabela e gjashtë tregon se shumica e pjesëmarrësve (81%) janë në kontakt të përditshëm me familjen, një tjetër tregues i rëndësisë së familjes, pavarësisht ndryshimeve që kohët moderne kanë prurë në organizimin/dinamikën e marrëdhënieve familjare dhe lëvizjeve të mëdha demografike të popullatës brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Tabela 6: Shpeshtësia e kontaktit me familjen

Familjen	Çdo ditë	Çdo javë	Çdo muaj	1 herë në vit	Asnjëherë
	81%	7%	6%	2%	1%
Kushërinjtë	Çdo ditë	Çdo javë	Çdo muaj	1 herë në vit	Asnjëherë
	12%	16%	44%	16%	8%

Ky studim nxori në pah rëndësinë e familjes në ditët e sotme për ish të përndjekurit politikë, pavarësisht faktit se vetë përndjekja e shumicës së tyre u shkaktua pikërisht për shkak të përkatësisë familjare dhe pati pasoja tejet të rënda për ta. Ish të përndjekurit politikë sot shfaqin një ndjenjë të lartë përkatësie familjare, e cila shërben njëkohësisht si burim krenarie dhe mbështetjeje, por dhe force për përballimin e vështirësive të ndryshme që hasin në jetë.

#### *Studimi i dytë*

Studimi cilësor i paraqitur në vijim shqyrton rolin e familjes për sa i përket të kuptuarit të së shkuarës dhe së tashmes.



## *Metoda*

Metoda e studimit të dytë përbëhet nga intervista gjysmë të strukturuar me mbi 27 të prekur nga krimet e diktaturës komuniste në Shqipëri. Llojet e krimeve të përjetuara përfshijnë burgosje dhe internim. Intervistat u kryen nga gushti i 2016-s deri në qershor 2017 dhe zgjatën nga 60 minuta deri në 5 orë. Pyetjet e intervistës përfshinin çështje si historiku familjar gjatë dhe pas diktaturës, këndvështrimi i tyre mbi drejtësinë dhe fajtorët e krimeve, ndryshimet ligjore/politike pas diktaturës, roli i medias, i shkencës dhe i artit si dhe politika e sotme në lidhje me të shkuarën.

Intervistat u analizuan duke përdorur analizë tematike teorike (Braun & Clacke, Terry, 2014) ku për analizën e të dhënave studiuësit udhëhiqen nga një teori e caktuar (në këtë rast Teoria e Identitetit Social). Analiza u përqendrua në gjetjen e temave më të diskutuara ndër pjesëmarrësit e ndryshëm. U identifikuan disa tema kryesore të cilat do të parashtrohen në vijim. Në mbështetje të analizës, për secilën temë do të paraqiten shembuj ilustrues nga intervistat. Pikat në kllapa (...) tregojnë reduktimin e fjalëve për shkak të hapësirës së kufizuar të këtij punimi.

## *Familja si burim përndjekjeje dhe krenarie*

Siç duket qartë nga analiza e studimit të parë, shumica e pjesëmarrësve në studimin e dytë u përdoqën nga diktatura komuniste për shkak të lidhjeve të tyre familjare.

*Citim I: 'Babain tim e quanin sabotator (...) Arrestuan vëllain e mamasë, babain e mamasë si bashkëpunëtorë të sabotatorit(...) Kështu lufta e klasave bëhej në disa mënyra. Ajo psikologjike kundër familjes; politike, duke diskredituar të gjithë familjen para opinion publik, armiq të e partisë (...) Ne e dinim se çfarë na priste. Prindërit na përgatitën: "Më vjen keq, fëmijë, por kjo punë duhet bërë. Kur të rriteni do të keni fatin tim, burgun, por nuk duhet të dorëzoheni para dhimbjes".'*

Dëshmia e mësipërme flet për pasojat ndër pjesëtarët e tjerë të familjes pasi një anëtar akuzohej për krime kundër regjimit. Dënimi shtrihej dhe në lidhjen e martesave dhe kjo bëhej qëllimisht që të krijonte presion psikologjik te popullata e gjerë. I intervistuari tregon mënyrat e ndryshme sesi ndodhte ky presion psikologjik, ku pjesë e dënimit ishte diskreditimi i familjes para opinionit publik, i cili ishte një faktor i rëndësishëm në një shoqëri si Shqipëria e diktaturës komuniste. Për më shumë, prindërit e dinin se fëmijët e tyre do të vuanin nga pasojat e diktaturës duke qenë thjesht pjesëtarë të asaj familjeje, ndaj dhe një pjesë filluan t'i përgatisin fëmijët për jetën e gjatë e të vështirë në të ardhmen. Pavarësisht nga vuajtjet e përjetuara për shkak të përkatësisë familjare, shumë nga pjesëmarrësit nuk flasin me zemëratë apo duke e fajësuar

familjarin/en apo të afërmin/en që u bë shkak për përndjekjen e tyre. Përkundrazi, ata flasin me krenari për parimet dhe vlerat e familjes së tyre, siç duket qartë nga pjesa e intervistës në vijim:

*Citim II. 'Deri në vitet 60' burgu ishte mbushur me njerëz si ne, familjet, le te themi familjet e mira. (...) Ne ishim familje, ne ishim nacionalistë, ne e donim vendin tonë. (...) Gjyshi dhe babai im e donin këtë vend. Kur u deklarua pavarësia e Kosovës, unë kam qarë, sepse thashë babai dhe gjyshi im kanë vuajtur për këtë dhe nuk e panë rezultatin.'*

I intervistuari i mësipërm (citimi II) flet për krenarinë që ndjen si pasojë e të qenit nga një familje me histori të pasur dhe kontribut të veçantë për shtetin shqiptar. Ky këndvështrim sakrifice dhe atdhetarie shihet qartë në reagimin ndaj pavarësisë së Kosovës ku i intervistuari ndihet i trishtuar për shkak se gjyshi dhe i ati nuk mundën t'i gëzoheshin kësaj ngjarjeje për të cilën ata kishin kontribuar. Pasojat që familjarët kanë përjetuar janë shumë të rëndësishme dhe shumë nga pjesëmarrësit mendojnë se duhen analizuar në thellësi. I intervistuari në vijim tregon sesa gjerë shtrihej ndikimi negativ i krimeve të regjimit komunist dhe sesi jo vetëm të përndjekurit (qoftë të akuzuarit drejtpërdrejt apo të burgosurit e të torturuarit) por edhe familjet e tyre duhen trajtuar dhe studiuar, pasi dhe atyre u janë mohuar të drejtat thelbësore.

*Citim III: 'Nuk asht ba asgja (...) në kuptimin psiko-analizë të vujtjeve të këtyre familjeve duke trajtuar si të burgosurit politik, si familjen që ishte pushkatuar një pjesëtar i tyre dhe që nga pushkatimi i pjesëtarit të familjes dhe deri në vitet '90 atij i mohoheshin të gjithë të drejtat e liritë e njeriut, i mohohej prona, i konfiskohej prona (...) Për shembull, unë jam djali i një të burgosuri politik, (...) pinjoll i një fisi me ndjenja kombëtare që në kohën (...) që ka bërë thirrje kombi, pjesëtarët e familjes sime kanë marrë pjesë, kanë dhënë kontribute të cilat gjatë periudhës së diktaturës komuniste janë mohuar. Më është mohuar arsimi (...) Du të trajtoj problem këtu të (...) çfarë ndodhte me të burgosurit është më mirë që të intervistosh të burgosurit që kanë qenë në burg. Po çfarë ndodhte me ne jashtë burgut? Jashtë burgut, me familjet e të burgosurve.'*

### ***Familja si mjet kontrolli dhe shkatërrimi i së ardhmes***

Shumë nga të intervistuarit tregojnë qartë sesi familjet (përfshi dhe fëmijët) u përdorën si mjet kontrolli dhe ndëshkimi. Shpesh regjimi komunist vinte në shënjestër meshkujt si dhe femrat, nënat, gratë, motrat dhe vajzat e të akuzuarve. Shumë nga të intervistuarit shpjegojnë sesi me dënimin e meshkujve, puna e grave për t'u kujdesur për veten dhe fëmijët teksa mundoheshin të përballonin vështirësitë ekonomike bëhej e pamundur.

Citim IV: *'Pastaj filloi gjithë aventura tjetër, djemtë në burg, s'kish kush punonte, nuk jepnin triskë ushqimi, po vdisnin urie. Ishin gra. (...) Ashtu si të gjitha gratë e tjera një grup grash me të njëjtat probleme persekutimi që i kishin djemtë dhe burrat në burg, punonin në një fshat që ishte 5 orë larg, mblihnin ullinj, që arritën të siguronin të paktën një triskë ushqimi. Nejsë, kjo histori vazhdoi, dolën nga burgu (...)'*

Internimi dhe rrënimi financiar që pasonte ishte njëra mënyrë kontrolli. Mënyra tjetër ishte izolimi dhe përjashtimi nga marrëdhëniet me pjesën tjetër të popullatës. Për shembull, i intervistuari në citimin e mëposhtëm flet për mënyrat sesi fëmijët e një të dënuari përjashtoheshin nga mundësia për martesë, pengoheshin të kishin arritje në shkollë e në punë si dhe nuk u shfaqej kurrë mirënjohje për kontributin e tyre.

Citim V: *'Pas arrestimit të babait, motrat e mia nuk mund të martoheshin jashtë klasës së përndjekur, ishte e ndaluar (...) Në shkollë, dhe të isha më i miri, nuk më jepte notën maksimale. "Ti je djali i armikut." (...) Po si e ndërtuan këtë shtet? Me punën e 50.000 familjeve në kampet e punës. Në kampet e përqendrimit.'*

Pjesa e intervistës në vijim tregon sesi një mënyrë tjetër dënimi ishte shkatërrimi i lidhjeve familjare dhe i atyre me komunitetin. Në kulturën dhe vlerat shqiptare, gëzimet dhe hidhërimet ndahen me komunitetin, ndërkohë diktatura komuniste diktonte përjashtimin e individëve dhe të familjeve të përndjekura nga komuniteti. Ky përjashtim arrihej, përveçse në shumë nga format e përmendura më sipër, edhe, siç tregohet në Citimin VI, me anë të përjashtimit nga ndarja e hidhërimeve dhe e gëzimeve.

Citim VI: *'Të persekutuar. Po jo te familje të tjera. As familje të tjera nuk vinin. Për shembull, në qoftë se do të vdiste babai im, pjesëtarët e (...) fshatit nuk do merrnin pjesë në varrim se ishte familje kriminel. Kishte vdek një kriminel. Babain unë e kam varros vetëm me vëllanë dhe me dy motrat dhe dy dhëndurët.'*

Shpesh shpërndarja e madhe gjeografike e familjes çonte në humbje kontakti pa dëshirë, sidomos kur kishte kontroll të plotë të lëvizjes nga zonat e përcaktuara për vuajtjen e dënimit.

### ***Drejtësia në tranzicion (Transitional Justice)***

Dy temat e para paraqitën një hyrje të përgjithshme mbi pasojat e vuajtjeve të familjeve të ish të përndjekurve politikë gjatë periudhës së diktaturës. Studimi i parë tregon se shumë nga shtresa e të përndjekurve politikë janë krenarë për prejardhjen e familjeve të tyre, dhe që familja është thelbësore edhe në ditët e sotme për këtë shtresë. Si pasojë, dhe kuptimi i drejtësisë në tranzicion ndikohet nga këndvështrimi familjar. Kjo ndodh në disa mënyra, një prej të cilave do të diskutohet në vijim. Shumë nga të intervistuarit më të rinj në moshë flasin për rëndësinë që krimet e komunizmit kishin në kujtesën e tyre familjare si dhe në kuptimin e të shkuarës. Për

ta familjarët ishin shpesh burimi më i rëndësishëm i informacionit për të interpretuar të shkuarën. Pjesa e intervistës në Citimin VII flet për rolin e informacionit të marrë nga brezi më i vjetër në interpretimin e filmave të prodhuar gjatë diktaturës. Informacionet nga gjyshja vunë në dyshim vërtetësinë e ngjarjeve të paraqitura në filma dhe kjo ndikoi në rishikimin e së shkuarës në mënyrë më kritike.

*Citim VII: 'Për shembull, nëse ne, unë shihja për shembull filmin, këtë komedinë "Prefekti" i Tiranës me Qazim Mulletin, gjithmonë kishte një background ku gjyshja ime nga mami ose gjyshja nga babi, gjithmonë tregonin histori që nuk është kështu siç thonë këta. (...) Tani kjo të bënte të ngrije një pyetje, se tani gjyshja ime, pra gjyshja nuk qenka budallaqe, nuk është budallaqe, thotë një histori e cila nuk përputhet fare me këtë filmin që ne shohim dhe qeshim. Atëherë, çfarë ka në këtë mes?'*

Citimi VII flet për këtë ndërlidhje të së shkuarës me të tashmen si dhe mënyrën sesi brezi i ri i ish të përndjekurve politikë e shohin të shkuarën. Kjo është problematike në shumë drejtime dhe përbën burim shqetësimi jo vetëm për brezat që jetuan gjatë diktaturës por dhe për brezat e rinj. Kjo shkakton pakënaqësi psikologjike në të tashmen dhe shqetësim për të ardhmen pasi brezat e rinj mundohen të kuptojnë dhe përballen me të shkuarën.

### ***Përfundim***

Dy studimet e paraqitura në këtë punim përbëjnë një hap eksplorues mbi rolin e familjes në interpretimin e të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes. Rezultatet e analizave sugjerojnë se familjet e ish të përndjekurve politikë, edhe pse burim vuajtjeje në të shkuarën, sot janë burim njohurish dhe force. Po ashtu, familja përcakton njohuritë dhe interpretimin e të shkuarës në mungesë të burimeve më objektive. Është e nevojshme të bëhet një studim i detajuar i pasojave mbi familjet si dhe të gjithë të përndjekurit politikë, ku të shqyrtohet edhe ndikimi i zhvillimeve tranzicionale që kanë për qëllim shpagimin dhe rivendosjen e drejtësisë në lidhje me krimet e kryera gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri.

## Referenca

- Atwoli, Lukoye, Dan J. Stein, Karestan C. Koenen, and Katie A. McLaughlin. "Epidemiology of posttraumatic stress disorder: prevalence, correlates and consequences." *Current opinion in psychiatry* 28, no. 4 (2015): 307.
- Braun, Virginia, Victoria Clarke, and Gareth Terry. "Thematic analysis." *Qual Res Clin Health Psychol* 24 (2014): 95-114.
- Bronfenbrenner, Urie, and Stephen J. Ceci. "Nature-nuture reconceptualized in developmental perspective: A bioecological model." *Psychological review* 101, no. 4 (1994): 568.
- Bronfenbrenner, Urie. *Making human beings human: Bioecological perspectives on human development*. Sage, 2005.
- Doosje, Bertjan, Russell Spears, and Naomi Ellemers. "Social identity as both cause and effect: The development of group identification in response to anticipated and actual changes in the intergroup status hierarchy." *British Journal of Social Psychology* 41, no. 1 (2002): 57-76.
- Ellemers, Naomi, Russell Spears, and Bertjan Doosje. "Self and social identity." *Annual review of psychology* 53, no. 1 (2002): 161-186.
- Kellezi, Blerina, and Stephen Reicher. "The double insult: Explaining gender differences in the psychological consequences of war." *Peace and Conflict: Journal of Peace Psychology* 20, no. 4 (2014): 491.
- Kellezi, Blerina, Stephen Reicher, and Clare Cassidy. "Surviving the Kosovo Conflict: A Study of Social Identity, Appraisal of Extreme Events, and Mental Well-Being." *Applied Psychology* 58, no. 1 (2009): 59-83.
- Kellezi, B., and S. Reicher. "Social cure or social curse? The psychological impact of extreme events during the Kosovo conflict." (2012): 217-233.
- Kellezi, Blerina., Bowe, Mhairi, Wakefield, Juliet, McNamara, Niamh, and Bosworth, Mary. "Coping with immigration detention: social identities as cures and curses." *European Journal of Social Psychology*(2018).
- Kohrt, Brandon. "Social ecology interventions for post-traumatic stress disorder: what can we learn from child soldiers?" *The British Journal of Psychiatry* 203, no. 3 (2013): 165-167.
- Llashanaku, Luljeta & Tufa, Agron. (2014, 2015, 2016, 2017). *Zerat e kujteses*. Vellimi I, II, III, IV. West Print, Tirane.
- Lazarus, Richard. S., & Folkman, Susan. (1984). *Stress, appraisal and coping*. New York: Springer Publishing Company
- Maercker, Andreas, and Tobias Hecker. "Broadening perspectives on trauma and recovery: A socio-interpersonal view of PTSD." *European journal of psychotraumatology* 7, no. 1 (2016): 29303.
- Muldoon, Orla T., and Robert D. Lowe. "Social identity, groups, and post-traumatic stress disorder." *Political Psychology* 33, no. 2 (2012): 259-273.
- Santiago, Patcho N., Robert J. Ursano, Christine L. Gray, Robert S. Pynoos, David Spiegel, Roberto Lewis-Fernandez, Matthew J. Friedman, and Carol S. Fullerton. "A systematic review of PTSD prevalence and trajectories in DSM-5 defined trauma exposed populations: intentional and non-intentional traumatic events." *PloS one* 8, no. 4 (2013): e59236.
- Tajfel, Henry. (1981). *Human groups and social categories*. Cambridge: Cambridge University Press.

- Tajfel, Henry., & Turner, John. C. (1979). An integrative theory of intergroup conflict. In W. G. Austin & S. Worchel (Eds.), *The social psychology of intergroup relations* (pp. 33–47). Monterey, CA: Brooks/Cole
- Teitel, Ruti G. *Transitional justice*. Oxford University Press on Demand, 2000.
- Tol, Weiste A., Mark JD Jordans, Brandon A. Kohrt, Theresa S. Betancourt, and Ivan H. Komproe. "Promoting mental health and psychosocial well-being in children affected by political violence: Part I—Current evidence for an ecological resilience approach." In *Handbook of resilience in children of war*, pp. 11-27. Springer, New York, NY, 2013.
- Turner, John. C. (1985). Social categorization and the self-concept: A social cognitive theory of group behaviour. In E.J. Lawler (Ed.), *Advances in group processes* (Vol. 2, pp.77–122). Greenwich, CT: JAI Press.

## Lukas Kaminski - ENRS, Poloni

### Dëbimet e komunizmit dhe puna e detyruar: përvoja polake

#### Historia dhe Kujtesa

Dëbimet masive dhe puna e detyruar kanë qenë pjesë e komunizmit që prej fillimit të tij. Aktet e para që e përcaktonin punën e detyruar si masë penale u miratuan në fillim të vitit 1918. Në të njëjtën kohë u krijuan kampet e para sovjetike të përqendrimit dhe kampet e punës së detyruar. Gjatë luftës civile, kozakët dhe fshatarët u dëbuan masivisht nga zonat ku u realizuan kryengritjet.

Sistemi i kampit u zgjerua në periudhën e kolektivizimit intensiv të bujqësisë dhe zgjerimit industrial në fillim të viteve 1930. Ai u shërbeu dy objektivave: ndëshkimit dhe shfarosjes së armiqve aktualë dhe imagjinar të popullit, nga njëra anë, dhe shfrytëzimit të krahut të punës pa pagesë, nga ana tjetër. Ai gjithashtu bëri të mundur realizimin e "projekteve të mëdha ndërtimore komuniste", siç është kanali i Detit të Bardhë, i hapur nga të burgosurit në vitet 1931-1932<sup>1</sup>.

Në vitin 1931, u themelua Administrata Kryesore e Kampeve të Punës Korrektuese dhe Vendeve të Burgimit, akronimi rus i të cilës "Gulag" u bë i njohur në mbarë botën si emblemë e terrorit të kampeve komuniste. Në kulmin e tij, sistemi përfshinte 53 zona të menaxhimit të kampeve, 425 koloni penale dhe një total prej rreth 30,000 vendesh izolimi me madhësi të ndryshme. Numri i të intenuarve kishte luhatje, ndërsa numri maksimal i shënjuar i të internuarve ka qenë mbi 2.5 milion njerëz, në varësi të periudhës, me 20-60% të të burgosurve për arsye politike. Të internuarit merreshin kryesisht me industri, miniera, shpesh edhe në kantieret e ndërtimit dhe ndonjëherë dhe me prerje pyjesh. Sipas statistikave zyrtare, në Gulag<sup>2</sup> kanë humbur jetën 1.6 milionë njerëz.

Nga mesi i viteve 1930, dëbimet aplikoheshin masivisht. Ato ishte formë ndëshkimi për të gjitha grupet shoqërore, ose kombet, ndërkohë që kishin edhe një dimension ekonomik. Statusi i të dëbuarve ndryshonte, kategoritë bazë ishin *specpereselentsy* (dëbimet e posaçme), *ssylnposelelentsy* (dëbimet për internim) dhe "të dëbuarit e lirë". Dy kategoritë e para të të dëbuarve i nënshtroheshin punës së detyruar dhe pavarësisht dallimeve formale në shumicën e rasteve, e njëjta gjë vlente edhe për kategorinë e tretë. Të dëbuarit punonin në bujqësi, prerjet e

---

<sup>1</sup> Ann Applebaum, *Gulag. A history*, New York etc 2003; S. Ciesielski, *Gulag. Radzieckie obozy koncentracyjne 1918-1953*, Warszawa: 2010.

<sup>2</sup> ГУЛАГ (Главное управление лагерей). 1918-1960, Москва: 2000, f. 410-442.

drurëve në pyje dhe, ndonjëherë, edhe në industri. Deri në fillim të viteve '50, numëroheshin në total rreth 6 milion njerëz<sup>3</sup>.

Viktimat e kësaj politike përfshinin edhe polakët nga territoret e mëparshme polake të përfshira në Bashkimin Sovjetik. Në vitin 1936, rreth 40,000-50,000 polakë të konsideruar si kulakë, u dëbuan nga Ukraina Sovjetike në Kazakistan. Në periudhën 1937-1938, NKVD-ja realizoi një “operacioni polak”. Polakët (ndonjëherë njerëz që kishin vetëm mbiemra polakë) dëboheshin masivisht. 111.091 polakë u ekzekutuan, ndërsa 28.744 vetë u dënuan me qëndrime të gjata në kampet e Gulagut, ku iu nënshtruan një pune shkatërruese<sup>4</sup>.

Kjo përvojë së shpejti do të përjetohej nga shumë polakë të tjerë. Më 23 gusht 1939, Gjermania naziste dhe Bashkimi Sovjetik arritën një marrëveshje që hyri në histori si Pakti i Molotov-Ribbentrop-it. Një shtojcë konfidenciale bashkëlidhur marrëveshjes ndante Poloninë dhe një pjesë të Evropës Lindore-Qendrore midis dy pushteteve totalitare. Kjo hapi rrugën për Luftën e Dytë Botërore. Lufta e Dytë Botërore filloi kur gjermanët sulmuan Poloninë më 1 shtator 1939, me sovjetikët që shtuan sulmin e tyre më 17 shtator. Së shpejti, gjithë Polonia u nda midis agresorëve. Në politikat e tyre, të dyja palët i përdornin deportimet dhe punën e detyruar, por, duke marrë parasysh temën e kontributit tim, unë do të përqëndrohem ekskluzivisht te pushtimi sovjetik, i cili deri në qershor të vitit 1941 mbuloi gjysmën e vendit.

Territoret polake u përfshinë në Bashkimin Sovjetik. Kjo do të thoshte sovjetizim të shpejtë, duke përshtatur jetën politike, sociale dhe ekonomike me realitetet e vendit të këshillave sovjetike. Të gjitha këto ndryshime u hasën me rezistencë, të thyer me represione brutale. Vlerësohet se gjatë pushtimit të parë sovjetik janë arrestuar rreth 110,000 shtetas polakë. Shumica u dënuan dhe u dërguan në kampet e punës së detyruar të sistemit Gulag në veriun e largët në bazenin e Kolimas, ku të dëbuarit nxirrnin burime natyrore në kushte shumë të këqija. Fati i atyre që u burgosën në territoret e mëparshme polake nuk ishte më i mirë: rreth 20,000 vetë u vranë pas shpërthimit të luftës gjermano-sovjetike në qershor të vitit 1941<sup>5</sup>.

Komunistët sovjetikë kërkonin gjithashtu ndryshime në strukturën shoqërore dhe kombëtare të zonave të pushtuara. Mjetet për këtë qëllim ishin dëbimet. Dëbimi i parë u realizua më 10 shkurt 1940. Për shkak të kushteve të dimrit, ai ishte shumë dramatik dhe çoi në numrin më të madh të viktimave. Dëbimi përfshinte familje polake (të cilat u vendosën atje në tokat shtetërore në vitet 1920 dhe 1930) si dhe familjet e rojeve të pyjeve, gjithsej rreth 140,000 vetë. Operacioni gjigant kërkoi jo vetëm më shumë se 20,000 funksionarë dhe ushtarë të NKVD-së,

---

<sup>3</sup> L. Viola, *The Unknown Gulag. The Lost World of Stalin's Special Settlements*, Oxford - New Yor: 2007.

<sup>4</sup> M. Iwanow, *Zginëli, bobyli Polakami. Koszmar "operacji polskiej" NKWD 1937-1938*, Poznań: 2017.

<sup>5</sup> T. Szarota, W. Materski (ed.), *Polska 1939-1945. Straty osobowe i ofiary represji pod dwiema okupacjami*, Warszawa: 2009.



por edhe disa dhjetra mijë zyrtarë të armatosur dhe përfaqësues të “aktivistëve ruralë”. Në aspektin formal, të dëbuarve u jepeshin dy orë kohë për të paketuar dhe kapaciteti i kufirit të valizheve për familje ishte 500 kilogramë.

Në realitet zyrtarët u jepnin më pak kohë të dëbuarve dhe njerëzit, të tmerruar, nuk ishin në gjendje të zgjedhin dhe të marrin gjërat më të nevojshme. E gjithë pasuria e tyre e patundshme, mjetet bujqësore, kafshët, paratë në monedha të huaja, gjërat e çmuara dhe “literatura kundërrevolucionare” konfiskohej. Megjithëse dëbimet përfshinin në mënyrë tipike vetëm individët emrat e të cilëve ishin në listat e paracaktuara, njihen edhe raste kur dëboheshin njerëz të zakonshëm për shkak të faktit që duhej të plotësoheshin numrat.

Pas largimit (në shumicën e rasteve përgjithmonë) nga shtëpitë e tyre, familjet shoqëroheshin në stacionin më të afërt hekurudhor. Udhëtimi drejt lindjes zgjaste tre-katër javë, me një “ngarkesë” të vetme transporti që përfshinte 1500 persona të mbyllur në vagonët e mallrave. Vetëm rojet e NKVD-së rrinin në vagonat e pasagjerëve. Të dëbuarit vuanin nga të ftohtët, mungesa e ushqimit dhe ndonjëherë edhe e ujit. Kushtet sanitare në vagonat e trenit ishin shumë të këqija. Destinacioni ishin pjesët veriore dhe perëndimore të Siberisë. Të dëbuarit u vendosën në ndërtesa të veçanta rezidenciale nën mbikqyrjen e NKVD-së. Largimi nga vendbanimi për më shumë se 24 orë kërkonte leje zyrtare. Shumica e të dëbuarve përdorshin për prerjen e drurëve edhe pse disa punonin me detyrim në sektorin e minierave dhe çelikut. Në muajt e parë, problemi kryesor ishte mungesa e banesave për ta. Të dëbuarit u vendosën në kasolle, me 1-2 metra katrorë për frymë në dispozicion.

Dëbimi i radhës u bë në prill të vitit 1940. Ai përfshinte familjet e të dëbuarve, përfshirë edhe viktimat e masakrës së Katinit, rreth asaj kohe. Atje, në Katin dhe gjetkë, u qëlluan për vdekje rreth 22.000 oficerë policie dhe ushtarakë polakë, si dhe rojet e burgjeve dhe kufirit. Rreth 61,000 anëtarë të atyre dhe viktimat të tjera të represionit sovjetik u dëbuan në Kazakistanin verior. Zyrtarisht, statusi i tyre ishte më i mirë se ai i të dëbuarve të tjerë por, në praktikë, puna e vetme që ata mund të bënin në *sovkhos*-in shtetëror dhe në fermat *kolkhoz* ishte puna në bujqësi. Vetë mekanizmi i dëbimit pasqyronte praktikën e mëparshme dhe më të vona. Atë kohë, vështirë se ndërmyjet të dëbuarve kishte ndonjë njeri të aftë për punë. Gratë duhej të siguronin veten, fëmijët dhe shpesh edhe të moshuarit.

Thuaje dy muaj më vonë, u dëbuan 80.000 vetë të tjerë, refugjatë nga territoret e okupuara gjermane, të cilët kishin refuzuar shtetësinë sovjetike. Ata ishin kryesisht hebrenj polakë. Ata u zhvendosën në Siberi dhe në Rusi. Ashtu si në rastin e dëbimit të parë, ata merreshin me punë të detyruar kryesisht në prerjen e drurëve, ndërkohë që një përqindje e vogël ka punuar në miniera dhe në në përpunimin e çelikut.

Dëbimi i fundit (faza e tretë) u realizua në maj dhe në qershor të vitit 1941. Ai u ndërpre nga shpërthimi i luftës gjermano-sovjete, para së cilës u zhvendosën rreth 40,000 njerëz (ose "elementët e huaj në shoqëri" si armiq ideologjikë) nga territoret polake. Ky ishte një operacion i gjerë që përfshinte të gjitha fushat e përfshira në Bashkimin Sovjetik në periudhën 1940-1941: Poloninë, por edhe Lituaniën, Letoninë dhe Estoninë, si dhe Besarabinë rumune dhe Bukovinën e Veriut. Shumë tragjik ishte fati i prurjeve të fundit, pasi pas përfundimit të luftës, disa trena u bombarduan nga gjermanët. Të dëbuarit e asaj vale ishin dënuan zyrtarisht me 20 vjet rivendosi të detyruar, kryesisht në Siberi dhe pjesërisht në Kazakistanin e Veriut<sup>6</sup>.

Kur Polonia dhe Bashkimi Sovjetik i rilidhën marrëdhëniet diplomatike, u dha një amnisti për qytetarët polakë të dëbuar dhe të dërguar në kampe të punës me detyrim. Amnistia u aplikua mbi rreth 390,000 vetë, 120,000 prej të cilëve ia dolën të lënë Bashkimin Sovjetik me ushtrinë polake të udhëhequr nga Gjeneral Władysław Anders. Të tjerët morën shpejt nënshtetësinë sovjetike me detyrim dhe patën mundësi të ktheheshin në Poloni (tashmë brenda kufijve të saj të ri) vetëm pasi mbaroi lufta. Numri i viktimave nuk dihet, por vlerësohet jo më pak se 10%, pra afërsisht në 40,000 vetë.

Dëbimet sovjetike janë një shembull i mirë i tensionit midis pikëpamjes së publikut lidhur me të shkuarën dhe njohurive bashkëkohore të historianëve. Për shumë vite nuk njihej asnjë dokument që do të ndihmonte për përcaktimin e numrit të të dëbuarve. Ende gjatë luftës, qeveria polake në mërgim vlerësonte që bëhej fjalë për rreth një million vetë. Ndër vite, kjo shifër interpretohej zakonisht si shifra aktuale, veçanërisht nga viktimat, duke u bërë simbol i rrëfimeve të martirizimit të polakëve në Lindje. Kjo shifër iu dha gjithashtu emigrantëve polakë dhe historianëve perëndimorë. Pas vitit 1989, ajo u shfaq edhe në veprat e shkruara nga historianët në Poloni, ndërsa kishte edhe nga ata që e rritën këtë shifër duke shtuar qindra mijëra të tjerë. Megjithatë, pas disa vitesh, në bazë të dokumenteve sovjetike të vëna në dispozicion, historianët llogarisnin se në total katër valët e dëbimit kanë përfshirë rreth 320,000 shtetas polakë<sup>7</sup>. Botimi i shifrës çoi në shumë debate dhe diskutime të nxehta, të cilat, megjithëse jo me aq intensitet, vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Pjesa më e madhe e komunitetit të ish të dëbuarve nuk i pranon këto raporte. Puna e historianëve perceptohet se nuk kërkon të vërtetën, por thjesht si përpjekje për të minuar vuajtjen e kombit. Gjithashtu, vihet në pikëpyetje edhe besueshmëria e dokumenteve sovjetike.

---

<sup>6</sup> S. Ciesielski, G. Hryciuk, A. Srebrakowski, *Masowe deportacje ludności w Związku Radzieckim*, Toruń: 2004, p. 206-246.

<sup>7</sup> D. Boćkowski, *Masowe deportacje polskiej ludności cywilnej w głąb ZSRR w latach 1940-1941 - próba weryfikacji danych*, "Mazowieckie STudia Humanistyczne" 1996, nr. 1, p. 41-51.

Megjithatë, le t'i kthehemi historisë. Territoret në Poloninë lindore u zaptuan sërish nga BRSS-ja në vitin 1944, kësaj here për gjithmonë, gjë të cilën aleatët e Perëndimit e konfirmuan gjatë konferencës së Jaltës. Kjo nënkuptoi një vale tjetër represioni: rreth 40,000 vetë u ndaluan dhe u dënuan me dëbim për punë të detyruar, ose në kampe internimi<sup>8</sup>. Disa prej tyre u liruan në periudhën 1946-1947 dhe duhej të prisnin deri sa të vdiste Stalini. Për vite me radhë, baza polake ishte gjithnjë e më pak aktive, kjo edhe për shkak të rikthimit të më shumë se 1 milion njerëzish në Poloninë me kufij të rinj. Dënimet që përfshinin dëbimet në kampet e punës me detyrim vazhduan të jepeshin edhe për shumë vite të tjera.

Ndërkohë, falë trupave të Ushtrisë së Kuqe dhe të NKVD-së, pushtetin në Poloni e morën komunistët. Po ashtu, rreth 50,000 persona u internuan nga Polonia për punë në BRSS, kryesisht në zonën e minierave në Donbas, në vitin 1945. Në fillim të viteve 1950<sup>9</sup> ata ishin ende duke u kthyer në vend.

Operacioni më i madh i dëbimit pas luftës kishte si epiqendër ukrainasit. Objektivi i tij ishte çaktivizimi i veprimtarisë së trupave guerile të Ushtrisë Kryengritëse të Ukrainës, e cila luftonte jo vetëm kundër autoriteteve komuniste, por kishte sulmuar edhe civilë polakë. Gjatë këtij operacioni të vitit 1947, të quajtur "Vistula", 140,000 vetë u zhvendosën në territoret perëndimore dhe veriore, të cilat ishin një lloj "kompensimi" për Poloninë për ata që humbën në lindje. Shumica e të dëbuarve nuk kishin asnjë lidhje me organizatat e fshehta<sup>10</sup>.

Ndryshe nga vendet e tjera të bllokut sovjetik, dëbimet nuk u aplikuan në një masë më të madhe gjatë kolektivizimit rural. Udhëheqja e partisë komuniste kishte menduar për një mundësi të tillë, por kurrë nuk e kishte përdorur atë si metodë në praktikë, ndoshta sepse rezistenca e fshatarëve polakë ishte jashtëzakonisht e fortë dhe kishte frikë se mund të përshkallëzohej. Po kështu, nuk u zbatuan as planet për dëbimin e "elementëve reaksionarë" nga qytetet dhe qytetet. Shembulli i vetëm i një operacioni të tillë ishte rivendosja e një duzine familjesh nga Gdańsku pas grevës së punëtorëve në gusht të vitit 1946<sup>11</sup>.

Që nga fillimi i sundimit komunist në Poloni, filloi krijimi i rrjetit të kampeve të punës së detyruar. Shpesh kampet vendoseshin aty ku kampet gjermane nuk kishin qëndruar për shumë gjatë më parë. Fillimisht, ato pranonin kryesisht gjermanë, *Volksdeutsche* (polakë, të cilët gjatë okupimit nazist kishin deklaruar kombësi gjermane) dhe të burgosur lufte, por numri i të burgosurve polakë u rrit me kalimin e kohës. E drejta për të vendosur njerëz në kampet e punës së detyruar deri në dy vjet në bazë të një vendimi administrativ (pa vendim

---

<sup>8</sup> M. Golon, Represje Armii Czerwonej i NKWD wobec polskiej konspiracji niepodległościowej 1944-1956, cz. I, "Czasy Nowożytnie" 1996, t. I, p. 75-102.

<sup>9</sup> A. Dziurok, M. Niedurny (ed.), Deportacje Górnolązaków do ZSRR w 1945 roku, Katowice: 2004.

<sup>10</sup> E. Misiło, Akcja "Wisła". Dokumenty, Warszawa: 1993.

<sup>11</sup> Strajk dokerów w 1946 r. Materiały z konferencji w Gdańsku Nowym Porcie 6 września 2013, Gdańsk 2013.

gjykatë) i ishte dhënë Komisionit të Posaçëm për Luftën kundër Abuzimit Ekonomik dhe Sabotazhit, i ngritur në fund të vitit 1945. Dy periudhat kur aktiviteti i tij ishte më shumë shtypës ishin: “beteja për tregti” e vitit 1947 dhe kolektivizimi i zonave rurale që filloi një vit më pas. Megjithatë, arsyeja e funksionimit të Komisionit nuk ishte vetëm goditja e grupeve "armiqësore" të shoqërisë, të tilla si pronarët e dyqaneve, artizanëve, apo fshatarëve më të pasur. Dikush mund të përfundonte në një kamp pune edhe pse kishte treguar një shaka politike, pse kishte qenë vonë për punë në disa raste, kishte dëgjuar Radion *Free Europe* (Evropa e Lirë), kishte kritikuar komunizmin, ishte marrë me thashetheme, kishte treguar të vërtetën për masakrën e Katinit, apo edhe për shkak të pamjes së gabuar të tij/saj kur ajo konsiderohej si imitim i modës perëndimore. Në total, Komisioni dërgoi më shumë se 84,000 persona në kampe pune, megjithatë numri i të dëbuarve ishte më i lartë pasi kampet ishin të mbushura edhe me individët e dënuar nga gjykatat. Jo të gjithë të dëbuarit ishin dërguar atje për arsye politike. Disa ishin kriminelë ose raste në kufi midis dy kategorive, si të ashtuquajturit huliganë<sup>12</sup>. Numri maksimal i të dëbuarve u regjistrua në vitin 1947, kur numëroheshin 58,000 njerëz të dëbuar. Në vitin 1954, ky numër ishte rreth 30,000 vetë.

Lista e plotë e kampeve nuk dihet, por deri në vitin 1950 kanë funksionuar 206 kampe. Ato zakonisht ishin të vendosura afër minierave, guroveve ose fabrikave industriale për të përdorur punën e të dëbuarve. Ndryshe nga Çekosllovakia dhe BRSS-ja, të dëbuarit në Poloni nuk u përdorën për nxjerrjen e uraniumit. Në vitin 1950, u hoq termi negativ "kamp pune" duke u zëvendësuar me "Qendrat e Punës të Burgosurve". Sistemi i kampit u braktis si rezultat i transformimit të vitit 1956. Kampi i fundit u mbyll në vitin 1958. Vlerësohet se numri i përgjithshëm i të ndaluarve ishte madje deri në 350,000 vetë. Në periudhën nga viti 1944 deri në vitin 1956, mbi 21,000 persona vdiqën në burgje dhe kampe pune të detyruara (përfshirë të ekzekutuarit)<sup>13</sup>.

Në vitin 1949 u krijua një sistem i ri që lejonte përdorimin e punës së detyruar: minerat ushtarake dhe njësitë e ndërtimit. Ato ishin të mbushur me rekrutë që konsideroheshin “elementë të klasës armiqësore”, domethënë persona që vinin nga familje të fshatarëve më të pasur, tregtarë, pronarë të ndërmarrjeve industriale, prindërit ose motrat dhe vëllezërit e të cilëve u dënuan për krime politike ose për pasjen e të afërmeve me “qëndrim armiqësor ndaj Polonisë Popullore” që jetonin jashtë dhe të rinj për të cilët aparati i sigurimit kishte prova që

---

<sup>12</sup> A. Zaćmiński, Przewodnik encyklopedyczny, Warszawa 2002; T. Wolsza, Od Sillamäe do Goli Otok. Obozy pracy przymusowej i NKWD w krajach nadbałtyckich, Europie Środkowo-Wschodniej i na Bałkanach po drugiej wojnie światowej. Skala zjawiska i codzienność, "Dzieje Najnowsze" 2016, nr 2, p. 94-100.

<sup>13</sup> B. Kopka, Obozy pracy w Polsce 1944–1950. Przewodnik encyklopedyczny, Warszawa 2002; T. Wolsza, Od Sillamäe do Goli Otok. Obozy pracy przymusowej i NKWD w krajach nadbałtyckich, Europie Środkowo-Wschodniej i na Bałkanach po drugiej wojnie światowej. Skala zjawiska i codzienność, "Dzieje Najnowsze" 2016, nr 2, p. 94-100.

sugjeronin qëndrimin e tyre kritik ndaj komunizmit. Ata u vendosën në njësi speciale që operonin në miniera ose në njësitë e ndërtimit të strukturave ushtarake, të tilla si aeroportet. Paga që u jepej për punë të vështirë ishte minimale dhe koha e shërbimit shpesh shtrihej nga 24 deri në 33 muaj, ose edhe në 39 muaj. Këta ushtarë-minatorë ishin viktimat të shumë aksidenteve në miniera, të shkaktuar nga mosrespektimi i standardeve bazë, si dhe nga kërkimi i vëllimeve maksimale të nxjerrjes, qoftë edhe me koston e jetës së njeriut.

Piku arriti përkatësisht në vitin 1952 dhe 1954, ku mbi 58,000 të rinj shërbenin në njësitë e minierave ushtarake dhe i njëjti numër shërbente në njësitë e ndërtimit. Batalioni i fundit i minierave u shpërbë në vitin 1959 dhe numri i përgjithshëm i personave të detyruar për t'iu nënshtruar punës së detyruar si pjesë e shërbimit ushtarak ishte rreth 200,000<sup>14</sup>.

Në vitin 1954, më shumë se një mijë murgesha u zhvendosën me forcë nga manastiret dhe u detyruan të kryejnë punë të detyruar në gjashtë kampe në një operacioni të koduar me emrin "X-2". Mbase ky ishte prelud i një operacioni më të gjerë të mbylljeve të manastireve, modeluar bazuar në modelin e vitit 1950 të kryer në Çekosllovakë. Megjithatë, nuk u vijua me represione të tjera për shkak të transformimit politik. Motrat e ndaluara u lanë të lira në dhjetor të vitit 1956.

Në vitet në vazhdim, autoritetet e Polonisë komuniste nuk përdornin më punë të detyruar. Pas miratimit të ligjit ushtarak në dhjetor të vitit 1981, u krijua një rrjet kampesh internimi, të mbushura me afro 10,000 vetë, të cilët, pavarësisht internimit, nuk u detyruan të punonin.

Tani do të kaloj në një prezantim të shkurtër të ndërlidhjes midis nocioneve të kujtesës dhe drejtësisë.

Gjatë dekadave të para pas luftës, kujtimi i represionit sovjetik, dëbimeve dhe kampeve të punës së detyruar mund të ruhej vetëm nga *émigrés*. Falë faktit që kishte rreth 120,000 ish të burgosur dhe të internuar të larguar nga BRSS-ja në vitin 1942 në ushtrinë e Gjeneral Anders-it, ishte e mundur të mbledheshin disa dëshmi<sup>15</sup>. Këto dëshmi ishin baza e studimeve historike dhe e shumë botimeve. Represionet e pasluftës u përkujtuan shumë më pak.

Në Poloninë komuniste, nuk ishte e mundur të flitej hapur për dëbime ose punë të detyruar dhe kampe të tjera, pasi kjo mbartte rrezikun e represioneve që varionin nga humbja e vendit të punës deri në burgim. Megjithatë, kjo kujtesë mbijetoi përmes transmetimit në familje dhe, më e rëndësishmja, përmes emisioneve të Radio *Free Europe* (Evropa e Lirë). Në

---

<sup>14</sup> P. Piotrowski, *Bataliony budowlane i górnicze w Wojsku Polskim*, [in:] Ł. Kamiński (ed.), *Studia i materiały z dziejów opozycji i oporu społecznego*, Wrocław 1998, p. 123-142.

<sup>15</sup> J.T. Gross, I. Grudzińska-Gross, *W czterdziestym nas matko na Sibir zesłali...* Polska a Rosja 1939-1942, Kraków 2007.

shkurt të vitit 1956, Nikita Hrushovi mbajti një fjalim sekret që e kritikonte Stalinin në kongresin e njëzetë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në Poloni, fjalimi u lexua në mbledhjet e hapura të partisë, gjatë të cilave ishin të shumtë ata që pyetën publikisht për polakët e dëbuar në lindje.

Interesimi për këtë temë u rrit pas shfaqjes së organizatave të reja të opozitës në gjysmën e dytë të viteve 1970, veçanërisht pas krijimit të Sindikatës së Pavarur Vetëqeverisëse “Solidarność” në verën e vitit 1980. Në revistat e pavarura dhe librat e botuar në atë kohë, shumë hapësirë iu kushtua dëbimeve dhe punës së detyruar. Në fshehtësi u ribotuan edhe botimet e emigrantëve, si edhe studime dhe tregime të reja të dëshmitarëve. Përveç represionit sovjetik, në botime të tilla diskutohej po ashtu edhe për dëbime pas luftës dhe për kampet e punës.

Ekzistenca ligjore e "Solidaritetit" në periudhën 1980-1981 çoi gjithashtu në diçka të jashtëzakonshme në një shtet komunist: në ngritjen e disa monumenteve në Poloni për të përkujtuar viktimat e komunizmit. Sidoqoftë, kishte një kufi të qartë, pasi ato nuk duhej t'i referoheshin krimeve sovjetike. Dëbimet dhe kampet e punës së detyruar mund të përkujtoheshin vetëm në kishat ku ishin vënë pllaka të posaçme përkujtimore. Në vitin 1984, u ngrit një faltore për “Të rënë dhe të vrarët në Lindje” në një nga kishat e Varshavës, ku u vendosën pllaka të vogla përkujtimore për rreth një mijë viktime të krimeve sovjetike, dëbimeve dhe kampeve të punës së detyruar.

Kjo temë u fut plotësisht në kujtesën polake vetëm pas rënies së sistemit komunist në vitin 1989. Në muajt e fundit të ekzistencës së sistemit, në dhjetor të vitit 1988, u regjistrua Shoqata e të Dëbuarve në Siberi, e cila mblidhte së bashku viktimat e dëbimeve sovjetike dhe të kampeve. Gjatë viteve të mëpasshme, u krijuan organizata të reja që sillnin së bashku komunitete të veçanta, të tilla si: Shoqata e të Dënuarve në Kampet e Punës Sovjetike, Ushtarët e Ushtresë në Shtëpi, Shoqata e Ushtarëve-Minatorë të Shtypur Politikisht dhe Shoqata e të Burgosurve të Ndërgjegjes të Epokës Staliniste. Organizata të tilla ishin aktive në luftën për të drejtat e viktimave, mobilizimin e ndihmës për anëtarët e tyre, dhe përhapjen e njohurive për shtypjet komuniste.

Për më tepër, shoqatat e viktimave shpesh morën iniciativa për ngritje monumentesh ose pllakash për të përkujtuar fatin e të shtypurve. Në të gjithë vendin, aktualisht ekzistojnë disa qindra vende të tilla përkujtimore. Një rol të veçantë luan Monumenti për të Vrarët dhe të Rënë në Lindje. I ngritur në Varshavë në vitin 1995, ai përfaqëson një platformë hekurudhore me të cilën kryqëzohen katolikë dhe ortodoksë, si dhe gurët e varreve hebraike dhe myslimane.

Përpara monumentit zhvillohen festimet shtetërore dhe ngjarjet e organizuara nga organizatat qytetare.

Ngjarja kryesore përkujtimore mbahet çdo vit më 17 shtator, në përvjetorin e pushtimit Sovjetik të 1939-ës. Në vitin 1991, Shoqata e të Dëbuarve në Siberi shpalli atë datë Ditën e Dëbuarve në Siberi, ndërsa Parlamenti e shpalli të njëjtën datë si ditë zyrtare përkujtimore në vitin 2013. Përveç festimeve shtetërore, çdo vit, në këtë ditë organizohen ngjarje edukative dhe kulturore. Më e rëndësishmja prej tyre është Marshi Ndërkombëtar i Përkujtimit të të Dëbuarve në Siberi, i mbajtur në Białystok që nga viti 1991. Pjesëmarrës në këtë aktivitet janë vetë të internuarit, përfaqësues të autoriteteve shtetërore dhe vendore, si dhe, më e rëndësishmja, mijëra të rinj.

Në vitin 1991 u miratuan tri akte ligjore të rëndësishme. Akti i parë jepte përfitime të veçanta (të tilla si një pagesë mujore, aktualisht rreth 100 euro, ndihmë sociale, trajtim mjekësor përparësor, si edhe zbritje dhe përfitime të ndryshme) për personat e dëbuar dhe të burgosur në kampet e punës së detyruar dhe personat e burgosur pas luftës.

Në vitin 1994, të tilla të drejta iu dhanë edhe ish-ushtarëve të batalioneve të minierave dhe të ndërtimit. Akti i dytë bëri të mundur marrjen e vendimeve të paligjshme gjyqësore dhe vendimeve të organeve jogjyqësore të nxjerra në vitet 1944-1956. Ky lloj anulimi kërkonte procedurë gjyqësore dhe pasi të jepej, individit mund të merrte kompensim për burgimin e tij/saj, edhe për dëbimin në një kamp pune të detyruar. Akti i tretë i vitit 1991 futi në rendin juridik polak termin "krimi stalinist", duke lehtësuar përndjekjen e krimeve të kryera në periudhën 1939-1956. Akti ka shërbyer si bazë për hetimet në lidhje me, për shembull, dëbimet sovjetike të polakëve dhe krimet e kryera në kampe të caktuara të punës së detyruar.

Në vitin 2003, Parlamenti themeloi Kryqin e Mërgimtarëve Siberianë, të cilin Presidenti ua jep të gjithë të internuarve të dërguar në Bashkimin Sovjetik.

Në vitet 1990, aktivitetet edukative në lidhje me përvojën e dëbimit dhe punën e detyruar kryheshin kryesisht nga organizata joqeveritare. Veçanërisht e dalluar në këtë drejtim ishte Ośrodek 'Karta' (Qendra e Kartave), e ngritur në vitin 1987 dhe ende funksionale edhe sot e kësaj dite. Karta nxorri botime, përgatiti ekspozita dhe organizoi projekte edukative të cilat u ofruan të rinjve mundësi për sa i përket të mësuarit për fatin e të shtypurve. Sot, aktivitete të ngjashme kryhen nga disa dhjetra OJQ të tjera. Arritjet kryesore të Kartës janë dy projekte të dokumentacionit: *Arkivi Lindor* dhe *Indeksi i të Shtypurve*. E para përfshiu regjistrimin e mbi 1.500 llogarive të njerëzve të shtypur në BRSS, duke mbledhur mijëra ditarë, fotografi dhe dokumente të tjera. Në projektin e dytë, dokumentet sovjetike dhe burime

të tjera përbënin bazën për hartimin e një liste emrash të të shtypurve, e cila aktualisht mund të gjendet edhe në internet.

Në vitet 1990, ishte paradoks që historianët polakë u lejuan të kishin akses te shumë dokumente sovjetike në lidhje me dëbimet dhe shtypje të tjera, ndërsa në Poloni ato ishin pothuajse ose plotësisht të paaksesueshme. Kjo ndryshoi kur u krijua në vitin 2000 Instituti i Përkujtimit Kombëtar - Komisioni për Përndjekjen e Krimeve kundër Kombit Polak (shkurtesa polake: IPN). Institucioni mori përsipër të gjitha dokumentet që lidhen me shtypjet e periudhës 1939-1989, përfshirë këtu edhe skedarët e mëparshëm të paaksesueshëm të aparatit të sigurimit. Për momentin, koleksioni përfshin më shumë se 90,000 metra dhe dokumentet u vihen në dispozicion viktimave, studiuesve dhe gazetarëve (ato që lidhen me persona publikë, ndërsa dosjet e zyrtarëve komunistë janë në dispozicion për të gjithë).

Një detyrë tjetër e Institutit është të kryejë hetime në lidhje me krimet e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit, si dhe krimet e luftës dhe komunizmit. Midis mijëra hetimesh, shumë kanë të bëjnë me krimet në lidhje me dëbimet dhe punën e detyruar.

Ajo çfarë është me rëndësi është që hetimet kryhen edhe kur autorët nuk janë më gjallë. Kjo lejon klasifikimin ligjor të një krimi të caktuar, rikrijimin e rrethanave të tij dhe konstatimin e identitetit të viktimave. Kjo ka një rëndësi të madhe për rikthimin e një sensi drejtësie.

IPN-ja është gjithashtu e angazhuar në aktivitete kërkimore dhe edukative në shkallë të gjerë. Deri tani, ajo ka botuar më shumë se 2,000 libra dhe botime periodike, ka organizuar qindra konferenca dhe mijëra projekte edukative (vetëm ekzpozita mbi 500). Të thuash të vërtetën për të shkuarën ka rëndësi pasi kjo është një formë e drejtësisë simbolike. Është gjithashtu edhe një paralajmërim kundër kthimit në çdo formë të totalitarizmit ose diktaturës dhe u tregon të rinjve kuptimin e termave të tillë si liria, ose të drejtat e njeriut.

Në vitin 2007, Institutit të Përkujtimit Kombëtar iu dha detyra të kryente vlerësimin, i njohur ndryshe me termin lustracion, proces i cili ishte bërë nga një institucion tjetër më parë. Që nga viti 2011, ka funksionuar një program gjithëpërfshirës në funksion të kërkimit të vendeve të varrosjes së viktimave të terrorizmit komunist. Mbetjet e gjetura janë identifikuar me teste gjenetike. Deri tani janë gjetur eshtrat e më shumë se 1000 vetëve dhe janë identifikuar rreth 10% e tyre. Në vitin 2016, kompetencat e Institutit janë shtrirë për t'u kujdesur për varrezat e luftës, si dhe për të dhënë mendime për propozimet që lidhen me ngritjen e monumenteve të reja.



Instituti i Përkujtimit Kombëtar është institucioni më i madh, por jo i vetmi, që merret me rivendosjen e kujtesës për fatin e të internuarve dhe të burgosurve në kamp. Që nga viti 2015, ka funksionuar në Radzionków<sup>16</sup> Qendra për Dokumentacionin e Dëbimeve të Silesianëve të Epërm në BRSS-së në vitin 1945. Në Białystok, po ndërtohet Muzeu Memorial i Sybirit, i cili planifikohet të hapet në vitin 2020. Muzeu kryen veprimtari shkencore dhe arsimore edhe tani<sup>17</sup>. Historia e disa kampeve të punës së detyruar tregohet në muzetë lokale, ku një shembull është Muzeu Komunal në Jaworzno me një ekspozitë të përhershme me titullin: “Kampi i dy regjimeve totalitare. Jaworzno 1943-1956”. Shumë projekte arsimore kushtuar fatit të të shtypurve realizohen edhe në shkolla.

I detyrohemi drejtësi, të vërtetën dhe kujtesë viktimave të krimeve të komunizmit.

Drejtësia na detyron të bëjmë përpjekje për të ndëshkuar autorët. Përvoja polake tregon se edhe pse është e vështirë, kjo është akoma e mundur. Drejtësia përfshin gjithashtu edhe rehabilitimin e viktimave dhe kompensimin e dëmit të bërë, përfshirë pagesat e kompensimit. E vërteta kërkon akses të plotë në arkiva, pasi falë këtij aksesit është e mundur të sqarohet fati i individëve dhe i tërë kombeve. Është ende e nevojshme të kapërcehen pasojat e gënjeshtrove institucionale ndër dekada.

Mbi të gjitha, përkujtimi nënkupton edukimin dhe mbrojtjen e vendeve që lidhen me vuajtjet e viktimave - ne duhet të ruajmë të paktën disa prej tyre për brezat e ardhshëm. Kujtimi mbart edhe dimensionin simbolik, të shprehur, për shembull, në formën e monumenteve dhe emrave të shesheve/rrugëve.

Duhet të kujtojmë, të tregojmë të vërtetën dhe të luftojmë për drejtësi. Kjo është detyra jonë ndaj viktimave dhe të afërmëve të tyre dhe, në fund të fundit, edhe ndaj vetes.

---

<sup>16</sup> <https://deportacje45.pl/>

<sup>17</sup> <http://sybir.bialystok.pl/>

## **Tobias Wunschik - BSUT, Gjermani**

### **Puna e detyruar në Republikën Demokratike Gjermane 1950-1990**

#### **Kampet e punës në burgje gjatë periudhës staliniste të Republikës Demokratike Gjermane**

Pas përfundimit të diktaturës kombëtare socialiste me luftërat e saj të agresionit, skllavërimin e kombeve të tjera dhe shfarosjen masive të jetës njerëzore në kampet e përqendrimi, okupesit fitimtarë sovjetikë jo vetëm që pohuan autoritetin e tyre mbi Gjermaninë Lindore përmes krijimit të të ashtuquajturave kampe speciale. Qëllimi i tyre kryesor ishte burgosja e kundërshtarëve të mundshëm të sistemit, e cila u vlerësua edhe më e rëndësishme sesa ndëshkimi i socialistëve kombëtarë për krimet e tyre. Sidoqoftë, për pjesën më të madhe, dërgimi i qëllimshëm i të dënuarve në kampet e punës së detyruar në Bashkimin Sovjetik nuk ndodhi në të vërtetë. Për shkak të dietës së tyre të mjerueshme, shumica e të burgosurve bëheshin shpejt shumë të dobët për ta përballuar këtë.

Forcat okupuese sovjetike e ndihmuan aleancën e partisë komuniste dhe socialiste, e cila më vonë u bë e njohur si Partia e Unitetit Socialist të Gjermanisë (SED) për të ardhur në pushtet në Gjermaninë Lindore. Edhe qeveria e sapokrijuar e Republikës Demokratike Gjermane ("RDGJ") i detyroi sistematikisht të burgosurit të punojnë. Sidoqoftë, unë do të përmbahem nga përdorimi i termit punë e detyruar në kontekstin e sistemit penal të RDGJ-së, pasi termi përdoret zakonisht për të përshkruar punën e kryer nga civilë nga vendet e Evropës Lindore nën okupimin nacional socialist para vitit 1945, të rrëmbyer rastësisht nga rruga dhe të deportuar pa asnjë lloj vendimi gjyqësor. Kjo nuk e ndryshon aspak faktin që puna e kryer nga të burgosurit në RDGJ ishte punë e detyruar dhe ndonjëherë kryhej në kushte krejt të tmerrshme. Të burgosurit politikë u trajtuan veçanërisht keq. Për shkak të kohës së kufizuar, më poshtë nuk do të jem në gjendje të flas për kushtet e burgjeve.

Konferenca e Dytë e Partisë SED, në pushtet në korrik të vitit 1952, u përqëndrua te "përsheptimi i ndërtimit të socializmit", gjë që reflekton periudhën relativisht të shkurtër vërtet staliniste të GDR-së. Gjatë asaj kohe, u krijuan katërbëdhjetë kampe pune në burg për të mbajtur rreth 15,000 të burgosur<sup>1</sup>, që përbënin rreth 40 përqind të të gjithë të burgosurve në

---

<sup>1</sup> Të burgosurit do të ndaheshin në katërbëdhjetë kampe pune si më poshtë: 1,000 në Preschen, 1,000 në Rothenburg, 500 në Drewitz, 400 (gra) në Saßnitz 400, 1000 në St. Egedien, 300 në Zehdenick, 150 në Uckeründe, 300 në Collm/Böhlitz, 250 në Groß-Räschen, 1,500 në Fürstenberg, 950 në Volkstedt, 6,500 në Glowe, 300 në Bautzen, 200 në Coswig. Shënim. Raport tremujor i zyrës së shërbimeve korrektuese, datë 15 prill 1953; BA, DO 1/3737, [pa numër faqeje].

RDGJ në atë kohë, përjashtuar Berlinin Lindor. Ata punonin kryesisht për projekte të mëdha ushtarake dhe ekonomike infrastrukturore, si, për shembull, për ndërtimin e një porti të madh detar (në ishullin e Rügen-it) të modeluar mbi sistemin gulag.

Në kohën e Kryengritjes së Popullit më 17 qershor 1953, këto kampe tashmë ishin të mbushura në më shumë se një të tretën e tyre. Sidoqoftë, në bazë të direktivave mbrojtëse të qeverisë në lidhje me "drejtimin e ri", i cili ishte lëshuar vetëm disa ditë më parë (11 qershor) dhe që me siguri nxiti gjendjen shpirtërore që çoi në kryengritje, krijimi i këtyre kampeve "pushoi" menjëherë<sup>23</sup>. Projektet kryesore të përmendura më parë nuk ishin më të nevojshme, dhe niveli i ri i ulur i shtypjes së brendshme siguroi që numri i të burgosurve të binte me më shumë se një të tretën, për momentin<sup>4</sup>. Komiteti Qendror i SED-së vendosi që "ndryshe nga qasja e Bashkimit Sovjetik, sistemi penal i RDGJ-së duhet të zbatonte dhe riedukimin e të burgosurve afatgjatë në ambientet e përhershme korrektuese "pasi ndalimi i tyre në kampe pune masive në burgje nuk ishte më i mundshëm" duke marrë parasysh situatën aktuale të një Gjermanie të ndarë"<sup>5</sup>. Kampe të tilla, me sa duket, nuk konsideroheshin më të sigurta pas Kryengritjes së Popullit dhe duke parë afërsinë relativisht të afërt të kufirit me Perëndimin. Në epokën post-staliniste, ishte gjithashtu e vështirë të krijohesh pa u vënë re një Arkipelag Gulag në zemër të Evropës.

### **Puna e detyruar në RDGJ nga gjysma e dytë e viteve '50 e në vijim**

Përveç të burgosurve që merreshin me punë të detyruar në projektet kryesore të përmendura më herët, shumica e të dënuarve ishin internuar në ambiente klasike të përhershme korrektuese në atë kohë, si dhe në kampe të punës në burg (disa prej të cilave kishin ca kohë që ekzistonin). Disa valë të burgosurish që ishin marrë nga sovjetikët në vitin 1950 dhe ishin dënuar nga gjykatat ushtarake sovjetike u lanë të lirë në periudhën nga janari 1954 deri në verën e vitit 1955. Për shkak të rënies së numrit të përgjithshëm të të burgosurve, për herë të parë po përdorej sistemi i punës së detyruar. Nga fundi i vitit 1956, tre nga katër të burgosur ishin të angazhuar në punë të detyruar (78.7%)<sup>6</sup>.

Ata shpesh duhej të mbështeteshin në makineri dhe punë në fabrika që tashmë ishin përdorur nga shërbimi i burgut i Republikës së Weimarit. Megjithëse kushtet e përgjithshme të

<sup>2</sup> Letër e shkruar nga Karl Markon, shefi i Policisë së Gjermanisë Lindore (DVP), për Ministrin e Brendshëm Stoph më 15 shtator 1953; BA, DO 1/11/1484, faqe 310-318. Shih po ashtu Ingo.

<sup>3</sup> Pfeiffer, *Marinehafenprojekt am Volksaufstand gescheitert*, në: *Marineforum* Nr. 12/1992, f. 437-438.

<sup>4</sup> Cf. Falco Werkentin, *Politische Strafjustiz in der Ära Ulbricht*, Berlin 1995, f. 405.

<sup>5</sup> Cf. Memorandum i zyrës qendrore të shërbimeve korrigjuese, datë 9 gusht 1954; BA, DO 1/11/1589, f.172.

<sup>6</sup> Cf. Raport tremujor i departamentit të prodhimit të administratës së sistemit penal IV/56, datë 15 janar 1957; BA, DO 1 11/1472, f. 129-130.

burgut ishin përmirësuar dukshëm gjatë atyre viteve, marrja e pakove ushqimore ishte bërë më e vështirë në gusht të vitit 1955, pasi pritej që të burgosurit të fitonin ushqimin e tyre duke punuar më shumë që prej atij momenti dhe më tej.

Ideja ishte që puna e vështirë do t'i rehabilitonte të burgosurit. Kjo qasje konsiderohej gjithashtu e pranueshme nga publiku i gjerë në atë kohë. Fabrikat ishin madje edhe një ekspozitë e preferuar kur delegacionet perëndimore (për shembull nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar) lejoheshin të inspektonin burgjet e RDGJ-së në intervale të rastësishme në fund të viteve 1950. Për mua do të ishte shumë interesante të zbuloja nëse ka paralele këtu me vende të tjera si Shqipëria, apo nëse kjo ka ndodhur vetëm për shkak të pozicionit special të RDGJ-së në ndërfaqen midis sistemeve.

### **Puna e detyruar në vitet '70 dhe '80.**

Njëzet mijë të burgosur u angazhuan në punë të detyruar në të gjithë RDGJ-në në vitin 1960. Deri në vitin 1975, kjo shifër u dyfishua. Kampet e punës në burg u riemëruan në "ambiente korrektuese", megjithëse asgjë nuk ndryshoi në natyrën e institucioneve përkatëse. Me sa duket, emri me tingull paksa më burokratik mendohej ta rrëzonte pak më pak diktaturën.

Mesatarisht një në dy të burgosur punonte në fabrikat brenda burgjeve, gjysma tjetër zakonisht merrej në "kombinatet mëmë" aty pranë, jashtë mureve të burgut. Rreth 250 kombinate dhe institucione në RDGJ bashkëpunonin me shërbimin e burgut në këtë mënyrë dhe siguronin disa mallra të prodhuara ose pjesërisht ose plotësisht nga të burgosurit. Disa shembuj që ia vlen të përmenden këtu janë shtypja e revistës së FDJ-së e lëvizjes rinore të SED-it "Frösi" (nga 40 të burgosur), ose zgjerimi i Aeroportit Schönefeld.

Shumica e asaj që këta të burgosur u detyruan të prodhojnë mbeti në RDGJ, ose u eksportua në vendet pas Perdes së Hekurt. Sidoqoftë, RDGJ-ja ruajti gjithnjë e më shumë marrëdhënie tregtare me Republikën Federale të Gjermanisë Perëndimore (FRG); RFGJ-ja e inkurajoi këtë për të parandaluar që vendi i ndarë tashmë të copëtohej edhe më tej.

Për këtë arsye, tregëtia brenda Gjermanisë përfshinte edhe një numër në rritje të produkteve të prodhuara nga të burgosurit, si, për shembull, geta për gratë që shiteshin me emrat e markave "Sayonara", "Amoretto" dhe "Petit Chat" nga zinxhirët e shitjes me pakicë në Gjermaninë Perëndimore *Aldi*, *Hertie* dhe *Woolworth*. Këto marka ishin prodhuar me kosto të ulët në RDGJ dhe më pas shiteshin për shumë më tepër në Perëndim. Rreth 150 të burgosura gra të angazhuara në punë të detyruar, përfshirë shumë të burgosur politikë nga burgu i

famshëm i grave Hoheneck, prodhonin rreth 9 milion palë çdo vit për kombinatin Esda Thalheim. Në fund, vëllimi vjetor i tregtisë së të gjitha produkteve të prodhuara përmes punës së detyruar arriti në të paktën 200 milion marka në Gjermaninë Perëndimore.

Po ashtu, në RDGJ prodhoheshin edhe mobilje, të cilat më pas eksportoreshin në Perëndim. Ato bëheshin me porosi të Ikea-s, ashtu edhe për konkurrentin e saj Richard Karl Lämmerzahl, një distributori i madh që furnizonte Quelle, Neckermann, Möbel-Hess dhe shumë zinxhirë të tjerë të njohur të dyqaneve të Gjermanisë Perëndimore. Në këmbim të çmimeve shumë të lira me shumicë, nga ana tjetër, ai financonte Partinë Komuniste Gjermane (DKP, aleat i SED-së) duke bërë porosi në një shtypshkronjë afër partisë për punë shtypshkrimesh, për të cilat më pas paguhej një çmim shumë më i lartë se zakonisht. Kjo karakteristikë e mundimshme ishte e domosdoshme sepse zyrtarisht, SED-ja nuk lejohej të zotëronte asnjë pasuri në Gjermaninë Perëndimore.

Revolucionari i kolltukëve Lämmerzahl e kishte zakon të priste drejtorët e kombineve të Gjermanisë Lindore që ndërtonin pishina në pishinën e shtëpisë së tij. Kështu, ai madje arriti të siguronte një kontratë që i jepte atij të drejta ekskluzive për shpërndarjen e mobiljeve të bëra në RDGJ në RFGJ pak para se Ikea të hynte në tregun e Gjermanisë Perëndimore. Sidoqoftë, fabrikat e RDGJ-së preferuan të furnizonin Ikea-n sepse kjo ishte mënyra e vetme që ata të mund të plotësonin kuotat e eksportit të dekretuara nga qeveria e tyre. Ikea e injoroi me sportivitet monopolin e Lämmerzahl-it, duke arsyetuar se kompania vështirë se shiste mobilje *Biedermeier* prej druri dhe se në fakt shiste thjesht mobilje bashkëkohore prej pishë. Kjo çoi në një luftë të ashpër tregtare midis dy rivalëve Kamprad dhe Lämmerzahl gjatë viteve të mëvonshme. Në fund, Ikea fitoi falë strategjisë së saj ekspansioniste në treg. Shumica e pjesës kryesore të mobiljeve mbase prodhohej nga të burgosurit, megjithëse ndonjëherë prodhoheshin edhe divanë të tëra.

Megjithatë, të burgosurit prodhonin edhe televizorë, motorë dhe filma me ngjyra (për Neckermann-in), soba (për Quelle-in) si dhe qirinj (për farmacitë Schlecker), së bashku me punëtorët "e lirë", si dhe makina shkrimi, tela prej bakri, motorë elektrikë, autokombajna, pjesë prej gize, këpucë, fibra qelqi, dhe fenerë makinash - të gjitha të destinuara për eksport në Perëndim.

### **Roli i Ministrisë së Sigurimit të Shtetit ("Stasi").**

Sidomos Stasi ndërmori çdo përpjekje për të mbajtur të fshehtë faktin se të burgosurit (politikë) punonin për ndërmarrjet perëndimore, duke kaluar në procedura vlerësimi mbikëqyrësit dhe punëtorët dhe duke qendruar gjithmonë në gjueti për mesazhe sekrete. Sidoqoftë, për shkak se kontrollet ishin të rastësishme, blerësit në Perëndim ndonjëherë i zbulonin mesazhe të tilla nga të burgosurit në RDGJ, për shembull, të futura në getat që prodhoheshin prej tyre, për t'i njoftuan kompanitë e Gjermanisë Perëndimore të furnizuara me këto mallra.

Kompanitë e Gjermanisë Perëndimore u përballën gjithashtu me faktin se mallrat që ata shisnin ishin prodhuar përmes punës së detyruar të të burgosurve kur ish të burgosur që ishin liruar nga qeveria e Gjermanisë Perëndimore u kishin thenë se kishin parë produkte në raftet e dyqaneve, të cilat ishin të ngjashme me mallrat që ata ishin të detyruar t'i prodhonin në burg në RDGJ. Jo vetëm kaq, por fakti që kjo u bë publikisht e ditur para vitit 1989 erdhi gjithashtu për shkak të organizatave të të drejtave të njeriut, të tilla si *Amnesty International*.

## **Përfundime**

Përdorimi i të burgosurve për punë të detyruar ishte vetëm një shtesë në repertorin e RDGJ-së për shtypjen politike të ushtruar kundër kundërshtarëve të regjimit dhe një mjet për disiplinimin e të gjithë të burgosurve. RDGJ-ja i detyronte të burgosurit të punonin thjesht për arsye ekonomike; vetëm aspektet e politikës (së jashtme) ishin edhe më të rëndësishme se paratë e kursyera në këtë mënyrë. Herë pas here, u lejuan amnistitë, kjo edhe për të qetësuar vizitorët e shtetit nga vendet perëndimore, përkundër faktit që këto amnisti kishin efekt shkatërrues mbi ekonominë e RDGJ-së. Një paradoks i veçantë ishte se shteti i SED-së i detyroi gjithashtu të burgosurit e tij politikë të punonin dhe se çuditërisht, ai gjithashtu i shiti mallrat e prodhuara prej tyre tek "armiku i klasës", te Gjermania Perëndimore.

Sigurisht, historia nuk njeh drejtësi poetike, megjithëse ndonjëherë mund të na bekojë me një *esprit de l'escalier*. Situata pas amnistisë së vitit 1987, kur edhe burgu i të rinjve Halle nuk mund të furnizonte punëtorë të mjaftueshëm, mund të konsiderohet se ka qenë pikërisht një dëshmi e tillë. Jo vetëm ushtarët, por edhe dhjetë oficerë me kohë të plotë të Stasi-t u përdorën për të mbushur hendekun. Në periudhën nga nëntori 1987 deri në mars 1988, kutitë e veglave të punës prodhoheshin tani prej tyre, jo më nga të burgosurit e rinj. Në thelb, ata përmbushën edhe një nga kërkesat e Revolucionit Paqësor të vitit 1989, megjithëse në mënyrë të pavullnetshme: "Stasi në fabrika!"

## Lory Amy – Universiteti i Gjeorgjisë së Jugut

### Problemi i Hoxhës: Trashëgimia komuniste dhe kërkesat e të vdekurit

Nëse trashëgimia përfaqëson një relike të së shkuarës, përkujtimi përfshin përgjigjen ndaj kërkesave të të vdekurve.

Joost Fontein, *The Politics of the Dead: Living Heritage, Bones and Commemoration in Zimbabwe*

Dua të mendoj për sistemin e dëbimit të periudhës 1949-1955 përmes lenteve të trashëgimisë dhe përkujtimit si përgjigje ndaj kërkesave të të vdekurve. Pse trashëgimi, dhe pse përgjigje ndaj kërkesave të të vdekurve?

Ta filloj, së pari, nga trashëgimia: Këshilli Ndërkombëtar i Monumenteve dhe Siteve (ICOMOS) e përkufizon trashëgiminë kulturore si "shprehje të mënyrave të të jetuarit të zhvilluar nga një komunitet dhe të përcjellë brez pas brezi, duke përfshirë doket, praktikat, vendet, objektet, shprehjet dhe vlerat artistike" (ICOMOS, 2002). Kur e konsiderojmë trashëgiminë kulturore si "mënyrë të të jetuarit të zhvilluar nga një komunitet dhe të trashëguar nga brezi në brez", atëherë shohim që një gjysmë shekulli terrori shtetëror në Shqipëri krijoi në të vërtetë një kulturë – kulturën e spiunimit, burgosjes, torturës, ekzekutimit, punës së detyruar, i udhëhequr nga fantazitë paranojake egomaniake të Enver Hoxhës, të forcuara edhe nga rrethi i tij i brendshëm.

Dua t'ia nis nga këtu: traumat specifike që përjetuan njerëzit nën komunizëm ishin secila pjesë e një cohe kulturore më të madhe, çdo thurrje e së cilës ishte e punuar me terror shtetëror. Njerëz të dërguar te Gulagët, familjet që jetonin nën shtypjen e biografisë së keqe, ata të shpronësuar, torturuar dhe ekzekutuar – të gjithë janë viktimat e dukshme të terrorit shtetëror. Por, këto dhuna specifike mund të ndodhin vetëm në sajë të shtypjes brutale, të mosmarrëveshjeve dhe vrasjes së dhunshme të të gjithë opozitës së mundshme të kryer nga arkitektët e terrorit shtetëror dhe agjentët e shtetit. ***Nga ana e saj, kjo shtypje brutale e terrorizoi pjesën tjetër të popullatës duke u bërë ose mbështetës bashkëpunues me regjimin, ose në të bindur pasivë me shpresën për të mbrojtur veten.***

Për dy gjeneratat e lindura në këtë strukturë të terrorit shtetëror, atëherë, dhe për gjeneratën e lindur në tranzicion, *kjo* është trashëgimia kulturore me të cilën duhet të përballemi: "mënyrat e të jetuarit të zhvilluara nga komuniteti", të terrorizuar për t'ju bindur urdhrave arbitrare të një shteti kriminal, përfshijnë:

frikë kronike, të vazhdueshme;

fshehtësinë, mosbesimin - fshehtësi dhe mosbesim, natyrisht, sepse spiunimi dhe gënjeshtria janë *modus operandi* të shtetit, ashtu si edhe gama e larmishme e mohimeve (nga gënjeshttrat e dukshme, si në rastet kur shteti mohon krimet e tij, e deri te zakonet e përditshme që zhvillojnë njerëzit për t'i mbijetuar dhunës së shtetit, deri tek gjërat e vogla: mungesa e dëshirës për të ditur se çfarë ndodhte me të vërtetë në gulagë, shmangia e fqinjëve me biografi të keqe dhe vetëdija e dyfishtë që u tregon njerëzve në fuqi atë që duan të shohin ndërsa mohojnë të vërtetën e përvojës së tyre.

Për të kuptuar plotësisht pse Shqipëria nuk ka arritur ende të përballet me krimet e diktaturës së proletariatit, ne duhet ta kuptojmë këtë ***trashëgimi të dhunës shtetërore si trashëgimi kulturore të komunizmit***. Vetëm kur ta kuptojmë këtë gjë, mund të shohim se çdo përpjekje për të dokumentuar krimet e komunizmit hyn në këtë suazë: pothuajse çdo person që sot mund ta emërtojë si "kriminel", sipas Kushtetutës socialiste dhe Kodit Penal të vitit 1952, thjesht po zbatonte ligjet e vendit dhe urdhërat e eprorëve të tij. Gjyqtari që nënshkroi një urdhër ekzekutimi, hetuesi që kreu tortura, skuadrat e ekzekutimit, të gjithë këta realisht po bënin thjesht punën e tyre.

Njëzet e shtatë vjet pas përfundimit zyrtarisht të komunizmit, natyra kriminale e diktaturës komuniste ende nuk është njohur zyrtarisht nga asnjë qeveri, **dhe është pikërisht ky dështim për të pranuar dhe marrë përgjegjësinë për krimin shtetëror atëherë arsyeja pse krimi shtetëror lejohet të vazhdojë, tani, i pakontrolluar. KJO, pra, është arsyeja pse duhet t'i drejtohem trashëgimisë në mënyrë që të merremi me krimet e komunizmit:** sepse ne tani kemi katër breza shqiptarësh të lindur në një kulturë të formësuar nga terrori shtetëror, dhe "mënyrat e të jetuarit" të zhvilluara nga një popull që ka jetuar në këtë kulturë janë trashëguar dhe vijojnë të trashëgohen nga njëri brez tek tjetri. Për të përballuar të shkuarën që vazhdon të ndjekë vendin dhe për t'u njohur me krimet gjithëpërfshirëse të diktaturës së proletariatit, duhet të përballemi, më në fund, me arkitekturën e terrorit shtetëror, dhe arkitektin kryesor të tij, Enver Hoxhën.

Kjo na çon në pyetjen: pse na duhet një përgjigje ndaj kërkesave të të vdekurve?

Kur postova njoftimin për këtë konferencë në faqen time të FB-së, mora mesazhin më poshtë:

*"Nëna ime është 93 vjeç, jeton në Tiranë, ka memorie të mprehtë, është përndjekur gjatë gjithë jetës, babain ia kanë ekzekutuar dhe ajo ende nuk e di se ku janë [eshtrat e tij]. Pas ekzekutimit të tij gjyshja ime mbeti vetëm, pa një strehë nën kokë, me asnjë,*



*5 fëmijë të vetëm, më i vogli 2 vjeç. Unë ende nuk kam përgjigje se pse dhe si mund të jenë të tillë njerëzit”<sup>1</sup>.*

Një shtet kriminal çorodit strukturën e marrëdhënies shoqërore - kjo është arsyeja pse njerëzit mund të ishin të tillë. Por, **ne mund të jemi ndryshe**. Është pikërisht themeli i marrëdhënieve tona njerëzore që, mbi dhe përtej çdo gjëje, diktatura e proletariatit u përdhos, dhe studimi ynë për të kaluarën komuniste duhet të jetë në shërbim të ripozicionimit të vetvetes si genie njerëzore në një lidhje etike me njëri-tjetrin.

Sepse ne ende nuk e kemi bërë këtë punë, *modelet e mohimit* - një aspekt themelor i strukturës së terrorit shtetëror - mbesin, jo vetëm *një trashëgimi* e regjimit komunist, por *një tipar i vazhdueshëm i shtetit sot*<sup>2</sup>. Kjo është shumë, shumë e rrezikshme. Gjysma e vendit është nën 30 vjeç dhe shumë njerëz mendojnë - gabimisht - se kjo gjeneratë e re nuk interesohet për të kaluarën komuniste dhe se, në të vërtetë, komunizmi nuk ka asnjë lidhje me ta. Në të vërtetë, shumë nga ata që kanë pushtet politik duket se presin që të vdesë i mbijetuari i fundit i sistemit gulag, dhe më pas mendojnë se do të shpëtojnë nga "problemi" i komunizmit.

E kanë gabim.

Në fakt, komunizmi përcakton brezin e tranzicionit. Historitë e paartikuluara — sipas formulimit të Paul Connerton-it, historitë e krijuara, ose, sipas formulimit të Pierre Bourdieu, habitati i jetës së jetuar nga prindërit e tyre nën komunizëm u janë përcjellë atyre<sup>3</sup>. Në të njëjtën kohë, ishujt e tyre të vegjël të kujtimeve familjare nuk kanë një spirancë në një narrativë të integruar historiko-kulturore. Në të dyja nivelet, si në atë individual dhe në atë kolektiv, heshtja, shtypja, shtrembërimi dhe fragmenti i mohimit dhe polarizimi, e shkëpusin fillin lidhës midis së shkuarës dhe së tashmes<sup>4</sup>.

Të vdekurit kërkojnë llogaridhënie historike.

Për të vdekurit për t'u prehur në paqe, për të gjallët për të bërë paqe me të shkuarën, për të rinjët për të mbyllur plagët që u janë transmetuar, brez pas brezi, për thuajse një

---

<sup>1</sup> M.B. Mesazh në FB, datë 25 tetor.

<sup>2</sup> Për një diskutim të hollësishëm të këtij mohimi, siç është ndërtuar në strukturën e shtetit, shihni vepërën e Lori Amy-it "Re-Membering in Transition: The Trans-National Stakes of Violence and Denial in Post-Communist Albania." In *History of Communism in Europe, Vol. I, Politics of Memory in Post-Communist Europe*, 205 - 222. Bucharest: Zeta Books, 2010.

<sup>3</sup> Për një diskutim të hollësishëm të kujtesës së krijuar, shihni vepërën e Paul Connerton-it *How Societies Remember London*: Cambridge University Press, 1989; për një diskutim të hollësishëm të habitusit, shihni vepërën *The Language of Symbolic Power*. Cambridge: Harvard University Press, 1999.

<sup>4</sup> Shihni Hirsch, Marianne. *The Generation of Post Memory: Writing and Visual Culture after the Holocaust*. New York: Columbia University Press, 2012.

shekull, tani, më në fund, se duhet të merremi me strukturën e dhunës shtetërore dhe natyrën e shtetit kriminal.

Jennifer Balint, në librin *Genocide, State Crime, and the Law: In the Name of the State* (*Gjenocidi, krimi shtetëror dhe e drejta: në emrin e shtetit*) e përcakton krimin shtetëror si politikë shtetërore që përdor institucionet e shtetit për të kryer dëmtime në masë kundër popullsisë së tij. “Kjo përfshin policinë, ushtrinë dhe sistemin ligjor”(5) dhe kuadrin shtetëror për kryerjen e krimeve shtetërore”(6).

Hoxha i vendosi strukturat e terrorit shtetëror menjëherë pas luftës së dytë botërore. Brenda një kohe shumë të shkurtër, arkitektura e terrorit shtetëror u krijua në mënyrë të pakontestueshme, dhe pjesa tjetër e strukturës shoqërore - lidhjet familjare, miqësitë dhe komunitetit, u përdhosën.

Një vështrim i përciptë i Kushtetutës të Socializmit dhe ndryshimeve të Kodit Penal tregon se si arkitektura e Hoxhës e përsosi strukturën e saj kriminale. Dokumente të tjera në këtë vëllim do të hyjnë në më shumë detaje në lidhje me këtë. Jemi me fat që në këtë vëllim kemi të përfaqësuar edhe studiues juridikë, kështu që unë do të jap vetëm disa detaje për qëllime inkuadrimi:

Më 22 maj 1952, Ministri i Drejtësisë, Bilbil Klosi, prezantoi kodin e ri penal, bazuar në parimet e “luftës së klasave” dhe “drejtësisë revolucionare”;

neni 6 i Kodit lejonte burgosjen e fëmijëve që prej moshës 12 vjeç për “dëmtim të pronës shtetërore dhe sabotim ekonomik”;

neni 16 përcaktonte këto dënime për këto krime: "vdekje, burgim dhe internim në “kampet korrigjuese të punës”<sup>5</sup>.

Dhe lista vazhdon dhe vazhdon.

Sipas nenit 90, njerëzit mund të dënoheshin me internim ose në kampe pune në burg deri në pesë vjet për "prodhim të mallrave industrialë me cilësi të dobët, jo në sasi të mjaftueshme, ose në shkelje të standardit të caktuar".

Sipas nenit 201, njerëzit që largoheshin herët nga puna, ose që përpiqeshin të hiqnin dorë mund të dënoheshin me punë korrigjuese, ose me burg.

Sipas nenit 203, njerëzit që nuk pranonin të shkonin atje ku i dërgonte shteti për punë mund të dënoheshin me burg ose punë korrigjuese.

---

<sup>5</sup> Të dhëna të marra nga Raporti i Kombeve të Bashkuara ose Komiteti Ad Hoc për Punën e Detyruar, Shtojca Nr. 13 në Regjistrat Zyrtarë të Sesionit të Gjashtëmbëdhjetë të Këshillit Ekonomik dhe Social dhe Nr. 36 në Studime dhe Raporte (Seritë e reja) të Punës Ndërkombëtare Zyra, Gjenevë, 1953.

Sipas nenit 204, njerëzit që refuzonin të kryenin "punë vullnetare" në prodhimin shtetëror dhe në kantieret e ndërtimit mund të dënoheshin deri në dy vjet punë korrigjuese.

Ky ishte Kodi Penal i vitit 1952. Por, si arriti vendi që të ratifikojë Kushtetutën socialiste dhe të parashikojë dënime me burg për fëmijë dymbëdhjetë vjeç për sabotim ekonomik? Kjo trajektore u përcaktua me shfaqjen "Gjyqi i tradhëtisë", në vitin 1945 – e cila u vu në skenë në Teatrin Kombëtar. Dhe këtu kemi mbërritur në zemër të trashëgimisë si "trashëgimi e së shkuarës" dhe të përkujtimit si "përgjigje ndaj kërkesat e të vdekurve"<sup>6</sup>. Si trashëgimi e së shkuarës, *Gjyqi i Tradhëtisë* i vënë në skenë në Teatrin Kombëtar, është, sipas fjalëve të Robert Elsie, "një nga ngjarjet më spektakolare në periudhën e hershme të komunizmit në Shqipëri, dhe shënoi fillimin e një regjimi të paparë të terrorit që zgjati me vite. Njerëz të panumërt e gjetën veten në burg dhe internim ose para skuadrës së pushkatimit".

Gjyqi i tradhëtisë i vitit 1945, i vënë në skenë në Teatrin Kombëtar, ishte ngjarja inauguruese që nxiti shtetin kriminal të zhvilluar nga Enver Hoxha. Ndërsa përuroi shtetin kriminal, vetë gjyqi ishte një vazhdim i spastrimeve që partizanët kishin kryer gjatë Luftës së Dytë Botërore. Siç kanë vërejtur shumë studiues, fuqitë aleate financuan grupet kryesore politike brenda Shqipërisë së okupuar për të kryer operacione sabotimi kundër forcave ushtarake italiane dhe, më vonë, gjermane<sup>7</sup>. Literatura e kohës është e mbushur me vajtime kundër përpjekjeve për kryengritje të shqiptarëve, të cilat ishin shumë joefektive, në masë të madhe sepse grupet politike përdorën para dhe armë për të luftuar njëri-tjetrin. Për Shqipërinë, Lufta e Dytë Botërore kishte më pak lidhje me boshtin e luftës - aleatin sesa ishte një luftë e brendshme për kontrollin politik të vendit - aq sa disa studiues i referohen Luftës së Dytë Botërore si lufta civile e Shqipërisë (Elsie 2015; Fevziu 2017, Lucas 2015).

Partizanët ishin veçanërisht efektivë për të fshirë kundërshtarët e tyre, në veçanti Ballin Kombëtar, rezistencën kombëtare antikomuniste dhe Legalitetin, mbështetësit e mbretërisë besnikë ndaj Mbretit Shqiptar, Zogut, i cili u largua nga Shqipëria menjëherë pas okupimit italian. Në kohën kur përfundoi Lufta e Dytë Botërore, partizanët kishin pastruar një pjesë të madhe të kundërshtarëve të tyre politikë. Kur marshuan në Tiranë më 28 nëntor 1944, qëllimi kryesor i tyre ishte të përfundonin punën e nisur për të pastruar të gjithë opozitën politike dhe të konsolidonin pushtetin (Elsie 2015; Fevziu 2017, Lucas 2015).

---

<sup>6</sup> (Fontein [https://www.theasa.org/publications/asaonline/articles/asaonline\\_0102.shtml](https://www.theasa.org/publications/asaonline/articles/asaonline_0102.shtml)).

<sup>7</sup> Elsie, Robert. *Albania in a Nutshell: A Brief History and Chronology of Events, Albanian Studies Volume VII*, Amazon Digital Services, 2015; Fevziu, Blendi, *Enver Hoxha: Grushti i hekurt i Shqipërisë*, Londër: I.B. Tauris & Co. Ltd., 2017; Lucas, Peter. *The OSS in World War II: Albania Covert Operations and Collaboration with Communist Partisans*, Jefferson: McFarland, 2015.

Me Mbretin Zog në mërgim, gjyqi për tradhti i 1945-ës ishte i barabartë me një gjykatë ushtarake përmes së cilës partizanët pastruan me dhunë çdo kundërshtar të mundshëm të mbetur dhe përfunduan luftën civile që kishin nisur. Kujtimet e atyre që jetuan nëpër spastrime flasin për partizanët që zbrisnin nga malet, që i nxirrnin familjet nga shtëpitë e tyre dhe i merrnin ato për vete. Lazër Radi, një nga të akuzuarit dhe një nga të dënuarit nga Gjyqi i Tradhtisë, e përshkroi situatën në Tiranë në vjeshtën e vitit 1944 në kujtimet e tij si më poshtë: *“E kam kaluar periudhën nga 18 deri më 23 nëntor ulur në dritaren time, duke vëzhguar aktivitetet e partizanëve që po arrestonin njerëz në ndërtesat e ndryshme në komplekset e apartamenteve përgjatë Lanës. Të gjithë e dinin që ndërtesat ishin të banuara kryesisht nga figura publike dhe zyrtarë qeveritarë. ... Njëri pas tjetrit, banorët e këtyre ndërtesave u arrestuan nga partizanët ... duke i lënë familjet në rrugë, në mënyrë që partizanët të merrnin në dorë apartamentet luksoze”* (Elsie 8 - 9).

Skena e krimit të komunizmit fillon në Teatrin Kombëtar, me *Gjyqin e Tradhtëtisë* të vitit 1945 dhe "mbretërimin e terrorit" të përruar prej tij. 17 nga 60 personat e gjykuar u dënuan me vdekje si kriminelë lufte dhe armiq të popullit: "ekzekutimet u kryen menjëherë, më 14 prill 1945, në një kanal në afërsi të Kodrës së Priftit në Tiranë" (Elsie 15). Më pas, shfaqet e gjyqeve komuniste u bënë tipar standard i jetës nën diktaturë dhe ishin mjet parësor për shpronësimin e pronës: "Të gjitha dënime me vdekje, ose me pesë ose më shumë vjet burgim, mbartën me vete konfiskimin e tërë pasurisë së të akuzuarit. Në këtë mënyrë, u krijua një numër i madh vejuhash, grash dhe fëmijësh të dëbuar nga shtëpitë e tyre, duke u hedhur pa asnjë qindarkë në rrugë" (Elsie, 27). Në të vërtetë, sistemi gulag u zhvillua bashkë me shpronësimin e shtetit dhe spastrimet politike; familjet e shpronësuara dhe gratë dhe fëmijët e të burgosurve dhe të ekzekutuarve u dërguan në kampe internimi, ndërsa mijëra të tjerë u dërguan për punë të vështirë në kampe burgu.

Shpronësim 100%, në të njëjtën kohë me formimin e sistemit gulag dhe një vend të tërë të ndërtuar nga skllavëria e të burgosurve dhe puna e detyruar (e quajtur "vullnetare") - kjo është trashëgimia nga komunizmi, dhe ne akoma po i jetojmë këto dhunime edhe sot e kësaj dite. Për shembull: afërsisht 20% e popullsisë në Shqipëri ishte objekt i masave ekstreme shtypëse nën regjim, dhe 80% e atyre që janë ekzekutuar nga regjimi nuk janë arritur të gjenden për t'u varrosur, dhe as nuk ka të ngjarë të gjenden (Krasniqi, 2012). Mijëra qytetarë të zakonshëm janë ende në kërkim të të dashurve që u ekzekutuan dhe që u varrosën në fshehtësi. Varri masiv i gjendur pas Malit të Dajtit jep një shembull të tillë: tre burra të zakonshëm me lopata kopshtesh dhe me informacionin që kishin se ku mund të ishte

varrosur një anëtar i familjes së tyre filluan të gërmojnë ... dhe zbuluan kufomat e 19 personave të ekzekutuar dhe të varrosur në fshehtësi, një taktikë e shtetit kjo për të parandaluar familjarët që të gjenin kufomat e personave të vrarë prej tij<sup>8</sup>.

Kthimi i pronave është plotësisht i dështuar, duke e lënë pronën të lidhur në gjykatë pa një fund të parashikueshëm. Krimet ndaj pronave janë normë, ku krimet e shpronësimit komunist përsëriten sot në një rreth vizioz të biznesmenëve të fuqishëm dhe zyrtarëve të korruptuar të qeverisë që kërcënojnë, kërkojnë ryshfete dhe urdhërojnë ndryshime të paligjshme mbi titujt e pronësisë - një biznes i madh në një vend ku, pas pesëdhjetë vitesh diktature komuniste, familjet e shpronësuara janë ende duke luftuar për të marrë pronat, dhe biznesmenët mafiozë dhe zyrtarët e korruptuar të qeverisë po luftojnë edhe më shumë për të marrë tokën e kontestuar dhe për të ndërtuar ndërtesa të larta. Juristë, gjyqtarë, biznesmenë të fuqishëm, administratorë në Zyrën e Pronave - të gjitha këto janë instanca të zakonshme të institucioneve shtetërore dhe zyrtarëve që realizojnë strukturën kriminale të shpronësimit nga shteti, kësaj radhe për të vjedhur prona për zhvillim të paligjshëm.

Krimet me pronat në Hipotekë, zhvillimi i paligjshëm, dështimet për kthimin e pronave kanë ndihmuar për ta bërë gjyqësorin shqiptar institucionin që ka fjalën e fundit lidhur me mosmarrëveshjet e pronave – një ndër më të korruptuarit në rajon - dhe e gjithë kjo u vu në lëvizje me gjyqin e vitit 1945 dhe udhëheqjen e përgjakshme të terrorit që konsolidoi fuqinë e Enver Hoxhës.

Po në lidhje me gulagët? Kur fillojmë të hulumtojmë nivelin e vdekjeve në sistemin e gulagut, të krijuar në të njëjtën kohë me Gjyqin e Tradhtisë, bëhet e qartë se shifrat zyrtare nënperfaqësojnë në mënyrë të konsiderueshme numrin e njerëzve të vrarë nga dhuna e shtetit. Për shembull, të dhënat e marra nga raporti i Këshillit të Sigurimit të OKB i vitit 1955 mbi punën e detyruar në Shqipëri përshkruajnë këtë situatë: "*Në Kampin e Vdekjes në fshatin Vloçisht ... disa nga të burgosurit që ishin shumë të sëmurë dhe nuk punonin dot u varrosën të gjallë në kanal*" (11 - 13).

Znj. Gjyshte Ndoci ishte shtatzënë kur u arrestua pasi burri i saj ishte larguar nga ushtria. Ajo dhe 3 fëmijët e saj - Zefi, 9 vjeç, Deda, 6 vjeç dhe Lulja, 5 vjeç, u dërguan në kampin e përqendrimit në Tepelenë. 3 muaj më vonë, ajo lindi një djalë që vdiq 3 ditë pasi lindi. Të burgosurit detyroheshin të marshonin nga Tepelena në një kamp tjetër në Gjirokastrë. "*Gjatë rrugës, djali i saj Deda vdiq dhe ajo vetë u desh ta gërmonte varrin dhe ta varroste të*

<sup>8</sup> <http://www.balkaninsight.com/en/article/investigation-son-s-search-for-father-uncovers-albanian-mass-grave>.

*birin buzë rrugës, ndërsa policia që e shoqëronte e fyente. Katër ditë pasi mbërriti në kampin e ri, vdiq edhe djali i saj i madh, Zefi, po ashtu për shkak të kequshqyerjes dhe sëmundjes”(17).*

Mustafa Hoxha, një imam që u larguar nga Shqipëria, i përshkruante kushtet si kaq të këqija saqë të burgosurit detyroheshin të hanin “bar dhe kafshë të ngordhura”. Kjo çoi në përhapjen e një epidemie ... me shtatë ose tetë vdekje çdo ditë, kryesisht fëmijë. Kur kampi u zhvendos në Tepelenë, situata u përkeqësua edhe më shumë”(16). Më tej Hoxha raporton se zyrtarët e kampit vendosën të zhvendosnin varrezat. ... Të burgosurit, burra dhe gra, u detyruan të gërmonin varret e personave të varrosën kohët e fundit dhe t'i rivarrosin ata në vendin e ri. Ky operacion shkaktoi një epidemi të re, dhe niveli i vdekjeve në kamp u rrit”(16). Në njëzet muajt e internimit, Hoxha raporton për 1,200 vdekje në kampet ku kishte qenë i burgosur.

1,200 vdekje në njëzet muajt? Fëmijë të lindur dhe të vdekur brenda ditësh, të sëmurë të varrosur të gjallë në lumenjtë që po pastronin, nëna që gërmonin varre për fëmijë në marshime të detyruara nga kampi në kamp!? Këto të dhëna sfidojnë shifrat shumë më të ulëta zyrtare, duke na detyruar të pyesim: si llogariten shifrat zyrtare të vdekjeve në burg? Me çfarë regjistrash dhe të dhënash dhe me cilën metodë? Mospërputhje të tilla si këto kërkojnë që ne të gjejmë gjilpërën në kashtë. Për të kuptuar me të vërtetë se çfarë ka ndodhur, ne duhet të krahasojmë materialin arkivor, me dëshmitë gojore, artikujt e gazetave, dëshmitë nga të mbijetuarit e kampeve - duhet t'i mbledhim të gjitha këto dokumente, t'i krahasojmë dhe të kërkojmë për mangësi, mospërputhje, të ngremë pyetje. Të kërkuarit e gjilpërës në kashtë mund të na ndihmojë edhe për të analizuar rrjedhjen e gjërave - hendeqet dhe kontradiktat në regjistra janë vetë dëshmi e copëzimit, shtrembërimit, gënjeshtërisë dhe mohimit, të cilat në vetvete janë *mekanizma* të terrorit shtetëror.

Këto të dhëna na tregojnë gjithashtu se: çdo centimetër i tokës shqiptare dëshmon për një dhunë që nuk është vajtuar ende. Dhe *kjo* është përgjigjja thelbësore ndaj kërkesave të të vdekurve:

- u kemi borxh atyre, dhe vetvetes, të vajtojmë për mohimin, shtypjen, shtrembërimin - shpesh përmes gënjeshtreve dhe manipulimeve. Nëse nuk arrijmë të vëmë drejtësinë në vend për ata që janë prekur pa të drejtë, të kuptojmë plotësisht natyrën e asaj që ndodhi - *nëse nuk vajtojmë* për vuajtjet kolektive të kombit, ne hyjmë në një periudhë që Joseph Etkind e quan periudha e pas katastrofës. Në botën pas katastrofës "e shkuara ndjek qytetarinë, ndan shoqërinë dhe kufizon zgjedhjen politike" (Etkind 2013, 42).

Në të vërtetë, pas katastrofa në Shqipëri është aq e rëndë, sa shumë refuzojnë të pranojnë se, në fakt, diktatura e proletariatit ISHTE katastrofike. Ky refuzim merr shumë forma: nostalgji enveriste, falje për regjimin (shiko se çfarë gjërash të mira janë bërë), larje e krimeve të komunizmit nga shteti, aktorë të pushtetit komunist në detyrë sot, libra historie që nuk janë shkruar.

KJO është situata jonë në Shqipëri. Si spektrat e të vdekurve të pagjendur dhe problemet ende të pranishme ndërmjet familjeve të burgosura dhe të internuara gjatë regjimit vazhdojnë të fanisin jetën politike, sociale dhe kulturore në Shqipërinë e sotme. Në çdo fushë, e shkuara e ndjek pas si fantazmë të tashmen dhe **do të mbetet e tillë** si të vdekurit e pavarrosur, deri sa ne e marrim parasysh të shkuarën. Po si mund ta bëjmë këtë gjë? Etkind përcakton tri energji parësore që shërbejnë si shtysë për njerëzit në situatat pas katastrofave:

Përpjekjen konjitive për të mësuar për katastrofën;

Dëshirën emocionale për të vajtuar për viktimat e saj;

dhe shtysën aktive për të gjetur drejtësi dhe për t'u hakmarrë ndaj keqbërësve.

Shqipëria e ka kaluar momentin kur mund të ishte e mundur që drejtësia të gjendej në shkallë të gjerë. Prandaj, trajtimi i së shkuarës është veçanërisht i rëndësishëm për plotësimin e nevojave për të mësuar në lidhje me katastrofën (dëshirën konjitive) dhe për të vajtuar për viktimat e saj (dëshirën emocionale). Por, çfarë kuptojmë me vajtim? Vajtimi e sjell të shkuarën te e tashmja, në mënyrë që të njohë dhimbjen, pikëllimin dhe praninë e dhunës; duke e pranuar atë, ne krijojmë "një shtëpi për veten e gjymtuar dhe të dhunuar të tjetrit" (Das 2007, 47–48). Ajo çfarë është më e rëndësishmja, vajtimi na lejon të rilidhemi dhe të rimishërojmë cohën e memories ndër breza që është shkëputur nga katastrofa. Në rastin e këputjes traumatike, kur një komb i tërë ka shtrembëruar kujtesën e tij përmes fushatave propagandistike të vendosura me dashje, kur mizoritë fshihen ose mohohen, kur shfaqet e gjyqeve shfaqin publikisht fuqinë e shtetit dhe shndërrojnë çdo nocion të së vërtetës dhe drejtësisë në farsë dhe absurditet, kur njerëzit mbijetojnë për shkak të heshtjes dhe censurimit të vetvetes, duke pretenduar se pajtohen me forcat e pushtetit, në mënyrë që të mos bëhen viktima të atij pushteti - në këto rrethana, vazhdimësia midis përvojës individuale dhe kujtesës dhe ndërmjetësimit shoqëror përmes së cilit kujtesa kolektive mund të stabilizojë një histori të vetvetes dhe kombit është e shkatërruar. Pikërisht përmes vajtimit nipërit e mbesat e botës postkatastrofike duhet të rivendosin linjat e transmetimit midis përvojës individuale dhe kolektive (Etkind 245).

**Dhe këtu puna jonë me trashëgiminë komuniste bëhet shumë e rëndësishme.**

Puna e trashëgimisë si riparues shoqëror duhet të përfshijë dimensionet komplekse të traumës, humbjes, vajtimit, bashkëveprimit, mohimit, shtypjes dhe shtrembërimit. Kjo **punë vajtimi** kërkon atë që Heidi Bauer-Clapp e quan **përkujtim restaurues** - përkujtimin që "përfshin angazhimin e

individit dhe të tërë komunitetit me dimensionet materiale, sociale, apo politike të dhunës në të shkuarën, në mënyrë ideale me konsiderimin e njëkohshëm të asaj që nënkuptonte kjo dhunë në të shkuarën dhe çfarë vazhdon të nënkuptojë ajo edhe në të tashmen”(3).

Është kjo pikë - çfarë nënkuptonte dhuna në të shkuarën dhe çfarë nënkupton ajo aktualisht - ajo që e mbyll rrethin se pse të merresh, më në fund, me krimet e diktaturës së proletariatit kërkon ta vendosim veten në trashëgimi, si përgjigje ndaj kërkesave të të vdekurve: **përkujtimi restaurues i trashëgimisë së dhunshme pranon borxhin e të gjallëve ndaj sakrificave të të vdekurve - kjo është një lloj shlyerjeje, një shenjtërim i marrëdhënieve shoqërore të profanizuara nga diktatura e proletariatit. Përmes punës së kujtesës, si vajtimi, ne kemi shpresën e pajtimit, shërimit dhe zgjidhjes së vuajtjeve"** (Rowlands qtd. Fontein 1999: 142).

Tani më lejoni ta bëj konkret këtë argument: viti 2018 mund të karakterizohet si viti i ngërçit mbi teatrin kombëtar. Qeveria dëshiron të shkatërrojë Teatrin Kombëtar - skenën e krimit që vendosi qeverinë komuniste në Shqipëri dhe përuroi sistemin e gulagut - dhe t’ia japë tokën në qendrën historike një biznesi privat për të ndërtuar një ndërtesë të lartë<sup>9</sup>. Ky plan parashikohet të vijohet përmes një "ligji të veçantë" - i miratuar përmes Parlamentit me shumicën e qeverisë - një ligj që është kondërshtuar dy herë, nga Presidenti, duke përmendur baza të shumta paligjshmërie<sup>10</sup>.

Shfaqja e gjyqit e vitit 1945 dëshmon për krimin inaugures të komunizmit, dhe përpjekja e shtetit për të shkatërruar skenën e krimit përsëritet, është pikërisht struktura e krimit shtetëror, ku ligjet e shtetit përdoren për të legjitimuar dhe për të realizuar krimet e tij. Të shkatërrosh teatrin është të na dënosh të jetojmë pa vajtuar - dhe, me shkatërrimin e teatrit, të pavajtuar, vjen edhe përsëritja e shtetit kriminal. Këtë nënkuptonte Balinti kur thoshte se, nëse nuk arrijmë të kuptojmë natyrën e shtetit kriminal, strukturat e krimit të shtetit **të atëhershëm** do të vazhdojnë ta përcaktojnë shtetin e **tanishëm**.

Prania e të vdekurve të gjallë vazhdon ta ndajë shoqërinë, pasi ne vazhdojmë të banojmë në strukturat e dhunës që përsosi Hoxha gjatë 40 viteve si arkitekti i terrorit shtetëror. Përtej ekzekutimeve, përtej sistemit të gulagëve, përtej aparatit të mbikëqyrjes, përtej dhunës specifike të miratuar, është në të vërtetë baza e marrëdhënieve tona njerëzore ajo që është përdhosur, dhe është kjo përdhosje që mbetet një plagë e hapur sot - plagë kjo e cila do të shërohet vetëm kur të merremi me natyrën kriminale të shtetit dhe të arkitektit të saj, Enver Hoxhës. Terrori i shteti ka manipuluar cohën e marrëdhënieve tona shoqërore dhe është detyra

<sup>9</sup> (Erebera <https://www.reporter.al/projektligj-i-jashtezakonshem-per-shembjen-e-teatrit-kombetar>).

<sup>10</sup> (Meta <http://president.al/en/njoftim-per-media>).



jonë, tani, ta ripozicionojmë veten si qenie njerëzore në një lidhje etike me njëri-tjetrin. Dhe kjo gjë realizohet pikërisht përmes vajtimit nga nipërit e mbesave në kohët pas katastrofave.

Dua ta mbyllem me frikën e shprehur nga një koleg i imi kur i kërkova ndihmë për rekrutimin e pjesëmarrësve në një ngjarje kundër korrupsionit:

Problemi im është tema dhe niveli i lartë i vetëcensurës që kemi, gjë që përkeqësohet çdo ditë. Kam frikë se diplomatët nuk do të guxojnë të flasin. OKB-ja dhe të gjitha organizatat e tjera ndërkombëtare të pranishme nuk kanë qenë kurrë më të qetë përpara stilit të korrupsionit të Shqipërisë. Problemi i dytë i dukshëm është se korrupsioni është i lidhur me mafian dhe kjo e bën të folurit një gjë mjaft të guximshme<sup>11</sup>.

Për të thyer heshtjen që po lejon një marshim të qëndrueshëm drejt një diktature të re, duhet të përballemi me trashëgiminë e Enver Hoxhës. Për të ndryshuar strukturën e krimit shtetëror tani, ne duhet të merremi, më në fund, me natyrën kriminale të shtetit - me mënyrat me të cilat shteti përdor ligjin dhe institucionet e shtetit për të legjitimuar dhe kryerjen e krimeve të tij - dhe ne duhet të merremi me Enver Hoxhën si arkitekti i terrorit shtetëror. Siç argumenton Etkind, nën një regjim që refuzon të pranojë dhunën e vet, vajtimi i viktimave të tij [është] një veprim politik, një mekanizëm i rëndësishëm dhe ndonjëherë edhe mbizotërues i rezistencës ndaj [vazhdimësisë së] regjimit ”(2013, 243). Aktet dhe veprat e zisë janë pra veprime të zgjedhjes etike, rezistencës politike dhe vetëshprehjes estetike (Etkind 2013, 243).

Atëherë, si mund ta nisim punën për llogaridhënien e strukturave të shtetit dhe të institucioneve të kriminalitetit? Dhe si e kërkojmë këtë llogaridhënie në një mënyrë që na ndihmon të arrijmë pajtimin dhe ta bashkojmë shoqërinë? (Balint 5). Disa pika fillestare përfshijnë:

Prioritizimin e përkujtimit restaurues në vendet e trashëgimisë kulturore si akt të vajtimit kulturor;

Artikulimin e strukturave të terrorit shtetëror parësor - çdo dhunë ndaj popullsisë shqiptare është kryer në mënyrë të ligjshme, duke ndjekur ligjet e shtetit, dhe është realizuar nga institucionet e shtetit. Përdorini këto formulime për t'u ballafaquar drejtpërdrejt me apologjetët dhe justifikuesit me prova për natyrën kriminale të shtetit;

Të kuptuarin dhe të artikuluarin e mënyrës se si ndërtohet mohimi në funksionimin e shtetit;

---

<sup>11</sup> (komunikim me email, nëntor 2018).

Përdorimin e mundësisë së rëndësishme të ofruar nga Autoriteti i krijuar rishtazi për të hapur dosjet e ish sigurimit dhe ish regjimit komunist për të lobuar në qeveri për të sjellë një komision historik të së vërtetës dhe kujtesës në Shqipëri.

Joost Fontein-i argumenton në librin *The Politics of the Dead* se pranimi i borxhit të të gjallëve ndaj sakrificave të të vdekurve është një lloj shlyerjeje, një shenjtërim i marrëdhënieve shoqërore të përdhosura nga dhuna e shtetit. Përmes punës përkujtuuese, të tilla si vajtimi, ne kemi mundësinë që të merremi, më në fund, me Enver Hoxhën si arkitektin e terrorit shtetëror dhe, në këtë mënyrë, të arrijmë pajtimin, shërimin dhe zgjidhjen e vuajtjeve”(Rowlands qtd. Fontein 1999: 142). KY, është detyrimi ynë moral: të sjellim një përkujtim restaurues në trashëgiminë tonë të trazuar pikërisht në mënyrë që të shërojmë vuajtjet, të vajojmë të vdekurit dhe të çlirojmë të gjallët.

### ***Punimet e cituara***

Amy, Lori. “Re-Membering in Transition: The Trans-National Stakes of Violence and Denial in Post-Communist Albania”, in: *History of Communism in Europe, Vol. I, Politics of Memory in Post-Communist Europe*, 205 - 222. Bucharest: Zeta Books, 2010.

Balint, Jennifer. *Genocide, State Crime, and the Law: In the Name of the State*. London: Routledge-Cavendish, 2012.

Bourdieu, Pierre. *The Language of Symbolic Power*. Cambridge: Harvard University Press, 1999.

Connerton, Paul. *How Societies Remember* London: Cambridge University Press, 1989.

Das, Veena, *Life and Words: Violence and the Descent into the Ordinary*, Oakland: University of California Press, 2006.

Elsie, Robert, *The 1945 Albanian Treason Trial*. Create Space Independent Publishing Platform, 2015.

Erebara, Gjergj, “Sons’ Search For Father Uncovers Albanian Mass Grave,” *Balkan Insight*, 11 shkurt, 2010, <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-governments-knew-of-communist-mass-grave>.

Erebera, Gjergj, “Projektligj i jashtëzakonshëm për shembjen e Teatrit Kombëtar,” *Reporter Albania*, 10 qershor 2018, <https://www.reporter.al/projektligj-i-jashtezakonshem-per-shembjen-e-teatrit-kombetar>.

Etkind, Joseph. *Stories of the Undead in the Land of the Unburied*. Palo Alto: Stanford University Press, 2013.

Fontein, Joost, *The Politics of the Dead: Living Heritage, Bones and Commemoration in Zimbabwe*, *Association of Social Anthropologists Edinburgh of the UK and Commonwealth*, March 8, 2017,

[https://www.theasa.org/publications/asaonline/articles/asaonline\\_0102.shtml](https://www.theasa.org/publications/asaonline/articles/asaonline_0102.shtml).

Hirsch, Marianne. *The Generation of PostMemory: Writing and Visual Culture after the Holocaust*. New York: Columbia University Press, 2012.

International Council on Monuments and Sites. “A Cultural Heritage Manifesto.”

October 2015, <http://www.icomos->

uk.org/uploads/sidebar/PDF/A%20Cultural%20Heritage%20Manifesto.pdf

Krasniqi, Afrim. *'Civil' shqiptar – Një hisotri e pafundme tranzicioni*. Dorëshkrim i pabotuar. Revista Universitare Illyrus, Shqipëri.

M., mesazh në FB, datë 25 tetor.

Republika e Shqipërisë Presidenti. Presidenti Meta dekreton rishikimin e Ligjit 37/2018 nga Kuvendi i Shqipërisë. 27 korrik 2018, <http://president.al/en/njoftim-per-media/>.

Kombet e Bashkuara. Raporti i Kombeve të Bashkuara ose Komiteti Ad Hoc për Punën e Detyruar, Shtojca Nr. 13 në Regjistrat Zyrtarë të Sesionit të Gjashtëmbëdhjetë të Këshillit Ekonomik dhe Social dhe Nr. 36 në Studime dhe Raporte (Seritë e reja) të Punës Ndërkombëtare Zyra, Gjenevë, 1953.

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Të mohuar nga regjimi : burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri në 1945-1990 : konferenca ndërkombëtare shkencore : Tiranë , 30-31 tetor 2018 / përgat. për bot. Sonila Boçi ; red. Meliha Balla. – Tiranë : AIDSSH, 2019, 453f. : me foto ; ... cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-4553-8-3

1.Persekutimi politik	2.Të burgosur politikë	
3.Kampe të përqendrimit	4.Historia	
5.Sundimi komunist, 1945-1991	6.Konferenca	7.Shqipëri



323.281(496.5) "1945/1990" (062)

94(496.5) .09 (062)

## Organizuar nga:

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Institutin e Integritit të ish të Përndjekurve Politikë.

Aktiviteti u mbështet nga PNUD në Shqipëri dhe Qeveria e Italisë, në kuadër të projektit "Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar", Fondacioni Konrad-Adenauer (KAS), Rrjeti European i Kujtesës dhe Solidaritetit (ENRS), Muzeu Historik Kombëtar.



Empowered lives.  
Resilient nations.